BANKA E SHQIPËRISË

ARTIKUJ TË BOTUAR NË BULETININ EKONOMIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË GJATË NJË DEKADE

Vëllimi II

Periudha

2001 - 2004

Dhjetor 2007

Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Këtyre artikujve lutemi t'u referoheni si mendime personale të autorëve.

Të nderuar lexues,

Buletini Ekonomik i Bankës së Shqipërisë ka 10 vjet që botohet, për një auditor profesionistësh, si në fushën e biznesit, në atë të bankingut, për akademikët dhe për publikun e thjeshtë. Në përmbajtjen e tij, më të shumtën e rasteve kanë zënë vend artikuj, vrojtime dhe analiza të ndryshme të punonjësve të Bankës. Nisur nga dëshira e mirë që këto punime të mund të përdoren apo të gjenden lehtësisht edhe pas një periudhe relativisht të gjatë kohore, nga botimi i parë zyrtar, menduam të publikojmë këtë përmbledhje të tyre në një format të vetëm.

Duam me këtë rast, të tërheqim vëmendjen tuaj, që këto punime, përveç faktit që shprehin opinione dhe përfundime të autorëve, duhen parë edhe të vendosura në kuadrin kohor kur janë shkruar, të lidhura me ngjarjet të cilave u referohen apo me fenomenet që marrin në shqyrtim.

PËRMBAJTJA

2001

Institucionet financiare rurale dhe financimi i ekonomive fermere 9
Drini Salko

Zbatimi i parimeve bazë të Komitetit të Bazelit për
një mbikëqyrje efektive 23
Miranda Ramaj

Monedha Euro është tek pragu 43
Selami Xhepa

Ekonomitë e rajonit 53
Selami Xhepa
Diana Shtylla

Sistemi bankar në Shqipëri dhe vendi që zënë institucionet
e mikrokreditit 75
Fatos Ibrahimi

Analiza e diferencës së interesave midis investimeve dhe depozitave
për vitin 2000 dhe tremujorin e parë të vitit 2001 89
Suzana Sheqeri

Pas sulmit terrorist, çfarë e pret ekonominë…? 105
Fatos Ibrahimi

Shqipëria dhe Euro 115
Gramoz Kolasi

Ekonomia botërore dhe ajo shqiptare pas ngjarjeve
të 11 shtatorit 2001 125
Diana Shtylla

Tendenca e inflacionit në Shqipëri gjatë dekadës së kaluar:
Një vështrim empirik 145
Gramoz Kolasi
Evelina Çeliku
Genti Hashorva

Instrumentet indirekte të politikës monetare 171
Sonila Taçi

Euro - Monedha më e re 203
Fatos Ibrahimi

Euro dhe kursi ligjor i saj 211
Neritan Kallfa

2002

Punonjësit e bankave qendrore 219
Teuta Baleta

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë e realizuar nëpërmjet
operacioneve të tregut të hapur gjatë vitit 2001 235
Suzana Sheqeri
Arta Pisha

Rreziku i kreditit dhe agjencitë listuese të cilësisë së kreditit 245
Aida Hysi

Depozitat në sistemin bankar në periudhën 1999-2000 261
Suzana Sheqeri
Edlira Abazi

Çështje të administrimit të burimeve njerëzore në Bankën e Shqipërisë 297
Ervin Fortuzi

Programi i kompensimeve i një banke qendrore 315
Zhizela Balla

Argumente mbi nivelin e kapitalit minimal të paguar 329
Erjona Suljoti

2003

Reagimi i tregjeve ndaj vendimeve të politikës monetare 349
Suzana Sheqeri
Arta Pisha

2004

Ristrukturimi i sistemit të pagave në Bankën e Shqipërisë 369
Roland Kajca

Godina e Selisë së Bankës së Shqipërisë, Tiranë 395
Niko Shtrepi

Transparenca e Bankës së Shqipërisë 401
Sofika Note

Roli i marrëdhënieve me publikun në audiencat e Bankës së Shqipërisë 425
Esmeralda Uruçi
Bledar Striniqi

Institucionet financiare rurale dhe financimi i ekonomive fermere
Drini Salko
Mars 2001

Zbatimi i parimeve bazë të Komitetit të Bazelit për një mbikëqyrje efektive
Miranda Ramaj
Mars 2001

Monedha Euro është tek pragu
Selami Xhepa
Qershor 2001

Ekonomitë e rajonit
Selami Xhepa
Diana Shtylla
Qershor 2001

Sistemi bankar në Shqipëri dhe vendi që zënë institucionet e mikrokreditit
Fatos Ibrahimi
Qershor 2001

Analiza e diferencës së interesave midis investimeve dhe depozitave për vitin 2000 dhe tremujorin e parë të vitit 2001
Suzana Sheqeri
Shtator 2001

2001

Pas sulmit terrorist, çfarë e pret ekonominë...?
Fatos Ibrahimi
Shtator 2001

Shqipëria dhe Euro
Gramoz Kolasi
Shtator 2001

Ekonomia botërore dhe ajo shqiptare pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001
Diana Shtylla
Dhjetor 2001

Tendenca e inflacionit në Shqipëri gjatë dekadës së kaluar: Një vështrim empirik
Gramoz Kolasi
Evelina Çeliku
Genti Hashorva
Dhjetor 2001

Instrumentet indirekte të politikës monetare
Sonila Taçi
Dhjetor 2001

Euro - Monedha më e re
Fatos Ibrahimi
Dhjetor 2001

Euro dhe kursi ligjor i saj
Neritan Kallfa
Dhjetor 2001

INSTITUCIONET FINANCIARE RURALE DHE FINANCIMI I EKONOMIVE FERMERE

*Drini Salko**

Fjalë kyçe
- Ekonomi fermere - Institucione financiare rurale - Shoqëri Kursim-Krediti -

1. HYRJE

Mundësitë e prodhuesve bujqësorë për burime financiare shtesë, gjatë periudhës së tranzicionit, ballafaqohen me mjaft kufizime, të cilat japin efekte në prodhimin, në ristrukturimin e fermës dhe në investimet, që duhet të kryhen në to. Këto kufizime janë rezultat i kombinimit të faktorëve, që rrjedhin nga informacioni i kushtueshëm dhe jo i plotë në tregjet financiare rurale si dhe i një sërë problemeve specifike të periudhës së tranzicionit.

Një treg financiar rural eficient, luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe në rritjen e produktivitetit në bujqësi. Kjo nënkupton ngritjen e një sistemi financiar për të plotësuar funksionet tipike të një ekonomie tregu. Gjithashtu, të rëndësishme janë edhe mobilizimi dhe shpërndarja e burimeve pa ndërhyrjet qeveritare dhe ndërtimin e një kuadri institucional, që ofron fonde në përputhje me kërkesën.

Nga dy burimet kryesore të kapitalit, të jashtëm e të brendshëm, fondet e brendshme janë komponenti më i rëndësishëm. Në shumicën e vendeve me të ardhura të ulta, fondet e brendshme përbëjnë një pjesë të madhe të burimeve për investime. Një

ndër burimet kryesore monetare, që do të plotësonte një pjesë të konsiderueshme të financimeve për bujqësinë janë dhe kursimet e vetë këtij sektori.

2. NJË VËSHTRIM MBI TREGJET FINANCIARE RURALE DHE INSTITUCIONET QË OPEROJNË NË TO

Vendet në tranzicion ballafaqohen me dy sfida: *së pari;* sektori financiar në vetvete ka nevojë të ristrukturohet rrënjësisht nga një instrument qeveritar për grumbullimin e kursimeve dhe për shpërndarjen e fondeve te ndërmarrjet, në një sistem financiar të pavarur i aftë të kryejë funksionet e tij në një ekonomi tregu; *së dyti*, funksionimi i rregullt i tij është një parakusht për ristrukturimin dhe modernizimin e ekonomive bujqësore dhe bërjen e tyre eficiente.

Një karakteristikë e tregjeve financiare rurale është asimetria e informacionit. Kjo do të thotë që në një transaksion krediti huamarrësi e njeh mirë gatishmërinë dhe mundësinë e tij për të shlyer huanë në afat. Institucioni huadhënës, nga ana tjetër, nuk i njeh qëllimet reale të huamarrësit ose nëse ai mund të ndryshojë mendim pas marrjes së kredisë. Në këtë situatë, rreziku është i lartë. Fitueshmëria e ulët e fermave është një tjetër problem i financave rurale, i cili kufizon mundësinë e shlyerjes së huave. Nga ana tjetër, kolaterali luan një rol të rëndësishëm në mundësinë e fermerit për të siguruar burime financiare shtesë. Në ekonomitë e tranzicionit, kërkesat për kolateral nga institucionet financiare për huatë bujqësore shpesh kanë qenë të larta, për shkak të faktorëve tranzicionalë si: mangësitë në të drejtat e pronësisë, mungesa e tregjeve të tokës, inflacioni i lartë, pasiguria etj..

Për më tepër, bankat shpesh refuzojnë tokën bujqësore si kolateral edhe kur e drejta e pronësisë është e plotë, për shkak të mungesës së tregut të tokës. Kjo ka bërë që të krijohen modele institucionale të përshtatshme, që drejtojnë më mirë rrezikun e mësipërm dhe që përshtaten më mirë në financimin e sektorit rural. Shumë qeveri përdorin banka të specializuara bujqësore si mjetin kryesor të tyre për të kredituar këtë sektor.Klientët, në

mjaft raste, i konsiderojnë këto institucione si pseudoqeveritare dhe huatë e marra nga to si ndihmë qeveritare dhe jo si kontratë tregtare. Në këto raste, bankat bujqësore vazhdojnë të jenë instrumente qeveritare, që subvencionojnë fermat dhe rezultatet janë jo të mira.[1]

2.1. BANKAT DHE FINANCIMI I EKONOMIVE FERMERE

Reformimi dhe zhvillimi i sistemit bankar shqiptar ka për qëllim mbështetjen me produkte dhe shërbime bankare të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

Kërkesat për kredi nga fermerët privatë për financimin e imputeve (plehra kimike, fara, pesticide etj.) dhe pajisjeve të mekanizuara, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të mëdha e në rritje. Krediti rural dhe sigurimi i shërbimeve financiare është ndrydhur shumë edhe nga pamundësia e bankave për t'iu përgjigjur rritjes së kërkesës për kredi nga sektori i ri privat.

Megjithëse, për financimin e bujqësisë funksiononte një institucion i specializuar siç ishte Banka Tregtare Agrare (BTA), mund të themi se ky institucion nuk ka funksionuar siç duhet në mbështetje të bujqësisë. Ineficienca në operacionet krediduese të Bankës Tregtare Agrare (BTA) shprehet në dy aspekte:

së pari, në pamundësinë e kësaj banke për të plotësuar kërkesat për kredi të fermerëve të vegjël. Kjo, pasi BTA vepronte mbi parimet tregtare. Dihet që kostoja e administrimit të kredisë për këtë grup të madh klientësh të vegjël është e lartë. Gjithashtu, dhe vetë niveli i normave të interesit e ka bërë koston e kreditimit të lartë;

së dyti, në shmangien e aktivitetit të BTA nga kredidhënia në sektorin e bujqësisë. Po t'i referohemi të dhënave lidhur me strukturën e kredive të akorduara sipas objekteve, do të shohim se kreditimi për sektorët e tjerë (tregti mallrash, ndërtime etj.) nga kjo bankë zë një peshë të konsiderueshme.

Në fund të vitit 1996 në strukturën e tepricës së kredisë së kësaj banke zëri "aktivitet tregtar" plus zërin "ndërtime", zënë 64 për qind të tepricës. Huatë e akorduara si nga fondet e vetë BTA-së ashtu edhe nga fondet e projekteve, të financuara nga donatorët dhe që kanalizoheshin nëpërmjet bankës, në pjesën më të madhe, nuk drejtoheshin në veprimtaritë ekonomike të ekonomive fermere.

Ineficienca e dhënies së kredive për sektorin bujqësor gjen shprehjen e vet dhe në nivelin mjaft të lartë të kredive të pakthyera në afat. Në fund të vitit 1996 kreditë e pakthyera në afat të tre bankave me kapital shtetëror zinin rreth 33 për qind të të gjitha kredive të akorduara. Kriza e vitit 1997 e rriti më tej këtë tregues negativ.

Prodhuesit bujqësorë privatë pas viteve 1990, në pamundësi për të siguruar kredi nga bankat tregtare, kanë përdorur si burim financiar shtesë, marrjen hua nga fajdexhinjtë, miqtë apo të afërm të tjerë.

Sipas një vrojtimi, të realizuar për vitet 1993-1994, në 25 nga 36 rrethet e vendit, në rreth 648 ferma doli se vetëm 2 për qind e fermerëve kanë përdorur kredi nga sistemi bankar. Ndër vështirësitë që ata theksonin për marrjen e kredive nga bankat janë: përqindja e lartë e interesit, burokracia e procedurave dhe afati i shkurtër i maturimit. Një pjesë tjetër kanë përdorur kredinë nga të afërmit ose nga tregtarët.

Viti 2000 u karakterizua, krahas zgjerimit të veprimtarisë së bankave tregtare private edhe nga një rritje e ndjeshme e kreditimit të ekonomisë nga bankat. Stabiliteti makroekonomik, rritja e sigurisë në vend dhe përmirësimi i klimës për investime janë faktorët, që gjatë vitit të kaluar i bënë bankat të rritin interesimin për kreditimin e ekonomisë. Pothuajse të gjitha bankat, në bazë të politikave të tyre, shprehin interes të kreditojnë biznesin e mesëm e të madh. Edhe ato banka që kanë në politikën e tyre kreditimin e biznesit të vogël (siç është banka FEFAD) e përqendrojnë vëmendjen e tyre në klientelën e zonës urbane, duke mos kredituar ekonomitë fermere. Kreditë e

pakta në këtë sektor janë dhënë në raste të rralla në veprimtaritë agroushqimore dhe në ngritjen e serave.

Një bankë, që sapo ka filluar të japë kredi në bujqësi është "Banka Amerikane e Shqipërisë". Megjithatë, klientët e sektorit bujqësor të kësaj banke janë në numër mjaft të kufizuar dhe kryesisht operojnë në zonat e ulta perëndimore (ku dhe janë fermerët më të specializuar).

Ndër shkaqet kryesore të moskreditimit të ekonomive fermere nga bankat mund të rendisim:

- Mungesa e kapacitetit institucional të bankave tregtare, për shkak të kostos së lartë që kanë kreditë e vogla. Bankat i konsiderojnë veprimtaritë e ekonomive fermere të vogla dhe për rrjedhojë, huadhënien për to të kushtueshme.
- Madhësia e vogël e fermave dhe të ardhurat e pamjaftueshme të tyre, pengojnë thithjen e investimeve formale në sektorin e bujqësisë e në sektorë të lidhur me të.
- Normat relativisht të larta të interesit (për shkak të primit shumë të lartë për rrezikun e kredisë) janë një faktor tjetër pengues. Fermerët e vegjël nuk mund të shlyejnë kredinë me kushtet tregtare që ofron banka. Kjo rezulton si nga praktika e deritanishme, ashtu dhe nga konkluzioni i nxjerrë nga anketimi i buxhetit të fermës.
- Bankat nuk angazhohen në kredidhënien në bujqësi, sepse ato i shohin fermat si aktivitete jo të vazhdueshme dhe jo shumë të qëndrueshme. Kjo është edhe rrjedhojë e tendencës së zhvendosjes së familjeve fshatare drejt zonave urbane.
- Fermerët e vegjël shpesh kanë mungesë kolaterali për të plotësuar kërkesat e bankës. Mosfunksionimi i tregut të tokës është një pengesë relativisht e madhe për kreditimin, sepse toka ende nuk preferohet të shërbejë si kolateral.
- Mungesa e infrastrukturës bankare në sektorin rural, që shfaqet në mosshtrirjen e veprimtarisë së bankave në këtë sektor. E vetmja bankë, që ka shtrirje në gjithë territorin e vendit është Banka e Kursimeve. Kjo bankë, ka ndaluar kredidhënien për ekonominë pasi është në fazën

e ristrukturimit dhe të përgatitjes për privatizim. Të gjitha bankat e tjera operojnë kryesisht në Tiranë dhe vetëm dy vitet e fundit kanë filluar të shtrijnë veprimtarinë në disa qytete kryesore të vendit për kredi.

2.2. KRIJIMI I INSTITUCIONEVE TË MIKROFINANCËS NË FSHAT - ALTERNATIVË PËR MBËSHTETJEN E EKONOMIVE FERMERE

Mosinteresi i bankave për financimin e bujqësisë si dhe transformimet strukturore që pësoi sektori bujqësor si rrjedhojë e reformave ekonomike të ndërmarra, e bënë të domosdoshëm krijimin e institucioneve financiare rurale, të përshtatshme me kushtet e vendit tonë. Një nga modelet më të efektshme institucionale përfaqësohet nga kooperativa e kreditit, që në vendin tonë është emërtuar Shoqëri Kursim- Krediti (SHKK). Eksperienca e tyre, përgjithësisht ka qenë e suksesshme. Për shembull, në Rumani, bankat kooperativë kanë qenë të suksesshme në dhënien e huave për fermerët e vegjël privatë. Në Bullgari, një program i një fondi reciprok (*mutual fund*) për bujqësinë u zhvillua me mbështetjen e programit Phare të BE. Në Shqipëri, Fondi i Zhvillimit Shqiptar (FZHSH) dhe komponenti rural i tij sot, Fondi i Financimit Rural (FFR) kanë qenë të suksesshëm.

Eksperienca e vendeve në tranzicion është e ndryshme. Për shembull, në Rusi përpjekjet për të krijuar kooperativa krediti nuk sollën rezultatet e dëshiruara.

Ngritja dhe operimi i këtyre institucioneve të reja financiare në sektorin rural reflekton, gjithashtu, edhe modelet e ndryshme të strukturës së fermave. Këto të fundit, në shumë ekonomi tranzicioni variojnë në madhësi nga mjaft të mëdha në mjaft të vogla (tabelë 1). Kjo mund të kërkojë institucione të ndryshme. Kërkesat për kredi të fermave të mëdha mund të plotësohen nga huatë e bankave tregtare. Nga ana tjetër, fermat e vogla duke patur kosto transaksioni e ndërmjetësimi të lartë, mund

të shërbehen më mirë nga kooperativat e kreditit. Në Hungari, Poloni apo Rumani institucione të tilla tashmë operojnë dhe kanë prirje të zgjerohen.

Tabelë 1. Treguesi individual bujqësor në disa vende (TIB) në vitin 1995[2].

Vendi	TIB	Vendi	TIB
Shqipëria	94.2	Republika Çeke	22.1
Armenia	81.8	Hungaria	17.3
Latvia	80.2	Bjellorusia	15.2
Rumania	55.2	Ukraina	14.1
Bullgaria	45.4	Rusia	12.1
Estonia	37.5	Sllovakia	3.1

Shihet dominimi i fermerëve individualë në bujqësinë shqiptare, e ardhur kjo nga reforma në këtë sektor ekonomik. Shpërndarja e tokës bujqësore tek fermerët ka qenë një proces relativisht i shpejtë në Shqipëri. Kjo pati si rezultat krijimin e një numri mjaft të madh fermash të vogla, rreth 380.000, me një sipërfaqe mesatare toke që varion nga 0,5 deri 1.8 ha për familje fermeri, e ndarë kjo në disa parcela. Ky tregues e bën mëse të qartë domosdoshmërinë e operimit të SHKK në Shqipëri si një institucion financiar i përshtatshëm për këtë strukturë. Këto institucione financiare të mikrofinancës mund të mobilizojnë kursimet e këtij sektori, duke i përdorur ato në zhvillimin e tij.

3. ROLI I FONDIT TË FINANCIMIT RURAL. THEMELIMI I SHKK

Sektori rural në vendin tonë gjatë këtyre viteve, ka siguruar financim shtesë nga disa burime. Këtu përfshihen huatë nga ish-Banka Tregtare Agrare, huatë nga organizatat ndërkombëtare (fondet e donatorëve të ndryshëm dhe projektet e zhvillimit) si dhe huadhënësit individualë (sektori informal). Projekti i Kredisë Rurale i implementuar më parë nga FZHSH dhe tani nga FFR është projekti më i vjetër dhe me shtrirje më të gjerë në zonat rurale shqiptare. Fillimisht, ky program nisi në kuadrin e Projektit të Zbutjes së Varfërisë Rurale me objektiv lehtësimin e periudhës

tranzitore për fermerët e varfër dhe më pas, mori formën e plotë të një programi mikrofinance. Programi ofronte një sistem të ri kredie, të bazuar në bashkëpunimin ndërmjet dy hallkave; këshillit të kredisë së fshatit (KKF) dhe oficerit të kredisë. Nëpërmjet tyre realizohej dhënia e kredive të vogla fermerëve, të cilët nuk mund të mbështeteshin me kredi nga bankat. Krahas kësaj, bëhej edhe trajnimi i fermerëve dhe i KKF.

Miratimi i kredisë bazohet në kritere të qarta dhe të kuptueshme mirë: mundësitë që ka huamarrësi për të kthyer kredinë, mundësitë e investimit, aftësitë dhe besueshmëria te klienti etj.. Ky projekt adoptoi skema krediti bazuar në kërkesat e fermerëve për kredi të vogla, që i korrespondonin nivelit ekonomik të fermës së tyre. Tavani i kredisë, nga disa qindra dollarë dhënë në fillimet e këtij procesi sot është 2000 usd dhe kreditë jepen për një periudhë deri në 3 vjet. Në raste të veçanta mund jepen kredi deri në 5000 usd.

Zonat e ndërhyrjes, gjatë këtyre viteve, kanë qenë rrethet Elbasan, Tiranë, Vlorë, Krujë, Gramsh, Peshkopi, Kukës, Pukë, Has e Tropojë.

Aktiviteti kryesor i përdorimit të kredisë, për shumë kohë, ka qenë blegtoria, e lidhur kjo me zonën ku shtrihej veprimtaria e FFR, me shumën e kredisë dhe me nevojat e emergjencës së familjeve fshatare. Gjithnjë e më shumë, po vihet re ndryshimi i raporteve në aktivitetet e financuara me kredi. Deri në këtë periudhë, 53.38 për qind e shumës është përdorur në blegtori, në një kohë që mesatarja kumulative është 61.69 për qind. Pra, vihet re një tendencë uljeje e përdorimit të kredisë për blegtori në favor të aktiviteteve të tjera si sera, tregti, mekanikë bujqësore, artizanat etj., që janë aktivitete më rentabël dhe që ndikojnë në mënyrë të dukshme në zhvillimin e fermës fshatare.

Hapja e fshatrave të reja rreth qyteteve si dhe rritja e interesit për të kryer investime, ndryshoi edhe kërkesën për kredi, si nga pikëpamja e shumës, e kohëzgjatjes ashtu edhe e aktiviteteve të financuara. Në funksion të kërkesës dhe të objektivave të projektit u eksperimentua dhënia e kredive mbi tavanin e

zakonshëm. Kështu, u dhanë vetëm gjatë vitit 1999, 27 kredi me shuma nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë.

Përveç kësaj, edhe mesatarja e kredive të shpërndara gjatë kësaj periudhe (94 462 lekë) u rrit rreth 20 për qind, në krahasim me atë të shpërndarë gjatë vitit 1998 (78940 lekë). Kjo tendencë vazhdoi edhe më tej, me shumë kujdes, pasi garancia e kredisë praktikisht është vetëm morale.

Mbështetur në çfarë u tha më sipër, Banka Botërore në marrëveshje me Qeverinë Shqiptare, në fillim të vitit 2000, miratoi financimin e një projekti të ri, objektivi strategjik i të cilit është arritja e qëndrueshmërisë financiare dhe transformimi i programit ekzistues të mikrokredisë rurale në një institucion të qëndrueshëm, që progresivisht do të bëhet i vetfinancueshëm.

Objektivi kryesor i projektit të ri të FFR është të krijojë një rrjet SHKK dhe të mbështesë zhvillimin progresiv të unionit të tyre, në përputhje me ligjin mbi SHKK dhe bazuar në sistemin ekzistues të FKF *(fondet e kredisë së fshatit, me status OJQ)* si dhe të zgjerojë zonën e ndërhyrjes së sistemit të kredisë rurale, duke e zgjeruar rrjetin në zonat fushore bregdetare si dhe duke shtuar gamën e shërbimeve financiare, të ofruara fermerëve.

Projekti do të mbështesë transformimin e sistemit të FKF, në një sistem të qëndrueshëm, bazuar në SHKK-të. SHKK-të do të jenë organizata, që do të kenë për qëllim sigurimin e kredisë dhe mbledhjen e kursimeve nga anëtarët. SHKK-të do të kenë një demokraci, autonomi dhe përgjegjësi më të madhe se FKF-të.

Si organizata të zotëruara dhe të kapitalizuara nga anëtarët, SHKK-të do të kenë një iniciativë të fortë për të ruajtur qëndrueshmërinë financiare dhe për të minimizuar rrezikun e moskthimit të kredisë. Shumë detyra, që aktualisht i kryen Fondacioni i Financimit Rural do t'i transferohen progresivisht SHKK-ve, kur ato të kenë marrë kualifikimin e nevojshëm dhe të kenë fituar një autonomi dhe pjekuri më të madhe. Pas një periudhe maksimumi 3 vjet, SHKK-të do të mbështeten për të krijuar unionin e tyre.

Krijimi i një rrjeti SHKK po realizohet nëpërmjet dy rrugëve:

së pari: krijimi i SHKK nëpërmjet transformimit të FKF në SHKK. Këtu, një rol mjaft të rëndësishëm do të luajë FFR, i cili duke e njohur dhe drejtuar këtë eksperiencë do të arrijë të realizojë këtë shndërrim. Eksperienca e deritanishme e kooperimit si dhe mundësitë për kapitalizim të tyre, janë fillesa të mira për arritjen e ngritjes dhe të funksionimit të këtyre institucioneve. FFR, krahas ndihmës teknike, u akordon kredi SHKK-ve me 11 për qind dhe këto ua japin anëtarëve të tyre me 15 për qind (marzh që mbulon shpenzimet operative të tyre).

Me konsolidimin, kapitalizimin e SHKK-ve dhe krijimin e unionit, këto institucione synohet të bëhen të pavarura nga FFR. Në fund të vitit 2000, janë krijuar nëpërmjet këtij transformimi 18 SHKK-të e para, të cilat ende janë në fazën e konsolidimit të tyre. Në fund të vitit 2000, ekonomitë fermere kanë marrë kredi nga FFR 1,8 milionë dollarë, nga të cilët 300 mijë dollarë janë kredi për SHKK-të dhe pjesa tjetër për zonat ekzistuese, ku operojnë FFK. E rëndësishme është që nëpërmjet SHKK-ve, fermerët kanë mundësi të marrin një shumë më të madhe kredie (sot kjo shumë është rritur në 5000 usd) duke u orientuar gjithnjë e më shumë në financimin për qëllime investimi. Disa tregues të veprimtarisë së FFR jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 2. Tregues të veprimtarisë së FFR. Shifrat në usd (1 usd = 140.0 lekë).

Treguesit	31.12.1999	30.06.2000	31.12.2000
Numri i anëtarëve të SHKK-ve	0	112	505
Numri i SHKK-ve të krijuara	0	5	18
Numri i SHKK-ve në proces	0	9	3
Portofoli i huave (outstanding loan)	2694144	2958954	2673760
Numri i huave aktive	5754	5415	4423
Shuma mesatare e huasë	468	534	605

Burimi: FFR, Raporti Vjetor 2000.

së dyti: krijimi i SHKK të reja. Në qoftë se rruga e parë presupozon iniciativën nga jashtë fshatit të kombinuar me atë të fermerëve, kjo rrugë është më origjinale dhe bazohet në iniciativën vetëm të fermerëve. Tashmë në vendin tonë ky proces është në hapat e parë[3].

Krijimi i SHKK-ve të reja është një rrugë tjetër, e cila merr një rëndësi të veçantë po të kemi parasysh edhe mangësinë e rrugës së parë. Edhe nga analiza e aktivitetit ekonomik dhe e buxhetit të fermerëve del që në zonat me perspektivë zhvillimi, kapaciteti i kursimeve dhe ai i shlyerjes së kredisë është më i lartë.

Nga ana tjetër, këto zona kanë një infrastrukturë më të mirë dhe mbi të gjitha mund të konsiderohen zona urbane apo pranë qendrave urbane. Krijimi i SHKK-ve të reja në këto zona merr përparësi edhe për faktin se popullata rurale e këtyre zonave ka më pak premisa apo gatishmëri për t'u shpërngulur drejt qyteteve të mëdha. Deri në fund të vitit 2000, me mbështetjen teknike të FFR janë krijuar tre SHKK të reja në zonat me perspektiva zhvillimi në bujqësi. Nga analiza e të ardhurave bruto, por dhe e të ardhurave monetare, familjet fermere në këto zona kanë të ardhura më të larta. Zona të tilla në mendojmë se përfshijnë ato grupe fshatrash që rrethojnë qendra urbane me mikroqytete të tilla si Vorë, Maliq, Milot, Divjakë, Novoselë etj.. Këto qendra duhet të shërbejnë si vendet ku SHKK do të kenë zyrat e tyre. Kjo, nga ana tjetër, do të ndihmojë dhe për rritjen e shërbimeve bankare për fermerët.

Fillesa më të mira dhe më të shpejta të ngritjes së SHKK-ve të reja kanë ato qendra urbane, në të cilat kooperimi ka një zhvillim më të mirë. Organizime të tilla fermerësh, që kooperojnë në sferat e marketingut, të tregtisë etj., megjithëse janë të pakta në numër, ekzistojnë. Është mjaft e rëndësishme që themelimi i SHKK-ve të para të jetë i suksesshëm, pasi fermeri ynë në fillim kërkon të shohë shembullin, pastaj të veprojë.

Krijimi i SHKK-ve të reja përbën dhe rrugën e vetme të financimit të fermerëve në këto zona, në kushtet kur reforma në sektorin bankar po krijon një boshllëk shërbimesh financiare në fshat.

Rrjeti aktual i SHKK-ve rurale i krijuar, në të cilin, po të përfshihen të tilla institucione të ngritura me mbështetjen e projekteve të tjera, ka arritur në 30. Është kjo arsyeja, që e bëri emergjent rishikimin e kuadrit ligjor përkatës, ku me mjaft

rëndësi janë ndryshimet e propozuara lidhur me mbikëqyrjen e këtyre institucioneve nga Banka e Shqipërisë. Projektligji i SHKK-ve në hartimin e të cilit Banka e Shqipërisë është pjesëmarrëse, tashmë është në fazën përfundimtare dhe pret miratimin nga Kuvendi. Shpejtimi i procedurave për miratimin e tij është i rëndësishëm tashmë, kur këto institucione janë në prag të mobilizimit të kursimeve nga anëtarët e tyre.

PËRFUNDIME

- Ineficienca e sistemit bankar që çoi në likuidimin e Bankës Tregtare Agrare, ka çuar në një situatë paradoksale: megjithëse Shqipëria është një vend bujqësor, nuk ka qoftë edhe një institucion financiar të vetëm, të specializuar në financimin e sektorit rural.
- Kushtet aktuale e bëjnë domosdoshmëri krijimin dhe funksionimin e institucioneve financiare të specializuara në zonat rurale. Si model më i përshtatshëm mendoj se është krijimi dhe operimi i kooperativave të kreditit apo siç mund të quhen ndryshe, shoqëritë e kursim - kreditit. Vetëm këto institucione mund të krijojnë një sistem mikrokredish për fermerin shqiptar.
- Krijimi i SHKK-ve të reja, në zonat me një perspektivë të qartë zhvillimi në bujqësi. Zona të tilla përfshijnë grupet e fshatrave, që janë pranë qendrave urbane dhe qytetet e vogla me orientim bujqësor. Premisat më të mira në krijimin e SHKK-ve të reja janë në ato zona ku operojnë shoqatat e fermerëve. Këto mendoj se duhet të jenë shembulli i parë i themelimit të SHKK-ve.
- SHKK-të gjatë 2-3 viteve të ardhshme mund të shtrihen vetëm në nivel lokal. Pas konsolidimit të këtij rrjeti SHKK, në mënyrë të natyrshme do të lindë nevoja e krijimit të unioneve të para të SHKK-ve dhe kalimi i tyre në formën më të organizuar, duke marrë plotësisht tiparet e një institucioni apo ndërmjetësi financiar, i cili do t'i nënshtrohet kuadrit ligjor, rregullues dhe mbikëqyrës të sistemit bankar.

SHËNIME

* Drini Salko, Lektor i lëndës "Paraja dhe banka" në Universitetin Bujqësor Tiranë dhe anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

[1] Dihet tashmë likuidimi i Bankës Tregtare Agrare veprim, që u ndërmor pas përkeqësimit të portofolit të huave të saj.

[2] Ky tregues (TIB) mat ndryshimin nga fermat shtetërore dhe kolektive në fermat individuale dhe llogaritet si TIB= (In95−In89)/(100−In89)(100), ku In95 dhe In89 janë pjesa e fermave individuale në totalin e tokës bujqësore, përkatësisht në vitet 1995 dhe 1989.

[3] Megjithëse në stadin e sapokrijimit, janë 5 SHKK që janë themeluar në sektorin e bujqësisë.

LITERATURA

Gabriel A.Fuentes: "The Use of Village Agents in Rural Credit Delivery". Journal of Development Studies, Vol.33.No.2;1996.

Johan Swinnen and "Agricultural Finance and Institutional Reform in Hamish Gow: "Transition Economies" Paper presented, 1998.

Franz Heidhues and "Rural Financial Market Development"; Discussion paper Gertrud Schrieder No.1 May 1999.

FFR, "Raport Vjetor" 1999; 2000.

Banka e Shqipërisë, "Raport Vjetor" 1998; 1999.

Banka Tregtare Agrare, "Treguesit statistikorë" 1994 - 1995 – 1996.

ZBATIMI I PARIMEVE BAZË TË KOMITETIT TË BAZELIT PËR NJË MBIKËQYRJE EFEKTIVE

*Miranda Ramaj**

Fjalë kyçe
- Komitetit i Bazelit - Mbikëqyrje bankare - Parime bazë - Inspektor -

Komiteti i Bazelit është krijuar si një komitet për rregullimin bankar dhe praktikat mbikëqyrëse, nga guvernatorët e bankave qendrore të vendeve të grupit të të dhjetëve (G10), në fund të vitit 1974. Ky komitet nuk ka autoritet mbikëqyrës dhe konkluzionet e tij nuk kanë fuqi ligjore. Komiteti formulon standarde të gjera mbikëqyrëse, përgatit udhëzime dhe rekomandime për praktikat më të mira, që autoritete të veçanta mund të zbatojnë në sistemin e tyre kombëtar.

Objektivi kryesor i Komitetit të Bazelit për mbikëqyrjen bankare është:

"Asnjë njësi bankare të mos i shpëtojë mbikëqyrjes dhe mbikëqyrja të jetë e mjaftueshme".

Dobësitë e sistemit financiar të një vendi në zhvillim apo të zhvilluar mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë financiare të këtij vendi, por edhe qëndrueshmërinë ndërkombëtare. Nevoja për të përmirësuar dhe forcuar sistemin financiar, ka ardhur nga rritja e problemeve ndërkombëtare të krijuara. Mbi këtë bazë, Komiteti i Bazelit ka përgatitur një dokument që titullohet "Parimet bazë për një mbikëqyrje bankare efektive.".

Për hartimin e këtij dokumenti, Komiteti i Bazelit ka bashkëpunuar ngushtë edhe me vendet që nuk janë anëtare të G10. Në mënyrë që sistemi i mbikëqyrjes të jetë efektiv është e nevojshme të zbatohen 25 parimet e Komitetit të Bazelit. Këto parime kanë të bëjnë me :

- parakushtet për një mbikëqyrje efektive;
- licencimin dhe strukturën;
- rregullat e kujdesshëm dhe kërkesat;
- metodat e mbikëqyrjes në vazhdimësi;
- kërkesat e informacionit;
- fuqinë ligjore të mbikëqyrësve;
- mbikëqyrjen e aktivitetit bankar jashtë kufijve.

Këto parime përbëjnë disa kërkesa minimale që zbatohen sipas kushteve të vendit përkatës, pavarësisht nga niveli i zhvillimit të tij.

Në përcaktimin e parimeve bazë për një mbikëqyrje efektive është patur parasysh që:

- objektivi kryesor i mbikëqyrjes, është ruajtja e qëndrueshmërisë dhe e besimit në sistemin financiar dhe reduktimi i rrezikut të humbjes së depozituesve dhe të kreditorëve;
- mbikëqyrësit duhet të inkurajojnë disiplinën e tregut;
- mbikëqyrësit duhet të kenë pavarësi operacionale dhe fuqi ligjore për të grumbulluar informacion dhe autoritet për të kërkuar zbatimin e vendimeve të tyre;
- mbikëqyrësit duhet të kuptojnë natyrën e biznesit që kryejnë bankat dhe të sigurohen që rreziku i ndërmarrë nga bankat administrohet mirë;
- profili i rrezikut të çdo banke të vlerësohet mirë dhe të ketë burime të mjaftueshme mbikëqyrëse;
- mbikëqyrësit duhet të sigurohen që rreziku, që ka ndërmarrë banka është në raport me kapitalin e saj, sistemin e kontrollit të brendshëm të saj; dhe
- të vendosin një bashkëpunim të ngushtë me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të tjera.

Banka e Shqipërisë, në zbatimin e rolit të saj mbikëqyrës të sistemit bankar, ka hartuar një sistem të tërë rregullash të detyrueshëm për t'u zbatuar nga bankat e nivelit të dytë me qëllim kufizimin e rrezikut, që ato ndërmarrin gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre.

Në hartimin e sistemit rregullativ, Departamenti i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë është mbështetur në përvojën ndërkombëtare, si dhe në 25 parimet bazë për një mbikëqyrje efektive të Komitetit të Bazelit.

Duke shtjelluar parimet bazë të mbikëqyrjes bankare do të analizojmë zbatimin e tyre në sistemin ligjor dhe rregullativ të mbikëqyrjes bankare.

Parakushtet për një mbikëqyrje bankare efektive

PARIMI 1

Një sistem efektiv i mbikëqyrjes bankare përcakton përgjegjësi dhe objektiva të qartë për çdo individ ose agjenci të përfshirë në mbikëqyrjen e institucioneve bankare. Çdo agjenci ose individ duhet të ketë pavarësinë operacionale dhe burime të mjaftueshme. Për mbikëqyrjen bankare është e nevojshme vendosja e një kuadri të përshtatshëm ligjor duke përfshirë këtu dispozitat, që lidhen me autorizimin e institucioneve bankare dhe me mbikëqyrjen në vazhdimësi të tyre; autoritetin për të trajtuar dhe zgjidhur zbatueshmërinë e ligjeve dhe mbrojtjen ligjore të inspektorëve; vendosjen e rregullave për shkëmbimin e informacionit midis inspektorëve dhe ruajtjen e sekretit të një informacioni të tillë.

Në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë" , në nenin 12 të tij, përcaktohet qartë se Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e bankave:

"Banka e Shqipërisë është ekskluzivisht përgjegjëse për dhënien e licencave dhe për mbikëqyrjen e të gjitha bankave në Republikën e Shqipërisë.".

Pavarësia e këtij autoriteti mbikëqyrës, gjen shprehjen e vet në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", në nenin 1 pikën 3 të tij, ku thuhet: *"…Banka e Shqipërisë është e pavarur nga çdo pushtet tjetër për realizimin e objektivit*

kryesor të veprimtarisë së saj, si dhe në ushtrimin e detyrave të ngarkuara".

Në nenin 3 të këtij ligji jepen objektivat dhe përgjegjësitë e Bankës së Shqipërisë. Në pikën 4c të këtij neni thuhet: *"Banka e Shqipërisë ka për detyrë të licencojë ose t'u revokojë këtë licencë bankave dhe të mbikëqyrë veprimtarinë e tyre bankare, me qëllim që të sigurojë qëndrueshmërinë e sistemit bankar".*

Pra, kuadri ligjor që Banka e Shqipërisë të realizojë me sukses mbikëqyrjen e bankave të nivelit të dytë është i plotësuar.

Detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në ligj si dhe standardet ndërkombëtare të mbikëqyrjes bankare janë shprehur në rregulloren "Për funksionimin e Departamentit të Mbikëqyrjes". Ndërsa, "Manualet operacionale", përmbajnë përgjegjësitë dhe objektivat për çdo individ të përfshirë në mbikëqyrjen e institucioneve bankare.

Më tej, ky parim gjen zbërthim edhe në nenin 41, të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën Shqipërisë", ku thuhet: *"Banka dhe dega e bankës së huaj është objekt kontrolli nga inspektorët e Bankës së Shqipërisë".*

Në këtë kuadër, për të krijuar mbështetjen e duhur rregullative për inspektorët, janë adoptuar rregullore të ndryshme si rregullorja për dhënien e licencave për bankat dhe subjektet jobanka; rregullorja e likuiditetit; e kapitalit minimal të kërkuar; e klasifikimit dhe provigjonimit të kredive; e pozicionit të hapur valutor, e aktivitetit të këmbimeve valutore si dhe e rreziqeve të tregut.

Në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", në nenin 44 të tij, janë të parashikuara edhe gjobat dhe dënimet, si dhe masat që mund të merren ndaj bankave apo administratorëve të tyre në raste të shkeljeve të ligjeve, të mosrespektimit të rregulloreve ose të ndonjë kufizimi tjetër, të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë.

Për zbatimin e plotë praktik të këtij parimi duhen:

- përmirësimi dhe plotësimi i rregulloreve dhe i manualeve operacionale me përgjegjësi dhe objektiva të qartë, për çdo punonjës të departamentit;
- ndryshimet e nevojshme ligjore për të siguruar mbrojtjen ligjore të mbikëqyrësve.

LICENCIMI DHE STRUKTURA

PARIMI 2

Duhet të përcaktohen qartë aktivitetet e lejuara të institucioneve, që janë licencuar dhe që janë subjekt i mbikëqyrjes si banka; duhet të kontrollohet, sa të jetë e mundur më shumë, kuptimi i përdorimit të fjalës "bankë".

Ky parim gjen shprehjen e vet në nenin 26 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohen aktivitetet e lejuara të institucioneve, që janë licencuar dhe që janë subjekt i mbikëqyrjes nga Banka e Shqipërisë. Në nenin 6 (3), të këtij ligji shprehimisht thuhet: *"Asnjë subjekt nuk do të përdorë fjalën bankë ose derivate të fjalës bankë, në ushtrimin e veprimtarisë tregtare…pa licencë të lëshuar nga Banka e Shqipërisë"*.

PARIMI 3

Autoriteti i licencimit duhet të vendosë kritere dhe të anulojë aplikimet për institucionet, që nuk plotësojnë standardet. Minimumi i kërkesave të licencimit duhet të konsistojë në një vlerësim të pronësisë së institucionit, të planit të veprimtarisë dhe të kontrollit të brendshëm të tij, të parashikimit të gjendjes financiare të tij, përfshirë këtu edhe kapitalin bazë të tij dhe kur pronari ose institucioni mëmë është bankë e huaj, duhet të merret miratimi paraprak nga autoritetet mbikëqyrëse vendase.

Në nenin 2 të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 jepet përcaktimi i termit "bankë" dhe "veprimtari bankare", e cila lejohet të kryhet vetëm me një licencë të dhënë nga Banka e Shqipërisë.

Në kreun II (nga neni 7 deri në nenin 14) të ligjit: "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" i jepet Bankës së Shqipërisë autoriteti

i vetëm për dhënien e licencave. Në mënyrë më specifike, në nenin 10 (2) të këtij ligji jepen kriteret ku mbështetet Banka e Shqipërisë, për dhënien e miratimit paraprak të licencës. Në pikën 3 të këtij neni thuhet: *"Banka e Shqipërisë, kur vendos për refuzimin e miratimit paraprak të licencës, shpjegon arsyet për të cilat është refuzuar dhënia e licencës"*.

Kreu II i këtij ligji, i cili trajton autoritetin licencues të Bankës së Shqipërisë dhe disa kërkesa të përgjithshme, është zgjeruar më tej në rregulloret e licencimit. Rregulloret e miratuara lidhur me procesin e licencimit janë: rregullorja "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë", rregullorja "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari financiare nga subjekte jobanka në Republikën e Shqipërisë" dhe rregullorja "Mbi kërkesat, që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja". Banka e Shqipërisë ka si objekt licencimi bankat, zyrat e këmbimeve valutore dhe subjektet jobanka, që kryejnë veprimtari financiare.

Rregullorja "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë" shtjellon në mënyrë të detajuar:

- strukturën e pronësisë së bankës së propozuar, duke përfshirë vlerësimin e aktivitetit të aksionerëve, reputacionin e tyre, fuqinë financiare dhe mundësinë e tyre për të mbështetur bankën në qoftë se nevojitet. Rregullorja e mësipërme si dhe ligji nuk e shtrijnë vlerësimin në kontrollin indirekt nga aksionerët, siç kërkohet në zbatimin e parimeve të Komitetit të Bazelit;
- planin e veprimit, sistemin e kontrollit dhe të organizimit të brendshëm të bankës së propozuar. Plani i veprimit përfshin një përshkrim dhe një analizë të pjesës që mendon të zërë banka e propozuar në treg, aktivitetet që do të kryejë dhe një strategji për aktivitetin e mëtejshëm të bankës. Gjithashtu, përshkruhet dhe skema e administrimit dhe e kontrollit të bankës;
- të dhënat për administratorët e bankës, duke parë nëse

ata janë të përshtatshëm moralisht dhe profesionalisht. Autoriteti licencues duhet të ketë informacion të mjaftueshëm për të vlerësuar reputacionin, aftësitë dhe përvojën e administratorëve të propozuar. Në rregulloren "Mbi kërkesat, që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja" janë të specifikuara të gjitha kërkesat e Bankës së Shqipërisë për vlerësimin e çdo administratori të propozuar;

- projektin financiar duke përfshirë kapitalin. Autoriteti licencues duhet të përcaktojë nëse banka ka kapital të mjaftueshëm për të realizuar atë projekt financiar të propozuar. Autoriteti përcakton një shumë minimale të kapitalit të nevojshëm për të zhvilluar aktivitet bankar, që aktualisht është 700 milionë lekë (rreth 5 milionë dollarë);
- miratimin e autoritetit mbikëqyrës të vendit ku ndodhet banka-mëmë, kur aksioner i bankës është një bankë e huaj. Kur pronari i bankës është një bankë e huaj në nenin 4.2.1 të rregullores së licencimit kërkohet në mënyrë specifike: *"miratimi, nga ana e autoritetit mbikëqyrës përkatës, i aktivitetit financiar të drejtorisë qendrore të bankës së huaj të interesuar…"*.

PARIMI 4

Mbikëqyrësit bankarë duhet të kenë autoritetin të shqyrtojnë dhe të anulojnë çdo propozim për transferime të rëndësishme të pronësisë të aksionerëve, që kontrollojnë interesat në bankat ekzistuese të palëve të tjera.

Në nenin 13 (2) të ligjit për bankat, jepen rastet në të cilat mund të revokohet licenca e dhënë. Një nga këto raste, i përfshirë në pikën 2(d) është kur: *"Pa miratimin paraprak me shkrim, të Bankës së Shqipërisë, zotëruesi i pjesës influencuese të kapitalit në bankë ka transferuar ose ka humbur këtë të drejtë…."*.

Në lidhje me përcaktimin në nenin 2 (e) të këtij ligji, me "interesa të rëndësishëm" nënkuptohet mbajtja direkte ose indirekte e 10 për qind ose më shumë të kapitalit aksioner. Në nenin 17 të rregullores "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë" pohohet, që

transferimi i interesave të rëndësishëm (10 për qind ose më shumë) kërkon, pas miratimit të aksionerëve të bankës, miratimin me shkrim nga Banka e Shqipërisë.

Për dhënien e një miratimi të tillë, Banka e Shqipërisë kërkon paraqitjen, për aksionerin që propozohet, të të njëjtit dokumentacion si në rastin kur kemi të bëjmë me miratimin paraprak për licencë.

PARIMI 5

Mbikëqyrësit bankarë duhet të kenë autoritetin të përcaktojnë kriteret për analizimin e saktë të përfitimeve dhe të investimeve kryesore, për t'u siguruar se filialet ose strukturat e korporatës nuk e ekspozojnë bankën ndaj rreziqeve të tepërta ose pengojnë mbikëqyrjen efektive.

Investimet kryesore të një banke, janë të lejuara vetëm në bazë të kufizimeve të neneve 30 dhe 33 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Ky parim gjen zbatim në rregulloren "Për rreziqet e mëdha", ku përcaktohen kufijtë maksimalë të ekspozimit të bankës ndaj rreziqeve, kundrejt një përfituesi dhe një grupi përfituesish.

Në rregulloren "Për pjesëmarrje në kapitalin e shoqërive tregtare nga bankat dhe degët e bankave të huaja" përcaktohet se investimi i lejuar nuk duhet të kalojë 15 për qind të kapitalit rregullator bankar. Investimi që kalon 15 për qind, por jo më shumë se 25 për qind të kapitalit rregullator bankar, duhet të ketë autorizimin paraprak me shkrim nga Banka e Shqipërisë. Mbështetur në kërkesën e ligjit është hartuar një rregullore në lidhje me kriteret, mbi bazën e të cilave, bëhet miratimi, nga Banka e Shqipërisë i dhënies së një autorizimi të tillë. Kjo rregullore, ka për qëllim vendosjen e një ekuilibri ndërmjet aktivitetit të lirë të bankave nëpërmjet pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare dhe respektimit të detyrueshëm të disa raporteve mbikëqyrëse, për të mos lejuar bankat të përballen me rreziqe të natyrës jobankare ose financiare.

KËRKESAT DHE RREGULLORET E KUJDESSHME

PARIMI 6

Mbikëqyrësit bankarë duhet të vendosin një minimum të mjaftueshëm, të detyrueshëm kapitali për bankat, që reflekton rreziqet që bankat do të ndërmarrin dhe duhet të përcaktojnë elementet përbërëse të kapitalit, duke pasur parasysh aftësitë e tyre për të mbuluar humbjet. Për bankat me aktivitet ndërkombëtar, këto minimume të detyrueshme nuk duhet të jenë më pak se ato të vendosura në Marrëveshjen e Kapitalit të Komitetit të Bazelit.

Në nenin 1.4 të rregullores "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë" përcaktohet shuma minimale e kapitalit të kërkuar për të filluar aktivitetin bankar (700 milionë lekë). Në nenin 30 të ligjit për bankat është përcaktuar detyrimi, që kanë bankat për të disponuar një kapital rregullator të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

Elementet përbërëse të kapitalit rregullator të bankës janë përcaktuar në udhëzimin "Për kapitalin rregullator të bankës". Në rregulloren "Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit" aktivet dhe zërat jashtë bilancit klasifikohen sipas rrezikut, duke dhënë dhe koeficientët përkatës. Në këtë rregullore përcaktohet raporti minimal i lejueshëm ndërmjet kapitalit rregullator dhe aktiveve e zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun, që quhet dhe norma e mjaftueshmërisë. Kjo normë është përcaktuar 12 për qind. Në qoftë se norma e mjaftueshmërisë bie poshtë këtij kufiri, bankat janë të detyruara të hartojnë një plan për arritjen ose për rikthimin në këtë normë të detyruar.

Neni 48 i ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" pohon që kur norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës është më pak se 50 për qind e normës së kërkuar (pra, më pak se 6 për qind) banka, brenda një periudhe prej gjashtë muajsh, duhet të rregullojë gjendjen. Në qoftë se, në fund të gjashtë muajve, norma mbetet përsëri më pak se 50 për qind e normës së kërkuar, Banka e Shqipërisë emëron kujdestarin për të marrë në administrim dhe në kontroll bankën, për një periudhë, që nuk duhet të tejkalojë 12 muaj. Në rast se situata

nuk përmirësohet, atëherë, fillon procesi i kujdestarisë dhe më pas i likuidimit të bankës.

Bankat që kanë filluar aktivitetin e tyre më parë se të miratohej rregullorja "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë", pra para datës 31.03.1998 mbështetur në vendimin nr.143, datë 31.03.1998 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, kanë detyrimin që të bëjnë plotësimin e kapitalit të derdhur jo më pak se 700 milionë lekë, brenda afatit 31.03.2001.

PARIMI 7

Pjesë e rëndësishme e çdo sistemi mbikëqyrës është vlerësimi i politikave, i praktikave dhe i procedurave të bankës, që lidhen me dhënien e huave dhe marrjen pjesë në investime, si dhe i administrimit në vazhdimësi, si të portofolit të huasë ashtu dhe të atij të investimeve.

Në nenet 28 dhe 29 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", përcaktohen dokumentet ligjore të detyrueshme për t'u mbajtur nga bankat lidhur me aktivitetin, që ato zhvillojnë. Mbi këtë bazë dhe të akteve të saj të brendshme rregullative, banka krijon një tërësi dokumentacioni të domosdoshëm për të ndjekur në vijimësi aktivitetin e saj, i cili kontrollohet dhe nga Banka e Shqipërisë. Pjesë e këtij dokumentacioni është dokumentacioni i kreditit ku përfshihen politikat dhe procedurat e dhënies së kredisë. Për të ndjekur ecurinë e portofolit të kreditit dhe krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, Banka e Shqipërisë ka miratuar rregulloren "Për klasifikimin e kredive dhe krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë", ku përcaktohen standardet e provigjonimit dhe të klasifikimit të huave, që bankat janë të detyruara të zbatojnë.

Për diversifikimin e rrezikut që ndërmerr banka, Banka e Shqipërisë ka miratuar këto rregullore:

"Për rreziqet e mëdha", që përcakton kufirin maksimal të ekspozimit ndaj rrezikut të përqendrimit për një përfitues deri në 20 për qind të kapitalit rregullator dhe, deri në 700 për qind

për të gjithë përfituesit, që tejkalojnë 10 për qind të kapitalit rregullator;

"Për pozicionet e hapura në valutë" dhe udhëzimin përkatës, në të cilët përcaktohen kufijtë maksimalë të pozicioneve të hapura në valutë për çdo valutë dhe në tërësi.

PARIMI 8

Mbikëqyrësit bankarë duhet të binden se bankat jo vetëm që kanë vendosur, por edhe zbatojnë politika, procedura dhe praktika të mjaftueshme për vlerësimin e cilësisë së aktiveve dhe mjaftueshmërinë e provigjoneve dhe të rezervave për humbjet nga huatë.

Në vazhdim të neneve 28 dhe 29 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton dokumentet e nevojshme bankare, që duhet të mbajnë bankat (përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara) në nenin 31 (2) theksohet se bankat janë të detyruara të klasifikojnë dhe të vlerësojnë aktivet, të provigjonojnë kreditë në bazë të klasifikimit dhe të përcaktojnë kohën kur të ardhurat nga aktivet nuk do të kontabilizohen më.

Gjatë inspektimeve në vend në banka, nga inspektorët e Departamentit të Mbikëqyrjes, bëhen vlerësime në përputhje me rregulloren "Për klasifikimin e kredive dhe krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë", lidhur me mjaftueshmërinë e provigjoneve të krijuara prej bankave dhe me rregulloren "Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit", lidhur me klasifikimin e aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun.

Në përfundim të inspektimeve u jepen bankave rekomandimet përkatëse.

PARIMI 9

Mbikëqyrësit bankarë duhet të binden se bankat kanë sisteme të administrimit të informacionit, që u japin mundësi drejtuesve të identifikojnë përqendrimet brenda portofolit si dhe mbikëqyrësve, të vendosin kufij, për të kufizuar ekspozimin e bankës ndaj huamarrësve të vetëm ose grupeve të huamarrësve.

Ky parim gjen zbatim në nenin 30 të ligjit për bankat si dhe në rregulloren "Për rreziqet e mëdha", ku kërkohet që bankat e nivelit të dytë të kontrollojnë ekspozimin ndaj rreziqeve, duke mos krijuar përqendrime të mëdha.

Gjatë inspektimeve në vend në banka, nga inspektorët e Departamentit të Mbikëqyrjes, bëhen vlerësime në përputhje me rregulloren "Për rreziqet e mëdha", udhëzimin "Për administrimin e rrezikut të normës së interesit" dhe udhëzimin "Për likuiditetin e bankave".

PARIMI 10

Më qëllim që të parandalohen abuzimet, që lindin nga huatë e lidhura, mbikëqyrësit bankarë duhet të vendosin kërkesa, që sigurojnë se bankat u japin hua kompanive dhe individëve të lidhur, mbi baza jopreferenciale; që aktivitete të tilla kredidhënieje administrohen në mënyrë efektive dhe që; për të kontrolluar dhe zvogëluar rreziqet janë marrë masa të tjera, të përshtatshme.

Në kreun V (nenet 35, 36 dhe 37) të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" jepet përcaktimi i personave të lidhur me bankën: *"një person, i cili lidhet me një administrator nëpërmjet një martese, një lidhjeje gjaku të shkallës së dytë ose interesave të biznesit siç përcaktohen në rregulloren e Bankës së Shqipërisë"* (neni 35 (b)). Kushtet dhe afatet e dhënies së kredive janë të njëjta me ato të klientelës.

Për personat e lidhur është vënë kufizimi në rregulloren e re "Për klasifikimin e kredive dhe krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë". Në qoftë se këto kredi nuk janë të kolateralizuara ose të garantuara mirë, atëherë pjesa e pakolateralizuar i zbritet kapitalit rregullator të bankës.

PARIMI 11

Mbikëqyrësit bankarë duhet të sigurohen që bankat kanë politika dhe procedura të mjaftueshme për identifikimin, administrimin dhe kontrollin e rreziqeve të vendit; transferimit të rrezikut të aktiviteteve të investimit dhe të kredidhënies ndërkombëtare dhe për të mbajtur një rezervë të mjaftueshme kundrejt rreziqeve të tilla.

Si është thënë më lart, në nenin 29 (d), bankave u kërkohet të kenë politika dhe procedura të shkruara për identifikimin,

administrimin dhe kontrollin e rreziqeve, duke përfshirë rreziqet ndërkombëtare; megjithatë nuk ka ligj ose rregullore të veçantë, të cilat t'i adresohen "rrezikut të vendit dhe transferimit të rrezikut".

Aktivitetet huadhënëse, që janë zbatuar së fundi prej bankave në Shqipëri janë të kufizuara në marrëdhëniet me klientët shqiptarë ose me ata, që kanë vendosur marrëdhënie me bankën-mëmë në vendin e tyre. Investimet janë të kufizuara në bonot e thesarit të Qeverisë Shqiptare. Ndërkaq, pritet që këto aktivitete të zgjerohen në komunitetin ndërkombëtar. Kërkesa të tilla të përgjithshme të vendosura në nenin 29, aktualisht janë të mjaftueshme.

Duke parë zgjerimin e aktivitetit të bankave, në zbatim të këtij parimi, mendohet hartimi i një rregulloreje, që do të mbulojë rrezikun e vendit dhe transferimin e rrezikut.

PARIMI 12

Mbikëqyrësit bankarë duhet të binden që bankat kanë vendosur sisteme që matin, administrojnë dhe kontrollojnë në mënyrë të mjaftueshme rreziqet e tregut; mbikëqyrësit duhet të kenë të drejtën të propozojnë kufij të veçantë dhe/ose një rezervë kapitale të veçantë për ekspozimin ndaj rreziqeve të tregut, në qoftë se justifikohet.

Siç është theksuar më sipër, në nenin 29 (d) të ligjit mbi bankat përcaktohet që bankat duhet të kenë politika dhe procedura të shkruara për identifikimin, administrimin dhe kontrollin e rreziqeve të tregut. Në nenin 30 të ligjit për bankat, autoriteti që të imponojë kufij specifikë dhe/ose rezervë kapitale për ekspozimin ndaj rreziqeve të tregut i jepet Bankës së Shqipërisë. Për të vendosur këta kufij Këshilli Mbikëqyrës miratoi rregulloren "Për rreziqet e tregut". Aty cilësohen rastet kur zbatohen kuota kapitali shtesë. Kjo rregullore, aktualisht, është pak e zbatueshme për bankat, gjë që lidhet dhe me aktivitetin e kufizuar të tyre. Rekomandimet e reja të Komitetit të Bazelit për mjaftueshmërinë e kapitalit parashikojnë përfshirjen në analizën e rreziqeve të tregut të të gjithë zërave të bilancit, por këto janë akoma në fazë studimore.

PARIMI 13

Mbikëqyrësit bankarë duhet të binden që bankat administrojnë në mënyrë të gjithanshme rrezikun, për të identifikuar, matur dhe kontrolluar të gjitha rreziqet e tjera të konsiderueshme.

Neni i cituar më lart i ligjit për bankat, i jep autoritetin e duhur Bankës së Shqipërisë të zbatojë një vlerësim të përshtatshëm të rrezikut, siç është kërkuar prej këtij parimi.

Gjatë kryerjes së inspektimeve në vend mbikëqyrësit, mbështetur në Manualin e Ekzaminimit, bëjnë një analizë të hollësishme të administrimit të rrezikut në banka.

PARIMI 14

Mbikëqyrësit bankarë duhet të përcaktojnë nëse drejtuesit e bankës kanë zbatuar sisteme të kontrolleve të brendshme, që janë të përshtatshme për natyrën dhe për shkallën e aktivitetit të tyre. Këtu duhet të përfshihet qartë marrëveshja për delegimin e autoritetit dhe të përgjegjësisë; ndarja e funksioneve.

Në nenin 29 të ligjit mbi bankat përcaktohet se duhen hartuar procedura dhe politika të shkruara. Në vazhdim, Departamenti i Mbikëqyrjes, ka hartuar një rregullore për "Kontrollin e brendshëm në banka". Kjo rregullore kërkon që çdo bankë të zhvillojë një sistem efektiv kontrolli të brendshëm të pavarur; të bëjë kombinimin e këtyre kontrolleve për t'u siguruar që bankat operojnë në mënyrë të shëndoshë dhe të sigurtë.

Në nenin 39 (1) të ligjit mbi bankat pohohet që bankat duhet të kenë caktuar një ekspert kontabël të pavarur. Në nenin 41 të ligjit mbi bankat theksohet që*: "Të gjitha bankat do të jenë subjekt i inspektimeve nga inspektorët e Bankës së Shqipërisë dhe nga një ekspert kontabël i licencuar"*. Ligjërisht ky parim është i zbatuar, por praktikisht akoma nuk është realizuar pasi ekzistojnë disa vështirësi në licencimin e shoqërive të njohura si eksperte ndërkombëtare, nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

PARIMI 15

Mbikëqyrësit bankarë duhet të verifikojnë nëse bankat kanë politika, praktika dhe procedura të mjaftueshme në përdorim, duke përfshirë rregulla të përcaktuar "Si të njohësh klientin", të cilët nxisin standarde të larta etike dhe profesionale në sektorin financiar dhe parandalojnë që banka të përdoret, me qëllim ose pa qëllim nga elementë kriminalë.

Ky parim gjen zbatim në ligjin për bankat, neni 26 dhe në rregulloren "Për parandalimin e pastrimit të parave", miratuar me vendim nr. 3.3.1997, datë 16.01.1997 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Në zbatim të tyre, Departamenti i Mbikëqyrjes, në çdo inspektim, vlerëson edhe mjaftueshmërinë e praktikave: "Si të njohim klientin".

Në dhjetor 2000, hyri në fuqi ligji "Për parandalimin e pastrimit të parave", që parashikon krijimin, pranë Ministrisë së Financave, të Agjencisë së Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave.

METODAT PËR NJË MBIKËQYRJE BANKARE TË VAZHDUESHME

PARIMI 16

Një sistem mbikëqyrës efektiv bankar duhet të sigurojë një ndërthurje të mbikëqyrjes në vend me analizën.

Departamenti i Mbikëqyrjes ka Sektorin e Inspektimit në Vend, që realizon mbikëqyrjen bankare. Pjesë e këtij sektori janë dhe analistët, që aktualisht shërbejnë si mbledhës të dhënash, qendër e përpunimit të tyre dhe e përgatitjes së raporteve e analizave.

Grupi i analistëve përgatit analiza të gjendjes financiare të sistemit bankar për çdo muaj me treguesit kryesorë të tij dhe mbikëqyr zbatimin e kufijve të përcaktuar në rregulloret e mbikëqyrjes bankare. Inspektorët kryejnë inspektime të plota apo të pjesshme në banka, të cilat realizohen në afate kohore të përcaktuara. Inspektimet e plota realizohen një herë në vit.

Periudha midis dy inspektimeve ndiqet në vazhdimësi nëpërmjet analizave mujore e tremujore të të dhënave të raportuara nga bankat. Analistët realizojnë edhe furnizimin paraprak me të dhëna të grupit të inspektimit. Ndërthurja e veprimtarisë së analistëve dhe inspektorëve brenda këtij sektori, realizon mbikëqyrjen në vazhdimësi të bankave.

PARIMI 17

Mbikëqyrësit bankarë duhet të kenë kontakte të vazhdueshme me administratorët e bankave, për të njohur kështu gjendjen e tyre.

Është vendosur kontakt i vazhdueshëm me administratorët e bankave, i cili është zyrtarizuar në një takim mujor me drejtuesit e bankave dhe të degëve të bankave të huaja.

Më shumë kontaktet lindin nga problemet që dalin gjatë inspektimeve në vend, si dhe gjatë shqyrtimit të të dhënave të raportuara nga bankat. Si një praktikë pune, Departamenti i Mbikëqyrjes u parashtron administratorëve problemet e dala gjatë inspektimit, të cilat do të përfshihen në raport, përpara se të bëhet miratimi i tij në Bankën e Shqipërisë.

Përpara se të miratohen rregullore të reja të mbikëqyrjes bankare, tërhiqen mendimet e bankierëve dhe shikohet mundësia e zbatimit të këtyre rregulloreve nga bankat e nivelit të dytë.

PARIMI 18

Mbikëqyrësit bankarë duhet të kenë të dhënë një grup raportesh të analizuara dhe të shqyrtuara si dhe të dhëna statistikore nga bankat në bazë unike dhe të konsoliduar.

Në nenet 38 dhe 43 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", bankave u kërkohet që të mbajnë të dhëna të përshtatshme dhe të përgatisin raporte përmbledhëse për Bankën e Shqipërisë. Këto raporte duhet të përgatiten në bazë të konsoliduar dhe individuale (neni 43).

PARIMI 19

Inspektorët bankarë duhet të jenë të pavarur në shqyrtimin e informacionit mbikëqyrës, si nga ekzaminimet në vend, ashtu dhe nëpërmjet kontrolleve të brendshme.

Ligji "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" (nenet 39 dhe 41) përcakton kryerjen e inspektimeve në vend nga inspektorët e Bankës së Shqipërisë, që programohen çdo vit, si dhe nga kontrollorët e jashtëm. Ligji në fuqi, kërkon që kontrollorët e jashtëm të jenë të miratuar nga Banka e Shqipërisë (neni 39 i ligjit). Vlerësimet e inspektorëve dhe të kontrollorëve të jashtëm janë të pavarura, por vetë kontrollorët kanë detyrim ligjor të njoftojnë Bankën e Shqipërisë në raste të gjetjes së veprimeve mashtruese apo të mangësive dhe parregullsive, që i sjellin humbje bankës. Gjithashtu, në nenin 39 të ligjit, përcaktohet që një kopje e opinionit të kontrollit të ekspertit kontabël të autorizuar, i dërgohet Bankës së Shqipërisë.

PARIMI 20

Një element i rëndësishëm i mbikëqyrjes bankare është aftësia e inspektorëve të mbikëqyrin grup bankash në mënyrë të konsoliduar.

Mbështetur në nenin 43 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" inspektorit i krijohet një mundësi e tillë, duke bërë vlerësimin e gjendjes financiare të bankës ose të degës së bankës së huaj sipas të dhënave të konsoliduara, të sjella prej tyre. Realizimi i inspektimeve në vend të degëve të bankave jashtë vendit, kushtëzohet edhe nga marrëveshje reciproke të autoriteteve mbikëqyrëse të vendeve respektive.

Ky parim nuk është plotësisht i zbatueshëm pasi ne kemi një sistem rregullativ mbi baza individuale.

INFORMACIONI I KËRKUAR

PARIMI 21

Mbikëqyrësit bankarë duhet të sigurohen se çdo bankë mban të dhëna të mjaftueshme në bazë të politikave dhe të praktikave unike kontabile. Këto u lejojnë mbikëqyrësve të krijojnë një përfytyrim të saktë të gjendjes financiare të bankës dhe eficiencën e biznesit të saj. Gjithashtu, duhet të sigurohen se bankat publikojnë periodikisht deklaratën e gjendjes financiare, që reflekton saktësisht gjendjen e vërtetë të bankës.

Në nenet 38 dhe 40 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", u kërkohet bankave të mbajnë të dhëna të mjaftueshme dhe t'i publikojnë ato në raportin e tyre vjetor.

Nga 1 janari i vitit 1999 ka filluar përdorimi i "Manualit të kontabilitetit bankar" dhe bankat raportojnë në Bankën e Shqipërisë duke përdorur këtë sistem.

FUQIA LIGJORE E MBIKËQYRËSVE

PARIMI 22

Mbikëqyrësit bankarë duhet të kenë në dispozicion të tyre mjete të mjaftueshme mbikëqyrëse për të marrë masa korrektuese në kohën e duhur, në rastet kur bankat nuk arrijnë të zbatojnë kërkesat e rregulloreve (si për shembull, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit), kur ka shkelje të rregulloreve ose kur depozituesit janë të kërcënuar në ndonjë formë tjetër. Në rrethana ekstreme, kjo duhet të përfshijë të drejtën për t'i revokuar licencën ose të rekomandojë revokimin e saj.

Në kapitujt VII dhe VIII (nenet 44-65) të ligjit për bankat, përcaktohen masat ndëshkimore dhe dënimet, që mund të ndërmerren nga Banka e Shqipërisë në rastet e shkeljes së ligjit, të rregulloreve apo të ndonjë urdhri të saj. Përfshihet në këto masa edhe revokimi i licencës (neni 44 (2) (g)).

VEPRIMTARIA BANKARE JASHTË KUFIRIT

PARIMI 23

Mbikëqyrësit bankarë duhet të praktikojnë mbikëqyrje të konsoliduar globale mbi organizatat bankare me aktivitet ndërkombëtar, mjaftueshmëri administrimi dhe zbatimi të normave të kujdesshme, të përshtatshme për të gjitha aspektet e aktivitetit të kryera nga këto organizata bankare me përmasa ndërkombëtare, kryesisht në degët e tyre të huaja, bashkimeve apo bija (filiale).

Aktiviteti bankar i zhvilluar në Shqipëri është i kufizuar. Ai nuk është shtrirë jashtë vendit, me degë apo filiale.

Për këtë arsye, mbikëqyrësit e Bankës së Shqipërisë janë të kufizuar në aktivitetet e brendshme.

PARIMI 24

Një element kyç i mbikëqyrjes së konsoliduar është krijimi i kontakteve dhe shkëmbimi i informacionit me mbikëqyrës bankarë të vendeve të tjera, kryesisht të autoriteteve mbikëqyrëse të vendit-mëmë për bankën.

Më 18 janar 1999, Guvernatorët e Bankës së Shqipërisë dhe të Bankës së Greqisë miratuan një marrëveshje të përbashkët për mbikëqyrjen bankare – Memorandum Bashkëpunimi.

Ekzistojnë, aktualisht, tre banka ose degë bankash të bankave greke, që operojnë në Shqipëri.

PARIMI 25

Mbikëqyrësit bankarë duhet të kërkojnë që operacionet lokale të bankave të huaja të kryhen sipas atyre standardeve të larta, të njëjta siç kërkohen nga institucionet vendase dhe duhet të kenë të drejtën të shkëmbejnë informacionin, që kërkohet nga mbikëqyrësit bankarë vendas të këtyre bankave, për qëllimin e kryerjes së mbikëqyrjes së konsoliduar.

Mbështetur në nenin 4 (1) (c) të ligjit për bankat përcaktohet që degët e bankave të huaja licencohen nga Banka e Shqipërisë, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe në rregulloren përkatëse. Të gjitha bankat, që operojnë në Shqipëri, degë banke ose jo – janë të licencuara si "banka" prej Bankës së Shqipërisë.

Në nenin 58 (2) (i) të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" lejohet shkëmbimi i informacionit të Bankës së Shqipërisë me banka të tjera qendrore dhe autoritete të tjera mbikëqyrëse. Kjo siguron një informacion më të zgjeruar dhe ndihmon në realizimin e mbikëqyrjes së konsoliduar të filialeve dhe degëve të bankave të huaja.

* Miranda Ramaj, Përgjegjëse e Zyrës së Licencimit. Departamenti i Mbikëqyrjes.

MONEDHA EURO ËSHTË TEK PRAGU

*Selami Xhepa**

Fjalë kyçe
- Euro - Monedhë ligjore - Banka Qendrore Evropiane - Bashkimi Monetar Evropian - Zona e Euros -

Boks. 1 Monedhat që dalin nga qarkullimi:

Marka gjermane
Franga franceze
Lireta italiane
Gulden holandez
Franga belge
Franga luksemburg
Paund irlandez
Eskudo portugeze
Peseta spanjolle
Shilinga austriake
Marka finlandeze
Dhrahmia greke

HYRJE

Siç është bërë e ditur që nga 1 janari 1999, Sistemi Monetar Evropian hyri në fazën përfundimtare të tij: u krijua një monedhë unike (EURO) dhe një bankë qendrore e përbashkët (Banka Qendrore Evropiane). Plani i kalimit drejt kësaj faze parashikonte një periudhë tranzitore trevjeçare gjatë së cilës, jo vetëm do të

thellohej më tej konvergjenca ekonomike dhe monetare brenda vendeve anëtare, por dhe do të bëheshin përgatitjet teknike për zëvendësimin fizik të monedhave të vendeve anëtare me monedhën e re.

Tashmë, nuk ka mbetur më shumë se gjysmë viti kur bota do të shohë këtë monedhë të re të qarkullojë në treg si monedhën e vetme ligjore. Nga 1 janari 2002 në të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, do të qarkullojë fizikisht monedha e re. Për të bërë zëvendësimin fizik të të gjitha monedhave të vendeve anëtare që janë në qarkullim, autoritetet vendimmarrëse kishin parashikuar një kohë tranzitore prej gjashtë muajsh (nga 1 janari – 30 qershor 2002).

Më vonë kjo periudhë u shkurtua në dy muaj. Kjo do të thotë se, nga 1 mars 2002, prerjet e monedhave aktuale të vendeve anëtare të kësaj zone, pushojnë së vepruari si monedha ligjore. Ky shkrim ka për qëllim të shikojë në disa probleme specifike dhe praktike për zëvendësimin fizik të këtyre monedhave që qarkullojnë në vendin tonë.

1. Si dhe kur do të kryhet zëvendësimi fizik i monedhave?

2. Ku mund të kryhet zëvendësimi?

3. A do t'i kushtojë kjo konsumatorëve dhe kush do t'i përballojë këto kosto?

4. Çfarë vendimesh duhet të merren nga autoritetet e vendit (Banka e Shqipërisë dhe bankat tregtare)?

1. SI DHE KUR DO TË KRYHET ZËVENDËSIMI FIZIK I MONEDHAVE?

Zëvendësimi në çdo vend anëtar të Zonës së Euros, nuk do të kryhet sipas të njëjtit kalendar. Çdo vend ka përshtatur një kalendar kohor të vetin. Sidoqoftë, koha kur do të nisë ky proces zëvendësimi është data 1 janar 2002. Autoritetet evropiane

kanë vendosur që ky operacion të kryhet deri në datën 28 shkurt (megjithëse vëmendja e tyre është që zëvendësimi të kryhet brenda dy javësh).

Pra, nga data 1 mars 2002, lira, marka, dhrahmia etj., do të mbeten thjesht si relike historike. Meqenëse bëhet fjalë për transportimin e një sasie tepër të madhe (dhe që konsiderohet si një nga sfidat më të mëdha logjistike), shpërndarja e euros në banka do të fillojë që në muajin shtator 2001. Gjatë periudhës shtator-dhjetor 2001, bankat nga ana e tyre, do të shpërndajnë euro në dyqanet e shitjes me pakicë. Megjithatë, Banka Qendrore Evropiane ka kundërshtuar që euro t'u shpërndahet klientëve para datës 1 janar 2002. Përmasat tepër të mëdha të këtij operacioni kanë krijuar një lloj frike, lidhur me problemet e sigurisë së transportit të kësaj sasie tepër të madhe parash (660 miliardë euro), për rrjedhojë, autoritetet monetare kanë kërkuar edhe ndërhyrjen e ushtrisë (përveç forcave të sigurimit dhe të policisë). Me përjashtim të Gjermanisë, në të gjitha vendet e tjera, klientët mund të këmbejnë paratë e vjetra me të rejat në çdo degë banke. Në Gjermani, bankat do të bëjnë këmbimin vetëm për klientët e tyre. Pra, secili duhet të hapë një numër llogarie gjatë kësaj periudhe. Kjo masë është marrë për të penguar pastrimin e parave që shumë analistë mendojnë se mund të hyjnë nga vendet e Evropës Lindore.

Konsumatorët shqiptarë, biznesmenët, kambistët dhe agjentët e tjerë ekonomikë, kanë në përdorim dhe qarkullojnë monedha të vendeve të ndryshme. Një pjesë e madhe monedhash në qarkullim, i përkasin vendeve anëtare të Bashkimit Monetar Evropian, të cilat do t'i heqin ato nga qarkullimi duke i zëvendësuar me monedhën e re. Kjo do të thotë se, çdo mbajtës i një monedhe të tillë (shih boks. 1 për monedhat që dalin nga qarkullimi) duke filluar nga data 1 janar 2002, mund të fillojë të kryejë zëvendësimin fizik të tyre. A ka rëndësi që zëvendësimi i monedhave në euro të bëhet sipas afateve që do të bëhen dhe në vendet anëtare? Jo, nuk është e rëndësishme, përderisa monedhat përbërëse të euros nuk janë monedha që përdoren si mjet pagese në vendin tonë (kryesisht ato luajnë funksionin si mjet i rezervës – pra për kursime). Për rrjedhojë, megjithëse

zëvendësimi mund të fillojë dhe në vendin tonë, nga muaji janar 2002, periudha për t'i zëvendësuar ato pritet të shkojë deri në 10 vjet. (Kjo periudhë është përcaktuar që është e vlefshme në vendet anëtare të Zonës së Euros.) Por, monedhat e vjetra nuk mund të përdoren në asnjë transaksion tregtar.

Kushdo që do të udhëtojë në një nga këto shtete, duke filluar nga data 1 mars nuk mund të bëjë asnjë lloj pagese në monedha të vjetra, përveçse në euro.

Më e rëndësishme kjo periudhë është për biznesmenët shqiptarë, që kryejnë transaksione tregtare me një nga këto vende. Duke filluar që nga 1 janari, faturimet (pagesat) e mallrave të importuar nga këto vende, do të kryhen vetëm në euro. Për rrjedhojë, biznesmenët duhet të kontaktojnë me bankat në të cilat mbajnë gjendjen e tyre të llogarive, për të marrë informacionet e nevojshme.



Burimi: Financial Times, 31 maj, 2001.

Si do të bëhet zëvendësimi? Siç dihet, monedhat pjesëmarrëse në Bashkimin Monetar Evropian, kanë një kurs këmbimi të fiksuar kundrejt euros. Pra, lira, marka dhe monedhat e tjera që qarkullojnë, kanë një kurs këmbimi të fiksuar kundrejt euros.

Tabelë 1. Kurset dypalëshe të këmbimit.

Vendet	Kursi
Gjermani (DEM)	1.95583
Francë (FRF)	6.55957
Itali (ITL)	1936.27
Holandë (NLG)	2.20371
Belgjikë (BEF)	40.3399
Luksemburg (LUF)	40.3399
Irlandë (IEP)	0.787564
Portugali (ESP)	166.386
Spanjë (PTE)	200.482
Austri (ATS)	13.7603
Finlandë (FIM)	5.94573
Greqi (GRD)	340.75

Duke lexuar tabelën e mësipërme, do të thotë se: për të blerë 1 euro duhet të jepni 1.95583 marka gjermane ose 1936.27 lira italiane etj.. Ose nëse ju keni 1000 marka gjermane, kur t'i dorëzoni në bankë për të bërë zëvendësimin e tyre në euro, ju do të merrni: 1000 marka/1.95583 = 511.3 euro.

Ky është kursi i këmbimit i fiksuar në Zonën e Euros. Banka e Shqipërisë duhet të nxjerrë një vendim që të detyrojë të gjitha bankat, të cilat do të kryejnë zëvendësimin e monedhave, që të respektojnë këtë nivel të kursit të këmbimit. Por, nëse dikush vendos të këmbejë në dollarë, kursi i këmbimit të euros (pra, dhe monedhave përbërëse) është i luhatshëm. Pra, në këtë rast klientët duhet të ndjekin ecurinë e kursit të këmbimit në treg.

2. KU MUND TË KRYHET ZËVENDËSIMI FIZIK I MONEDHAVE?

Në vendet anëtare të Zonës së Euros, zëvendësimi fizik i monedhave do të kryhet qoftë në banka, në institucione financiare, në ATM-të, në zyrat e postave dhe në dyqane. Llogaritë bankare zëvendësohen automatikisht me monedhë të

re (këto në fakt janë zëvendësuar) titujt e letrave me vlerë të pronësisë apo të borxhit, gjithashtu, do të shprehen në euro.

Po qytetarët shqiptarë, që mbajnë monedha të këtyre vendeve, jashtë sistemit bankar apo dhe nëpër banka?

Nëse monedhat e këtyre vendeve janë të vendosura në banka, secili do të jetë në gjendje të tërheqë monedhën e re euro pasi bankat do të përgatiten t'i zëvendësojnë fizikisht ato. Nëse dikush mban monedha të këtyre vendeve si kursime në shtëpi, pra jo në banka, përsëri është e mundur që të bëhet zëvendësimi fizik i monedhave duke u paraqitur në sportelet e bankave.

Megjithatë, Banka e Shqipërisë duhet të përcaktojë zyrtarisht emrat e bankave (apo edhe të zyrave të këmbimeve valutore) dhe të bëjë njoftime publike për këtë qëllim. Kjo do të shmangte mundësitë e spekulimeve në dëm të konsumatorëve të pambrojtur.

3. KUSH DO TË PAGUAJË KOSTON E KËTIJ ZËVENDËSIMI?

Emetimi i monedhave të reja ka një kosto të caktuar, që lidhet me printimin, me letrën etj.. Sipas udhëzimeve të Bankës Qendrore Evropiane, zëvendësimi fizik i monedhës nuk do të shoqërohet me kosto për konsumatorët. Shpenzimet që lidhen me këtë proces normalisht do të përballohen nga bankat qendrore të vendeve anëtare, të cilat janë njëkohësisht përgjegjëse për emetimin dhe shpërndarjen e monedhave në qarkullim.

Zëvendësimi fizik, në rastin e vendeve jashtë Zonës së Euros, duhet të bëhet me marrëveshje formale mes bankave qendrore. Kjo do të thotë, se Banka e Shqipërisë duhet të fillojë të kontaktojë me bankat qendrore të vendeve të Zonës së Euros dhe të lidhë marrëveshje dypalëshe për zëvendësimin e monedhave. Duhet të jetë përgjegjësi e Bankës së Shqipërisë që të përcaktojë termat

kontraktuale për dorëzimin e monedhave ekzistuese, për marrjen e monedhave të reja, për shpërndarjen etj.. Banka e Shqipërisë duhet të marrë vendimet përkatëse edhe lidhur me përballimin e kostove që do të shoqërojnë këtë proces. Në parim, këto kosto duhet të përballohen ose nga Banka e Shqipërisë ose të ndahen me bankat tregtare. Nuk do të ishte e arsyeshme që konsumatorët të përballojnë kostot e këtij procesi.

4. ÇFARË VENDIMESH DUHET TË MARRIN AUTORITETET MONETARE TË VENDIT?

Sipas një vendimi të Bankës Qendrore Evropiane, bankat dhe institucionet financiare dhe të kredititi do të kenë të drejtën që të furnizojnë me monedhën e re, filialet, degët apo institucionet e tyre në vendet jashtë Zonës së Euros. Kjo do të thotë, se bankat e huaja që punojnë në vendin tonë, do të kenë të drejtën të furnizohen nga bankat e tyre mëmë në vendet përkatëse. Banka e Shqipërisë duhet të hyjë në kontakte me këto institucione që të koordinojë këtë proces nëpërmjet marrëveshjeve formale për të siguruar një tranzicion normal dhe të mbyllë mundësitë spekulative që mund të krijohen.

Banka e Shqipërisë duhet që të drejtojë operacionin e zëvendësimit monetar, duke caktuar zyrtarisht bankat si operatore të zëvendësimit dhe vetë Banka e Shqipërisë të sigurojë furnizimin me monedhën e re në sasitë e nevojshme. Kjo kërkon që vetë ajo të nënshkruajë marrëveshje kontraktuale me bankat qendrore të vendeve të Zonës së Euros, për të specifikuar detajet e këtij procesi, si dhe me bankat tregtare që veprojnë në Shqipëri.

Veç aspekteve të tilla teknike, Banka e Shqipërisë duhet të kujdeset që ky proces të kalojë pa shqetësime. Kjo kërkon edhe një fushatë intensive të ndërgjegjësimit të publikut të vendit, informimin e tij për detajet e këtij procesi etj..

5. A MBART RREZIQE KY PROCES?

Banka Qendrore Evropiane dhe autoritetet e vendeve të Zonës së Euros, kanë lëshuar instruksione të detajuara për problemet e sigurisë që do të shoqërojnë këtë fazë tranzitore. Nuk mendohet se do të ketë probleme shqetësuese, edhe pse prerjet e monedhës së re shkojnë dhe në denominimin prej 500 euro.

Nuk ka arsye për të besuar se ky proces mund të mbartë rreziqe për konsumatorët kursimtarë apo për agjentët e tjerë ekonomikë të vendit tonë. Edhe vetë afati i zëvendësimit nuk përfundon brenda një periudhe kohe të dhënë. Bankat qendrore të vendeve të Zonës së Euros, do të kenë të drejtën të kryejnë zëvendësimin fizik të monedhave edhe për afate kohe më të gjata (deri në 10 vjet), edhe pse monedhat aktuale të tyre nuk mund të përdoren. Kjo do të thotë se, Banka e Shqipërisë në marrëveshjet që duhet të nënshkruajë me bankat qendrore të këtyre vendeve, duhet të parashikojë mundësitë e zëvendësimit fizik edhe për afate kohore më të gjata. Në thelb, ky proces do të jetë i ngjashëm me çdo zëvendësim të monedhave që ka ndodhur dhe më parë në vendin tonë (dalja nga qarkullimi i monedhave me prerje të vjetra).

Por, ky proces i zëvendësimit fizik të monedhave, mund të jetë një rast për pastrimin e parave nëpërmjet bankave. Ky është në fakt dhe shqetësimi më i madh për sistemin bankar evropian. Mundet që monedha të falsifikuara, që janë aktualisht në qarkullim, të zëvendësohen me euro në banka. Kjo për shkak të rradhëve të gjata, që mendohet se do të krijohen në sportelet e bankave dhe pamundësisë së zyrtarëve të bankave për të kontrolluar çdo njësi të monedhave që do të kërkohet të zëvendësohen.

Megjithëse një gjë e tillë nuk është shumë e mundur të ndodhë në vendin tonë, Banka e Shqipërisë duhet të nxjerrë udhëzime të detajuara për t'u zbatuar nga sistemi bankar i vendit dhe të shoqërojë me një mbikëqyrje të kujdesshme këtë proces.

Vetë euro është një monedhë e re dhe e pafalsifikuar, por mund të zëvendësohen prerje të falsifikuara markash, lirash etj., të cilat mund të jenë në qarkullim qoftë në vendin tonë, ose të vijnë nga vende të tjera të rajonit ku qarkullojnë sasi të mëdha, kryesisht të markave.

Një tjetër shqetësim, që mund të krijohet, lidhet me kursin e këmbimit. Nëse klientët nuk do të dëshirojnë të këmbejnë kursimet e tyre valutore në lira, marka, dhrahmi etj. në euro, por të zgjedhin dollarin si monedhë të tyre të preferuar, në tregun e brendshëm kjo mund të vendosë euron nën presione zhvlerësuese artificiale ose spekulative. Banka e Shqipërisë duhet të luajë një rol frenues në këtë drejtim, duke ndjekur situatën e tregut valutor në mënyrë të kujdesshme dhe të bëjë ndërhyrjet e nevojshme për të mos lejuar spekulimet që mund të rezultojnë. Veçanërisht mundësi spekulimesh mund të krijohen në tregun joformal të këmbimit. Banka e Shqipërisë duhet të lëshojë mesazhe të vazhdueshme tek publiku gjatë gjithë kësaj periudhe.

Duke përfunduar:

Nuk besojmë se ka ndonjë arsye për të krijuar shqetësime për këtë proces të zëvendësimit fizik të kursimeve valutore jo në dollarë, që njerëzit mbajnë qoftë në shtëpi apo nëpër banka. Ky proces do të ketë një shtrirje kohore të mjaftueshme. Banka e Shqipërisë duhet të marrë masat e nevojshme për t'i paraprirë këtij procesi dhe për një mbikëqyrje të kujdesshme.

Banka e Shqipërisë duhet të fillojë të bëjë përgatitjet e nevojshme teknike për këtë proces, të nxjerrë udhëzime të nevojshme për bankat dhe për zyrat e këmbimeve valutore, të familjarizojë publikun me monedhën e re etj.. Edhe vetë departamentet e Bankës së Shqipërisë duhet të evidentojnë çështjet e tyre specifike që lidhen me këtë proces dhe të jenë të përgatitura në kohë.

---

* Selami Xhepa, specialist, Departamenti i Kërkimeve.

EKONOMITË E RAJONIT

Selami Xhepa
*Diana Shtylla**

Fjalë kyçe
- Maqedonia - Situata makroekonomike - Banka Kombëtare e Maqedonisë - Kosova - Ekonomia kosovare -

Ditët e fundit në Shqipëri u bë temë e ditës realizimi i marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e rajonit. Pa u përpjekur për të analizuar anët pozitive apo negative të këtij procesi, një gjë është e qartë: zbatimi i këtyre marrëveshjeve do të çojë në rritjen e integrimit ekonomik të rajonit. Përveç përfitimeve, integrimi rrit edhe rrezikun e transmetimit të problemeve ekonomike apo politike të një ose disa vendeve të rajonit në ekonominë shqiptare. Po ashtu, integrimi krijon hapësira dhe tregje të reja "për t'u pushtuar" nga biznesmenët shqiptarë. Ky proces bën të nevojshme ndjekjen me kujdes të zhvillimeve në ekonomitë e rajonit.

Materiali në vazhdim analizon efektet e mundshme të krizës në FYROM në ekonominë shqiptare si dhe hapësirat që ofron Kosova.

KRIZA NË MAQEDONI

1. SFONDI I NGJARJEVE

Kriza në vendin fqinj, Maqedoni, filloi në fund të muajit shkurt 2001 dhe vazhdon akoma. Zgjidhja e krizës politike në këtë vend duket akoma shumë e paqartë. Komuniteti ndërkombëtar, krahas mbështetjes që i jep Qeverisë Maqedonase, po i kërkon gjithnjë

e më shumë gjetjen e zgjidhjeve politike të krizës, duke vendosur dialog me faktorin shqiptar. Ky ka qenë thelbi i të gjitha mesazheve të përcjella gjatë vizitave të shpeshta të zyrtarëve të lartë evropianë dhe amerikanë në këtë vend si dhe i takimit të nivelit të lartë të BE-së në Gotenburg. Megjithatë, deri tani duket se të dy komunitetet etnike vazhdojnë të thellojnë përçarjen e tyre.

Zhvillimet në Maqedoni kanë mbetur në kuadrin e një krize të brendshme politike, pa shkaktuar ndonjë tronditje ekonomike as të vetë Maqedonisë[1].

2. SITUATA MAKROEKONOMIKE NË MAQEDONI DHE PARASHIKIMET PËR VITIN NË VAZHDIM

Sipas raporteve zyrtare[2], gjatë vitit 2000, Maqedonia shënoi përparim në fushën e stabilitetit të çmimeve. I matur me indeksin e kostos së jetesës (siç është rënë dakord në marrëveshjen e Maqedonisë me FMN-në), inflacioni shënoi një normë vjetore prej 6.1 për qind. Megjithëse ky tregues ishte më i lartë se vitet e kaluara, efekti i tij erdhi kryesisht nga:

- futja e TVSH-së (efekti i së cilës jepet një herë);
- rritja e çmimeve të naftës (Maqedonia është importuese neto e burimeve energjitike);
- rritja e çmimeve të kontrolluara nga shteti (të shërbimeve publike).

Por, konsiderohet sukses arritja e stabilitetit të çmimeve në sensin që faktorët thelbësorë që gjenerojnë inflacion, si: politika monetare, politikat fiskale dhe kurset e këmbimit, dhe formimi i pagave, kanë qenë nën kontroll. Për vitin 2001, norma e inflacionit është parashikuar të jetë në 1.2 për qind.

Politika monetare e Bankës Kombëtare të Maqedonisë (BKM) ka si ankorë ruajtjen e stabilitetit të monedhës kombëtare, në raportin *target* prej 31 dinarë për 1 markë gjermane. Ruajtja e këtij niveli të këmbimit është vënë si objektiv dhe për vitin në vazhdim. Rezervat valutore të saj në fund të vitit 2000 arritën

në 713.6 milionë dollarë amerikanë (me një rritje prej 235.5 milionë dollarësh vetëm gjatë vitit që shkoi).

Si rrjedhojë e heqjes së kufizimeve në kredidhënie të bankave tregtare, raportohet një rritje e ndjeshme e aktivitetit kreditues të sektorit joqeveritar (prej 27.8 për qind – krediti në dinar). Me heqjen e kufizimeve në kredidhënie, edhe Banka Kombëtare e Maqedonisë kaloi gjatë vitit që shkoi, në përdorimin e vetëm të instrumenteve indirekte në realizimin e politikës së saj monetare.

Borxhi i jashtëm (sipas disbursimeve), deri në 30 shtator 2000, arriti në 1,400.8 milionë dollarë ndërsa borxhi afatshkurtër i sektorit privat arriti në 42.9 milionë dollarë. Borxhi i jashtëm llogaritet të zërë 42 për qind të PBB-së (vend me një nivel borxhi të moderuar deri në mesatar).

3. KRIZA DHE EKONOMIA

Deri tani nuk ka asnjë evidencë se kriza politike dhe operacionet ushtarake të kenë shkaktuar ndonjë prishje të ekuilibrave ekonomikë në vend. Maqedonia vazhdon të jetë e përfshirë në programet ekonomike të FMN-së që pritet të transformohen në dokumentin e Strategjisë së Rritjes Ekonomike dhe Reduktimit të Varfërisë.

Mund të mendohet që kriza të japë efekte në vonesat në realizimin e reformave strukturore, si konsolidimin e sistemit bankar (shkrirjen e bankave të vogla lokale), mbylljen e njësive ekonomike që gjenerojnë humbje (të planifikuara të mbyllen 4 të tilla për këtë vit, nga lista prej 40 ndërmarrjesh të tilla që duhet të mbyllen gjatë programit me FMN-në.). Vlerësohet se rreth 1 miliard marka gjermane kursime të popullsisë, të mos jenë të kanalizuara në sistemin bankar[3]. Nga ana tjetër, shkalla e zëvendësimit monetar në këtë vend[4] është ndër më të lartat.

Për rrjedhojë, nuk mendojmë se mund të ndodhin tronditje të rëndësishme në politikat monetare, të paktën për momentin kur po flasim (kursi i këmbimit të monedhës së vendit ndaj markës

gjermane është brenda objektivit vjetor të përcaktuar nga BKM). Deri tani nuk duket të jetë e mundur që operacionet ushtarake të japin efekte të konsiderueshme në financat e Maqedonisë.

Raportet e shtypit kanë cituar deklarata të Ministrit të Financave se Maqedonia disponon mjetet monetare[5] për blerjen e armatimeve të reja, ndërkohë që është tashmë një fakt i njohur nga media se mjaft armatime janë dhënë falas nga vende të tilla si Ukraina, Bullgaria dhe Greqia.

Ndihmat e huaja[6] për Maqedoninë deri tani të deklaruara pritet të jenë në 17 milionë dollarë amerikanë, në ndihma ushtarake dhe rreth 38 milionë, në financime për ekonominë. Financime të tjera pritet të jepen dhe në kuadrin e Marrëveshjes së Asociim Stabilizimit me BE-në, të nënshkruar në 9 prill 2001.

4. LIDHJET EKONOMIKE E SOCIALE SHQIPËRI-MAQEDONI

Lidhur me kanalet e përhapjes së krizave nga një vend në një tjetër, literatura evidenton si më thelbësoret dy të tilla: lidhjet tregtare dhe lidhjet financiare.

Tradicionalisht, gjatë gjithë dekadës së tranzicionit, lidhjet ekonomike dhe tregtare midis dy vendeve kanë ruajtur nivele mjaft të ulëta, që mund të konsiderohen të neglizhueshme. Pesha e tregut maqedonas ka zënë mesatarisht (për vitet 1994-1999 – shih tabelën 1) 2 për qind të importeve dhe 2.7 për qind të eksporteve, me një tendencë vazhdimisht në rënie. Nga kjo pikëpamje, nuk mund të mendohet ndonjë influencë e rëndësishme.

Tabelë 1. Tregtia e jashtme e Shqipërisë me Maqedoninë (në milionë usd).

Vitet	Import	Eksport	Total importi	Total eksporti	Raporti ndaj totalit, në % Importe	Eksporte
1994	14.5	6.6	601	141.4	2.4	4.7
1995	16.5	8.0	679.8	204.8	2.4	3.9
1996	19.5	5.6	922	243.7	2.1	2.3
1997	13.2	3.8	693.5	158.6	1.9	2.4
1998	11.3	3.1	811.7	208	1.4	1.5
1999	17.4	4.2	937.9	275.1	1.9	1.5
Mesatare					2.0	2.7

Nga ana tjetër, nuk ekziston asnjë lidhje financiare mes dy vendeve. Nuk kemi marrëdhënie detyrimesh financiare reciproke mes nesh, të tilla që do të ndikoheshin nga ndonjë ndryshim në normat e interesave apo në kurset e këmbimeve. Nuk ka asnjë evidencë që kursime individuale shqiptare të jenë vendosur në letrat me vlerë në Bursën e Shkupit që, gjithashtu, do të ishin të ndikueshme nga ndryshimet e kushteve të brendshme ekonomike e monetare.

Një lidhje mund të evidentohet të ekzistojë në fushën e shërbimeve, kryesisht në tranzitim të mallrave drejt Kosovës. Sipas bisedave me specialistë të doganave, ditët e mbylljes së kufirit Maqedoni-Kosovë, është rritur fluksi i tranzitimeve nëpërmjet vendit tonë, që mund të ketë ndikuar në një shtim të të ardhurave buxhetore nga ky faktor. Megjithatë, shkalla e veprimit të tij është, gjithashtu, e papërfillshme. Mbyllja e kufirit veproi për një interval kohe të shkurtër dhe aktualisht ai është rihapur. Për më tepër, mbyllja e kufirit mund të ketë rezultuar në një rritje të evazionit fiskal në vendin tonë, nëpërmjet mashtrimeve të tranzitimit, ndërsa mallrat mund të kenë qëndruar në Shqipëri, duke iu shmangur pagimit të detyrimeve tatimore[7].

Një tjetër ndikim i mundshëm në financat tona publike do të ishte përballimi i një emigrimi të popullsisë shqiptare nga Maqedonia drejt vendit tonë. Edhe në këtë rast, nuk është evidentuar asnjë zhvillim për t'u konsideruar. Një numër i vogël emigrantësh që kaluan nëpërmjet kufirit shqiptar, kanë qenë në tranzit duke patur si destinacion vende të tilla si Kosova dhe Turqia. Mendojmë se dhe në rast të një përkeqësimi më të madh të situatës në Maqedoni (në rastin e skenarit më pesimist), barra buxhetore që do të nevojitej për mbajtjen e një numri më të madh emigrantësh do të ishte jo në përmasa të papërballueshme, duke parë preferencat e tyre për të emigruar kryesisht në vendet ku ata kanë të afërmit e tyre (Kosovë, Turqi apo vende të tjera perëndimore).

Nga të gjitha evidencat, nuk mund të evidentohet ndonjë paralele me krizën kosovare.

VËSHTRIM MBI KOSOVËN

NATYRA DHE POZITA GJEOGRAFIKE

Kosova ka një sipërfaqe prej 10,877 km^2, popullsi prej 2.3 milionë banorësh dhe shtrihet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik. Krahas pozitës së favorshme gjeografike, Kosova zotëron burime të rëndësishme mbi dhe nëntokësore, klimë, florë dhe faunë të përshtatshme dhe të shumëllojshme. Burimi kryesor natyror i Kosovës është toka e punueshme. Ndër pasuritë ujore vlejnë të përmenden burimet termale ndërsa si burim energjie shfrytëzohen rezervat e qymyrgurit, të cilat vlerësohen në nivelin 11.5 miliardë ton. Kosova është mjaft e pasur në metale me ngjyrë si boksite, xehe plumbi, zinku dhe nikeli.

EKONOMIA PARA KONFLIKTIT

Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova përfaqësonte një ekonomi kryesisht bujqësore në kuadrin e Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë. Transformimi ekonomik që u bë nën strukturën e planifikimit qendror, solli industrializimin dhe zhvillimin e industrisë nxjerrëse. Gjatë viteve '70-'80, falë financimit nga një fond kombëtar investimesh, aktiviteti ekonomik i Kosovës u zgjerua dhe u zhvillua kryesisht në drejtim të industrisë nxjerrëse, prodhimit të lëndëve të para dhe produkteve gjysmë të gatshme (çelik, qymyr, zink dhe tekstile) por bujqësia vazhdoi të mbetej e rëndësishme. Mesi i viteve '90 solli një përkeqësim të gjendjes ekonomike, që erdhi si pasojë e keqadministrimit të burimeve.

Gjatë kësaj periudhe, investimi në sektorët më fitimprurës të ekonomisë u tkurr në masë të konsiderueshme dhe papunësia arriti shifra të larta. Sektori industrial ishte shtetëror ose në pronësi shoqërore (me ndërmarrje të zotëruara nga punëtorët) dhe bankat kreditonin nisur nga motive politike. Diskriminimi etnik shfaqej edhe në ekonomi ku të punësuarit në sektorin industrial, sidomos në pozicionet kyçe, i përkisnin etnisë serbe, ndërsa popullsia shqiptare ishte e detyruar të angazhohej me

ekonominë joformale, me bujqësi apo të emigronte. Gjatë kësaj periudhe u krijuan edhe sistemet paralele të arsimimit, të shëndetësisë apo të përfitimeve sociale, të financuara prej dërgesave të diasporës kosovare dhe një sistemi taksimi paralel.

EKONOMIA AKTUALE

Ekonomia kosovare duket se po bën përpjekje për të dalë nga gjendja e krijuar në dy dekadat e mëparshme dhe për t'u përballur me pasojat e rënda që la pas konflikti i vitit 1999. Mbështetjen kryesore kjo ekonomi e ka gjetur në sipërmarrjet vendase, të cilat janë ndihmuar dhe po ndihmohen fuqimisht nga donatorë të huaj.

Asistenca e donatorëve së bashku me kursimet vendase dhe fluksin e fondeve nga diaspora, po mbajnë aktualisht barrën e rimëkëmbjes së ekonomisë së Kosovës. Këto fonde, me përfundimin e konfliktit, u mobilizuan për të riaktivizuar sektorin bujqësor apo për të filluar riparimin e shtëpive, të rrjetit ujësjellës dhe të atij elektrik. Për të siguruar qëndrueshmërinë e çmimeve dhe në mungesë të një monedhe të vendit, u vendos që të legalizohej përdorimi i markës gjermane. Paralelisht është ofruar asistencë për krijimin e një sistemi pagesash dhe bankar. Deri në gjysmën e parë të vitit 2000 mendohet që bujqësia ka arritur rreth 75 për qind të nivelit të paraluftës. Aktiviteti me më gjallëri paraqitet ndërtimi i ndjekur nga disa shërbime private si restorante, hotele apo dyqane. Tregtia e jashtme dominohet nga importet, që përfaqësojnë 85 për qind të PBB-së. Siç shihet nga tabela e mëposhtme, PBB për frymë vlerësohet në nivelin 750 dollarë amerikanë ndërkohë që shpenzimet për frymë kapin nivelin 1,125 dollarë amerikanë.

Diferenca e madhe ndërmjet të ardhurave dhe konsumit për frymë plotësohet nga dërgesat e emigrantëve kosovarë, të cilat për vitin 2000 kanë arritur deri në 40 për qind të PBB-së. Kjo sasi është rreth 1.3 herë më e lartë nga shuma e dërgesave të emigrantëve në Shqipëri, për të njëjtin vit.

Tabela e mëposhtme paraqet nivelet e disa treguesve të rëndësishëm makroekonomikë për Kosovën dhe Shqipërinë, gjatë vitit 2000. Veçanërisht të larta për të dyja vendet janë shifrat e importit.

Tabelë 2. Nivelet e treguesve makroekonomikë për Kosovën dhe Shqipërinë, gjatë vitit 2000.

Tregues makroekonomikë	Shqipëria (2000)	Kosova (2000)
PBB	3,734 mil usd	1,421 mil usd
PBB/frymë	1,131 usd	750 usd
Bilanci fiskal	- 399 mil usd *	-103.7 mil usd
Bilanci tregtar	-814.3 mil usd	-1,203 mil usd
Importi	1070.1 mil usd	1,203 mil usd
Eksporti	255.8 mil usd	--
Llogaria korente	-151.8 mil usd	-487 mil usd
Transfertat private	438.6 mil usd	569 mil usd
Transfertat shtetërore	94.4 mil usd	147.8 mil usd

Shënim: Viti 1999, në mungesë të të dhënave për vitin 2000.

GJENDJA E INVESTIMEVE AKTUALE DHE MUNDËSITË PËR INVESTIME NË KOSOVË

Ekonomia e Kosovës, me gjithë vëmendjen që po i kushtohet nga autoritetet ndërkombëtare, po kalon një fazë të vështirë. Kjo ekonomi, momentalisht, vuan nga mungesa e investimeve të huaja dhe të brendshme. Si shkaqe për mungesën e investimeve të huaja në Kosovë renditen tranzicioni i vështirë, mungesa e ligjeve dhe rreziku i shpërthimit të vatrave të tjera të konfliktit në zonën përreth. Shpeshherë mediat e huaja bëjnë pasqyrime jorealiste të situatës në vend, gjë që paralizon dëshirën apo iniciativën e investitorëve për t'u futur në tregun kosovar. Ndërhyrja e firmës "Alcatel" në rrjetin e telefonisë fikse të Kosovës u mirëprit nga opinioni shqiptar, duke ngjallur shpresën për mbërritjen e gjigantëve të huaj në ekonominë që, për momentin, duket se është lënë në hije.

Përsa i përket investimeve të biznesmenëve nga Shqipëria në Kosovë, këto janë ende të kufizuara në fushën e biznesit të vogël të restoranteve, të picerive dhe të aktivitetit tregtar. Investitorët nga Shqipëria janë ende të pasigurt për të shtrirë aktivitetin e tyre në sferën e industrisë. Këta investitorë hasin, gjithashtu, njëfarë rezistence nga tregu kosovar, i cili preferon mallrat e lirë lindorë ndaj mallrave më të shtrenjtë që vijnë nga Shqipëria.

Përmbledhja që vijon bën një paraqitje të sektorëve të ekonomisë së Kosovës, ku shfaqen mundësi për gjenerimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), sipas një studimi të kryer në vitin 1998. Megjithëse studimi i takon periudhës para shpërthimit të konfliktit në ish-Jugosllavi supozohet se, gjatë dy viteve të fundit, zhvillimet në këto drejtime kanë qenë shumë të pakta ose inekzistente. Për këtë arsye, vlerësohet se ekonomia kosovare ka ende nevojë për rimëkëmbjen dhe shfrytëzimin e këtyre mundësive që kanë shumë për të ofruar. Momentalisht në Kosovë vepron Njësia e Përkohshme Krediuese e themeluar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim (EAR), e cila synon të ndihmojë SME-të. Fondacione të tjera krediuese për mbështetjen e projekteve pilot janë siguruar nga Banka Botërore, EAR dhe BERZH. Në vijim paraqiten sektorët e ekonomisë, që mendohet se paraqesin interes për investime.

AGROBIZNESI

Nga studimi i kryer, në rend të parë vendoset aktiviteti i agrobiznesit. Nevoja për produkte ushqimore është theksuar sidomos pas situatës së krijuar në vitin 1999, gjë që shprehet në nivelin e lartë të importeve të këtyre produkteve në Kosovë. Për shkak të zhvillimit të ekonomisë familjare dhe të ekzistencës së sipërfaqeve të vogla bujqësore, ferma bujqësore konsiderohet si bartëse e aktivitetit të agrobiznesit. Është vlerësuar se, nëpërmjet investimeve të përbashkëta ose investimeve që vijnë tërësisht nga diaspora, mund të realizohen programe me vlerë nga 8,000 deri në 100,000 dollarë amerikanë (apo më tepër), të cilat japin norma fitimi të nivelit deri në 30 për qind, ndërkohë që investimi fillestar mund të shlyhet brenda 2-3 vjetëve. Në vijim paraqiten disa ndër programet që janë parë të përshtatshme për investime: përpunimi i produkteve të qumështit; prodhimi i produkteve të brumit; konservimi dhe përpunimi i frutave dhe i perimeve; minithertoret dhe përpunimi i mishit; minibirraritë; fermat e majmërisë së gjedhëve, pulave, deleve, dhive, derrave, shpezëve të egra etj.; prodhimi dhe përpunimi i mjaltit; paketimi i produkteve ushqimore etj.. Nga vlerësimi i mundësive që i hapen Kosovës së pasluftës, rezulton se ky vend mund të kthehet

në një eksportues të mallrave të agrobiznesit/ përpunimeve bujqësore në vendet e Bashkimit Evropian në të ardhmen.

INDUSTRIA

Industria ose prodhimtaria paraqet një spektër të gjerë të veprimtarive në Kosovë dhe llogaritet se punëson mbi 20 për qind të popullsisë kosovare. I përbërë nga ndërmarrjet shoqërore dhe private, ky sektor duket se punon me kapacitete të vogla. Për zhvillimin e këtij sektori të ekonomisë Departamenti për Tregti dhe Industri pranë UNMIK-ut, gjatë vitit 2000, ka shpallur 10 tendera për ndërmarrjet.

Industria mund të trajtohet sipas tre linjave kryesore: industria përpunuese, industria e përpunimit të metaleve dhe industria tradicionale.

a. Të dhënat për zhvillimin e deritanishëm të *industrisë përpunuese* në Kosovë dhe krahasimi i tyre me të dhënat përkatëse të vendeve më të zhvilluara, tregojnë se Kosova është karakterizuar nga një shkallë e ulët e industrisë përpunuese. Deri në fillim të viteve '90 në Kosovë janë prodhuar ose ka patur mundësi të prodhohen kryesisht plehrat kimike, pijet alkolike dhe joalkolike, çimentoja, disa produkte metalurgjike dhe disa produkte të gomës, produkte këto që kanë përmbushur pjesërisht kërkesat për eksporte. Megjithëse fillimisht industria përpunuese është parë si industri e kapaciteteve të mëdha, ajo ka nisur të perceptohet si industri që mund të zhvillohet nga kapacitetet e vogla dhe të mesme, në përputhje me zhvillimet teknike dhe teknologjike që kanë ndodhur në botë. Përveçse në sferën e produkteve të lartpërmendura, të cilat nuk prodhohen më, industria përpunuese ka nevojë të zgjerohet me produkte të tilla si kimikatet; barnat dhe lëndët e para farmaceutike; yndyrnat dhe vajrat; ngjyrat, llaqet dhe pigmentet e tjera; prodhimet e rafinimit të naftës dhe të përpunimit të drurit; materialet plastike dhe gomat; druri, celuloza dhe kartoni etj., të cilat aktualisht

sigurohen nga eksporti.

b. *Industria e përpunimit të metaleve* duhet të mbështetet në stimulimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat shfrytëzojnë përparësitë krahasuese të sigurimit vetjak të lëndës së parë si edhe eksperiencën e grumbulluar gjatë shumë viteve në këtë fushë. Kosova është kryesisht e pasur në plumb, zink, kadmium, bizmut, argjend, ferronikel etj..

Duke ditur se prodhuesit e mëdhenj të Evropës shtrojnë kërkesa të larta për produkte finale apo gjysmë të gatshme të kësaj industrie, mendohet se industria e Kosovës, në të ardhmen, mund të synojë të realizojë plotësimin e këtyre kërkesave, krahas përmbushjes së pjesshme apo të plotë të nevojave të vendit për këto produkte.

Gjendja e infrastrukturës industriale të Kosovës, në të shkuarën, ka qenë e kënaqshme, ndërkohë që, aktualisht, po synohet t'i jepet përparësi rehabilitimit dhe rigjenerimit të kësaj infrastrukture, e cila rreshti së shfrytëzuari gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme shihen si njësi të cilat, me fillimin e punës në industrinë nxjerrëse, me investime të vogla dhe fuqi të kufizuar punëtore, mund të shfrytëzojnë metalet e lartpërmendura për prodhimin e gjysmëprodukteve dhe produkteve finale. Kusht elementar që duhet plotësuar për një prodhim fillestar nga plumbi, zinku, bismuti dhe kadmiumi është instalimi i një furre të vogël elektroinduktive me kapacitet deri në 20 kw. Është e vetëkuptueshme që çdo ndërmarrje, që ka të bëjë me përpunimin e lëndëve minerale, duhet të veprojë sipas rregullave për mbrojtjen e ambientit.

c. *Industria tradicionale* e Kosovës mendohet se do të mbështetet në prodhimin e sapunëve dhe të detergjenteve; prodhimin e letrës për ambalazhim; industrinë e qelqit, të porcelanit dhe të qeramikës; në medikamentet farmaceutike etj.. Një theks i veçantë duhet vënë në rigjenerimin e industrive tradicionale të Kosovës si tekstili, përpunimi i drurit dhe industria e materialit ndërtimor, të cilat në të kaluarën kanë siguruar produkte të cilësisë së lartë.

NDËRTIMTARIA

Gjatë viteve të fundit, ndërtimtaria në Kosovë ka marrë një rëndësi të veçantë duke qenë se nevojat për rindërtimin e shtëpive dhe ndërtesave të shkatërruara apo të lëna pas dore gjatë luftës, kanë qenë të mëdha.

Deri në fund të vitit 2000, vlerësohet se investimet për rindërtim arrijnë në gjysmë miliardi dollarë ndërkohë që, sipas vlerësimit të Agjencisë Evropiane për Rindërtim, kërkesa për materiale ndërtimi do të vazhdojë të rritet edhe për disa vite të ardhshme në Kosovë.

Kontributi i Shqipërisë në procesin e rindërtimit të Kosovës është materializuar në eksportet masive të lëndës drusore, të siguruar nga pyjet në veri të Shqipërisë. Firmat apo shoqëritë ndërtimore nga Shqipëria, duke mos u ndjerë të sigurta, nuk i janë afruar Kosovës, me gjithë urinë e madhe që ka vendi për zhvillimin e këtij aktiviteti. Aktualisht, në Kosovë veprojnë 34 ndërmarrje shoqërore dhe rreth 95 ndërmarrje private, të cilat merren kryesisht me prodhimin e tjegullave, të tullave, të çimentos dhe të gëlqeres, si edhe me përpunimin e drurit për mobilje, dyer, dritare etj..

Sipas studimit të lartpërmendur, ndërmarrjet e vogla ndërtimore në Kosovë mund të grupohen në tre lloje të ndryshme të strukturave. Tipi i parë janë ndërmarrjet që në portofolin e tyre kanë prodhimin e materialit ndërtimor, si edhe tregtinë dhe projektimin e materialeve. Tipi i dytë i firmave të mesme janë ndërmarrjet private që ushtrojnë aktivitet ndërtimor. Këto firma, nëse arrijnë efikasitetin e duhur, mund të çojnë në rritjen e kapaciteteve.

Tipi i tretë i ndërmarrjeve të mesme mendohet se do të krijohet nga privatizimi dhe nga ristrukturimi i ndërmarrjeve të sotme shoqërore/shtetërore. Aktiviteti i këtyre tre lloj ndërmarrjesh mendohet se do të kontribuojë kryesisht në rindërtimin e Kosovës së pasluftës dhe do të shtrihet në linjat e mëposhtme: ekzekutim i punimeve të zakonshme ku bëjnë pjesë ndërtimtaria e lartë

dhe ajo e ulët, punët zejtare dhe mirëmbajtja e objekteve; dhe ekzekutim i punimeve të specializuara (fundimet-gjeoteknika, montimi, izolimet, rrënimet, minimet etj.).

KOMUNIKACIONI

Zhvillimi i komunikacionit në Kosovë merr një rëndësi të veçantë, duke pasur parasysh çrregullimet që kanë rezultuar natyrshëm pas situatës së krijuar në vitin 1999. Lëvizjet e mëdha të popullsisë nga brenda jashtë Kosovës dhe në drejtim të kundërt, transporti i mallrave dhe hyrja masive e administratës së huaj janë dukuri që e bëjnë të domosdoshëm krijimin e një rrjeti efektiv të komunikacionit rrugor, hekurudhor, ajror dhe atij të PTT-së dhe RTV-së. SME-të e komunikacionit pritet që të realizojnë transportin e mallrave dhe të udhëtarëve, mirëmbajtjen e infrastrukturës së trafikut dhe mjeteve të transportit etj..

TURIZMI

Pasuritë natyrore e kulturore të Kosovës paraqesin burime turistike me vlerë. Kosova disponon kushte të volitshme për zhvillimin e turizmit dimëror-malor, të banjave mjekuese, të gjuetisë, të peshkimit sportiv dhe të sporteve të ujit. Ndonëse aktiviteti i turizmit, momentalisht, është lënë mënjanë, ai mund të shihet si burim të ardhurash në një të ardhme jo shumë të largët. Në lëmin e turizmit, përparësi merr: rigjallërimi i objekteve ekzistuese si edhe ndërtimi i objekteve të reja të destinuara për turizëm masiv (kryesisht në lokalitetet e Brezovicës dhe të Deçanit), afirmimi i turizmit në sportet e gjuetisë dhe të peshkimit, zgjerimi i objekteve hoteliere me qendra sportive, rikonceptimi i kompleksit "Boro e Ramiz" në Prishtinë, me qëllim krijimin e mundësive për manifestime kulturore, sportive, ekonomike etj.. Një rol të rëndësishëm në ringjalljen e turizmit në Kosovë mund të luajnë agjencitë turistike, të cilat mund ta zgjerojnë aktivitetin e tyre nga sigurimi i biletave te krijimi i ofertës cilësore turistike.

AKTIVITETI I KONSULENCËS

Nga pikëpamja e zhvillimit të konsulencës në Kosovë, vihet re një ngecje pothuajse totale. Roli i konsulencës shihet i lidhur kryesisht me transfertën teknologjike, progresin teknik vetjak dhe perspektivën eksportuese. Aktiviteti i konsulencës për transfertën teknologjike brenda SME-ve shihet i përqendruar në fazën parainvestive të importit të teknologjisë. Aktiviteti këshillëdhënës në këtë rast, konsiston në grumbullimin e të dhënave përkatëse për prodhuesit e ndryshëm të teknologjive për një varg produktesh që mendohet se do të prodhohen në periudhën e dhënë. Po kështu, ky aktivitet, duke pasur parasysh kërkesat, mund të shtrihet në sferën ekonomike, financiare, juridike. Shërbimet e konsulencës shihen si shumë të dobishme edhe në sferën e marrjes së kredive nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare apo, nga kredidhënësit e jashtëm si edhe në sferën e investimeve të përbashkëta.

INFORMATIKA

Gjenerimi i NVM-ve në fushën e informatikës shihet i lidhur me tregtimin e pajisjeve dhe të *software*-ve, instalimin e tyre, krijimin e *software*-it për qëllime biznesi, krijimin e *software*-it për rrjete, krijimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve dhe arsimimin kompjuterik. Përpilimet e *software*-ve përkatës, specifikë për nevojat e segmenteve të ndryshme si edhe mirëmbajtja dhe krijimi i mundësive për aplikimin e tyre, përbëjnë mundësi reale dhe shumë të volitshme për formimin e SME-ve.

TREGTIA

Tregtia në Kosovë ka pasur një zhvillim dinamik i cili është theksuar sidomos gjatë dy viteve të fundit. Pas konfliktit të vitit 1999, Autoriteti Qendror Fiskal që operon në Kosovë pa të arsyeshme vendosjen e një strukture të thjeshtë dhe neutrale të regjimit tregtar. Kjo strukturë u mendua si e përshtatshme për stimulimin e rritjes ekonomike nga ana e sektorit privat,

për shpejtimin e rindërtimit si edhe për krijimin e kushteve për eksporte të shëndetshme. Në mungesën e një makinerie administrative, që do të mund të realizonte mbledhjen e taksave mbi të ardhurat dhe konsumin, UNMIK-u prezantoi regjimin tregtar të bazuar mbi doganat si burimin kryesor të të ardhurave për buxhetin lokal të Kosovës.

Karakteristikat kryesore të regjimit tregtar janë: së pari, prezantimi i një tarife doganore uniforme prej 10 për qind dhe një takse mbi shitjet prej 15 për qind. Kjo strukturë tarifore u rekomandua për shkak të thjeshtësisë dhe të normës së ulët të zbatuar. Njëkohësisht, u paraqitën dhe u vunë në zbatim përjashtime nga taksat doganore të disa produkteve bujqësore dhe mjekësore; së dyti, regjimi i tregtisë së jashtme nuk përfshin masa jotarifore dhe kufizime sasiore; së treti, një përparësi të sistemit e përbëjnë procedurat transparente dhe jodiskriminuese të regjistrimit dhe të licencimit të tregtarëve.

Përsa i përket zhvillimit të tregtisë midis Shqipërisë dhe Kosovës, ai ka marrë hov gjatë dy viteve të fundit duke u materializuar kryesisht në eksportet prej Shqipërisë. Që prej gjashtëmujorit të dytë të vitit 1999 deri në fund të vitit 2000 Kosova është renditur e katërta ndër partnerët tregtarë të Shqipërisë. Duke pasur parasysh gjendjen jo të rregullt të kufijve doganorë dhe 'urinë' e madhe të tregut kosovar për artikujt bazë të jetës, vlerësohet se eksportet me këtë vend duhet të kenë qenë shumë më të mëdha se shifrat e regjistruara. Mallrat e eksportuar, fillimisht i përkisnin kategorisë së mallrave ushqimorë (drithëra dhe nënprodukte të tyre) ujit të pijshëm, makinerive dhe pajisjeve (kryesisht gjeneratorë elektrikë) dhe produkteve të industrisë së shtypit.

Në fillim të vitit 2000, u vu re një ndryshim i orientimit të këtyre eksporteve. Në përputhje me përmirësimin gradual të kushteve të jetesës dhe të përpjekjeve për rimëkëmbjen e ekonomisë së Kosovës, eksportet e Shqipërisë, krahas mallrave ushqimorë, përqendrohen tashmë në grupin "artikuj të ndryshëm të prodhuar" (pajisje dhome) si edhe në atë të lëndëve djegëse minerale. Fluksi i mallrave në formën e *shuttle trade* vlerësohet

të jetë i konsiderueshëm, gjatë kësaj periudhe. Gjatë vitit 2000, gradualisht, lëndët djegëse dhe produktet e industrisë kimike ia zunë vendin pajisjeve të dhomës të cilat, deri në këtë periudhë, zinin peshën më të madhe të eksporteve shqiptare në Kosovë.

Aktivitetin eksportues e kanë lehtësuar fillimi i funksionimit të linjës ajrore Prishtinë-Tiranë në janar të vitit 2000, hapja e zyrës së INSIG-ut të Shqipërisë në Prishtinë dhe disa panaire tregtare të çelura për nxitjen e këtyre shkëmbimeve. Sidoqoftë, për t'u kthyer në një partner të fuqishëm tregtar të Kosovës, në krahasim me Maqedoninë, Shqipëria paraqet shumë mangësi në aspektin e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, si edhe të mekanizmave të shëndoshë të marketingut.

Deri më sot Shqipëria është gjendur përballë një situate jo të favorshme në marrëdhëniet tregtare me Kosovën. Eksportet shqiptare për në Kosovë, përveç vështirësive dhe kostos së lartë të transportit (në mungesë të rrugës Durrës – Kukës), i nënshtrohen një barre të konsiderueshme fiskale. Lidhjet e forta tregtare midis Maqedonisë dhe Kosovës, infrastruktura e rregullt dhe marrëveshja tregtare midis ish-Republikës së Jugosllavisë dhe Maqedonisë, që i siguron kësaj të fundit statusin preferencial në tregti, bëjnë që eksportet nga Shqipëria ta gjejnë me vështirësi rrugën e tyre për në Kosovë. Një zhvillim pozitiv në këtë drejtim përbëjnë përpjekjet e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe të Tregtisë së Shqipërisë, e cila ka filluar bisedimet për nënshkrimin e një Marrëveshjeje të Tregtisë së Lirë me Maqedoninë. Kjo gjë do të zhdukte pengesat doganore për eksportet nga Shqipëria në Maqedoni dhe më pas në Kosovë. Nga ana tjetër, Qeveria e Shqipërisë dhe UNMIK-u nuk kanë hapur asnjëherë bisedime për uljen e pengesave doganore midis dy vendeve. Vështirësitë e përmendura më lart duket se, përveç kostove të larta të atyre tregtarëve që iu nënshtrohen taksave doganore, përbëjnë një shkak të fuqishëm të përhapjes së kontrabandës.

Një tjetër njësi, që po bën përpjekje për forcimin e lidhjeve të biznesit midis tregtarëve të Shqipërisë dhe atyre të Kosovës është Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë. Kjo njësi, në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Kosovës ka

punuar dhe po punon për organizimin e disa takimeve midis palëve të lartpërmendura për krijimin e kushteve për organizimin e panaireve të dyanshme.

SISTEMI BANKAR

Për të siguruar zhvillimin e sistemit bankar në Kosovë UNMIKU-u, në nëntor të vitit 1999, miratoi dy rregullore që përcaktonin themelimin e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës dhe njëkohësisht rregulla për licencimin e bankave tregtare si edhe për kontrollin e mbikëqyrjen e tyre. BPK licencon dhe mbikëqyr të gjitha institucionet financiare banka dhe jobanka, që funksionojnë në Kosovë; mban një stok monedhash dhe kartëmonedhash në marka gjermane dhe dinarë jugosllavë; siguron shërbime depozituese dhe pagesash në marka gjermane deri sa në sistemin tregtar bankar të krijohen kapacitetet e nevojshme. Duke funksionuar si bankë e qeverisë, BPK pranon depozita nga UNMIK-u dhe agjenci të tjera zyrtare dhe bën pagesat me urdhër të Autoritetit Qendror Fiskal dhe të depozituesve të tjerë. Përveç ruajtjes së parasë për arsye sigurie, BPK nuk iu ka ofruar shërbime të depozitave dhe pagesave ndërmarrjeve, me qëllim që të mos kthehet në konkurrente të drejtpërdrejtë të sistemit bankar, i cili është në hapat e tij të parë.

Meqenëse në Kosovë nevoja për krijimin e një rrjeti bankar është e madhe, kushtet për krijimin dhe licencimin e bankave të reja vlerësohen të jenë rreth 3-4 herë më pak rigoroze sesa kushtet, që aplikohen në rajon. Procedurat e licencimit parashikojnë një shkallëzim të aktiviteteve që iu lejohen bankave tregtare në përputhje me nivelin e kapitalit. Bankat, që kanë kapital minimal prej 1 milion markash lejohet të pranojnë depozita dhe të ofrojnë shërbim pagesash. Bankat, që duan edhe të japin hua konsumatore apo tregtare, duhet të kenë kapital minimal tre herë më të lartë.

Ndërsa për bankat që duan të zhvillojnë veprimtaritë e administrimit të portofolit, të tregtimit të letrave me vlerë të

borxhit apo pronësisë kërkohet të kenë kapital 5 milionë marka gjermane.

Aktualisht, në Kosovë funksionojnë tre banka tregtare dhe 10 institucione financiare jobankare të licencuara. Bankat tregtare merren kryesisht me pranimin e depozitave dhe kryerjen e transfertave bankare, ndërkohë që aktiviteti kreditues lëvrohet shumë pak ose aspak. Rolin kreditues momentalisht e luajnë institucionet e lartpërmendura (që varen nga Banka Botërore, BERZH, EAR etj.) të cilat japin kredi me synim uljen e interesave. Disa prej këtyre fondacioneve japin kredi me interesa në nivelin 7-12 për qind, ndërkohë që paralelisht po punohet për krijimin e kushteve për ofrimin e kredive të vogla (2000 – 5000 marka gjermane ose 1000 – 2500 dollarë amerikanë) për sipërmarrjet bujqësore. Në këtë mënyrë, duket se po krijohet një ambient deri-diku nxitës, si edhe parakushtet për një treg të mirëfilltë financiar.

Një përkrahje tjetër që i bëhet rajonit në përgjithësi dhe Kosovës në veçanti, vjen nga Pakti i Stabilitetit, i cili u adoptua në qershor 1999. Në kuadër të këtij pakti synohet të përballohen problemet urgjente që lindën nga kriza në Kosovë, për t'u përqendruar më vonë në nxitjen e zhvillimit dhe të stabilitetit në të gjithë Evropën Juglindore. Me gjithë mangësitë dhe problemet që mbart në vetvete, vëmendja që i është kushtuar dhe po i kushtohet rajonit nga organizata të fuqishme ndërkombëtare duhet vlerësuar dhe shfrytëzuar në kohë.

PËRFUNDIME

Paraqitja e mësipërme transmeton mesazhe kontradiktore, të cilat nga njëra anë nxjerrin në pah realitetin jo shumë optimist të ekonomisë dhe të investimeve në Kosovë, dhe nga ana tjetër synojnë të ngjallin interesin e investitorëve apo të tregtarëve për shfrytëzimin e mundësive dhe sidomos të kërkesave të mëdha të vendit në fusha të ndryshme të ekonomisë. Në këto kushte, është e vështirë të zbehësh apo të mbulosh problemet e shumta që rrjedhin nga statusi aktual politik i Kosovës dhe nga goditja

fatale që pësoi vendi në vitin 1999. Sidoqoftë duket se ka ardhur koha që situata të shihet me një sy më pak pesimist dhe të pranohet që Kosova ka shpresë dhe mundësi për ta realizuar atë.

Ekonomia e tregut është një gjë dhe motivet morale apo politike, diçka tjetër. Nisur nga këndvështrimi thjesht ekonomik mund të thuhet që shpeshherë duhet pak guxim dhe iniciativë për të hedhur sytë atje ku rrallëkush guxon të shkojë, por ku mundësitë për fitim janë të shumta. Këndvështrimi tjetër, që në këtë rast mund të përkthehej, integrim i Shqipërisë dhe i Kosovës nëpërmjet ekonomisë apo disa prej degëve të saj, mbetet për t'u vënë në provë, gjithnjë pasi të jetë dëshmuar se veprimi në bazë të interesit vetjak të të gjitha palëve, ka dhënë frytet e veta.

SHËNIME

* Selami Xhepa, Diana Shtylla, specialistë, Departamenti i Kërkimeve.

[1] Në kohën e këtij shkrimi, nuk ekziston asnjë raport ekonomik dhe tregues të zhvillimeve apo episode të ndonjë situate të rënduar ekonomike në këtë vend. Nga ana tjetër, edhe të dhënat mbi zhvillimet e brendshme ekonomike nuk janë disponibël. Aktualisht, nuk disponojmë të dhëna mbi zhvillimet tregtare, të buxhetit, të turizmit, të tranzitimit etj.. Për rrjedhojë, të paktën deri sot, do të ishte e vështirë të bënim një analizë të saktë vlerësuese të ndikimeve të mundshme.

[2] Fjalimi i Guvernatorit të Bankës Kombëtare të Maqedonisë në Parlament, shkurt 2001.

[3] South-East Europe, EIS, shkurt, 2001.

[4] Shih. Bishev "Monetary Policy in the Balkan Region", WP, NBRM.

[5] Gjatë vitit që kaloi financat publike rezultuan me suficit që rezultoi kryesisht nga shitjet e paketave të aksioneve të Telekomit (51 për qind të aksioneve u shitën për 342 milionë euro në *cash* dhe 256 milionë euro investime kompanisë Hungareze Matav). Shih. South-East Europe, EIS, shkurt, 2001.

[6] "The Guardian", prill 2001.

[7] Mbyllja e kufirit mund të ketë patur më shumë ndikim në ekonominë e Kosovës pasi tranzitimi i mallrave për në Kosovë kryhej nëpërmjet Maqedonisë, kjo për shkak të mosekzistencës së barrierave doganore mes tyre, ndërsa në rastin e tranzitimit nëpërmjet kufirit nga Kukësi, zbatohej një tarifë doganore prej 20 për qind. Këto ndryshime në sistemin e tranzitimit, mund të kenë dhënë efekte dhe në ndryshimet në kanalet e furnizimit me mallra të zonës verilindore të vendit tonë (nga importet nga Kosova, për shkak të çmimeve më të ulëta) në furnizimin e tyre nga Tirana. Shih. "Shekulli", 27 mars 2001.

BIBLIOGRAFI

Departamenti për tregti dhe industri, Broshurë.

Kosova, Republika Federale e Jugosllavisë, Reformat sociale dhe ekonomike për paqe dhe pajtim, Raporti Nr.21784-Kos, Banka Botërore, Shkurt 2001.

Ish-bankat e Jugosllavisë iu kanë borxh kosovarëve mbi 200 milionë dollarë, Gazeta "Ekonomia", 17 Prill 2001.

Kosova: Çështjet makroekonomike dhe qëndrueshmëria fiskale, Corker, R., Kostial, K., Rehm, D., FMN 2001.

Kosova - ekonomia astmatike pas luftës, "Monitor" Nr. 8, Mars 2001.

Maqedonia rrit çmimet në Kosovë, Gazeta "Ekonomia", 27 Mars 2001.

Shqipëri – Kosovë: Integrimi përmes ekonomisë, "Monitor" Nr. 4, Mars 2001.

http://www.kosova.com/RIINVEST/riinvest.htm, Instituti për Kërkimet e Zhvillimit, Kosovë.

SISTEMI BANKAR NË SHQIPËRI DHE VENDI QË ZËNË INSTITUCIONET E MIKROKREDITIT

*Fatos Ibrahimi**

Fjalë kyçe
- Reforma strukturore - Sistemi bankar shqiptar - Institucionet e mikrokredisë -

1. HYRJE

Ndryshimet e thella politike në Shqipëri në fillimet e viteve '90 e bënin të domosdoshme kryerjen e reformës në ekonominë shqiptare, që do të bënte të mundur transformimin nga sistemi i ekonomisë së planifikuar drejt sistemit të ekonomisë së tregut.

Një element mjaft i rëndësishëm në fushën e reformave strukturore për të gjitha vendet që u futën në rrugën e ekonomisë së tregut ishte edhe reforma në fushën e sistemit financiar e atij bankar. Reforma në këtë fushë mori një rëndësi të madhe në arritjen e stabilizimit makroekonomik. Zbatimi i një kuadri efikas të drejtimit monetar pa të cilin stabilizimi do të ishte i vështirë të realizohej, është një proces interaktiv dhe evolutiv që lejon që nëpërmjet reformave të sektorit financiar të lehtësohet riorganizimi i drejtimit monetar dhe anasjelltas.

Sistemi financiar në vendin tonë i konceptuar si tërësi e tre komponentëve: institucioneve, tregjeve dhe instrumenteve financiare, ka përballuar mjaft sfida e vështirësi në rrugën e zhvillimit e të konsolidimit të tij gjatë 10 viteve të fundit. Nuk mjaftuan kushtet e disfavorshme makroekonomike, financiare

dhe prapambetja në zhvillimin e institucioneve bankare e financiare në të cilat kjo reformë filloi, por ajo u përball edhe me mjaft vështirësi të brendshme të saj që buronin nga rritja e vazhdueshme e kredive të këqija, mungesa e eksperiencës në fushën e mbikëqyrjes bankare, ineficienca e sistemit të pagesave etj.. Këto vështirësi arritën kulmin me krizën e piramidave, që shërbeu si një shkëndijë që destabilizoi gjithë vendin dhe e futi ekonominë shqiptare në një kolaps të plotë.

Për vetë trashëgiminë dhe nivelin e arritur të zhvillimit, sistemi bankar zë peshën më të rëndësishme në sistemin financiar të vendit tonë.

Vitet 1991-1992 shënuan krijimin e sistemit të ri bankar nga pikëpamja e organizimit sipas modelit të vendeve perëndimore. Kuadri ligjor në këtë periudhë bëri të mundur kalimin e sistemit bankar njënivelor në sistem bankar dynivelor. Si bankë e nivelit të parë u krijua Banka e Shqipërisë (BSH) me atributet e një banke qendrore, ndërsa në nivelin e dytë operonin tre banka me kapital shtetëror: Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Banka e Kursimeve (BK) dhe Banka e Bujqësisë dhe e Zhvillimit që shpejt ndërroi emrin në Banka Tregtare Agrare (BTA).

Zhvillimet e viteve të mëvonshme u karakterizuan nga kryerja e reformave në këto banka si dhe krijimi dhe zgjerimi i veprimtarisë bankare nga banka të reja private. Reforma në sistemin bankar, e cila synonte rritjen e efektshmërisë në tregun bankar, krahas realizimit, fillimisht të ristrukturimit, u mbështet në privatizimin e tyre.

Si rrjedhim, në mesin e vitit 2001, në Shqipëri operojnë 13 banka universale dhe brenda një viti pritet të fillojë aktivitetin edhe Banka Tregtare e Kuvajtit, e cila është licencuar para një muaji nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Sipas pronësisë së kapitalit, Banka e Kursimeve është e vetmja bankë me kapital shtetëror, ndërsa të tjerat janë me kapital të përbashkët (2) dhe kapital privat të huaj (10). Gjithashtu, në vendin tonë operojnë 20 zyra të këmbimeve valutore, 3 shoqëri financiare jobanka, 36 shoqëri kursim - krediti si dhe një numër fondacionesh, që

nuk licencohen nga Banka e Shqipërisë por kryejnë veprimtari në fushën e kreditimit.

Zhvillime ka patur edhe në operimin e institucioneve të tjera financiare jobankare. Tashmë, në Shqipëri operojnë dy shoqëri private sigurimesh. Edhe vetë Instituti i Sigurimeve (INSIG-u) synohet që të privatizohet. Gjithashtu, janë licencuar tre fonde investimesh nga të cilët vetëm njëri ka qenë aktiv në procesin e grumbullimit të bonove të privatizimit, por që ende nuk ka filluar investimet.

Megjithëse jo i zhvilluar, funksionon tregu i parasë, ndërsa tregu i kapitalit është ende në fazën embrionale. Premisat e zhvillimit të këtyre tregjeve bazohen në përpjekjet, që tashmë kanë filluar të bëhen, për shtimin e operatorëve të tregut dhe të instrumenteve që tregtohen në të. Bazë në zhvillimin e tregut të kapitalit është dhe procesi i privatizimit të kompanive shtetërore që po njeh një ritëm më të mirë gjatë këtij viti.

2. REFORMA BANKARE DHE PROBLEME TË ZHVILLIMIT TË SISTEMIT BANKAR SHQIPTAR

Më poshtë do të ndalem në këto çështje:

- Baza ligjore dhe kuadri rregullativ;
- Privatizimi i bankave shtetërore;
- Gjendja aktuale e sistemit bankar;
- Banka e Shqipërisë dhe institucionet financiare jobanka.

2.1. BAZA LIGJORE DHE KUADRI RREGULLATIV

Kuadri ligjor dhe rregullativ bankar ka pësuar ndryshime të vazhdueshme gjatë 10 viteve të fundit si pasojë, jo vetëm e nevojës së perfeksionimit, por edhe e zhvillimit të dukurive negative në këtë sektor.

Në prill dhe maj 1992, u hodhën bazat ligjore për formulimin e politikave monetare, për krijimin e bankave tregtare dhe për rregullimin e veprimtarisë së tyre. Këto baza u hodhën me miratimin e ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" si autoriteti më i lartë monetar i vendit i autorizuar për formulimin e politikave monetare dhe për rregullimin e sistemit bankar, si dhe me miratimin e ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohej mënyra e organizimit dhe e funksionimit të bankave tregtare. Në përputhje me këto ligje, u formua një sistem bankar dynivelor në të cilin përfshiheshin: Banka e Shqipërisë si bankë qendrore dhe bankat tregtare që mbikëqyreshin prej saj.

Këto dy ligje bazë pësuan ndryshime të konsiderueshme në vitin 1996. Kriza financiare e vitit 1997, e shkaktuar nga falimentimi i skemave piramidale, dëshmoi se edhe në kuadrin ligjor bankar kishte mangësi të theksuara që lejuan lulëzimin e këtyre skemave.

Ishte kjo arsyeja kryesore që në fund të viteve 1997 dhe 1998, të dyja ligjet (ligji "Për Bankën e Shqipërisë dhe ai "Për bankat në Republikën e Shqipërisë") pësuan ndryshime të theksuara, që synuan si rritjen e pavarësisë së Bankës së Shqipërisë si autoriteti kryesor monetar dhe mbikëqyrës i sistemit bankar, ashtu dhe forcimin e vetë sistemit bankar nëpërmjet rregullimeve dhe forcimit të mbikëqyrjes.

Krahas përmirësimit ligjor, Banka e Shqipërisë gjatë viteve të fundit ka përmirësuar ndjeshëm kuadrin rregullator dhe mbikëqyrës të bankave të nivelit të dytë, duke forcuar rregullat e licencimit apo përcaktimin e normave standarde ndërkombëtare mbi mjaft nga treguesit e veprimtarisë bankare.

Mbikëqyrjes dhe inspektimit të Bankës së Shqipërisë i nënshtrohen, pa dallim, bankat shqiptare apo degët e bankave të huaja, banka shtetërore apo private si dhe çdo subjekt tjetër financiar, që licencohet nga Banka e Shqipërisë.

Degët e bankave të huaja, që operojnë në Shqipëri, lejohet të inspektohen edhe nga autoritetet mbikëqyrëse të vendeve

përkatëse, gjë që i ka hapur rrugën edhe nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe me këto vende në fushën e mbikëqyrjes bankare, çka e rrit më tej stabilitetin dhe sigurinë e këtyre institucioneve.

Hartimi dhe miratimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ në fushën bankare është bërë në përputhje me planin strategjik të Bankës së Shqipërisë për një mbikëqyrje efektive. Objektivi strategjik i kësaj mbikëqyrjeje është krijimi i një sistemi bankar të sigurt dhe të shëndoshë. Realizimi i këtij objektivi strategjik është një proces dinamik dhe kërkon përmbushjen e një sërë objektivave afatshkurtër dhe afatmesëm duke synuar:

- *krijimin* e një kuadri ligjor dhe rregullator që të konvergojë me standardet ndërkombëtare të Komitetit të Bazelit dhe direktivat e BE për mbikëqyrjen bankare;
- *sigurimin* e respektimit dhe të zbatimit rigoroz të kuadrit ligjor dhe rregullator;
- *kufizimin* e ndërmarrjes, nga ana e bankave, të rreziqeve të tepërta të cilat vënë në rrezik depozituesit.

Arritja e këtyre objektivave sigurohet nëpërmjet:

a. mbikëqyrjes së procesit të hyrjes së bankave të reja; (licencimi)
b. rregullimit të bankave të nivelit të dytë dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të respektimit të rregullave;
c. mbikëqyrjes së ecurisë financiare të bankës (analiza e bankave dhe e sistemit bankar);
d. mbikëqyrjes së procesit të trajtimit të bankave me probleme (nga marrja e veprimeve korrektuese deri tek revokimi i licencës).

2.2. PRIVATIZIMI I BANKAVE ME KAPITAL SHTETËROR

Procesi i privatizimit të bankave shtetërore, i filluar në vitin 1995 me miratimin e ligjit "Për transformimin e bankave shtetërore në shoqëri tregtare dhe lejimin e privatizimit të tyre",

u pasua më vonë me mjaft akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Mungesa e eficiencës së këtyre bankave, sidomos në treguesin e kthyeshmërisë së kredisë, tregoi se hapat fillestarë të ristrukturimit qenë të pamjaftueshëm dhe jo të suksesshëm. Dhënia e kredive pa kriter, trysnia politike në shpërndarjen e tyre, korrupsioni që fitoi legjitimitet moral nëpërmjet pagesës së 10 përqindëshave për çdo kredi të shpërndarë dhe përhapja që morën skemat piramidale, e çuan sistemin bankar në prag të falimentimit nëpërmjet ballafaqimit me krizën e likuiditetit.

Në masat e para që u morën për të përballuar këtë krizë pas vitit 1997 ishin vendimi i qeverisë për mbylljen e Bankës Tregtare Agrare dhe vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për ndalimin e kreditimit nga ana e bankave shtetërore. Në vitin 1998, Kuvendi miratoi strategjinë e privatizimit të sektorëve strategjikë të ekonomisë shqiptare. Pjesë e rëndësishme e kësaj strategjie ishte edhe privatizimi i bankave tregtare me kapital shtetëror, përkatësisht Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka e Kursimeve.

Lidhur me Bankën Kombëtare Tregtare në atë periudhë, u shtruan dy alternativa: e para ishte ristrukturim dhe më pas privatizim ose në pamundësi të një ristrukturimi të suksesshëm banka të likuidohej. Realizimi me sukses i këtij procesi, nëpërmjet investitorit strategjik shpresojmë që së shpejti të japë një impakt të konsiderueshëm në zhvillimin e konsolidimin e mëtejshëm të sistemit bankar në vendin tonë.

Prandaj, privatizimi i sektorit bankar, në rradhë të parë kërkon që shteti të heqë dorë nga qeverisja e drejtpërdrejtë e institucioneve bankare dhe të marrë përsipër rolin që i takon dhe aq sa i takon, si rregullator dhe si mbikëqyrës i bankave.

Eksperiencat në vendet e tjera sugjerojnë se kalimi i bankave në pronësi private është mënyra e vetme që siguron një strukturë adekuate drejtimi, domethënë, që i lejon bankierët të marrin vendimet lidhur me shpërndarjen e kredive në mënyrë të pavarur. Kjo përbën edhe çelësin për të kuptuar rolin e bankave gjatë periudhës së tranzicionit.

Pronësia private mbi kapitalin siguron sistemin adekuat të rrezikut dhe të shpërblimit, që janë bazat e strukturës së drejtimit të bizneseve në ekonominë e tregut.

2.2.1 Privatizimi i Bankës së Kursimeve

Autoritetet shqiptare janë shprehur pro-privatizimit të Bankës së Kursimeve dhe madje ky proces ka filluar prej vitesh. Tashmë mund të themi se jemi afër fundit të privatizimit të kësaj banke.

Duhet të theksoj se për privatizimin e Bankës së Kursimeve po tregohet një vëmendje e veçantë nga ana e autoriteteve qeveritare dhe e institucioneve financiare ndërkombëtare që ndjekin nga afër këtë proces. Në mbështetje të këtij procesi janë miratuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me miratimin e programit dhe të strategjisë së privatizimit të bankës, me formulën e privatizimit, me rikapitalizimin e bankës dhe me mbulimin e humbjeve nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit dhe është miratuar vendimi për procedurat e privatizimit të Bankës së Kursimeve

Vlen të përmendet që, për herë të parë gjatë këtyre 10 viteve të fundit, Banka e Kursimeve doli me fitim vitin e kaluar dhe për vitin 2000 ky fitim u katërfishua, çka krijon një bazë të shëndoshë për perspektivën e bankës.

Po kështu, rikapitalizimi i bankës para përfundimit të procesit të privatizimit të saj (në dallim nga Banka Kombëtare Tregtare që u rikapitalizua në momentin e privatizimit) krijon një epërsi për bankën dhe e bën atë më atraktive për blerësit e huaj.

Privatizimi i Bankës së Kursimeve, që parashikohet nëpërmjet investitorëve strategjikë, synon të rritë eficiencën dhe fitimin e bankës, të rritë konkurrencën në sistemin bankar, të sjellë teknologji dhe njohuri të reja, të rritë nivelin e shërbimit dhe të ofrojë për klientët e bankës produkte të reja sipas praktikave ndërkombëtare të bankingut modern, të cilat me siguri do të rritin reputacionin e bankës dhe besimin e klientëve ndaj saj. Në përgjithësi, rekomandohet që privatizimi i bankave të hartohet në mënyrë të tillë që të nxisë një mjedis konkurrues, me qëllim

që sektori financiar të mos dominohet nga pak institucione bankare si dhe të sigurojë që institucionet e privatizuara të drejtohen realisht në mënyrë të pavarur nga qeveria.

2.3. GJENDJA AKTUALE E SISTEMIT BANKAR

Viti 2000 është viti i tretë rradhazi gjatë të cilit situata makroekonomike e vendit është brenda kornizave të programit të zhvillimit afatmesëm.

Zbatimi i këtij programi ka siguruar qëndrueshmëri makroekonomike duke krijuar premisa për të mbështetur zhvillimin afatgjatë dhe për të patur mundësi për hartimin e strategjive të zhvillimit, të sektorëve të veçantë të ekonomisë së vendit, për të forcuar institucionet dhe për t'u angazhuar në ato aspekte që përbëjnë prioritet.

Të rëndësishme do të konsideroja veçanërisht, zhvillimet në sistemin bankar shqiptar ku ndër më kryesoret mund të përmend: zhvillimet në kuadrin e zbatimit të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, shtimin e kredive për ekonominë si dhe përmirësimin e situatës së sistemit të bankave tregtare.

Në vitin 2000, Banka e Shqipërisë mori të gjitha masat e nevojshme për të realizuar kalimin nga instrumentet direkte në ato indirekte të zbatimit të politikës monetare. Është fakt i njohur që për të dhënë sinjalet në treg, banka qendrore nuk bazohet më në kufirin e kreditit apo në normën minimale të interesit për depozitat me afat në lekë. Të dyja këto instrumente janë "shfuqizuar". Rolin e normës referencë ose bazë e luan tashmë norma e interesit të ankandeve për marrëveshjet e riblerjes. Në këtë proces zëvendësimi të instrumenteve, Banka e Shqipërisë veproi me maturi dhe arriti të realizojë synimet e saj. Ky kalim u bë i mundur në sajë të nivelit në të cilin ka arritur sistemi bankar, të mjedisit ekonomik relativisht të favorshëm të krijuar në vend si edhe nga bashkëpunimi më i mirë i siguruar me Ministrinë e Financave, në drejtim të administrimit të procesit të financimit të brendshëm të deficitit buxhetor.

Stabiliteti makroekonomik i arritur dhe nevoja për të siguruar rritje ekonomike, i krijuan mundësi Bankës së Shqipërisë që, për të tretin vit rradhazi, të zbuste politikën monetare, duke reduktuar vazhdimisht normat e interesit. Në tërësi, normat e interesit në ekonomi u ulën. Këta faktorë, vlerësohet të kenë ndikuar edhe në rritjen e kredisë së dhënë nga sistemi bankar për ekonominë. Në vitin 2000, gjendja e kredive rezulton tri herë më shumë se në vitin 1999; kreditë e reja, gjatë vitit 2000, janë pothuaj sa teprica në fund të këtij dhe se i konsiderueshëm ka qenë dhe niveli i shlyerjeve të kredive.

Në vitin 2000, gjendja në sistemin bankar shqiptar vlerësohet relativisht e sigurt dhe e shëndoshë. Ndër zhvillimet më të rëndësishme mund të rendis zgjerimin e rrjetit bankar, ndryshimin e strukturës së pronësisë së këtij sistemi, kapitalizimin e sistemit si dhe gjendjen financiare të tij.

- Rrjeti bankar u zgjerua kryesisht jashtë qytetit të Tiranës. Dega e Alfa Bank ka shtrirë aktivitetin e saj në Elbasan dhe në Durrës; Banka Tirana ka shtrirë aktivitetin e saj në Gjirokastër; Banka FEFAD filloi aktivitetin edhe në Fier dhe në Elbasan; Banka Amerikane e Shqipërisë filloi aktivitetin në Durrës dhe në një agjenci brenda Ambasadës Amerikane.

- Struktura e pronësisë së sistemit bankar ka ndryshuar dukshëm në favor të pronarëve joshtetërorë dhe përfaqësues të kapitalit të huaj. Përfundimi i privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare bëri që niveli i kapitalit shtetëror në sistemin bankar të bjerë nga 38.1 për qind, në fund të vitit 1999, në 13.4 për qind në fund të vitit 2000. Për të njëjtat periudha pesha e kapitalit të huaj në vend u rrit nga 59.8 në 84 për qind. Ky është tregues i drejtpërdrejtë i shtimit të investimeve të huaja dhe i besimit relativisht më të madh që kanë investitorët e huaj në sektorin bankar krahasuar me krejt ekonominë.

- Niveli i kapitalizimit të sistemit bankar është mjaft i kënaqshëm. Mjaftueshmëria e kapitalit, treguesi më i

drejtpërdrejtë i matjes së kapitalizimit, është rritur nga 8.2 për qind, në fund të vitit 1999, në 41.8 për qind, në fund të vitit 2000, duke kaluar me 3.5 herë normën minimale të lejuar nga Banka e Shqipërisë. Kjo situatë është rezultat i drejtpërdrejtë i vendimit të Bankës së Shqipërisë[1] për rritjen e nivelit të kapitalit të paguar nga bankat si dhe i kapitalizimit nga Qeveria të Bankës së Kursimeve.

- Për të dytin vit rradhazi, sistemi bankar rezulton me fitim. Në fund të vitit 2000 fitimi arriti në 5.4 miliardë lekë ose 4.5 herë më shumë se në vitin 1999. Shtimi i fitimit dhe kapitalizimi i kënaqshëm do të thotë më shumë kredi dhe investime nga bankat.

Shtimi i pranisë së kapitalit të huaj privat në sistemin bankar, përmirësimi i situatës financiare, kapitalizimi i mjaftueshëm i bankave, rritja e konkurrencës si dhe perspektivat për situatë të qëndrueshme ekonomike kanë krijuar kushtet, që në vitin 2001, bankat të kontribuojnë më shumë në ekonominë e vendit.

3. ZHVILLIMI I INSTITUCIONEVE TË MIKROKREDISË

Një zhvillim mjaft pozitiv që vihet re vitet e fundit në Shqipëri është edhe prania e institucioneve të mikrokredisë, të cilat përfaqësohen nga subjektet financiare jobanka dhe nga shoqëritë e kursim - kreditit. Sot në Shqipëri funksionojnë 36 shoqëri kursim - krediti, 3 institucione financiare jobanka dhe 4 fondacione krediti me një tepricë kredie rreth 8 milionë dollarë.

a) Institucionet financiare jobanka kryejnë një ose disa aktivitete së bashku që është karakteristikë e veprimtarive të lejuara për bankat, por në dallim prej tyre, subjekteve jobanka u ndalohet pranimi dhe grumbullimi i mjeteve monetare nga publiku në çdo formë.
b) Shoqëritë e kursim - kreditit, me ligj, marrin depozita, japin kredi dhe kryejnë transaksione me palët e treta. Me ligj

është përcaktuar se aktiviteti i grumbullimit të depozitave dhe i dhënies së kredive bëhet vetëm brenda komunitetit të anëtarëve të shoqërisë së kursim - kredisë.

Anët e përbashkëta:

a) Objekti i veprimtarisë së tyre zhvillohet kryesisht në hapësirat e pambuluara nga sistemi bankar. Në këtë mënyrë, sistemi plotësohet me aktorë të rinj, që dalin në treg, për të plotësuar kërkesat e klientelës duke rritur njëkohësisht konkurrencën.
b) Klientela e tyre janë kryesisht individë dhe biznesi i vogël, më shumë të orientuar në zonat rurale.

Perspektiva e tyre:

Ne gjykojmë se e rëndësishme është që aktiviteti i tyre të sjellë një forcim të vazhdueshëm të gjendjes financiare. Forcimi i vazhdueshëm i gjendjes financiare në aspektin e përgjithshëm, ruan dhe konsolidon stabilitetin financiar të sistemit. Kjo për shumë arsye:

E para: pavarësisht se sot numri dhe madhësia e tyre janë relativisht të vogla pra dhe ndikimi tyre në stabilitetin e përgjithshëm financiar, sot për sot, mund të jetë po ashtu i vogël ose i papërfillshëm, por bazat e një disipline tregu vendosen pikërisht në këto momente.

E dyta: ekzistojnë të gjitha hapësirat ligjore për një rritje të gjerë të veprimtarisë së këtyre institucioneve në të gjitha zonat e vendit.

E treta: mund të jem më optimist seç duhet, por bindja ime është se këto institucione mund të shërbejnë si bazë mbi të cilën mund të lindin bankat e ardhshme. Do të konsideroja shumë të rëndësishme eksperiencën e vetë punës profesionale të tyre dhe shumë pozitive marrëdhëniet me mbikëqyrjen, që në fillimet e veprimtarisë.

Organizimi i mbikëqyrjes:

Siç e theksova dhe më lart, mbikëqyrja ushtrohet në emër të një të drejte që të është dhënë për të ushtruar një veprimtari të caktuar, pra "justifikohet" nga dhënia e licencës.

1. Për subjektet financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë, mbikëqyrja organizohet me të gjitha elementet përbërëse të saj, si licencimi, rregullimi, analiza, inspektimi në vend. Ndërsa, për subjektet financiare jobanka që janë të përjashtuara nga procedura e licencimit, mbikëqyrja reduktohet vetëm në shkëmbimin e informacionit dhe në trajtimin e problematikës së dalë nga informacioni i dërguar.

2. Shoqëritë e kursim - kredititi. Nisur nga ligji nr. 8089, datë 23.03.1996 roli i Bankës së Shqipërisë ishte vetëm ai i shkëmbimit të informacionit. Me ndryshimin e ligjit, i cili ka kaluar në Parlament, por ende nuk ka hyrë në fuqi, Banka e Shqipërisë ka të drejtën e mbikëqyrjes me të gjitha elementet e saj, pasi, sipas ligjit, tani ajo është e ngarkuar me licencimin e këtyre mikroinstitucioneve. Për këtë arsye, ka dhe një projekt të Bankës Botërore për mbështetjen dhe kualifikimin e burimeve njerëzore për ndërtimin e kuadrit të plotë mbikëqyrës.

Rekomandimet:

E ardhmja e shumë prej këtyre institucioneve është pozitive. Mendoj se, sot për sot, duhen të ndërmerren disa hapa në drejtim të organizimit të përbashkët për t'i paraprirë disa fenomeneve të ardhshme.

E para: mendoj se duhet filluar që sot për të menduar se si mund të komunikohet me njëri - tjetrin, me institucionet e ngjashme ndërkombëtare, me institucionet e Shtetit Shqiptar etj., me një gjuhë të përbashkët. Në këtë drejtim, organizimi i përbashkët në formën e një shoqate, si ajo e bankierëve nuk është veçse anë pozitive.

E dyta: sot bota moderne është informacion. Të gjitha përpjekjet sot bëhen tashmë jo më për sigurimin e tij, por për

koston dhe shpejtësinë e marrjes. Është tamam në kohë të mendohet për krijimin e një qendre të përbashkët informacioni, ku secili të kërkojë dhe të marrë atë që ka nevojë. Le të shërbejë si departament i parë i tij, qendra e informacionit për kredinë.

Jemi të ndërgjegjshëm që sistemit bankar në Shqipëri i mungojnë ende shumë aspekte për t'u konsideruar një sistem bankar modern. Për zhvillimin e tij do të përballemi ende me shumë probleme dhe sfida. Por, sa theksova edhe më lart ai po zgjerohet dhe po konsolidohet nga dita në ditë, paraqitet i sigurt dhe i shëndoshë, po shtohen aktorët pjesëmarrës në të, po përsosen mekanizmat dhe po shtohen produktet bankare, çka krijon besim dhe siguri për të ardhmen.

* Fatos Ibrahimi, Zëvendësguvernator i Parë dhe Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë.

ANALIZA E DIFERENCËS SË INTERESAVE MIDIS INVESTIMEVE DHE DEPOZITAVE PËR VITIN 2000 DHE TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2001

*Suzana Sheqeri**

Fjalë kyçe
- Kostoja e ndërmjetësimit - Depozita në lekë - Investime në lekë - Bono thesari -

Gjatë vitit 2000 dhe tremujorit të parë të vitit 2001, kostoja e ndërmjetësimit për sistemin bankar, e vlerësuar sipas diferencës midis interesit mesatar të ponderuar për pranimet e reja të depozitave në lekë dhe interesit mesatar të ponderuar për investimet e reja në lekë, është reduktuar lehtë gradualisht çdo muaj. Konkretisht, nga niveli mesatar 10.65 për qind në vitin 1999, ka arritur në 7.56 për qind në vitin 2000, duke u ulur mesatarisht me 3.09 pikë përqindjeje. Edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2001 kostoja është ulur, duke arritur në 4.67 për qind.

Duke filluar nga viti 1996, krahasimi i të dhënave tregon që tendenca e kostos së ndërmjetësimit për sistemin bankar, e vlerësuar sipas diferencës është karakterizuar nga tendenca në ulje dhe viti 2000 është viti në të cilin sistemi bankar ka arritur nivelin më të ulët duke kaluar për herë të parë në nivel njëshifror.

Tabelë 1. Diferenca mesatare vjetore (në përqindje).

Vitet	Diferenca mesatare vjetore
1996	19.70
1997	16.20
1998	13.83
1999	10.65
2000	7.56

Grafik 1. Diferenca midis interesit të investimeve në lekë dhe interesit të depozitave në lekë për sistemin.



Diferenca midis interesit mesatar të ponderuar për investimet në lekë (kreditë e reja e bonot e thesarit të blera në tregun primar) dhe pranimeve të reja të depozitave në lekë në sistemin bankar gjatë vitit 2000, u luhat në vlerat 9.76 – 5.82 për qind.

Interesi mesatar i ponderuar për pranimet e reja të depozitave në lekë u reduktua me 3.18 pikë për qind; ndërsa interesi mesatar i ponderuar për kreditë e reja në lekë dhe investimet në tregun primar të bonove të thesarit, u reduktuan me 6.28 pikë për qind. Për tremujorin e parë të vitit 2001 këto reduktime janë përkatësisht 0.32 pikë për qind dhe 1.53 pikë për qind.

Nga të dhënat del që, niveli i reduktimit të interesit mesatar të ponderuar të pranimeve të reja të depozitave ka qenë më i ulët, krahasuar nivelin e reduktimit të interesit mesatar të investimeve të kryera rishtazi (viti 2000 me 6.28 - 3.18 = 3.09%) dhe (3ml 1.53-0.32=1.21%).

Ngushtimi i diferencës midis interesit mesatar të ponderuar për investimet e reja dhe pranimet e reja të depozitave në lekë është rrjedhim i influencës së një kompleksi faktorësh që ndikojnë në të. Ndër këta faktorë do të përmendim:

- politika e Bankës së Shqipërisë;
- përmirësimet që i janë bërë sistemit bankar në vend;

- strategjitë e vetë bankave tregtare në fushën e monedhës kombëtare, drejt një administrimi më aktiv të burimeve në lekë në tregun e brendshëm;
- rritja e nivelit të konkurrencës midis bankave;
- përmirësimet në rritjen e shkallës së transparencës dhe kooperimit të Bankës së Shqipërisë me bankat tregtare, lidhur me kuptimin e drejtë të hapave të ndërmarrë në fushën e politikës monetare.

Kështu, nga ana e Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 2000, është punuar në drejtim të:

- dërgimit të sinjaleve të politikës monetare në treg, përmes normës së përcaktuar në ankandet e repove. Duke e konsideruar atë si normë bazë u synua ulja e nivelit të interesave të tregut, në përputhje me lëvizjen e inflacionit dhe zhvillimeve të tjera monetare;
- krijimit të portofolit të marrëveshjeve të riblerjes me një madhësi të tillë që duke e ndryshuar këtë madhësi, të ndikohet në nivelin normave të tregut;
- remunerimit të rezervës së detyrueshme, duke ndikuar në reduktimin e kostos së bankave;
- administrimit të likuiditeteve në sistemin bankar, përmes parashikimit të nevojave afatshkurtra të qeverisë dhe të sistemit bankar;
- nxitjes së zhvillimit të tregut ndërbankar;
- pjesëmarrjes më aktive në treg të bankave të nivelit të dytë;
- rritjes së mundësive dhe të fleksibilitetit të ndërhyrjeve në treg nga Banka e Shqipërisë;
- rritjes së larmisë së instrumenteve për bankat e nivelit të dytë.

Të gjitha këto kanë influencuar në drejtim të nxitjes së konkurrencës në treg dhe të ruajtjes së stabilitetit ekonomiko-financiar, duke dhënë efekt në sistem në drejtim të uljes së kostos së ndërmjetësimit, e cila ka arritur nivelin më të ulët ku kanë lëvizur ndërmjetësit financiarë në vend, për të plotësuar shpenzimet e tyre dhe për të arritur fitimin.

Nga pikëpamja e bankave, ulja e vazhdueshme e diferencës tregon se këto banka janë bërë më aktive në treg dhe në drejtim të administrimit të fondeve. Ndjekja vizuale e tendencës së kësaj diference për bankat e nivelit të dytë, tregon se në disa nga këto banka kjo tendencë ka qenë drejt uljes dhe, në përgjithësi, me oshilacione të zbutura ndaj vijës së tendencës. Tendenca drejt uljes e kësaj diference, në këto banka, është vlerësues i rritjes së nivelit të administrimit të likuiditeteve në lekë, që përbën një tregues të rritjes së efektivitetit të punës së tyre ndaj monedhës vendase.

Zhvillimet më të detajuara në nivelin e interesit mesatar të ponderuar për pranimet e reja të depozitave dhe investimeve të reja paraqiten:

I. Interesi mesatar i ponderuar për pranimet e depozitave në lekë në sistemin bankar nga 8.32 për qind në vitin 1999, arriti mesatarisht në nivelin 5.14 për qind për vitin 2000, dhe 4.69 për qind në periudhën janar – mars 2001.

Ky reduktim është ndikuar nga:

1. Ulja e nivelit të interesave për depozitat në lekë. Gjatë vitit 2000, Banka e Shqipërisë ndoqi një politikë të zbutur në fushën e interesave. Veçantia qëndron në formën e transmetimit të kësaj politike në treg, gjatë vitit. Në pjesën e parë të vitit u përdor instrumenti direkt i interesave, përmes uljes së nivelit minimal të detyrueshëm të interesave për depozitat me afat në lekë në janar, mars dhe maj 2000. Reagimi i bankave me kapital shtetëror ndaj këtyre vendimeve të Bankës së Shqipërisë qe i vonuar. Kjo vonesë u reflektua edhe në ndryshimin e nivelit të interesit për depozitat në lekë edhe për bankat e tjera. Si rrjedhim, niveli i interesit mesatar për depozitat mbeti pothuajse në të njëjtat nivele, duke rënë vetëm në maj dhe qershor. Në Bankën e Kursimeve niveli i interesit mesatar arriti në 5.55 për qind në qershor 2000, nga 6.82 për qind në janar 2000.

Sulmi i shtypit dhe i medias ndaj Bankës së Kursimeve, reagimi i shpejtë i publikut përmes tërheqjes së depozitave, sollën si pasojë ngurrimin e Bankës së Kursimeve për uljen e nivelit të

interesave për depozitat në lekë, kryesisht në pjesën e parë të vitit. Në këto kushte, edhe bankat e tjera që ndiqnin me një diferencë mesatarisht 2 pikë më lart se sa Banka e Kursimeve, nuk nxituan t'i lëviznin nivelet e tyre të interesave. Mosfunksionimi i këtij mekanizmi, bëri që niveli i interesit mesatar të ponderuar për pranimet e reja të depozitave në sistem, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2000, të reduktohet në nivele të ulta.

Në periudhën e dytë të vitit, për herë të parë Banka e Shqipërisë vuri në funksionim ankandet e marrëveshjeve të riblerjes. Interesi i ofruar nga Banka e Shqipërisë për shumën e pranuar në ankand, erdhi në rënie. Fillimisht ai ishte 9 për qind, ndërsa në tremujorin e fundit të vitit u stabilizua në 6.5 për qind. Banka e Shqipërisë, përmes administrimit të portofolit të marrëveshjeve të riblerjes, ndikoi në treg duke bërë që bankat të ulnin nivelin e interesave.

Tabelë 3. Vëllimi mujor i rezervave të tepërta i investuar në marrëveshje të riblerjes dhe interesi mesatar.

	Investuar në repo (në milionë lekë)	Int. mes. mujor (%)
Korrik '00	1,150	6,58
Gusht	4,299	6,75
Shtator	6,999	5,37
Tetor	4,999	4,62
Nëntor	33,091	5,74
Dhjetor '00	23,216	6,45
Janar	20,994	5,20
Shkurt	34,000	6,10
Mars '01	43,000	6,20

Ky fakt del i qartë në uljen graduale, pas muajit korrik 2000, të nivelit mesatar të ponderuar për depozitat në lekë. Kështu, vetëm në Bankën e Kursimeve niveli i interesit mesatar për pranimet e reja të depozitave arriti të ulet nga 5.26 për qind, në korrik 2000, në nivelin 4.32 për qind në dhjetor 2000 dhe 4.8 për qind, në mars 2001. Ndërsa, vetëm për depozitat me afat ky nivel u ul, po për të njëjtat periudha, nga 7.87 për qind në 6.94 për qind dhe 7.0 për qind.



1. ZHVILLIMET E STRUKTURËS SË PRANIMEVE TË REJA TË DEPOZITAVE

Niveli i pranimeve të reja paraqitet me tendencë në rritje si për depozitat pa afat ashtu edhe për depozitat me afat. Por, nga krahasimi i tyre del që tendenca e rritjes në pranimet e reja të depozitave pa afat ka qenë më e lartë se sa ajo e depozitave me afat, krahasuar me vitin 1999. Rrjedhimisht, ndryshimet strukturore të pranimeve të reja të depozitave në lekë në favor të depozitave pa afat, kanë ndikuar në drejtim të reduktimit të interesit mesatar të ponderuar të pranimeve të reja të depozitave.

Tabelë 4. Pranimet mesatare mujore të depozitave në lekë (në milionë lekë).

Depozita	1999	Viti 2000	3m I 01
12 mujore	3.419	3.580	5.570
6 mujore	1.288	1.551	2.593
3 mujore	12.576	14.095	16.616
Gjithsej	17.283	19.226	24.779
Llogari rrjedhëse	14.903	17.362	21.105

Në tremujorin e parë të vitit 2001, tendenca është e kundërt. Rritje në nivel më të lartë të pranimeve të reja të depozitave me afat, kundrejt atyre pa afat. Një strukturë e tillë e pranimeve të reja të depozitave ka çuar në rritjen e nivelit të interesit mesatar të

depozitave në lekë. Kështu, nga 4.18 për qind në dhjetor 2000, ky nivel u rrit në 4.83, 4.72 dhe 4.51 për qind respektivisht në janar, shkurt dhe mars 2001.

Banka të ndryshme kanë strukturë të ndryshme të pranimeve të reja të depozitave. Bankat që zotërojnë pjesën më të madhe të depozitave në lekë në këtë treg paraqesin strukturat si më poshtë:

Në Bankën Kombëtare Tregtare, vazhdon të ruhet e njëjta strukturë e pranimeve të reja gjatë vitit 2000, ashtu si gjatë vitit 1999. Pesha specifike e llogarive rrjedhëse ndaj totalit të pranimeve të reja llogaritet në 78 – 85 për qind të totalit të këtyre pranimeve. Për këtë arsye, edhe kostoja e pranimeve të reja të depozitave qëndron në nivele shumë të ulëta (jo më shumë se 3.0 për qind).

Pavarësisht nga kjo, kompozimi i pranimeve të reja të depozitave me një nivel të lartë të depozitave pa afat shpreh shkallën e lartë të likuiditetit në lekë, duke e bërë më të ekspozuar këtë bankë kundrejt rrezikut.

Për Bankën e Kursimeve, struktura e pranimeve të reja për depozitat pa afat dhe ato me afat paraqitet në tabelën 5:

Tabelë 5. Struktura e pranimeve të reja të depozitave në Bankën e Kursimeve (në miliardë lekë).

Pranimet	1999	Viti 2000	3ml 2001
Gjithsej	24.3	28.23	34.46
Depozita pa afat	8.77	11.41	13.68
Depozita me afat	15.60	16.82	20.78

Për vitin 2000, niveli i pranimeve të reja, ruan të njëjtat tendenca si gjatë vitit 1999. Peshën më të lartë në këto pranime e kanë depozitat me afat. Pranimet e reja në depozitat pa afat kanë ardhur duke e rritur pjesën e tyre ndaj totalit. Edhe, pse pesha e pranimeve të reja në depozitat me afat është më e lartë kundrejt depozitave pa afat, rritja në nivele më të larta e depozitave pa afat ka bërë që niveli i interesit mesatar të ponderuar të reduktohet.

Duke përjashtuar Bankën e Kursimeve dhe Bankën Kombëtare Tregtare, për bankat e tjera tregtare, niveli i interesit mesatar të ponderuar për pranimet e depozitave në lekë ka ardhur gradualisht duke u reduktuar. Pavarësisht nga ky fakt, këto banka në total rezultojnë me një kosto më të lartë për pranimet e depozitave të krahasuara me Bankën e Kursimeve dhe Bankën Kombëtare Tregtare. Kjo është e pritshme në kushtet kur niveli i interesit për depozitat me afat në lekë në këto banka, qëndron mbi atë të bankave me kapital shtetëror.

Tabelë 6. Niveli mesatar i pranimeve të reja të depozitave në lekë dhe interesi mesatar i ponderuar i tyre.

	Viti 1999	Viti 2000	3m I '01
Int.mes.pon.për depozitat në bankat private	7.2%	6.0%	4.39%
Niveli mes.muj.pran.dep në bankat private(në milionë lekë)	3.22	4.35	7.10
Në për qind ndaj totalit të pranimeve të sistemit	10.6%	12.97%	15.54%

Pjesa që zënë këto banka në totalin e pranimeve të reja të sistemit ka patur tendencë në rritje. Tendenca në rënie e nivelit mesatar të ponderuar të interesave për depozitat në lekë dhe tendenca në rritje e nivelit mesatar mujor të pranimeve të reja të depozitave, flet për rritje të nivelit të konkurrencës midis bankave në tregun e depozitave në lekë.

II. Investimet e bëra nga bankat në sistem kanë reflektuar një rënie të vazhdueshme të interesit mesatar të ponderuar për sistemin bankar. Nga tabela 7, evidentohet se ky nivel kalon në vlera njëshifrore gjatë tremujorit të parë të vitit 2001.

Tabelë 7. Interesi mesatar i ponderuar për investimet në lekë (në përqindje).

	Viti 1999	Viti 2000	3m I '01
Int.mes. pond. invest. lekë	18.90	12.70	9.36

Ndër faktorët që kanë ndikuar në këtë rënie janë struktura e investimeve dhe niveli i normës së kthimit të investimeve në lekë. Nga analiza e tyre do të nxjerrim edhe faktorin që ka patur efektin më të ndjeshëm në këtë rënie.

1. Strukturën e investimeve nga ana e bankave sipas rrezikut do ta vlerësonim si më poshtë:

Tabelë 8. Investimet e reja në lekë (në milionë lekë).

	Viti 1999	Viti 2000	3m I '01
Kredi në lekë	410.30	263.21	219.27
Bono thesari	10,861.31	17,232.32	16,193.23
Investime	11,271.61	17,495.53	16,412.51

Të dhënat janë mesatare mujore.

Struktura e investimeve sipas rrezikut ka ndryshuar në drejtim të rritjes së investimeve në bono thesari të qeverisë kundrejt nivelit të kredive të reja. Kredia e re e dhënë në lekë, mesatarisht çdo muaj, zë peshë të vogël në krahasim me investimet e kryera në tregun primar të bonove të thesarit. E njëjta tendencë ruhet edhe gjatë periudhës janar – mars 2001. Rrjedhimisht edhe efekti i portofolit të kredive në lekë në nivelin mesatar të ponderuar të investimeve në lekë është dukshëm i vogël.

Ashtu si edhe në periudhat e mëparshme kreditimi i ekonomisë në lekë për këto periudha vazhdon të bëhet nga Banka FEFAD, Banka Tirana, Banka Ndërkombëtare Malajziane, Banka Alfa Kredit. Peshën kryesore e zënë Banka FEFAD dhe Banka Tirana. Tendenca kryesore në dhënien e kredive është kryesisht në kredi nga 6 muaj deri në 1 vit dhe ato nga 1- 3 vjet.

Ndërsa Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka e Kursimeve vazhdojnë të investojnë vetëm në tregun primar të bonove të thesarit. Moskreditimi i ekonomisë nga banka më e madhe në vend, e cila zotëron mbi 80 për qind të likuiditeteve në lekë të sistemit bankar, ka bërë që, nga ana e tyre, investimi në bono thesari të vazhdojë të vlerësohet si rruga e mundshme për të mbuluar koston e shpenzimeve për interesat dhe aktiveve pa interes.

Ky fakt si dhe rritja e pjesëmarrjes në tregun primar nga bankat e tjera të sistemit për blerje bonosh thesari, tregon se investimet në bono thesari të tregut primar, vazhdojnë të zënë peshën kryesore të investimeve të bankave në monedhën vendase. Investimet në tregun primar të bonove të thesarit zënë

mesatarisht rreth 36.0-40.0 për qind të totalit të pranimeve të reja të depozitave. Bankat e vlerësojnë investimin në bono thesari si rrugën më të lehtë për të mbuluar koston e interesave për depozitat.

2. NDIKIMI I NIVELIT TË INTERESAVE PËR KREDITË NË LEKË DHE *YIELD*-I I BONOVE TË THESARIT

Interesi mesatar i ponderuar për kreditë në lekë, gjatë vitit 2000, ka vazhduar të qëndrojë në nivele të larta. Në pjesën e parë të vitit, niveli i tyre mbeti pothuajse i pandryshuar. Vetëm në pjesën e dytë të vitit 2000, tendenca e tyre ka qenë në rënie nga një muaj në tjetrin. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2001, niveli mesatar i kredive u ul ndjeshëm. Sipas strukturës rënia më e madhe është në nivelin e interesit për kredinë me afat nga 6 muaj deri në 1 vit dhe në kredinë me afat mbi 3 vjet.

Tabelë 9. Interesi mesatar i kredive në lekë sipas afatit (për qind).

	Dhjetor '00	Janar '01	Shkurt '01	Mars '01
Deri në 6 muaj	21.19	23.58	18.92	20.92
6 muaj deri në 1 vit	23.70	15.11	19.61	16.10
1 deri ne 3 vjet	23.70	22.90	20.71	22.19
Mbi 3 vjet	27.00	15.09	16.30	15.58
Interesi mesatar i ponderuar për sistemin	23.54	16.63	20.00	17.61

Rëniet e vazhdueshme dhe graduale të interesave të tjerë të tregut, si *yield*-it të bonove të thesarit, interesit të depozitave u shoqëruan edhe nga rënia e nivelit të interesave të kredisë për ekonominë. Këta interesa qenë të fundit që njohën ulje në treg, pas mbetjes pothuajse në të njëjtat nivele për një periudhë të gjatë kohe.

Ky fakt, si dhe rritja e nivelit të pranimeve për depozitat në lekë në bankat me kapital privat dhe të përbashkët, përbëjnë premisa pozitive që në të ardhmen, këto banka do të mbështesin ekonominë me kredi në lekë në nivele më të mëdha se sa aktualisht.

Por, duke qenë se pesha e kredive të reja në lekë është e vogël në krahasim me investimet në bono thesari të tregut primar, masa e ndikimit të nivelit të interesit për kreditë në interesin mesatar të ponderuar për investimet është e vogël. Kështu, tendencën kryesore të interesit mesatar për investimet, e përcakton *yield*-i i bonove të thesarit.

*Yield*i i bonove të thesarit ka ardhur gradualisht duke rënë. Në nivel mesatar për të tre maturitetet, ai është reduktuar sipas shifrave që paraqiten në tabelën 10. Gjatë vitit 2000, reduktimi ka qenë më i ndjeshëm në bonot me maturim tremujor. Ndërsa, për tremujorin e parë të vitit 2001, reduktimi është më i ndjeshëm në bonot e thesarit me maturim gjashtëmujor dhe dymbëdhjetëmujor.

Tabelë 10. *Yield*-i mesatar i bonove të thesarit dhe ndryshimi (në përqindje).

	Qershor '00 (1)	Ndryshimi (1-12.99)	Dhjetor '00 (2)	Ndryshimi (2-1)	Mars (3)	Ndryshimi (3-2)
Bth 12-mujore	14.00	-1.65	12.33	-1.67	11.14	-1.19
Bth 6-mujore	13.06	-2.11	11.34	-1.72	10.14	-1.20
Bth 3-mujore	10.73	-4.15	7.83	-2.90	7.57	-0.26

Grafik 3. Diferenca midis *yield*-it të bonove të thesarit dhe interesit të depozitave sipas maturitetit.



Reduktimi i nivelit të *yield*-it të bonove të thesarit në tregun primar të letrave me vlerë, ka dhënë ndikimin kryesor në rënien e nivelit të interesit mesatar të ponderuar për investimet në lekë.

Për herë të parë gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2000, u bë pagimi i interesave për shumat e rezervave të detyrueshme që mbahen në Bankën e Shqipërisë, duke filluar nga muaji gusht 2000, me një të tretën e normave të interesit të tregut dhe më vonë në dhjetor, me një të dytën e këtyre normave. Duke remuneruar rezervën e detyrueshme sipas normave të tregut, Banka e Shqipërisë pati si qëllim të ndikonte në uljen e çmimit të investimeve, duke ulur koston e ndërmjetësimit të sistemit bankar.

Konkretisht, për periudhën para remunerimit të rezervës së detyrueshme, kostoja e rezervës së detyrueshme në lekë, në madhësinë e diferencës midis interesit të depozitave në lekë dhe investimeve në lekë, u luhat në vlerat 1.99 – 2.96 për qind.

Pas remunerimit të rezervave të detyrueshme në masën 1/3 e *yield*-it të bonove të thesarit tremujore, në ankandin më të fundit, kostoja e rezervës, në madhësinë e diferencës midis interesit të depozitave në lekë dhe investimeve në lekë, u ul në nivele nën 1.0 për qind. Konkretisht, 0.44 për qind, 0.64 për qind dhe 0.86 për qind përkatësisht në shtator, tetor dhe nëntor 2000. Rritja e përqindjes së remunerimit në dhjetor 2000 nga 1/3 në 1/2 e *yield*-it të bonove tremujore, edhe pse tendenca e *yield*-it të bonove tremujore qe në rënie, ndikoi në uljen e elementit taksativ të rezervës së detyrueshme. Pas këtij ndryshimi, kostoja e rezervës së detyrueshme në madhësinë e diferencës midis interesit të depozitave në lekë dhe investimeve në lekë, vazhdoi të ulet, duke arritur vlera minimale për periudhën dhjetor 2000 – mars 2001 (0.86 për qind).

Remunerimi i rezervës së detyrueshme solli efekte pozitive në lehtësimin e kostos së bankave, duke ulur pjesën e painvestuar. Por, shkalla e transmetimit të këtij efekti në treg, nga ana e bankave tregtare, qe e ndryshme në çmimet e investimeve në treg, si bono thesari dhe kredi. Përsa i përket kredive, çmimi i tyre edhe pas reduktimeve, vazhdon të qëndrojë në nivele ende të larta. Diferenca që ruhet midis nivelit të interesave të kredive dhe depozitave në lekë është gati 2 herë, duke mos qenë shumë nxitës, për zhvillimin e tregut të kredive.

Në ndryshim nga kreditë, *yield*-i i bonove të thesarit ra gradualisht, duke ruajtur diferenca të ngushta me depozitat. Por, fakti që Banka e Kursimeve është ofruesja kryesore e këtij tregu, sjell që çmimi i përcaktuar nga kërkesa dhe oferta të jetë i deformuar dhe deri-diku, i diktuar nga pozicioni dominues në treg i Bankës së Kursimeve.

Për bankat me kapital joshtetëror kostoja e ndërmjetësimit, e vlerësuar sipas diferencës, për vitin 2000 dhe tremujorin e parë të vitit 2001, është ulur ndjeshëm krahasuar me vitin 1999. Edhe për periudhën janar – mars 2001, niveli i saj ruan të njëjtën tendencë. Reduktimi ka qenë më i ndjeshëm në interesin e investimeve të reja krahasuar me pranimet e reja të depozitave. Pavarësisht nga kjo, ky nivel qëndron më lart se sa kjo diferencë për sistemin.

Tabelë 12. Diferenca për bankat me kapital joshtetëror.

Në për qind	Mes. vjetore 1999	Mes. vjetore 2000	Ndryshim 2000-1999	3ml 2001
Int.mes. depo. (1)	7.20	6.06	-1.14	4.39
Int.mes. inves.(2)	20.41	14.18	-6.23	11.49
Diferenca (2-1)	13.21	8.12	-2.74	7.10

VLERËSIMI I KOSTOS SIPAS REZULTATIT FINANCIAR TË BANKAVE DHE TË SISTEMIT BANKAR

Sipas kësaj metode[1], duke u nisur nga rezultati financiar i bankave, për vitin 2000 sistemi bankar paraqet tregues më të mirë se viti 1999 për marxhinalin bruto dhe neto. Po kështu, edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2001 shifrat e ndryshimit të këtyre treguesve janë pozitive dhe në nivele të mira. Nga paraqitja grafike duket që, të gjithë muajt e vitit 2000, dhe të tremujorit të parë të vitit 2001 ndryshimin si për marxhinalin bruto edhe atë neto, e kanë pozitiv.

Tabelë 13. Ndryshimi i treguesve të rezultatit financiar (në milionë lekë).

	Viti 1999	Viti 2000	3ml 2001
Interesi marxhinal	432.85	735.90	738.6
Marxhinali bruto	517.80	1,455.78	1375.1
Marxhinali neto	263.25	1,123.71	1024.2

Fakti që ndryshimi mujor i interesit marxhinal ka ardhur duke u rritur nga një vit në tjetrin tregon se në sistemin bankar ka patur një tendencë në drejtim të rritjes së arkëtimeve për interesat, në krahasim me shpenzimet për to.

Grafik 4. Ndryshimi i marxhinalit bruto dhe neto të sistemit bankar.



Nga ana tjetër, edhe të ardhurat nga veprimtari të tjera, me ndonjë përjashtim, janë rritur duke sjellë rritje të ndryshimit mesatar mujor të marxhinalit bruto nga një vit në tjetrin. Pas zbritjes së shpenzimeve të veprimtarisë, ndryshimi i marxhinalit neto në sistem qëndron në nivele mesatare mujore pozitive. Rritja në ndryshimin mujor të tyre nga një periudhë në tjetrën ka ardhur si nga rritja e interesave të arkëtuar, ashtu edhe nga të ardhura të tjera, ndërkohë që shpenzimet e veprimtarisë së bankave tregtare nuk kanë patur ndryshime të ndjeshme gjatë vitit.

Tendencat e vërejtura për këta tregues gjatë vitit 2000, kanë vazhduar të ruhen edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2001.

Llogaritja e këtyre treguesve për banka të veçanta të sistemit, tregon përmirësime të këtyre treguesve për vitin 2000 dhe në vazhdim. Në Bankën e Kursimeve llogaritjet paraqesin qëndrimin në terma pozitivë të ndryshimit mujor të treguesve të marxhinalit bruto dhe neto në çdo muaj. Për bankat me kapital privat dhe të përbashkët lëvizjet mujore të marxhinalit bruto janë

përgjithësisht pozitive për vitin 2000 dhe në vazhdim. Tregues të mirë të rezultatit financiar kanë kryesisht Banka Tirana, Banka Alfa Kredit, Banka FEFAD, Banka Amerikane Shqiptare. Lëvizjet e marxhinalit neto janë pozitive në bankat e sipërpërmendura.

Nga sa u trajtua më sipër veçojmë se, gjatë vitit 2000 dhe tremujorit të parë të vitit 2001:

- sistemi bankar ka arritur nivelin më të ulët të diferencës:
  - duke kaluar në nivel njëshifror,
  - duke ruajtur tendencën në rënie,
  - duke patur luhatje të vogla dhe shumë të zbutura ndaj vijës së tendencës;
- reduktimi i interesit mesatar të ponderuar për investimet (bono thesari) është më i lartë se sa reduktimi i interesit mesatar të ponderuar për pranimet e reja të depozitave në lekë;
- në periudhën janar - mars 2001, niveli i interesit mesatar të ponderuar për investimet kalon në nivel njëshifror, duke arritur për herë të parë nivelin më të ulët në sistem 8.33 për qind;
- investimet për ekonominë në lekë, vazhdojnë të zënë një peshë të vogël ndaj totalit të investimeve;
- edhe pse me ndikim shumë të vogël, siç u theksua më lart, nuk mund të lëmë pa përmendur faktin që, niveli i interesit mesatar të ponderuar për kreditë e reja është reduktuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2001, në një nivel më të lartë krahasuar me periudhat e kaluara;
- në përgjithësi, të gjitha bankat në sistemin bankar me punën e tyre kanë synuar në drejtim të uljes së kostos së ndërmjetësimit, duke u përpjekur që të ruajnë diferenca në nivele më të ulta, krahasuar me periudhat e mëparshme;
- treguesit, sipas rezultatit financiar të veprimtarisë së bankave tregtare, tregojnë për përmirësime të punës së çdo banke në veçanti dhe të të gjithë sistemit në tërësi;
- në kushtet kur, niveli i *yield*-it të bonove të thesarit qëndron më lart se interesi i depozitave me afat në lekë, forma e investimit të likuiditeteve në lekë në bono thesari lehtëson punën e bankave në drejtim të përballimit të kostos së

depozitave në lekë, por, nga ana tjetër, nuk përbën nxitje që bankat të bëjnë investime afatgjata në ekonomi duke marrë përsipër rrezikun.

Viti 2000 konsiderohet si faza fillestare e mbështetjes së politikës monetare në instrumente indirekte dhe, në përgjithësi, vlerësohet se politika monetare e Bankës së Shqipërisë është arritur të përçohet në sistemin bankar.

Gjatë vitit 2001, Banka e Shqipërisë do t'i shtrijë operacionet në tregun e parasë në një diapazon më të gjerë, duke synuar rritjen e efektivitetit të përdorimit të këtyre instrumenteve për të garantuar realizimin e objektivit të saj kryesor. Ndërhyrja në treg përmes operacioneve të tregut të hapur dhe nxitja e tregut ndërbankar, do të ndikojnë në rritjen e elasticitetit të instrumenteve të politikës monetare. Përmes këtyre zhvillimeve do të sigurohet stabilizimi i normave afatshkurtra të interesit dhe niveli i likuiditeteve në sistemin bankar, si dhe do të rritet në një nivel më të lartë konkurrenca në sistemin bankar.

Nga ana tjetër, ekonomia ka premisa të kreditohet më shumë nga ana e sistemit bankar. Një faktor me rëndësi do të jetë ulja e parashikuar e nivelit të financimit të deficitit buxhetor nga ana e sistemit bankar, e cila do të krijojë hapësira më të mëdha për rritjen e financimit të ekonomisë. Në programin monetar të Bankës së Shqipërisë është parashikuar një rritje e stokut të kredisë për ekonominë gjatë vitit 2001, prej 8.1 miliardë lekësh, që përbën 29.6 për qind të stokut ekzistues të saj.

---

* Suzana Sheqeri, specialiste, Departamenti i Politikës Monetare.

[1] Të dhënat janë marrë nga Departamenti i Mbikëqyrjes, nga pasqyra mujore e të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati financiar përfshin veprimtarinë në lekë dhe në valutë.

PAS SULMIT TERRORIST, ÇFARË E PRET EKONOMINË…?

*Fatos Ibrahimi**

Fjalë kyçe
- Terrorizëm - 11 shtatori - Ekonomia amerikane - Recesion -

Është ende shpejt për të bërë parashikime të sakta lidhur me ndikimet që do të ketë në ekonominë amerikane dhe atë globale ngjarja më e rëndë që i ka ndodhur SHBA që nga koha e Luftës së Dytë Botërore, kur u godit baza ushtarako-detare e Perl Harbour-it në Oqeanin Paqësor. Kjo për faktin se, pas reagimit të parë, nuk dihet se për sa kohë do të vazhdojnë të reagojnë tregjet financiare, konsumatori, bizneset dhe më e rëndësishmja, me çfarë intensiteti do t'i përgjigjen SHBA këtij akti terrorist (i cili, sipas deklaratës së Presidentit Bush, është konsideruar i barabartë me shpalljen e luftës kundër SHBA.) dhe të gjitha shtetet e tjera, që janë bashkuar dhe kanë mbështetur Shtetin Amerikan në luftën kundër terrorizmit.

Kjo luftë e cila tashmë ka filluar, sipas deklaratave të ndryshme do të jetë e gjatë, e vështirë dhe jo sipas skenarëve tradicionalë të luftërave të zhvilluara deri sot.

Vështirësia e parashikimit qëndron edhe në faktin se rasti është i paprecedent dhe jashtë çdo parashikimi, për pasojat që solli në humbjen e jetëve njerëzore. Por, komentet dhe analizat nuk kanë munguar. Ato janë të shumta dhe bëhen nga institucione prestigjioze, institute kërkimore, universitete, banka qendrore etj. dhe, pavarësisht nga pikëpyetjet e shumta që shtrohen

për të ardhmen lidhur me rrjedhat që do të ndjekë ekonomia amerikane dhe ajo botërore, për të bërë një parashikim, duhet të merren në konsideratë disa faktorë:

Së pari: cila ishte gjendja e ekonomisë amerikane dhe e asaj botërore në prag të sulmit terrorist kundër dy simboleve të kapitalizmit amerikan: simbolit ekonomik, Qendrës Botërore të Tregtisë dhe simbolit ushtarak: Godinës së Pentagonit?

Së dyti: cili është reagimi i menjëhershëm i tregjeve financiare pas ngjarjes, përkatësisht:

- tregut të kapitaleve;
- tregut të parasë;
- tregut të këmbimeve valutore;
- tregut të punës;
- si dhe reagimi i konsumatorit dhe i bizneseve.

Dhe së treti: cili do të jetë intensiteti, kohëzgjatja dhe përmasat që do të marrë konflikti, që tashmë ka filluar midis SHBA dhe të gjitha shteteve të tjera që e mbështetin dhe terrorizmit ndërkombëtar simbol i të cilit sot është bërë Bin Laden.

Por, përpara se t'u japim përgjigje pyetjeve që shtruam më sipër, është e nevojshme të mbahen parasysh tri gjëra:

a. Që nga momenti i sulmit terrorist, parashikimet ekonomike për të ardhmen do të kenë shumë vështirësi pasi është rritur shumë pasiguria, paqëndrueshmëria; konsumatori ka pësuar një *shock* psikologjik, i cili patjetër do të reflektohet në parashikimet për të ardhmen, gjë që e bën atë më të vështirë se në kushte normale. Duke marrë parasysh që në Qendrën Botërore të Tregtisë zhvillonin aktivitetin e tyre mjaft shoqëri financiare, analistë të tregjeve, shoqëri dealerash dhe brokeresh, një pjesë e të cilëve nuk jetojnë më dhe një pjesë e të cilëve e kanë përjetuar terrorin e asaj ngjarjeje të tmerrshme, i jep procesit të vlerësimit edhe një dimension personal.
b. Është e rëndësishme të ndahen dhe të dallohen pasojat

afatshkurtra dhe pasojat afatgjata të kësaj ngjarjeje. Pasojat e menjëhershme dihet që ishin negative nga ana e konsumatorit, tregjeve dhe bizneseve, por duhet të priten pasojat afatmesme, të cilat mund të shërbejnë si bazë më e mirë edhe për parashikimet në të ardhmen.

c. Edhe sipas prononcimit të disa personaliteteve botërore në fushën e financës si Drejtori i FMN-së Kohler, Greenspan etj., në periudha afatgjata ndikimet do të jenë relativisht më të vogla.

Pra, në parashikimet afatgjata do të ndikojnë faktorë më themelorë, që përcaktojnë zhvillimin ekonomik si produktiviteti, pozicionet fiskale të një vendi, gjendja e bilancit të pagesave që reflekton edhe llogarinë korente edhe llogarinë e kapitalit, inflacioni, regjimet valutore etj..

Duhet thënë se ekonomia amerikane kishte dhënë shenjat e një rënieje të ritmeve të rritjes ekonomike, duke filluar që nga fundi i vitit të kaluar prandaj edhe u reagua nëpërmjet lehtësimit të politikës monetare, nëpërmjet uljes së vazhdueshme të normave të interesit (*fed fund rates*), prej 6 për qind deri në 3 për qind, që është aktualisht. Pas një lulëzimi gati 10 - vjeçar me rritje ekonomike të fortë, inflacion të ulët, një monedhë stabël dhe në rritje, çka reflektonte produktivitetin e ekonomisë më të madhe në botë, si dhe një normë papunësie në kufijtë natyrorë të saj shumë më poshtë se pjesët e tjera të botës, ekonomia amerikane filloi të japë shenjat e hyrjes në një cikël tkurrjeje të biznesit të përgjithshëm.

Parashikimet në fund të gjashtëmujorit të parë, nuk ishin optimiste për ekonominë botërore. Treguesit flisnin qartë për një ngadalësim të rritjes ekonomike në SHBA, Japoni, si dhe në ekonominë evropiane.

Parashikimet e fundit para sulmit terrorist bënin fjalë për një rritje ekonomike të PBB-së në SHBA jo më shumë se 1,5 për qind, për rënie të prodhimit industrial në nivelin 4,8 për qind si dhe rënie të prodhimit në teknologjitë e larta 7,2 për qind, në krahasim me një vit më parë.

Por, ndërsa gjatë vitit kishim rënie të prodhimit industrial, të aktivitetit të biznesit dhe të treguesit të investimit të bizneseve, ishin shpenzimet e konsumatorit një tregues shumë i afërt me treguesin e besimit të konsumatorit, që e mbanin ekonominë amerikane akoma pezull për ta shmangur nga recesioni. Por, sondazhi i publikuar nga Universiteti i Miçiganit, në datën 13 shtator dhe që përfshinte periudhën deri në datë 10 shtator, një ditë para sulmit, tregonte për një rënie drastike të besimit të konsumatorit. Duke u nisur nga fakti që shpenzimet e konsumit përbëjnë dhe shtyllën kurrizore të ekonomisë amerikane, duke kapur rreth 2/3 e PBB-së, mund të imagjinohet edhe ndikimi negativ që do të ketë ky tregues në rritjen ekonomike. Por, pavarësisht nga këta tregues, prej shumë ekonomistëve mendohej, se SHBA kishte mundësi ta shmangte një recesion, nëpërmjet mbështetjes së politikave monetare dhe buxhetore lehtësuese.

Në një gjendje më të vështirë ndodhej ekonomia japoneze, e cila jepte shenjat e dukshme të një recesioni së bashku me Singaporin dhe Tajvanin. Problemet e ekonomisë japoneze, sipas mendimit të shumë ekspertëve, janë më të mprehta se sa ato të ekonomisë amerikane, nëse abstragojmë nga ngjarja e fundit. Ekonomia japoneze, e cila shënonte rënien e katërt gjatë një periudhe 10-vjeçare, ballafaqohet me nevojën e disa reformave strukturore, të cilat prekin sidomos sistemin bankar, politikën monetare dhe atë buxhetore. Gjendja e kredive të këqija në sistemin bankar vazhdon të jetë problematike.

Rregullimet në aktivitetin ekonomik janë bërë më të vështira, duke patur parasysh rënien ekonomike, rënien e eksporteve, që përbëjnë një komponent mjaft të fuqishëm për ekonominë japoneze dhe ndikimin negativ që pasqyrohet në nivelin e punësimit dhe në nivelin e të ardhurave, të cilat, nga ana e tyre, ndikojnë në nivelin e kërkesës agregate.

Kjo kërkesë pasqyron jo vetëm rënien ekonomike brenda vendit, por edhe rënien e kërkesës për prodhime të teknologjisë së lartë nga SHBA, që është edhe importuesi kryesor i këtyre mallrave. Rënia e kërkesës për eksportet japoneze e shoqëruar

edhe me tendencat e mbiçmimit të jenit japonez, tregojnë që ekonomia japoneze do të përballet me mjaft probleme deri sa të dalë nga cikli i rënies ekonomike.

Situata, edhe pse jo në të njëjtat nivele, nuk paraqitej optimiste edhe në Evropë. Nuk parashikohej një rënie ekonomike drejt krizës, treguesit nuk po pasqyronin një dinamizëm dhe një potencial të kënaqshëm rritjeje. Parashikimi në muajin maj ishte që PBB të rritej jo më shumë se 2,4 për qind, ndërsa në shtator u ul në 1,8 për qind. Shenja jooptimiste paraqesin ekonomia gjermane dhe ajo franceze dhe si më të stabilizuara paraqiten ekonomia angleze dhe ajo italiane.

Menjëherë pas sulmit terrorist në New York dhe Washington dhe pas mbylljes disaditore të tregjeve kryesore të kapitalit në SHBA si NYSE, NASDAQ, AMEX etj., reagimi i menjëhershëm ishte një rënie e vlerës së aksioneve në të gjitha bursat amerikane, që u ndoq edhe nga bursat kryesore në Evropë dhe në Azi. Pësuan rënie të gjithë treguesit e bursave si DOW JONES, NASDAQ, S&P etj., të cilët ranë mesatarisht 10-12 për qind.

Duhet thënë, se rënia nuk ishte aq dramatike sa ç'pritej, duke patur parasysh që në vitin 1987, rënia e Dow Jones ishte 22 për qind dhe pas një dite, pothuajse të gjitha bursat filluan të shënojnë rritje. Po kështu, në ditët në vazhdim është vënë re një luhatje, por brenda marzheve normale. Siç duket, tregjet janë në pritje të aksioneve që do të zhvillohen në të ardhmen, si nga pikëpamja politike dhe ushtarake, ashtu edhe nga veprimet e mëtejshme dhe masat që do të merren në fushën e politikës monetare dhe fiskale. Edhe ulja e normave të interesit konsiderohet indirekt si një mbështetje për tregjet e aksioneve duke qenë në rradhë të parë, mbështetje për biznesin.

Për stimulimin e ekonomisë amerikane po veprohet jo vetëm nëpërmjet komponentit monetar, por edhe nëpërmjet nxitësve fiskalë, duke mbajtur parasysh faktin që buxheti federal amerikan është parashikuar me një suficit përafërsisht për 175 miliardë dollarë amerikanë.

Si hap i parë ishte miratimi nga Kongresi Amerikan i propozimit të Presidentit Bush për një mbështetje të shpenzimeve ushtarake me anë të një pakete prej 40 miliardë dollarësh amerikanë dhe të një pakete të re prej 75 miliardë dollarësh amerikanë, që pritet të miratohet dhe që do të mbështesë ato degë të ekonomisë, të cilat kanë qenë më të goditura nga pasojat e sulmit terrorist të 11 shtatorit. Lehtësimi i politikës fiskale mund të bëhet jo vetëm duke operuar në krahun e shpenzimeve, por edhe në krahun e të ardhurave, nëpërmjet një uljeje të mëtejshme të taksave, premtim i bërë nga Presidenti Bush edhe gjatë fushatës së tij elektorale. Si rezultat i këtyre veprimeve, sipas disa analistëve, mundet që buxheti amerikan të rezultojë me deficit për vitin 2002 , prandaj sugjerojnë që të bëhet kujdes me komponentin fiskal, për të mos patur pasoja negative afatgjata.

Në mënyrë të menjëhershme reaguan edhe tregjet monetare. Rezerva Federale qëndroi e hapur edhe gjatë ditës së sulmit, duke njoftuar se ishte e gatshme të ofronte likuiditete për të shmangur çdo panik të mundshëm në sistemin bankar.

Më pas, u operua me dy ulje të mëtejshme të normës së interesit, duke arritur nivelin më të ulët që prej 40 vjetësh në 2,5 për qind. Ky lehtësim i politikës monetare ishte për të nëntën herë rradhazi që nga fillimi i këtij viti dhe përbën një politikë monetare mjaft agresive. Para sulmit terrorist, shumë ekonomistë ishin optimistë dhe besonin se nëpërmjet lehtësimit të politikës monetare, SHBA mund ta kapërcente fazën e tkurrjes ekonomike, pa rënë në recesion.

Por, pas këtij sulmi, shpresat dhe optimizmi kanë rënë së tepërmi dhe recesioni pothuajse është bërë i pashmangshëm Në të njëjtën mënyrë, vepruan edhe bankat e tjera qendrore si BQE, Banka e Kanadasë, Banka e Zvicrës etj.. BQE, ndonëse më "e ngurtë" se FED-i në lidhje me normat e interesit, i hapi rrugë politikës ekspansioniste duke bërë tre ulje që nga muaji maj i këtij viti (nga 4,75 në 3,75 për qind).

Pritet që të ketë edhe reagime të tjera në të ardhmen, në drejtim të lehtësimit të politikës monetare dhe, sipas parashikimeve

vetëm nga pranvera e vitit tjetër pas daljes nga faza e tkurrjes, mendohet që politika monetare të ndryshojë kahun e vet në SHBA.

Reagimi i tregjeve të këmbimeve valutore ishte i menjëhershëm pas datës 11 shtator. Në të gjitha tregjet pati një nënçmim të dollarit, si në raport me euron që arriti në kufijtë 0,94 usd dhe këto ditë është luhatur në kufijtë 0.91-0.92, ashtu edhe me jenin japonez që u kuotua në kufijtë 116-117 jen për dollar amerikan. Por, pati një koordinim të menjëhershëm të bankave qendrore dhe një gatishmëri për të blerë dollarin amerikan si dhe operacione konkrete në Evropë dhe në Japoni, ku u blenë sasi të konsiderueshme dollarësh, si nga ana e BQJ ashtu edhe nga Ministria e Financës e Japonisë.

Autoritetet japoneze janë të shqetësuara, pasi një dobësim i dollarit do ta theksojë më tej tendencën e dobësimit të eksporteve japoneze, çka do ta dobësonte më tej kërkesën në këtë vend që paraqitet dhe problemi kryesor për daljen e ekonomisë japoneze nga kriza. Prandaj, gjykohet që Japonia do të vazhdojë lehtësimin e politikave fiskale dhe monetare, edhe pse normat e interesit janë shumë pak mbi zero për të mbështetur një dobësim të jenit japonez. Një forcim i mëtejshëm i dollarit do të ndikonte në keqësimin e mëtejshëm të eksporteve japoneze, por edhe të eksporteve evropiane.

Reagim të menjëhershëm pati edhe tregu i punës. Kompanitë më të goditura nga kjo ngjarje ishin kompanitë e udhëtimeve ajrore dhe ato të prodhimit të avionëve. Humbjet ditore të kompanive të udhëtimeve ajrore shënojnë miliona dollarë çka, i ka detyruar ato të njoftojnë për shkurtime masive, të cilat deri tani, mendohet se kapin shifrën e 100 mijë vetëve. Kanë bërë njoftime për shkurtime, kompani mjaft të njohura si Boeing, Britishair.

Por, ai që reagoi menjëherë ndaj këtij akti terrorist ishte konsumatori. Sondazhi i fundit i Universitetit të Miçiganit, i publikuar në 24 shtator, tregonte një rënie të mëtejshme të besimit të konsumatorit, çka do të thotë një rënie e mëtejshme e kërkesës agregate dhe e perspektivës për nxjerrjen e ekonomisë

nga kjo situatë tkurrjeje e përgjithshme, në të cilën ajo ndodhet dhe duke patur parasysh që shpenzimet e konsumit përbëjnë afërsisht 65 për qind të produktit bruto në SHBA.

Në mbrëmjen e datës 7 tetor u njoftua që avionët amerikanë dhe ata britanikë filluan bombardimet kundër bazave ushtarake dhe qendrave të stërvitjes së terroristëve në Afganistan. Sigurisht që mënyra se si do të zhvillohen këto operacione ushtarake, kohëzgjatja e tyre, intensiteti dhe përmasat që do të marrin ato do të kenë ndikimet veta në rrjedhat e zhvillimit të ekonomisë amerikane dhe të asaj botërore. Këtu duhet mbajtur parasysh edhe ndikimi që do të ketë në çmimin e naftës, si lënda bazë që është e lidhur me operacionet ushtarake, por edhe ndikimet që ka çmimi i naftës në ekonominë botërore. Pas 11shtatorit pati një kërcim të menjëhershëm të çmimeve të naftës dhe më pas, takimi i vendeve të OPEK-ut dhe analiza e faktorëve të ndërsjelltë, e uli përsëri çmimin në kufijtë 23-24 dollarë për fuçi.

Pra, pavarësisht nga analiza që u munduam të bëjmë më lart, shumë ekonomistë e shikojnë me optimizëm perspektivën e ekonomisë botërore duke parashikuar që, dalja e ekonomisë amerikane, nëse ajo do të konstatohet, në tremujorët në vijim do të realizohet brenda vitit 2002. Sot mendohet që ekonomia botërore është më e përgatitur se një dekadë më parë për të përballuar situata krizash.

Si faktorë në mbështetje të këtij arsyetimi shërbejnë sidomos niveli i ulët i inflacionit në shkallë globale dhe politikat e shëndosha monetare dhe fiskale që zbatohen në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare. Pra, nga analiza e gjithë asaj që theksuam më sipër, ngjarja e 11 shtatorit do të ketë një ndikim në rrjedhat e ekonomisë botërore. Ajo mund të krahasohet me një grusht me rërë që është hedhur në ingranazhet e mekanizmit të ekonomisë botërore dhe ka ndodhur në momentin më të papërshtatshëm, për nivelin në të cilin ndodhej kjo ekonomi.

Sulmi terrorist i 11 shtatorit, duke patur një ndikim global, patjetër do të ketë ndikimet e veta edhe në vendin tonë, të cilat

duhet të analizohen me kujdes për të mbajtur parasysh dhe për të shmangur ndikimet negative.

Ekonomia shqiptare është një ekonomi e vogël dhe shkalla e komunikimit të saj me ekonominë botërore është relativisht e vogël. Kanali më i ndjeshëm i komunikimit të ekonomisë shqiptare me botën është tregu i këmbimeve valutore. Ky treg bëri reagimin e parë pas ngjarjes së 11 shtatorit. Pas rënies që pësoi dollari në krahasim me lekun në ditët e para pas këtij sulmi, deri në nivelin 141 lekë për 1 dollar (dhe që reflektonte reagimet e dollarit me euron dhe me monedhat e tjera), më pas stabilizimi i dollarit në tregun ndërkombëtar solli stabilizimin e tij edhe në tregun e brendshëm.

Për të parë ndikimet e mundshme të kësaj ngjarjeje në ekonominë shqiptare duhet studiuar bilanci i pagesave, si dokumenti bazë ku reflektohen këto ndikime. Kështu një frenim i përgjithshëm i kërkesës mund të kishte një ndikim negativ edhe në eksportet tona, të cilat llogariten në kufijtë 250-300 milionë dollarë.

Edhe pse mendohet që ky ndikim mund të jetë i vogël, përsëri nuk mund të neglizhohet, por duhet të mbahet në konsideratë edhe në turizëm, i cili është më i lidhur, jo vetëm me nivelin e përgjithshëm të infrastrukturës, por edhe me nivelin e sigurisë. Nuk dihet se sa gjatë do të vazhdojë kjo gjendje pasigurie. Në pjesën e llogarisë kapitale duhet të mbahet parasysh fakti që investimet për disa kohë mund të qëndrojnë në një gjendje pritjeje, për të parë zhvillimet në të ardhmen. Disa investime mundet edhe të shtyhen në kohë kjo për shkak të përqendrimit të vëmendjes në një rajon tjetër të botës.

Industria bankare në Shqipëri mendohet që nuk do të preket nga kjo ngjarje për faktin se portofolet e letrave me vlerë të bankave shqiptare kapin një përqindje shumë të vogël, afërsisht 2-3 për qind, të totalit të aktivit të bankave dhe këto investime janë kryesisht në letra me vlerë të borxhit dhe jo të pronësisë, të cilat kanë shkallë më të lartë ndjeshmërie dhe ndikohen nga ngjarje të tilla. Në periudha afatmesme, në varësi me zhvillimet

e biznesit, nuk përjashtohen edhe ndikimet në rrezikun e kreditit.

Pra, gjykohet që nga pikëpamja makroekonomike zhvillimet në ekonominë shqiptare do të varen më tepër nga faktorë të brendshëm sesa nga zhvillimet ndërkombëtare.

Kështu, pavarësisht nga pamja optimiste lidhur me ndikimet e mundshme të kësaj ngjarjeje në ekonominë shqiptare, duhet mbajtur parasysh fakti që kudo në botë është rritur shumë pasiguria dhe paqëndrueshmëria. Kjo kërkon shkallë të lartë angazhimi e bashkërendimi midis të gjitha institucioneve përgjegjëse për të ndërhyrë me instrumentet përkatëse në rast nevoje si në fushën monetare edhe në atë fiskale.

Kjo ngjarje ka shtruar, për momentin, përpara të gjitha institucioneve përgjegjëse edhe nevojën e një bashkërendimi më të organizuar për zbatimin me rreptësi të kërkesave të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave", në mënyrë që t'i priten burimet financiare terrorizmit ndërkombëtar.

---

* Fatos Ibrahimi, Zëvendësguvernator i Parë i Bankës së Shqipërisë.

SHQIPËRIA DHE EURO

*Gramoz Kolasi**

Fjalë kyçe
- Euro - Eurozonë - Fushatë informimi - Fushatë sensibilizimi - Edukim i publikut -

Afrimi i fundvitit 2001, përkon me një ngjarje tejet të veçantë për botën e financave dhe të biznesit: me "daljen në dritë" të Euros si një para fizike. Në të vërtetë përmasat e këtij evenimenti janë realisht të mëdha, kur sjell ndërmend se formacionet ekonomike dhe shoqërore, që janë të lidhura dhe të interesuara për të, janë po aq të mëdha si për nga numri ashtu dhe për nga shtrirja gjeografike.

Njësimi monetar i Evropës së Bashkuar, i arritur që në fillimin e vitit 1999, duke filluar që nga një janari i vitit 2002, do të shënojë një zhvillim të ri, duke u bërë një realitet i dukshëm dhe i prekshëm nga kushdo. Duket se ka ardhur momenti i përshtatshëm për të filluar edukimin dhe familjarizimin e vetvetes me këtë fenomen të ri në pritje. Nuk kemi pse të çuditemi nga reduktimi i shportës së monedhave të huaja në vetëm dy – tre monedha kryesore ose më saktë nuk duhet të na zërë paniku kur në vend të fjalëve dojçmarka, lireta apo dhrahmi do të dëgjojmë një fjalë të vetme Euro.

Nga këndvështrimi i këtij artikulli dhe nga interesat praktikë të publikut të gjerë duket se nuk është shumë i rëndësishëm rikthimi mbrapa në histori. Megjithatë, qoftë dhe thjesht për kuriozitet, do të ishte me interes përmendja e dy – tre momenteve kryesore

që çuan në lindjen e monedhës së Evropës së Bashkuar, për t'i lënë vendin më tej sqarimit të shumë momenteve praktike që kanë të bëjnë me "look-un" e saj, me rëndësinë që ka kjo ngjarje për Shqipërinë, me masat që do të ndërmarrë Banka e Shqipërisë etj..

PAK HISTORI

Hapi i parë politik për krijimin e Evropës së Bashkuar përkon me Traktatin e Romës në vitin 1957, ku udhëheqësit e vendeve të Evropës ranë dakord për krijimin e Tregut të Përbashkët Evropian me qëllim kryesor rritjen e mirëqenies ekonomike dhe krijimin e një bashkimi shumë të ngushtë midis popujve të Evropës. Ndërkohë që, me kalimin e viteve shtohej bashkëpunimi dhe iniciativat e përbashkëta evropiane, sidomos në fushën politike, vendimet e mirëfillta që i paraprinë bashkimit ekonomik dhe monetar të BE-së, arrijnë diçka më vonë, fillimisht në vitin 1986 nëpërmjet Aktit Unik mbi Evropën (1986) dhe më vonë në vitin 1992, me anë të Traktatit të Bashkimit Evropian. Zhvillimi më i rëndësishëm përkon me 1 janarin e vitit 1999, kur filloi dhe e ashtuquajtura faza e tretë e bashkimit monetar. Më konkretisht, u vendos që politika monetare e vendeve të Zonës së Euros të ishte e përbashkët dhe që nga ai moment Euro u pranua si monedha e përbashkët në llogari. Konvertimi i monedhave pjesëmarrëse në Euro me njëra – tjetrën do të bëhej sipas raporteve të fiksuara dhe që nga ai moment, monedhat kombëtare të 11 vendeve pjesëmarrëse u bënë thjesht shprehje kombëtare.

Më 1 janar 2001 numri i vendeve të Eurozonës shtohet me një anëtar të ri që ishte Greqia, duke çuar numrin e vendeve anëtare në 12.

KARTËMONEDHAT E REJA. SI DO TË JENË ATO.

Ndoshta jo që nga data 1 janar 2002, por me siguri që në ditët në vijim çdokush do të ketë mundësinë që të zotërojë një bankënotë të quajtur Euro. E çfarë prerjeje mund të jetë ajo, cilat janë karakteristikat e përbashkëta dhe kush është

domethënia e simboleve dhe e figurave të stampuara në kartëmonedhë?

Këto janë pyetje të natyrshme që mund të lindin që në momentin e parë. Ky kuriozitet intuitiv bëhet akoma më i madh kur dihet që deri sot Euro është një monedhë në llogari dhe perceptimi i individëve për këtë formë të parasë është i vështirë për aq kohë sa ajo nuk preket dhe nuk mbahet në portofol.

Dizenjatorët e kartëmonedhave dhe të monedhave Euro, janë përpjekur të ruajnë një ekuilibër midis identitetit të çdo vendi anëtar me simbolikën e përdorur për të treguar bashkimin e tyre. E gjithë seria e monedhave[1] përbëhet nga 8 prerje të ndryshme: 1, 2, 5, 10, 20 dhe 50 cent si dhe 1 dhe 2 euro. Të tetë llojet e monedhave ndryshojnë në madhësi, në peshë, në trashësi dhe në materialin që i përbën ato.

Në dizenjimin e monedhave është rënë dakord që faqja e përparme të jetë e njëjtë për të gjitha vendet anëtare, ndërsa faqja e mbrapme të jetë kombëtare ose e thënë ndryshe të pasqyrojë simbolikat kombëtare[2] të çdo vendi anëtar. Pavarësisht faktit se faqja e mbrapme do të ndryshojë nga njëri vend në tjetrin, të gjitha monedhat do të jenë mjete zyrtare pagese në të gjitha shtetet anëtare të BE-së.

Ndryshe nga monedhat, prerjet e kartëmonedhave do të kenë të njëjtin "*look*" në të gjitha shtetet anëtare. E gjithë seria e tyre përbëhet nga 7 prerje: 5, 10, 20, 50, 100, 200 dhe 500 euro. Kartëmonedhat Euro janë dizenjuar nga artisti austriak Robert Kalina, i cili është frymëzuar nga tema "Epokat dhe Stilet Evropiane". Janë zgjedhur stile arkitektonike tipike të shtatë periudhave të historisë dhe të kulturës evropiane: arti klasik për prerjen 5 euro; arti romantik për prerjen 10 euro; arti gotik për prerjen 20 euro; arti i rilindjes për prerjen 50 euro; baroku dhe rokoko për prerjen 100 euro; arkitektura e hekurit dhe e qelqit për prerjen 200 euro dhe arkitektura e shekullit 20 për prerjen 500 euro. Elementet arkitektonike reflektojnë stilin tipik të çdo epoke dhe nuk përfaqësojnë monumente reale.

Në elementet e përbashkëta, që janë vendosur në çdo prerje, veçojmë flamurin evropian, 12 yjet e BE-së, pesë shkurtimet[3] për Bankën Qendrore Evropiane, si dhe shkrimi në latinisht dhe greqisht i fjalës EURO. Përveç simboleve të njohura të BE-së, në serinë e kartëmonedhave gjejnë pasqyrim dhe elemente të tjera me simbolika të caktuara si prania e një ure në faqen e prapme, e cila nënkupton bashkëpunimin midis vetë popujve të Evropës dhe më gjerë, prania e portave në faqen e përparme, që simbolizon shpirtin evropian të hapur dhe të gatshëm për bashkëpunim etj..

Në përfundim, duhet thënë se madhësia dhe ngjyrat e çdo prerjeje janë të ndryshme për të lehtësuar identifikimin e tyre. Sa më e madhe të jetë vlefta e biletës që zotëron aq më e madhe është edhe ajo vetë. Nga ana tjetër, janë marrë masat për t'i ardhur në ndihmë edhe personave të verbër, për të cilët janë vendosur shenja dalluese të veçanta.

Për të shuar më tej kuriozitetin është vendosur që në datën 1 janar 2002, të jenë në dispozicion 14545 milionë kartëmonedha, të cilat do të jenë të shpërndara sipas shteteve dhe prerjeve.

Kurioziteti i mëtejshëm në lidhje më monedhën e përbashkët mund të vazhdojë të shuhet me detaje më të hollësishme, që kanë të bëjnë me elementet e sigurisë, me teknikat e printimit etj.. Megjithatë, edhe për shpjegime më të detajuara është menduar, por duhet thënë se momentalisht individët, agjentët ekonomikë në përgjithësi janë më shumë të interesuar për atë se si do të ngjajnë ato dhe çfarë masash po merren nga autoritetet në Shqipëri, në mënyrë që lançimi i monedhës së re të përjetohet sa më natyrshëm.

EURO DHE EKONOMIA SHQIPTARE

Tashmë nuk përbën ndonjë të re fakti, që pjesa më e madhe tregtisë së jashtme zhvillohet me vendet e Eurozonës, ashtu sikurse dhe pjesa më e madhe e ndihmave financiare dhe e kredive, që i janë akorduar Shqipërisë nga BE-ja, janë në Euro. Po kështu dhe të hyrat valutore nga emigracioni, për aq kohë sa dërguesit e tyre, në pjesën më të madhe janë të vendosur në

Greqi, Itali dhe Gjermani, janë të shprehura në Euro. Në këtë kuptim, megjithë "një simpati" të shqiptarëve ndaj monedhës amerikane, siç vihet re, një pjesë e mirë e hyrjeve valutore është e shprehur në Euro.

Në këtë mënyrë, ekonomia e vendit tonë është e përballur me një lloj rreziku, që ka të bëjë me ecurinë e këmbimit të monedhës evropiane me monedhat e tjera të huaja ashtu sikurse dhe me vetë Lekun Shqiptar. Një ulje e vlerës së monedhës evropiane në raport me Lekun do të bënte që, për një njësi import malli, tregtari shqiptar të paguajë më pak lekë, e për rrjedhim edhe presioni i çmimeve të importit mbi zhvillimet e brendshme do të ishte më i zbutur.

Anasjelltas, në qoftë se tregtarit shqiptar do t'i duhej që për një njësi Euroje të paguajë më shumë se një ditë më parë kuptohet, që ai do të korrigjojë të gjitha çmimet e shitjes në lekë, me tendencën për t'i rritur ato.

Përveç implikimeve makro, lançimi i Euros mund të shoqërohet dhe me forma të ndryshme paniku. Një pjesë e mirë e pasurisë së shqiptarëve në formën e likuiditetit (në llogari bankare apo në shtëpi) mbahet në Euro. Megjithëse dollari amerikan vlerësohet të jetë i preferuar për thesarizimin e pasurisë, përsëri ekziston dhe alternativa tjetër, ajo e ruajtjes së tyre në nënfisha[4] të Euros. Nga ana tjetër, për shkak të ekzistencës së ekonomisë joformale, mund të shfaqet rasti kur në duart e shumë individëve dhe agjentëve ekonomikë (biznesmenë, kambistë etj.) të jetë një sasi e caktuar markash, liretash etj.. Në këto rrethana nuk përjashtohet mundësia që, në një moment të caktuar, të ketë "dyndje" në sportele fenomen i cili në mungesë të një administrimi të ideuar që më parë mund të marrë përmasat e një paniku, pasojat e të cilit do të ndiheshin si mbi stabilitetin e sistemit financiar ashtu dhe mbi vetë ekonominë.

Megjithëse kanë kaluar rreth 2 vjet nga lançimi i Euros si para në llogari, akoma, nga shumica e individëve, parapëlqehet të thuhet se zotëron marka, lireta apo dhrahmi. Në të vërtetë, ata nuk e dinë se raportet e shkëmbimit të tyre me 1 euro janë

njëherë e mirë të fiksuara dhe nuk ka nevojë që të shkosh në treg dhe të pyesësh se sa është kursi i sotëm i këmbimit të dhrahmisë me euron. Kjo mungesë njohurish në shtresat e gjera të popullsisë mund të kthehet në faktor spekulimi, i cili duke u kombinuar me pasojat e mundshme, të shpjeguara më sipër, mund të marrë përmasa të mëdha.

Duke iu kthyer edhe një herë përfundimeve të arritura në paragrafët e mësipërm, do të evidentonim se, ndërsa rreziku i kursit të këmbimit më së shumti ka të bëjë me parimet bazë të makroekonomisë, implikimet e tjera kryesisht janë për shkaqe subjektive.

Për rrjedhim, shmangia e tyre është plotësisht e mundshme dhe për këtë qëllim Banka e Shqipërisë ka filluar përgatitjet me kohë.

ÇFARË KA PROGRAMUAR BANKA E SHQIPËRISË?

Periudha e mbetur deri në 1 janar 2002, nga ana e Bankës së Shqipërisë është konsideruar si një periudhë intensive e informimit dhe e edukimit të publikut, sidomos duke filluar që nga muaji shtator 2001. Në të vërtetë, plani i ideuar i masave përveç fushatës së informimit konsiston dhe në kryerjen e disa veprimeve operacionale që kanë të bëjnë me hedhjen në qarkullim të Euros.

Megjithatë, këto të fundit janë detaje më teknike, trajtimi i të cilave do të jetë pjesë e debatit mes bankierëve. Ajo çka është me interes është fushata e informimit të publikut, qëllimi i së cilës do të jetë krijimi i një ambienti sa më të përshtatshëm për pranimin sa më të natyrshëm të Euros nga realiteti shqiptar.

Në funksion të këtij qëllimi, Banka e Shqipërisë ka kuptuar se kjo fushatë informimi dhe edukimi e publikut do të jetë e dështuar nëse ajo (Banka) nuk do të arrijë të bashkëpunojë dhe ta ndajë këtë përgjegjësi me institucionet e tjera financiare në vend, me shoqatën e bankierëve dhe sidomos me median në përgjithësi. Është ky shkak që e ka shtyrë Bankën e Shqipërisë

që mbas mbarimit të fazës së parë[5] (deri më 31 gusht 2001) të fillojë një fushatë propaganduese[6] në lidhje pamjen, elementet e sigurisë, afatin e mbarimit ligjor të nënfishave të Euros etj..

Informacioni i bollshëm për karakteristikat e mësipërme të monedhës së re evropiane do të disponohet në të gjitha sportelet e sistemit bankar, në sportelet e agjencive valutore si dhe në sportelet e të gjitha institucioneve të tjera financiare, të licencuara nga Banka e Shqipërisë. Për publikimin e këtij informacioni do të ftohen që të kontribuojnë si media e shkruar ashtu dhe ajo vizive.

Gjatë fazës së dytë, një vend të rëndësishëm do të zënë dhe seminaret e organizuara nga Banka e Shqipërisë, qëllimi i të cilave do të jetë sqarimi në detaje i çështjeve të trajtuara më sipër. Gjithashtu, për t'i shërbyer një auditori sa më të madh të interesuarish, Banka e Shqipërisë është e gatshme që të mbajë emisione të posaçme në median vizive.

Grupi i dytë i masave të parashikuara, ka një natyrë operacionale dhe synon të sigurojë:

- që më 1 janar 2001, Euro do të jetë e pranishme dhe në Shqipëri;
- se konvertimi i zotërimeve në valuta kombëtare të vendeve të Eurozonës me Euro do ta bëhet pa eksese;
- se do të garantohet mbajtja nën kontroll e spekulimeve të mundshme me kursin e këmbimit.

Për t'i paraprirë plotësimit të këtyre tre objektivave, Banka e Shqipërisë, gjykon se përveç veprimeve që do të kryejë për llogari të saj, ajo (Banka) do të kërkojë nga bankat e nivelit të dytë që të marrin masat për:

- sigurimin e fondeve të mjaftueshme në *cash,* në përputhje me zotërimet që ato kanë në nënfisha të Euros para datës 30 dhjetor;
- përgatitjen e një plani masash se si bankat do ta zgjidhin këtë problem.

Nga ana e saj Banka e Shqipërisë do të marrë të gjitha masat për sigurimin e rezervave të veta në *cash*, duke gjykuar mbi vëllimin dhe strukturën sipas prerjeve dhe për shmangien e spekulimeve të mundshme me kurset e këmbimit.

NË VEND TË MBYLLJES

Periudha e mbetur nuk duhet konsideruar mjaftueshmërisht e gjatë por nga ana tjetër, nuk duhet të na zërë dhe paniku. Fakte të tilla si për shembull, mosekzistenca e një vlerësimi të përafërt mbi shumën totale të zotërimeve në Euro që ambienti ekonomik dhe individët shqiptarë kanë në zotërim përbëjnë shqetësim por që gjithsesi, mund dhe duhen ezauruar. Nga ana tjetër, duhet pranuar që në fushatën e informimit të publikut, çdo palë duhet të bëjë pjesën e vet, e për rrjedhim edhe përgjegjësia për sensibilizimin dhe edukimin e publikut duhet parë si një përgjegjësi e ndarë më tresh, Banka e Shqipërisë, institucione financiare dhe media.

SHËNIME

* Gramoz Kolasi, Zëvendësdrejtor i Departamentit të Kërkimeve, Banka e Shqipërisë.
Prezantim në seminarin "Hyrja në qarkullim dhe shpërndarja e Euros".
[1] 1 euro është e barabartë me 100 cent.
[2] Belgjika, Luksemburgu, Holanda dhe Irlanda kanë vendosur vetëm një motiv, përkatësisht Mbreti Ludvig II, Duka i Madh Henri, Mbretëresha Beatriçe, simboli kombëtar i harpës. Po kështu një motiv të vetëm kanë dhe monedhat e prera në Itali, Austri dhe Greqi.
Në monedhat e Gjermanisë, prerjet 1 dhe 2 euro, kanë shqiponjën e Federatës, ndërkohë që monedhat 10, 20 dhe 50 cent kanë Portën e Bradenburgut. Në prerjet e vogla 1, 2 dhe 5 cent është vendosur një degë lisi. Ashtu si Gjermania edhe Franca, Spanja dhe Portugalia kanë përdorur tre motive të ndryshme.
[3] EZB – BCE – ECB – EKT – EKP janë shkurtimet që bazohen në 11 gjuhët zyrtare të BE-së.
[4] Monedhat kombëtare të 12 vendeve të Eurozonës.
[5] Gjatë kësaj faze është parashikuar të bëhen botime të ndryshme me karakter informativ si dhe të mbahen konsultime me shoqatën e bankierëve.
[6] Kjo fushatë përkon dhe me fazën e dytë, që fillon nga data 1 shtator 2001 deri më 31 dhjetor 2001. Ndarja e fushatës në dy periudha ka lidhje me faktin se vetë Banka Qendrore Evropiane ka shpallur një intensifikim të fushatës së saj informuese dhe edukuese, duke nisur që nga shtatori 2001.

EKONOMIA BOTËRORE DHE AJO SHQIPTARE PAS NGJARJEVE TË 11 SHTATORIT 2001

*Diana Shtylla**

Fjalë kyçe
- Goditje terroriste - Tregjet e aksioneve - Kurset e këmbimit - Ngadalësim ekonomik -

Goditja terroriste e 11 shtatorit mbi New York dhe Washington konsiderohet si një ngjarje *shock* për ekonominë amerikane dhe atë botërore. Sidoqoftë periudha që pasoi (11 shtator e këtej) pati disa momente të dallueshme nga njëra tjetra, të cilat mund të ndahen si vijon:

1. Sulmi terrorist mbi SHBA (11 shtator).
2. Lajmet e rreme për fillimin e sulmit amerikan ndaj Afganistanit (afërsisht 21 shtator dhe 1 tetor).
3. Fillimi i sulmit amerikan ndaj Afganistanit (7 tetor).

Meqenëse termometri më i ndjeshëm dhe ndoshta më i saktë i situatës politike dhe ekonomike në mbarë botën përfaqësohet nga tregjet e aksioneve, përmbledhja e mëposhtme e nis paraqitjen e impaktit të goditjes pikërisht me përshkrimin e ecurisë së tregjeve të aksioneve nëpër botë.

A. TREGU I AKSIONEVE

1. BURSAT MENJËHERË PAS GODITJES - 17 SHTATOR 2001

Vendimi për të mos hapur bursat amerikane deri më 17 shtator nuk mundi të parandalonte rënien e parashikuar të çmimeve të

aksioneve. Dita e parë e aktivitetit në Wall Street shënoi një rënie të indeksit Dow Jones, me 7.13 për qind dhe të NYSE, me 6 për qind. Kompanitë e para që humbën pikë në tregun e aksioneve ishin ato ajrore dhe shoqëritë e mëdha të sigurimeve. Në mënyrë direkte u dëmtuan nga sulmi terrorist shumë kompani financiare, të cilat pësuan humbje të konsiderueshme materiale dhe njerëzore.

Një sulm i tillë mbi Amerikën ishte i paprecedent. Për më tepër, për nga vetë natyra e sulmit, tek populli dhe politikëbërësit amerikanë doli në pah dhe madje u forcua ndjenja e patriotizmit dhe e solidaritetit. Ndonëse është e vështirë të mendohet një nxitje e blerjeve të aksioneve shtyrë nga ndjenja patriotike, është pikërisht kjo ajo që ndodhi në ditët e para të hapjes së bursave anekënd SHBA. Ndoshta, rënia në çmimet e aksioneve do të kishte qenë më e madhe në mungesë të bashkëveprimit të njëkohshëm të politikës ekspansioniste të Rezervës Federale dhe të besimit që u injektua në tregun e kapitaleve, nëpërmjet thirrjeve dhe veprimeve që mbështesnin blerjen e aksioneve.

Në të njëjtën kohë në Evropë bursat, duke e parë me optimizëm vendimin e datës 17 shtator të Rezervës Federale për uljen e kostos së parasë me 0.5 pikë përqindjeje, reaguan pozitivisht duke rikuperuar brenda pjesës së dytë të ditës së hënë, të gjitha humbjet e pësuara në fillim të saj. Konkretisht, Bursa e Milanos e mbylli ditën me një rritje prej 0.17 për qind, ajo e Parisit me +2.3 për qind, e Londrës me +2 për qind dhe e Frankfurtit me +2.9 për qind.

2. FUNDI I JAVËS SË PARË PAS HAPJES

Data 21 shtator nuk solli lajme të mira për bursat në mbarë botën. Ndërkohë që në New York vazhdonin gërmimet në rrënojat e Qendrës Botërore të Tregtisë, nga politikanët dhe media vinin mesazhe të ndryshme lidhur me qëndrimin që do të mbanin SHBA ndaj Afganistanit. Frika se një qëndrim i ashpër i SHBA do të nxiste një reagim po aq të ashpër dhe të paparashikueshëm nga ana e terroristëve, bëri që bursat ta mbyllnin javën në pikat e tyre më të ulëta. Aksionerët, të trembur nga ajo çka

mund të ndodhte gjatë dy ditëve në vazhdim (kur bursat ishin të mbyllura) shpejtuan të shisnin aksione në masë, duke bërë kështu që bursat ta mbyllnin ditën me humbje që varionin nga 5-7 për qind. Si të mos u mjaftonte pritja e shpalljes së sulmit amerikan, bursat evropiane e gjetën veten përpara problemesh të shumta teknike dhe alarmesh të rreme për bomba apo për sulme "surprizë". Ideja që u hodh në atë kohë ishte se bursat evropiane dhe ato amerikane kishin hyrë në një rreth vicioz, i cili bënte që humbjet e njërës palë të pasqyroheshin vazhdimisht tek tjetra dhe anasjelltas.

Pas pikës së ulët që kapën më 21 shtator, bursat e SHBA, Londrës, Parisit, Japonisë, Gjermanisë, Italisë etj. nisën ngjitjen e ngadaltë dhe të pasigurt, me shpresën se humbjet e pësuara gjatë javës së kaluar do të rikuperoheshin së shpejti. Gjithsesi, parashikimet për datën e sulmit të pritshëm të SHBA mbi Afganistanin, u kthyen në një faktor të pamëshirshëm për tregjet e aksioneve. Kështu më datë 1 tetor, po në përgjigje të sulmeve të pritshme, Nasdaq humbi 2 për qind ndërsa Bursa e Milanos - Mibtel 2.2 për qind. Lëvizje të pothuajse të njëjtës masë, u vunë re në bursat e të gjithë botës.

Aksionet që u shitën më tepër në këtë moment iu përkisnin kompanive të teknologjisë së lartë dhe të telefonisë. Shkak për këtë rënie në çmimet e aksioneve nuk ishte vetëm sulmi i pritshëm i SHBA, por edhe përballja e mëtejshme e kompanive amerikane dhe evropiane me probleme të thella financiare. Disa nga kompanitë që e panë veten më ngushtë në këtë periudhë ishin: British Airways, holandezja 'KLM', zvicerania 'Swissair', si edhe gjermania 'Lufthansa'. Këto kompani i bënë kërkesë për ndihmë financiare Komisionit Evropian të Transportit në Bruksel. Komisioni nuk e mori parasysh këtë kërkesë nën pretendimin se për kompanitë evropiane, nuk ekzistonte një buxhet federal që do t'i mbështeste në rast vështirësish. I njëjti skenar u vu re në SHBA një javë më parë. Ndryshimi në këtë rast ishte se Kongresi iu akordoi kompanive ajrore në vështirësi shumën prej 15 miliardë dollarësh, nga të cilat 10 miliardë në formën e kredive të buta.

Me kalimin e momenteve *shock* tregjet e aksioneve i janë kthyer normalitetit, por eksperienca e 11 shtatorit sigurisht që iu dha atyre diçka për t'u mbajtur mend.

B. ECURIA E KURSEVE TË KËMBIMIT

Nëse i hedhim një shikim të shpejtë kurseve të këmbimit në tregjet valutore botërore, do të arrijmë në përfundimin se dollari, që prej fundit të muajit qershor, nisi të humbiste terren ndaj euros, jenit japonez (JPY), sterlinës britanike (GBP) dhe frangës zvicerane (CHF). Në lidhje me monedhat euro dhe frangën zvicerane, dollari shfaqi shenja rimëkëmbjeje rreth fundit të muajit gusht. Kjo dukuri mund të shpjegohet me mesazhet më optimiste që nisën të vinin nga ekonomia amerikane në këtë periudhë. Ideja se potenciali i kësaj ekonomie do të mundësonte një dalje të shpejtë dhe të qëndrueshme nga situata e vështirë, vazhdoi të përhapej dhe të besohej deri në momentin kur sulmi i papritur goditi SHBA.

Gjatë ditëve që tregjet amerikane të aksioneve qëndruan mbyllur, tregjet valutore nëpër botë vazhduan të fiksonin vlerat e reja të kursit të këmbimit të dollarit me monedhat e tjera. Rënia e dollarit ndaj monedhave të sipërpërmendura (euro, JPY dhe CHF), rifilloi që prej datës 11 shtator, por pikat më të ulëta të monedhës së gjelbër u shënuan në datat 19, 20 dhe 21 shtator. Pikërisht në këto data, lajmet e pasakta mbi fillimin e sulmit amerikan ndaj Afganistanit përmbytën mediat e shkruara dhe televizive.

Tabelë 1. Kurset e këmbimit të disa monedhave ndaj usd në ditët e pikave më të ulëta.

Data e pikës më të ulët të usd	Monedha	Vlera ndaj 1 usd
19 shtator	Euro	1.08015
20 shtator	JPY	115.85
21 shtator	CHF	1.587
5 tetor	GBP	0.6759

Ndërkohë që monedha euro ishte "më e shpejtë", sterlinës britanike iu deshën rreth dy javë për ta çuar dollarin në vlerën më të ulët të tij, gjatë muajve të fundit.

Që prej datës 19 shtator, usd nisi të forcohej gradualisht ndaj euros ndonëse kursi i këmbimit ka shfaqur luhatje të vogla. Deri në mes të muajit nëntor kursi euro/usd arriti afërsisht në nivelin e mesit të muajit gusht.

Ecuria e deritanishme sugjeron forcim të mëtejshëm ose të paktën ruajtje të vlerës aktuale të usd, megjithatë fjala e fundit në këtë parashikim i takon mënyrës se si do të zhvillohen ekonomitë, që secila nga këto monedha mbështet. Pothuajse i njëjti skenar është zhvilluar midis dollarit dhe JPY me ndryshimin që vlerësimi i dollarit pas datës 20 shtator ishte më i shpejtë se në rastin e euros.

Ndërkohë që ndaj euros dollari u vlerësua me 3.4 për qind midis datave 19 shtator dhe 25 tetor, ndaj jenit japonez, për të njëjtën periudhë dollari fitoi rreth 6 për qind të vlerës.

Po në datat 19-20 shtator jpy arriti një kulm edhe ndaj euros, por zhvillimet e muajit pasardhës flasin për një forcim të monedhës evropiane ndaj asaj aziatike. Franga zvicerane (chf) mposhti si dollarin ashtu edhe euron në të njëjtën ditë (21 shtator), duke u këmbyer përkatësisht me 0.630 usd dhe 0.692 euro. Duhet thënë se, ndërsa dollari e arriti më ngadalë këtë pikë, euro pësoi një zbritje të menjëhershme brenda 3-4 ditëve. Deri në mes të muajit nëntor, chf është zhvlerësuar gradualisht ndaj usd, por mbetet akoma më e fortë nga çka qenë para datës 11 shtator.

Përsa i përket kursit chf/euro, ai është dukshëm më i favorshëm për chf nga çka qenë para 21 shtatorit dhe tendenca dëshmon për një zhvlerësim të mëtejshëm të euros.

Stërlina apo paundi britanik (gbp) ka nisur vlerësimin ndaj usd që prej fundit të muajit maj, kur 1 usd këmbehej me 0.723 gbp. Deri më sot kjo mbetet pika e fundit më e lartë e usd gjatë 6 muajve të fundit. Më datë 5 tetor, usd arriti pikën e ulët prej 0.675 gbp për t'u ngritur më pas deri në nivelin e fillimit të muajit gusht.

Pas një pike të ulët ndaj paundit më 5 tetor, euro ka vazhduar rënien ndaj monedhës britanike. Në këtë kohë lajmet mbi ekonominë britanike janë më optimiste nga ato që vijnë prej pjesës tjetër të Evropës Perëndimore dhe sidomos Gjermanisë. Siç u pa nga zhvillimet e mësipërme, të gjitha monedhat e fuqishme botërore reaguan ndaj monedhës së gjelbër duke e çuar atë në pikat më të ulëta, çuditërisht jo në momentin kur SHBA shpallën luftën ndaj Afganistanit (7 tetor 2001), por në momentin fillestar, kur lajmet e rreme për luftën e pritur dhe hamendjet mbi reagimin e terroristëve, shkaktuan frikë dhe pasiguri nëpër botë. Nga kjo pikturë komplekse e tregjeve valutore, mund të bëhet supozimi se efekti psikologjik dhe pritshmëritë luajnë një rol tepër të rëndësishëm në ecurinë e kurseve të këmbimit.

C. TREGU VALUTOR NË SHQIPËRI

Përpara se të kalohet tek pasojat që pati goditja terroriste mbi dollarin që këmbehej në Shqipëri, duhet thënë se dollari nuk ka njohur zhvillime shumë pozitive edhe në dy muajt që paraprinë goditjen. Kursi mesatar për muajin qershor ishte 148.55 lek/usd. Një nivel kaq i lartë për dollarin nuk ishte parë që nga tetor-nëntori i vitit të kaluar. Muaji qershor i këtij viti shënoi pikën e fundit të fortë të dollarit, i cili filloi të binte ndaj lekut duke kaluar në nivelin mesatar prej 147.8 lekësh në korrik dhe 143.25 në gusht. Është e kuptueshme që një ecuri e tillë, përveçse nga faktorët sezonalë, u kushtëzua në masë të madhe nga dobësimi i vazhduar i ekonomisë amerikane, i cili reflektohej besnikërisht në kursin usd/euro. Ashtu siç ndodhi në tregjet botërore gjatë këtyre muajve, edhe në Shqipëri usd humbi terren ndaj euros, e cila u këmbye me 126.8 lekë në qershor, 127.2 lekë në korrik dhe 128.9 lekë në gusht.

Sulmi terrorist mbi SHBA, u reflektua pikësëpari në rënien e menjëhershme të vlerës së dollarit. Gjatë dy javëve që pasuan, gazetat përcillnin në opinionin publik tituj që e shtonin akoma më tepër mosbesimin ndaj monedhës së gjelbër e cila deri pak muaj më parë, po sipas trumbetimit të gazetave, gëzonte "parajsën" në Shqipëri. Efektet psikologjike luajtën rol negativ

në ecurinë e dollarit kundrejt lekut. Gjatë javës së dytë pas 11 shtatorit, dollari humbi 1.67 për qind ndaj lekut duke kaluar nga vlera 144 lek/usd (10 shtator) në vlerën 141.63 lek/usd (21 shtator). Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e raportit euro/usd nga datat 10-28 shtator 2001.

Grafik 1. Kursi i këmbimit euro/usd i matur në tregjet botërore dhe në Shqipëri.



Shënim: Raporti euro/usd shpreh raportin e dy monedhave, të llogaritur në bazë të kurseve të këmbimit me lekun. Raporti euro/usd* paraqet kursin ndërkombëtar të dy monedhave.

Siç shihet nga grafiku, kurset e këmbimit lek/usd dhe lek/euro, gjatë muajit shtator, kanë ndjekur në përgjithësi zhvillimet në tregun ndërkombëtar. I vetmi moment, që mund të konsiderohet paksa i veçantë, është ai i datës 21 shtator. Në këtë datë një dollar, pas vlerës së ulët të një dite më parë, u ngrit menjëherë duke u këmbyer në tregjet botërore me 1.099 euro, ndërkohë që në Shqipëri i njëjti raport ishte 1.089 euro/usd. Gjatë muajit shtator, dollari ka kapur vlerat më të ulëta ndaj lekut në datat 17, 20 dhe 26 kur ai është këmbyer me përkatësisht 141.35, 141.37 dhe 141.21 lekë. Data 20 shtator ka shënuar njëkohësisht në Shqipëri edhe vlerën më të lartë të monedhës euro për muajin (130.75 lekë). Mesatarja e muajit për dy monedhat ishte 142.89 lekë/usd dhe 129.83 lekë/euro.

Gjatë muajit në vazhdim, dollari u luhat në kufijtë 142.26 lekë dhe 140.66 lekë. Shifra e fundit i takon datës 9 tetor dhe ishte dhe vlera më e ulët e arritur gjatë muajit. Monedha evropiane ndërkohë lëvizi midis vlerave 126.11 lekë (26 tetor) dhe 129.7 lekë (5 tetor).

Nga këto zhvillime duket se tregu valutor shqiptar ka lëvizur, në përputhje me tregun valutor ndërkombëtar dhe ka reaguar ndaj zhvillimeve që janë vënë re në këtë treg.

D. REAGIMI I BANKAVE QENDRORE NDAJ SULMIT TË 11 SHTATORIT DHE MË TEJ

"Sistemi i Rezervës Federale është i hapur dhe në gjendje pune kurse *discount window* është e gatshme të përballojë nevojat për likuiditet". Kjo ishte deklarata e vetme që u lëshua nga zëvendëspresidenti i bankës qendrore më të fuqishme në botë pasditen e 11 shtatorit 2001[1]. Dhe ishte po kjo deklaratë ajo që bëri të mundur injektimin e 80 miliardë dollarëve në sistemin financiar amerikan, deri në fund të kësaj dite të pazakontë. Në të njëjtën kohë autoritetet drejtuese të Bankës Qendrore Evropiane konfirmuan gatishmërinë e BQE për t'i siguruar likuiditetin e duhur tregut financiar evropian. Banka Qendrore Gjermane duke filluar që nga kjo ditë, veproi si siguruesja më e madhe e likuiditetit dhe në pak ditë kaloi nëpërmjet sistemit të saj të kleringut një sasi prej 500 miliardë usd.

Një ditë pas goditjes terroriste ministrat e financave dhe guvernatorët e bankave qendrore të Grupit të të Shtatëve përgatitën një plan shpëtimi, i cili përfshinte kosto të ulura të huamarrjes me qëllim shtimin e likuiditetit në treg dhe nxitjen e ekonomisë. Mbyllja e tregjeve të aksioneve, gjatë javës së parë, la shteg për dyshime dhe spekulime të shumta lidhur me zhvillimet e mëtejshme në indekset e aksioneve. Në SHBA mbizotëronte frika se paniku do të çonte në ulje të theksuara të çmimeve të aksioneve, si pasojë e shitjeve në masë të madhe.

Në këtë pikë trysnia mbi Rezervën Federale për një ulje të menjëhershme të interesave ishte shumë e lartë. Ndoshta, e vetmja arsye për të cilën ulja e parashikuar dhe pothuajse e sigurt nuk u bë, ishte përshtypja e disa ekspertëve amerikanë se një hap i tillë, i ndërmarrë në një moment kur Amerika ishte akoma nën shokun e pamjeve të sulmit dhe kur tregu i aksioneve qëndronte mbyllur, nuk do të kishte influencën e pritur në tregjet

financiare. Përveç pyetjes 'kur?' Fed shtroi në tryezë edhe pyetjen e pashmangshme: ç'do të ndodhë me pjesën tjetër të botës pasi ne të ulim interesat?

Përgjigjja për këtë pyetje nuk vonoi të vinte në fillim të javës që pasoi, menjëherë pasi Fed-i shpalli, për të tetën herë gjatë këtij viti, uljen e normave të interesit, pra uljen e kostos së parasë, me 0.5 për qind duke i çuar ato në nivelin 2.5 për qind. Lajmi i uljes së kostos së parasë u shoqërua nga thirrja që Guvernatori i Fed-it, Allan Greenspan, iu bëri bankave për të qenë tolerante ndaj klientëve të vënë në vështirësi financiare, si pasojë e atentateve terroriste. Gjithashtu, Fed-i iu kërkoi bankave të ishin të gatshme për të kredituar individë apo kompani të ndryshme që paraqisnin nevojë për fonde. Me këto masa Rezerva Federale synonte të nxiste investime të reja dhe të ruante nivelin aktual të konsumit të amerikanëve, i cili përbën rreth 2/3 e PBB-së.

Ndërkohë që në SHBA po luheshin të gjithë gurët për ta mbajtur ekonominë në formë, në Evropë gjysmë ore pas një operacioni rifinancimi të kryer me normën 4.25 për qind, BQE shpalli uljen e normës së rifinancimit me 0.5 për qind. Sipas komenteve të një bankieri qendror "Evropa duhej t'i tregonte botës që ishte me Amerikën". Pikëpyetjet dhe komentet, ndoshta jo shumë mirëdashëse ndaj politikës së BQE-së rrjedhin nga qëndrimi tepër i kujdesshëm i saj në lidhje me uljen e normave të interesit, ndërkohë që Fed-i nuk ka treguar as hezitimin më të vogël për të ndjekur një politikë ekspansioniste gjatë gjithë vitit 2001.

Përveç dy bankave qendrore më të mëdha, ndaj zhvillimeve në SHBA reaguan edhe autoritetet monetare në Japoni, Zvicër, Kanada dhe Britani e Madhe. Menjëherë pas goditjes ato injektuan sasi të mëdha likuiditeti. Fed-i hyri në marrëveshje *swap* me BQE, me Bankën e Anglisë dhe me Bankën e Kanadasë me qëllim që të lehtësonte funksionimin e tregjeve financiare dhe që të siguronte likuiditet në usd. Ulja e interesave nga Fed-i dhe BQE u ndoq nga ulje të së njëjtës masë nga Banka e Kanadasë dhe Banka Kombëtare e Zvicrës. Normat e interesit u ulën më pas edhe nga autoritetet monetare të një sërë shtetesh

si: Anglia, Japonia, Danimarka, Suedia, Zelanda e Re, Hong Kong Sar dhe Koreja.

Reagimi i parë i bankave qendrore u mirëprit nga tregjet ndërkombëtare dhe u konsiderua si mbështetje e fuqishme dhe e nevojshme për ekonomitë e veçanta. Deri në 6 nëntor, Rezerva Federale bëri edhe dy ulje të tjera të normave të interesit, duke i çuar ato në nivelin 2 për qind. Po në këtë kohë, Banka e Anglisë, uli normën e interesit afatshkurtër me 0.5 pikë përqindjeje deri në nivelin 4 për qind dhe Banka Qendrore Evropiane, duke bërë një ulje të së njëjtës masë i çoi normat e veta në nivelin 3.25 për qind. Tendencat ekspansioniste të bankave qendrore ndërkohë që po përkrahen nga ata që synojnë nxitje të ekonomisë botërore, shihen me skepticizëm nga ata që i tremben pamundësisë për të manovruar në një periudhë më afatgjatë. Si shembulli më negativ, merret rasti i Japonisë, e cila po e sheh veten në një periudhë recesioni të zgjatur.

Uljet në normat ndërkombëtare të interesit pritet që të reflektohen në ulje të të ardhurave nga rezervat që Banka e Shqipërisë ka depozituar jashtë vendit, gjatë vitit në vazhdim. Përveç këtij efekti, këto ulje janë pasqyruar dhe po vazhdojnë të pasqyrohen në normat e interesit të depozitave në valuta të ndryshme dhe sidomos tek ato në dollarë.

E. IMPAKTI I NGJARJEVE TË FUNDIT MBI VENDET ME TË ARDHURA TË ULËTA DHE MESATARE

Në vijim të ngjarjeve të ndodhura kohët e fundit, institucionet ndërkombëtare si Banka Botërore apo Fondi Monetar Ndërkombëtar kanë shpejtuar të bëjnë rivlerësime të parashikimeve të tyre lidhur me performancën ekonomike botërore dhe atë të shteteve, në veçanti.

Është e qartë që influenca e ngadalësimit të ekonomisë globale mbi secilin shtet varet nga karakteristikat e shtetit në shqyrtim dhe nga marrëdhëniet tregtare dhe financiare të këtij shteti me pjesën e mbetur të botës. Për këtë arsye analiza, bëhet

veçmas për grupe shtetesh që i lidhin si afërsia gjeografike ashtu edhe karakteristika të përbashkëta të zhvillimit ekonomik.

Për vendet në zhvillim[2], ku bën pjesë edhe vendi ynë, parashikimet për rritjen e PBB-së gjatë viteve 2001 dhe 2002 janë ulur, për shkak të varësisë së tyre ndaj zhvillimit ekonomik të vendeve të zhvilluara. Efektet më direkte të krizës botërore mbi këto shtete priten të shfaqen në disa forma, të cilat analizohen më poshtë:

Turizmi- Pasiguria që pllakosi botën pas akteve terroriste të 11 shtatorit u manifestua në reduktim të menjëhershëm të numrit të udhëtarëve që përdornin linjat ajrore. Fluturimet ndërshtetërore në SHBA , ato nga SHBA në Evropë dhe midis vendeve evropiane deri pak javë pas tragjedisë vuajtën nga një reduktim i madh i kërkesës së udhëtarëve. Tarifat e fluturimit pësuan ulje të konsiderueshme, të cilat duke i privuar firmat ajrore nga fitimi, shërbenin së paku për të mbushur deri-diku avionët e boshatisur. Ndonëse stepja e fillimit tashmë është zbutur, ngurrimi i udhëtarëve, sidomos për të ndërmarrë udhëtime turistike, mbetet në nivele të larta. Ndoshta do të duhet të kalojë një kohë e gjatë deri sa sjellja e turistëve t'i kthehet normalitetit.

Shqipëria duke bërë pjesë në Gadishullin e Ballkanit, nën dritën e zhvillimeve të fundit në rajon, mbetet në listën e vendeve që paraqesin një shkallë jo të vogël rrezikshmërie, dhe ngjarjet në SHBA, sigurisht që nuk kanë ndihmuar për të zbutur perceptimin e vizitorëve të huaj apo shqiptarë.

Gjatë muajve në vazhdim, pra për festat e fundvitit, mund të ndodhë që një pjesë e shtetasve shqiptarë tashmë rezidentë të shteteve evropiane apo amerikane, të mos kthehen pranë familjeve në Shqipëri, të stepur nga pasiguria e udhëtimeve të gjata. Sipas përkufizimit të bilancit të pagesave shërbimet që këta persona blejnë në Shqipëri (shërbime të udhëtimit) bëjnë pjesë në kategorinë e shërbimeve të eksportuara në të cilën zënë rreth 84.5 për qind të totalit.

Shërbimet e eksportuara të udhëtimit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2001, kapën shifrën 194 mil usd –rreth 66 mil usd më të larta se shërbimet e importuara, duke bërë që bilanci total i shërbimeve të ishte pozitiv me 18 mil usd. Nëse muajt pasardhës shoqërohen me një rënie të numrit të shtetasve shqiptarë, jorezidentë, që vizitojnë vendin, mund të ndodhë që bilanci i shërbimeve të përkeqësohet dhe të humbasë rolin që ka luajtur deri tani si balancues i llogarisë korente. Përsa i përket numrit të të huajve që vizitojnë Shqipërinë[3], ky mund të bjerë, gjithashtu. Megjithatë në statistikat tona, pesha kryesore mbahet prej kategorisë së lartpërmendur, pra shqiptarëve jorezidentë që vijnë në Shqipëri për të kaluar pushimet e verës apo të dimrit.

Nga ana tjetër, nëse një ulje në çmimet e turizmit tërheq më shumë shtetas shqiptarë jashtë vendit , bilanci i shërbimeve ka të ngjarë të ngushtohet më tej. Në këtë mënyrë përkeqësimi mund të jetë i dyanshëm.

Tregjet financiare - Gjatë muajit shtator investimi i tregjeve të kapitalit në ekonomitë në zhvillim ra me 35 për qind, në krahasim me nivelin e muajit gusht.

Ndërkohë që ulja e normave të interesit në SHBA në vitin 1990 bëri që kapitali të hynte në masë të konsiderueshme në vendet në zhvillim, situata e tanishme mund të kushtëzojë nivelin e huadhënies si edhe numrin e vendeve që do të përfitojnë nga këto fonde.

Investimi i huaj direkt, i cili shihet i lidhur ngushtë me ciklet e biznesit në vendet e zhvilluara ka të ngjarë të pësojë rënie, si pasojë e ecurisë jo shumë pozitive të ekonomive të këtyre vendeve. Investimi i huaj direkt varet jo vetëm nga ecuria ekonomike e vendeve të zhvilluara, domethënë nga pasja ose jo e kapitalit për investim, por edhe nga sentimenti i investitorëve, i cili ka kohë që jep shenja jo të mira.

Siç duket qartë nga grafiku, dy vitet e fundit dëshmojnë për një rritje të investimeve të huaja në vend.

Nëse muajt në vazhdim shoqërohen nga rënie e besimit të investitorëve nëpër botë dhe nëse Rajoni i Ballkanit vazhdon të shihet si një zonë konfliktesh, piktura në Shqipëri ka të ngjarë të ndryshojë. Çfarë krijon më tepër probleme në këtë parashikim është lidhja midis investimeve të huaja dhe procesit të privatizimit.

Ndërkohë që në Shqipëri po përgatitet terreni për privatizimin e njësive të fuqishme ekonomike dhe financiare, mundësia e largimit të investitorëve të huaj në terma të numrit apo të fondeve që ata ofrojnë, nuk është një lajm i mirë.

Tregjet e mallrave bazë- Një rimëkëmbje e vonuar e ekonomisë botërore mund të pengojë rritjen e çmimeve të artikujve bazë, të cilat kanë shfaqur rënie gjatë katër viteve të fundit. Rënia e këtyre çmimeve u theksua edhe më tepër pas datës 11 shtator si më poshtë vijon[4]:

Tabelë 2. Ndryshimet në çmimet e disa mallrave bazë.

Produkti	Ndryshimi në çmim (11 shtator – 24 tetor)
Naftë	-4.5 usd
Produkte bujqësore	-(6-8) %
Metale	-4 %

Ulja në këto çmime, ndërkohë që pasqyron një avantazh për shtetet importuese të këtyre produkteve, krijon një situatë të pasigurt për vendet eksportuese. Ato shtete që mund të vuajnë më tepër momentalisht dhe në të ardhmen e afërt nga ulja e çmimeve janë ekonomitë, tregtia e së cilave mbështetet fuqimisht në eksportet bujqësore apo të materialeve të përpunuara me origjinë tekstile. Këto vende, duke mos qenë importuese dhe përdoruese të mëdha të naftës, nuk përfitojnë nga ulja e çmimit të naftës ndërkohë që paguajnë 'taksën' e tyre në anën e eksporteve.

Për bilancin tregtar të Shqipërisë këto zhvillime mund të shihen deri-diku si pozitive, për shkak të strukturës së import/eksporteve, e cila paraqitet në këtë mënyrë[5]:

Tabelë 3. Peshat e mallrave bazë në importet dhe eksportet shqiptare.

Grupmalli	Në % ndaj importeve totale	Në % ndaj eksporteve totale
Naftë (dhe produkte energjitike)	8.9	1.9
Produkte bujqësore	16	3.4
Metale bazë dhe produkte të tyre	7.7	8.4

Duke pasur parasysh që vëllimi i importeve është shumë më i lartë se ai i eksporteve (rreth 4.2 herë), si edhe raportet e mësipërme, arrihet lehtësisht në përfundimin që ecuria e çmimeve në tregjet ndërkombëtare për Shqipërinë, do të thotë përfitim në kahun e importeve.

Tregtia- Një ngadalësim në ekonominë botërore do të thotë ulje në kërkesën për eksporte të vendeve në zhvillim dhe rritje në kostot e tregtimit. Nga këto dukuri pritet të vuajnë më tepër vendet me tregti të zhvilluar që gjenden larg tregjeve ku ato eksportojnë. Rritja e kostove të tregtimit vjen nga kostot më të larta të sigurimit dhe transportit të mallit, si pasojë e rrezikut më të lartë që perceptohet.

Krahasimi vit në vit bëhet për të mënjanuar shpjegimin e ecurisë në bazë të dukurisë së sezonalitetit. Pra, shihet se në muajt qershor, korrik dhe gusht të vitit 2001 eksportet shqiptare

drejt vendeve të BE-së (kryesisht Itali, Greqi, Gjermani), kanë pësuar rënie të dukshme në krahasim me eksportet drejt po këtyre vendeve, një vit më parë. Muaji shtator i këtij viti, duke qenë më i lartë në eksporte se ai i vitit të kaluar, mbetet përsëri mbrapa ritmit të rritjes së eksporteve gjatë muajve të parë të vitit. Sidoqoftë, një muaj është i pamjaftueshëm për të arritur në përfundime.

Bilanci tregtar i Shqipërisë kushtëzohet, në masë tepër të madhe nga marrëdhëniet tregtare me vendet e BE-së, me të cilat Shqipëria kryen rreth 77 për qind të importit dhe 93 për qind të eksportit[6].

Kur flitet për një ngadalësim ekonomik, një nga idetë e para që vjen në mendje është pakësimi i kërkesës së brendshme të partnerëve tanë për mallra të importuar nga Shqipëria.

Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë e eksporteve shqiptare drejt vendeve të BE-së, gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2001:

Tabelë 4. Ecuria e eksporteve me vendet e Komunitetit Evropian, viti 2001.

Viti 2000	Eksportet në mld lekë	Ndryshimi në % (vnv)
Janar	3,046	27
Shkurt	3,811	20
Mars	3,832	36
Prill	3,726	45
Maj	3,684	21
Qershor	3,625	0
Korrik	2,453	-26
Gusht	1,960	-9
Shtator	3,486	12

Nëse eksportet e muajit tetor qëndrojnë në nivelet e tanishme apo janë më të ulëta, mund të thuhet me njëfarë sigurie që vendet importuese të mallrave të prodhuar në Shqipëri, po kalojnë një periudhë të uljes së kërkesës për mallra konsumi.

Kuptohet që ulja e nivelit të eksporteve përballë importeve në rritje nuk shihet si zhvillim pozitiv për llogarinë korente dhe bilancin e pagesave të Shqipërisë.

Prurjet nga emigrantët - Ngadalësimi ekonomik, deri më tani i reflektuar shpeshherë në shkurtimin e vendeve të punës, pritet të sjellë pasojat e tij edhe tek të ardhurat nga emigrantët. Shtetet që mendohet se do të ballafaqohen më tepër me ulje të prurjeve nga emigrantët janë Jordania, Maroku, Tunizia të cilat presin dërgesa nga shtetet e Amerikës Qendrore dhe Evropa Perëndimore, si edhe disa vende tepër të varfra të Afrikës, të cilat përfitojnë nga prurjet e emigrantëve të tyre në SHBA. Shqipëria, në llogarinë korente të së cilës dërgesat nga emigrantët përbëjnë rreth 36.6 për qind të të ardhurave[8], ka emigrantë si në Evropën Perëndimore ashtu edhe në SHBA.

Grafik 3. Dërgesat nga emigrantët (transfertat private) në Shqipëri gjatë periudhës tremujori i parë viti 2000-tremujori i tretë viti 2001 (milionë usd).



Përveç tremujorit të parë, i cili ka shfaqur ngritje ndaj tremujorit të parë të vitit të kaluar, dy tremujorët e tjerë krijojnë përshtypjen se kriza botërore ka prekur edhe të ardhurat nga emigrantët. Niveli i tremujorit të dytë është 10 për qind më i ulët nga ai i vitit të kaluar ndërkohë që niveli i të tretit është 20 për qind më i ulët. Nëse tremujori i katërt, i cili zakonisht shënon pikun e prurjeve nga emigrantët (me rastin e festave të fundvitit), është në masë të konsiderueshme më i ulët se ai i vitit të kaluar, atëherë mund të themi, pothuajse pa pikë dyshimi që një nga zërat më të fuqishëm të llogarisë korente të Shqipërisë, po tkurret si pasojë e krizës botërore.[7] Gjithsesi, gjatë tremujorit të katërt të këtij viti duhet të përgatitemi për të parë ndryshime të shkaktuara nga pritja e hyrjes së monedhës euro.

E. SHËNIM PËRMBYLLËS

Kohëve të fundit, nëpër gazeta dhe revista ekonomike haset shpesh thënia "Që prej 11 shtatorit, bota nuk është më e njëjta". Ndërkohë që sulmet terroriste goditën vetëm SHBA, pasojat priten të ndihen në të gjithë ekonominë botërore. Një fakt që të shtyn ta besosh këtë parashikim është ecuria ekonomike pothuajse e sinkronizuar e SHBA, Evropës dhe Japonisë gjatë gjysmës së parë të vitit 2001. Ngadalësimi i njëkohshëm ekonomik në SHBA dhe Evropë, dobësimi i sektorit të teknologjisë së informacionit, kriza në Japoni dhe përkeqësimi i kushteve financiare në tregjet e reja, dëshmuan për lidhje globale më të fuqishme nga ç'ishte menduar përpara vitit 2001. Menjëherë pas 11 shtatorit u servirën si shembuj shumë katastrofa natyrore, me qëllim që të analizohej reagimi i ekonomisë pas ndodhjes së tyre.

Sidoqoftë duhet pranuar fakti se efektet indirekte të 11 shtatorit do të jenë shumë më të ndryshme dhe ndoshta më të rënda se ato të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.

Ashtu siç u vu re në javët e para pas ngjarjes, reagimi i parë negativ erdhi në formën e rënies së besimit konsumator dhe të shpenzimeve private në SHBA, dobësimit të besimit të biznesit si në SHBA ashtu edhe Evropë, dhe rritjes së pasigurisë së perceptuar nga masat në mbarë botën.

Sidoqoftë ka disa pika të forta tek të cilat ekonomistët mbështesin parashikimet e tyre për një të ardhme disi më optimiste se viti që po kalon. Së pari, ekonomitë kryesore morën nga ana e qeverive të tyre mbështetjen e duhur, mbështetje kjo që u vlerësua më e fortë nga ç'ishte parashikuar. Këtu mjafton të përmendim masat që mori Qeveria e SHBA për të rritur shpenzimet qeveritare me 45 miliardë usd (nga të cilat 40 miliardë usd vetëm për rikuperimin e dëmeve të shkaktuara nga sulmi i 11 shtatorit), si edhe projeksionet për uljen e taksave në vitin 2002. Këto ulje pritet të arrijnë deri në nivelin -1.6 për qind të PBB-së.[9]

Së dyti, bazat ekonomike në mbarë botën sot janë shumë më të fuqishme nga ato të pak viteve më parë. Këto baza janë

reflektuar në nivele më të ulëta inflacioni, në pozicione më të forta fiskale, në regjime më fleksibël të kurseve të këmbimit dhe prekshmëri të jashtme më të ulët të tregjeve në zhvillim. Së treti, sulmet terroriste nuk pritet të ndryshojnë në masë të konsiderueshme rritjen e produktivitetit në SHBA. Ngjarjet e fundit sidoqoftë treguan që krizat mund të dëmtojnë shumë ekonominë, kur e gjejnë atë në një moment ngadalësimi.

SHËNIME

* Diana Shtylla, specialiste, Departamenti i Kërkimeve.

[1] "Cool nerves at the central Banks", Financial Times, 1 tetor 2001.

[2] Sipas përkufizimit, Shqipëria bën pjesë në grupin "vende në tranzicion- vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe ato të ish-BS" por në këtë analizë grupet 'vende në zhvillim' dhe 'vende në tranzicion' janë shkrirë në një të vetëm kundrejt grupit të 'vendeve të zhvilluara'.

[3] Nga pikëpamja e bilancit të pagesave, shtetasit e huaj që nuk banojnë në Shqipëri dhe shqiptarët jorezidentë konsiderohen të njëjtë, por ndarja në këtë material bëhet për arsye të ndryshimeve që këto dy kategori udhëtarësh kanë në mënyrën e perceptimit të vendit.

[4] Burimi: Raporti i Bankës Botërore mbi 'Ndikimin e ngjarjeve të fundit në vendet me zhvillim të mesëm dhe të ulët", Nëntor 2001.

[5] Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti Statistikor - të dhëna për vitin 2000.

[6] Po aty, të dhëna për vitin 2000.

[7] Transfertat private (rreth 530 mil usd për vitin 2000), shërbejnë në masë të konsiderueshme për të barazpeshuar deficitin tregtar të Shqipërisë (rreth 820 mil usd).

[8] Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë, Raporti Statistikor. Të dhënat për vitin 2000.

[9] Burimi: HSBC Strategjitë e të ardhurave fikse të SHBA, Tetor 2001.

TENDENCA E INFLACIONIT NË SHQIPËRI GJATË DEKADËS SË KALUAR: NJË VËSHTRIM EMPIRIK

*Gramoz Kolasi**
Evelina Çeliku
Genti Hashorva

Fjalë kyçe
- Seri kohore - Indeksi i çmimeve të konsumit - Parashikimi i inflacionit - Përcaktuesit e inflacionit -

1. SERITË KOHORE DHE RËNDËSIA E STUDIMIT TË TYRE

Krijimi i serive kohore ose siç njihet ndryshe krijimi i bazës së të dhënave, përbën hallkën e parë në problematikën e studimit të serive kohore. Tashmë, shumica e serive kohore ka një histori më shumë se tetëvjeçare (duke filluar nga viti 1992), e cila përbën një bazë deri-diku të mirë për analizat dhe për përfundimet që do të nxirren nga këto analiza.

Siç do të shihet në vijim, seritë kohore të inflacionit dhe të treguesve të tjerë (me frekuencë mujore) duke e patur origjinën e tyre nga viti 1993, kanë tashmë rreth 93-94 terma, numër i mjaftueshëm për të arritur në përfundime të drejta. Qëllimi kryesor është që këto të dhëna të vihen në shërbim të analizës dhe të parashikimit të fenomenit ekonomik e financiar që merret në studim.

Një nga treguesit e rëndësishëm, për të cilin Banka e Shqipërisë është mjaft e interesuar që të ketë parashikime sa më realiste dhe të përqasura, është inflacioni. Ka disa kohë që qëllimin final të kryerjes së studimeve në sferën e parashikimit të inflacionit,

banka qendrore e ka fokusuar mbi: arritjen e zbatimit të regjimit të *inflation targeting* apo "inflacionit objektiv". Ashtu siç tregon përvoja e vendeve të tjera dhe rekomandimet e herëpashershme të misioneve të FMN, adoptimi i një regjimi të tillë realizohet nëpërmjet analizave të serive kohore dhe konkluzioneve që nxirren mbi këto analiza.

2. ECURIA E INFLACIONIT

Për të krijuar një ide më të qartë nga pikëpamja vizuale mbi sjelljen e shifrës së inflacionit në kohë, do të na vinin në ndihmë fillimisht, paraqitjet grafike 1 dhe 2, ku të dhënat që janë përdorur kanë frekuencë tremujore. Paraqitja grafike 1 merr parasysh shtrirjen e serisë së indeksit të çmimeve, përgjatë periudhës: tremujori i parë i vitit 1993 – tremujori i katërt i vitit 2000.

Një paraqitje e dytë na ndihmon të evidentojmë ecurinë e ndryshimeve tremujore të indeksit të çmimeve apo inflacionit tremujor (p-cpi), të shprehura në përqindje.

Grafik 1. Seria e IÇK-së nga tremujori i parë i vitit 1993 në tremujorin e tretë të vitit 2001.



Grafiku 2, na ndihmon të dallojmë në një pamje të parë, ekzistencën e sezonalitetit së bashku me komponenten e rastit që është e pranishme në çdo seri kohore.

Grafik 2. Seria e ndryshimeve tremujore të IÇK-së nga tremujori i parë i vitit 1993 në tremujorin e tretë të vitit 2001.

Nga pikëpamja analitike, do të ishte e nevojshme të matej efekti i secilit sezon (tremujor), pasi të jetë eliminuar komponentja e rastit. Modeli që do të përdoret është ai aditiv, sepse në serinë e ndryshimeve të inflacionit ka terma pozitivë dhe negativë. Seria e koeficientëve sezonalë, në rastin tonë përmban katër terma të cilët në varësi të shenjës, i shtohen apo i pakësohen përkatësisht për çdo tremujor nivelit të trendit.

Tabelë 1. Koeficientët sezonalë të serisë së inflacionit.

Sample: 1993:1 2001:4	
Included observations: 32	
Difference from Moving Average	
Original Series: P_CPI	
Adjusted Series: P_CPISA	
Scaling Factors:	
1	2.593065
2	-1.084623
3	-1.878914
4	0.370473

Nëse do të shënohej me c_cpi seria e ndryshimeve tremujore të inflacionit në përqindje, atëherë kjo do të paraqitej me ekuacionin:

$$p_cpi = T + S + R \qquad (1)$$

ku, T – trendi; S – përbërësja sezonale; R – përbërësja e rastit.

Për qëllime parashikimi, nevojitet një seri e zhveshur edhe nga sezonaliteti[1].

Kështu, eliminimi i përbërëses stinore, do të transformonte lidhjen (1) si më poshtë:

$$p_cpi = T + R \qquad (2)$$

Koeficientët e mësipërm, të njehsuar me anë të metodës aditive, tregojnë se tremujori i dytë dhe ai i tretë, ashtu siç edhe pritej, manifestojnë një tendencë në rënie të ritmeve të inflacionit (përgjatë periudhës prill-shtator). Tremujori i tretë është ai që mbart rëniet më të theksuara të çmimeve gjatë vitit. Ky fakt, shpjegohet edhe me strukturën e shportës së mallrave mbi të cilën llogaritet indeksi i çmimeve të konsumit (cpi), në të cilën, rreth 73 për qind[2], e përbën grupmalli "pije-ushqim-duhan".

Në këtë tremujor, veç importeve të këtyre produkteve (kryesisht fruta dhe perime), në treg shfaqen në mënyrë të konsiderueshme edhe prodhimet vendase, fakt që çon në uljen e çmimeve të këtyre produkteve.

Tremujori i parë dhe ai i katërt, karakterizohen nga rritjet e këtij treguesi. Sidoqoftë, tremujori me rritje më të theksuara, evidentohet i pari i çdo viti.

Grafik 3. Seria kohore e ndryshimeve tremujore të IÇK-së dhe IÇK-së të pastruar nga sezonaliteti.



Siç vihet re në grafik, luhatjet e shkaktuara nga efektet sezonale shfaqen në vitet e zhvillimit normal të ekonomisë ('95-'96 dhe pas gjysmës së dytë të vitit '97).

Në ekuacionin (2), që krijoi serinë e të dhënave të inflacionit të rregulluar nga ndikimet sezonale (c_cpisa), do të synohet që të pastrohen në maksimum të dhënat nga luhatjet e rastësishme.

Kjo arrihet me anë të metodës së mesatareve rrëshqitëse apo të sheshimit eksponencial.

Konkretisht mbi serinë p_cpisa, është zbatuar metoda e sheshimit apo parashikimit eksponencial, për të fituar përqasjen më të madhe me trendin e serisë. Theksojmë se metoda ofron eliminimin maksimal të mundshëm të përbërëses së çrregullt, por jo zhdukjen e plotë të ndikimeve të saj. Nëse ky eliminim do të arrihej plotësisht, atëherë do të kishim të bënim me një vijë ideale të trendit (Trend).

Grafik 4. Seria kohore e ndryshimeve tremujore të IÇK-së, të IÇK-së të zhveshur nga sezonaliteti dhe komponentja e rastit dhe vija ideale e trendit të serisë.



Sidoqoftë, megjithëse ideale, kjo vijë nuk është reale. Për pasojë, është e papërshtatshme për parashikime, sepse gjithmonë një seri kohore do t'i nënshtrohet ndikimeve të rastit, sado të parëndësishme që të jenë ato. Kjo, për faktin që të dhënat e serisë kohore, nuk janë krejtësisht të përcaktuara apo të varura vetëm nga variabli kohë.

Seria e të dhënave p_cpissm është tashmë e pastruar maksimalisht nga ndikimet e rastit. Përfundimisht, në ekuacion do të mbetet vetëm përbërësja e trendit.

p_cpi apo p_cpissm(t) = T (3)

Grafik 5. Seria kohore e ndryshimeve tremujore të CPI, të CPI të zhveshur nga sezonaliteti dhe komponentja e rastit.

Grafik 6. Seria kohore e ndryshimeve tremujore të CPI, të CPI të zhveshur nga sezonaliteti dhe seria pa sezonalitet dhe komponenten e rastit.



Paraqitjet grafike më sipër tregojnë në mënyrë vizuale se si është transformuar seria kohore e inflacionit (p_cpi), deri në rregullimin (pastrimin) më të mirë të mundshëm të saj nga përbërësit sezonalë dhe të rastit.

3. NJË SKENAR PËR PARASHIKIMIN E INFLACIONIT

Le të procedojmë në gjetjen e ekuacionit të trendit, pra me mënyrën se si variabli i varur p_cpissm, shpjegohet nga variabli i pavarur kohë. Për këtë, është e nevojshme të shtjellohen disa nga format e mundshme të varësisë së inflacionit të rregulluar nga koha, forma të cilat i sugjeron deri-diku edhe paraqitja grafike apo shtrirja në kohë e serisë p_cpissm.

Format e sugjeruara kërkojnë ndërtimin e tre modeleve, që shprehin varësinë e inflacionit të rregulluar nga koha në format: lineare, kuadratike dhe kubike.

Tabelë 2. Varësia lineare[3].

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	9.140330	0.859140	10.63893	0.0000
TIME	-0.263097	0.044092	-5.966956	0.0000
R-squared	0.534566	Mean dependent var		4.667684
Adjusted R-squared	0.519552	S.D. dependent var		3.479530
S.E. of regression	2.411813	Akaike info criterion		4.657326
Sum squared resid	180.3220	Schwarz criterion		4.748023
Log likelihood	-74.84588	F-statistic		35.60456
		Prob(F-statistic)		0.000001

Tabelë 3. Varësia kuadratike.

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	8.982488	1.361547	6.597268	0.0000
TIME	-0.236038	0.184632	-1.278426	0.2109
TIME*TIME	-0.000796	0.005268	-0.151070	0.8809
R-squared	0.534920	Mean dependent var		4.667684
Adjusted R-squared	0.503915	S.D. dependent var		3.479530
S.E. of regression	2.450748	Akaike info criterion		4.717172
Sum squared resid	180.1850	Schwarz criterion		4.853218
Log likelihood	-74.83333	F-statistic		17.25253
		Prob(F-statistic)		0.000010

Tabelë 4. Varësia kubike.

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	12.34452	1.741041	7.090310	0.0000
TIME	-1.341020	0.436872	-3.069593	0.0046
TIME*TIME	0.079253	0.029621	2.675581	0.0121
TIME*TIME*TIME	-0.001570	0.000573	-2.738279	0.0104
R-squared	0.630466	Mean dependent var		4.667684
Adjusted R-squared	0.592238	S.D. dependent var		3.479530
S.E. of regression	2.221896	Akaike info criterion		4.547811
Sum squared resid	143.1678	Schwarz criterion		4.729206
Log likelihood	-71.03889	F-statistic		16.49241
		Prob(F-statistic)		0.000002

Paraqitja grafike dhe analiza krahasuese e rezultateve të të tre regreseve më sipër dëshmojnë se, varësia më shpjeguese është ajo kubike. Koeficientët e regresit janë të kuptimtë. Këtë e tregojnë vlerat e statistikës së Studentit – t dhe probabilitetet përkatëse të tyre. Nga ana tjetër, këtë lloj modeli e mbështet koeficienti i përcaktueshmërisë, që në rastin e varësisë kubike merr një vlerë mbi mesataren e fuqisë shpjeguese dhe krahasuar me varësitë e tjera gjendet, në mënyrë të konsideruar, më lart se ato. Vlera e koeficientit të korrigjuar të përcaktueshmërisë (Adjusted R-squared) në rastin e varësisë kubike përmirësohet dukshëm, me rreth 10 pikë përqindjeje shpjegueshmëri më të mirë, të inflacionit të rregulluar nga variabli kohë.

Nëse do t'i referohemi edhe kritereve të tjera të testimit që ofron programi për zgjedhjen e modelit më të përshtatshëm, atëherë dy kriteret bazë "Akaike info criterion" dhe "Schwarz criterion", duke marrë vlerat minimale në modelin kubik përkatësisht (4.41 dhe 4.72), konfirmojnë edhe një herë, se modeli i alternuar (kubik) është ai më i përshtatshmi.

Në këtë mënyrë ekuacioni i trendit do të jetë:

$$p_cpissm(t) = 12.34 - 1.34*t + 0.08*t^2 - 0.0015*t^3 \ (*).$$

Në këtë model nëse i japim vlera të caktuara variablit kohë (t), atëherë rezultati do të tregonte vlerën e rregulluar të inflacionit (në mungesë të sezonalitetit dhe të rastësisë). Duke qenë se kërkohet një vlerë sa më reale e serisë do të duhej që në mënyrë të domosdoshme të merret në konsideratë ndikimi stinor, i cili rrit ose ul vlerën e rregulluar të serisë.

Në mënyrë të natyrshme një model i tillë mund të përdorej për të parashikuar ndryshimin tremujor të inflacionit, në varësi të faktorit kohë (modeli me *) dhe të atij sezonal. Kështu, do të kishim një rezultat që merr për bazë trendin (rregullsinë që fenomeni ka manifestuar përgjatë periudhës në studim) si edhe efektin stinor, nëse ai është i pranishëm.

Le ta ilustrojmë gjithçka u përshkrua më sipër me një parashikim vlerësues për ndryshimin e inflacionit, për tremujorin e dytë të vitit 2001.

Në këtë rast, vlera e variablit kohë do të jetë t = 34, pra nga fillimi i periudhës për të cilën disponohen të dhëna e deri në fund të saj (tremujori i parë i vitit 2001) kemi 33, kështu që në tremujorin e dytë të vitit 2001 që po përpiqemi të parashikojmë, vlera e variablit kohë do të jetë t+1, pra 34.

$$p_cpissm(34) = 12.34 - 1.34*(34) + 0.08*(34)^2 - 0.0015*(34)^3$$

$$p_cpissm(34) = 0.31$$

Vlera e gjetur e trendit, pa efektin stinor, rezulton 0.31 për qind. Ndërsa, duke patur parasysh ndikimin sezonal të tremujorit të dytë (-1.08), ndryshimi tremujor për periudhën (prill-qershor 2001) do të rezultojë –0.77 për qind, [0.31+(- 1.08)].

Vlera është mëse e pranueshme nëse i referohemi rezultateve statistikore të vlerësimeve të kryera paraprakisht, vlerësime të cilat kanë marrë parasysh vlerat reale të serisë së inflacionit për periudhën që përfshin tremujorin e parë të vitit 1993 e në vazhdim. Gjithashtu, edhe nëse vrojtohen periudhat e njëjta edhe për vitet paraardhëse, vite në të cilat vendi ka kaluar situata pothuajse normale, mund të kishim disa shifra të përafërta me vlerësimin (-0.77).

Për shembull:

- në tremujorin e dytë të vitit 1995 vlera e shpallur e inflacionit ishte rreth –0.65 për qind;
- në tremujorin e dytë të vitit 2000 vlera e shpallur e inflacionit ishte rreth –0.72 për qind.

Në tremujorin e dytë të vitit 2001, vlera e pritur e inflacionit do të duhej të ishte rreth shifrës – 0.72 për qind ndërkohë që, vlera e shpallur nga INSTAT kapi shifrën 0.38 për qind. Si do të shpjegohet kjo shmangie? Në fakt a do të quhet shmangie

derisa vlerësimi pa sezonalitetin është afërsisht i barabartë me 0.31 për qind, ndërkohë që shifra e shpallur e inflacionit për këtë tremujor ka rezultuar afro 0.38 për qind? Në fund të fundit në këtë diagnostikim të kryer, a kemi të drejtë të gjykojmë se efektet sezonale kanë qenë pothuajse të papërfillshme dhe përse?

Shmangia mund të jetë shkaktuar nga ekzistenca e një vargu problemesh:

së pari, modeli merr parasysh vetëm varësinë e inflacionit nga variabli kohë;

së dyti, efektet sezonale mund të kenë qenë shumë të zbutura, pra të mos kenë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në rënien e çmimeve për tremujorin e dytë të vitit 2001. Zakonisht në këtë periudhë ka një ulje të ndjeshme të çmimeve në produktet fruta-perime, për shkak të efektit sezonal. Situata e ashpërsuar në rajon, konflikti në Maqedoni, shkaktoi një rënie të ndjeshme të importeve të produkteve ushqimore (fruta, perime dhe drithëra) përbërës të rëndësishëm të shportës, që njëkohësisht ndjejnë edhe ndryshime sezonale. Rënia e importeve të këtyre produkteve nga Maqedonia, që konsiderohet si një nga eksportuesit kryesorë të këtyre mallrave, vlerësohet të ketë shkaktuar deri-diku, një rënie të konsiderueshme të ofertës në treg, fakt që ka implikuar rritjen e çmimeve për këto produkte, të kërkuara nga konsumatorët. Kështu, indeksi i grupmallit fruta-perime, pësoi një rritje vjetore prej 18.6 për qind, veçanërisht frutat shënuan një rritje vjetore prej 6.7 për qind dhe perimet prej 35 për qind. Kështu, zëri ushqim-pije-duhan për tremujorin e dytë 2001 shënoi një rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, prej afro 5.1 për qind (INSTAT);

së treti, megjithëse metoda e përdorur ka mënjanuar maksimalisht ndërhyrjen e rastësisë në model, kjo nuk do të thotë që ky mënjanim ka qenë i plotë. Komponenti i rastit është gjithmonë i pranishëm në seritë kohore dhe pa dyshim që do të përçojë devijime, qoftë edhe të vogla, nga të dhënat reale.

Duhet theksuar se, nuk është vetëm variabli kohë (tendencat e shkuara) dhe efekti sezonal, që ndihmojnë në procesin e një parashikimi, relativisht të saktë, të inflacionit në të ardhmen. Faktori kohë jep vetëm një prirje të tij. Është tashmë e njohur dhe e provuar se edhe ngjarjet politike, ndikojnë në nivelet e inflacionit, sidomos në kahun rritës. Në shumë vende të botës, kryesisht të zhvilluara, nuk përjashtohet mundësia e një ndikimi të tillë.

4. NDIKIMI I NGJARJEVE POLITIKE NË INFLACION

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit vendi ynë është ballafaquar me situata të veçanta, që lidhen në mënyrë të pashmangshme me ngjarjet politike. Ndër këto ngjarje mund të përmendim fushatat e ndryshme elektorale (zgjedhjet parlamentare, lokale apo referendumet e ndryshme) dhe shumë evenimente të tjera politike. Mendimi i specialistëve është se, pavarësisht intensitetit me të cilin janë zhvilluar, ato nuk kanë ndikuar në mënyrë të dukshme në tregues të rëndësishëm ekonomikë, kryesisht në inflacion.

Duke përjashtuar gjysmën e parë të vitit 1997, periudhë në të cilën ekonomia u përball me fenomenin e rënies së veprimtarisë së firmave piramidale, në shumicën e rasteve të tjera, sistemi imunitar ndaj zhvillimeve politike, duket se ka funksionuar dhe ndikimet e tyre mund të konsiderohen të çastit dhe të parëndësishme në veçanti për inflacionin. Ecuria e inflacionit e dëshmon këtë fakt.

Më poshtë, do të paraqesim një përpjekje tonën, që shpjegon se ndryshimet në inflacion para dhe pas ngjarjeve politike, nuk kanë qenë statistikisht të rëndësishme. Në këtë mënyrë, metodat analitike të përdorura verifikojnë hipotezat e ngritura më lart nga specialistët.

Për të kryer një analizë sa më të bazuar, gjykojmë se seria kohore e inflacionit, e marrë në studim, duhet të ketë frekuencë mujore (ndryshimet nga njëri muaj në tjetrin). Kjo zgjedhje

bazohet në faktin se, në përgjithësi, interesohemi nëse dallojmë ndryshime të rëndësishme të inflacionit dy muaj para dhe pas ngjarjes politike, pra, në total, marrim parasysh pesë muaj, ku është përfshirë edhe muaji në të cilin ka patur ngjarje politike apo në të cilin ngjarja ka arritur kulmin. Për serinë mujore të inflacionit duhet të ndiqen po ato etapa të shpjeguara tashmë më parë, për gjetjen e ekuacionit të tendencës.

Më pas, në këtë model do të ndërhyjnë në mënyrë të njëpasnjëshme periudhat kohore që nënkuptojnë brenda vetes ngjarjet politike. Për të modeluar këto ndërhyrje vijnë në ndihmë variablat cilësorë apo indikatorë (dummy). Modelimi dhe njehsimi i këtyre ndikimeve në inflacion, arrihet me marrëveshjen se kur:

variabli dummy = 1, vlerat e serisë i përkasin periudhës së ngjarjes politike;

variabli dummy = 0, vlerat e serisë nuk i përkasin periudhës së ngjarjes politike, por pjesës tjetër të periudhës.

Paraqitja e të dhënave mujore të inflacionit, tregon se në këtë seri janë të pranishme si përbërësja e trendit ashtu edhe ajo sezonale, pa përjashtuar përbërësen e çrregullt (të rastit).

Grafik 7. Seria kohore e ndryshimeve mujore të IÇK-së.





Paraqitja më sipër përforcon më tepër idenë se në serinë mujore të inflacionit, varësia ndërmjet inflacionit dhe kohës është e rendit të tretë. Kjo do të thotë që, ekuacioni i trendit është i formës kubike.

Tabelë 4. Varësia kubike.

Dependent Variable: CPI_MUSM				
Method: Least Squares				
Sample(adjusted): 1992:01 2001:05				
Included observations: 113 after adjusting endpoints				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	10.71643	0.411305	26.05472	0.0000
TIME	-0.514910	0.031108	-16.55220	0.0000
TIME*TIME	0.008143	0.000633	12.87324	0.0000
TIME*TIME*TIME	-4.06E-05	3.65E-06	-11.11469	0.0000
R-squared	0.854112	Mean dependent var		1.600844
Adjusted R-squared	0.850097	S.D. dependent var		2.730014
S.E. of regression	1.056987	Akaike info criterion		2.983479
Sum squared resid	121.7772	Schwarz criterion		3.080024
Log likelihood	-164.5666	F-statistic		212.7169
Prob(F-statistic)	0.000000			

Këto rezultate tregojnë se regresi që shpjegon lidhjen e inflacionit me kohën në formën kubike, është në tërësi statistikisht i rëndësishëm. Koeficientët e regresit janë plotësisht të rëndësishëm dhe madje në nivele të larta besueshmërie. Po kështu, edhe koeficienti i përcaktueshmërisë është i lartë dhe i rëndësishëm statistikisht. Ekuacioni i trendit (pa sezonalitetin) do të jetë:

$$cpi_musm = 10.72 - 0.52 * time + 0.008\ time^2 - 4.06E\text{-}05\ time.$$

Në këtë ekuacion, mund të ndërhyjnë tashmë variablat cilësorë në mënyrë të njëpasnjëshme, sipas periudhave kohore që ata përfaqësojnë, nga janari i vitit 1992 deri në dhjetor të vitit 2000.

Tabelë 5. Varësia kubike dhe variablat cilësorë (dummy).

Dependent Variable: CPI_MUSM				
Method: Least Squares				
Sample: 1992:01 2001:05				
Included observations: 113				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	9.721167	0.627728	15.48626	0.0000
TIME	-0.461565	0.041930	-11.00798	0.0000
TIME*TIME	0.007172	0.000776	9.245203	0.0000
TIME*TIME*TIME	-3.51E-05	4.22E-06	-8.330145	0.0000
DUMMY92	1.279724	0.531025	2.409913	0.0177
DUMMY94	-0.590168	0.406905	-1.450382	0.1500
DUMMY96	0.585665	0.307602	1.903967	0.0597
DUMMY97	2.434477	0.406164	5.993829	0.0000
DUMMY98	-0.664394	0.414841	-1.601563	0.1123
DUMMY99	-1.372991	0.413034	-3.324158	0.0012
DUMMY00	0.037030	0.435231	0.085080	0.9324
R-squared	0.916038	Mean dependent var		1.600844
Adjusted R-squared	0.907806	S.D. dependent var		2.730014
S.E. of regression	0.828925	Akaike info criterion		2.554902
Sum squared resid	70.08597	Schwarz criterion		2.820400
Log likelihood	-133.3520	F-statistic		111.2834
Durbin-Watson stat	0.555027	Prob(F-statistic)		0.000000

Rezultatet tregojnë se, në përgjithësi, ngjarjet politike veçanërisht situatat para dhe paszgjedhore si edhe referendumet, nuk ndikojnë në mënyrë të rëndësishme tek ndryshimet në inflacion. Koeficientët rezultojnë statistikisht të parëndësishëm (vlerat e statistikës-t të shpërndarjes së studentit nuk verifikojnë rëndësinë statistikore të koeficientëve të regresit).

E kundërta ndodh me situatat e tensionuara në të cilat ka kaluar vendi në përgjithësi dhe ekonomia shqiptare në veçanti. Konkretisht, bëhet fjalë për krizën e vitit 1997 si edhe atë të Kosovës në pranverën e vitit 1999. Konstatohet dhe verifikohet statistikisht se këto dy situata tepër të vështira, ndikuan në mënyrë të rëndësishme tek ndryshimet në inflacion. Situata e vitit 1997, shënoi rritje të konsiderueshme në inflacionin mujor. Ndërsa ajo

e krizës së Kosovës në tërësi shënoi rënie të tij, ndoshta edhe për shkak të ardhjes së flukseve të mëdha të ndihmave, që deri-diku shkaktuan edhe rënie çmimesh të produkteve kryesore të shportës.

5. NDIKIMI I KURSIT TË KËMBIMIT NË INFLACION

Një nga faktorët e rëndësishëm, që vlerësohet të ndikojë në vlerat e ardhme të serisë së inflacionit, pra në inflacionin e pritshëm, është edhe kursi i këmbimit.

Për sa kohë që ai është një tregues, ndaj ndryshimeve të të cilit ndjeshmëria e përgjithshme e publikut, e biznesit, e bankave është e madhe, mendojmë se trajtimi i tij duhet bërë me kujdes. Vetë fakti që, pjesa më e madhe këmbimeve tregtare përbëhet nga importet, të cilat vlerësohen të jenë më shumë se sa trefishi i eksporteve, tregon se, në përgjithësi, ekonomia së pari, është e lidhur ndjeshëm me kursin e këmbimit. Së dyti, ndryshimet në kurset e këmbimit ndikojnë tek çmimet e mallrave të konsumit, fakt që reflektohet në mënyrë logjike edhe në ndryshimet në nivelet e inflacionit.

Grafik 9. Seria kohore e ndryshimeve mujore të kursit të këmbimit të dollarit dhe të CPI.

Shihet qartë edhe në grafikun 9, se ndryshimet në kursin e dollarit përçohen me rreth 1 muaj vonesë tek treguesi i inflacionit.

Treguesit e kursit dhe të inflacionit janë të shprehur në ndryshime mujore, në përqindje në trajtë zinxhir.

Mbiçmimi i lidhjes së inflacionit me kursin e këmbimit të dollarit do të jepet në bazë të kësaj logjike. Si variabla shpjegues për ndryshimet në inflacion do të jenë:

- inflacioni i një periudhe më parë;
- kursi i këmbimit të dollarit të një periudhe më parë (lekë/ dollarë amerikanë).

Gjatë procesit të diagnostikimit të një grupi modelesh (ndërhyrja e disa variablave të mundshëm dhe me hapa vonese të ndryshme (*lag*)) u konstatua se dy nga variablat më të përshtatshëm janë variablat e lartpërmendur.

Ekonomikisht dhe teorikisht, ky fakt qëndron. Inflacioni aktual është shumë i lidhur me atë të një periudhe më parë dhe me kursin e këmbimit me po këtë vonesë. Pra, e rëndësishme është të kuptohet që efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit reflektohen tek inflacioni, një periudhë më vonë.

Tabelë 6. Varësia e inflacionit nga kursi i këmbimit.

Dependent Variable: CPI_MUSM				
Method: Least Squares				
Sample(adjusted): 1993:04 2001:05				
Included observations: 98 after adjusting endpoints				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	0.023012	0.059212	0.388644	0.6984
CPI_MUSM(-1)	0.858569	0.041515	20.68097	0.0000
C_USD(-1)	0.060984	0.013997	4.356909	0.0000
R-squared	0.820023	Mean dependent var		0.654973
Adjusted R-squared	0.816234	S.D. dependent var		1.172826
S.E. of regression	0.502766	Akaike info criterion		1.492750
Sum squared resid	24.01350	Schwarz criterion		1.571882
Log likelihood	-70.14476	F-statistic		216.4228
Durbin-Watson stat	1.933047	Prob(F-statistic)		0.000000

Siç vërehet, të dy variablat shpjegues janë statistikisht të rëndësishëm dhe për më tepër mbështesin teorinë ekonomike. Ndryshimet në inflacionin e periudhës përkatëse, ndjekin të njëjtën tendencë si edhe ndryshimet në kursin e këmbimit të

dollarit amerikan të një periudhe më parë. Po kështu ndodh edhe me inflacionin e një periudhe më parë. Nga modeli rezulton se ai është po aq vendimtar sa edhe kursi i këmbimit të dollarit tek inflacioni aktual. Vonesa prej një muaji justifikohet me faktin se janë zhvillimet paraprake në variablat shpjegues, të cilat parapërgatitin terrenin e ecurisë së inflacionit në të ardhmen e afërt.

Kurset e këmbimit të monedhave të tjera (nënfishave të euros), nuk janë shpjeguese të rëndësishme statistikisht, të ecurisë së inflacionit në mënyrë direkte, por në përpjekje të mëtejshme do të na duhet të provojmë lidhjen e tij me variabla indirektë si për shembull, me REER.

Modeli më sipër përjashton edhe kursin aktual të këmbimit të dollarit. Ai del i pakorreluar me inflacionin e të njëjtës periudhë (aktuale). Atij i duhet rreth një muaj që të shfaqë efekte inflacioniste në ekonomi.

Rëndësia e përgjithshme e modelit (pra që të dy variablat janë të rëndësishëm njëkohësisht) dështmohet me vlerat e larta të koeficientit të rregulluar të përcaktueshmërisë. Ai tregon se rreth 82 për qind e variancës së inflacionit shpjegohet nga prania në model e dy variablave me vonesë negative një.

Nga ana tjetër, në këtë model mungon multikolineariteti, pra lidhja ndërmjet dy variablave shpjegues. Rezultatet analitike dhe grafike e mbështesin mungesën e plotë të kolinearitetit të variablave shpjegues. Kjo do të thotë që vlera e koeficientit të përcaktueshmërisë, afër 82 përqindëshit, është reale dhe i dedikohet vetëm variablave shpjegues.

Tabelë 7. Matrica e korrelacionit.

Korrelacioni	CPI_MUSM(-1)	C_USD(-1)
CPI_MUSM(-1)	1.000000	-0.101578
C_USD(-1)	-0.101578	1.000000

Grafik 10. Varësia e ndryshimit mujor të kursit të këmbimit të usd dhe inflacionit mujor.



6. PERIUDHAT E MBIÇMIMIT DHE NËNÇMIMIT TË MONEDHËS VENDASE DHE NDIKIMI I TYRE NË INFLACION

Natyrshëm lind pyetja: A është një sojë përcaktues kursi i këmbimit të dollarit amerikan (lekë/usd) si në periudhat e mbiçmimit ashtu edhe në ato të nënçmimit të monedhës vendase (lekut).

Tabelë 8. Periudha e mbiçmimit.

Dependent Variable: CPI_MUSM				
Method: Least Squares				
Sample: 1996:02 1996:10 1997:09 1999:03				
Included observations: 28				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	0.010998	0.083064	-0.0.132399	0.8957
CPI_MUSM(-1)	0.933176	0.071594	13.03436	0.0000
C_USD(-1)	0.024831	0.017993	1.380016	0.1798
R-squared	0.873412	Mean dependent var		0.829776
Adjusted R-squared	0.863285	S.D. dependent var		0.782471
S.E. of regression	0.289319	Akaike info criterion		0.458382
Sum squared resid	2.092635	Schwarz criterion		0.601118
Log likelihood	-3.417352	F-statistic		86.24546
Durbin-Watson stat	1.396050	Prob(F-statistic)		0.000000

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, *së pari* duhet të vrojtohen periudhat më të rëndësishme që i përkasin mbiçmimit dhe nënçmimit të lekut dhe *së dyti*, duke marrë si të mirëqenë lidhjen tashmë të përcaktuar në modelin e këtij seksioni, rezultatet e

të cilit janë paraqitur në tabelën 6, do të realizohet modelimi vetëm duke modifikuar periudhat, që evidentojnë në mënyrë më të dukshme fenomenet e mbiçmimit dhe të nënçmimit të monedhës vendase.

Si periudha në të cilat mund të evidentohet tendenca e mbiçmimit e monedhës vendase, duke vrojtuar të dhënat mujore janë gjykuar: 1996:02 deri 1996:10 dhe 1997:09 deri 1999:03. Ndërsa, si periudha në të cilat mund të evidentohet tendenca e nënçmimit të monedhës vendase, janë gjykuar: 1995:01 deri 1996:02; 1996:10 deri 1997:07 dhe 1999:03 deri 2000:12.

Rezultatet e regresit të kryer për të dy fenomenet në veçanti, dëshmojnë për faktin e pritshëm teorikisht dhe praktikisht: fenomeni i mbiçmimit tregon se lidhja midis inflacionit dhe kursit të këmbimit është statistikisht e parëndësishme, ndërkohë që, në periudhat e nënçmimit ndodh e kundërta, kjo lidhje është plotësisht e rëndësishme, për nivele të larta besueshmërie, fakt që tregon se faktori spekulativ është i fuqishëm.

Tabelë 9. Periudha e nënçmimit.

Dependent Variable: CPI_MUSM				
Method: Least Squares				
Sample: 1995:01 1996:02 1996:10 1997:07 1999:03 2000:12				
Included observations: 46				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-0.071310	0.071487	-0.997528	0.3241
CPI_MUSM(-1)	0.785848	0.072664	10.81477	0.0000
C_USD(-1)	0.090192	0.017479	5.159986	0.0000
R-squared	0.828191	Mean dependent var		0.127665
Adjusted R-squared	0.820200	S.D. dependent var		1.081515
S.E. of regression	0.458593	Akaike info criterion		1.341688
Sum squared resid	9.043240	Schwarz criterion		1.460947
Log likelihood	-27.85882	F-statistic		103.6388
Durbin-Watson stat	2.405156	Prob(F-statistic)		0.000000

7. DISA KONKLUZIONE DHE PROBLEME

1. Studimi i sjelljes së inflacionit në kohë dëshmon se rruga për të arritur në parashikimin e tij nuk është e lehtë. Një nga problemet që vlen të merret parasysh në ndërtimin e modeleve shpjeguese dhe parashikuese, është jetëgjatësia e serive.

Megjithëse, në fillim të këtij artikulli është dhënë një vlerësim relativisht pozitiv në drejtim të madhësisë së serive kohore shqiptare, do të vlerësohej se në përgjithësi seritë e treguesve makroekonomikë, mund të konsiderohen seri të një moshe "të re". Në këtë aspekt, edhe seria e inflacionit që përbën objektin e këtij studimi, e vuan këtë problem. Për më tepër, është një seri që përmes traumave që ka kaluar ekonomia shqiptare ka pësuar tronditjet më të mëdha. Ky fakt e ka kthyer atë në një seri me ndërprerje. Kjo është njëra nga arsyet që studimi i ecurisë së inflacionit, që normalisht do të vihet në shërbim të gjetjes së modeleve parashikuese për të, të kryhet mbi serinë e gjeneruar nga ndryshimet mujore apo tremujore të IÇK-së. Kjo gjetje bën që seritë kohore të inflacionit dhe të variablave që do ta shpjegojnë atë (kursi i këmbimit të dollarit amerikan), të kthehen në seri stacionare apo të qëndrueshme, pra të përshtatshme për analiza dhe parashikime.

Skenari i propozuar që studion ecurinë e inflacionit në kohë, jo vetëm që pasqyron trendin e tij, por nga ana tjetër mund të përdoret për parashikime. Megjithë forcën e mirë shpjeguese të tij, ky skenar paraqet disa probleme që lidhen me faktin se:

- modeli (skenari), pasqyron vetëm varësinë e inflacionit nga variabli kohë: kjo do të thotë që ai nuk merr parasysh treguesit e tjerë makroekonomikë dhe socialë, të cilët kanë ndikim të padiskutueshëm mbi inflacionin. Megjithatë, qëllimi i ndërtimit të një skenari të tillë, i shërben më shumë gjetjes së trendit kryesor për inflacionin dhe si i tillë, ai përmbush më së miri cilësitë e një modeli "të mirë";

- problemi tjetër, i cili në njëfarë mënyre varet nga ai paraardhës, lidhet me faktin se sa gjatë mund të parashikojë ky model, pra sa larg sheh ai në kohë. Teorikisht, me anë të tij mund të parashikohet mjaft larg, aq larg sa edhe lejon vargu i numrave natyrorë, pra në pafundësi. Praktikisht, kjo mënyrë parashikimi del jashtë realitetit sa më shumë i largohemi vlerave të faktuara (publikuara). Kjo është arsyeja që ky model ndihmon më shumë për parashikime afatshkurtra dhe, parë me disa rezerva, edhe afatmesme.

2. Gjatë dekadës së fundit, vendi dhe ekonomia janë ndeshur me ngjarje politike që kanë lënë gjurmë edhe në treguesin e inflacionit. Por cilat prej tyre më veçanërisht "e kanë goditur", në mënyrë më të konsiderueshme atë?

Prezantimi i rezultateve të modelit që studion këtë fenomen tregon se janë situatat tepër të tensionuara në të cilat ka kaluar vendi dhe ekonomia shqiptare në veçanti, që kanë shkaktuar tronditje (ndryshime) statistikisht të rëndësishme tek inflacioni. Konkretisht, bëhet fjalë për krizën e vitit 1997 si edhe atë të Kosovës në pranverën e vitit 1999, ndërsa situatat e tjera si periudha elektorale apo referendume nuk kanë shkaktuar ndikime të tilla. Rëndësia e kësaj gjetjeje qëndron në faktin se në modelimet e ardhshme është e arsyeshme që këto periudha të përjashtohen (kryesisht pranvera e vitit 1997), sepse përfaqësojnë periudha *shock,* si të tilla deformojnë parashikimet dhe analizat.

3. Inflacioni është një tregues mjaft i lidhur me kursin e këmbimit në tërësi dhe në veçanti me kursin e këmbimit të dollarit amerikan. Verifikohet se fuqia shpjeguese e kursit të këmbimit të monedhës amerikane është shumë herë më e lartë se sa ajo e monedhave evropiane, nënfisha të euros.

Një nga problemet e ndeshura në ndërtimin e modelit ka qenë zgjedhja e hapit të vonesës (*Lag*). Modeli ka dhënë rezultate të besueshme për lag=(-1), por praktika e ndërtimit të modeleve të tilla në përgjithësi, njeh *Lag* më të madh. Në rastin e realitetit shqiptar ndjeshmëria ndaj ndryshimeve të kursit të këmbimit të dollarit amerikan është shumë më e shpejtë tek inflacioni, ajo shfaqet një muaj më vonë.

4. Fenomeni i mbiçmimit të monedhës vendase tregon se lidhja midis inflacionit dhe kursit të këmbimit është statistikisht e parëndësishme, ndërkohë që, në periudhat e nënçmimit të saj ndodh e kundërta, kjo lidhje është plotësisht e rëndësishme, për nivele të larta besueshmërie. Në fakt rastet e periudhave të mbiçmimeve të forta të monedhës vendase duhet të gjenerojnë ulje të inflacionit dhe kjo lidhje normalisht duhet të rezultonte

e rëndësishme, gjë që të dhënat tona nuk e verifikojnë. Ky fakt konfirmon natyrën e tregut tonë, i cili nuk është një rregullator i çmimeve në kahun zbritës, pra ku elementi spekulativ është mjaft i fuqishëm.

5. Rregullimi sezonal dhe sheshimi i serive, tashmë përbën një kërkesë mjaft të rëndësishme dhe që, normalisht, duhet zbatuar në studime të këtyre llojeve. Kjo kërkesë, për arsyet e shpjeguara përgjatë materialit, është zbatuar në të gjithë variablat (endogjenë dhe ekzogjenë), të këtij materiali. Për më tepër, që vetë standardet e statistikave evropiane, janë tepër kërkuese në zbatimin e një rregullimi sezonal të serive kohore, sepse si të tilla ato janë të krahasueshme në kohë dhe në hapësirë.

Problemet e trajtuara më sipër, tregojnë se studimi i inflacionit, sjelljes së tij dhe përcaktuesve kryesorë, është një rrugë e gjatë, përmes së cilës synohet drejt modeleve me fuqi shpjeguese dhe parashikuese të lartë. Studimi i prezantuar më lart përbën një përpjekje për të sqaruar vetëm disa momente të rëndësishme të sjelljes së tij dhe shpjegimin e tyre në mënyrë empirike. Ndërkohë që ai do të pasohet me prezantimin e modeleve që me modesti do të quheshin të tilla dhe që do të ndihmojnë bankën qendrore për parashikimin e tij, fillimisht për periudha afatshkurtra.

ANEKSI 1

Shpjegues i tabelave të rezultateve të regresit të dala nga programi Eviews 4.0.

Sample = madhësia e zgjedhjes në shtrirje kohore.
Variable = Variablat e varur.
Coefficient = Koeficientët e regresit.
Std. Error = Gabimet standarde.
t-Statistic = Statistika e Studentit (vlera e testit).
Prob. = Probabiliteti i pranimit të hipotezës bazë të rëndësisë së koeficientëve të regresit.
R-squared = Koeficienti i përcaktueshmërisë.
Adjusted R-squared = Koeficienti i rregulluar i përcaktueshmërisë.
S.E. of regression = Devijimi standard i regresit.
Sum squared resid = Shuma e katrorëve të mbetjeve.
Log likelihood = Përqasja maksimale.
Durbin-Watson stat = Statistika Durbin-Watson (test për autokorelacionin).
Mean dependent var = Mesatarja e variablit të varur (endogjen).
S.D. dependent var = Devijimi standard i variablit të varur.
Akaike info criterion = Kriter statistikor (test) për zgjedhjen e modelit.
Schwarz criterion = Kriter statistikor (test) për zgjedhjen e modelit.
F-statistic = Kriteri i Fisherit për rëndësinë e përgjithshme të regresit.
Prob(F-statistic) = Probabiliteti për kriterin e Fisherit.

ANEKS 2

Periudhat e shprehura me variabla cilësorë (dummy) në model janë si më poshtë:

DUMMY92 - përfshin periudhën janar '92 – shtator '92.
DUMMY94 - përfshin periudhën gusht '94 – dhjetor '94.
DUMMY96 - përfshin periudhën mars '96 – dhjetor '96.
DUMMY97 - përfshin periudhën prill '97 – gusht '97.
DUMMY98 - përfshin periudhën shtator '98 – janar '99.
DUMMY99 - përfshin periudhën mars '99 – korrik '97.
DUMMY00 - përfshin periudhën gusht '00 – dhjetor '00.

SHËNIME

* Gramoz Kolasi, Zëvendësdrejtor i Departamentit të Kërkimeve.
Evelina Çeliku, specialiste, Departamenti i Kërkimeve.
Genti Hashorva, specialist, Departamenti i Kërkimeve.

[1] Pastrimi i serive kohore nga sezonaliteti dhe nga përbërësja e rastit, arrihet nëpërmjet metodave statistikore, të përfshira në programe speciale si për shembull, EViews, SPSS, SAS etj.. Në këtë material të gjitha përpunimet analitike dhe grafike janë kryer me anë të programit Eviews 4.0.

[2] Nga vrojtimi i buxhetit të familjes, në vitin 2000, grupi "ushqim-pije –duhan", ka rezultuar të zërë një peshë prej afro 58 për qind të konsumit në buxhetin e familjeve shqiptare.

[3] Në aneksin 1 të këtij artikulli, gjenden përkthimet e termave (treguesve) statistikorë. Tabelat përgjatë gjithë artikullit, meqë përfaqësojnë produkte statistikore të vlerësimeve të regreseve, janë lënë në formën dhe përmbajten e prodhuar nga programi Eviews 4.0.

BIBLIOGRAFIA

Amir D. Aczel (1989), Complete Business Statistics, Yale University Press, Boston, U.S.A.

Barro R. (1995), "Inflation and economic growth", Bank of England Quarterly Buletin, May.

Bernake B., Laubach T., Mishkin F. and Posen A. (1999), Inflation Targeting: Lessons from the International Experience, Princeton, New Jersey: Princeton University Press.

Fisher S. (1994), "The role of macroeconomics factors in growth", Journal of Monetary Economics, Vol. 32, pp 485 – 512.

Friedman M.(1960), A Programme for Monetary Stability, New York: Fordham University Press.

Green H. William., (1997), Econometrics Analysis, Prentice – Hall, New Jersey, U.S.A.

Green J. (1976), "Inflation targeting: Theory and policy implications", IMF Staff Papers, Vol. 43, No. 4, December 1996.

Kolasi G., (2000), "Regjimet e politikës monetare dhe prirja e Bankës së Shqipërisë", Buletini Ekonomik, v.3, nr. 4, dhjetor 2000, Banka e Shqipërisë.

Kunst R., Luniku R. (1998), "Inflation, its dynamics and its possible causes in Albania", Institute for Advanced Studies, Vienna, WP, No. 57.

Mytkolli H., Hadëri S. "Inflacioni në Shqipëri – Burimet, prirjet aktuale dhe ato të perspektivës", Ekonomia dhe Biznesi, Buletini Nr.4, Fakulteti Ekonomik.

Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë, Viti 1992 – 2000.

INSTRUMENTET INDIREKTE TË POLITIKËS MONETARE

*Sonila Taçi**

Fjalë kyçe
- Politika monetare - Instrumente indirekte - Operacionet e tregut të hapur - Rezerva e detyrueshme - Instrumentet mbështetëse -

Instrumentet e politikës monetare kanë lindur e janë zhvilluar bashkë me krijimin, zhvillimin e konsolidimin institucional të Bankës së Shqipërisë, për t'i dhënë jetë rolit të saj si hartuese e më tej si zbatuese të politikës monetare në vend, në funksion të objektivit parësor të saj, atij të stabilitetit të çmimeve.

Zhvillimi i instrumenteve të politikës monetare, shtrirë në një periudhë rreth nëntëvjeçare, ka kaluar nëpër disa etapa të kushtëzuara këto nga niveli i zhvillimit të Bankës së Shqipërisë si politikëbërëse, i sistemit bankar dhe i ekonomisë shqiptare në tërësi. Siç është pasqyruar në shumë studime ndërkombëtare mbi politikën monetare dhe instrumentet e zbatimit të saj, në fazat e hershme të zhvillimit, politika monetare e një vendi është zbatuar nëpërmjet instrumenteve direkte të saj e më pas, gradualisht e në funksion të zhvillimit e përparimit ekonomik të vendit, të politikave të tij ekonomike, të zhvillimit të tregjeve financiare, të lindjes e krijimit të institucioneve të reja financiare, të njohjes së vazhdueshme të instrumenteve të reja financiare, është kaluar në të ashtuquajturat instrumente indirekte të politikës monetare. Të njëjtën rrugë zhvillimi kanë përshkuar instrumentet e politikës monetare në Bankën e Shqipërisë, duke kaluar nëpër katër etapa, sipas njohjes dhe përdorimit të tyre:

- zbatim i politikës monetare vetëm me instrumente direkte;
- njohja e disa prej instrumenteve indirekte;
- zbatim i politikës monetare me kombinimin e instrumenteve direkte dhe indirekte;
- së fundmi, lënia mënjanë e instrumenteve direkte dhe zbatimi i politikës monetare, duke përdorur vetëm instrumentet indirekte.

Në etapat e ndryshme të këtij procesi zhvillimi, përdorimi i njërit apo tjetrit tip instrumenti ka patur përmasa të ndryshme dhe është bërë në funksion të plotë të politikës monetare dhe të objektivave të saj afatshkurtër dhe afatmesëm, brenda kufijve të lejuar nga zhvillimi i ekonomisë shqiptare dhe institucioneve të saj.

Në pjesën e parë të këtij materiali përmenden dallimet që ekzistojnë midis instrumenteve direkte dhe indirekte. Në pjesën e dytë, i kushtohet vëmendje fazës së tranzicionit nga instrumentet direkte në ato indirekte si dhe argumentohet zbatimi i politikës monetare, mbështetur tërësisht në instrumentet indirekte të saj. Ndërsa, në të tretën bëhet një përshkrim i thjeshtë por i detajuar i gjithë gamës së instrumenteve, aktualisht të përdorshme nga Banka e Shqipërisë dhe sistemi bankar shqiptar.

PJESA E PARË

INSTRUMENTET DIREKTE DHE INDIREKTE TË POLITIKËS MONETARE. DALLIMI MIDIS TYRE

Banka e Shqipërisë është banka e qendrore e vendit. Nëpërmjet politikave të saj dhe në funksion të detyrave që i përcakton ligji "Për Bankën e Shqipërisë" ajo bën përpjekje për arritjen e objektivit themelor: ruajtjen e stabilitetit të çmimeve ose siç jemi mësuar të gjithë ta dëgjojmë, kontrollin e nivelit të inflacionit. Përpara se të hartojë me saktësi politikat që duhet të ndjekë, Banka e Shqipërisë përkufizon objektivat finalë, objektivat e ndërmjetëm dhe instrumentet me të cilat do të operojë për arritjen e objektivave.

Ajo, me anë të politikave të saj dëshiron të arrijë disa objektiva si për shembull, të kontrollojë inflacionin, të nxisë rritjen ekonomike në vend apo të arrijë të ketë një bilanc të ekuilibruar pagesash. Megjithatë, ajo nuk mund të kontrollojë direkt këta objektiva. Në këtë proces, Banka e Shqipërisë formulon objektiva të ndërmjetëm, të tillë si rritja e ofertës së parasë (agregatët monetarë). Këta, me anë të sjelljes së tyre, ndikojnë direkt objektivat finalë. Meqenëse dhe këta objektiva të ndërmjetëm nuk janë plotësisht të kontrollueshëm nga Banka e Shqipërisë, ajo përcakton disa objektiva operacionalë, të tillë si rritja e bazës monetare, të cilët janë të kontrollueshëm, mund të rriten apo zvogëlohen nga instrumentet e përzgjedhura për zbatimin e politikës së saj.

Ç'kuptojmë me instrumente të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë?

Instrumentet përfaqësojnë ato mjete apo mekanizma, me anë të të cilave Banka e Shqipërisë ndërhyn në marrëdhëniet e saj me bankat e nivelit të dytë, për të siguruar që kushtet e tregut dhe niveli i parasë në ekonomi të jenë në përputhje me objektivin final të saj – kontrolli i nivelit të çmimeve dhe rritja ekonomike.

Për zbatimin e politikës së saj monetare, një bankë qendrore mund të veprojë në dy mënyra: direkt, nëpërmjet fuqisë së saj rregullatore ose indirekt, nëpërmjet ndikimit të saj në tregun e parasë, me cilësinë e saj si emetuese e të ashtuquajturës *pará e bankës qendrore*[1]. Termi direkt, i referohet një korrespondence të drejtpërdrejtë, një për një, të instrumentit me objektivin përkatës të politikës monetare. Për ta ilustruar, përmendim instrumentin *kufi krediti* me objektivin respektiv të politikës monetare *krediti i brendshëm*.

Dallimin midis instrumenteve direkte dhe indirekte të politikës monetare mund ta vërejmë në dy drejtime kryesore:

- Instrumentet direkte, nëpërmjet rregulloreve e udhëzimeve përkatëse vendosin ose kufizojnë sasinë dhe çmimin e

agregatëve monetarë dhe të kreditit. Si shembull tipik përmendim: përcaktimin e normës minimale të interesit mbi depozitat në lekë, që paraqet një rast të përcaktimit të çmimit; dhe vendosjen e kufirit të kreditit që çdo bankë e nivelit të dytë mund t'i servirë publikut, që është rasti i përcaktimit të sasisë.

- Instrumentet indirekte operojnë apo veprojnë nëpërmjet tregut, duke ndikuar në ofertën dhe kërkesën për fonde në treg. Instrumentet direkte të politikës monetare, si për shembull, kufiri i kreditit, prekin drejtpërsëdrejti bilancet e bankave tregtare, ndërsa pjesa më e madhe e instrumenteve indirekte, prekin kryesisht bilancin e bankës qendrore. Kështu për shembull, me anë të kufirit të kreditit, bankave u kufizohet niveli i mjeteve në bilancet e tyre në zërin "*Kredi*", ndërsa lidhur me instrumentet indirekte, vetë banka qendrore përcakton nivelin e mjeteve në bilancin e saj në zërat "*Hua për bankat e nivelit të dytë*" apo "*Marrëveshje riblerjeje*"etj..

Ndikimi në kushtet e tregut nuk përjashton mundësinë që, banka qendrore të vendosë objektiva lidhur me nivelin e normave të interesit apo me sasinë e kreditit në ekonomi. Në vend të kontrollit direkt, mekanizmi i tregut u lejon pjesëmarrësve në tregun e parasë t'i përshtaten indirekt vendosjes së këtyre parametrave.

Instrumenteve indirekte iu referohemi, gjithashtu, dhe si instrumente që aplikohen nëpërmjet tregut, meqë ato përgjithësisht ndryshojnë rezervat e bankave të nivelit të dytë nëpërmjet transaksioneve me bankat dhe jobankat, vullnetarisht me çmimet e tregut. Instrumentet indirekte, që në themel të tyre kanë tregun, dallohen nga tipet e tregjeve në të cilat aplikohen.

Megjithëse këto instrumente quhen indirekte ose të bazuara në treg, ato në vetvete përmbajnë një shkallë minimale rregullimi. Kjo, me qëllim që "të qeverisin" kushtet që realizojnë funksionimin e tyre si: palët në transaksione, mënyrën apo formën e zbatimit të tyre (për shembull, tipi i ankandit), formën e realizimit të pagesës në momentin e mbylljes së transaksionit etj.. Brenda

këtij kuadri, janë forcat e tregut ato, që nëpërmjet instrumenteve indirekte të politikës monetare, ndikojnë në ndryshimin e nivelit të parasë së bankës qendrore.

PJESA E DYTË

KALIMI NGA INSTRUMENTET DIREKTE NË ATO INDIREKTE TË POLITIKËS MONETARE

Miratimi i ligjit nr. 7559 në prill të vitit 1992 shënoi krijimin e bankës qendrore të Shqipërisë, Bankës së Shqipërisë, përgjegjësia kryesore e të cilës ishte: ruajtja e vlerës së monedhës kombëtare nëpërmjet zbatimit të politikës monetare; licencimi i bankave dhe mbikëqyrja e tyre; si dhe kontrolli, rregullimi dhe administrimi i sistemit të pagesave. Krijimi i Bankës së Shqipërisë u shoqërua, përveç të tjerave, me zhvillimin e kuadrit të politikës monetare dhe të instrumenteve të saj.

Gjendja e përgjithshme e ekonomisë shqiptare dhe niveli i zhvillimit të sistemit financiar në Shqipëri në atë kohë mund të lejonin hartimin e një politike monetare të mbështetur pothuajse tërësisht në instrumentet direkte të kontrollit monetar. Vetë natyra dhe karakteristikat e këtyre instrumenteve i vinin për shtat gjendjes së sistemit bankar shqiptar. Nga eksperienca e shumë ekonomive të zhvilluara dhe në zhvillim, instrumentet direkte kanë rezultuar të besueshme dhe të suksesshme (pa ndonjë efekt anësor të dukshëm) në kontrollin e kreditit për ekonominë, shpërndarjen dhe koston e tij.

Njëkohësisht zbatimi i instrumenteve direkte ka qenë mjaft i thjeshtë, pasi mjaftonte që banka qendrore të vendoste limitet apo kufijtë e tyre dhe ky veprim të transmetohej direkt me anë të udhëzimeve përkatëse në bankat e nivelit të dytë. Instrumentet direkte e bëjnë më të thjeshtë hartimin e programit monetar, pasi kufijtë e rritjes së agregatëve monetarë dhe të kreditit përcaktohen apo vendosen direkt nga hartuesit e programit në funksion të arritjes së objektivave të politikës monetare. Instrumentet direkte

janë mjaft të përshtatshme në ekonomitë me tregje financiare të pazhvilluara ose pak të zhvilluara, pasi ato nuk realizohen nëpërmjet tregut. Zbatimi i politikës monetare me anë të instrumenteve indirekte kërkon tregje financiare të zhvilluara, kërkon instrumente të tregtueshme, kërkon institucione bankare e ndërmjetës financiarë të konsoliduar. Në kushtet e Shqipërisë, kur kuadri institucional ishte i pazhvilluar, ku nuk kishte ende instrumente të tregtueshme (letra me vlerë), kur sistemi bankar sapo kishte kaluar në sistemin me dy nivele, kur kultura bankare dhe financiare në kushtet e ekonomisë kapitaliste ishte fare e pakët, nuk mund të pretendohej gjë tjetër në kuadrin e politikës monetare, përveç zbatimit të saj me instrumente direkte.

Gjatë vitit 1992, Banka e Shqipërisë filloi të punojë me përcaktimin e normës së interesit të depozitave dhe kufirit të kreditit. Po në këtë periudhë, ajo filloi mbajtjen e rezervës së detyrueshme për bankat e nivelit të dytë dhe publikimin e normës së rifinancimit. Kështu, në qershor të vitit 1992, ajo nxjerr njoftimin e parë zyrtar për kufirin e kreditit.

Sipas tij, të gjitha institucionet krediduese që ushtronin aktivitet bankar duhet të respektonin kufirin e kreditit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, domethënë të jepnin kredi sipas niveleve të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë për çdo bankë të nivelit të dytë. Kufiri i kreditit për çdo bankë përcaktohej për çdo tremujor në fillim të vitit kalendarik. Për disa vite me rradhë, Banka e Shqipërisë vazhdoi të bëjë shpërndarjen e kufirit të kreditit për bankat e nivelit të dytë në përputhje me objektivat e programit të saj monetar e në bazë të biznesplaneve të tyre, të kapacitetit të ekonomisë për të thithur kredi etj.. Kufiri i kreditit vazhdoi të zbatohej deri në muajin nëntor të vitit 1999. Pas këtij momenti bankat e nivelit të dytë mund të jepnin kredi për ekonominë pa asnjë kufizim nga Banka e Shqipërisë, por sipas nevojave të ekonomisë për t'u ushqyer me investime të ndryshme.

Po në vitin 1992 filloi mbajtja në nivelin 10 për qind e rezervës së detyrueshme. Mbajtja 10 për qind do të thoshte që për çdo muaj bankat do të linin në llogaritë e tyre pranë Bankës së Shqipërisë, 10 për qind nga detyrimet e tyre ndaj të tretëve.

Kohë pas kohe janë bërë përmirësime të ndryshme në paketën rregulluese të rezervës së detyrueshme për një funksionim të mirë, praktik dhe fleksibël të këtij instrumenti. Ndryshimet më të rëndësishme të tij kanë qenë aplikimi i mesatares javore në llogaritjen e rezervës së detyrueshme dhe lejimi i përdorimit të nivelit 5 për qind të rezervës nga bankat e nivelit të dytë. Këto ndryshime, që u realizuan në fund të vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999, u bënë me qëllimin e mirë të zhvillimit të këtij instrumenti dhe, njëkohësisht, të krijimit të disa lehtësive për një zhvillim të shpejtë të sistemit bankar. Një ndryshim tjetër i rëndësishëm, që u bë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2000, ishte remunerimi i rezervës së detyrueshme. Kjo do të thoshte që bankat e nivelit të dytë do të shpërbleheshin për fondet e tyre në llogarinë e rezervës së detyrueshme. Të gjitha ndryshimet e sipërpërmendura i shërbenin nxitjes së zhvillimit të sistemit bankar dhe realizimit të një pakete instrumentesh të përshtatshme për integrimin e ardhshëm evropian.

Po në qershor të vitit 1992, Banka e Shqipërisë filloi të përcaktojë dhe të publikojë normën minimale të detyrueshme të interesit për depozitat në lekë. Përcaktimi i normës së interesit nga Banka e Shqipërisë është bërë duke u nisur kryesisht nga niveli i inflacionit në ekonominë shqiptare, për të siguruar një normë interesi reale pozitive, që do të thotë se Banka e Shqipërisë është kujdesur që kursimet e depozituesve të mos gërryheshin nga niveli i lartë i inflacionit në periudha të ndryshme.

Gjithashtu, me anë të politikës së normës së interesit Banka e Shqipërisë është kujdesur t'i shërbejë njëkohësisht dhe kryesisht promovimit të rolit të sistemit bankar, nxitjes së investimeve reale për ekonominë, përmirësimeve të vazhdueshme makroekonomike, zhvillimit të tregut të letrave më vlerë dhe forcimit të besimit të publikut, veçanërisht gjatë dhe pas vitit 1997, kur norma e lartë e inflacionit detyroi një normë interesi për depozitat, 37 për qind. Aplikimi i normës së interesit si instrument vazhdoi deri në muajin shtator të vitit 2000, vit gjatë të cilit Banka e Shqipërisë hoqi dorë gradualisht nga përcaktimi i normës së interesit, fillimisht për depozitat gjashtëmujore dhe më pas për ato dymbëdhjetë dhe tremujore.

Formën e tyre të plotë kredia lombard dhe e rifinancimit e morën gjatë vitit 1996, me kompletimin e rregulloreve të tyre. Ato gjetën përdorim mjaft të gjerë gjatë vitit 1997 dhe gjysmës së parë të vitit 1998, periudhë e mbushur me probleme likuiditeti për sistemin bankar. Ndërsa, kredia e rifinancimit nuk ekziston më në paketën e instrumenteve të Bankës së Shqipërisë, kredia lombard është menduar të mbulojë nevojat afatgjata (deri në tre muaj) për likuiditet të bankave, nëse këto të fundit nuk kanë asnjë mundësi tjetër nga tregu i parasë.

Gjatë vitit 1996 u njohën për herë të parë dhe marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes. Qëllimi i tyre ishte të rregullonin problemet afatshkurtra të mungesave dhe të tepricave të likuiditetit në sistemin bankar. Deri në korrik të vitit 2000 ato kanë funksionuar me procedura dypalëshe. Pas kësaj periudhe, marrëveshjet e riblerjeve, qëllimi i të cilave tanimë është përçimi i sinjaleve të politikës monetare, filluan të realizoheshin nëpërmjet ankandeve, duke ndjekur kështu dhe duke iu përafruar modelit të Bankës Qendrore Evropiane.

Pas krizës së përgjithshme të vitit 1997, me rimëkëmbjen e gjithë ekonomisë shqiptare dhe stabilizimin makroekonomik që vijoi, me rifitimin e besimit të publikut nga sistemi bankar, me rimëkëmbjen dhe zhvillimin gradual të tij, zbatimi i politikës monetare me instrumentet direkte nuk po i shërbente më, ashtu siç duhej, zhvillimit ekonomik të vendit. Në këto kushte është punuar në përmirësimin e vazhdueshëm të instrumenteve të politikës monetare, jo vetëm në drejtim të njohjes së instrumenteve të reja, por në drejtim të funksionimit sa më të mirë të tyre. U arrit deri aty sa politika monetare e Bankës së Shqipërisë të zbatohej vetëm nëpërmjet instrumenteve indirekte, kuadri i plotë i të cilave paraqitet në pjesën e tretë të këtij materiali.

Cilat janë kriteret e përcaktimit të paketës së instrumenteve për një bankë qendrore?

Një nga kriteret kryesore është aftësia e instrumentit për të kontrolluar variablin që banka qendrore dëshiron të influencojë si për shembull, niveli i rezervave dhe parasë, krediti dhe normat e

interesit. Për të siguruar suksesin e kontrollit, efektet e përdorimit të instrumentit duhet të jenë të parashikueshme. Aftësia e një instrumenti për të kontrolluar mund të rritet nëse instrumenti është elastik (fleksibël), që do të thotë se efektet monetare të tij mund të ndryshohen, asnjanësohen apo të kthehen mbrapsht relativisht shpejt.

Kriteri i dytë lidhet me efektet anësore të instrumentit në shpërndarjen e burimeve financiare. A mund të ndodhë që përdorimi i instrumentit mund të interferojë me tregun financiar apo të shkaktojë shformime në shpërndarjen e burimeve reale? Po. Për shembull, kontrolli i kreditit me anë të kufirit të kreditit mund të jetë mjaft efektiv në kontrollin e agregatit të kreditit, por kjo mund të çojë në mosndërmjetësim financiar, në ngadalësim të zhvillimit të tregjeve financiare dhe në shformim të shpërndarjes së burimeve financiare.

Një kriter i tretë, i përgjithshëm lidhet me atë se sa mund të kontribuojë një instrument i veçantë apo e gjithë paketa e instrumenteve, në zhvillimin e përgjithshëm financiar të një vendi apo në stabilitetin e sistemit të tij financiar. Për shembull, operacionet e Bankës së Shqipërisë me letra me vlerë (bono thesari 3, 6 dhe 12-mujore) nuk përbëjnë vetëm një mjet kontrolli të likuiditeteve të sistemit bankar, por ato nxisin gjithashtu, zhvillimin e tregjeve financiare, në mënyrë të veçantë tregjet e letrave me vlerë afatshkurtra të qeverisë.

Një kriter i katërt ka të bëjë me aftësinë e instrumentit përkatës apo të paketës së instrumenteve për të trajtuar situatat e vështira financiare (*shock*) në sistem apo në banka të veçanta si për shembull, *shock*-u i likuiditeteve (apo fluksi i madh i tërheqjes përpara kohe të depozitave). Në këto raste, kredia e rifinancimit, ka rezultuar të jetë e suksesshme në trajtimin e problemeve të bankave të veçanta. Po të kthehemi mbrapsht në kohë, fundi i vitit 1996 dhe gjysma e parë e vitit 1997, kujtojmë se bankat shqiptare kanë patur mjaft probleme likuiditeti. Paketa e instrumenteve direkte dhe indirekte të përdorura në atë periudhë, arriti të përballojë problemet e likuiditetit të sistemit.

Në krijimin e paketës së instrumenteve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë janë marrë parasysh gjithë kriteret e mësipërme. Megjithatë, funksionimi i mirë i kësaj pakete kërkon koordinimin e përdorimit të secilit prej instrumenteve në atë se sa shpesh dhe në çfarë mase duhet të përdoren dhe sa e ndikojnë nivelin e likuiditetit. Në këtë kontekst, del domosdoshmëri programimi i rezervës së parasë, pasi ai siguron analizën sistematike të burimeve dhe të përdorimeve të likuiditetit.

PJESA E TRETË

PËRSHKRIMI I PLOTË I INSTRUMENTEVE TË POLITIKËS MONETARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË DHE ZBATIMI PRAKTIK I TYRE

Aktualisht, Banka e Shqipërisë operon vetëm me instrumentet indirekte të politikës monetare. Kështu, ajo kryen operacionet e tregut të hapur, ofron lehtësitë e përhershme dhe iu kërkon institucioneve parádepozituese të mbajnë pranë llogarive të tyre në Bankën e Shqipërisë, rezervën minimale të detyrueshme.

Cilat janë instrumentet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë?

1. Operacionet e tregut të hapur

1.1. Operacionet e kthyeshme.
1.2. Transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota.
1.3. Operacionet në valutë (mund të kuptohen si pjesë e shitblerjeve me të drejta të plota).

2. Instrumentet mbështetëse

2.1. Kredia lombard.
2.2. Kredia njëditore.
2.3. Depozita njëditore.

3. Rezerva e detyrueshme

1. ÇFARË JANË OPERACIONET E TREGUT TË HAPUR?

Operacionet e tregut të hapur luajnë një rol të rëndësishëm në politikën monetare të Bankës së Shqipërisë dhe kanë për qëllim të drejtojnë sjelljen e normave afatshkurtra të interesit, të administrojnë situatat e likuiditetit, duke shtuar apo pakësuar likuiditetin në treg dhe të sinjalizojnë politikën monetare të saj. Operacionet e tregut të hapur mund të jenë në formën e *transaksioneve të kthyeshme,* që përfshijnë *marrëveshjet e riblerjeve* dhe *të anasjellta të riblerjeve,* dhe në formën e *transaksioneve me të drejta të plota*, që përfshijnë *operacionet e shitblerjeve të letrave me vlerë apo të valutave*. Është e rëndësishme të thuhet që, operacionet e tregut të hapur iniciohen nga Banka e Shqipërisë, e cila vendos gjithashtu, për instrumentet që do të përdorë dhe, për kushtet e ekzekutimit të tyre.

1.1 TRANSAKSIONET E KTHYESHME

Këto transaksione quhen të tilla, pasi ato përfaqësojnë transaksione që përbëhen nga dy operacione. Operacioni i parë përfaqësohet nga shitja/blerja e letrës me vlerë dhe operacioni i dytë apo i kthimit, që përfaqësohet nga riblerja/rishitja mbrapsht e letrës me vlerë.

Marrëveshjet e riblerjeve dhe të ansjellta të riblerjeve

Të përgjithshme

Marrëveshjet e riblerjeve dhe të anasjellta të riblerjeve janë aplikuar për herë të parë në tregun parasë në vitin 1996, në trajtën e marrëveshjeve dypalëshe, joperiodike midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë. Që nga ky vit e deri në muajin korrik të vitit 2000, ato janë përdorur të kombinuara me instrumentet direkte të politikës monetare, si: kufiri i kreditit dhe norma minimale e interesit për depozitat në lekë në bankat me

kapital shtetëror. Në muajin korrik të vitit 2000, filloi funksionimi i marrëveshjeve të riblerjeve nëpërmjet ankandeve javore të mbajtura rregullisht në Bankën e Shqipërisë.

Marrëveshja e riblerjes nënkupton një marrëveshje, me anë të së cilës Banka e Shqipërisë shet letra me vlerë dhe premton t'i riblejë ato në të ardhmen, sipas afateve dhe kushteve të rëna dakord paraprakisht. Ky është një instrument, që përdoret për të pakësuar përkohësisht likuiditetin në sistemin bankar.

Marrëveshja e anasjelltë e riblerjes nënkupton një marrëveshje, me anë të së cilës Banka e Shqipërisë blen letra me vlerë dhe premton t'i rishesë ato në të ardhmen, sipas afateve dhe kushteve të rëna dakord paraprakisht. Ky është një instrument që përdoret për të shtuar përkohësisht likuiditetin në sistemin bankar.

Maturimi

Nisur nga afati i maturimit dallojmë katër tipe të marrëveshjeve të riblerjeve:

- *me afat maturimi një ditë*. Këto marrëveshje realizohen me ankande të tipit të shpejtë;
- *me afat maturimi shtatë ditë*. Këto marrëveshje realizohen me ankandet e tipit standard;
- *me afat maturimi një muaj*. Këto marrëveshje riblerjeje realizohen me ankande të tipit të shpejtë;
- *me afat maturimi tre muaj*. Këto marrëveshje realizohen me ankande të tipit të shpejtë.

Shuma për pjesëmarrje

Që një bankë të marrë pjesë në ankandin e marrëveshjeve të riblerjeve, kërkesa e saj duhet të jetë minimalisht 5 (pesë) milionë lekë dhe mbi këtë shumë, mund të rritet me shumëfisha prej 100 mijë lekësh.

Në *ankandet me shumë çmime*, shuma që ofrohet miratohet nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, me propozim të

Departamentit të Operacioneve Monetare dhe shpallet në njoftimin përkatës për ankand. Kërkesat e pjesëmarrësve plotësohen sipas shumës së paraqitur në kërkesën për të marrë pjesë në ankand. Në rast se shuma e të gjitha kërkesave është më e madhe se sasia e ofruar nga Banka e Shqipërisë atëherë, kërkesat plotësohen me *pro-rata* (ose pjesërisht sipas një proporcioni të caktuar).

Në *ankandet me çmim fiks*, kërkesat e pjesëmarrësve plotësohen sipas shumave të përcaktuara nga vetë bankat e nivelit të dytë për të marrë pjesë në ankand.

Çmimi/norma e interesit

Norma fikse e interesit të riblerjes për ankandet standarde propozohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare dhe miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Kjo normë shërben si nivel maksimal/minimal për ankandet me shumë çmime.

Norma e interesit për ankandet e shpejta i referohet normës fikse të interesit për ankandet standarde dhe miratohet nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare.

Mjetet për sigurimin e detyrimit

Për sigurimin e detyrimit të palëve në transaksion ose thënë ndryshe, si kolateral, aktualisht, përdoren bonot e thesarit me afat maturimi deri në një vit ose me periudhë të mbetur deri në maturim, jo më pak se 14 ditë.

Marrëveshjet e anasjellta të riblerjeve, që zhvillohen nëpërmjet ankandeve për blerje konsiderohen si hua të kolateralizuara. Në këtë rast, vlera e kolateralit është 115 për qind, pra 15 për qind më shumë se shuma e futur në veprim.

Si mjete për sigurimin e detyrimit mund të përdoren dhe letra të tjera me vlerë të qeverisë, nëse pranohen të përdoren

si të tilla, me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Tipi i ankandit

Ankandet për zhvillimin e marrëveshjeve të riblerjes mund të jenë disa tipesh. Tipi i ankandit miratohet nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare.

Sipas tipit të marrëveshjes, riblerje dhe e anasjelltë riblerjeje, dallojmë:

- *Ankand për shitje* (marrëveshje riblerjeje). Në këtë ankand, Banka e Shqipërisë shet letrat me vlerë dhe premton t'i riblejë ato në një datë të caktuar në të ardhmen.
- *Ankand për blerje* (marrëveshje të anasjellta riblerjeje). Në këtë ankand, Banka e Shqipërisë blen letrat me vlerë dhe premton t'i rishesë ato në një datë të caktuar në të ardhmen.

Sipas çmimit dallojmë:

- *Ankand me çmim fiks*. Sipas këtij ankandi, plotësimi i kërkesave të pjesëmarrësve bëhet sipas normës së interesit të përcaktuar dhe të shpallur nga Banka e Shqipërisë, në njoftimin për ankandin e rradhës.
- *Ankand me shumë çmime*. Sipas këtij tipi, plotësimi i kërkesave të pjesëmarrësve bëhet sipas normës së interesit të secilit pjesëmarrës të përcaktuar në kërkesë, me kusht që interesi të mos jetë më i lartë në ankandet për shitje/ më i ulët në ankandet për blerje, nga norma e interesit të shpallur nga Departamenti i Operacioneve Monetare, në njoftimin përkatës.

Sipas kohës së zhvillimit të tyre dallojmë:

- *Ankand të tipit standard*. Këto ankande zhvillohen brenda ditës së nesërme nga njoftimi i Departamentit të

Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë për ankandin e rradhës shtatëditor. Kryerja javore e këtyre ankandeve është e fiksuar paraprakisht (në kalendarin përkatës).

- *Ankand të shpejtë*. Ankandet e tipit të shpejtë janë të klasifikuara në dy nëntipe:
  - *ankande të shpejta për marrëveshjet e riblerjeve me afat maturimi një ditë*. Këto ankande zhvillohen brenda dy orëve nga njoftimi i Departamentit të Operacioneve Monetare për ankand njëditor;
  - *ankande të shpejta për marrëveshjet e riblerjeve me afat maturimi një/tre muaj*. Këto ankande zhvillohen brenda katër orëve nga njoftimi i Departamentit të Operacioneve Monetare për ankand një/tremujor.

Në dallim nga ankandet e tipi standard, ankandet e tipit të shpejtë nuk janë të fiksuara që më parë dhe zhvillohen sa herë gjykohet e arsyeshme nga Banka e Shqipërisë. Qëllimi i mbajtjes së tyre është kryesisht *administrimi i likuiditetit në sistemin bankar*.

Gjobat në rast shkeljeje të kushteve të marrëveshjes

Në rast se, njëra nga palët shkel kushtet e marrëveshjes, atëherë mbi të aplikohen penalitetet e parashikuara nga rregullat për kolateralin.[2]

Palët në transaksion

Palë në marrëveshjet e riblerjeve të organizuara nga Banka e Shqipërisë janë bankat e nivelit të dytë.

Procedurat e rregullimit të llogarive

Regjistrimi i veprimeve në llogari të ankandeve është i formës *book-entry*.[3] Bazuar në parimin "livrim kundrejt pagesës (DVP – Delivery Versus Payment) bëhet lëvizja e njëkohshme e bonove të thesarit (letrave me vlerë) dhe e kundravleftës në lekë të transaksionit.

Çfarë duhet të bëjë një bankë për t'u pranuar të marrë pjesë në ankandet e marrëveshjeve të riblerjeve?

Për të qenë të pranueshme si palë në ndonjë marrëveshje riblerjeje, bankat e nivelit të dytë, në fillim të çdo viti kalendarik, duhet të nënshkruajnë një kontratë me afat njëvjeçar me Bankën e Shqipërisë, e cila i paraprin zbatimit të marrëveshjeve të riblerjeve që do të zhvillohen në vazhdim, nëpërmjet ankandeve.

Si funksionon ankandi për marrëveshjet e riblerjeve?

Banka e Shqipërisë, përpara organizimit të ankandit të marrëveshjeve të riblerjes, njofton bankat e nivelit të dytë për tipin dhe kushtet e ankandit me SWIFT, teleks, REUTERS, faks ose shkresë zyrtare. Në këtë njoftim (shkresë), ndër të tjera, bankat njoftohen për llojin e ankandit, datën dhe orën e ankandit, shumën e ofruar në ankand, normën e interesit etj.. Nëse ankandi është i tipit standard ai zhvillohet periodikisht çdo javë, ditën e mërkurë në orën 14:00. Kërkesat e bankave duhet të paraqiten në Departamentin e Operacioneve Monetare, ku zhvillohet ankandi, brenda orës 13:30 të ditës së ankandit, sipas një formulari-kërkesë të gatshëm, të përgatitur nga Departamenti i Operacioneve Monetare. Në këtë formular-kërkesë, bankat duhet të vendosin emrin dhe informacione të tjera shtesë për bankën, shumën e pjesëmarrjes në ankand, normën e interesit të ofruar në rastet e ankandeve me shumë çmime etj..

Komisioni i ankandit, me fillimin e ankandit, shqyrton kërkesat e bankave. Në rast se vërehen parregullsi në plotësimin e kërkesës ose nëse ajo nuk është sipas formës standarde, kërkesa e bankës përkatëse nuk kualifikohet për të marrë pjesë në ankand.

Për ankandet me afat maturimi deri në shtatë ditë, komisioni përbëhet nga dy anëtarë, përfaqësues respektivisht të Departamentit të Operacioneve Monetare dhe Departamentit të Kërkimeve dhe Publikimeve. Për ankandet e marrëveshjeve të riblerjeve me afat maturimi një/tre muaj, komisioni përbëhet nga tre anëtarë, dy përfaqësues të Departamentit të

Operacioneve Monetare dhe një i Departamentit të Kërkimeve dhe Publikimeve.

Në ankandet me shumë çmime, kërkesat rradhiten në mënyrë rritëse/zbritëse. Shpallen automatikisht fituese të gjitha kërkesat, nëse shuma e kërkuar nga bankat është më e vogël sesa shuma e ofruar nga Banka e Shqipërisë. Nëse shuma e kërkuar nga bankat është më e lartë se shuma e ofruar nga Banka e Shqipërisë, atëherë nga komisioni i ankandit do të zbatohet *pro-rata*, që është raporti midis sasisë së mbetur për t'u shpërndarë, me shumën e kërkesave të bankave, interesi i riblerjes së të cilave është i barabartë.

Pas përfundimit dhe shpalljes së fituesve, komisioni i ankandit bën njoftimet përkatëse për rezultatet e ankandit, si për pjesëmarrësit ashtu dhe për Administratorët e Bankës së Shqipërisë. Njoftimi i pjesëmarrësve në ankand bëhet me SWIFT, teleks, REUTERS, faks ose me shkresë zyrtare.

1.2. TRANSAKSIONET E SHITBLERJEVE ME TË DREJTA TË PLOTA

Të përgjithshme

E veçanta e operacioneve të shitblerjeve me të drejta të plota qëndron në efektin e përhershëm të tyre në tregun e parasë. Këto nuk janë transaksione të kthyeshme. Shitja apo blerja e letrave me vlerë nuk shoqërohet me operacionin e anasjelltë të riblerjes apo të rishitjes së tyre.

Këto operacione ekzekutohen me iniciativën e Bankës së Shqipërisë dhe kanë për qëllim administrimin e likuiditeteve dhe të normave të interesit. Transaksionet mund të jenë në formën blerjeve të letrave me vlerë, që do të thotë shtim i likuiditetit në sistemin bankar ose të shitjeve të letrave me vlerë nga Banka e Shqipërisë, që nënkupton tërheqjen e likuiditetit nga sistemi bankar.

Objekti i transaksioneve

Në transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota mund të

shiten dhe të blihen bono thesari me afat maturimi deri në një vit dhe me periudhë të mbetur në maturim jo më pak se shtatë ditë. Gjithashtu, në këto transaksione, mund të shiten dhe të blihen letra me vlerë të borxhit, që kanë likuiditet dhe kredibilitet të lartë e që pranohen si të tilla, me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Propozimi

Transaksionet me të drejta të plota realizohen me propozim të drejtorëve të departamenteve të Kërkimeve dhe të Operacioneve Monetare dhe me miratim të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë. Propozimi për transaksione me të drejta të plota, merr shkas nga kushtet aktuale të tregut të parasë, mbështetur në programin monetar të Bankës së Shqipërisë, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Procedura e transaksionit

Shitblerjet me të drejta të plota mund të realizohen nëpërmjet procedurave dypalëshe ose ankandeve të shpejta. Me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë jep miratimin për procedurën e transaksionit.

Në rastin e kryerjes së transaksioneve të shitblerjeve me të drejta të plota me procedura dypalëshe, Banka e Shqipërisë njofton me SWIFT, faks, teleks apo REUTERS bankën e nivelit të dytë me të cilën synon të operojë. Nëse kjo bankë pranon të marrë pjesë në transaksion, ajo dërgon menjëherë konfirmim në Bankën e Shqipërisë. Pas këtij veprimi, të dyja palët përcaktojnë kushtet dhe termat e transaksionit.

Në rastin e kryerjes së transaksioneve me ankande të shpejta, Banka e Shqipërisë njofton deri në orën 10:00 me SWIFT, teleks, faks, REUTERS apo me shkresë zyrtare të gjitha bankat e nivelit të dytë. Njoftimi duhet të përmbajë të dhëna referuese për ankandin si dhe vlerën nominale të bonove të thesarit që ofrohet apo kërkohet për të shitur apo blerë, afatin e maturimit

të tyre etj.. Në një interval kohe prej dy orësh nga momenti i njoftimit, bankat e nivelit të dytë duhet të konfirmojnë pranë Bankës së Shqipërisë pjesëmarrjen e tyre në ankand. Konfirmimi përmban, përveç të dhënave referuese për ankandin dhe vlerën nominale të bonove të thesarit që kërkohen/ofrohen në ankand, çmimin e blerjes/shitjes së tyre, afatin e maturimit etj.. Kërkesat e paraqitura për shitblerjen e bonove të thesarit nëpërmjet ankandit renditen sipas rendit zbritës/rritës të çmimit. Fitues në ankand konsiderohen të gjithë pjesëmarrësit deri në plotësimin e vlerës nominale të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Në rastin e pjesëmarrësve me kushte të njëjta, kërkesat plotësohen pjesërisht sipas mekanizmit *pro-rata*.

Menjëherë pas përfundimit të ankandit, komisioni përkatës përgatit dhe u dërgon pjesëmarrësve njoftimet mbi rezultatet e ankandit.

Palët në transaksion

Si kundërparti të Bankës së Shqipërisë në transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota janë të gjitha bankat e nivelit të dytë, që mbajnë llogari pranë Bankës së Shqipërisë.

Teknikat kontabël

Llogaritë e transaksioneve të shitblerjeve me të drejta të plota, rregullohen në të njëjtën ditë me mbajtjen e ankandit apo të përfundimit të transaksionit dypalësh. Në bazë të parimit "livrim kundrejt pagesës", bëhet transferimi i së drejtës së pronësisë së bonove të thesarit dhe lëvizja e fondeve në llogaritë e bankave dhe Bankës së Shqipërisë.

1.3. OPERACIONET NË VALUTË, NDËRHYRJET

Banka e Shqipërisë ndërmerr operacione shitblerjeje me të drejta të plota apo të përkohshme (swap-s) në valutë. Praktikisht, Banka e Shqipërisë blen dhe shet valutë në treg, kur ajo synon të ndërhyjë në treg kryesisht për të zbutur luhatjet e kursit të këmbimit. Në marrëdhëniet e saj me qeverinë, Banka

e Shqipërisë konverton huatë në valutë, në monedhë shqiptare ose i shet valutë qeverisë për të shlyer detyrimet valutore të borxhit të jashtëm.

2. INSTRUMENTET MBËSHTETËSE

Instrumentet mbështetëse kanë për qëllim të shtojnë apo të pakësojnë në mënyrë të përkohshme likuiditetin, të sinjalizojnë karakterin e politikës monetare dhe të pengojnë luhatjet e mëdha të normave të interesit. Ato realizohen gjithmonë dhe ekskluzivisht me iniciativën e bankave të nivelit të dytë. Palë e Bankës së Shqipërisë në këto transaksione janë vetëm bankat e nivelit të dytë.

2.1. KREDIA LOMBARD

Të përgjithshme

Si instrument i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, *kredia lombard* ka ekzistuar prej kohësh. Megjithatë, ajo nuk është përdorur për shumë kohë, madje nuk është përdorur në asnjë rast të vetëm gjatë viteve 2000 dhe 2001. Përmirësimet dhe ndryshimet e njëpasnjëshme të rregullores përkatëse janë bërë në përputhje me zhvillimin e institucioneve parádepozituese dhe të tregut të parasë. Për herë të fundit, kjo rregullore është rishikuar dhe plotësuar në shkurt të vitit 2001. Qëllimi i kredisë lombard nuk është të ndikojë gjendjen e përgjithshme të likuiditetit në sistemin bankar, por të ndihmojë bankat e nivelit të dytë të kapërcejnë problemet e përkohshme të likuiditetit. Norma e interesit të kësaj kredie, e cila përfaqëson normën tavan të interesit të vendosur nga Banka e Shqipërisë, shërben si udhëtreguese për normat e tjera afatshkurtra të interesit.

Çdo bankë e nivelit të dytë mund të paraqesë pranë Bankës së Shqipërisë kërkesën për kredi lombard vetëm pasi të ketë shfrytëzuar më parë mundësitë e brendshme të saj për likuiditete, tregun ndërbankar apo dhe marrëveshjet e riblerjes. Kredia lombard, për një bankë të nivelit të dytë, miratohet nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, me

propozim të Departamentit të Kërkimeve dhe Publikimeve dhe të Departamentit të Operacioneve Monetare.

Maturimi

Afati i maturimit të kredisë lombard është deri në tre muaj. Një bankë e nivelit të dytë mund të marrë kredi lombard vetëm një herë në çdo tremujor.

Shuma maksimale

Një bankë e nivelit të dytë, që paraqet kërkesë për kredi lombard në Bankën e Shqipërisë, përfiton kredinë lombard për shumën më të madhe midis 20 për qind të kapitalit të paguar të saj dhe 2 për qind të depozitave në lekë.

Norma e interesit

Norma e interesit të kredisë lombard është 6 pikë përqindjeje më e lartë se interesi i marrëveshjeve të riblerjeve. Aktualisht, interesi i kredisë lombard është 13 për qind (7 për qind interesi i marrëveshjeve të riblerjes plus 6 për qind).

Kolaterali

Si mjet për sigurimin e detyrimit në rastin e kredisë lombard shërbejnë të gjitha vlerat e pranuara si të tilla në rregulloren përkatëse "Mbi mjetet e sigurimit të detyrimit":

- bonot e thesarit me afat maturimi jo më të vogël sesa afati i maturimit të kredisë së akorduar nga Banka e Shqipërisë;
- depozita në lekë dhe në valutë.

Palët në transaksion

Palë të Bankës së Shqipërisë në kredinë lombard janë të gjitha bankat e nivelit të dytë.

Gjobat

Në rast se njëra nga palët shkel detyrimet e marra përsipër, atëherë mbi të aplikohen penalitetet e parashikuara nga rregullat përkatës të rregullores "Mbi mjetet e sigurimit të detyrimit". Nëse banka e nivelit të dytë nuk e kthen kredinë lombard në datën e maturimit të saj, atëherë asaj nuk do t'i lejohet të marrë asnjë lloj tjetër kredie në tremujorin pasardhës.

2.2 KREDIA NJËDITORE

Të përgjithshme

Kredia njëditore është një kredi plotësisht e garantuar, që akordohet për të ndihmuar bankat e nivelit të dytë të zgjidhin problemet njëditore të likuiditetit. Gjithashtu, ajo ndihmon për të zbutur luhatjet e normave të interesit afatshkurtër. Kredia njëditore është një instrument i ri (i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në shkurt të vitit 2001). Aktualisht, bankat e nivelit të dytë nuk e kanë ndjerë ende nevojën e përdorimit të këtij instrumenti, që nga hyrja e tij.

Maturimi

Kredia maturohet për një ditë. Banka, të cilës i është akorduar kjo kredi duhet ta shlyejë atë të nesërmen e datës së akordimit.

Akordimi nga Banka e Shqipërisë

Banka e nivelit të dytë, që për arsye të ndryshme nuk ka likuiditet të nevojshëm për të përmbushur të gjitha premtimet për pagesa në një ditë të caktuar pune, kërkon në Bankën e Shqipërisë akordimin e një kredie njëditore.

Kredia njëditore mund të akordohet dhe automatikisht nga Banka e Shqipërisë, në rast se llogaria "Rezervë" e një banke të nivelit të dytë, deri në orën 15:00 të ditës së punës, rezulton nën nivelin e lejuar të 95 për qind.

Shuma maksimale

Një bankë e nivelit të dytë mund të kërkojë kredi njëditore pa kufizim, me kushtin që shuma e kërkuar të jetë plotësisht e garantuar me letra me vlerë, pra plotësisht e kolateralizuar.

Norma e interesit

Norma e interesit të kredisë njëditore është 2.5 për qind më e lartë se norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjes, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Aktualisht, norma e interesit e kredisë njëditore është 9.5 për qind (7 për qind norma e repove[4] plus 2.5 për qind).

Kolaterali

Për garantimin e detyrimit që rrjedh nga kredia njëditore shërbejnë:

- bonot e thesarit me afat maturimi jo më të vogël sesa afati i maturimit të kredisë së akorduar nga Banka e Shqipërisë;
- depozitat në lekë dhe në valutë.

Gjobat

Në rast se njëra nga palët shkel detyrimet e marra përsipër me këtë kredi, atëherë për të zbatohen rregullat e përgjithshëm të paraqitur në rregulloren "Mbi mjetet e sigurimit të detyrimit".

2.3 DEPOZITA NJËDITORE

Të përgjithshme

Depozita njëditore është një instrumenti i ri, i miratuar në shkurt të vitit 2001. Që nga prezantimi i këtij instrumenti, përdorimi i tij nga bankat e nivelit të dytë është rritur vazhdimisht. Depozita njëditore përfaqëson një instrument që ndihmon bankat e nivelit të dytë të veprojnë me likuiditetin e tepërt, duke e depozituar atë vetëm për një ditë në Bankën e Shqipërisë. Gjithashtu, depozita

njëditore ndihmon në tërheqjen e likuiditetit nga sistemi bankar dhe në zbutjen e luhatjeve të mëdha në normat afatshkurtra të interesit. Interesi mbi depozitën njëditore përfaqëson normën dysheme të interesit në tregun e parasë.

Maturimi

Depozita njëditore maturohet ditën e nesërme të vendosjes së saj. Siç shihet, ky është një instrument me afat maturimi njëditor.

Shuma maksimale

Shuma e fondeve në lekë, që banka e nivelit të dytë dëshiron të vendosë në depozitë njëditore pranë Bankës së Shqipërisë është e pakufizuar. Megjithatë, Banka e Shqipërisë mund të refuzojë kërkesën e bankave të nivelit të dytë për të vendosur depozitë njëditore, pa dhënë shpjegime. Refuzimi i kërkesës nga Banka e Shqipërisë bëhet në varësi të kushteve të tregut, të programit monetar dhe të objektivave afatshkurtër të Bankës së Shqipërisë në lidhje me normat e interesit në tregun e parasë.

Çmimi/Norma e interesit

Norma e interesit, që Banka e Shqipërisë i paguan bankës së nivelit të dytë është 2.5 për qind, me bazë vjetore, më e ulët se norma e interesit të marrëveshjeve të riblerjeve, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Kështu, nëse norma e marrëveshjeve të riblerjes është 7 për qind, norma e interesit të depozitës është 4.5 për qind (7 për qind norma e *repo*ve, zvogëluar me 2.5 për qind).

3. REZERVA E DETYRUESHME

Të përgjithshme

Banka e Shqipërisë u kërkon të gjitha institucioneve parádepozituese të mbajnë në llogarinë e tyre, pranë saj, rezervën

minimale të detyrueshme, në lekë dhe në valutë. Rezerva minimale e detyrueshme, si instrument i politikës monetare është prezantuar që në vitin 1992. Norma e rezervës së detyrueshme mbi depozitat në lekë dhe në valutë është unike në nivelin 10 për qind për gjithë bazën e rezervës. Sistemi i rezervës minimale të detyrueshme iu mundëson bankave të nivelit të dytë të përfitojnë nga mekanizmi i mesatarizimit, që do të thotë që plotësimi i rezervës së detyrueshme bëhet në bazë të mesatares javore të llogarisë rezervë të bankave të nivelit të dytë, për periudhën e mbajtjes prej një muaji. Shuma e rezervës së detyrueshme që mbahet në llogarinë e bankave të nivelit të dytë pranë Bankës së Shqipërisë është e remunerueshme. Kjo do të thotë që, bankat e nivelit të dytë marrin interes për fondet e lëna si rezervë e detyrueshme në Bankën e Shqipërisë. Rezerva e detyrueshme përpiqet të realizojë funksionet monetare si në vijim:

- Stabilizimin e normave të interesit në tregun e parasë.

Mekanizmi i mesatarizimit në kuadrin e rezervës së detyrueshme synon të kontribuojë në stabilizimin e normave të interesit në tregun e parasë, duke i dhënë bankave të nivelit të dytë mundësi dhe njëkohësisht lehtësi për të zbutur apo për të sheshuar efektet e luhatjeve të përkohshme në gjendjen e likuiditetit. Thënë më qartë, bankat e nivelit të dytë mund të përdorin fonde nga llogaria e rezervës së detyrueshme për kryerjen e transaksioneve të përditshme, me kusht që mesatarja javore e llogarisë rezervë të jetë jo më e vogël se rezerva minimale e detyrueshme.

- Krijimin apo rritjen e mungesave strukturore të likuiditetit.

Rezerva e detyrueshme kontribuon në krijimin apo në rritjen e mungesave strukturore të likuiditetit. Kjo është e dobishme me qëllim që të përmirësohet aftësia e Bankës së Shqipërisë për të operuar me eficiencë në rolin e saj si furnizuese likuiditetesh.

Institucionet, subjekt i rezervës minimale të detyrueshme.

Subjekte të mbajtjes së rezervës së detyrueshme janë bankat dhe degët e bankave të huaja që autorizohen të kryejnë veprimtari bankare në Shqipëri, konform legjislacionit përkatës[5].

Përcaktimi i rezervës minimale të detyrueshme

a. Baza e rezervës

Bankat detyrohen të mbajnë rezervë ndaj depozitave monetare në lekë dhe në valutë ose thënë ndryshe, mbi detyrimet e bankave të nivelit të dytë ndaj të tretëve. Rezerva e detyrueshme llogaritet mbi depozitat monetare në lekë dhe në valutë, duke përfshirë letrat me vlerë të emetuara nga bankat dhe duke përjashtuar depozitat dhe llogaritë rrjedhëse që kanë bankat me njëra-tjetrën si dhe fondet e krijuara për garantimin e letërkredive, me kusht që të jenë të bllokuara brenda ose jashtë vendit.

Bankat e nivelit të dytë raportojnë çdo javë në Bankën e Shqipërisë të dhënat për llogaritjen e rezervës së detyrueshme, sipas formularëve përkatës. Baza e rezervës për muajin M-1 përcaktohet në muajin M, sipas të dhënave të dërguara për depozitat në lekë dhe në valutë. Rezerva e detyrueshme në valutë mbahet në dollarë amerikanë dhe në euro. Detyrimet e bankave në valutat e tjera që nuk bëjnë pjesë në euro, konvertohen në dollarë amerikanë dhe në këtë trajtë paraqiten në formularin e bazës së rezervës.

b. Llogaritja e rezervës minimale të detyrueshme

Rezerva minimale e detyrueshme për çdo bankë të nivelit të dytë, llogaritet duke aplikuar mbi bazën e rezervës, normën e rezervës së detyrueshme. Norma e rezervës së detyrueshme është uniforme për të gjitha llojet e depozitave që përbëjnë bazën e rezervës (lekë dhe valutë) në nivelin 10 për qind. Rezerva e detyrueshme në lekë dhe në valutë llogaritet në bazë të informacioneve javore.

Rezerva e muajit M-1 llogaritet si mesatare e rezervave javore, ponderuar me numrin e ditëve kalendarike të muajit.

Mbajtja e rezervës së detyrueshme

a. Periudha e mbajtjes së rezervës minimale të detyrueshme

Periudha e mbajtjes së rezervës së detyrueshme është një muaj. Mbajtja fillon nga dita e pesëmbëdhjetë e muajit M deri në ditën e katërmbëdhjetë të muajit M+1, për llogari të muajit M-1. Për shembull, rezerva e detyrueshme për muajin janar paguhet në datën 15 shkurt dhe mbahet nga data 15 shkurt deri në datën 14 mars.

b. Mbajtjet e rezervës

Bankat e nivelit të dytë mbajnë në Bankën e Shqipërisë llogari në lekë dhe në valutë. Llogaria në lekë emërtohet llogaria "Rezervë" dhe përbëhet nga llogaria rrjedhëse dhe rezerva e detyrueshme. Bankat gjatë ditës mund të përdorin deri në 5 për qind të llogarisë së rezervës së detyrueshme, por duhet që brenda javës ta zëvendësojnë këtë përdorim, me kusht që mesatarja javore e llogarisë "Rezervë" të jetë sa rezerva e detyrueshme në lekë, e llogaritur nga Banka e Shqipërisë në datën 15 të muajit përkatës.

Për rezervën e detyrueshme në valutë, bankat kanë llogaritë "rezervë e detyrueshme" në dollarë amerikanë dhe në euro, të cilat furnizohen nga llogaritë rrjedhëse të bankave të nivelit të dytë në Bankën e Shqipërisë në dollarë amerikanë dhe në euro.

c. Remunerimi i rezervës minimale të detyrueshme

Për rezervat e detyrueshme të bankave të nivelit të dytë, që mbahen pranë Bankës së Shqipërisë, kjo e fundit paguan interesa, pra i remuneron ato.

Për rezervën e detyrueshme në lekë, norma e remunerimit është sa 1/2 e *yield*-it të bonove të thesarit me maturim tremujor në ankandin më të fundit, para datës 15 të çdo muaji kur fillon mbajtja e rezervës së detyrueshme.

Për rezervën e detyrueshme në valutë, norma e remunerimit është sa 1/2 e interesit LIBOR[6] për depozitat me afat njëmujor në dollarë amerikanë dhe në euro, në datën 15 të muajit kur

fillon mbajtja e rezervës së detyrueshme. Remunerimi bëhet në të njëjtën valutë si rezerva e detyrueshme (dollarë amerikanë dhe euro). Remunerimi kryhet në datën e kalimit në llogari të veprimeve të rezervës së detyrueshme. Për shembull, në datën 15 shkurt fillon mbajtja e rezervave të detyrueshme për muajin janar dhe paguhet remunerimi për rezervat e detyrueshme të muajit dhjetor, që janë mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga data 15 janar deri në 14 shkurt.

- Mospajtimi me detyrimet për mbajtjen e rezervës minimale të detyrueshme

Çdo bankë e nivelit të dytë mund të gjendet në kushtet e mosplotësimit të rezervës së detyrueshme. Banka ka mosplotësim të rezervës së detyrueshme kur:

- pas llogaritjes së rezervës së detyrueshme, banka nuk ka gjendjen e nevojshme në llogarinë e saj në valutë për plotësimin në shtesë të rezervës së detyrueshme në valutë. Të gjitha ditët deri në furnizimin e llogarisë së rezervës së detyrueshme në valutë, konsiderohen si ditë mosplotësimi. Për rezervën e detyrueshme në lekë, rasti në shtesë i rezervës së detyrueshme nuk paraqet problem, pasi ajo mbahet në llogarinë "rezervë", që përfshin rezervën e detyrueshme dhe llogarinë rrjedhëse;
- në periudhën e mbajtjes së rezervës së detyrueshme në lekë, gjatë javës, mesatarja javore e rezervës së detyrueshme të bankës së nivelit të dytë është nën nivelin e rezervës së detyrueshme, që është llogaritur dhe përcaktuar në datën 15 të muajit përkatës (niveli 100 për qind). Në këtë rast, ditët që nga dita e rënies nën nivelin 100 për qind deri në fund të javës, konsiderohen si ditë mosplotësimi.

Për mosplotësim të rezervës së detyrueshme, Banka e Shqipërisë zbaton këto gjoba:

- për mosplotësim të rezervës së detyrueshme në lekë, masa e gjobës llogaritet për çdo ditë mosplotësimi, me interesin e ankandit më të fundit për bonot e thesarit me afat maturimi

tremujor, plus 2 për qind;

- për mosplotësim të rezervës së detyrueshme në dollarë amerikanë dhe në euro, masa e gjobës llogaritet, në dollarë amerikanë, për çdo ditë mosplotësimi me interesin LIBOR për depozitat tremujore në dollarë amerikanë të ditës së fundit të muajit për të cilin llogaritet rezerva e detyrueshme, plus 2 për qind.

Për shumat në euro konvertimi bëhet në dollarë amerikanë me kursin e fundit të muajit.

SHËNIME

* Sonila Taçi, specialiste, Departamenti i Kërkimeve.

[1] Me termin "pará e bankës qendrore" (ose siç njihet në literaturë "high powered money" ose "reserve money") nënkuptohet paraja në qarkullim dhe llogaritë e bankave të nivelit të dytë në bankën qendrore. Është kjo pará, mbi të cilën banka qendrore ka autoritet të plotë, që mundëson zbatimin e politikës monetare me anë të instrumenteve indirekte.

[2] Rregullorja për "Mjetet e sigurimit të detyrimit", nr. 111, datë 10.08.1998.

[3] Book-entry system – sistem kontabël që lejon transferimin e të drejtave (letrave me vlerë), pa lëvizjen fizike të dokumenteve letër apo të çertifikatave të pronësisë.

[4] Repo është shkurtimi në anglisht i termit "marrëveshje riblerjeje" (Repurchase Agreement).

[5] Ligji " Për bankat në Republikën e Shqipërisë", nr. 8365, datë 02.07.1998.

[6] LIBOR - London InterBank Offered Rate - norma e interesit e ofruar në tregun ndërbankar londinez.

REFERENCAT

Banka e Shqipërisë, rregullore "Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes", Buletini Zyrtar, Vëllimi 3, Numër 1, Janar 2001.

Banka e Shqipërisë, rregullore "Mbi kredinë lombard", Buletini Zyrtar, Vëllimi 3, Numër 1, Janar 2001.

Banka e Shqipërisë, rregullore "Mbi transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota", Buletini Zyrtar, Vëllimi 3, Numër 1, Janar 2001.

Banka e Shqipërisë, rregullore "Mbi kredinë njëditore", Buletini Zyrtar, Vëllimi 3, Numër 1, Janar 2001.

Banka e Shqipërisë, rregullore "Mbi depozitën njëditore", Buletini Zyrtar, Vëllimi 3, Numër 1, Janar 2001.

International Monetary Fund, "The Adoption of Indirect Instruments of Monetary Policy", IMF Occasional Paper, by a staff team headed by Alexander, William E., Tomás J.T. Baliño, and Charles Enoch, (Washington, June 1995).

European Central Bank, "The Single Monetary Policy in Stage Three", General documentation on ESCB monetary policy and procedures, September 1998.

Skreb, M., "Monetary Policy Instruments and Monetary Policy Implementation in Albania", Working Paper, May 2001.

Axilrod, Stephen H., "Transformations to Open Market Operations" Developing economies and emerging markets, IMF Economic Issues 5, (Washington: International Monetary Fund, December 1996).

Deutsche Bundesbank, "The Monetary Policy of the Bundesbank", October 1995.

Oesterreichische Nationalbank, "The Development of the Monetary Policy Instruments of the Oesterreichische Nationalbank", Reports and Summaries of the Oesterreichische Nationalbank, 2/1996.

The Swiss National Bank, "The Swiss National Bank in brief", January 1999.

EURO - MONEDHA MË E RE

*Fatos Ibrahimi**

Fjalë kyçe
- Euro - Bashkimi Ekonomik dhe Monetar - Eurozonë -

Prej disa vjetësh emërtimi Euro ka hyrë në fjalorin tonë dhe shumë prej nesh mund të mendojnë se dinë gjithçka që duhet të dinë për të. Sidoqoftë, tani që momenti i madh i ndërrimit, ai i kalimit nga një koncept ose monedhë abstrakte në diçka të prekshme dhe të dukshme, po afron, ndoshta do të ishte mirë të shikonim se kur, ku dhe si e ka zanafillën kjo monedhë.

Monedha ka marrë emrin Euro në vitin 1995 në mbledhjen e Këshillit Evropian në Madrid. Ky emër, siç mund të kuptohet lehtë, vjen nga emri i kontinentit të cilit kjo monedhë i përket prej tre vjetësh. Simboli është marrë nga shkronja greke epsilon, kurse dy vijat paralele që përshkojnë simbolin përfaqësojnë stabilitetin e kësaj monedhe. Edhe pse shumë njerëz mund të mendojnë që euro vjen në jetë (hyn në ekzistencë) në datën 1 janar 2002, ideja për krijimin e një monedhe të tillë është hedhur shumë kohë më parë.

Bëhet fjalë për Traktatin e Romës (1957) në të cilin u deklarua se objektivi i Evropës ishte një treg i përbashkët evropian. Ky treg do të luante një rol të pallogaritshëm në rrugën drejt një "bashkimi gjithnjë e më të ngushtë të banorëve të Evropës". Traktati në fjalë u ndoq nga Akti i Evropës së Bashkuar (1986) dhe Traktati mbi Bashkimin Evropian (1992) prej të cilëve

lindi Bashkimi Ekonomik dhe Monetar ose ndryshe, baza për monedhën e përbashkët evropiane.

Nëse koncepti i një monedhe të tillë ka qenë i pranishëm prej mëse gjysmë shekulli, lindja e monedhës së shumëpritur është konfirmuar në 1 janar 1999. Që prej këtij momenti 11 nga vendet e BE (12 që prej pranimit të Greqisë më 1 janar 2001) iu përkushtuan implementimit të një politike të përbashkët monetare dhe adoptimit të një monedhe të vetme, nëndarje e së cilës ishin të gjitha monedhat e vendeve pjesëmarrëse në BE. Këtu ka vend sqarimi se Danimarka, Suedia dhe Britania e Madhe nuk bëjnë pjesë në monedhën e përbashkët evropiane, megjithëse janë anëtare të BE. Këto tre shtete kanë të drejtë të ndjekin politikë të pavarur monetare, por ato nuk lejohen të ndërhyjnë në përcaktimin apo vënien në zbatim të politikës monetare të Zonës së Euros.

Një ide shumë e mirë mund të mos vlejë nëse që prej konceptimit të saj nuk krijohen rrugët apo mjetet për ta vënë në jetë atë. Në rastin e euros, institucioni që e ka lidhur ngushtë ekzistencën me këtë monedhë është Banka Qendrore Evropiane, e cila u krijua në 1 qershor 1998. Kjo bankë, së bashku me bankat qendrore të vendeve anëtare të BE-së që kanë adoptuar euron, përbëjnë atë që quhet Eurosistemi.

Qëllimi kryesor i eurosistemit është ruajtja e stabilitetit të çmimeve gjë të cilën e arrin nëpërmjet përcaktimit dhe zbatimit të politikës monetare, kryerjes së operacioneve valutore dhe operimit të sistemeve të pagesave. Eurosistemi drejtohet nga Këshilli Drejtues dhe Bordi Ekzekutiv i BQE dhe ka marrë përsipër realizimin e politikës monetare për monedhën e përbashkët - euro që nga 1 janari i vitit 1999. Në këtë pikë mund të bëjmë një kalim të shkurtër të fazave të përshkuara nga Bashkimi Ekonomik dhe Monetar (BEM) drejt vendosjes dhe konfirmimit të monedhës së re.

FAZAT E EUROS

Në qershor të vitit 1988, Këshilli Evropian konfirmoi objektivin e realizimit të bashkimit ekonomik të Evropës dhe caktoi

Presidentin e atëhershëm të Komisionit Evropian, Zhak Delor, kryetar të një komiteti, i cili do të studionte dhe do të propozonte hapa konkretë që do të çonin drejt këtij bashkimi. Nga puna e këtij komiteti rezultoi i ashtuquajturi "raporti Delor", i cili propozonte që bashkimi ekonomik dhe monetar të arrihej në tre faza të dallueshme nga njëra-tjetra.

a) Faza I e BEM

Në bazë të raportit të lartpërmendur u vendos që faza e parë e BEM të fillonte në 1 korrik 1990. Kjo fazë përfundoi në dhjetor 1993. Ajo u karakterizua nga heqja e të gjitha barrierave të lëvizjes së lirë të kapitalit midis vendeve të BE-së. Gjatë kësaj faze, koordinimi monetar i shteteve evropiane realizohej nga Komiteti i Guvernatorëve të Bankave Qendrore të vendeve anëtare të BE-së.

b) Faza II e BEM

Faza e dytë e BEM u fillua me krijimin e Institutit Monetar Evropian (1 janar 1994). IME nuk kishte përgjegjësi për zbatimin e politikës monetare të Komunitetit Evropian ashtu siç nuk kishte kompetenca mbi ndërhyrjen në tregjet valutore të shteteve anëtare. Dy detyrat që përmbushi ky institucion ishin: forcimi i bashkëpunimit midis bankave qendrore të vendeve të BE-së si edhe përgatitjet për krijimin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, për zbatimin e një politike monetare të përbashkët si edhe për krijimin e një monedhe të përbashkët në fazën e tretë. Pikërisht gjatë kësaj faze monedha e përbashkët mori emrin Euro.

Në datën 2 maj të vitit 1998 Këshilli i Komunitetit Evropian vendosi unanimisht që 11 vende anëtare të BE-së kishin plotësuar kushtet e nevojshme për adoptimin e monedhës së përbashkët evropiane në fillim të fazës së tretë që do të fillonte në 1 janar 1999. Këto shtete ishin: Belgjika, Gjermania, Spanja, Franca, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Austria, Portugalia, dhe Finlanda.

c) Faza III e BEM

Faza e tretë e BEM njihet si faza e fiksimit të pakthyeshëm të kurseve të këmbimit midis monedhave të secilit prej shteteve pjesëmarrëse në shportën euro dhe monedhës së re. Që prej kësaj date (1 janar 1999) secila nga monedhat e 11-shes u kthye në nënfish të monedhës së përbashkët. Kjo do të thotë që një markë gjermane apo një gulder holandez sot këmbehet me po aq euro sa ç'është fiksuar në datën e lartpërmendur dhe do të jenë po këto kurse këmbimi që do të përdoren që prej momentit kur monedha fizike do të hyjë në përdorim në vendet e BE-së dhe më gjerë.

PARASHIKIMET PËR ECURINË E EUROS PËR VENDET QË NUK I PËRKASIN BE

Gjatë periudhës që bëheshin përgatitjet për fazën e tretë të BME, u hodhën në tryezën e debatit shumë teori dhe ide lidhur me influencën që do të kishte euro jo vetëm në Eurozonë, por edhe në vendet që nuk i përkisnin BE. Ndërkohë që dobitë që do të sillte monedha e re në vendet e Zonës Euro vlerësoheshin të shumta, pikëpyetjet më të mëdha binin mbi rolin që do të luante monedha e re në vendet jashtë BE-së, që kishin dhe kanë marrëdhënie të ngushta tregtare dhe financiare me këtë zonë. Duke qenë se gjetja e një formule të vlefshme për të gjitha vendet ishte e pamundur, ekonomistët, me të drejtë konkluduan se për çdo vend impakti i euros, përveçse nga intensiteti i marrëdhënieve tregtare dhe financiare me vendet e BE-së, do të varej gjithashtu nga hapja e vendit ndaj tregjeve ndërkombëtare të kapitalit si edhe nga politikat e kursit të këmbimit që ndiqen në atë vend.

Meqenëse tregtia ndërkombëtare me Zonën Euro mendohet se luan rolin më të madh ndërmjet këtyre faktorëve, pasojat pozitive të implementimit të monedhës së re shihen në dy drejtime. Së pari, njëjtësimi i monedhës midis vendeve të Eurozonës do t'i bëjë ato më konkurruese në sy të partnerëve të tyre tregtarë, pra të shteteve që nuk bëjnë pjesë në Eurozonë, të cilat do të ballafaqohen me kosto më të ulëta importi. Së dyti,

mendohet se rritja ekonomike e Zonës Euro që pritet të pasojë implementimin e monedhës së re, do të ketë efekte të dukshme edhe në rajone të tjera të botës.

Në një fazë të parë që do të ndiqte implementimin e euros (edhe pse jo në formën e monedhës fizike), pra që pas 1 janarit 1999, parashikohej një dobësim gradual i euros ndaj dollarit amerikan dhe jenit japonez. Kjo do të ndodhte për arsye se tregtia midis vendeve të shportës së euros do të fillonte të kryhej jo më në formën e transaksioneve në monedha të huaja, por në formën e këmbimit midis dy nëndarjeve të së njëjtës monedhë. Në një periudhë të mëvonshme mendohej se roli ndërkombëtar i euros do të rritej duke rritur kështu përdorimin e monedhës në tregjet ndërkombëtare të valutës. Sikur të bënim një analizë aktuale të ecurisë së monedhës evropiane në krahasim me dollarin, do të shihnim se me të vërtetë euro ka pësuar një dobësim gradual ndaj monedhës 'rivale' gjatë dy viteve të fundit.

Grafik 1. Kursi i këmbimit euro/usd gjatë periudhës janar 1999-shtator 2001.



Ecuria e mëtejshme e monedhës evropiane ndaj usd mbetet të analizohet në kuadrin e ecurive të ekonomive që secila nga monedhat mbështet. Ndërkohë që komuniteti evropian dhe mbarë bota përgatiten për daljen fizike të monedhës së re, ekonomistët përpiqen të gjejnë përgjigje për disa probleme që ata mendojnë se do të fillojnë të shfaqen menjëherë pasi euro të mbërrijë në duart e përdoruesve të parasë.

Kur euro si monedhë apo kartëmonedhë të bëhet e prekshme, mund të priten rradhë të gjata para bankave dhe dyqaneve ndërkohë që 302 milionë qytetarë të Evropës do të stepen para parasë së re njësoj si turistët. Miliona produkte dhe shërbime do të riçmohen.

Operacioni do të ndikojë në shtete dhe kompani shumë larg Zonës së Euros. Sipas vlerësimeve një sasi prej rreth 35 miliardë dem qarkullon jashtë BE, kryesisht në Evropën Lindore.

Mali i Zi është një ndër vendet, që pas adoptimit të markës gjermane si monedhë të vetën, do të detyrohet të kthehet nga euro sapo marka gjermane të pushojë së ekzistuari.

PROBLEM (A) – NDRYSHIMET NË ÇMIME MIDIS ZONAVE TË NDRYSHME TË EUROZONËS

Një nga problemet që mendohet se do të rrjedhin nga adoptimi fizik i euros në Zonën e Euros që nga 1 janari 2002, do të jetë mundësia që do t'u jepet konsumatorëve të bëjnë krahasimin midis çmimeve të zonave të ndryshme. Ato hendeqe që monedhat e ndryshme evropiane kanë mundur t'i fshehin deri diku, do të bëhen të dukshme prej momentit kur pagat, çmimet dhe taksat të llogariten në të njëjtën monedhë.

Mendohet se, kur çmimet e mallrave dhe të shërbimeve të konvertohen në euro, do të fillojnë lëvizje masive të blerësve nga zonat me çmime të larta, drejt atyre me çmime më të ulëta me qëllim që të përfitohet në blerjen e makinave, të benzinës e kështu me rradhë. Ai që shihet më me frikë nga ekonomistët sot është reagimi i sindikatave të punëtorëve, të cilat mund të protestojnë ndaj pagave të ulëta të punëtorëve në zona të caktuara. Sipas një parashikimi të bërë gjatë gjysmës së parë të këtij viti, ekonomistët mendojnë se kostot e konvertimit dhe hezitimi i konsumatorëve për të shpenzuar mund të ngadalësojnë rritjen ekonomike të Zonës Euro për vitin 2002 me 0.25 për qind. Ky parashikim nuk ka marrë parasysh ngjarjet e fillimit të shtatorit, gjë që do të thotë që ka të ngjarë që kostot e konvertimit

të jenë akoma më të larta ose që efekti i tyre mbi ritmet e rritjes së Zonës Euro, të jetë akoma më i lartë.

Gjithsesi, konvertimi pritet të ketë dhe efekte pozitive që do të nisin të duken sapo zona në fjalë të rimëkëmbet nga ngadalësimi i vërejtur gjatë vitit të fundit. Nga ana e biznesmenëve ka shpresa se monedha dhe kartëmonedha e re do t'i lehtësojnë tepër bashkimet (shkrirjet) dhe blerjet midis kompanive dhe korporatave. Këto të fundit, nën mbretërimin e sistemit shumëmonedhësh kanë hasur shpeshherë pengesë nga ana e autoriteteve kombëtare gjatë proceseve të lartpërmendura. Pritet që sektori i shërbimeve financiare i cili ka 'vuajtur' më shumë nga barrierat e vendosura nga rregullatorët, të përfitojë më tepër nga konvertimi fizik i monedhës.

PROBLEM (B) INFLACIONI – I RRJEDHUR NGA RRUMBULLAKIMET E ÇMIMEVE LART

Në radhët e ekonomistëve ka lindur shqetësimi se adoptimi fizik i monedhës së re do të krijojë kushte për rritjen e inflacionit, për çrregullimin e politikës monetare në Evropë dhe për zhvlerësimin e euros ndaj dollarit dhe jenit japonez. Megjithëse çmimet në vende të ndryshme evropiane kanë lëvizur në kahe të ndryshme në rastet kur janë bërë ndryshime në numrin e zerove, ekziston frika se konvertimi i çmimeve në euro do të krijojë hapësira për rrumbullakosjen e çmimeve ekzistuese në nivele më të larta.

Nga ana tjetër, një nga dobitë më të mëdha të ekzistencës së euros, madje shtytja kryesore për implementimin e kësaj monedhe, pritet të jetë rritja e shtuar ekonomike e Eurozonës në një periudhë afatgjatë. Për vendet e shportës euro, monedha e re mendohet se do të rrisë nivelin e koordinimit të cikleve ekonomike nëpërmjet marrëdhënieve tregtare, integrimit në tregjet financiare dhe konvergjencës në rritje të politikave ekonomike.

Në prag të janarit 2002, ajo që pritet nga publiku sipas fjalëve të Drejtorit të Bankës Qendrore Evropiane, Vim Dojsenberg,

është besim në monedhën evropiane, e cila është provë që Evropa e bashkuar nuk është një ide abstrakte dhe e largët, por diçka reale dhe dinamike.

* Fatos Ibrahimi, Zëvendësguvernator i Parë i Bankës së Shqipërisë.

EURO DHE KURSI LIGJOR I SAJ

*Neritan Kallfa**

Fjalë kyçe
- Euro - Bashkimi Evropian - Parime bazë -

Në 1 janar 2002, kartëmonedhat dhe monedhat euro do të kenë kurs ligjor në 12 vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Përdorimi i euros ka efekte jo vetëm për Bashkimin Evropian, por edhe për vendet e tjera në ose jashtë Evropës.

EURO NË BASHKIMIN EVROPIAN

Dy janë karakteristikat kryesore që mund të veçohen në këtë proces historik për vendet e Bashkimit Evropian.

E para është, euro do të dalë fizikisht dhe jo si konvencion në veprimet e ndryshme. Pra, në formën e kartëmonedhës dhe të monedhës. Prej 1 janarit 2002, euro është para fizike në formën e kartëmonedhës dhe të monedhës.

Prodhimi i euros filloi në korrik 1999 në disa vende anëtare të Bashkimit Evropian. Sot, procesi i prodhimit të euros realizohet në 11 shtypshkronja të prodhimit të kartëmonedhës në vendet anëtare. Dy nga këto shtypshkronja janë të vendosura në Gjermani dhe çdo vend ka nga një shtypshkronjë të angazhuar për shtypjen e euros me përjashtim të Luksemburgut. Ndërsa meqenëse Greqia iu bashkua Zonës Euro në 1 janar të vitit

2001, prodhimi i saj në Bankën e Greqisë ka filluar në vjeshtën e vitit 2000.

Prodhimi i euros filloi pas disa fazave parapërgatitore: miratimi i konfigurimit dhe i specifikimeve teknike (1998), printimi i serive pilot (për shembull, printimi i sasive të vogla të kartëmonedhës në kushte prodhimi normale) (1998) dhe ngritja e një sistemi të administrimit të cilësisë (1999).

E dyta, është veshja e saj me pushtet. Pushteti i euros quhet "kurs ligjor". Nëpërmjet këtij pushteti euro do të:

- pranohet nga kreditorët për shlyerjen e detyrimit të debitorëve;
- ketë vlerën e përcaktuar në kartëmonedhë dhe monedhë;
- përdoret dhe pranohet për çdo veprim shkëmbimi;
- pranohet botërisht e drejta e përdorimit nga çdo mbajtës i saj;
- çdo njësi ose nënnjësi e saj është plotësisht e këmbyeshme në monedha të tjera apo mall dhe shërbime.

Origjina e euros e ka zanafillën në katër parimet kryesore të Bashkimit Evropian. Bashkimi Evropian ndërtohet mbi këto parime kryesore:

1. lëvizja e lirë e mallrave: dogana, tatimet dhe taksat;
2. lëvizja e lirë e mallrave: kufizimet sasiore;
3. lëvizja e lirë e kapitalit dhe bashkimi ekonomik dhe monetar;
4. lëvizja e lirë e krahut të punës.

Është parimi i tretë mbi të cilin është mbështetur konceptimi i euros. Ky parim përbëhet nga dy elemente si më poshtë:

1. lëvizja e lirë e kapitalit;
2. bashkimi ekonomik monetar.

Është elementi i dytë, Bashkimi Ekonomik Monetar, i cili krijoi premisa për aplikimin e parasë së Bashkimit Evropian.

(Tentativa e parë.) Zhvillimi historik e ka zanafillën në vitin 1969, në të cilin Kryetarët e Shteteve Anëtare vendosën të hartojnë planin për Bashkimin Ekonomik dhe Monetar. Komiteti Werner i krijuar për këtë qëllim konkludoi se Bashkimi Ekonomik dhe Monetar ka dy mundësi:

- këmbimin total dhe të pakthyeshëm të monedhave, të çliruara nga fluktacionet në kurset e këmbimit; ose
- më e preferueshmja do të ishte zëvendësimi në një monedhë të vetme.

(Tentativa e dytë.) Në zhvillimin historik shënohet një hap tjetër i rëndësishëm në vitin 1978, me krijimin e Sistemit Monetar Evropian (EMS). Sistemi institucionalizoi Mekanizmin e Këmbimit Valutor (ERM) dhe Njësinë Evropiane të Monedhës (ECU). Vlera e shkëmbimit të ECU-s ishte e përcaktuar kundrejt shportës së monedhave të vendeve anëtare të Komunitetit. ERM operonte nëpërmjet përcaktimit të vlerës së shkëmbimit të monedhës me ECU-në. Këto vlera, për sa kohë vendoseshin në mënyrë kolektive nuk mund të ndryshoheshin individualisht. Në rradhë të parë përcaktohej vlera e monedhës kombëtare me atë të ECU-së dhe më pas përcaktohej vlera e shkëmbimit me monedhat e tjera të vendeve anëtare. Vlera lëvizte normalisht midis një bande prej 2.25 për qind dhe maksimumi ishte 6 për qind. Kur kalonte kufijtë e parashikuar bankat qendrore ndërhynin për të normalizuar situatën.

(Tentativa e tretë.) Angazhimi politik i ndërmarrë nga Kryetarët e Shteteve Anëtare në vitin 1972, ishte shkaku i ripërfshirjes në axhendën e Samitit të Hanoverit 1988, pasojë e të cilit ishte mbledhja e këshillit në Madrid, në vitin 1989 për të vendosur mbi këtë çështje. Një komitet u krijua në mënyrë që të ndihmonte Këshillin në marrjen e vendimeve. Ky komitet u kryesua nga Jacque Delors, Presidenti i Komisionit. Komiteti Delors propozoi që Bashkimi Evropian Monetar të krijohej në tre faza.

Elementet e fazës së parë konsistojnë në përfundimin e krijimit të tregut të përbashkët, konvergimin më të ngushtë të ekonomive dhe anëtarësimin e të gjitha shteteve anëtare në

ERM. Në këtë fazë nuk ishte e nevojshme mbështetja juridike nga traktati. Në fazën e dytë ishte parashikuar krijimi i sistemit të bankave qendrore (ESCB), me qëllim që të koordinoheshin politikat monetare dhe formulimi i politikave monetare të përbashkëta për Komunitetin. Faza e tretë, përbënte fiksimin e kurseve të këmbimit dhe lindjen e monedhës së vetme evropiane, administrimi i të cilës do t'i besohej sistemit të bankave qendrore. Sistemi i bankave qendrore ishte konceptuar që në atë kohë si i pavarur dhe me objekt kryesor arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Por, raporti Delors parashikonte edhe kontrollin qendror mbi politikat kombëtare fiskale, për sa kohë këto politika mund të kishin impakte dhe pasoja për inflacionin ose përqindjen e interesave për të gjitha shtetet.

Ishte Traktati i Bashkimit Evropian që vendosi themelet drejt krijimit të Bashkimit Monetar Evropian, duke përcaktuar fillimin e fazës së dytë në 01.01.1994.

Së pari, hartimi i politikave ekonomike të vendeve anëtare së bashku duke përcaktuar objektivat brenda tregut të përbashkët, mbi parimin e lirisë së tregut dhe të konkurrencës së lirë. Këtu përfshihej edhe konceptimi i monedhës së vetme evropiane dhe objekti i veprimtarisë së sistemit të bankave qendrore në funksion të politikës ekonomike të Komunitetit.

Së dyti, kontrolli i dyfishtë i politikës fiskale nëpërmjet komisionit, duke kërkuar zvogëlimin e deficitit të vendeve anëtare në nivelet e parashikuara.

Së treti, është rregullimi i drejtpërdrejtë i politikës monetare me dispozita në Traktat. Kjo shënon krijimin e Institutit Evropian Monetar (EMI), i cili ishte paraardhësi i bankës qendrore evropiane (ECB). EMI përgatiti fazën përgatitore të krijimit të sistemit, duke përfshirë edhe përgatitjen e vetë ECU-së (sot euro).

Faza e tretë sipas Traktatit fillon jo më vonë se 01.01.1999. Përveç parakushteve të përcaktuara në fazën e parë dhe atë të dytë, sigurisht të vlerësuara nga Komisioni dhe EMI, komponent

shumë i rëndësishëm për kalimin në fazën e tretë ishte se, sa të pavarura ishin bankat qendrore në vendet anëtare dhe se sa e deri në çfarë shkalle ishte konvergimi i ekonomive. Plotësimi i këtyre parakushteve do të shënonte lindjen e euros. Ishin katër kritere:

1. Arritja e një shkalle të lartë të stabilitetit të çmimeve (mesatarja e përqindjes së inflacionit përgjatë një viti dhe që nuk duhej të kalonte mbi 1.5 për qind mbi nivelin mesatar të tre vendeve më të mira anëtare).
2. Qëndrueshmëria në gjendjen financiare të qeverive të vendeve anëtare (nivelet vjetore të deficitit buxhetor më pak se 3 për qind të PBB).
3. Mbarëvajtja e niveleve të fluktacioneve të përcaktuara nga ERM për të paktën dy vjet.
4. Qëndrueshmëria në konvergimin e ekonomisë e reflektuar në përqindjen e interesave afatgjatë.

Faza e tretë e lindjes së euros shënohet me krijimin e institucionit (ECB) dhe legalizimin e pushtetit të këtij institucioni mbi politikën monetare të Komunitetit Evropian.

Kartëmonedha dhe monedha euro është legjitimuar me aktet e mëposhtme:

1. Rregullore e Këshillit Evropian (EC) Nr. 1103/97, 17 qershor 1997.
2. Rregullore e Këshillit Evropian (EC) Nr. 974/98, 3 maj 1998.
3. Rregullore e Këshillit Evropian (EC) Nr. 2866/98, 31 dhjetor 1998.

EURO NË VENDET E TJERA

Euro formalisht në vendet e tjera kushtëzohet nga ligji monetar dhe e drejta kontraktore e vendeve joanëtare të Bashkimit Evropian.

---

* Neritan Kallfa, Këshilltar i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.

Punonjësit e bankave qendrore
Teuta Baleta
Mars 2002

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë e realizuar nëpërmjet operacioneve të tregut të hapur gjatë vitit 2001
Suzana Sheqeri
Arta Pisha
Mars 2002

Rreziku i kreditit dhe agjencitë listuese të cilësisë së kreditit
Aida Hysi
Mars 2002

2002

Depozitat në sistemin bankar në periudhën 1999-2000
Suzana Sheqeri
Edlira Abazi
Qershor 2002

Çështje të administrimit të Burimeve Njerëzore në Bankën e Shqipërisë
Ervin Fortuzi
Qershor 2002

Programi i kompensimeve i një banke qendrore
Zhizela Balla
Qershor 2002

Argumente mbi nivelin e kapitalit minimal të paguar
Erjona Suljoti
Shtator 2002

PUNONJËSIT E BANKAVE QENDRORE

*Teuta Baleta**

Fjalë kyçe
- Bankë qendrore - Numri i punonjësve - Rekrutim - Mandati i Guvernatorit -

Termi "bankë qendrore" është përdorur mjaft herët. Për herë të parë ky term është përdorur në vitin 1873 nga Walter Bagheot, editorialist në revistën "The economist". Akoma më e hershme është data e krijimit të institucionit të bankës qendrore. Banka e parë qendrore në botë është ajo e Suedisë e themeluar në vitin 1668. Qëllimi i krijimit të kësaj banke ishte të mundësonte financimin e shpenzimeve ushtarake. Ndërsa veprimtaria bankare qendrore, siç e njohim sot, është një shpikje e shekullit XX[1]. Ky shekull është quajtur ndryshe dhe shekulli i bankave qendrore.

Grafik 1. Numri i bankave qendrore (1900-2001).



Burimi: Morgan Stanley Central Bank Directory, 2002.

Numri i bankave qendrore u rrit ndjeshëm, nga 18 në vitin 1900[2] në 173 në vitin 2001. Në botë sot punojnë rreth gjysmë milioni bankierë qendrorë (535 114 vetë)[3].

Sot, bankat qendrore janë shndërruar në institucione të rëndësishme për ekonominë e një vendi. Kjo ka ardhur si pasojë e rolit të rëndësishëm që luajnë sidomos në katër fusha: nxitja e stabilitetit të çmimeve, ruajtja e funksionimit të duhur të sistemeve të pagesave; mbikëqyrja e sektorit financiar dhe administrimi i krizave financiare.

Të gjitha diskutimet e sotme për rolin dhe funksionet e bankave qendrore, për politikën monetare, për mbikëqyrjen bankare, për modelet dhe parashikimet, pavarësinë dhe përgjegjshmërinë etj., marrin jetë nga aktiviteti i përditshëm i personelit të bankave qendrore. Për këtë arsye mbetet i pranishëm diskutimi se sa personel duhet të ketë një bankë qendrore për të përmbushur me sukses dhe eficiencë detyrat e saj. Ky diskutim nuk mund të ketë një përgjigje të drejtpërdrejtë dhe të vetme. Numri i punonjësve të bankave qendrore, praktikisht, është një tregues që nuk mund të krahasohet midis bankave qendrore të vendeve të ndryshme. Arsyeja kryesore ka të bëjë me funksionet që kryejnë bankat qendrore. Megjithëse, në tërësi, ka një standardizim në drejtim të funksioneve bazë të bankave qendrore si politika monetare, operacionet monetare etj., bankat qendrore sipas nevojave të vendit apo traditave mund të kryejnë edhe detyra të tjera. Më i dallueshëm është funksioni i mbikëqyrjes bankare.

Në disa vende ky funksion është nën autoritetin e bankës qendrore, në vende të tjera jo, pa patur një model unik. Po kështu, bankat qendrore mund të angazhohen me detyra të llogaritjes së treguesve statistikorë jo të lidhur drejtpërdrejt me politikën monetare. Funksionet e shërbimeve janë detyra të zgjidhura në forma të ndryshme duke blerë shërbime nga të tretë ose duke i kryer vetë ato. Apo si në rastin e Bankës së Shqipërisë, ku pjesë përbërëse e aktivitetit të bankës qendrore është edhe aktiviteti i Bursës së Tiranës, një përvojë pothuaj unike. Të gjitha këto kanë ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë tek numri i punonjësve të bankave qendrore. Përveç kësaj, është e

qartë që numri i punonjësve të bankës qendrore varet dhe nga eficienca e tyre në punë.

Ndryshimet e sotme kanë evidentuar tre prirje të përgjithshme: numri i bankave qendrore në botë rritet, numri i bankierëve qendrorë po bie, afati i qëndrimit faktik në detyrë të guvernatorit po rritet.

Bankat qendrore janë rritur në numër kryesisht si pasojë e shfaqjes së shteteve të reja dhe e krijimit të bankave në ato shtete ku nuk kanë ekzistuar më parë. Numri i përgjithshëm i punonjësve tenton të reduktohet sepse bankat përpiqen të ekonomizojnë kostot e tyre dhe/ose të humbasin disa funksione[4]. Ndërsa, qëndrimi faktik i guvernatorit në post po rritet si pasqyrim i përpjekjeve për të forcuar pavarësinë e bankave qendrore, sidomos atë reale.

Tabelë 1. Të dhëna mbi bankat qendrore të disa shteteve.

Nr.	Shteti	Nr. punonjësve	Nr. punonjësve për 100000 banorë	Viti i krijimit të bankës qendrore
1	Kina	150000	11.8	1948
2	Rusia	80700	55.5	1990
3	SHBA	23056	8.3	1914
4	Gjermania	16074	19.4	1948
5	Franca	15265	25.6	1800
6	Italia	8515	14.8	1893
7	Turqia	5500	8.3	1931
8	Japonia	5415	4.3	1882
9	Spanja	3124	7.8	1829
10	Greqia	3096	29.1	1927
11	Rumania	2444	10.9	1880
12	Belgjika	2408	23.5	1850
13	Mbretëria Bashkuar	2344	3.9	1694
14	Argjentina	2191	5.9	1935
15	Malajzia	2124	9.6	1958
16	Afrika Jugut	2133	4.9	1920
17	Korea Jugut	2078	4.3	1950
18	Holanda	1842	11.5	1814
19	Portugalia	1828	18.2	1846
20	Kanadaja	1539	4.9	1934
21	Republika Çeke	1450	14.1	1993
22	Libani	1351	37.2	1964
23	Sllovakia	1320	24.4	1993
24	Hungaria	1201	11.9	1924
25	Bullgaria	1200	15.6	1879
26	Austria	1121	13.8	1816
27	Polonia	1118	2.9	1945
28	BQE	1032		1998

29	Jugosllavia	1000	9.4	1883
30	Australia	977	5.0	1945
31	Ukraina	995	2.0	1991
32	Lituania	884	24.5	1922
33	Tajvani	876	3.9	
34	Izraeli	846	14.2	1954
35	Singapori	842	19.6	
36	Kazakistani	834	5.0	1990
37	Jordania	815	15.8	1963
38	Bjellorusia	814	7.9	1990
39	Irlanda	720	18.7	1943
40	Finlanda	702	13.6	1811
41	Letonia	685	28.7	1922
42	Norvegjia	630	14.0	1816
43	Hong Kongu	601	8.3	1993
44	Kroacia	583	13.5	1991
45	Zvicra	583	8.0	1907
46	Kili	561	3.7	1925
47	Danimarka	553	10.3	1818
48	Moldavia	496	11.2	1991
49	Suedia	488	5.5	1668
50	Sllovenia	384	19.9	1991
51	Malta	300	76.0	1967
52	FYROM	284	13.9	1992
53	Qipro	273	35.8	1963
54	Estonia	250	17.6	1919
55	Bosnje dhe Hercegovina	240	6.1	1997
56	Zelanda e Re	199	5.1	1933
57	Luksemburgu	180	40.6	1983
58	Islanda	114	41.0	1961

Burimi: Morgan Stanley Central Bank Directory, 2002.

Megjithatë, tendenca e përgjithshme e reduktimit të numrit të punonjësve të bankës qendrore nuk është e njëjtë për çdo rajon. Përgjithësisht, banka që sapo janë krijuar apo ende janë në proces të zhvillimit institucional kanë prirje të shtojnë numrin e punonjësve.

I vetmi kontinent ku kjo mbetet kategorikisht e pavërtetë është Afrika kur tre të katërtat e bankave qendrore janë ende në zgjerim. Gjithashtu, shumë banka në Evropën Lindore dhe në ish-Bashkimin Sovjetik janë ende në zgjerim. Banka Kombëtare e Republikës së Bjellorusisë shtoi 92 punonjës vitin e fundit dhe është zgjeruar nga 364 punonjës në vitin 1993 në 814 sot, ndërsa Banka Qendrore e Bosnjës dhe Hercegovinës është fryrë si një tullumbace nga 157 në vitin 1999 në 240 në vitin 2001. Të tjera banka me rritje të konsiderueshme në numrin e punonjësve janë bankat qendrore të Shqipërisë, Gjeorgjisë dhe Maqedonisë. Disa, megjithatë, duket se tashmë kanë arritur

pikun dhe po fillojnë të reduktojnë personelin, si për shembull, Banka Qendrore e Bullgarisë, e cila u ngrit nga 479 punonjës në vitin 1992, në 1330 në vitin 1998 dhe tani ka rënë në 1200. Në mënyrë të ngjashme, Banka e Letonisë rriti numrin e punonjësve nga 200 në vitin 1993 në 715 në vitin 2000, por, aktualisht, punëson 685 punonjës; Banka Qendrore e Moldavisë është një rast i ngjashëm. Në Bankën Kombëtare të Hungarisë numri i punonjësve ka qenë në rënie të qëndrueshme qysh në vitin 1993, duke rënë nga 2654 në 1201 punonjës këtë vit[4]. Sistemi i bankave qendrore evropiane ka të punësuar rreth 56 mijë vetë, një shifër sa dyfishi i sistemit të Rezervës Federale të SHBA, megjithëse ekonomia e SHBA është më e madhe. "...Evropa ka shumë bankierë qendrorë dhe është koha për t'i dhënë fund kësaj përmbytjeje"[5].

Në tërësi, numri i punonjësve të bankave qendrore ka një tendencë rritjeje në vitet e para të aktivitetit, arrin një pik dhe më pas fillon të bjerë.

I. PERSONELI I BANKËS SË SHQIPËRISË NË VITE

Banka qendrore e një vendi është institucion përgjithësisht i pavarur nga ekzekutivi. Një element i ushtrimit të së drejtës së pavarësisë është edhe pavarësia në politikat e punësimit të personelit të bankës qendrore. Përgjithësisht, bankat qendrore synojnë të tërheqin personel të kualifikuar, të aftë për të siguruar kryerjen me sukses të detyrave të bankës qendrore. Kjo politikë ka koston e vet, e cila në formën më të drejtpërdrejtë shfaqet në nivelin e pagave. Pagat dhe shpërblimet e paguara për personelin e sistemit të bankave qendrore evropiane, gjatë vitit 2001, vlerësohen rreth 4.2 miliardë dollarë amerikanë[6].

Nga ana tjetër, banka qendrore duhet të siguroje që nuk abuzohet apo keqpërdoret pavarësia në çështjet e rekrutimit të personelit. Për këtë, vëmendja përqendrohet në rritjen e eficiencës së personelit të saj. Për këto arsye, i kushtohet vëmendje aspekteve që kanë të bëjnë me personelin dhe

ndjekjes së treguesve të tillë, si numri i punonjësve të bankave qendrore.

Përmendja e Bankës së Shqipërisë si një bankë qendrore që ka rritur ndjeshëm numrin e punonjësve, në artikullin e cituar të revistës "Central Banking" tërhoqi vëmendjen për të parë ecurinë e këtij treguesi në periudhën 1992-janar 2002.

Grafik 2. Numri i punonjësve faktikë të Bankës së Shqipërisë.



Gjatë periudhës 1992-janar 2002, në Bankën e Shqipërisë kanë qenë të punësuar mesatarisht çdo vit 300 nëpunës. Nisur nga numri i punonjësve gjithsej, Banka e Shqipërisë renditet e 125-ta në rendin zbritës ndër bankat qendrore sot në botë. Megjithatë, personeli i saj është mjaft i ulët në krahasim me numrin mesatar të një banke qendrore, prej 3148 vetësh madje edhe me numrin medianë prej 693 vetësh. Në përgjithësi, tendenca e vërejtur, siç pritej, ka qenë rritja e numrit të punonjësve, mesatarisht me 5 për qind çdo vit. Kjo rritje nuk ka qenë e njëtrajtshme, por mund të ndahen qartë periudhat e mëposhtme:

- Gjatë viteve 1992-1997 numri i punonjësve të Bankës së Shqipërisë është rritur ndjeshëm nga 210 në 372. Rritja në këtë periudhë është e justifikuar, për faktin se banka qendrore u krijua në vitin 1992 dhe mjaft nga funksionet e saj përfaqësoheshin me një punonjës ose vetëm si vende pune. Gjatë kësaj periudhe në Bankën e Shqipërisë u

kryen të gjitha rregullimet e nevojshme strukturore për të plotësuar kuadrin organizativ si me funksione ashtu edhe me personelin përkatës.

- Vitet 1998 dhe 1999 në të cilët numri i punonjësve reduktohet, duke arritur në 272. Në këto dy vite, gjithashtu, kanë ndodhur rregullime strukturore si dhe shkurtime punonjësish në kuadër të programit qeveritar për të pakësuar numrin e punonjësve të administratës shtetërore.
- Gjatë viteve 1999-2002 përsëritet pamja e periudhës së parë, domethënë vërehet rritje e numrit të punonjësve të Bankës së Shqipërisë.

Struktura në Bankën e Shqipërisë, përveç ndarjes në departamente, sektorë, zyra etj., për qëllime të politikës së personelit dhe të punësimit është e ndarë në këto kategori:

- nëpunës kryesorë, ku përfshihen të gjithë ata punonjës që i përkasin departamenteve që përmbushin funksionet bazë kryesore të bankës qendrore, si Departamenti i Kërkimeve dhe Politikave Monetare, Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Mbikëqyrjes etj.;
- nëpunës dytësorë ku përfshihen të gjithë ata punonjës që i përkasin departamenteve që përmbushin funksione dytësore të nevojshme për bankën qendrore dhe që ndihmojnë në kryerjen e detyrave kryesore, si Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave, Departamenti Teknologjisë Informacionit, Departamenti Juridik dhe Burimeve Njerëzore etj.;
- nëpunës mbështetës ku përfshihen të gjithë ata punonjës që kryejnë funksione mbështetëse për aktivitetin e bankës qendrore si shërbimin e pastrimit, të sekretarisë, të transportit etj..

Të treja grupet e mësipërme përfaqësojnë administratën në qendër të Bankës së Shqipërisë. Personeli i saj plotësohet dhe me punonjësit e degëve të Bankës në rrethe, të Shtypshkronjës dhe të Qendrës së Trajnimit të Bankierëve, e cila funksionoi për periudhën 1993-1998. Në këtë mënyrë, ndryshimet në numrin e punonjësve janë shkaktuar nga ndryshimet e të gjitha kategorive.

Karakteristikë për personelin e bankës qendrore është niveli relativisht i ulët i nëpunësve kryesorë, pra i atij grupi që përmbush funksionet bazë të bankës. Mesatarisht nëpunësit kryesorë kanë përbërë rreth 1/5 (21.5 për qind) të punonjësve gjithsej të Bankës së Shqipërisë. Nga 40 që ishin në vitin 1992, kjo kategori aktualisht numëron 69 vetë, ndërsa numrin më të madh e ka arritur në vitin 1997 me 93 vetë. Raporti nëpunës kryesorë/nëpunës dytësorë mesatarisht për të gjithë periudhën e shqyrtuar është 1.

Numri i ulët i nëpunësve kryesorë të bankës qendrore jo domosdoshmërisht është tregues i eficiencës së lartë në punë. Nga ana tjetër, niveli i lartë i nëpunësve dytësorë dhe mbështetës tregon për një administrim joefikas të kësaj pjese të aktivitetit të bankës.

Karakteristikë tjetër është fakti që tendenca gjatë periudhës nuk ka qenë ajo e rritjes së vazhdueshme të kategorisë së nëpunësve kryesorë. Përveç kësaj, masat që u morën pas vitit 1997 për reduktimin e të punësuarve në Bankën e Shqipërisë duket se më tepër prekën këtë kategori. Kështu, në fund të vitit 1999 krahasuar me fundin e vitit 1997 kishte 31 vetë më pak nëpunës kryesorë kundrejt:

- 14 vetë më pak si nëpunës dytësorë;
- 12 vetë më pak si nëpunës mbështetës;
- 19 vetë më pak si nëpunës të administratës së degëve në rrethe;
- 19 vetë më pak si nëpunës të shtypshkronjës;
- 5 vetë më pak si nëpunës të Qendrës së Trajnimit pasi kjo njësi u shkurtua si strukturë.

Nga ana tjetër, rritja e numrit të punonjësve deri në fillim të vitit 2002, gjithashtu nuk ka ndodhur në kategorinë e nëpunësve kryesorë, por te kategoritë e tjera. Nëpunësit kryesorë janë shtuar me 7 vetë në krahasim me fundin e vitit 1999 kundrejt shtimit me:

- 33 vetë të nëpunësve dytësorë;
- 19 vetë të nëpunësve të administratës së degëve në rrethe.

Kategoria e nëpunësve mbështetës është reduktuar me 8 vetë.

Grafik 3. Ritmi vjetor i ndryshimit të numrit të punonjësve.



Për këtë arsye, nëse mesatarisht Banka e Shqipërisë ka rreth 9.6 nëpunës për njëqindmijë banorë, një shifër relativisht e lartë po të krahasohet me mjaft prej bankave të vendeve të zhvilluara, ka vetëm 2.1 nëpunës kryesorë për njëqindmijë banorë, pra një nivel mjaft të ulët.

Grafik 4. Numri i punonjësve faktikë të Bankës
së Shqipërisë për 100000 banorë.



Një paraqitje e tillë e shifrave dhe e ecurisë së numrit të punonjësve të Bankës së Shqipërisë dhe e kategorizimit të tyre ka mjaft rëndësi për të përcaktuar strategjinë, të paktën afatmesme,

në këtë drejtim. Është e qartë që Banka e Shqipërisë për të rritur cilësinë e punës së saj duhet të përqendrohet në zhvillimin e funksioneve bazë. Në rradhë të parë, kjo kërkon pajisjen e nevojshme me personel. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë ka nevojë të përmirësojë administrimin e anëve të tjera të aktivitetit të saj, duke synuar të rrisë eficiencën.

Prirja, të paktën edhe për periudhën afatmesme, duke marrë të pandryshuar strukturën e bankës qendrore, do të jetë rritja e personelit të saj. Por, do të ishte e përshtatshme të rregulloheshin raportet midis kategorive të ndryshme. Kështu, më tepër punonjës duhet të jenë në shërbim të funksioneve bazë të Bankës apo të atyre funksioneve, që për vetë mjedisin shqiptar paraqesin rëndësi. Praktikisht, në të ardhmen përqendrimi i punonjësve duhet të shihet në sektorë të tillë si kërkimet, analizat apo statistikat.

Po kështu, "për të hequr barrën" që vjen nga funksione jotipike për bankën qendrore, do të ishte i rekomandueshëm largimi i mjaft shërbimeve mbështetëse, të cilat mund të sigurohen prej të tretëve apo që thjesht nuk janë të përshtatshme të kryhen nga një bankë qendrore. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë nuk ka pse të angazhojë energji për aktivitete si tregu i kapitaleve, shtypshkrimet apo dhe shërbime të thjeshta si ato të pastrimit, përkthimit etj..

Mbikëqyrja bankare paraqet një aspekt më delikat. Sot mjaft banka qendrore po heqin dorë nga mbikëqyrja bankare duke ia besuar atë agjencive të tjera dhe kjo lëvizje është shoqëruar me reduktim personeli. Megjithatë, nuk është e rekomandueshme që Banka e Shqipërisë të jetë agresive në këtë çështje dhe të largojë këtë funksion, të paktën dhe për një periudhë pesëvjeçare. Diskutimi i këtij problemi nuk është objekt i këtij shkrimi, megjithatë është e dobishme të theksohet se ky sektor duhet të mbështetet me personel të shtuar për të përballuar aktivitetin, që vjen duke u rritur dhe nevojën për mbikëqyrje më cilësore.

Tabelë 2. Numri faktik i punonjësve të Bankës së Shqipërisë.

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
I. Administrata në qendër	113	131	178	221	241	266	229	209	214	238	241
Nëpunës kryesorë	40	38	66	84	66	93	68	62	70	66	69
Nëpunës dytësorë	47	53	55	65	82	76	76	62	64	95	95
Nëpunës mbështetës	26	40	57	72	93	97	85	85	80	77	77
II. Administrata lokale (degët)	63	61	68	57	57	56	39	37	54	56	56
III. Shtypshkronja	48	48	45	45	45	45	31	26	26	26	26
IV. Qendra e trajnimit		5	4	5	5	5	1				
Gjithsej	224	245	295	328	348	372	300	272	294	320	323

Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti Juridik dhe Burimeve Njerëzore.

II. BANKA E SHQIPËRISË DHE DISA BANKA TË RAJONIT

Nëse krahasojmë treguesit e mësipërm me disa nga bankat e rajonit që veprojnë në popullsi të ngjashme me atë të Shqipërisë, vërejmë se banka qendrore e Shqipërisë qëndron në pozita më favorizuese, duke pasur numrin më të vogël të personelit si në shumë absolute ashtu dhe në raport me popullsinë si dhe me tendencë jo të theksuar rritjeje të këtij treguesi. Ky pozicion pasqyron faktin që edhe për disa vite, Banka e Shqipërisë do të vijë duke rritur numrin e punonjësve në përgjigje të konsolidimit të funksioneve që zhvillon dhe sidomos të përmirësimit të cilësisë së kryerjes së tyre. Rritja e eficiencës ka nevojë të kërkohet në një fazë të dytë, të mëvonshme.

Tabelë 3. Banka e Shqipërisë dhe banka të ngjashme.

Shteti	Popullsia (në milionë)	Nr. punonjësve të bankës	Nr. punonjësve të bankës për 100000 banorë	Ndryshimi i nr. të punonjësve në % 1996-2001
Bosnje-Hercegovina	3.9	240	6.1	
Moldavia	4.4	496	11.2	16.4
Armenia	3.3	379	11.4	31.6
Kroacia	4.3	583	13.5	35.3
FYROM	2.1	284	13.9	45.6
Sllovenia	1.9	384	19.9	-3.3
Shqipëria*	3.1	320	9.6	-8.0

Burimi: Morgan Stanley Central Bank Directory, 2002.

* Banka e Shqipërisë.

III. QËNDRIMI I GUVERNATORIT NË DETYRË

Një nga tendencat e kohëve të fundit është një rritje graduale e pritshmërisë për periudhën e qëndrimit në zyrë të guvernatorëve. Në vitin 2001 ka patur 23 guvernatorë të rinj, në pjesën më të madhe të rasteve për shkak të përfundimit të mandateve të guvernatorëve të mëparshëm, por edhe të rasteve të zëvendësimit para kohe. Fluksi hyrës mesatar i guvernatorëve të rinj nga viti 1997 është 27, mesatare e cila u rrit në vitin 1999 me një ndryshim veçanërisht të lartë kur u emëruan 37 guvernatorë të rinj. Një llogaritje e shpejtë tregon se pritshmëria mesatare për periudhën e qëndrimit në zyrë të guvernatorëve të bankave qendrore është rreth 6.5 vjet dhe në një tendencë në rritje[8]. Një tregues i matjes së pavarësisë reale të bankës qendrore është norma e ndërrimit të guvernatorëve. Llogaritja e këtij treguesi, për herë të parë në shtator të vitit 1999[9], konfirmoi një nivel mjaft të ulët të pavarësisë reale. Kështu çdo guvernator kishte shërbyer në detyrë mesatarisht 18 muaj. Duke u bazuar në qëndrueshmërinë që ka patur drejtimi i bankës qendrore pas vitit 1997, vërehet dhe një përmirësim i ndjeshëm i treguesit. Qëndrimi në detyrë i guvernatorit është rritur në mesatarisht 24 muaj.

Megjithatë, sipas këtij treguesi, Banka e Shqipërisë është ende larg të qenurit e pavarur realisht. Qëndrimi faktik në detyrë përfaqëson 28.6 për qind të mandatit 84-mujor të një

Grafik 5. Pavarësia ligjore e Bankës së Shqipërisë dhe mandati real i Guvernatorit (periudha prill 1992 – mars 2002).



guvernatori. Duke patur parasysh që pragu, që ndan qarkullimin e lartë me atë të ulët të guvernatorit i merr vlerat në intervalin [0.2; 0.25] për rastin e Bankës së Shqipërisë numri mesatar i ndryshimit të guvernatorit për një vit është ende i lartë, në nivelin 0.5.

Pra, nëse është konfirmuar deri tani prirja për rritjen e periudhës së qëndrimit në zyrë të guvernatorit, ligjërisht dhe realisht, kjo periudhë është sa 1/3 e mesatares së përgjithshme. Kjo prirje është ndikuar, përveç të tjerash, edhe nga rritja e pavarësisë ligjore. Megjithëse pavarësia ligjore dhe ajo reale janë komponentë të pavarësisë gjithsej të bankës qendrore, forcimi i së parës krijon premisa për rritjen e së dytës. Në periudhën në shqyrtim, për rastin e Bankës së Shqipërisë, mund të thuhet që forcimi i pavarësisë ligjore (i matur me indeksin e ndërtuar prej Cukierman)[7, 8, 9] ka ndihmuar në rritjen e pavarësisë reale, madje ndjeshëm (koeficienti i korrelacionit është 0.7).

Tabelë 4. Korrelacioni ndërmjet pavarësisë reale dhe pavarësisë ligjore.

		Pavarësia reale	Pavarësia ligjore
Pavarësia ligjore	Korrelacioni	0.688	1.000
	Sig. (2-tailed)	0.000	
	N	120	120

Korrelacioni është i rëndësishëm në nivelin 0.01 (2-tailed).

IV. KONKLUZIONE

Sot, si prirje e përgjithshme, vërehet se po rritet roli i bankave qendrore në ekonomi; po rritet pavarësia e tyre duke i kthyer në institucione të rëndësishme për ekonominë e vendeve; për pasojë bankat qendrore po rrisin përpjekjet për t'u bërë më eficiente dhe për t'u përqendruar kryesisht në funksionet e tyre bazë. Kjo prirje e përgjithshme pasqyrohet në numrin e punonjësve të bankave qendrore dhe në cilësinë e tyre.

Në tërësi, numri i punonjësve të bankave qendrore rritet me krijimin dhe zhvillimin e bankës, arrin një pik, dhe fillon të bjerë me rritjen e interesit për të qenë më eficient si dhe i përqendruar në funksionet bazë të bankës qendrore. Për këtë

arsye, nëse në bankat qendrore të vendeve të zhvilluara vërehet tendenca e reduktimit të numrit të punonjësve ose treguesi relativ i punonjësve për njëqindmijë banorë është në nivele të ulëta gjë që flet për rendiment dhe eficiencë më të lartë në punë; vendet më pak të zhvilluara apo në zhvillim janë ende në pjesën rritëse të kurbës. Kjo vjen për shkak të plotësimit të tyre me funksione, zhvillimit të funksioneve që mund të mos jenë pjesë përbërëse e aktivitetit normal të bankës qendrore, nivelit më të ulët teknologjik të aplikuar si dhe cilësisë së personelit.

Është e qartë që një histori të tillë zhvillimi do të ndjekë edhe Banka e Shqipërisë. Në tërësi, për të paktën tre vitet e ardhshme, duke supozuar se nuk do të largohet asnjë funksion aktual i bankës, do të vërehet rritje e numrit të punonjësve. Objektivi duhet të jetë që rritja e numrit të punonjësve të shkojë kryesisht në ato njësi, që kanë për detyrë të mundësojnë ushtrimin e detyrave bazë të bankës qendrore, jo në personel mbështetës.

Gjithsesi, është në interes të Bankës së Shqipërisë dhe në ndihmë të përmirësimit të administrimit të saj zhveshja prej aktiviteteve dytësore, të cilat fare mirë mund të sigurohen si shërbime prej të tretëve.

SHËNIME

* Teuta Baleta, Drejtore, Departamenti i Kërkimeve dhe Politikës Monetare.
[1] "The economist", 25 shtator 1999.
[2] "The economist", 28 nëntor 1998 dhe 19 shkurt 2000.
[3] Morgan Stanley Central Bank Directory, 2002, Londër, 2002, fq. XI.
[4] "Central banks' vital statistics", Central Banking, volume XII, nr. 2, nëntor 2001, fq. 10,11.
[5] "Europe's costly surplus of central bankers", Business Week, 21 janar, 2002.
[6] "Europe's costly surplus of central bankers", Business Week, 21 janar, 2002.
[7] "Central banks' vital statistics", Central Banking, volume XII, nr. 2, nëntor 2001, fq. 10.
[8] Cani Shkëlqim, Baleta T., "Elementet e pavarësisë së bankës qendrore. Banka e Shqipërisë: Sa e pavarur është ajo?", material diskutimi nr. 1/99, shtator 1999, fq. 44-47.
[9] Cani Shkëlqim, Baleta T., "Elementet e pavarësisë së bankës qendrore. Banka e Shqipërisë: Sa e pavarur është ajo?", material diskutimi nr. 1/99, shtator 1999, fq. 28.

POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË E REALIZUAR NËPËRMJET OPERACIONEVE TË TREGUT TË HAPUR GJATË VITIT 2001

*Suzana Sheqeri**
Arta Pisha

Fjalë kyçe
- Politika monetare - Kuadri operacional - Marrëveshjet e riblerjes -

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë deri në tetor të vitit 2000, u mbështet në përdorimin e instrumenteve direkte të politikës monetare. E ndodhur në kushtet kur uljet e vazhdueshme të përqindjeve administrative të interesit nuk po ndiqeshin nga bankat tregtare, në fillim të tremujorit të tretë të vitit 2000, Banka e Shqipërisë konsideroi të arsyeshëm rikonceptimin e kuadrit operacional, duke vendosur që politika monetare e saj të bazohej në zbatimin e instrumenteve të tregut. Rolin e përqindjes bazë në ekonomi tashmë e luan norma e përqindjes së marrëveshjeve të riblerjes (repove).

Gjatë vitit 2001, Banka e Shqipërisë ka bërë përmirësime dhe ndryshime sistematike për përsosjen e kuadrit operacional në funksion të arritjes së objektivave të saj. Konkretisht, në muajin shkurt 2001 u plotësua kuadri operacional me lehtësitë e përhershme (depozitë njëditore dhe kredi njëditore), me ankande shitblerjeje me të drejta të plota, me ankandet e shpejta të marrëveshjeve të riblerjes njëditore, si dhe u bënë përmirësime të rregulloreve ekzistuese të tregut. Ndërsa në muajin tetor 2001, u miratua një operacion i ri strukturor i tregut, ankandet një dhe tremujore të marrëveshjeve të riblerjes. Kjo bëri që kuadri operacional i Bankës së Shqipërisë të zgjerohej dhe të bazohej në: operacionet e tregut të hapur, lehtësitë e përhershme dhe rezervën e detyrueshme.

Përmirësimi dhe plotësimi i rregulloreve të tregut të parasë me elemente të reja, rriti hapësirat manovruese të politikës së Bankës së Shqipërisë. Konkretisht:

1. kalimi në muajin prill nga ankandet me shumë çmime në ankandet me çmim fiks, ndihmoi në dhënien e sinjaleve sa më të qarta për tregun e parasë;
2. përdorimi, për herë të parë, i lehtësive mbështetëse njëditore të ofruara nga Banka e Shqipërisë ndihmoi në tërheqjen dhe në injektimin e rezervave të tepërta nga sistemi. Përdorimi i tyre solli një stabilitet të normave të interesit të tregut të parasë, duke krijuar një korridor imagjinar për luhatjen e tyre brenda këtyre kufijve të vendosur nga Banka e Shqipërisë. Këto norma interesi janë shumë të rëndësishme për sinjalizimin e politikës monetare;
3. miratimi dhe më pas ndërhyrja për herë të parë me operacione strukturuese dhe rregulluese në treg, duke mundësuar sterilizimin me bazë të qëndrueshme të tregut.

Të gjitha këto e ndihmuan Bankën e Shqipërisë në zbatimin e politikës së saj, e cila ndryshoi gradualisht në varësi të ecurisë së treguesve makroekonomikë nga një politikë monetare lehtësuese e mbartur që nga viti i kaluar, në një politikë neutrale dhe më pas në një politikë të lehtë shtrënguese. Në vazhdim po paraqisim se si ka evoluar politika monetare e Bankës së Shqipërisë përmes kuadrit operacional.

Deri në muajin mars 2001, marrëveshjet e riblerjes u zbatuan si ankande javore[1], me shumë çmime dhe me shumë të deklaruar. Interesi i ofruar nga Banka e Shqipërisë, gradualisht u stabilizua në 6.5 për qind. Përmes këtyre ankandeve, Banka e Shqipërisë synonte të sinjalizonte tregun rreth politikës së saj zbutëse monetare që po ndiqte si dhe të siguronte një informacion mbi gjykimin e bankave për çmimin e parasë në këtë treg.

Gjatë zhvillimit të këtyre ankandeve u vërejt që frekuenca e rregullt e tyre i ndihmonte bankat tregtare të bënin një administrim të planifikuar të nivelit të rezervave të tepërta. Por, planifikimet për këto investime ballafaqoheshin me mundësi të kufizuara të

investimit të rezervave të tepërta. Kjo, pasi bankat konkuronin në ankand si për shumën ashtu edhe për normën e interesit. Tërheqja, në nivelet e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë, e rezervave të tepërta të sistemit linte jashtë fonde të papërdorura pas ankandeve. Nga ana tjetër, veçori e gjysmës së parë të vitit 2001 ka qenë fakti që për financimin e deficitit buxhetor, krahas burimeve të tjera, qeveria përdori dhe të ardhurat nga privatizimi, të cilat e pakësuan kërkesën e qeverisë në treg duke ndikuar në rritjen e tepricës së likuiditeteve në treg. Të gjitha këto bënë që niveli mesatar mujor i rezervave të tepërta[2] të luhatej në rreth 4.3 miliardë lekë.

Në situatën e mbizotërimit të ofertës së vazhdueshme në treg dhe të mundësive të kufizuara për investime, bankat tregtare reduktuan normat e interesit të tregut duke filluar që nga normat e ofruara në ankandin e marrëveshjeve të riblerjes si një përpjekje për të fituar në ankand. Rënia e interesit mesatar të ankandit të marrëveshjeve të riblerjes fillon të pasqyrohet edhe në normat e tjera të tregut të parasë, por me nivele të ndryshme elasticiteti. Kështu *yield*-i i bonove të thesarit manifestoi nivelin më të lartë të elasticitetit. Kjo, pasi reagimi i sistemit qe pothuajse i fortë dhe i menjëhershëm në drejtim të reduktimit të *yield*-it të letrave me vlerë të qeverisë. Interesat e depozitave në lekë të bankave tregtare patën tendencë rënëse, por me një shkallë elasticiteti më të ulët krahasuar me *yield*-in dhe më të vonuar në kohë, që nga momenti i përçimit të sinjalit në treg. Ndërsa çmimi i kredive edhe pse në përgjithësi manifestoi tendencë rënëse, u shoqërua edhe me rritje në muaj të veçantë[3] të kësaj periudhe, duke reflektuar rolin e kufizuar të kreditimit në lekë. Prania e këtyre faktorëve në treg pengon zbatimin me efikasitet të instrumenteve për arritjen e objektivave të politikës monetare.

Niveli i reagimit të bankave tregtare bëri që ato të ulin gradualisht diferencat e larta midis normave të interesit të kërkuara për kredidhënie dhe normave të interesit të ofruara për pranimet e depozitave. Kështu, për periudhën janar – mars '01, si rezultat i reduktimit të çmimit të kredive, niveli mesatar tremujor i diferencialit llogaritet në 10.98 për qind nga 15.73 për qind në tremujorin e katërt të vitit 2000.

Ajo që u vërejt gjatë kësaj periudhe qe mungesa e një korridori orientues për transaksionet e tregut ndërbankar. Si rrjedhim, niveli i interesave në këto transaksione nuk qe i stabilizuar. Interesi në transaksionet për afate të njëjta lëvizi në amplituda të gjera, të cilat për marrëveshjet ditore u luhatën në nivelet 5.0-6.5 për qind, dhe për marrëveshjet njëjavore u luhatën në nivelet 4.95 -7.2 për qind. Por, përdorimi i ankandeve javore të marrëveshjeve të riblerjes, edhe pse vendoste kufizime për bankat tregtare, dha rezultatet e veta në gjallërimin e aktivitetit ndërbankar. Për periudhën, u vu re një rritje modeste nga muaji në muaj i tregut ndërbankar. Vëllimi mesatar mujor i transaksioneve, arriti në 0.89 miliardë lekë. Vëllimi i ulët i transaksioneve në treg ndërbankar u kushtëzua jo vetëm nga mbioferta e tregut, por edhe nga mangësitë që ka ky treg për një funksionim normal e të rregullt.

Nisur nga zhvillimet e brendshme ekonomike, treguesit e inflacionit dhe zhvillimet e tjera monetare, Banka e Shqipërisë vendosi të ndryshojë qëndrimin e saj të politikës monetare, nga një politikë zbutëse në një qëndrim neutral. Kjo i përket periudhës prill 2001 - gusht 2001. Banka e Shqipërisë vazhdoi të përdorte, si operacion kryesor të tregut, ankandet javore të marrëveshjeve të riblerjes, por me çmim fiks. Kështu, Banka e Shqipërisë për përcaktimin nivelit të interesit të marrëveshjeve të riblerjes u bazua në nivelin mesatar që kishte rezultuar nga ankandet me shumë çmime, të cilat së fundi ishin stabilizuar rreth nivelit 6,5 për qind. Ndryshimi i formës së ankandit synoi që të stabilizonte normat e interesit të tregut dhe të zgjidhte problemet që u evidentuan gjatë periudhës së parë.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë zbatoi për herë të parë lehtësitë e përhershme, depozita njëditore dhe kredi njëditore. Interesi, i përcaktuar në këto lehtësi, qëndron plus 2.5 për qind mbi interesin e marrëveshjeve të riblerjes për kredinë njëditore dhe minus 2.5 për qind nën interesin e marrëveshjeve të riblerjes për depozitën njëditore. Qëllimi i përdorimit të këtyre lehtësive ishte që të siguronte tërheqjen dhe injektimin e likuiditetit ditor nga bankat tregtare, duke ndikuar në stabilizimin e lëvizjeve të normave njëditore në treg, në sinjalizimin e kuadrit të

përgjithshëm të politikës monetare, dhe të shërbente si korridor për normat ditore të tregut.

Vendosja e korridorit për normat e tregut shënoi fundin e periudhës së mungesës së stabilitetit të interesave në treg ndërbankar, për maturitete të ndryshme. Që nga kjo periudhë normat e interesave në treg ndërbankar u stabilizuan, duke patur si referencë korridorin e përcaktuar nga kuadri operacional i Bankës së Shqipërisë. Interesi në marrëveshjet ditore u luhat në nivelet 4,25 - 4,5 për qind dhe për marrëveshjet njëjavore u luhat në nivelet 6 - 6,7 për qind.

Ndryshimet e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë i krijuan mundësi bankave tregtare të investonin të gjitha sasitë e rezervave të tepërta të planifikuara për një maturitet njëjavor, duke zgjidhur problemin kronik të tregut. Në këtë periudhë shuma e kërkuar dhe e pranuar nga bankat tregtare në ankandet javore të marrëveshjeve të riblerjes, arriti në 196.3 miliardë lekë. Por, ndër të tjera, u vu re që përveç rezervave të tepërta me maturitet nën shtatë ditë, në disa raste, bankat nuk arrinin të parashikonin të saktë sasinë e likuiditeteve të mundshme për t'u investuar në marrëveshje të riblerjes. Kjo vinte pasi bankat, në ditën e zhvillimit të ankandit javor të marrëveshjeve të riblerjes ka raste që nuk kanë njoftim për rezultatet e ankandit të tregut primar.



Në këto kushte, midis të tjerave, bankat shfrytëzuan edhe lehtësinë e ofruar nga Banka e Shqipërisë, depozitë njëditore, për investimin e tepricave të likuiditetit, duke përfituar një interes 4.0 për qind. Kjo lehtësi e ofruar nga Banka e Shqipërisë pati një përdorim masiv nga të gjitha bankat e sistemit bankar. Totali i rezervave të investuara në depozita njëditore arriti masën 191.2 miliardë lekë.

Rezultante e të gjitha këtyre ndryshimeve qe ulja e nivelit mesatar mujor të rezervave të tepërta të paremuneruara, në nivelin rreth 0.64 miliardë lekë.

Tërheqja e të gjitha rezervave të tepërta, të planifikuara nga bankat tregtare për t'u investuar në ankandet javore të marrëveshjeve të riblerjes nga Banka e Shqipërisë, ndihmoi në rritjen e aktivitetit të tregut ndërbankar krahasuar me periudhën e parë. Vëllimi mesatar mujor i transaksioneve arriti në rreth 1.6 miliardë lekë.

Ulja e rezervave të tepërta, uli presionet për reduktime të normave të interesit të tregut. Interesat për depozitat në lekë dhe *yield*-i i bonove të thesarit ndryshuan shumë pak, duke manifestuar stabilizimin e këtyre normave të interesit. Ndërkohë që çmimi i kredidhënies në lekë vazhdoi të reduktohej duke u luhatur nga njëri muaj në tjetrin. Si rezultat, duke filluar nga muaji qershor 2001 e në vazhdim, për herë të parë diferenca midis çmimit të kredive dhe interesit të depozitave në lekë ruajti nivele njëshifrore. Kjo shënoi dhe periudhën me diferencën më të ulët që nga viti 1997.

Paralelisht me format investuese të rezervave të tepërta, bankat tregtare përdorën edhe mundësitë e ofruara nga Banka e Shqipërisë për plotësimin e mungesave për likuiditet, si lehtësinë e kredisë njëditore dhe përdorimin deri në masën 5 për qind të rezervës së detyrueshme në lekë. Kredia njëditore u përdor me një frekuencë të ulët dhe në një masë të vogël, krahasuar me depozitën njëditore. Për periudhën në fjalë, niveli i kredive njëditore të dhëna nga Banka e Shqipërisë kapi shumën prej 4.2 miliardë lekësh. Ndërsa vëllimi i rezervës së detyrueshme në

lekë, të përdorur nga bankat tregtare llogaritet në masën 5.3 miliardë lekë.

Ndryshimi i pozicionit të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, nga zbutës në neutral, zbatimi i operacioneve të reja dhe lehtësitë e ofruara, rritën hapësirat manovruese të bankave të nivelit të dytë. Kuadri operacional e la në dorë të bankave përcaktimin e nivelit të rezervave të tepërta që duhet të mbanin. Rrjedhimisht, bankat ulën gjendjen e rezervave të tepërta në nivelin e dëshiruar, duke ulur presionet për uljen e normave të interesit të tregut. Paralelisht me këtë, përcaktimi i normës fikse të interesit të marrëveshjeve të riblerjes solli stabilizimin e normave të interesit të tregut.

Duke u nisur nga norma vjetore e inflacionit gjatë 7 muajve të parë të vitit 2001, niveli i tij në fund të muajit korrik në 5.6 për qind, pritshmëritë për rritje të presioneve inflacioniste, si dhe faktorë të tjerë makroekonomikë, Banka e Shqipërisë vendosi të rrisë normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes me 0.5 pikë për qind (50b.p). Këtë qëndrim Banka e Shqipërisë e përçoi në treg duke vazhduar të përdorte si operacion kryesor të tregut ankandet javore të marrëveshjeve të riblerjes, me çmim fiks.

Reagimi në treg primar dhe ndërbankar ishte i menjëhershëm, pasi rritja e interesave u bë, thuajse në të njëjtën masë, me rritjen e sinjalizuar nga Banka e Shqipërisë. Gjithashtu, karakteristikë për këtë periudhë mbeti stabiliteti i vendosur që në periudhën e dytë. Ndërkohë, rritja e interesave të depozitave ishte graduale dhe jo aq e dukshme sikurse në tregjet e sipërpërmendura. Kështu, bankat më të mëdha në vend Banka e Kursimeve dhe Banka Kombëtare Tregtare, mbajtën të pandryshuar interesat për depozitat, ndërkohë që rritën *yield*-in e bonove të thesarit, duke rritur diferencën midis *yield*-it të bonove të thesarit dhe interesit të pranimeve të depozitave. Nëpërmjet këtij reagimi, këto banka, interesoheshin më shumë për të rritur fitimet e tyre, duke pranuar humbje të pjesës së tregut të pranimeve të depozitave.

Ndërsa pjesa tjetër e sistemit reagoi, në përgjithësi, në përputhje me sinjalet e Bankës së Shqipërisë, duke u sjellë si konkurrent në treg. Këto banka rritën interesat e depozitave në lekë, krahas rritjes së *yield*-it të bonove të thesarit, duke ruajtur po ato diferenca midis interesave për investimet në lekë dhe pranimet e depozitave në lekë. Në realitet, sjellja e secilës prej bankave reflektoi vendin që ato zënë në treg.

Grafik 2. Interesat e tregut për periudhën korrik 1999 – dhjetor 2001.



Parë në tërësi si sistem reagimi i bankave qe pothuajse i fortë dhe i menjëhershëm në drejtim të rritjes së *yield*-it të letrave me vlerë të qeverisë, i dobët dhe i vonuar ndaj interesit të depozitave me afat në lekë dhe me efekt të paqartë për çmimin e kredidhënies, për arsyet që i kemi përmendur më lart. Për periudhën nga 20 gushti '01 deri në fund të vitit, sistemi bankar ruajti nivele të ulta të rezervave të tepërta. Ndërkohë, fundi i vitit u karakterizua nga një nivel më i ulët i likuiditeteve të tepërta, i cili u ndikua nga rritja e kërkesës për para. Në muajin dhjetor '01, niveli i pjesëmarrjes në marrëveshje të riblerjes u ul mjaft, madje në ankandin e fundit të këtij viti nuk pati fare pjesëmarrje nga bankat.

Pas një periudhe të gjatë mospërdorimi, lehtësia e kredisë lombard, si burimi i fundit i kreditimit i ofruar nga Banka e Shqipërisë, u përdor vetëm në datën 31 dhjetor 2001 nga dy banka tregtare.

INSTRUMENTE TË REJA

Një instrument i përdorur për herë të parë nga Banka e Shqipërisë për sterilizimin, me bazë të qëndrueshme të tregut janë edhe shitblerjet me të drejta të plota të letrave me vlerë. Banka e Shqipërisë ka kryer dy shitje bonosh thesari në muajt qershor '01 dhe shtator '01, në masën 4.0 miliardë lekë secila. Në të dyja rastet, blerësi ka qenë Banka e Kursimeve.

Në nëntor 2001, u organizua për herë të parë ankandi njëmujor i marrëveshjeve të riblerjes. Përmes tij u tërhoqën nga sistemi 2.0 miliardë lekë. Fituesja ishte Banka e Kursimeve. Pra, del se kuadri operacional i zbatuar nga Banka e Shqipërisë ka arritur të përçojë politikën monetare të saj në sistemin bankar dhe të ndikojë në tregun ndërbankar të huadhënies dhe të huamarrjes, si nëpërmjet rritjes së vëllimit të tregtimit ashtu edhe orientimit të interesave të këtij tregu. Bankat tregtare kanë reaguar ndaj qëndrimeve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimi në normat e interesit të tregut ka qenë në nivele të ndryshme elasticiteti dhe "lag-u" i kushtëzuar nga niveli i zhvillimit të tregjeve në vend, struktura e tregut financiar, vendi që zënë në treg bankat tregtare etj..

Roli i kufizuar i kreditit në lekë, i materalizuar në nivelin e ulët të zhvillimit të tregut të kredive në lekë bën që edhe efekti i politikës monetare në agjentët e tjerë ekonomikë të jetë modest. Përqindja e marrëveshjeve të riblerjes do të arrijë të përçojë plotësisht vendimet e Bankës së Shqipërisë në ekonomi pas minimizimit të pozicionit monopol të Bankës së Kursimeve dhe rritjes së konkurrencës në treg, koordinimit më të mirë të autoritetit monetar dhe fiskal, zhvillimit të tregut të kredisë për ekonominë, zhvillimit të tregjeve të tilla si ai i letrave me vlerë, i kapitaleve, i aktiveve fikse etj., si kanale potenciale dhe me rëndësi në përçimin e vendimeve të politikës monetare në ekonomi.

SHËNIME

* Suzana Sheqeri, Arta Pisha, specialiste, Departamenti i Kërkimeve dhe Politikës Monetare.

[1] Ankandet javore të marrëveshjeve të riblerjes janë me maturitet njëjavor dhe përdoren për tërheqjen e likuiditeteve të tepërta nga sistemi bankar.

[2] Mesatarja i përket periudhës janar '01 – 20 mars '01(deri në ditën e përdorimit të depozitës njëditore).

[3] Pothuajse çdo muaj ndryshojnë bankat që kreditojnë ekonominë në lekë dhe niveli i interesave që zbatohen në varësi të afatit të kredisë së dhënë. Kjo sjell oshilacione të larta në interesin mesatar të ponderuar për kredinë e dhënë në lekë.

RREZIKU I KREDITIT DHE AGJENCITË LISTUESE TË CILËSISË SË KREDITIT

*Aida Hysi**

Fjalë kyçe
- Rreziku i kreditit - Rating - Listimi i kreditit - Agjenci listuese -

Në një mjedis tepër dinamik, ku tregjet ndryshojnë në fraksione të sekondës, ku shkalla e kryerjes së operacioneve në këto tregje është tepër e lartë dhe transmetimi i informacionit shumë i shpejtë, ku konkurrenca dhe rregullat e lojës paraqiten tepër të forta, nëse mendohet të luhet në tregjet financiare si investitor dhe njëkohësisht të mundësosh për biznesin një rezultat pozitiv apo të administrosh në mënyrë të suksesshme, kjo së pari kërkon njohjen dhe administrimin e rrezikut të kreditit *-credit risk*.

Rreziku i kreditit shfaqet që në momentin e mbajtjes së një depozite të thjeshtë dhe ai vjen duke u rritur në përshtatje me shkallën spekulative që merr forma e investimit.

Një shërbim që ofrohet për njohjen dhe identifikimin e rrezikut të kreditit të bankave, të kompanive të letrave me vlerë, të shoqërive të sigurimeve, të financave publike, të financave të ristrukturuara, pra e shprehur me një fjalë, të tërësisë së institucioneve financiare, por njëkohësisht edhe të kreditit të autoriteteve sovrane të një vendi, është shërbimi i listimit që ofrojnë tre agjencitë e mëdha ndërkombëtare të klasifikimit të cilësisë së kreditit Standard & Poor's, Moody's dhe Fitchrating, që quhen ndryshe agjencitë e listimit të kreditit.

Këto agjenci i kanë gjurmët e para të tyre në fund të shekullit XIX ose në fillim të shekullit XX, duke ofruar për komunitetin investues elementet e para të vlerësimit të kreditit. Përdorimi i simboleve dhe i terminologjisë që futën këto agjenci, për të vlerësuar shkallën e cilësisë së kreditit, u konsideruan praktike që në fillimet e përdorimit të tyre dhe sot, përveçse kanë marrë një përdorim të gjerë, diapazoni i tyre plotësohet, rritet dhe pasurohet, duke iu përshtatur gjithmonë e më shumë zhvillimeve të reja në tregje të ndryshme.

Renditja apo klasifikimi i cilësisë së kreditit realizohet nëpërmjet përdorimit të një grupimi shkronjash apo kombinimi shkronjash dhe numrash. Njohja e kësaj gjuhe teknike është e nevojshme për të lexuar dhe kuptuar vlerësimet mbi cilësinë e kreditit që japin këto agjenci për një pjesë shumë të madhe të institucioneve financiare që ato listojnë në mbarë botën, qofshin ato banka, kompani investimi të letrave me vlerë, kompani sigurimesh apo edhe autoritetet sovrane të një vendi.

Si administruese e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë, është përgjegjëse për miradministrimin e kësaj rezerve. "Politika e administrimit të rezervës valutore" miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përcakton kriteret dhe kushtet brenda të cilave mund të investohet, llojet e letrave me vlerë të borxhit, si dhe kufijtë e lejueshëm të rrezikut të kreditit të bankave dhe institucioneve financiare me të cilat bashkëpunohet për të investuar, si në tregun e parasë ashtu edhe në tregun e letrave me vlerë me të ardhura fikse. Një ndër kushtet për investimin në letra me vlerë të borxhit të bankave apo kompanive investuese është edhe cilësia e kreditit të tyre, e vlerësuar nga tre agjencitë e lartpërmendura.

Në këto kushte është e nevojshme njohja e simboleve dhe e terminologjisë që ato përdorin për të kuptuar dhe vlerësuar shkallën e cilësisë së kreditit dhe rrezikun që shoqëron një instrument, një letër borxhi, një bankë apo një institucion financiar.

ÇFARË KUPTOHET ME *"RATING"*?

Që të treja agjencitë e përkufizojnë klasifikimin që ato japin për kreditin e bankave apo të kompanive të ndryshme financiare, si një opinion lidhur me besueshmërinë e aftësisë së përgjithshme paguese të një huamarrësi ose të aftësisë paguese lidhur me një letër specifike me vlerë, një detyrim financiar të veçantë apo një klasë të caktuar detyrimesh, duke dhënë kështu kuptimin e asaj që quhet prej tyre dhe pranohet nga të tjerët si *"rating"*. Kur flitet për një "issuer rating", pra një *listim apo një klasifikim të emetuesit* kjo nënkupton një aftësi të përgjithshme paguese, kurse aftësia lidhur me një letër me vlerë specifike, klasë detyrimesh apo detyrim të veçantë përbën atë që përkufizohet si "issue rating" apo *listim i emetimit*.

Ndërkohë, të treja agjencitë theksojnë në vlerësimet e tyre faktin se listimi nuk përbën në vetvete një rekomandim për të blerë, për të shitur apo për të mbajtur një obligacion financiar apo detyrim tjetër të veçantë, ashtu sikurse asnjë prej tyre nuk bën komente lidhur me çmimin e tregut apo për përshtatshmërinë e një investitori të caktuar.

DHËNIA E NJË *"RATING"*

Vlerësimet lidhur me listimin e kreditit të bankave dhe të institucioneve të tjera financiare që klasifikojnë këto agjenci, bëhen mbi baza cilësore dhe sasiore, duke ndjekur një metodologji specifike për çdonjërën prej agjencive në përputhje me kriteret, profilin apo modelin e zgjedhur statistikor, matematikor apo kompjuterik, që ato përdorin. Ato shkojnë përtej vlerësimeve të raporteve apo të treguesve të shprehura në gjuhën e numrave, që do të thotë se një listim vlerëson në të njëjtën kohë edhe fuqitë dhe dobësitë e padukshme të bankave apo të institucioneve të tjera.

Monedha në të cilën do të kryhet pagesa është një faktor kyç i analizës. Kështu, kapaciteti i një huamarrësi për të shlyer detyrimet në monedhë të huaj, shpesh është më i vogël se kapaciteti i tij për të shlyer detyrimet në monedhën vendase,

gjë që ndikohet nga kapaciteti i qeverisë së tij sovrane, që është relativisht më i ulët për borxhin në valutë të huaj sesa për borxhin në monedhë vendase.

Ajo që është e përbashkët për të treja agjencitë është fakti se, që të treja agjencitë japin vlerësimet e tyre lidhur me listimin e kreditit në terma të rrezikut të mosshlyerjes apo ndryshe *default risk*.

Ndërkohë, lidhur me simbolet me të cilat përkufizojnë kreditin ato përdorin për renditjen apo klasifikimin e cilësisë së kreditit simbole të përbëra nga grupime shkronjash apo kombinime shkronjash dhe numrash, të cilat kanë një domethënie të mirëpërcaktuar.

LLOJET E *"RATING"*

Listimi i emetimit mund të jetë afatgjatë ose afatshkurtër. Listimet afatshkurtra bëhen kryesisht për ato detyrime apo instrumente, që konsiderohen afatshkurtra në tregjet përkatëse. Në SHBA për shembull, kjo nënkupton detyrime me një maturim fillestar jo më shumë se 365 ditë, duke përfshirë edhe letrat tregtare. Por, një vlerësim i tillë iu bëhet edhe detyrimeve apo instrumenteve afatgjata (duke rezultuar në atë që konsiderohet një listim i dyfishtë) me qëllim që vlerësimet e borxhit të jenë sa më të sakta dhe koherente, dhe në ndjekje të vazhdueshme.

Notat afatmesme përcaktohen përmes listimeve afatgjata.

Më poshtë jepet përcaktimi për simbolet dhe termat e përdorur nga këto agjenci, për vlerësimin e kreditit të institucioneve financiare si dhe një tabelë përmbledhëse e njëvlefshmërisë së simboleve të ndryshme që ato mund të përdorin.

LISTIMI I KREDITIT AFATGJATË

Kategoria investuese

AAA ose Aaa

Cilësia më e lartë e kreditit

Klasifikimi apo renditja në kategorinë "AAA" ose "Aaa" përbën shkallën më të ulët të rrezikut të kreditit. Një vlerësim i tillë jepet në raste të veçanta kur ekziston një kapacitet shumë i fortë i pagesës në kohë të sipërmarrjeve financiare. Kjo kategori përbën listimin më të mirë që jepet nga agjencitë.

AA ose Aa

Cilësi shumë e lartë e kreditit

Klasa "AA" ose "Aa" parashikon një shkallë shumë të ulët të rrezikut të kreditit. Ajo tregon një kapacitet shumë të fortë në përmbushjen në kohë të sipërmarrjeve financiare. Ky kapacitet nuk është shumë i ndjeshëm ndaj ndryshimit të rrethanave dhe kushteve ekonomike.

A

Cilësi e lartë e kreditit

Listimi "A" parashikon një shkallë të ulët të rrezikut të kreditit. Ai tregon një kapacitet të fortë në përmbushjen në kohë të sipërmarrjeve financiare. Megjithatë, ky kapacitet është më i ndjeshëm ndaj ndryshimit të rrethanave dhe kushteve ekonomike sesa kapaciteti në rastin e listimit të mësipërm.

BBB ose baa

Cilësi e mirë e kreditit

Listimi "BBB" ose "Baa" nënkupton se aktualisht ekziston një shkallë e ulët pritjeje e rrezikut të kreditit. Ai tregon një shkallë të mjaftueshme të kapacitetit për pagesën në kohë të sipërmarrjeve financiare, por një përkeqësim i rrethanave dhe i kushteve ekonomike ka shumë të ngjarë ta përkeqësojnë këtë kapacitet. Kjo konsiderohet si shkalla më e ulët e kategorisë investuese.

Kategoria spekulative

BB ose Ba

Spekulative

Kategoria "BB" ose "Ba" nënkupton se ekziston mundësia e rritjes së shkallës së rrezikut të kreditit, veçanërisht në rast të përkeqësimit të rrethanave ekonomike me kalimin e kohës; megjithatë, alternativat e biznesit e ato financiare, ka të ngjarë të mundësojnë përmbushjen e sipërmarrjeve financiare. Kjo kategori shfaq në mënyrë të vazhdueshme pasiguri apo ekspozime të konsiderueshme ndaj rrethanave të pafavorshme të biznesit, atyre financiare dhe ekonomike që mund të vënë në pikëpyetje përmbushjen e sipërmarrjeve.

B

Shumë spekulative

Kategoria "B" nënkupton se aktualisht ekziston një shkallë e rëndësishme e rrezikut të kreditit. Megjithatë, mbetet edhe një hapësirë shumë e ngushtë sigurie. Sipërmarrjet financiare, aktualisht, janë duke u përmbushur, megjithëse kapaciteti lidhur me vazhdimësinë e kryerjes së pagesave kushtëzohet nga prania e një mjedisi ekonomik dhe kushte biznesi të qëndrueshme dhe të favorshme.

CCC, CC, C ose Caa, Ca, C

Shkallë e lartë e rrezikut të mosshlyerjes

Mosshlyerja është realisht e mundshme. Kapaciteti për të përmbushur detyrimet financiare është tërësisht i varur nga zhvillimet pozitive dhe të qëndrueshme të biznesit dhe ato financiare. Në rastin e kushteve të pafavorshme të biznesit paraqitet një mundësi shumë e madhe e rrezikut të mosshlyerjes.

Një listim "CCC" ose "Caa" është aktualisht i ndjeshëm ndaj mosshlyerjes; CC ose "Ca" aktualisht shumë i ndjeshëm.

DDD, DD, D

Mosshlyerje pagese

Letrat me vlerë ose institucionet që klasifikohen në këto kategori, janë jashtëzakonisht spekulative dhe vlera e tyre nuk mund të kalojë vlerën e marrë nga ndonjë proces i mundshëm likuidimi apo riorganizimi.

Kështu, institucionet e listuara në kategorinë "DDD" kanë mundësinë më të lartë për vazhdimin e veprimtarisë dhe për rimarrjen e vetes, dhe në të mund të përfshihet ose jo mundësia e një procesi riorganizimi.

Institucionet e renditura si "DD" dhe "D", aktualisht, janë duke ndërmarrë një riorganizim formal apo një proces likuidimi.

Kategoria "DD" ka më shumë mundësi të kënaqë detyrimet e pashlyera në një masë më të madhe, kurse "D" përfaqëson mundësinë më të ulët të ripagimit të të gjitha detyrimeve.

NJËVLERSHMËRIA E SIMBOLEVE PËR KREDITIN AFATGJATË

Fitch	Standard & Poor's	Moody's
AAA	AAA	Aaa
AA+	AA+	Aa1
AA	AA	Aa2
AA-	AA-	Aa3
A+	A+	A1
A	A	A2
A-	A-	A3
BBB+	BBB+	Baa1
BBB	BBB	Baa2
BBB-	BBB-	Baa3
BB+	BB+	Ba1
BB	BB	Ba2
B-	B-	Ba3
B/B+	B/B+	B1
CCC	CCC	Caa
CC	CC	Ca
C	C	C
D	D	D
NR	NR	NR

LISTIMI I KREDITIT AFATSHKURTËR

Lidhur me kreditin afatshkurtër, tre agjencitë përdorin simbole të ndryshme për të treguar shkallën e cilësisë së kreditit.

Standard & Poor's

A-1

Një institucion apo instrument i listuar si "A-1" konsiderohet si kategoria më e lartë nga Standard and Poor's. Aftësia për të përmbushur detyrimet financiare është e fortë.

A-2

Një institucion apo instrument i renditur si "A-2" është diçka më i ndjeshëm ndaj efekteve jofavorizuese të ndryshimeve në rrethanat apo në kushtet ekonomike, sesa një huamarrës i renditur më lart. Megjithatë, kapaciteti për të përmbushur detyrimet financiare është i kënaqshëm.

A-3

Një institucion apo instrument i listuar si "A-3" shfaq kapacitet të mjaftueshëm për përmbushjen e detyrimeve. Megjithatë, kushte të pafavorshme ekonomike apo rrethana të ndryshueshme, ka shumë të ngjarë të çojnë në një dobësim të kapacitetit pagues dhe të përmbushjes së detyrimeve të tij financiare.

B

Një institucion apo instrument i listuar si "B" konsiderohet si i ndjeshëm dhe ka karakteristika të konsiderueshme *spekulative*. Aktualisht, ai ka aftësinë të përmbushë detyrimet financiare; megjithatë, has pasiguri gjithnjë e më të mëdha, të cilat mund të çojnë në kapacitet të pamjaftueshëm për të përmbushur sipërmarrjet financiare lidhur me detyrimin e tij.

C

Një institucion apo instrument i listuar si "C" është aktualisht i ndjeshëm ndaj mospagesës dhe pagesa ose mospagesa varet nga kushtet e favorshme ekonomike, financiare apo të biznesit, të cilat kushtëzojnë përmbushjen e detyrimeve financiare të huamarrësit.

FITCH

F1 Cilësi e lartë e kreditit.

Tregon kapacitetin më të fuqishëm për pagesën në kohë të sipërmarrjeve financiare; kjo kategori mund të shoqërohet me shenjën "+" për të treguar një tipar krediti veçanërisht të fortë.

F2 Cilësi e mirë e kreditit.

Tregon një kapacitet të kënaqshëm lidhur me pagesën në kohë të sipërmarrjeve financiare, por kufiri i sigurisë nuk është aq i madh sa në rastin e kategorisë së mësipërme.

F3 Cilësi mesatare e kreditit.

Kapaciteti për shlyerjen në kohë të detyrimeve financiare konsiderohet i mjaftueshëm; megjithatë përkeqësimi i kushteve mund të rezultojë në një reduktim të kësaj kategorie dhe futjen e saj në një kategori joinvestuese.

B Spekulative.

Paraqet kapacitetin minimal të pagesës në kohë të sipërmarrjeve financiare dhe një ndjeshmëri të lartë ndaj përkeqësimit të kushteve dhe rrethanave ekonomike dhe financiare.

C Rrezik i lartë mosshlyerjeje.

Mosshlyerja e detyrimeve paraqitet si mundësi reale. Kapaciteti për përmbushjen e sipërmarrjeve financiare varet tërësisht

nga ekzistenca e një mjedisi ekonomik dhe kushte biznesi të qëndrueshme dhe të favorshme.

D Mosshlyerje.

Tregon paaftësi reale të shlyerjes aktualisht ose paaftësi shlyerëse të mundshme.

Moody's

Moody's përdor si sistem vlerësimi për kreditin afatshkurtër sistemin e quajtur *"Prime Rating System"*.

P-1 (Prime-1).

Tregon aftësinë më të madhe të institucionit financiar për të shlyer detyrimin afatshkurtër. Paraqitet si klasa më e lartë e cilësisë së kreditit afatshkurtër.

P-2 (Prime-2).

Tregon një aftësi të madhe për të ripaguar detyrimin afatshkurtër, por në një shkallë më të ulët në krahasim me klasën P-1. Kështu, prirja e fitimeve dhe raportet financiare megjithëse të mira, mund të jenë objekt i ndryshimeve me kalimin e kohës dhe me ndryshimin e kushteve ekonomike.

P-3 (Prime-3).

Ky simbol tregon se aftësia për të respektuar sipërmarrjet financiare konsiderohet e përshtatshme. Megjithatë, efektet e karakteristikave të industrisë dhe përbërja e tregut kanë një ndikim të fortë që duhet theksuar. Në të njëjtën kohë, ndryshimet në nivelin e të ardhurave dhe të fitimit, mund të çojnë në ndryshime të nivelit të sigurisë së borxhit.

NP (Not Prime).

Të gjitha institucionet financiare apo instrumentet dhe letrat me

vlerë që nuk kanë karakteristika, që do t'i bënin të klasifikoheshin në ndonjë nga kategoritë e mësipërme, vlerësohen në këtë kategori me simbolin NP.

KATEGORI DHE SIMBOLE TË TJERA LISTIMI

Shenja plus (+) ose minus (-).

Listimet nga kategoria "AA" në atë "CCC" të agjencive Standard & Poor's dhe Fitch mund të modifikohen nëpërmjet përdorimit të një shenje plus (+) ose minus (-) për të treguar një qëndrueshmëri relative brenda për brenda kategorive më të mëdha të listimit.

Modifikuesit numërorë- 1, 2, 3.

Ndërkohë, nga agjencia Moody's për të treguar një qëndrueshmëri relative brenda për brenda kategorive më të mëdha të listimit, përdoren si modifikues numrat nga 1 deri në 3 për kategoritë nga "Aa" në "Caa". Kështu, numri 1 tregon qëndrueshmërinë më të lartë, 2 një qëndrueshmëri mesatare dhe 3 qëndrueshmërinë më të ulët.

R.

Një institucion financiar i listuar si "R" është nën një mbikëqyrje rregullatore, si pasojë e gjendjes së tij financiare, periudhë gjatë së cilës rregullatori mbikëqyrës mund të gëzojë të drejtën për të favorizuar një klasë të caktuar detyrimi ndaj të tjerave ose të paguajë disa detyrime dhe të lërë të tjera pa paguar.

SD dhe D.

Një institucion financiar i listuar si "SD" *(selective defalut)* ose "D" *(default)* ka dështuar në pagimin e një apo më shumë detyrimeve të tjera financiare të tij (të listuara apo të palistuara), kur u ka ardhur afati i maturimit.

Agjencitë japin listimin në kategorinë "D" kur besojnë se mosshlyerja do të jetë e përgjithshme dhe huamarrësi do

të dështojë në shlyerjen totale apo të pjesës më të madhe të borxhit. Ndërsa, japin listimin në kategorinë "SD", kur besojnë se mosshlyerja nga ana e huamarrësit do të jetë e pjesshme në lidhje me një klasë apo një tip të veçantë detyrimi, ndërkohë që vazhdojnë pagesat në mënyrë të rregullt për klasat apo për tipet e tjera të borxhit të emetuar.

N.R.

Një institucion financiar apo instrument nën simbolin N.R. nuk figuron i listuar nga agjencia listuese. Kjo shenjë tregon se nuk është bërë ndonjë kërkesë për listim, nuk ka informacion të mjaftueshëm ku të bazohet listimi apo agjencia nuk e liston një obligacion apo emetues, si pasojë e politikës që ajo ndjek.

"pi" *Rating*.

LISTIMET PËR INFORMACION PUBLIK

Listimet me simbolin "pi" bazohen në një analizë të informacionit financiar të publikuar nga institucionet financiare, sikurse edhe në informacione shtesë të vëna në dispozicion të publikut. Megjithatë, ato nuk reflektojnë nga takime ku çështjet trajtohen me imtësi me grupin administrues të vet institucionit dhe, për këtë arsye, bazohen në informacione jo aq të plota sa listimet, të cilat nuk shoqërohen me simbolin "pi". Këto lloj listimesh rishikohen çdo vit, bazuar mbi gjendjen e përvitshme financiare.

Listimet me simbolin "pi" nuk shoqërohen nga listimi në perspektivë dhe, gjithashtu, nuk janë objekt i listimit të kreditit nën vëzhgim (CreditWatch).

Në përgjithësi, ato nuk modifikohen me shenjat (+) ose (-), por në raste të caktuara shenja të tilla mund të përdoren për të treguar presionin nga rreziku i autoriteteve sovrane ose cilësinë e borxhit të kompanisë mëmë apo të grupeve të lidhura.

Outlook Rating.

LISTIMI I PERSPEKTIVËS

Listimi i Perspektivës që kryejnë agjencitë listuese vlerëson drejtimin e mundshëm të listimit të kreditit afatgjatë në intervale të ndërmjetme gjatë kësaj periudhe. Në përcaktimin e perspektivës së listimit, i jepet rëndësi çdo ndryshimi në kushtet ekonomike dhe/ose në kushtet bazë të biznesit. Megjithatë, perspektiva nuk është një prekursor i padiskutueshëm i ndryshimeve në listim apo i ndërmarrjes së veprimit të klasifikimit të kreditit në kategorinë e "Kreditit nën Vëzhgim".

Vlerësimi që i bëhet perspektivës mund të jetë:

- *Pozitiv,* çka nënkupton që niveli i listimit do të rritet;
- *Negativ*, që nënkupton se niveli i listimit do të jetë më i ulët;
- *I qëndrueshëm*, që do të thotë se listimi ka shumë mundësi të mos ndryshojë;
- *Në zhvillim*, që do të thotë që niveli mund të jetë më i lartë ose më i ulët;
- *N.M.* do të thotë e paqartë.

CreditWatch.

Krediti nën Vëzhgim

Krediti nën vëzhgim vë në dukje drejtimin e mundshëm të një listimi afatgjatë ose afatshkurtër. Ai fokusohet në ngjarje të identifikueshme dhe prirje afatshkurtra, të cilat bëjnë që listimi të vendoset nën një vëmendje të veçantë të personelit të analistëve që realizojnë vlerësimin.

Këto ngjarje përfshijnë bashkime, rikapitalizime, referendume të votuesve, veprime rregullatore ose zhvillime operacionale të parashikuara më parë për të ndodhur.

Listimet përfshihen në Kreditin nën Vëzhgim kur ndodh një devijim apo mospërputhje e ngjarjeve me pritjet rreth tyre,

duke nxjerrë nevojën e një informacioni shtesë për të vlerësuar listimin korent. Megjithatë, kjo nuk nënkupton se Krediti nën Vëzhgim përfshin në vetvete të gjitha listimet në proces rishikimi, ndërkohë që ndryshimet në listim mund të ndodhin edhe pa u klasifikuar së pari te Krediti nën Vëzhgim.

Përcaktimi *"pozitiv"* nënkupton se kategoria e listimit do të rritet,*"negativ"* do të ulet dhe " në *zhvillim"* nënkupton se ajo mund të rritet, të ulet apo të qëndrojë e pandryshuar.

Dual Rating

PËRCAKTIMET E LISTIMIT TË DYFISHTË

Agjencitë listuese mund të japin edhe një vlerësim të dyfishtë *(dual rating)* për të gjitha emetimet e borxhit afatgjata, ato që kanë si pjesë përbërëse të strukturës së tyre një opsion shitjeje ose tipar kërkese. Kështu, për rastin e fundit, simbolet e para i adresohen aftësisë shlyerëse të principalit dhe interesave brenda afatit, ndërsa pjesa e dytë i referohet vetëm tiparit kërkues.

"r"

Ky simbol i shtohet listimit të instrumenteve që shoqërohen me një rrezik sinjifikativ që nuk ka lidhje me kreditin. *"r"* nënvizon rreziqet në lidhje me principalin ose luhatjen e të ardhurave të pritshme, të cilave nuk iu adresohet listimi i kreditit.

Shembuj të tillë janë: obligacionet apo detyrimet e lidhura me ose të indeksuara nga kapitali, valuta apo mallrat; obligacione ose detyrime të ekspozuara ndaj rreziqeve të mëdha të parapagimit.

Withdrawn

Tërhequr

Një listim konsiderohet i tërhequr kur agjencia e konsideron të pamjaftueshëm sasinë e informacionit të vënë në dispozicion

për qëllime listimi ose në rastet kur një obligacion maturohet, thirret (nëse ka tipar thirrjeje) ose rifinancohet.

RatingAlert:

Klasifikim i ngjashëm me *CreditWatch*, që jep Standard & Poor's jepet nga agjencia Fitch. Ky klasifikim i kreditit jepet për të vënë në dijeni investitorët se ka mundësi të konsiderueshme që të ndodhin ndryshime në listim dhe, në të njëjtën kohë, edhe për të treguar drejtimin e këtyre ndryshimeve. Ato klasifikohen në:

"pozitive" kur parashikojnë një rritje të kategorisë listuese;
"negative" kur parashikojnë një ulje në kategorinë listuese; ose
"në zhvillim" nëse parashikohet se kategoria e listimit mund të rritet, të ulet ose të qëndrojë e pandryshuar. Ky klasifikim përdoret për të karakterizuar gjendje shumë afatshkurtra.

Në përfundim të këtij prezantimi, duke pasur parasysh objektivat që synon të realizojë Banka e Shqipërisë, ku po shihet si mundësi rritja e numrit dhe e llojeve të instrumenteve në të cilat ajo mund të investojë, si dhe e institucioneve financiare me të cilat mund të bashkëpunohet për këtë qëllim, njohja e kësaj gjuhe është e nevojshme për të lexuar dhe për të kuptuar vlerësimet mbi cilësinë e kreditit, që japin këto agjenci për pjesën dominuese të institucioneve financiare në mbarë botën, qofshin ato banka apo kompani investimi të letrave me vlerë, njohja, përdorimi dhe përditësimi me të cilat mund shihet si një tjetër mundësi për administrimin me sukses të rrezikut të kreditit të rezervës që administrohet nga Banka e Shqipërisë.

Banka të tjera qendrore homologe përdorin shërbime që ofrojnë këto agjenci, në varësi të kritereve dhe të informacionit që ato kërkojnë të kenë në dispozicion. Megjithatë, tendenca në këto banka është se ato përdorin shërbimin e klasifikimit të cilësisë së kreditit nga të paktën dy prej tre agjencive.

---

* Aida Hysi, specialiste, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun.

DEPOZITAT NË SISTEMIN BANKAR NË PERIUDHËN 1999-2000

*Suzana Sheqeri**
Edlira Abazi

Fjalë kyçe
- Depozita - Ofertën e parasë - Aktivitet depozitues - Niveli i interesave -

Analiza e ecurisë së depozitave të pranuara nga bankat tregtare, përbërja e tyre sipas llojshmërisë, sipas afateve dhe monedhave kanë rëndësi të veçantë në disa aspekte. Ndër më të rëndësishmit do të përmendim kontributin që ato japin në krijimin e parasë gjithsej dhe komponentët përbërës të saj, duke luajtur një rol të rëndësishëm në vlerësimin e presioneve inflacioniste në ekonomi. Nga ana tjetër, struktura e parasë gjithsej dhe qëndrueshmëria e saj përbëjnë një burim të rëndësishëm për mbështetjen e ekonomisë kombëtare me kredi duke ndihmuar rritjen ekonomike të vendit. Materiali në vijim trajton ecurinë e aktivitetit depozitues të sistemit bankar për periudhën 1992-2001, faktorët që kanë ndikuar në ecurinë e depozitave, në politikën monetare të ndjekur nga Banka e Shqipërisë, në strukturën sektoriale të formimit të depozitave dhe në zhvillimet në tregun e depozitave të sistemit bankar.

I. ECURIA E DEPOZITAVE GJITHSEJ DHE NDIKIMI NË OFERTËN E PARASË

Depozitat në sistemin bankar në vitet 1992-2001 kanë ardhur duke u rritur. Kjo reflektohet edhe në tendencën e qëndrueshme

në rritje të depozitave të sistemit gjithsej ndaj totalit të pasiveve të sistemit bankar.

Grafik 1. Ecuria e raportit depozita gjithsej ndaj pasiveve të sistemit bankar, në përqindje.



Arsyet e rritjes së depozitave janë:

- rritja e mirëqenies, e cila sjell më shumë mundësi për kursim;
- rritja e nivelit të bashkëpunimit depozitues-bankë;
- rritja e numrit të bankave;
- rritja e produkteve të ofruara dhe reklamës.

Interesimi i bankave tregtare për të tërhequr kursimet është përputhur me strategjinë e Bankës së Shqipërisë të reduktimit të *cash*-it në ekonomi dhe zgjerimin e aktivitetit bankar.

Fakti nëse, në një periudhë të dhënë, agjentët ekonomikë i japin më shumë prioritet parasë, si para për transaksione ose për kursime, krijon mundësinë për të gjykuar mbi nivelin e stabilitetit të situatës monetare. Në periudhat e pritjeve inflacioniste, njësitë ekonomike tentojnë të mbajnë para me likuiditet të lartë, ndërsa rritja e besimit në stabilitetin e lekut rrit motivin e kursimeve, duke rritur pjesën e depozitave me afat ndaj ofertës së parasë.

Ndryshimet që ndodhin në shpërndarjen e mjeteve financiare, në para në qarkullim dhe forma të ndryshme të depozitave, shprehin motivet që përcaktojnë kërkesën për para. Këto

zhvillime në kohë, njëkohësisht reflektojnë efektet e politikës së Bankës së Shqipërisë në përdorimin e instrumenteve për arritjen e objektivave të ndërmjetëm në drejtim të rritjes së parasë gjithsej.

Në vazhdim, analizën e zhvillimit të shpërndarjes së mjeteve financiare do ta shikojmë në kuadrin e agregatëve monetarë dhe të kontributit që kanë dhënë në formimin e parasë gjithsej. Tendenca bazë e zhvillimit të ofertës së parasë nga viti 1992 - 2001 paraqitet në grafikun 2. Elementi përcaktues i rritjes së ofertës së parasë është i përqendruar kryesisht në depozitat me afat në lekë të agregatit M2.

Grafik 2. Ecuria e agregatëve monetarë në periudhën 1992-2001, në miliardë lekë.



Tabelë 1. Struktura e ofertës së parasë, në përqindje.

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Paraja jashtë bankave	34.39	35.85	39.03	38.99	30.93	36.63	28.52	27.77	30.25	30.26
Depozita pa afat në lekë	25.28	20.41	15.74	16.15	27.56	9.54	6.43	7.40	7.56	6.10
M1	59.67	56.26	54.78	55.14	58.49	46.17	34.95	35.17	37.81	36.35
Depozita me afat në lekë	16.55	23.32	26.43	26.17	19.57	35.53	48.24	46.66	42.81	41.23
M2	76.22	79.57	81.20	81.31	78.06	81.70	83.19	81.83	80.62	77.58
Depozita në valutë	23.78	20.43	18.80	18.69	21.94	18.30	16.81	18.17	19.38	22.42
M3	100.0	100.00	100.0	100.00	100.0	100.0	100.00	100.0	100.00	100.00
Treguesi i likuiditetit	0.25	0.20	0.16	0.16	0.28	0.10	0.06	0.07	0.08	0.06
Depozita valutë/para gjithsej	0.24	0.20	0.19	0.19	0.22	0.18	0.17	0.18	0.19	0.22

Të dhënat e tabelës 1 e shprehin më qartë ndryshimin në vite brenda strukturës së parasë gjithsej. Kështu:

- pjesa e parasë jashtë bankave është ulur me 4.13 pikë përqindjeje nga viti 1992 në vitin 2001, kundrejt një uljeje 19.18 pikë përqindjeje të depozitave pa afat për të njëjtën periudhë. Kjo ka bërë që treguesi i shkallës së likuiditetit (M1/M3), si një matës standard i likuiditetit disponibël në ekonomi, nga totali i ofertës së parasë, të vijë duke u ulur;
- pesha e depozitave me afat në lekë ndaj parasë gjithsej është rritur me 24.68 pikë përqindjeje për periudhën 1992-2001;
- pesha e depozitave në valutë ndaj parasë gjithsej nuk manifeston ndonjë tendencë të qëndrueshme për shkak të oshilacioneve që paraqet në vite të ndryshme. Megjithatë, pas vitit 1998, pesha e tyre ka ardhur duke u rritur në totalin e ofertës së parasë. Treguesi që shpreh nivelin e valutave ndaj parasë gjithsej për periudhën e marrë në analizë është luhatur në kufijtë 0.17-0.24, duke njohur një rënie prej 0.02 pikësh nga viti 1992 në vitin 2001.

Tregu i depozitave të sistemit bankar, në përgjithësi, ka ardhur në rritje dhe me ritme të kënaqshme. Këto kanë bërë që edhe zhvillimet në ofertën e parasë në Shqipëri, për periudhën 1992-2001, të karakterizohen nga një rritje e qëndrueshme e pjesës së depozitave me afat ndaj ofertës së parasë, kundrejt tendencës në rënie të depozitave pa afat në lekë, përjashtuar vetëm viti 1996.

Ndryshimi në pjesën që zënë depozitat pa afat dhe me afat në paranë gjithsej ka dhënë efekte në ndryshimin e strukturës së ofertës së parasë në favor të mjeteve më pak likuide, duke reflektuar stabilitetin në kohë të ofertës së parasë.

Zhvillimi i marrëdhënieve midis depozitave në lekë dhe në valutë, më shumë në favor të depozitave në lekë, konfirmon rritje të besimit të publikut në stabilitetin e lekut dhe rritje të aftësisë për të plotësuar funksionin e ruajtjes së vlerës së lekut.



Ndryshimet në raportin midis mjeteve financiare likuide ndaj atyre jo shumë likuide, kushtëzohen nga fakti që paraja përdoret për të plotësuar nevojat për transaksione në ekonomi (para jashtë bankave-depozita pa afat), për kërkesa spekulative (depozitat afatshkurtra) dhe për motiv kursimi (depozitat afatgjata).

Raporti, me kalimin e viteve, duket që ka ndryshuar në favor të kursimit duke reflektuar rritje të besimit në sistemin bankar. Ndërsa, paraja jashtë bankave dhe depozitat pa afat në lekë e kanë ulur peshën e tyre nga 59.67 për qind në vitin 1992, në 36 për qind në vitin 2001. Niveli i këtij treguesi pasqyron shkallën jo shumë të lartë të lidhjes midis sektorit bankar dhe atij real të ekonomisë.

Edhe pse nga ana e bankave tregtare është bërë një punë e konsiderueshme për afrimin e biznesit, shifrat flasin se një nivel i konsiderueshëm i transaksioneve kryhet në ekonominë joformale. Një pjesë e bizneseve apo e publikut preferojnë të mos i vendosin paratë në banka duke u nisur nga motive të tilla si:

- dëshira për t'iu shmangur detyrimeve tatimore,
- shmangia e deklarimit në banka të burimit të sigurimit të këtyre parave,
- pengesat dhe vonesat që mund të hasin në sportelet e bankave etj..

Grafik 4. Pesha e depozitave pa afat dhe e depozitave me afat në lekë ndaj totalit të këtyre depozitave, në përqindje.



Rritja e motivit të kursimit shprehet qartë në treguesin e depozitave me afat ndaj totalit të prodhimit të brendshëm bruto. Ky raport është rritur nga 23 për qind në vitin 1992 në 40 për qind për vitin 2001. Krahas shkallës së mobilizimit të kursimeve, ky nivel shpreh dhe rritjen e besimit të publikut ndaj institucioneve bankare.

Në zhvillimin e depozitave me afat në sistem, rol të rëndësishëm ka luajtur edhe politika e Bankës së Shqipërisë në drejtim të normës së interesave në lekë. Niveli minimal i interesave të depozitave me afat është rregulluar gradualisht në përputhje me lëvizjen e inflacionit dhe me zhvillimet e tjera monetare dhe ekonomike, në mënyrë që niveli i interesave realë të mbetej

Grafik 5. Ndryshimi vjetor i prodhimit të brendshëm real, interesit real mesatar, në përqindje.



në kufij pozitivë të pranueshëm. Në këtë mënyrë, kursimet e individëve mbeten të mbrojtura nga lëvizjet e inflacionit dhe të ardhurat reale mbeten në nivele pozitive.

Historiku i interesit real paraqitet me oshilacione të theksuara. Kështu dallon periudha korrik 95 - mars 97, ku interesat realë kanë qëndruar në nivele negative, dhe për pjesën tjetër të periudhës së marrë në shqyrtim, ky nivel ka qëndruar pozitiv, duke lëvizur nga +26.5 për qind deri në +1.0 për qind. Në nivel mesatar, interesi real për të gjithë periudhën llogaritet 5.11 për qind. Duke përjashtuar periudhat ku interesi real kap vlera ekstreme pozitive ose negative, niveli mesatar i interesit real llogaritet në 4.54 për qind. Ndërsa prodhimi i brendshëm bruto në nivel real është rritur mesatarisht për periudhën 6.8 për qind ose duke përjashtuar vitin 1997, që njohu rritje reale negative të prodhimit, ky nivel llogaritet 8.6 për qind.

Përqindja reale e interesit ose më saktë të ardhurat reale nga depozitat, kanë një efekt të rëndësishëm në vëllimin e kursimeve reale financiare dhe në rritjen ekonomike.

Nga krahasimi i interesit vjetor mesatar real dhe rritjes reale të prodhimit të brendshëm, efekti i përqindjes reale të interesit tek rritja ekonomike duket pozitiv. Politika e ruajtjes së përqindjeve reale pozitive të interesave është shoqëruar nga rritja në prodhimin e përgjithshëm të vendit. Që nga muaji tetor i vitit 1999 e në vazhdim, niveli real i interesave qëndron nën rritjen reale të prodhimit të brendshëm të ekonomisë, duke shprehur edhe zbutjen e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në fushën e përqindjes së interesave.

Box 1.

Në përgjithësi, situata në vitin 1996 paraqitej me rritje të nivelit të depozitave në sistem dhe një nivel inflacioni të ulët. Në këto kushte, rritjet e nivelit minimal të depozitave në 6.5 për qind për depozitat dymbëdhjetëmujore, tremujore dhe 6 për qind për depozitat gjashtëmujore ishte tepër e pranueshme për kushtet kur

u bënë këto ndryshime. Ishte e paparashikuar situata në të cilën u ndodh Shqipëria në muajt e parë të vitit 1997, dhe kuptohet që në parashikimet afatshkurtra të interesave realë, një vit më parë, nuk ishin parashikuar këto ndryshime kaq të mëdha të treguesve kryesorë makroekonomikë të vendit.

Megjithatë, u veprua me shpejtësi me nivelin e interesave për të kanalizuar të gjitha akumulimet e çliruara nga ky treg në sistemin bankar, për të kontrolluar ato në mënyrë që t'i shërbehej direkt objektivit kryesor, zbutjes së ritmeve të rritjes së nivelit të inflacionit. Në vendosjen e nivelit minimal të interesave për këtë periudhë nuk ishte qëllimi kryesor niveli real i tyre, por nëpërmjet këtyre niveleve sa më të pranueshme, të ndikohej në uljen e inflacionit. Pra, nuk do të stimuloheshin vetëm ata që kishin mundësi për të akumuluar, por e gjithë popullsia dhe kryesisht, pjesa më e varfër e saj.

Gjatë vitit 1997, interesat për depozitat me afat tremujor u ndryshuan më shumë se interesat për depozitat gjashtë dhe dymbëdhjetëmujore. Kështu, ato u rritën 4 herë duke shkuar nga 18.5 për qind në fillim të vitit '97, në 37 për qind në qershor të po këtij viti, për t'u ulur gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 1997 katër herë, duke arritur nivelin 26 për qind në fund të vitit.

Mbas muajit maj '97, për depozitat dymbëdhjetëmujore e gjashtëmujore nuk u bënë më ndryshime interesash, sepse mendohej që niveli i inflacionit për vitin 1998 do të vinte në rënie në krahasim me vitin 1997. Kështu, duke mbajtur të pandryshueshëm interesin nominal për depozitat dymbëdhjetëmujore, ato do të kalonin gradualisht nga niveli negativ, në terma realë në nivel pozitiv.

Ndërsa, për depozitat me afat maturimi tremujor, rritjet e interesit nominal synonin rikthimin e depozitave në sistem duke rritur aftësinë thithëse të mjeteve financiare që do të çliroheshin nga shpërndarja e parave të ngrira në llogaritë e fondacioneve "Populli" dhe "Xhaferri". Kjo, për faktin sepse ato ishin për momentin i vetmi instrument afatshkurtër që i përgjigjej situatës së vështirë financiare që po kalonte sistemi bankar pas rënies së ndjeshme të depozitave me afat në muajt e parë të vitit 1997.

Deri në fund të vitit 1997, u arrit që të tërhiqej një sasi e konsiderueshme e depozitave me afat në lekë. Pesha e depozitave

me afat në lekë ndaj parasë gjithsej u rrit nga 19.57 për qind në fund të vitit 1996, në 35.53 për qind në fund të vitit 1997.

Pas këtij viti, politika e Bankës së Shqipërisë në uljen e nivelit minimal të depozitave, i ka shërbyer direkt uljes së kostos së huadhënies, duke ndihmuar në gjallërimin dhe në rritjen e investimeve në ekonomi. Niveli vjetor i inflacionit ra nga 42.1 për qind në fund të vitit 1997, në 8.7 për qind në fund të vitit 1998. Niveli nominal i interesave u ul pesë herë gjatë vitit 1998, duke arritur respektivisht në nivelet 10 për qind, 9.5 për qind dhe 9.5 për qind për depozitat me afat 12, 6 dhe 3-mujor.

Rritja e stabilitetit monetar, rritja e besimit në stabilitetin e lekut dhe pritjet e ulta inflacioniste shërbyen si bazë për ndryshime të mëtejshme drejt uljes së këtyre përqindjeve edhe gjatë viteve 1999 dhe 2000. Duke ruajtur varësinë horizontale ndaj faktorit kohë, ato u ulën edhe tre herë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 1999, duke u pasuar nga tre ulje të tjera deri në fund të këtij viti. Interesi mesatar i ponderuar i sistemit bankar për depozitat dymbëdhjetëmujore arriti në 8.30 për qind në fund të vitit 2000. Ndërsa po ky interes për depozitat tremujore llogaritet në 7.72 për qind në fund të po këtij viti. Axhustimet e vazhdueshme të nivelit të interesave nominalë me nivelin e inflacionit gjatë këtij viti, bënë që niveli real i interesave për depozitat me afat të luhatet në kufij të arsyeshëm.

Pas tetorit të vitit 2000, niveli i interesave të depozitave me afat në lekë, nuk u përcaktua më administrativisht nga Banka e Shqipërisë. Si referencë për normat e interesave të tregut u përcaktua norma e interesit të repove. Deri në fund të vitit 2001, politika e Bankës së Shqipërisë në drejtim të interesave ka qenë politikë e zbutur monetare. Interesi mesatar i depozitave me afat tre dhe dymbëdhjetëmujor, për sistemin bankar, u reduktua përkatësisht në 7.08 për qind dhe 6.31 për qind në fund të vitit 2001.

Rritja e motivit të kursimit, e konkretizuar në rritjen e depozitave me afat, përmban edhe motivin "spekulues"[1]. Avantazhi i mbajtjes së parave në depozita afatshkurtra, nga ana e qytetarëve, çoi në ndryshimin e formës së strukturës së depozitave sipas afatit.

Struktura e depozitave me afat në lekë, në Bankën e Kursimeve[2], ka pësuar ndryshime të ndjeshme për periudhën 1992 deri në 2001. Në vitin 1992 raporti midis depozitave tre dhe dymbëdhjetëmujore ishte 1 : 92 për qind në favor të depozitave dymbëdhjetëmujore, në fund të vitit 2001 raporti është zhvendosur në 49.27 : 41.77 në favor të depozitave tremujore.

Para vitit 1996, diferencat në nivelin e interesave midis depozitave me afat (3, 6 dhe 12-mujore) në lekë nuk ishin shumë të larta për të nxitur zhvendosje midis maturiteteve. Gjate vitit 1997, të joshur nga fitimet që sillnin interesat e lartë për depozitat me afat, kryesisht ato me afat maturimi të vogël, u vu re një rritje shumë e madhe në pranimet e reja për depozitat me afat në lekë.

Gjithashtu, filloi një kalim gradual nga depozita pa afat në depozita me afat, ku ato tremujore zinin peshën kryesore. Këto ndryshime çuan në rritjen e kostos së pranimeve të reja të depozitave me afat të Bankës së Kursimeve në veçanti dhe të sistemit në tërësi, e matur përmes interesit mesatar të ponderuar për depozitat me afat në lekë.

Në vitin 1997, niveli mesatar mujor i interesit të depozitave me afat të sistemit u rrit nga 16.47 për qind në vitin 1996, në 29.77 për qind. Parë sipas maturiteteve interesi mesatar mujor

Grafik 6. Interesi mesatar i ponderuar për depozitat tre, dymbëdhjetëmujore dhe si mesatare e maturiteteve për sistemin bankar, në përqindje.



i ponderuar për depozitat tremujore u dyfishua krahasuar me vitin 1996, duke arritur në 30.33 për qind dhe interesi mesatar i ponderuar për depozitat dymbëdhjetëmujore u rrit nga 16.77 për qind në 27.07 për qind.

Edhe gjatë viteve 1998 dhe 1999, niveli mesatar për depozitat tremujore qëndroi më i lartë se sa për maturitetet e tjera. Në peshën e pranimeve të reja të depozitave tre dhe dymbëdhjetëmujore u vërejt tendenca drejt zbutjes së shpërpjesëtimeve, e ndikuar nga eliminimi i diferencave të mëdha midis interesave për depozita afatshkurtra dhe afatgjata. Në vitin 1999, kostoja mesatare e pranimit të depozitave të reja me afat tre dhe dymbëdhjetëmujor llogaritet përkatësisht 13.19 për qind dhe 12.87 për qind, duke u reduktuar në 6.3 për qind dhe 7.08 për qind për depozitat tre dhe dymbëdhjetëmujore në vitin 2001.

Tabelë 2. Zhvillimi i strukturës së depozitave dhe interesi mesatar i depozitave në lekë në Bankën e Kursimeve, në përqindje.

	1 muaj		3 muaj		6 muaj		12 muaj		24 muaj	
	Pjesa*	Interesi**	Pjesa	Interes	Pjesa	Interes	Pjesa	interesi	pjesa	Interes
1992			1.00	18.00	7.00	25.00	92.00	32.00		
1993			0.70	12.00	3.20	18.00	96.00	24.00		
1994			0.50	7.00	2.00	12.00	97.50	14.50		
1995			2.22	10.50	4.70	13.00	93.08	14.20		
1996	0.25	18.00	6.46	15.10	5.03	15.90	88.26	16.60		
1997	0.23	19.00	54.54	33.56	3.25	26.41	41.49	26.90	0.05	
1998	0.21	12.00	53.71	23.08	5.46	23.08	40.19	23.35	0.05	
1999			52.00	14.20	7.00	14.20	41.00	13.80	0.03	
2000			50.87	7.57	7.55	7.85	41.59	8.20		
2001			49.27	6.85	8.96	7.69	41.77	7.60		

* Pesha specifike në përqindje e depozitave në lekë sipas afatit ndaj totalit të depozitave në lekë. **Interesi mesatar i ponderuar për depozitat në këtë bankë.

Motivi i kursimit në ekonomi është ndikuar në një masë të ndjeshme edhe nga faktorët psikologjikë, të cilët kanë krijuar situata të njohura edhe si "panik". Këta faktorë, për nga natyra e tyre e paqëndrueshme, kanë patur një ndikim negativ të përkohshëm në ecurinë e depozitave të sistemit bankar dhe kanë qenë të lokalizuar në banka të veçanta. Në funksion të efektit të tyre në ndryshimin e motivit të kursimeve të publikut, Banka e Shqipërisë në ndryshimin e nivelit të interesave e ka patur si qëllim

neutralizimin e efektit negativ të këtyre faktorëve dhe sigurimin e rrjedhjes normale të depozitave në sistem. Sistemi bankar, për periudhën e marrë në studim ka njohur dy situata "paniku". Faktorët që i kanë shkaktuar ato kanë qenë të ndryshëm.

I pari, lidhet me "panikun" që krijoi falimentimi i firmave piramidale. Kolapsi total i firmave të tregut joformal të ekonomisë, u shoqërua krahas prishjes së shumë ekuilibrave ekonomikë, edhe me pasoja sociale, me pasoja ekonomike, me pasoja psikologjike dhe me pasoja politike. Kriza e besimit ndaj institucioneve të tregut joformal, mungesa e stabilitetit ekonomik dhe politik, u ndje edhe në institucionet e tregut formal. Qytetarët, në situatën e "panikut" të krijuar, tërhoqën depozitat nga bankat tregtare. Në kushtet e një krize politike dhe ekonomike dhe për të ndërprerë rrjedhjen e mëtejshme të depozitave nga sistemi bankar, Banka e Shqipërisë ndërhyri në treg duke rritur interesat e depozitave me afat.

I dyti, lidhet me procesin e privatizimit të Bankës së Kursimeve dhe me propagandën e bërë mbi gjoja pasigurinë e depozitave në këtë bankë, në fillim të vitit 2000. Paniku i krijuar dha efekte negative të menjëhershme në motivin e qytetarëve për vendosjen e depozitave në këtë bankë, duke u pasqyruar në ecurinë e depozitave gjatë vitit 2000. Më i fuqishëm efekti qe gjatë pjesës së parë të vitit, por ndikimi i tij u ndje edhe gjatë pjesës së dytë të vitit 2000. Në fund të vitit 2000, pesha e depozitave me afat ndaj parasë gjithsej u ul me 3.85 pikë përqindjeje, ndërkohë që paraja në qarkullim u rrit me 2.48 pikë përqindjeje.

Tabelë 3. Pesha në përqindje e depozitave me afat në lekë dhe e depozitave në valutë ndaj totalit të këtyre grupdepozitash.

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Depozita me afat në lekë	41.03	53.30	58.44	58.34	47.14	66.01	74.16	71.98	68.83	64.78
Depozita në valutë	58.97	46.70	41.56	41.66	52.86	33.99	25.84	28.02	31.17	35.22
Totali	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
Kursi mesatar vjetor lek/usd		102.06	94.62	92.79	104.5	148.93	150.64	137.69	143.88	143.61

Sjellja e depozitave në valutë dhe në lekë, ka qenë e kushtëzuar, përveç të tjerave edhe nga ruajtja e raporteve optimale midis nivelit të interesave për depozitat në lekë dhe për depozitat në valutë.

Kjo sjellje e depozitave në valutë dhe në lekë në sistem bankar del më e qartë po të analizojmë peshën specifike të depozitave në lekë dhe në valutë ndaj totalit të këtyre depozitave.

Në pamje të parë pesha e depozitave me afat në lekë paraqet një trend rritës, kundrejt trendit rënës të depozitave në valutë, krahasuar me totalin e depozitave me afat. Por, e studiuar vit pas viti, ecuria e peshës së depozitave me afat në lekë shkon gjithnjë në kah të kundërt me ecurinë e peshës së depozitave në valutë. Konkretisht, gjatë vitit 1996, ulja e depozitave në lekë kundrejt depozitave në valutë erdhi si pasojë e influencës së tregut joformal dhe nga prirja e bankave të huaja private për të pranuar më shumë depozita në valutë. Në vitin 1997, raporti ndryshon në favor të depozitave me afat në lekë si pasojë e interesave tepër atraktivë për këto depozita. Ky raport vazhdoi të ruhej edhe gatë vitit 1998, për të ndryshuar pas vitit 1999. Duke filluar nga viti 1999, në rritjen e peshës së depozitave me afat në valutë kundrejt atyre në lekë kanë ndikuar, krahas politikës zbutëse të Bankës së Shqipërisë në drejtim të uljes së normave të interesit, edhe faktorë të tjerë si, veprimi pas viteve '96-'97 i më shumë bankave të huaja private që priren të marrin depozita në valutë, hyrjet e mëdha në valutë në periudhën e Krizës Kosovare (viti 1999), marketingu i bërë nga bankat tregtare për konvertimin pa komisione të monedhave të Bashkimit Evropian (viti 2000), para hyrjes së monedhës fizike euro, në 1 janar 2002.

Grafik 7. Struktura e depozitave me afat në lekë dhe në valutë dhe tendenca (majtas në përqindje, djathtas në lekë).



Grafik 8. Ecuria e depozitave në valutë dhe e kursit të këmbimit lekë/usd.



Marrëdhëniet midis depozitave me afat në lekë dhe depozitave në valutë, zhvendosjet nga njëri kah në tjetrin influencohen kryesisht nga këta faktorë:

- niveli i interesave për depozitat në lekë,
- niveli i interesave për depozitat në valutë,
- ndërmjetësimi në këtë diferencë[3] i efektit të mbiçmimit ose të nënçmimit të lekut në tregun e brendshëm valutor,
- shkalla e stabilitetit të ambientit monetar, e cila lidhet kryesisht me pritshmërinë për nivelin e inflacionit.

Konkretisht, interesat e lartë në lekë gjatë vitit 1997 dhe mbiçmimi i lekut ndaj valutave kryesore çuan në zhvendosjen e depozitave nga ato në valutë në ato në lekë. Përfitimet nga interesat e depozitave në lekë qenë disa herë më të larta se sa ato nga interesat për depozitat në valutë. Ndërsa pas këtij viti dhe në vazhdim, si rezultat i politikës së kujdesshme të Bankës së Shqipërisë në fushën e përqindjeve të interesit dhe të stabilitetit të lekut, diferencat midis nivelit të interesave në lekë dhe nivelit sipas parimit të barazisë së interesave u ngushtuan ndjeshëm.

Grafikët 9 dhe 10 japin një ide më të qartë të nivelit nominal të interesave të depozitave me afat në lekë dhe nivelit të llogaritur të interesave për depozitat me afat në lekë pas ponderimit të nivelit nominal të interesave për valutat kryesore me koeficientët

e mbiçmimit/nënçmimit të lekut ndaj valutave kryesore, të llogaritura në bazë vjetore.

Grafik 9. Barazia e interesave për maturitetin dymbëdhjetëmujor, në përqindje.



Grafik 10. Barazia e interesave për maturitetin tremujor, në përqindje.



Sipas parimit të barazisë së interesave në lekë të zbatuar nga sistemi bankar dhe interesave në valutë kemi këtë situatë:

- deri në fund të vitit 1996, niveli i interesave për depozitat me afat dymbëdhjetëmujor në lekë ka qenë pothuajse nën nivelin që kërkon ky parim, duke paraqitur leverdinë më të madhe që ka patur mbajtja e depozitave në valutë në krahasim me depozitat në lekë;
- gjatë periudhës 1997-1998, niveli i interesave për depozitat

me afat tre dhe dymbëdhjetëmujor në lekë ka qenë më i lartë se sa duhej të ishte sipas këtij parimi. Raporti i peshës së depozitave në lekë ndaj peshës së depozitave në valutë ndryshoi nga 47.14:52.86 në fund të vitit 1996, në 74.16:25.84 në fund të vitit 1998;

- gjatë periudhës 1998-2001, niveli i interesave për depozitat me afat në lekë u ul në mënyrë të vazhdueshme duke iu përshtatur më mirë kushteve të tregut dhe duke ngushtuar diferencat që ekzistonin midis nivelit nominal që mbizotëronte në sistemin bankar dhe atij të llogaritur. Raporti i peshës së depozitave në lekë ndaj peshës së depozitave në valutë u ul lehtë, duke rezultuar 64.7:35.22 në fund të vitit 2001.

Pas vitit 2000 e në vazhdim diferenca është ngushtuar ndjeshëm duke arritur nivele të ulta, të cilat kanë ndikuar edhe në uljen e ritmeve të rritjes së depozitave me afat në lekë krahasuar me ato të viteve të mëparshme. Në njëfarë mënyre, kjo manifeston zhvendosjen e preferencës së publikut për mbajtjen e depozitave në valutë kundrejt depozitave në lekë, duke nënkuptuar rritje të kërkesës për para dhe premisa për nënçmim të monedhës vendase në tregun e brendshëm valutor.

II. STRUKTURA SEKTORIALE E DEPOZITAVE GJITHSEJ DHE KONTRIBUTI I TYRE NË KRIJIMIN E DEPOZITAVE

Analiza e strukturës së depozitave gjithsej sipas kontributit të sektorëve kryesorë të ekonomisë ndihmon në identifikimin e karakteristikave të veçanta të këtyre sektorëve në krijimin e depozitave, si dhe kontributin që ato japin në ofertën e parasë. Të dhënat statistikore nga bankat tregtare paraqesin një zhvendosje të depozitave për periudhën 1992-2001 nga sektori shtetëror tek individët.

Raporti i depozitave të individëve ndaj depozitave gjithsej, për periudhën 1992-2001, është ndryshuar nga 35.95 për qind në 80.85 për qind, ndërkohë që raporti i sektorit privat dhe të atij shtetëror ndaj depozitave gjithsej ka ndryshuar

përkatësisht nga 10.91 për qind në 12.75 për qind dhe nga 53.14 për qind në 6.4 për qind. Madje edhe ritmet e rritjes së depozitave në sektorin privat dhe në sektorin shtetëror janë ulur.

Një zhvillim i veçantë që ndryshon konkluzionin për tendencën e përgjithshme rreth influencës së depozitave të individëve në krijimin e depozitave ka ndodhur në periudhën midis viteve 1995-1996. Dinamika e depozitave gjithsej filloi të devijojë nga tendenca në rritje e depozitave të individëve drejt rritjes së atyre nga sektori privat.



Ky devijim u shkaktua nga aktiviteti i firmave të tregut joformal. Në këtë periudhë shumë qytetarë, tërhoqën kursimet e tyre nga sistemi bankar dhe i investuan në firmat e tregut joformal, që aplikonin interesa shumë më të lartë. Si rezultat, në muajt e parë të vitit 1996, u shfaq për herë të parë rënia e depozitave në lekë në sistemin bankar. Me zgjerimin e aktivitetit të këtyre firmave, u vu re një fenomen i ri, rënie e depozitave me afat në lekë në tremujorin e fundit të vitit 1996 dhe rritje e llogarive rrjedhëse, që qenë kryesisht për llogari të firmave rentiere në të njëjtën periudhë të vitit 1996. Tendenca rënëse e depozitave me afat u zbut në njëfarë mase nga hapja e depozitave me afat në emër të presidentëve të këtyre firmave.

Tabelë 4. Depozita sipas sektorëve ndaj depozitave gjithsej, në përqindje.

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Sektor shtetëror	53.14	47.86	33.8	29.24	14.99	15.71	10.72	9.76	7.60	6.40
Sektor privat	10.91	7.10	10.45	15.22	47.90	15.09	10.13	11.91	12.80	12.75
Individë	35.95	45.04	55.75	55.54	37.11	69.21	79.15	78.34	79.60	80.85

Ecuria e tre tipeve të depozitave - depozita pa afat në lekë, depozita me afat në lekë dhe depozita në valutë - varet para së gjithash nga preferencat dhe karakteristikat e sektorit që luan rolin përcaktues në ecurinë e tyre sipas grupeve.

Kështu, individët luajnë rolin vendimtar në zhvillimin e depozitave me afat dhe kanë një peshë të rëndësishme në depozitat në valutë, kurse sektori shtetëror dhe ai privat luajnë një rol të rëndësishëm në depozitat në valutë dhe llogaritë rrjedhëse në të cilat zënë pjesë të konsiderueshme. Rrjedhimisht, individët kanë efekt të rëndësishëm në përcaktimin e tendencës së depozitave me afat, ndërsa sektorët shtetëror dhe privat influencojnë kryesisht në fluktuacionet e pjesës likuide të parasë.

Tabelë 5. Depozitat sipas origjinës së krijimit, në përqindje.

	Depozita pa afat në lekë			Depozita me afat në lekë			Depozita në valutë		
	Sektor shtetëror	Sektor privat	Individë	Sektor shtetëror	Sektor privat	Individë	Sektor shtetëror	Sektor privat	individë
1992	28.24	3.21	7.05	1.64	0.49	23.11	23.26	7.21	5.79
1993	25.11	4.23	2.88		0.54	36.29	22.75	2.33	5.87
1994	16.96	5.20	3.10		1.05	43.10	16.90	4.20	9.60
1995	16.64	7.83	1.99		0.70	42.20	12.60	6.69	11.35
1996	8.53	29.33	2.04		2.78	25.55	6.46	15.79	9.51
1997	8.53	6.69	0.50		0.06	56.01	7.18	8.34	13.34
1998	4.70	3.91	0.38	0.07	0.41	67.32	5.94	5.81	11.45
1999	4.69	3.84	0.74	0.13	1.21	63.02	4.94	6.86	14.58
2000	2.80	6.90	1.10	0.40	0.30	60.70	4.40	5.60	17.80
2001	2.30	5.50	0.90	0.30	0.70	58.20	3.80	6.60	21.80

Ndryshueshmëria e karakteristikave sektoriale të zhvillimit të depozitave buron nga dy faktorë. Së pari, qëndrimet e ndryshme midis individëve dhe bizneseve në mbajtjen e parasë, në përputhje me funksionet e ndryshme sektoriale të kërkesës për para; dhe së dyti, nevojat dhe lehtësitë për të marrë kredi si burime shtesë ose burime të jashtme të financimeve të ndryshme.

Motivi i individëve për shtimin e parave përmban si elementin e plotësimit të shpenzimeve të tyre të përditshme ashtu edhe elementin e kursimeve. Përdorimi i mjeteve financiare në sektorin privat dhe shtetëror motivohet nga qëllime transaksioni dhe mbulim pjesor i nevojave financiare, kryesisht me kredi.

Depozitat e individëve. Nisur nga struktura e depozitave të individëve dhe tendenca e tyre rezulton që:

- depozitat me afat në lekë zënë peshën kryesore të depozitave të individëve dhe me tendencë në rritje. Pesha e tyre është rritur me 7.65 pikë përqindjeje;
- depozitat në valutë, për nga pesha, renditen pas depozitave në lekë dhe ruajnë tendencë në rritje (me 10.84 pikë përqindjeje);
- depozitat pa afat kanë ardhur duke rënë në mënyrë të vazhdueshme (me 18.49 pikë përqindjeje).

Tabelë 6. Depozitat e individëve sipas afateve dhe monedhës, në përqindje.

Viti	Depozita pa afat në lekë	Depozita me afat në lekë	Depozita në valutë
1992	19.61	64.29	16.10
1993	6.38	80.59	13.03
1994	5.57	77.25	17.18
1995	3.58	75.98	20.43
1996	5.50	68.87	25.63
1997	0.71	80.18	19.10
1998	0.48	85.06	14.46
1999	0.94	80.45	18.61
2000	1.35	76.27	22.37
2001	1.12	71.94	26.94

Grafik 12. Depozitat e individëve sipas afateve dhe monedhës, në përqindje.



Ndryshimeve kryesore të peshave midis kategorive të depozitave të individëve në vite do t'u jepnim shpjegimet e mëposhtme:

Depozitat në lekë të individëve u ulën me 7.11 pikë përqindjeje gjatë vitit 1996, për t'u rritur gjatë vitit 1997 me 11.31 pikë përqindjeje. Siç e kemi përmendur, ulja e depozitave me afat në lekë në sistem qe pasojë e influencës së tregut joformal të ekonomisë, ndërsa rritja e depozitave me afat në lekë qe rezultat i politikës së rritjes së përqindjeve të interesit të depozitave në lekë.

Gjatë vitit 1999, rritja e peshës së depozitave në valutë me rreth 4.0 pikë përqindjeje ndaj depozitave të individëve, u ndikua nga rritja e fluksit të hyrjeve në valutë nga organizma të ndryshëm, që zhvilluan aktivitetin e tyre në vendin tonë gjatë krizës kosovare dhe tendenca në rënie e interesave të depozitave në lekë. Interesat e depozitave në lekë, duke filluar nga viti 2000, u reduktuan vazhdimisht për të arritur në nivelet më të ulëta në historinë e sistemit bankar dynivelësh. Gjatë dy viteve të fundit, pesha e depozitave në valutë ndaj depozitave të individëve ka njohur rritje, ndërsa pesha e depozitave me afat në lekë ka ardhur në rënie. Këto zhvendosje të lehta shprehin faktin që qytetarët kanë rritur preferencat për depozita në valutë. Kjo bëri që individët, të ardhurat nga emigracioni, të cilat njohën nivelin më të lartë në dy vitet e fundit, të preferonin më shumë t'i vendosnin depozita në valutë.

Grafik 13. Fluksi mesatar vjetor i të ardhurave nga emigrantët dhe rritja mesatare vjetore e depozitave në valutë të vendosura në sistemin bankar për periudhën 1994-2001, në miliardë lekë.



Gjatë vitit 2001, në rritjen e depozitave në valutë ka ndikuar edhe depozitimi i monedhave të vendeve të Bashkimit Evropian në banka për t'i konvertuar pa komisione me futjen në qarkullim të monedhës euro, në 1 janar 2002.

Depozitat e sektorit privat. Depozitat e bizneseve në depozitat gjithsej, në fund të vitit 2001, përbëjnë rreth 13 për qind. Totali i parave që zotërojnë bizneset dhe që kalojnë nëpërmjet sistemit bankar është më i vogël se burimet financiare të mbajtura nga individët.

Në totalin e depozitave, që zotëron sektori privat, nivel të lartë paraqesin depozitat në valutë të bizneseve gjatë gjithë periudhës dhjetëvjeçare të marrë në studim. Në fund të vitit 2001, depozitat në valutë zënë rreth 52 për qind të depozitave gjithsej të sektorit privat. Edhe depozitat pa afat në lekë paraqiten me tendenca në rritje, nga 29.5 për qind në vitin 1992, në 43.1 për qind në fund të vitit 2001. Ecuria e depozitave pa afat, për periudhën 1992-2001, paraqitet me një tendencë të paqëndrueshme dhe niveli i tyre është shumë i ulët krahasuar me depozitat me afat.

Grafik 14. Ecuria e depozitave në sektorin privat, në përqindje.



Tabelë 7. Struktura e depozitave të sektorit privat, në përqindje.

Vitet	Depozita pa afat	Depozita me afat	Depozita në valutë
1992	29.45	4.49	66.06
1993	59.63	7.58	32.8
1994	45.56	8.75	45.69

1995	51.46	4.6	43.94
1996	61.23	5.8	32.96
1997	44.33	0.42	55.26
1998	38.57	4.05	57.38
1999	32.22	10.13	57.65
2000	52.82	2.51	44.68
2001	43.08	5.28	51.64

Ecuria e depozitave në sektorin privat gjatë 10 vjetëve manifeston këto karakteristika:

- depozitat në valutë e kanë ulur peshën e tyre në fund të vitit 2001 me 14.42 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 1992;
- pesha e depozitave pa afat është rritur me 13.59 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 1992. Pesha e depozitave pa afat nivelin më të lartë e ka patur në vitin 1996 me 61 për qind të depozitave të këtij sektori, duke u pasuar me një tendencë në rënie të këtyre depozitave pas vitit 1996. Në vitin 2000 pati një rritje të konsiderueshme të nivelit të tyre, vit ku kreditimi i biznesit u karakterizua nga ritme të larta krahasuar me gjithë vitet e kaluara;
- depozitat me afat në lekë zënë një peshë të vogël ndaj totalit. Pas vitit 1997 ajo ka ardhur duke u rritur si rrjedhim i vendosjes së depozitave me afat në lekë, në depozita tremujore gjatë vitit 1997, ku aktiviteti ekonomik në vend njohu tërheqje dhe u desh një periudhë kohe për t'u rikuperuar. Kjo bëri që të hiqeshin nga xhiroja ekonomike sasi parash një pjesë e të cilave u vendosën në depozita afatshkurtra.

Pesha e depozitave pa afat në lekë dhe pesha e depozitave në valutë duket që shkojnë në kahe të kundërta dhe krijojnë idenë se midis këtyre dy grupeve ekziston një shkallë zëvendësimi. Por, pa e përjashtuar këtë mundësi, theksojmë se pesha depozitave pa afat në fund të vitit mund të mos paraqesë plotësisht drejt situatën e tyre. Kjo pasi, për shkak të zhvillimeve jo të rregullta të depozitave pa afat, vëllimi i tyre rritet dhe ulet brenda vitit i ndikuar nga zhvillimet sezonale, nga cikli tregtar, nga niveli i kreditimit të ekonomisë etj..

Sektori shtetëror paraqitet me ulje të peshës së depozitave në të gjitha kategoritë e depozitave. Kështu, për depozitat pa afat në lekë pesha e këtij sektori ka rënë 25.94 pikë përqindjeje, për depozitat në valutë kjo peshë ka rënë me 19.46 pikë përqindjeje. Rënia e vazhdueshme e depozitave të këtij sektori, pra dhe të kontributit në totalin e depozitave të sistemit bankar është kushtëzuar nga disa faktorë. Ndër më të rëndësishmit do të përmendim:

- Mbylljen dhe privatizimin e një pjese të konsiderueshme të ndërmarrjeve të këtij sektori gjatë periudhës 1992-2001.
- Mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të ndërmarrjeve ekzistuese të këtij sektori. Duke qenë në pronësi shtetërore, mënyra e organizimit dhe e funksionimit, e udhëhequr nga politikat publike, bën që ato shpesh kalojnë në deficit, duke u kthyer në biznese me humbje (si në rastin e KESH-it). Si rrjedhim ato ndikojnë në uljen e kursimeve të këtij sektori.
- Shkalla jo shumë e lartë e vjeljes së të ardhurave nga taksat. Në shumë raste ky proces pengohet nga probleme administrative, të cilat mund të ulin kursimet e sektorit shtetëror.

Gjithashtu ndikojnë edhe të ardhurat nga eksporti dhe importi, niveli i shpenzimeve për borxhin e jashtëm dhe të brendshëm.

Të dhënat kumulative tregojnë që zhvillimet e depozitave sipas sektorëve ndryshojnë dukshëm. Kështu:

- Depozitat e individëve kanë tendencë në rritje të qëndrueshme. Duke zënë mbi 80 për qind të totalit të depozitave gjithsej, individët kanë një funksion të rëndësishëm në krijimin e trendit të depozitave gjithsej dhe ofertës së parasë.
- Rritja e depozitave në sektorin shtetëror dhe privat është më pak e qëndrueshme. Kjo për vetë faktin që këta sektorë kanë peshë të lartë në depozitat pa afat. Në këtë mënyrë, roli i burimeve financiare të këtyre dy sektorëve në formimin e trendit të depozitave gjithsej paraqitet më i vogël krahasuar me burimet financiare që zotërojnë individët.

Për sa u trajtua në pikat 1 dhe 2, do të evidentonim që:

Zhvillimet në depozitat e sistemit bankar kanë sjellë rritjen e mjeteve financiare më pak likuide, duke ndikuar në uljen e presioneve inflacioniste në ekonomi dhe rritjen e stabilitetit monetar.

Struktura e depozitave sipas afatit të maturitetit, në favor të atyre me afat të vogël maturimi paraqet një strukturë jo shumë të përshtatshme të burimeve financiare të aktivitetit kreditues të bankave tregtare. Nga ana tjetër, pasojë e kësaj strukture është edhe vëllimi i lartë i interesave që paguhen për këto depozita. Pjesa e interesave të përfituar nga depozitat duke u investuar në depozita të reja përbën një burim shtesë në rritjen e shpejtë të ofertës së parasë në ekonomi. Duke qenë se depozitat me maturim të vogël kanë një peshë të lartë, ato ndikojnë në drejtim të uljes së qëndrueshmërisë në kohë të kësaj pjese të ofertës së parasë.

Preferencat dhe karakteristikat e ndryshme të sektorëve të ekonomisë luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e depozitave duke influencuar dinamikën e zhvillimit të depozitave gjithsej. Kështu, depozitat e individëve rezultojnë se kanë një efekt të rëndësishëm në formimin e tendencës së depozitave gjithsej dhe më gjerë në ofertën e parasë, dhe duhen vlerësuar si një grup i qëndrueshëm. Ndërsa dy sektorët e tjerë influencojnë kryesisht në fluktuacionet e depozitave me likuiditet të lartë në depozitat gjithsej dhe ofertën e parasë.

III. NDRYSHIMET NË TREGUN E DEPOZITAVE SIPAS BANKAVE TREGTARE

Ndryshimet në kapacitetet thithëse të bankave të sistemit bankar kanë ardhur paralelisht me reformat në sistemin bankar. Fillimisht me krijimin e një sistemi që t'i përshtatej ekonomisë së tregut për nga forma e funksionimit dhe më pas në reformimin e tij në shumë drejtime për t'i shërbyer ekonomisë së tregut.

Roli i bankave qëndron në aftësitë thithëse të mjeteve përkohësisht të lira, që ka ekonomia, në kanalet e sistemit bankar në Shqipëri. Kjo ndihmon për të përcaktuar madhësinë e këtij tregu, në raport me tregun joformal. Në kushtet kur ende nuk ka një vlerësim standard për madhësinë e tregut joformal në Shqipëri, raporti i depozitave gjithsej ndaj prodhimit të përgjithshëm bruto na ndihmon për të vlerësuar shkallën e ndërmjetësimit financiar të sistemit bankar. Ky raport për periudhën 1992-2001 është rritur 37 : 47 për qind, duke shprehur rritjen e shkallës së ndërmjetësimit të sistemit bankar në ekonomi. Ky tregues edhe pse është më i ulët se sa niveli i tij në Eurozonë (78 për qind) është i krahasueshëm me vendet në tranzicion.

Ndërsa, brenda këtij sistemi, rëndësi ka struktura e shpërndarjes së kursimeve sipas bankave për realizimin e rolit të ndërmjetësit në zhvillimin ekonomik të vendit, në kushtet e rritjes së konkurrencës.

Madhësia e tregut përcaktohet nga madhësia e çdo banke dhe roli që luan çdo bankë në funksionimin me efektivitet të tregut, varet nga numri i pjesëmarrësve në të, nga shtrirja e tyre dhe nga niveli i konkurrencës së pjesëmarrësve në tregun e depozitave.

Pjesa e burimeve financiare që zotëron secila bankë në sistemin bankar, në vite të ndryshme, është e ndryshme dhe ndikohet nga shumë faktorë. Ndër faktorët, si më kryesorë do të veçonim:

- periudha që ushtron aktivitetin banka në sistem,
- madhësia dhe shpërndarja gjeografike në vend,
- numri i bankave në sistem,
- shkalla e konkurrencës në treg,
- sasia dhe cilësia e produkteve që ofron banka,
- lehtësitë në kryerjen e pagesave të ndryshme, të kushtëzuara nga niveli i zhvillimit të sistemit të pagesave,
- ndikimi i tregut joformal etj..

Llogaritja e peshës së totalit të depozitave për çdo bankë si sistem lejon të japim gjykime lidhur me punën e bankave në rritjen e potencialeve financiare, në drejtim të thithjes së mjeteve përkohësisht të lira nga xhiroja ekonomike. Deri në vitin 1996, tregu i depozitave zotërohej kryesisht nga tre banka me kapital shtetëror. Tregu paraqitej i segmentuar. Banka e Kursimeve zotëronte tregun e depozitave të individëve, Banka Kombëtare Tregtare zotëronte rreth 70 për qind të depozitave të sektorit shtetëror, ndërsa Banka Tregtare Agrare operonte në zonat rurale.

Në vitin 1993, bankat shtetërore zotëronin rreth 98 për qind të tregut të depozitave gjithsej. Tregu i depozitave gjithsej sipas bankave ka ndryshuar dukshëm pas vitit 1999[4] e në vazhdim. Kjo si rezultat i rritjes së rolit të bankave private në treg. Këto banka duke qenë më aktive në treg, si nga pikëpamja intensive dhe ajo ekstensive, kanë rritur pjesën që zotërojnë me 23.47 pikë përqindjeje[5]. Panorama e shpërndarjes së depozitave në sistem midis bankave reflekton pozicionin mbizotërues të Bankës së Kursimeve në thithjen e mjeteve përkohësisht të lira që zotëron ekonomia.

Përqendrimi i depozitave është studiuar edhe sipas kategorive të veçanta në:

- depozita në lekë dhe në valutë,
- depozita sipas shkallës së likuiditetit, në depozita me afat dhe depozita pa afat.

Njohja e kësaj strukture do të na lejojë që të evidentojmë se cila është përbërja e këtyre burimeve mbi të cilën mbështeten bankat, për të realizuar rolin e ndërmjetësit.

Tabelë 8. Pesha specifike e depozitave në lekë sipas pronësisë së bankave, në përqindje.

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Banka shtetërore	99.99	99.89	99.72	99.55	99.24	98.26	96.25	82.98	79.61
Banka private &JV	0.01	0.11	0.28	0.45	0.76	1.74	3.75	17.02	20.39



Për periudhën e marrë në shqyrtim do të veçonim këto karakteristika në lidhje me shpërndarjen e depozitave në lekë sipas bankave në sistem:

- bankat me kapital shtetëror zotërojnë rreth 80 për qind të kursimeve në lekë të sistemit. Ky nivel për këto banka ka patur një tendencë të lehtë në ulje që nga krijimi i sistemit bankar, ku pesha e tyre kapte nivelin rreth 99 për qind. Banka që zotëron pjesën dërrmuese të *depozitave në lekë* në sistem është Banka e Kursimeve[6]. Nivelin më të lartë të depozitave në lekë Banka e Kursimeve e ka arritur në fund të vitit 1998, me rreth 88 për qind. Përsa i përket fundit të vitit 1999 e në vazhdim, vihet re një rënie e lehtë në nivelin e tyre duke arritur në 79.6 për qind në fund të vitit 2001;
- bankat me kapital privat dhe të përbashkët e kanë rritur gradualisht pjesën e kursimeve në lekë, duke kapur nivelin rreth 20 për qind në vitin 2001. Rritja më e madhe e depozitave në lekë në këtë grup bankash ka qenë në vitet 2000 -2001, duke manifestuar edhe interesimin më të madh të këtyre bankave ndaj tregut të depozitave në lekë.

E ndryshme paraqitet tabloja në shpërndarjen e depozitave në valutë sipas bankave në sistem për periudhën 1993 - 2001.



Tabelë 9. Pesha specifike e depozitave në valutë sipas pronësisë së bankave, në përqindje.

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Banka shtetërore	95.98	92.75	91.85	90.75	80.23	74.82	60.35	39.98	34.01
Banka private e të përbashkëta	4.02	7.25	8.15	9.25	19.77	25.18	39.65	60.02	65.99

Tregu i depozitave në valutë në sistem sipas bankave është karakterizuar nga:

- tendenca në ulje e tregut të bankave me kapital shtetëror, kundrejt rritjes së tregut të bankave me kapital joshtetëror. Pjesa e tregut që zotërojnë bankat me kapital shtetëror është ulur në 61.97 pikë përqindjeje në favor të pjesës tjetër të sistemit, nga viti 1993 në vitin 2001;
- këto ndryshime janë bërë më të dukshme pas vitit 1997 dhe janë thelluar edhe më shumë pas vitit 1999.

Rritja e pjesës së depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave në valutë të sistemit, që zotërojnë bankat me kapital privat dhe të përbashkët, ka ardhur kryesisht nga rritja e depozitave pa afat, krahasuar me depozitat me afat. Kështu, për periudhën 1993-2001:

- pjesa e depozitave pa afat është rritur me 59.0 pikë përqindjeje,
- pjesa e depozitave me afat është rritur me 6.71 pikë përqindjeje.

Ritmet e rritjes së depozitave pa afat në këto banka duket që kanë qenë disa herë më të larta, krahasuar me ritmet e rritjes së depozitave me afat.

Tabelë 10. Pesha specifike e depozitave pa afat sipas pronësisë së bankave, në përqindje.

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Banka shtetërore	99.01	96.33	94.46	95.08	85.86	76.07	68.85	79.39	40.01
Banka private e të përbashkëta	0.99	3.67	5.54	4.92	14.14	23.93	31.15	20.61	59.99

Grafik 17. Depozitat në valutë sipas pronësisë së bankave, në përqindje.



Tabelë 11. Pesha specifike e depozitave me afat sipas pronësisë së bankave, në përqindje.

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Banka shtetërore	98.32	98.98	99.56	99.23	95.81	96.05	91.45	77.57	71.61
Banka private e të përbashkëta	1.68	1.02	0.44	0.77	4.19	3.95	8.55	22.43	28.39

Grafik 18. Ecuria e depozitave pa afat sipas pronësisë së bankave, në përqindje.



Në përfundim do të theksonim që, si rrjedhojë e konkurrencës midis bankave, tendencat, struktura dhe preferencat e klientëve, gjatë periudhës së marrë në analizë, kanë pësuar ndryshime.

Veçoritë që paraqet zhvillimi i tregut të depozitave sipas pronësisë së bankave janë:

- pjesa e tregut të depozitave të bankave tregtare me kapital shtetëror ka ardhur duke u reduktuar në favor të zgjerimit të tregut të depozitave të bankave të tjera;
- bankat private paraqiten më aktive në tregun e depozitave në valutë, me tendenca të rritjes së interesimit edhe për tregun e depozitave në lekë gjatë viteve të fundit.

Vazhdimi i reformave në sistemin bankar në drejtim të privatizimit të Bankës së Kursimeve, realizimi i një sistemi pagesash që do t'i përgjigjet kërkesave të biznesit në vend, zbatimi i skemës së sigurimit të depozitave, mbështetja më e madhe që do t'i japë sistemi bankar kreditimit të ekonomisë, arritjes së një tregu ndërbankar eficient etj., do të ndihmojnë në arritjen e një sistemi bankar që do të rrisë më shumë shkallën e ndërmjetësit në zhvillimin dinamik të ekonomisë.

3.1. FENOMENI I PËRQENDRIMIT NË AKTIVITETIN DEPOZITUES

Për të matur fenomenin e përqendrimit të sistemit bankar në aktivitetin e depozitave dhe ndryshimin e tij për periudhën 1992-2001 janë llogaritur raportet e përqendrimit dhe indeksi H. Në tërësi, vërehet se vlerat faktike të indeksit H dhe vlera optimale e tij ndryshojnë nga njëri vit në tjetrin.

Ndërsa vlera optimale paraqet një trend rënës, vlera faktike e indeksit H, duket që ka fituar një trend rënës pas vitit 1998, e ndikuar nga rritja e numrit të bankave dhe e punës intensive dhe ekstensive të tyre.

Tabelë 12. Vlerat e indeksit H të llogaritur për disa tregues të depozitave.

Vitet	Totali i Dep.	Dep. në lekë	Dep. në valutë	Dep.me afat	Dep. pa afat	Dep. e individëve	Dep në sekt. priv.	Dep. në sekt. shtet.	Indeksi H vlera optimale 1/nr	Numri i bankave
1992	0.8	0.8	0.8	1.0	1.0	1.3	1.1	1.0	0.33	3
1993	0.4	0.4	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.8	0.25	4
1994	0.4	0.5	0.5	0.6	0.6	0.7	0.4	0.8	0.17	6
1995	0.4	0.5	0.5	0.6	0.6	0.7	0.5	0.8	0.17	6
1996	0.5	0.5	0.4	0.5	0.6	0.5	0.7	0.6	0.14	7
1997	0.5	0.7	0.3	0.7	0.4	0.7	0.3	0.5	0.13	8
1998	0.6	0.8	0.3	0.8	0.3	0.8	0.3	0.5	0.10	10
1999	0.6	0.8	0.2	0.7	0.3	0.7	0.3	0.5	0.08	13
2000	0.5	0.7	0.2	0.6	0.3	0.6	0.3	0.4	0.08	13
2001	0.4	0.6	0.2	0.5	0.2	0.5	0.2	0.4	0.08	13

Grafik 19. Ecuria e depozitave me afat sipas pronësisë së bankave, në përqindje.



Në sistemin bankar shqiptar, gjatë periudhës 1992-2001, vërehen përqendrime, në masë të konsiderueshme në disa tregues të aktivitetit depozitues. Kështu, në pozita dominuese, deri në fund të vitit 1993, ka qenë Banka Kombëtare Tregtare përsa i përket depozitave gjithsej, depozitave pa afat dhe depozitave të sektorit privat. Ndërsa, për treguesin depozita të individëve dhe depozita me afat, në pozicion dominimi për këtë periudhë paraqitet Banka e Kursimeve.

Pas vitit 1993, në tregun bankar shqiptar filluan aktivitetin bankat private dhe shtimi i tyre u bë më intensiv pas vitit 1996. Vlerat faktike të indeksit H për depozitat në lekë tregojnë që fenomeni i përqendrimit të depozitave në lekë është i lartë. Sistemi bankar vazhdon të mbetet i përqendruar me tendencë të lehtë rënieje të këtij përqendrimi. Banka e Kursimeve, gjatë

gjithë periudhës, edhe pse numri i bankave private erdhi duke u rritur, ruan pozitat dominuese në aktivitetin depozitues në lekë. Ndërsa vlera faktike e indeksit H për depozitat në valutë i është afruar në mënyrë të vazhdueshme vlerës optimale të këtij indeksi, gjë që tregon se në tregun e depozitave në valutë nuk ka përqendrim.

Fakti që tregu i depozitave në lekë vazhdon të mbetet i përqendruar, ndërsa tregu i depozitave në valutë nuk konsiderohet i përqendruar shpreh edhe interesimin më të madh të bankave private dhe me kapital të përbashkët për të mobilizuar më shumë kursimet në valutë krahasuar me ato në lekë.

Grafik 20. Ecuria e indeksit H për totalin e depozitave si sistem bankar.



Grafik 21. Ecuria e indeksit H për depozitat në lekë dhe në vallutë.





Bazuar në vlerat në vite të këtij indeksi rezulton që, tendenca e fenomenit të përqendrimit në aktivitetin depozitues është drejt reduktimit, pavarësisht nga lëvizjet me kahe të ndryshme në tregues të caktuar të depozitave, në periudhën 1992-2001.

3.2. KONKLUZIONE

Nisur nga ajo çfarë u trajtua në këtë material mbi ecurinë e aktivitetit depozitues të sistemit bankar në periudhën 1992-2001 mendojmë se:

- Praktikisht, privatizimi i bankave shtetërore (Bankës së Kursimeve) ka qenë një proces që ka ecur ngadalë duke mos ndikuar për pasojë në përmirësimin dhe në eficiencën e sistemit bankar, si ndërmjetës financiar në zhvillimin e ekonomisë e reflektuar në nivelin e ulët të kreditimit të sektorit privat të ekonomisë.
- Sistemi bankar shqiptar në përgjithësi ka shënuar përmirësime si në drejtim të rritjes së motivit të kursimit, të përmirësimit të strukturës së depozitave sipas afateve ashtu edhe të interesimit të bankave për shtimin e produkteve të reja në tregun e depozitave. Kështu, nga bankat ofrohet shërbimi bankomat dhe forma të tjera të njohura si Mastercard, Eurocard për klientë të besueshëm. Në

llogaritë e kursimeve bankat ofrojnë çertifikata depozitash, për të cilat zbatojnë një nivel të lartë interesi, depozita me sigurim jete falas, interesa jo vetëm sipas afatit, por edhe për shuma të ndryshme brenda një afati. Po kështu, ofrojnë edhe interesa të negociueshëm dhe interesa jo vetëm fiksë por edhe të indeksuar etj..

- Agresiviteti i bankave private në drejtim të rritjes së depozitave në përgjithësi është i pranishëm, si pasojë edhe në drejtim të zgjerimit të rrjetit të tyre në dy vitet e fundit, si nga pikëpamja ekstensive ashtu edhe nga ajo intensive.
- Depozitat me afat kanë patur një ndikim të konsiderueshëm në ofertën monetare, i cili ka ardhur në rritje duke ndikuar në rritjen e qëndrueshmërisë në kohë të ofertës së parasë.
- Në përgjithësi, shkalla e zëvendësimit të mjeteve monetare ka shënuar rënie, duke treguar rritjen e besimit në monedhën kombëtare si rrjedhim i stabilitetit të saj në tregun e brendshëm valutor, i nivelit të ulët të inflacionit (duke përjashtuar vitin 1997).

SHËNIME

* Suzana Sheqeri, Edlira Abazi, specialiste, Departamenti i Kërkimeve dhe Politikës Monetare.

[1] Preferenca më e lartë për depozita tremujore njihet ndryshe edhe me emrin "spekulim", në kushtet kur ato janë motivuar, kryesisht, nga interesat më atraktivë dhe avantazhi në kohë i përfitimit të këtyre interesave, kundrejt interesave më të ulët në depozita dymbëdhjetëmujore.

[2] Analiza e strukturës së depozitave është përqendruar në Bankën e Kursimeve si banka që zotëron pjesën kryesore të depozitave në lekë të sistemit bankar.

[3] Është pikërisht diferenca në përqindjen e nivelit të interesave midis depozitave në lekë dhe atyre në valutë ajo që përcakton leverdishmërinë në alternativën e zgjedhjes midis mbajtjes së depozitave në lekë apo në valutë.

[4] Në rritjen e peshës së bankave me kapital joshtetëror në këtë vit ka ndikuar privatizimi i Bankës Kombëtare Tregtare.

[5] Pa BKT.

[6] Banka e Kursimeve që nga krijimi i sistemit bankar ka ruajtur pozicionin superior në zotërimin e këtyre burimeve duke qenë banka më e preferuar për publikun në vendosjen e depozitave të kursimit të lekë. Kjo është e kuptueshme kur dihet që kjo bankë tradicionalisht është njohur nga publiku si bankë për vendosjen e kursimeve. Për më tepër si bankë me kapital shtetëror ajo është parë si bankë me besueshmëri më të lartë. Krijimi i bankave të tjera në sistem i shtoi alternativat e zgjedhjes për vendosjen e depozitave.

ÇËSHTJE TË ADMINISTRIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

*Ervin Fortuzi**

Fjalë kyçe
- Burime njerëzore - Vlerësimi i punës - Kodi i etikës - Trajnim - Motivim i punonjësve -

Administrimi i Burimeve Njerëzore (MBNJ) është drejtimi kryesor i punës - dhe arsyeja e ekzistencës - së Sektorit të Burimeve Njerëzore (SBNJ) në Departamentin Juridik dhe Burimeve Njerëzore të Bankës së Shqipërisë (DJBNJ).

Ekzistojnë shumë përkufizime mbi rolin, qëllimet dhe objektivat e MBNJ në përgjithësi, dhe shumë prej këtyre përkufizimeve natyrisht do të mund të aplikoheshin pa shumë vështirësi teorike edhe në rolin që luajnë - apo duhet të luajnë - MBNJ në Bankën e Shqipërisë. Një përkufizim i thjeshtë dhe përmbledhës mbi qëllimin kryesor të punës së MBNJ në Bankën e Shqipërisë do të ishte "të sigurojë që, nga marrëdhëniet punonjës - Banka e Shqipërisë, të dyja palët të përfitojnë maksimumin e mundshëm nga njëra -tjetra".

Një përkufizim i thjeshtë për një detyrë të vështirë, sidomos në ato raste të panumërta kur interesat e punonjësit dhe të Bankës së Shqipërisë janë të kundërt. Për shembull, kundërshtia klasike ndërmjet interesit të punëmarrësit për të punuar sa më pak dhe për t'u paguar sa më shumë dhe interesit të punëdhënësit (Bankës) që punëmarrësi të punojë sa më shumë dhe të paguhet sa më pak është vërtetuar në praktikë se nuk zgjidhet dot në mënyrë efektive, vetëm nëpërmjet përcaktimit ligjor të kohës së

punës (8 orë), monitorimit teknik të zbatimit të kohës së punës etj.. Kështu, me një urdhër administrativ mund t'i ndalosh punonjësit të dalin nga ndërtesa e Bankës së Shqipërisë gjatë 8 orëve të punës (8.00-9.00 deri 16.00-17.00), duke i privuar kështu nga kënaqësia tipike shqiptare e kalimit të kohës me biseda informale në një kafe pranë bankës, por e vetmja gjë që do të arrijmë vetëm nëpërmjet një urdhri administrativ është se punonjësi do të zëvendësonte kënaqësinë e pirjes së kafes jashtë Bankës me kënaqësinë e lojës në kompjuter në zyrë. Pra, ajo që duhet në këtë rast është një administrim më i mirë i kohës së punës të punonjësve nga administratorët, nëpërmjet përshkrimeve individuale të punës të tilla, që të kërkojnë nga punonjësi punë gjatë 8 orëve, bashkërendim të punës në grupe, në mënyrë të tillë që nga rezultatet e punës të një punonjësi të varet direkt rezultati i punës së një grupi punonjësish (kjo e vë punonjësin nën presionin e kolegëve lidhur me afatet, me cilësinë dhe me sasinë e punës) etj.; dhe lidhja e rezultateve individuale të punës me pagën, në mënyrë të tillë që ta bëjnë realisht të interesuar punonjësin të punojë 8 orë dhe jo thjesht të rrijë në mjediset e vjetruara dhe monotone të Bankës.

Natyrisht, në gjetjen e një ekuilibri ndërmjet interesit të Bankës dhe interesit të punonjësit, MBNJ synon të arrijë "një mesatare të artë" që në fakt asnjëherë nuk është perfekte.

Siç ka treguar dhe praktika e deritanishme në Bankën e Shqipërisë, përkufizimi i mësipërm i qëllimit kryesor të ekzistencës së SBNJ përcakton një detyrë që vështirë se mund të konsiderohet e arritshme vetëm nëpërmjet njohjes dhe zbatimit të mirë të shkencës ekonomike të administrimit dhe menaxhimit. Psikologjia, sidomos etnopsikologjia, është një nga fushat e shumta të dijes - dhe jo e vetmja - që një administrues i burimeve njerëzore, dhe çdo drejtues apo administrues tjetër që ka në varësi të tij punonjës, duhet të përdorë për të kryer me sukses detyrën e tij. MBNJ ka subjekt të punës së tij punonjësin dhe synohet, përherë e më tepër, që MBNJ të konsistojë në vendosjen e kontakteve personale të administruesve dhe drejtuesve me çdo punonjës. Për shembull, është shumë interesante ajo që rekomandonte një kështilltar i huaj i burimeve

njerëzore për specialistët e kësaj fushe në Bankën e Shqipërisë dhe, në përgjithësi, për drejtuesit dhe administruesit në Bankën e Shqipërisë. Këshilltari rekomandonte që, kur drejtuesi t'i drejtohej vartësit lidhur me mosplotësimin nga ana e këtij të fundit siç duhet të detyrave të ngarkuara nga eprori, drejtuesi ta fillojë bisedën me lavdërime për punonjësin për ato punë që punonjësi i ka kryer mirë, për të kaluar më pas në kritika për të metat që janë vënë re. Kritikat duhen ndërtuar në një mënyrë të tillë që punonjësi të kuptojë që mesazhi i kritikës është, në përgjithësi, që ai duhet të përmirësojë punën, dhe jo, për shkak të mungesës së taktit në bashkëbisedim, punonjësi të marrë mesazhin e gabuar se eprori po e lufton atë, është i paragjykuar kundrejt tij etj.. Kështu, mënyra e kujdesshme dhe e sjellshme e të shprehurit "po të bësh më shumë nga këto gjëra të mira puna juaj do të ishte më e vlefshme dhe më interesante për Bankën e Shqipërisë" do të kishte një efekt shumë më të mirë sesa thjesht shprehja "përmirëso punën!", për më keq e thënë me ton të lartë dhe arrogant. Psikologjia shqiptare "ëmbëlsirat lihen për në fund", të cilën eprori në Bankën e Shqipërisë do të synonte instinktivisht të aplikonte në bashkëbisedim me vartësin, rezulton pra e gabuar në fushën e MBNJ. "Ëmbëlsirat" në një bashkëbisedim me vartësin duhen thënë në fillim, në mënyrë që të krijojmë tek punonjësi disponimin e mirë, të tillë që punonjësi ta presë mirë çdo kritikë apo sugjerim që eprori ka rezervuar për të pas "ëmbëlsirës".

Natyrisht, ekzistojnë një numër i pafund shembujsh të ngjashëm sesi pak kujdes nga ana e eprorit në marrëdhëniet e tij me vartësin krijon efekte pozitive të tilla, që nuk do të mund të përftoheshin ndryshe.

Praktikat e mira të MBNJ varen, në rradhë të parë, nga njohja e mirë e shkencës së ekonomisë në përgjithësi dhe e asaj të burimeve njerëzore në veçanti. Suksesi i këtyre praktikave, nga ana tjetër, varet nga një numër relativisht i madh kriteresh, që variojnë që nga njohja teorike e burimeve njerëzore e deri tek faktorë të tillë "të hollë" kulturorë si "kultura" kolektive dhe ajo individuale, të cilët përherë e më shumë po studiohen dhe aplikohen në MBNJ në Perëndim. MBNJ përherë e më tepër po

evoluon nga një disiplinë e pastër ekonomike në një ndërthurje disiplinash të ndryshme. MBNJ po bëhet përherë e më shumë një fushë që i jep mundësi për fantazi, punë krijuese – dhe fatkeqësisht edhe për spekulim - administruesit të burimeve njerëzore. Këto mundësi të pakufishme për punë krijuese – por dhe spekulim - përbëjnë një shkak pse MBNJ është një fushë që aktualisht po përjeton një eksplodim në Perëndim.

MBNJ ka, gjithashtu, një specifikë që e dallon nga drejtime të tjera të punës në Bankën e Shqipërisë: MBNJ mund t'i realizojë objektivat e tij me sukses vetëm nëse të gjithë drejtuesit dhe administruesit e Bankës së Shqipërisë janë të mirinformuar rreth - dhe zbatojnë - praktika të mira të MBNJ. Për këtë arsye, detyra e administruesit të burimeve njerëzore në Bankën e Shqipërisë është që të bashkëpunojë përherë e më shumë me drejtues e administrues të tjerë në bankë, për të përcjellë tek ata praktika të mira të marrëdhënieve me punonjësit.

Marrëdhëniet e punonjësit të Bankës së Shqipërisë me Bankën dhe deri - diku me punonjësit e tjerë, rregullohen nëpërmjet dokumentit "Rregullat mbi marrëdhëniet e punës së personelit në Bankën e Shqipërisë" (shkurt rregullore). Kjo rregullore, bashkë me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", përbën edhe bazën kryesore ligjore ku e mbështet punën e tij DJBNJ dhe departamentet e tjera të bankës. Deri tani kjo rregullore ka funksionuar mirë. Por, disa paqartësi në këtë rregullore, që janë vënë re kohët e fundit, kanë sjellë nevojën që kjo të ndryshohet ose të ribëhet. Konkretisht, në nenin 33, pika 1 b të kësaj rregulloreje thuhet shprehimisht se "kur punonjësi i Bankës së Shqipërisë nuk ka kryer një vit pune të plotë, kohëzgjatja e pushimeve vjetore të pagueshme përcaktohet në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve juridike të punës". Përcaktimi është i turbullt dhe shërben si burim kontradiktash në vend që të shërbejë si burim i zgjidhjes së kontradiktave. Klauzola siç është shkruar është shumë më tepër në favor të punonjësit sesa precedenti. Kështu, punonjësi që nuk ka mbushur një vit punë në bankë ka mundësi të marrë leje jo më pak se 21X/12 ditë të pagueshme në vit (ku 21 ditë është numri i ditëve leje të pagueshme për punonjësin që ka mbushur një vit punë,

X është muajt në punë dhe formula vlen për X<12) dhe një shpërblim në masën e një page (shpërblim që duhet të jepet në momentin e marrjes së lejes vjetore – të plotë apo të pjesshme - të pagueshme). Sipas precedentit, leja e zakonshme akordohet e plotë vetëm pasi punonjësi ka mbushur një vit punë. Për pasojë, ai humbet ditët e lejes që i takonin në vitin kur është punësuar. Përveç kësaj, humbet dhe të drejtën e përfitimit të shpërblimit që akordohet për lejen e zakonshme. E thënë ndryshe X ditë leje në vit, në realitet zbatohet X ditë leje çdo 2 vite. Mospërputhja ndërmjet interpretimit juridik dhe precedentit mjafton që DJBNJ të ndërmarrë iniciativën e ndryshimit të rregullores. Pikërisht kjo do të duhet të bëhet në muajt e ardhshëm, në mënyrë që DJBNJ të kryejë sa më mirë detyrën e tij; harmonizimi i interesave të bankës dhe të punonjësit të bankës, bazuar në ligje e rregullore të sakta, të ndershme e të qarta.

Vlerësimi individual vjetor i punës (VP) është një ndër drejtimet më interesante dhe potencialisht më frytdhënëse të punës së SBNJ. Thelbi i VP konsiston në akordimin çdo fundviti të "një note" çdo punonjësi nga ana e eprorit direkt të tij për punën e kryer nga punonjësi gjatë vitit, bazuar në një numër kriteresh të përbashkëta për tërë punonjësit, përmbledhur këto kritere në një formular standard. Në varësi direkte të "notës", në kufij të përcaktuar qartë në udhëzimin përkatës, eprori propozon rritje të pagës së punonjësit.

Praktika e VP është një praktikë relativisht e re në Bankën e Shqipërisë. Për konceptimin dhe për zbatimin e saj është punuar mjaft nga DJBNJ, duke marrë gjatë procesit të punës dhe mendimin e departamenteve relevante në bankë dhe të punonjësve të veçantë. Megjithatë, tashmë është mbledhur eksperiencë e mjaftueshme për të gjykuar mbi të mirat, të metat dhe mangësitë e VP, në formën që kryhet ai aktualisht në Bankën e Shqipërisë. Konkretisht, bazuar në biseda informale dhe vërejtje formale (me shkrim), shumica e punonjësve e konsiderojnë subjektiv VP, më saktë procesin e vlerësimit të punës së tyre nga eprori direkt. Interesante është të vihet re se, ndërsa kritikat më të zëshme për VP i bëjnë punonjësit që kanë marrë "notë" të ulët e si rrjedhojë shtesë page relativisht jo të

lartë, edhe ata punonjës që kanë marrë "notë" të lartë e shtesë page relativisht të lartë, e konsiderojnë VP gjithsesi subjektiv e të tepërt!

Arsyet për sa më sipër janë disa. Konkretisht: kriteret e përdorura në formularin standard të VP, pavarësisht se krijon fleksibilitet më të madh në vlerësimin e punonjësve krahasuar me formularin që ekzistonte, përsëri mendoj se janë më të shumta dhe më të ndërlikuara se ç'duhet. Gjithashtu, VP është jashtë vëmendjes së punonjësit dhe eprorit të tij gjatë tërë vitit, sepse aktualisht procesi i VP kryhet në fund të vitit në vetëm pak ditë. Zgjidhja? Duhet punuar për hartimin e një formulari të VP më të thjeshtë dhe më të drejtpërdrejtë por më funksional. Numri i kritereve duhet pakësuar. Kriteret, gjithashtu, duhet të thjeshtohen, duke mënjanuar kritere të tilla akademike, por jopraktike si "aftësia për t'u përshtatur në situata të ndryshme" etj., kritere që SBNJ konsideron se me të drejtë nxisin opinionin e punonjësve rreth VP si subjektiv.

Komunikimi më i mirë ndërmjet eprorit direkt dhe vartësit është në fakt thelbi i përmirësimit të efektivitetit të VP: është mënyra më e mirë për të arritur përmirësimin e "imazhit" të VP tek punonjësit. Më konkretisht, SBNJ do të synojë që, nëpërmjet kontakteve me drejtues dhe me administrues në bankë, t'i nxisë ata të përmirësojnë komunikimin me vartësit e tyre. Formulari i VP do të plotësohet në të ardhmen nga eprori direkt në praninë e punonjësit që vlerësohet. Do të ketë bashkëbisedim për çdo kriter, sugjerime dhe propozime. Është një masë shumë e thjeshtë, por një masë tek e cila SBNJ ka varur shumë shpresa për përmirësimin e efektivitetit të VP. Gjithashtu, synohet që nga një çështje "një-ditë-në-vit" VP të jetë në vëmendjen e punonjësit gjatë tërë vitit, nëpërmjet takimeve të eprorit direkt me vartësit e tij, ku të bisedohet ecuria e punonjësit gjatë vitit, bazuar në kriteret e VP.

Centralizimi në Bankën e Shqipërisë ul efektivitetin e VP. Konkretisht, eprori direkt ka të drejtë vetëm të propozojë ndryshime në pagë për vartësit bazuar në VP. Është Guvernatori autoriteti, që ndryshon dhe miraton ndryshime në pagë.

Ndonjëherë këto shtesa në pagë, të miratuara nga Guvernatori, ndryshojnë nga shtesat e propozuara nga eprori direkt, bazuar direkt në VP. Kjo ul besimin e punonjësve tek VP. Zgjidhja? Decentralizimi i kompetencave për shtesën në pagë bazuar në VP. Këto kompetenca duhen kaluar nga Guvernatori tek eprori direkt ose mund të eksplorohet mundësia e marrjes së vendimit me konsensus midis Guvernatorit dhe eprorit direkt.

Ka shumë rekomandime për mënyrën sesi mund të përmirësohet VP, mendime ndonjëherë edhe kundërthënëse. Kështu, këshilltari britanik i Bankës së Shqipërisë, z. Iain Thomson, theksonte në një takim diskutimi mbi administrimin e burimeve njerëzore organizuar nga Banka e Shqipërisë dhe FSVC në datat 11 dhe 12 prill 2002, se meqë mendimi rreth subjektivizmit të VP është kaq i përhapur në Bankën e Shqipërisë atëherë, bazuar edhe në përvojën britanike, VP duhet të hiqet! Ndërkohë, në të njëjtën kohë, këshilltari amerikan z. David Shanon ishte i mendimit dhe rekomandonte që jo vetëm që nuk duhet të hiqet VP, por ai duhet të përsoset e të përmirësohet më tej, duke e lidhur pagën e punonjësit gjithnjë e më shumë me VP.

Shembulli i mësipërm tregon sesi, për vetë natyrën e punës, nuk ekzistojnë zgjidhje akademike standarde për shumë probleme të MBNJ. Është detyra e SBNJ të adoptojë ato zgjidhje për probleme të ndryshme, të cilat SBNJ i konsideron të arsyeshme dhe praktike.

Etika është e harruara e madhe e DJBNJ. Ky departament, sidomos SBNJ, e kanë konsideruar etikën – kriteret etike që duhet të përmbushë punonjësi i Bankës së Shqipërisë - deri tani si një kategori më tepër juridike sesa objekt pune i MBNJ që kërkon angazhime njerëzore, jo vetëm juridike, nga ana e specialistëve administrues të SBNJ. Rregullorja në fjalë, përshkruan më shumë detyrime dhe ndalime për punonjësin sesa të drejta. Kjo bën, për shembull, që konfliktet për arsye të ndryshme të punonjësve të Bankës së Shqipërisë, të trajtohen si çështje që kërkojnë një impenjim juridik; hartimin, nga ana e SBNJ, të materialit të hollësishëm rreth konfliktit dhe përcjelljen e këtij materiali eprorëve për të përcaktuar masën ndëshkuese, shkurt,

një mënyrë zgjidhjeje konflikti që nuk e zgjidh konfliktin. Në këtë mënyrë zgjidhja e rasteve të tilla krijon burokraci të tepërt, humbje kohe dhe ulje efektiviteti në punë për tërë punonjësit e përfshirë.

Në të ardhmen, do të punohet në drejtim të 1) hartimit të rregullave të Kodit të Etikës, që të jetë më i qartë, më i drejtpërdrejtë; 2) njohjes sa më të mirë të punonjësve me Kodin e Etikës, nëpërmjet seminareve apo bashkëbisedimeve; 3) studimi i arsyeve që çojnë në konflikt dhe të mënyrave të mënjanimit të tyre (paraprakisht, mendohet se një koordinim më i mirë i punës ndërmjet departamenteve të ndryshme do të kontribuonte mjaft në shmangien e paqartësive rreth kompetencave dhe detyrave të çdo departamenti, paqartësi që shpesh çojnë në konflikte); 4) zbatimit të metodave të reja për zgjidhjen e konflikteve, duke preferuar kontaktet njerëzore individuale ndërmjet palëve dhe zgjidhjen e konflikteve ndërmjet tyre me ndërmjetësinë e administruesve të SBNJ, duke iu kthyer ndëshkimeve administrative të parashikuara në rregullore, vetëm në raste ekstreme.

Në hartimin e Kodit të ri të Etikës mund dhe duhet të mbahen parasysh problemet reale etike që has Banka e Shqipërisë në punën e saj. Është shumë e thjeshtë të merret një kod etike perëndimor, të përkthehet ai dhe të përshtatet për Bankën e Shqipërisë, por një kod i tillë do të ishte jorealist dhe si rrjedhojë jofunksional. Kështu, në kushtet e një ekonomie si ajo shqiptare, të bazuar në *cash* dhe jo në transaksione bankare, është një formalitet dhe burokraci e tepërt deklarimi i pasurisë[1] nga ana e punonjësve të Bankës së Shqipërisë dhe depozitimi më pas i formularëve përkatës pranë SBNJ – vërtetësia e këtyre deklarimeve, për shumë arsye, është e vështirë të verifikohet. Për këtë dhe të tjera arsye, Kodi i ri i Etikës, në vend që të tentojë "të ruajë" në këto drejtime integritetin e institucionit nëpërmjet praktikave burokratike jofunksionale si deklarimi i pasurisë, duhet të përpiqet të gjejë mënyrat sesi të dekurajohen punonjësit të bërtasin në korridore etj.. probleme etike këto që nuk ekzistojnë për shembull, në Bundesbank apo në Bankën e Anglisë.

Trajnimi, në mënyrën dhe me procedurat që ndiqen aktualisht në Bankën e Shqipërisë, nuk përmbush funksionet që duhet të kryejë trajnimi në një bankë qendrore. SBNJ është kthyer në një sektor që vetëm administron biletat e udhëtimit dhe procedura të tjera të ngjashme lidhur me trajnimet brenda e jashtë vendit. Nuk ekzistojnë kritere të sakta, të qarta dhe praktike në bazë të të cilave SBNJ të aplikojë një filtër – dhe jo vetëm kaq – për kërkesat e punonjësve dhe të departamenteve për trajnime. Nuk ekzistojnë procedura të sakta dhe të qarta për të matur efektivitetin e trajnimit. Është e vështirë për dikë të kundërshtojë me argumente opinionin e përhapur ndër punonjësit e bankës se trajnimet jashtë, sidomos trajnimet afatshkurtra nga një ditë deri dy javë, janë thjesht udhëtime turistike – në të shumtën e rasteve ato (trajnimet afatshkurtra jashtë) konsiderohen të tilla nga punonjësit.

Jo vetëm trajnimet afatshkurtra, por edhe ato afatgjata kryhen në mungesë të kritereve të matjes së efektivitetit të trajnimit. Për shembull, është e pamundur aktualisht për SBNJ që, bazuar në një logjikë elementare, të ndalojë një punonjës që, me lejen dhe rekomandimin e eprorit të tij, të kryejë një master të dytë apo të tretë, në kushtet kur vetë eprori i këtij punonjësi nuk zotëron asnjë diplomë master! Pyetjet e rëndësishme "kush shkon në trajnim", "pse shkon" etj., janë pyetje të cilat aktualisht marrin përgjigje formale, ndërkohë që këto dhe të tjera pyetje si këto duhet të ngrihen në nivele të kritereve të sakta, të qarta dhe të ndershme, në kuadër të një strategjie trajnimi.

SBNJ ka hartuar propozimet fillestare për ndërtimin e një strategjie trajnimi, të cilat u janë shpërndarë departamenteve relevante për mendim. Në të ardhmen mendohet që në bazë të këtyre propozimeve fillestare të hartohet një strategji, e thjeshtë dhe efektive, e mbështetur nga një software, e cila do të riparojë pjesën kryesore të mangësive që vihen re aktualisht.

Strategjia e trajnimit do të zgjidhë pjesën kryesore të problemeve që lidhen me trajnimin, por jo të gjitha. Një pjesë e madhe e efektivitetit të trajnimeve do të vazhdojë të varet nga komunikimi epror – punonjës. Pyetja, në dukje e thjeshtë,

që eprori do të duhet t'i drejtojë vartësit pas kthimit të këtij të fundit nga trajnimi "çfarë, konkretisht, sado gjë e vogël qoftë, mendon të ndryshosh apo përmirësosh ti vetë, personalisht, në punën tënde në Bankën e Shqipërisë bazuar në eksperiencën që more në trajnim?" do të ketë shumë më tepër vlerë se çdo lloj strategjie për trajnimin, sado e sofistikuar dhe akademike qoftë kjo strategji. Natyrisht, në të ardhmen do të duhet që SBNJ të nxisë drejtuesit dhe administruesit në bankë, që t'i japin më tepër rëndësi komunikimit të tillë të mësipërm me qëllim të përfitimit sa më shumë nga trajnimet e punonjësve të Bankës së Shqipërisë, sidomos nga trajnimet pranë institucioneve homologe në Perëndim.

Natyrisht, DJBNJ dhe SBNJ, ashtu si sektorë dhe departamente të tjera në bankë, funksionojnë në bazë të një strategjie përkatëse afatgjatë. Këto strategji shërbejnë, të paktën teorikisht, si një guidë për punën e sektorit dhe të departamentit gjatë një periudhe kohe afatgjatë. Por, mungon koordinimi i strategjive për departamente të ndryshme. Ky është një problem shumë i madh i cili, aktualisht, është thjesht në fazën e konstatimit. Do të duhet të bëhet një punë shumë e madhe, me më shumë input nga vetë Administratorët e Bankës së Shqipërisë, për riparimin e këtij problemi. Arsye kryesore për këtë nevojë të koordinimit të strategjive të departamenteve të ndryshme të bankës është se strategjitë janë në vetvete fryt i një pune shumë të madhe krijuese, dhe përbën ulje të madhe të efektivitetit të punës në bankë fakti që, për shkak të moskordinimit mes tyre, një pjesë e mirë e strategjive të mos zbatohen në praktikë. Zgjidhja? Shumë e thjeshtë – kontakte të shpeshta dhe komunikim i drejtpërdrejtë, takime në grup, ndërmjet drejtuesve apo punonjësve që merren me konceptimin e strategjive në çdo sektor dhe departament.

Çdo institucion funksionon në bazë të disa standardeve të caktuara. Në Bankën e Shqipërisë, në DJBNJ, në SBNJ, ashtu si në departamente e sektorë të tjerë të bankës, vihet re mungesa e standardeve dhe e procedurave të sakta. Si rrjedhojë, shumë punonjës humbasin një pjesë të madhe të kohës duke improvizuar standarde, që gjithsesi janë të përkohshme dhe nuk zbatohen nga punonjës të tjerë. Banka e Shqipërisë duhet të

njohë realitetin e pakëndshëm që ajo (Banka) është akoma në fazat e *institution-building* (ndërtimi i institucionit) dhe duhet të marrë iniciativën për ndreqjen e këtij problemi. Për shembull, standardizimi i shkresave në bankë ishte një hap po aq i madh dhe i rëndësishëm sa ç'ngjan i vogël dhe i parëndësishëm – u mënjanua një kaos në konceptimin e shkresave, që ulte efektivitetin në punë. Por, ky është vetëm një hap i parë, që duhet të ndiqet nga të tjerë shumë më të rëndësishëm. Duhet të arrihet deri aty sa kërkesat për leje të zakonshme etj., që aktualisht konsumojnë një kohë të panevojshme nga punonjësit për konceptimin e tyre dhe nga SBNJ për procesimin e tyre (sepse çdo kërkesë për shembull, drejtuar nga punonjësit DJBNJ apo të departamenteve të tjera, është "hartim" më vete, shkruar në një formë, stil dhe madje dialekte të pangjashme me njëri-tjetrin) të standardizohen. Kjo do të lironte punonjësit e bankës nga një punë e tepërt dhe e panevojshme, duke u lënë atyre më tepër kohë për punë krijuese. Punonjësit e Bankës së Shqipërisë nuk duhet të vazhdojnë të humbasin një pjesë të madhe të kohës së tyre duke improvizuar standarde për punën e tyre të përditshme në bankë. Kjo është një arsye – jo e vetmja - për nevojën për standardizimin dhe informatizimin e mëtejshëm të punës në bankë. Më shumë ligje, standarde dhe rregullore, sidomos ligje dhe rregullore të sakta, të qarta, të thjeshta dhe praktike, nuk do të thotë më shumë burokraci! Përkundrazi! Është përpjekja e vazhdueshme e punonjësve të bankës për improvizimin e standardeve, punë kjo krijuese, por e tepërt dhe pa rezultat afatgjatë, që komprometon vetë idenë e punës krijuese dhe krijon më shumë burokraci dhe *paperwork*.

Zgjidhja për sa më sipër është ngritja e një grupi pune që do të merret me problemet e standardizimit dhe të informatizimit të bankës. Ky grup pune do të duhej të kryente vetë një pjesë të madhe të punës, sidomos atë për konceptimin e punës, duke deleguar zbatimin e pjesëve të veçanta të projektit në departamente/sektorë të veçantë.

Një mënyrë tjetër zgjidhjeje për problemin e mësipërm do të ishte realizimi i një ideje që ka kohë që qarkullon në bankë: Banka e Shqipërisë të vendosë marrëdhënie të privilegjuara me

një bankë të madhe perëndimore (për shembull Bundesbank, si kampione e organizimit perfekt dhe e standardizimit dhe themeli i Bankës Qendrore Evropiane (BQE), në të cilën Banka e Shqipërisë synon të aderojë), e cila të marrë përsipër riorganizimin e Bankës së Shqipërisë sipas imazhit të vet, duke respektuar kushtet specifike të Shqipërisë. (Nëse është fjala për "përafrime", "binjakëzime" apo "patronazh" të për shembull Bundesbank, kjo nuk varet nga vullneti i mirë i Bankës së Shqipërisë e as nga impenjimi maksimal në këtë drejtim, sepse është kusht që duhet të "burojë" nga një marrëveshje mes Qeverive nëpërmjet BE, prandaj mund të shprehet ideja në një formë tjetër).

Siç vë re me të drejtë specialisti britanik në fushën e MBNJ z. Iain Thompson në seminarin që ai zhvilloi për drejtuesit dhe për administruesit në Bankën e Shqipërisë "në të kaluarën shumë organizata kanë qenë të prirura të jenë më shumë hierarkike, duke adoptuar një qëndrim tërësisht komandues dhe kontrollues. Sot organizmat janë më të thjeshtë dhe i japin më shumë pushtet punonjësve të tyre. Banka qendrore nuk është firmë, e ndërtuar në bazë të fitimit dhe ajo ndryshon këtu nga bankat e nivelit të dytë. Bankat qendrore ushtrojnë një numër më të madh veprimtarish të tipit kërkimor, në krahasim me veprimtaritë që ushtron normalisht sektori privat. Por, bankat qendrore kanë mbetur përgjithësisht më të hierarkizuara se ato tregtare dhe të rënduara me çështje dhe me rregulla administrativë". Kjo gjë përmban rrezikun, që është në fakt evident në Bankën e Shqipërisë, që administruesit e burimeve njerëzore - dhe jo vetëm - të merren më shumë dhe të jenë më të interesuar për zbatimin e procedurave dhe të rregulloreve sesa për të vepruar, për t'u marrë me personelin dhe me marrëdhëniet njerëzore në bankë.

Motivimi i punonjësve përbën një element kryesor të MBNJ dhe rrjedhimisht përbën - apo më saktë duhet të përbëjë - një drejtim kryesor të punës së SBNJ. Dihet tashmë se arsyeja kryesore - por jo e vetme (dhe në disa raste të pakta, por interesante, paga është arsye dytësore) - përse njerëzit punojnë është paga. Duke qenë se kufizimet buxhetore të çdo institucioni, rrjedhimisht

edhe të Bankës së Shqipërisë, përcaktojnë kufij të sipërm deri ku paga dhe shpërblimet mund të përdoren si motivim monetar për punonjësit, motivimi jomonetar merr një rëndësi të madhe. Duhet theksuar se motivimi jomonetar është një ndër drejtimet e punës të një administruesi të burimeve njerëzore, suksesi i të cilës varet jo aq nga ajo që administruesi ka studiuar në shkollë rreth MBNJ, por më shumë nga aftësia e administruesit të burimeve njerëzore në njohjen e punonjësve, të nevojave dhe të dëshirave të tyre, dhe nga fantazia e tij në konceptimin dhe pjesërisht zbatimin e programeve të ndryshme për motivimin jomonetar të punonjësve. Teorikisht, këto programe mund të jenë të shkëputura apo pjesë e një plani/strategjie afatgjatë veprimtarish, të hartuar dhe të miratuar më parë deri në detaje.

Hartimi paraprak i një plani afatgjatë për këto veprimtari, plan i cili përsëritet periodikisht çdo vit në afate kohore të caktuara, preferohet kundrejt programeve të veçanta dhe të shkëputura, të konceptuara ndryshe çdo vit, për arsye të planifikimit paraprak individual të kohës për çdo punonjës, për arsye se lehtëson punën e DJBNJ për administrimin e aktiviteteve etj.. Konkretisht, në Bankën e Shqipërisë ekzistojnë praktika të suksesshme të zhvillimit të disa veprimtarive kulturore – sportive (për shembull ndeshje futbolli), festimi i përbashkët i disa festave (si festa e Vitit të Ri), udhëtime turistike brenda apo jashtë vendit etj., por është detyrë e rëndësishme për të ardhmen që këto veprimtari të përfshihen në një plan afatgjatë, i cili të përsëritet në mënyrë periodike çdo vit, dhe jo të improvizohen aktivitete të ngjashme vit pas viti.

Banka e Shqipërisë - ndërtesa e saj në adresën e lakmuar "Sheshi Skënderbej nr. 1" - sa ç'është e bukur jashtë, aq është e pabanueshme brenda. Jo vetëm arkitektura e saj është mbi 60-vjeçare, por edhe kushtet e punës në të fatkeqësisht janë të përafërta me kushtet e punës para 60 vjetëve. Siç vënë re shpesh vizitorë të huaj në bankë, ajo (Banka) i përngjan për nga kushtet e punës një banke në far west-in amerikan para një shekulli.

Kushtet fizike të punës përbëjnë një mjet motivimi - apo demotivimi - të fuqishëm. Fatkeqësisht, kushtet fizike të punës në

Bankën e Shqipërisë aktualisht demotivojnë punonjësit - kjo për shkak të 1) konceptimit të ndërtesës nga arkitekti si një ndërtesë e ndërtuar jo rreth individit dhe kërkesave të tij (kriteri kryesor në arkitekturën moderne) por glorifikimit të një ideologjie të caktuar të kohës që, pavarësisht cila ishte, ishte një ideologji që ngrinte në kult kolektivin, duke injoruar kërkesat e individit; dhe 2) për shkak të gjendjes së amortizuar të ndërtesës. Kështu, ndërtesa aktuale e bankës ka holle të gjera - por dhoma pune të vogla, fasada të jashtme të bukura dhe impresionuese - por korridore të brendshme të errëta etj., të gjitha këto kontradikta, që rrjedhin nga konceptimi i ndërtesës prej arkitektit si një "glorifikuese e bashkësisë dhe robëruese e individit".

Difektet e mësipërme dhe mangësi të tjera si ajri i kondicionuar[2], pajisje zyrash joergonomike, ashensorë etj., shpresohet të rregullohen pjesërisht shumë shpejt pas rikonstruksionit të plotë të ndërtesës.

Roli i DJBNJ, në sa më sipër, ka konsistuar kryesisht në dhënien e mendimeve rreth konceptimit të zyrave dhe të mjediseve të tjera të bankës pas rikonstruksionit, sugjerimet për nevojën e ngritjes së një restoranti (me, ndër të tjera, çmime më të ulëta se tregu) mjedise të tjera çlodhëse etj. duke synuar që zyrat e reja dhe mjediset e reja të bankës të jenë sa më praktike dhe të këndshme për të punuar. Kjo është bërë edhe pas konsultimeve me punonjës të Bankës së Shqipërisë.

Aktualisht, kontributi i DJBNJ, Sektorit Juridik, është vendimtar në administrimin e procedurave që do të bëjnë të mundur të kryhet rikonstruksioni i plotë i bankës. Kontributi i SBNJ së fundi është reduktuar në rolin e palakmueshëm, por jo të tepërt të "sensibilizimit" të herëpashershëm (për mungesë të një termi më të saktë) të departamenteve relevante dhe të Administratorëve të Bankës së Shqipërisë për rëndësinë shumë të madhe të përmirësimit radikal të kushteve të punës në Bankën e Shqipërisë.

Është fakt që, pas ndërhyrjes energjike dhe të drejtpërdrejtë të Guvernatorit z. Cani, problemi i rikonstruksionit të plotë fizik të bankës është vënë në rrugën e realizimit.

Bashkëpunimi me intelektualët shqiptarë, që aktualisht janë në emigracion, përbën një iniciativë të re dhe interesante të SBNJ. Projekti konsiston në identifikimin e specialistëve shqiptarë në fusha relevante, të cilët aktualisht ndodhen në emigracion, krijimin e një *database* me të dhënat e mbledhura dhe më pas përdorimi i këtij *database* nga departamentet dhe punonjësit e interesuar në bankë. Është përfunduar konceptimi i punës dhe gjithashtu janë gjetur mënyrat sesi kjo ide mund të realizohet në praktikë, duke synuar që bankës dhe punonjësve të saj t'u shtojmë një mundësi më shumë dhe jo një burokraci më shumë.

David Shanon, ish-Drejtor i Burimeve Njerëzore në Fed, i cili gjatë muajit maj 2002 ndodhej në Tiranë për të ofruar ndihmën e tij për DJBNJ dhe jo vetëm, kur pyetej nga specialistët e DJBNJ të Bankës së Shqipërisë rreth procedurave konkrete të përpunimit të informacionit aq të shumtë në Fed, vazhdimisht theksonte: "again, we have software for that" (e përsëris, ne përdorim software...). Asnjë departament i bankës, asnjë sektor dhe asnjë punonjës i vetëm nuk mund ta kryejë siç duhet punën, dhe të arrijë efektivitetin maksimal, pa ndihmën e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit. Kjo ndihmë deri tani ka qenë e madhe, por rritja e sasisë së informacionit që duhet përpunuar nga DJBNJ bën të nevojshme një ndihmë më të madhe në zgjidhjen e këtij problemi, nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit për DJBNJ. Rritje e ndihmës së ofruar nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit nuk do të thotë thjesht rritje e numrit apo e cilësisë së kompjuterave në dispozicion të punonjësve të bankës; kompjuterët aktualisht përdoren në bankë më tepër si makina shkrimi. Natyrshëm, duhet ndihmuar më parë vetë Departamenti i Teknologjisë së Informacionit nga banka, dhe posaçërisht nga DJBNJ, në mënyrë që ky departament më pas, të ketë mundësi të ndihmojë departamentet e tjera të bankës, përfshirë DJBNJ. Kështu, punësimi i punonjësve të rinj, programistë – por jo vetëm - (proces në të cilin DJBNJ ka rolin e tij përcaktues) do të ndihmonte Departamentin e Teknologjisë së Informacionit në kryerjen e funksionit të tij.

Si përfundim, mendoj se potenciali shumë i madh akademik i punonjësve të Bankës së Shqipërisë mund të shfrytëzohet në

një masë shumë më të madhe - preokupim kryesor ky i SBNJ - në qoftë se banka - a) përmirëson kushtet fizike të punës dhe; b) merr masa për informatizimin e plotë, administrimin më të mirë dhe standardizimin e pjesës më të madhe të punës në bankë, punë që aktualisht kërkon shumë improvizim, duke shpërdoruar shumë kohë dhe përpjekje dhe duke dekurajuar kështu punonjësit të merren me punë krijuese.

SHËNIME

* Ervin Fortuzi, specialist, Departamenti Juridik dhe i Burimeve Njerëzore.

[1] Konflikti i interesave jashtëbankarë me punën që punonjësi kryen në Bankën e Shqipërisë është vetëm një nga arsyet pse, teorikisht, është parë i arsyeshëm deklarimi i pasurisë nga ana e punonjësve.

[2] Bëhet fjalë për kondicionimin qendror të ndërtesës, si zgjidhje afatgjatë, dhe jo për zgjidhje afatshkurtra, të shtrenjta dhe joestetike si vendosja e kondicionerëve individualë në çdo zyrë.

PROGRAMI I KOMPENSIMEVE I NJË BANKE QENDRORE

*Zhizela Balla**

Fjalë kyçe
- Programi i kompensimeve - Manual i vendit të punës - Struktura e pagave - Promocioni - Vlerësim i punës - Kompensim -

1. PROGRAMI IDEAL I KOMPENSIMEVE DHE PËRBËRËSIT E TIJ

Programi ideal i kompensimeve përbëhet nga disa komponentë, të cilët janë të lidhur në mënyrë të ngushtë e të njëpasnjëshme me njëri-tjetrin. Për të siguruar mbarëvajtjen e këtij programi është e nevojshme, që të gjithë komponentët të funksionojnë siç duhet dhe të japin inputin e nevojshëm për komponentin pasardhës. Kështu, për të krijuar imazhin e plotë të programit ideal të kompensimeve po analizojmë së pari komponentët e tij.

1.1 MANUALET E VENDEVE TË PUNËS

Këto manuale janë një përmbledhje informacioni për çdo pozicion specifik pune. Ky informacion përmban llojin dhe nivelin e përgjegjësisë, nivelin e njohurive dhe të aftësive të nevojshme, linjat e raportimit, hapësirën e veprimit, detyrat kryesore etj., për pozicionin specifik, që përshkruhet në manual. E rëndësishme është, që këto manuale të jenë të sakta, bashkëkohore, pra të reflektojnë punën, që bëhet në të tashmen e jo në të shkuarën

ose të ardhmen, dhe jo të detajuara. Kështu duhet, që ato të rishikohen periodikisht nga çdo njësi organizative, si rregull çdo vit ose dhe më shpesh kur është e nevojshme. Për çdo vend të ri pune duhet të përgatitet një manual i ri po nga njësitë organizative e më pas ky të miratohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore. Manuale të reja nevojiten edhe për vendet e punës, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilave ndryshojnë në mënyrë të ndjeshme.

Manualet e vendeve të punës nuk duhet të ngatërrohen me rregulloret ose me procedurat e punës. Rregulloret përshkruajnë rregullat, që çdo punonjës duhet të zbatojë gjatë marrëdhënieve të punës me bankën si dhe natyrën e shërbimit të njësisë organizative, të cilës i përkasin. Kurse, procedurat e punës përshkruajnë hapat dhe fazat e nevojshme për kryerjen e punës. Pra, është e qartë, se manualet e vendeve të punës janë krejtësisht të ndryshme nga rregulloret dhe procedurat e punës, pasi ato përshkruajnë detyrat dhe përgjegjësitë e një vendi të caktuar pune dhe jo të një grupi vendesh pune, të përfshira në një njësi organizative. Gjithashtu, ato nuk paraqesin fazat e nevojshme për kryerjen e punës.

Për të qartësuar më tej konceptin e manualeve të vendeve të punës po paraqesim përmbajtjen e një manuali tipik për një vend pune:

Titulli i vendit të punës – përshkruan qartë dhe shkurt natyrën dhe nivelin e punës, pra identifikon vendin e punës.

Niveli në strukturën ekzistuese të pagave – paraqet klasën ose intervalin e pagës, në të cilën është përfshirë vendi i punës aktualisht.

Sektori – pjesë e të cilit është vendi i punës.

Niveli raportues – paraqet nivelin administrues në strukturën organizative, tek i cili raporton personi i emëruar në këtë vend pune.

Përmbledhje – jep qëllimin e ekzistencës së vendit të punës në mënyrë të qartë e përmbledhur.

Detyrat dhe qëllimet kryesore – përshkruhen vetëm ato detyra, të cilat zënë të paktën 5 për qind të kohës së punës për vendin, që përshkruhet. Këto detyra renditen sipas prioritetit, kohës ose rradhës së kryerjes. Në përgjithësi, mund të përfshihen katër deri dhjetë përgjegjësi të vendit të punës në këtë paragraf.

Niveli i faktorëve të nevojshëm për vlerësimin e vendit të punës – Këta faktorë janë të ndryshëm për vende pune mbikëqyrëse ose jombikëqyrëse dhe përdoren për të vlerësuar relativisht vendin e punës, përpara se të klasifikohet në strukturën e pagave. Disa nga faktorët, që duhet të përfshihen në këtë paragraf janë:

- Minimumi i kërkesave për njohuri dhe aftësi për vendin e punës, që përshkruhet. Këto kërkesa duhet të justifikohen nga detyrat e vendit të punës.

- Për vendet jombikëqyrëse të punës duhet të përfshihen edhe:

  - mbikëqyrja e vendosur – niveli i kontrollit direkt dhe indirekt, që ushtron eprori direkt; përgjegjësia që mban punonjësi dhe niveli i rishikimit të punës së bërë;
  - udhëheqja dhe gjykimi i nevojshëm nga eprori;
  - kompleksiteti i punës – reflekton vështirësinë dhe origjinalitetin në procesin e kryerjes së punës;
  - efekti, që kanë detyrat e vendit të punës brenda njësisë organizative, brenda bankës si dhe jashtë saj;
  - niveli dhe qëllimi i kontakteve personale brenda dhe jashtë bankës;
  - kërkesat fizike dhe ambienti i punës, duke dhënë rreziqet dhe vështirësitë e ndryshme, që mund të ekzistojnë.

- Për vendet mbikëqyrëse të punës duhet të përfshihen edhe:

  - rëndësia e sektorit, e departamentit, e zyrës, e programit

ose e funksioneve, që mbikëqyr;
- niveli i autoritetit, që i është dhënë;
- niveli dhe qëllimi i kontakteve personale brenda dhe jashtë bankës;
- niveli i mbikëqyrjes, që ushtron, pra numri i vartësve.

1.2 VLERËSIMI I VENDEVE TË PUNËS

Ky vlerësim konsiston në përcaktimin e një vlere relative institucionale për çdo vend pune në mënyrë sistematike dhe fokusohet në karakteristikat dhe përmbajtjen e punës, jo në individin, që e kryen atë.

Fazat e vlerësimit të vendeve të punës janë:

- *Formulimi i manualeve të sakta dhe bashkëkohore të punës,* që është dhe faza më e rëndësishme pasi në bazë të informacionit të dhënë në këto manuale bëhet edhe analiza e vlerësimi i vendeve të punës.
- *Analiza e pozicioneve të punës*, që konsiston në analizën e informacionit të manualeve të punës në bazë të faktorëve të vlerësimit të vendeve të punës, të cilët duhet të jenë të ndryshëm për pozicione mbikëqyrëse e jombikëqyrëse.

Kështu faktorët, që mund të përdoren për të analizuar vendet e punës të nivelit jombikëqyrës, janë:

- njohuria e nevojshme për të kryer detyrat e këtyre vendeve të punës;
- mbikëqyrja e lejuar mbi këto vende pune;
- udhëheqja e nevojshme;
- kompleksiteti i detyrave të ngarkuara;
- efekti i detyrave dhe i përgjegjësive të vendit të punës mbi performancën e institucionit;
- niveli i kontakteve personale dhe qëllimi i tyre;
- kërkesat fizike;
- vështirësia e vendit të punës.

Faktorët, që mund të përdoren për të analizuar vendet e punës të nivelit mbikëqyrës, janë:

- impakti në njësinë organizative, ku përfshihen këto vende pune;
- niveli i raportimit ose pozicioni i vendit të punës në strukturën organizative të institucionit;
- autoriteti, që i është dhënë vendit të punës;
- kontaktet personale dhe qëllimi i tyre;
- kompleksiteti i mbikëqyrjes, që i është akorduar vendit të punës;
- niveli i vendeve të punës, që mbikëqyr pozicioni në fjalë;
- numri i vartësve, që mbikëqyren nga ky pozicion.

- *Vlerësimi relativ i vendeve të punës*, që është faza, ku për çdo faktor të vlerësimit, vendit të punës që është analizuar, i jepet një numër i caktuar pikësh dhe në bazë të pikëve totale, që ai grumbullon, klasifikohet në një interval page të caktuar në strukturën e pagave.

1.3 ANALIZA E TREGUT

Analiza e tregut konsiston në përcaktimin e vlerës së vendeve të punës në treg dhe në gjetjen e intervaleve konkurruese të pagave për institucionin tonë në këtë treg. Kjo analizë tregu duhet bërë periodikisht, për shembull, çdo vit, pasi është burimi kryesor i informacionit mbi pagat, që ofrojnë kompanitë e tjera për vende të ngjashme pune në industrinë, ku bën pjesë institucioni ynë, sistemin bankar, dhe në industri të tjera për vende pune, që ekzistojnë edhe në Bankën e Shqipërisë.

Manualet e punës janë baza për të përcaktuar ngjashmërinë e vendeve të punës, pagat e të cilave krahasohen. Për këto vende pune grumbullohen të dhëna mbi intervalet e pagave, që ofrojnë kompanitë e tjera. Më pas këto të dhëna analizohen e krahasohen me pagat, që institucioni ynë ofron për këto vende pune. Duke analizuar nivelin e pagave ekzistuese në institucionin

tonë, përcaktohet edhe aftësia e tyre konkurruese në treg dhe bëhet rishikimi i tyre, nëse është e nevojshme.

1.4 STRUKTURA E PAGAVE

Kjo strukturë duhet të jetë baza e një kompensimi të drejtë, të paanshëm e konkurrues për punonjësit e institucionit. Ajo është një kombinim i hierarkisë së brendshme, që rezulton nga vlerësimi relativ i vendeve të punës, dhe kushteve të jashtme të tregut, që analizohen gjatë vëzhgimit të tregut të punës. Më poshtë paraqitet grafikisht një strukturë ideale pagash.



Kjo strukturë pagash përbëhet nga një grup intervalesh, që mund të ndërpriten me njëri-tjetrin. Për të kuptuar më qartë ndarjen e pagave në intervale duhet të sqarojmë më parë nocionin e "compa-ratio", i cili është një koeficient krahasimi, i llogaritur me formulën e mëposhtme:

$$\text{Compa-ratio} = \frac{\text{Paga aktuale}}{\text{Paga mesatare e intervalit}} * 100\%$$

Ky koeficient shërben për të përcaktuar pozicionin e pagës së një punonjësi apo të një grupi punonjësish në lidhje me pagën mesatare të tregut për vende të njëjta pune.

Kështu, çdo interval page në strukturën e pagave përbëhet nga 3 pika kryesore, minimumi, mesatarja dhe maksimumi.

Minimumi është paga e një punonjësi me një vlerësim performancë të kënaqshëm.

Mesatarja është paga e një punonjësi të kualifikuar plotësisht për vendin e tij/saj të punës dhe me një performancë të kënaqshme për një kohë relativisht të gjatë. Kjo pagë korrespondon me pagën mesatare të tregut për atë vend pune.

Maksimumi është paga më e lartë për vendet e punës, që përfshihen në intervalin e dhënë.

Por, çdo interval është i përbërë edhe nga disa nënndarje të tjera përveç minimumit, mesatares dhe maksimumit. Këto nënndarje kanë një koeficient krahasues (compa-ratio) të veçantë dhe bazohen në vlerësimin e performancës. Kalimi i një punonjësi në një nënndarje më të lartë të intervalit, ku përfshihet paga e tij aktuale, bëhet në bazë të vlerësimit të performancës së tij/saj, kështu që rritja e pagës së punonjësve brenda një intervali është e ndryshme.

Paga e një punonjësi të ri caktohet, përgjithësisht, në nënndarjen më të ulët të një intervali, por duke marrë parasysh kualifikimin dhe eksperiencën e punonjësit kjo pagë mund të caktohet edhe në nënndarje më të larta.

Rritja e pagës së punonjësve bëhet vetëm në bazë të vlerësimit të performancës së tij. Kështu, çdo punonjës merr një rritje të pagës në përqindje në fund të vitit pas vlerësimit të performancës së tij. Kjo përqindje është në varësi të plotë nga vlerësimi i performancës, por në mënyrë indirekte merr parasysh edhe vjetërsinë e punonjësit në punë, pasi rritjet e grumbulluara në përqindje të pagës bazë, në bazë të vlerësimit të performancës reflektojnë edhe këtë vjetërsi dhe s'mund të tejkalojnë kufirin maksimal të intervalit, ku përfshihet paga e punonjësit. Përpara se të akordohen këto rritje në përqindje të pagës bazë, përcaktohet buxheti i disponueshëm për këto rritje.

Faktorët, që kushtëzojnë këtë buxhet janë:

- pozicioni konkurrues i punonjësve të institucionit në tregun e punës;
- buxheti i kompanive konkurruese për rritje vjetore në përqindje të pagave;
- kushtet e përgjithshme ekonomike;
- oferta dhe kërkesa për punonjës me aftësi dhe eksperiencë të njëjtë;
- kushtëzimet financiare dhe buxhetore të institucionit.

Pas miratimit të buxhetit total për rritjet në përqindje të pagave në bazë të vlerësimit të performancës, çdo njësie organizative i vihet në dispozicion një buxhet specifik, i shprehur në përqindje të fondit total të pagave për punonjësit e saj. Punonjësit mund të kalojnë në një interval page të një niveli tjetër, si rezultat i tre proceseve të mëposhtme:

1.5 NGRITJA NË SHKALLËT E KARRIERËS

Kjo ngritje konsiston në kalimin e punonjësit në një shkallë karriere me më shumë përgjegjësi e si rezultat me pagë më të lartë, dhe është e pranueshme vetëm nëse punonjësi ka një nivel performance të shkëlqyer në shkallën, ku ka qenë më parë. Kjo ngritje bëhet në bazë të konkurrimit të hapur, që mund të jetë intervistim ose analizë e të gjitha vlerësimeve të performancës së punonjësve, që paraqesin kandidaturat e tyre për ngritje në shkallë më të larta të karrierës.

1.6 PROMOCIONI

Promocioni nënkupton kalimin e punonjësit në një shkallë më të lartë karriere, kur ekziston një vend vakant. Ky vend vakant ka detyra dhe përgjegjësi më të larta se vendi aktual i punës së punonjësit. Edhe ky kalim bëhet në bazë të konkurrimit mes kandidatëve duke marrë parasysh kualifikimin e tyre, eksperiencën dhe performancën e tyre.

1.7 RIKLASIFIKIMI

Riklasifikimi përfaqëson klasifikimin e një vendi specifik pune në një shkallë të re karriere, si rezultat i ndryshimit të detyrave dhe të përgjegjësive të vendit të punës. Ky riklasifikim mund të rezultojë në ngritjen, uljen ose në mosndryshimin e shkallës së karrierës për vendin e punës, karakteristikat e të cilit ndryshojnë.

1.8 PROGRAMI I SHPËRBLIMEVE PËR PERFORMANCË TË SHKËLQYER

Ky program duhet të shërbejë si plotësues për rritjet në përqindje të pagave, si rezultat i vlerësimit vjetor të performancës së punonjësve. Shpërblimet e përfshira në këtë program, jepen për performancë shumë më të lartë dhe për detyra të realizuara, që janë përtej hapësirës së vendit të punës të punonjësit. Dy nga format e dhënies së këtyre shpërblimeve janë:

a) Shpërblimet në *cash*

Çdo punonjës i institucionit ka të drejtën të marrë shpërblime në *cash* për kontribute të veçanta e të rëndësishme për institucionin, brenda ose jashtë detyrave dhe përgjegjësive të vendit të tij të punës. Propozimin për këtë shpërblim duhet ta bëjnë eprorët e punonjësit në njësinë organizative ku ai punon.

b) Shpërblime për suksese të veçanta

Këto shpërblime akordohen një herë në vit nga një komitet i ngritur posaçërisht për këtë qëllim. Këtij komiteti i propozohen për shpërblim nga drejtuesit e njësive organizative të gjithë punonjësit e nivelit jodrejtues, të cilët kanë dhënë gjatë vitit një kontribut të veçantë në arritjen e misionit dhe të objektivave të institucionit në mënyrë direkte ose indirekte.

2. PROGRAMI AKTUAL I KOMPENSIMEVE NË BANKËN E SHQIPËRISË DHE MANGËSITË E TIJ NË KRAHASIM ME PROGRAMIN IDEAL TË KOMPENSIMEVE

2.1 MANUALET E PUNËS

Manualet e punës, që ekzistojnë në Bankën e Shqipërisë, nuk kanë cilësitë dhe karakteristikat e duhura për të qenë baza e të gjitha etapave të tjera të programit të kompensimeve. Shpesh ato nuk përshkruajnë saktë detyrat dhe përgjegjësitë e një vendi pune. Edhe rishikimi i tyre nuk është bërë në mënyrë periodike e në bazë të ndryshimeve, që ndodhin në përgjegjësitë dhe detyrat e një vendi specifik pune. Si rrjedhojë është e nevojshme, që manualet ekzistuese të analizohen me imtësi nga një komitet "ad-hoc", dhe të hartohen në mënyrë të tillë, që të jenë sa më të sakta e bashkëkohore për të qenë më tej baza e etapave të tjera pasuese në program.

2.2 VLERËSIMI I VENDEVE TË PUNËS

Ky komponent mungon krejtësisht në programin e kompensimeve të Bankës së Shqipërisë. Si rezultat, efekti dhe rëndësia relative e asnjë vendi pune nuk është vlerësuar dhe nuk është përdorur për klasifikimin e vendeve të punës në intervale të caktuara pagash. Pra, korrespondimi i një vendi pune me një pagë bazë të caktuar deri tani është bërë në mënyrë arbitrare dhe joobjektive. Një nga disavantazhet kryesore të këtij korrespondimi arbitrar është mosnjohja e kontributit, që ofrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e vendeve të ndryshme të punës në arritjen e objektivave të Bankës së Shqipërisë, dhe si pasojë mosmotivimi i punonjësve me më shumë përgjegjësi e detyra më të rëndësishme për të dhënë maksimumin e tyre në dobi të institucionit.

Si konkluzion, duhet theksuar, se është e rëndësishme, që ky komponent të përfshihet dhe të ketë rëndësinë e duhur në

programin e kompensimeve të institucionit tonë, pavarësisht nga kostoja dhe vështirësitë, që dalin. Zhvillimi i një programi vlerësimi për vendet e punës do të rezultojë në njohjen dhe në vlerësimin e drejtë të kontributit të çdo vendi pune në arritjen e objektivave të Bankës së Shqipërisë, në klasifikimin e saktë të vendeve të punës në strukturën e pagave e rrjedhimisht në kompensimin e drejtë të individëve, që kanë këto vende pune.

2.3 ANALIZA E TREGUT TË PUNËS

Edhe ky komponent ka munguar në programin e kompensimit të Bankës së Shqipërisë. Në disa raste janë mbledhur të dhëna mbi pagat e sektorit publik dhe të bankave tregtare, por këto të dhëna janë përdorur thjesht për të krijuar një ide mbi pozicionin e pagave të Bankës së Shqipërisë në tregun e punës. Krahasimi i nivelit të pagave për vende të njëjta pune ka munguar edhe si rrjedhojë e manualeve jo të sakta e jobashkëkohore të vendeve të punës, të cilat nuk lejojnë gjetjen e vendeve të punës sa më të përafërta në tregun e punës. Si pasojë, reflektimi i të dhënave të tregut të punës në nivelin e pagave të Bankës së Shqipërisë dhe përcaktimi i pozicionit të saj në këtë treg, nuk kanë qenë të sakta dhe ky fakt dëmton dukshëm aftësinë konkurruese të Bankës së Shqipërisë për rekrutimin e më të aftëve dhe, më të kualifikuarve.

Si rezultat, theksojmë përsëri se edhe analizës së tregut të punës duhet t'i jepet rëndësia e duhur. Është e nevojshme, që kjo analizë të bëhet në mënyrë periodike dhe rezultatet e saj të shërbejnë në rishikimin e strukturës së pagave. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë pas kësaj analize duhet të përcaktojë qartë pozicionin e saj strategjik në tregun e punës, gjithmonë me synimin për të ruajtur aftësinë e saj konkurruese në këtë treg.

2.4 STRUKTURA E PAGAVE

Struktura aktuale e pagave në Bankën e Shqipërisë dhe komponentët e saj paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Paga bazë	Shtesë për klasifikim departamenti	Shtesë për vjetërsi të përgjithshme në punë	Shtesë për vjetërsi pune në sistemin bankar	Shtesë për vështirësi pune	Shtesë për grada shkencore	Shtesë për vlerësim pune	Paga bruto
E përcaktuar nga Këshilli Mbikëqyrës	Çdo vend pune merr 20%, 10% ose 0% të pagës bazë në bazë të rëndësisë relative të departamentit ku përfshihet.	0.4% e pagës bazë për çdo vit shtesë në vjetërsinë e përgjithshme në punë të punonjësit. Limiti maksimal = 10% e pagës bazë, që korrespondon me 25 vjet pune.	1% e pagës bazë për çdo vit shtesë pune në sistemin bankar. Limiti maksimal = 20% e pagës bazë, që korrespondon me 20 vjet pune.	10% ose 5% e pagës bazë, sipas vështirësisë së vendit të punës.	1500 lekë ose 3300 lekë për punime shkencore në dobi të performancës institucionale të Bankës së Shqipërisë.	Shtesë në përqindje të pagës bazë si rrjedhojë e vlerësimit vjetor të punës. Limiti maksimal =20% e pagës bazë	Shuma e gjithë e kompensuar

Siç shihet kjo strukturë përbëhet nga paga bazë dhe nga gjashtë shtesa mbi pagën bazë, ndërkohë që një strukturë ideale pagash ka vetëm tre komponentë: pagën bazë, shtesën për vlerësim pune dhe bonuset e akorduara për performancë të shkëlqyer. Pra, struktura ekzistuese në Bankën e Shqipërisë është shumë më e komplikuar se ajo ideale. Gjithashtu, kjo strukturë nuk e bazon kompensimin e punonjësve tek performanca e tyre. Ekzistenca e shumë shtesave të tjera, të cilat bazohen në kritere të ndryshme nga niveli i performancës së punonjësit, bën që kompensimi i personelit të bankës të bazohet kryesisht në të tjerë faktorë dhe jo në kontributin, që ata japin në arritjen e objektivave institucionalë. Si rezultat, punonjësit nuk motivohen për një punë sa më cilësore e performancë të lartë.

Është e nevojshme, që kriteret e përdorura për shtesat mbi pagën bazë, përveç asaj për vlerësim pune, të përdoren si kritere të vlerësimit të vendeve të punës dhe efekti i tyre të përfshihet në pagën bazë, që do t'i akordohet këtyre vendeve pune. Kjo e thjeshton strukturën e pagave, por njëkohësisht ndihmon në kompensimin e drejtë të punonjësve.

Gjithashtu, në strukturën ekzistuese të pagave në Bankën e Shqipërisë mungon edhe klasifikimi i vendeve të punës në intervale të ndryshme pagash. Mungesa e intervaleve të pagave ka sjellë dhe mungesën e shkallëve të karrierës aq të domosdoshme për rritjen e motivimit të brendshëm të punonjësve, për nxitjen e kualifikimeve të mëtejshme profesionale dhe për rritjen e konkurrencës mes punonjësve për performancë sa më të lartë e në dobi të interesave të Bankës së Shqipërisë.

Ekzistenca e shtesës për vlerësim vjetor pune është një veçori pozitive e strukturës aktuale të pagave, pasi motivon më tej punonjësit për punë cilësore, por e meta kryesore e saj qëndron në mënyrën e vlerësimit të kësaj performance dhe në lidhjen e saj me sistemin e kompensimeve.

Së pari, programi i vlerësimit të performancës duhet rishikuar, me qëllim që vlerësimi i bërë të jetë sa më objektiv e të mos shërbejë thjesht për shtesën mbi pagën bazë.

Së dyti, akordimi i shtesës duhet të jetë më pak i centralizuar dhe duhet të bazohet në hartimin e buxheteve paraprake për çdo njësi organizative.

Si përfundim duket qartë se i gjithë programi i kompensimeve në Bankën e Shqipërisë ka nevojë për një ndryshim radikal, i cili kushtëzohet nga kostoja por dhe nga efektet psikologjike tek punonjësit e institucionit tonë. Prandaj është e nevojshme, që të gjenden rrugë të ndërmjetme, të cilat do të çojnë gradualisht drejt perfeksionimit të këtij programi dhe komponentëve të tij.

Duke arritur këtë perfeksionim Banka e Shqipërisë do të ketë një program kompensimi, që do ta ndihmojë të arrijë objektivat e mëposhtëm:

- drejtësinë dhe paanshmërinë në shpërblimin e punës së çdo punonjësi;
- tërheqjen, ruajtjen dhe motivimin e punonjësve të kualifikuar në çdo nivel të hierarkisë organizative;
- ruajtjen e aftësisë konkurruese në tregun lokal të punës;
- qartësimin e punonjësve për lidhjen, që ekziston mes performancës individuale dhe objektivave të Bankës së Shqipërisë;
- shpërblimin e punonjësve në bazë të performancës së tyre individuale dhe të kontributit, që ata japin në Bankën e Shqipërisë.

---

* Zhizela Balla, specialiste, Departamenti Juridik dhe i Burimeve Njerëzore.

ARGUMENTE MBI NIVELIN E KAPITALIT MINIMAL TË PAGUAR

*Erjona Suljoti**

Fjalë kyçe
- Funksionet e kapitalit - Kapitali minimal fillestar - Sistemi bankar shqiptar - Shkalla e rrezikut - Rentabiliteti -

I. Ç'PËRFAQËSON KAPITALI PËR NJË BANKË?

Banka si çdo shoqëri tjetër tregtare për të ushtruar veprimtarinë e saj ka nevojë për kapital. Por, në dallim prej tyre, bankës tregtare i duhet të mbajë në çdo moment të caktuar kohe një shumë kapitali, i cili të jetë në gjendje të amortizojë humbjet e paparashikueshme. Ky detyrim buron nga natyra e veçantë e veprimtarisë bankare.

Kapitali i një banke kryen një sërë funksionesh. Për të realizuar këto funksione ai duhet të ketë strukturë dhe madhësi, që të kënaqë autoritetet rregulluese, aksionerët, investitorët (përfshirë depozituesit).

Ndër funksionet kryesore të kapitalit do të përmendnim:

Së pari, kapitali thith humbjet e bankës si edhe ekspozimet e saj ndaj rreziqeve të ndryshme që i duhet të përballojë gjatë aktivitetit të saj.

Së dyti, kapitali bën që depozituesit dhe kreditorët e tjerë të ndjehen të mbrojtur jo vetëm gjatë periudhave normale të veprimtarisë bankare, por edhe gjatë periudhave të vështirësive

financiare. Kjo do të thotë se kapitali është faktor që përforcon besimin e publikut tek çdo bankë, në veçanti, dhe tek i gjithë sistemi bankar, në tërësi.

Së treti, kapitali i bankës është burim fondesh afatgjata për aktivet e qëndrueshme, për teknikën dhe për teknologjinë bankare. Kapitali është burim kryesor për financimin e rritjes së bankës gjë, që është tepër e rëndësishme për të qenë konkurrues në ambientin bankar.

Së katërti, kapitali shërben si instrument i kontrollit të rritjes së veprimtarisë së bankës. Në rast se aktivet e bankës rriten më shpejt sesa duhet, atëherë banka do të marrë sinjale nga autoritetet rregulluese, se ajo duhet të përmbahet në ekspansionin e saj ose përndryshe, të shtojë kapitalin në përputhje me rreziqet që ajo merr përsipër.

Së pesti, kapitali ndihmon bankën që ajo të licencohet, të organizohet dhe të operojë përpara se të fillojë fluksi i depozitave. Në periudhën fillestare, kur ende besimi i publikut ndaj bankës është në nivel relativisht të ulët, i vetmi burim financiar me të cilin banka mund të operojë është kapitali.

Duke iu referuar të gjitha këtyre funksioneve rëndësi të veçantë merr kategoria e kapitalit minimal fillestar dhe madhësia e tij.

II. CILËT FAKTORË MUND TË NDIKOJNË NË SHUMËN FILLESTARE TË KAPITALIT?

- Situata makroekonomike e vendit. Sa më e stabilizuar dhe e shëndoshë të jetë kjo situatë aq më e ulët është shkalla e rrezikut në ambjentin ku operojnë bankat. Kjo do të thotë se bankat në veprimtarinë e tyre mbartin më pak rrezik, prandaj kushte të tilla nuk përbëjnë nxitje për rritjen e shumës minimale të kapitalit.
- Nevoja për të pasur ose jo banka të reja. Kjo lidhet me nevojën e tregut për rritjen e sistemit bankar dhe të shërbimeve të tij. Nëse tregu ka mungesë konkurrence,

mungesë bankash dhe shërbimesh bankare, atëhere kjo mund të bëjë që autoritetet të nxisin hyrjen e bankave të reja duke vepruar edhe nëpërmjet kërkesës më liberale për kapital. Pasi në të kundërtën një kërkesë e lartë për kapital do të thotë, për investitorët, një kthyeshmëri më e ulët dhe anasjelltas.

- Fuqia e biznesit (në terma të kapitalit), shpreh mundësinë aktuale të bizneseve të një vendi për të qenë në gjendje që të hyjnë në industrinë bankare. Shpeshherë autoritetet e vendit janë të interesuara që të rrisin numrin e bankave me kapital vendas në sistemin bankar. Për të realizuar këtë preferencë, mbahen parasysh edhe fuqitë reale të biznesit në termat e kapitalit. Duke iu referuar këtij kriteri si dhe preferencave drejt bankave me kapital vendas, në çdo rast, kjo nuk do të ndikonte në rritjen e mëtejshme të shumës së kapitalit.
- Shkalla e interesit të investitorëve (të brendshëm ose të huaj) për të çelur bankë. Ky faktor nënvizon faktin se nuk është e rëndësishme vetëm sa është fuqia (në terma të kapitalit) e investitorëve për të investuar, por dhe sa është shkalla e interesit të tyre drejt këtij aktiviteti. Shkalla e interesit të investitorëve të huaj dhe vendas lidhet drejtpërdrejt me treguesit e përfitueshmërisë (kthyeshmërisë) së investimit të tyre në këtë aktivitet si dhe me rrezikun që ata marrin përsipër. Nëse interesi është i ulët, atëhere veprohet nëpërmjet mbajtjes së shumës së kapitalit në nivele të ulta dhe anasjelltas.
- Shkalla e rrezikut të vendit dhe në veçanti e aktivitetit bankar. Kur flasim për rrezik kemi parasysh një nga faktorët kryesorë që ndikojnë në vendimin për të investuar apo jo. Një sistem bankar që vepron në një ambjent me një rrezik të lartë kërkon më shumë siguri, më shumë kapital që do të thotë ka nevojë për më shumë kapital fillestar. Përveç rreziqeve të përgjithshme ndikim të drejtpërdrejtë ka dhe rreziku i sistemit bankar, karakteristikat kryesore të strukturës së tij, të cilat ndikojnë në ecurinë e aktivitetit.
- Nevoja për të përmbushur standardet ndërkombëtare si për shembull, direktiva të ndryshme nga BIS ose BE. Shumë vende të rajonit si Kroacia, Rumania etj. në kuadrin

e marrëveshjeve të asocimit për të aderuar në BE kanë konverguar shumën e kapitalit minimal sipas direktivës, nr. 12 të vitit 2000. Sipas kësaj direktive vendet që do të lidhin marrëveshjen e asocimit për aderimin në BE duhet të mbajnë një shumë minimale të kapitalit jo më të ulët se 5 milionë euro ose 4,7 milionë usd. Në përgjithësi, vendet anëtare në BE shumën e kapitalit minimal e kanë 18 milionë euro ose 16.5 milionë usd.

III. HISTORIKU I NDRYSHIMIT TË KËTIJ TREGUESI NË SHQIPËRI NË VITE

Aktualisht në Shqipëri kërkesa për kapital është 700 milionë lekë ose rreth 5 milionë usd. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, shuma e kapitalit ka ndryshuar me tendencë rritjeje. Kriteri i BE-së, 16.5 milionë usd është 3.3 herë më i lartë se norma aktuale e Shqipërisë, por gjithsesi ajo përmbush kriterin e BE-së për vendet që do të lidhin marrëveshjen e asocimit. Duke ditur që synojmë anëtarësimin në BE dhe përafrimi i legjislacionit është një hap i rëndësishëm drejt këtij anëtarësimi, natyrshëm lind pyetja: A duhet rritur shuma minimale e kapitalit? Përgjigjja është po, sepse nuk mund të largohemi nga procesi integrues i nisur si dhe për më tepër, sigurojmë edhe përfitime që shoqërojnë rritjen e kapitalit. Por, lind pyetja e dytë: A ka ardhur koha për të rritur shumën? Për këtë analizojmë disa fakte.

Tabelë 1. Ndryshimi nga viti në vit i kapitalit minimal në Shqipëri.

Vitet	Shuma e kapitalit minimal (në milionë lekë)	Nr. i bankave
Pas 1998	700	14
02.12.1998	700	10
dhjetor 1996	350	8
28.06.1996	200	8
Në vitin 1994	100 – 200*	6

*Shënim. Në vitin 1994 kishte dy nivele të kapitalit minimal të kërkuar: për investitorët vendas 100 milionë lekë dhe 200 milionë për investitorët e huaj.

Nga historiku i ndryshimit të shumës së kapitalit mund të nxjerrim drejtpërdrejt dy karakteristika të rëndësishme.

I: Në Shqipëri rritja e kapitalit nuk ka penguar kërkesën për çeljen e bankave, të cilat nga viti 1998 (kur kapitali minimal u rrit në nivelin e 700 milionë lekëve) janë shtuar edhe me 4 banka të reja. Kjo do të thotë që në interesin e investitorëve për të çelur banka kanë ndikuar faktorë të tjerë të ndryshëm nga shuma e kapitalit.

II. Në Shqipëri vëmë re se periudha e ndryshimit të kapitalit është pothuajse në çdo dy vjet. Ka raste kur shuma e kapitalit ka ndryshuar 2 herë brenda vitit (viti 1996). Në këtë vit ndryshimi u bë për të ruajtur të njëjtin nivel, të shprehur në usd (prej 2 milionë usd) të kapitalit minimal. Në realitet, në këtë vit kemi një nënçmim të theksuar të kursit të lekut ndaj dollarit (nga 100 lekë/usd në 170 lekë/ usd). Ky nënçmim i lekut bëri që të merrej vendimi për rritje të kapitalit minimal nga 200 milionë në 350 milionë lekë. Në vitin 1998, vendoset që bankat e reja që kërkonin të hynin në sistem duhet të paraqisnin një kapital jo më të ulët se 700 milionë lekë. Ndërsa për bankat ekzistuese dhe për ato që janë në proces miratimi të licencës, të bëhet një rritje disafazëshe e shumës së kapitalit minimal. Fillimisht u gjykua e arsyeshme të plotësohet një nivel prej 500 milionë lekësh. Ky detyrim do të përmbushej nga bankat në një hark kohor prej 18 muajsh dhe më pas të plotësohej një nivel prej 700 milionë, i cili duhej të përmbushej brenda 18 muajve të tjerë. Pra, nga viti 1992 deri më sot kemi katër ndryshime që mesatarisht do të thotë se ndryshimet janë bërë çdo dy vjet e gjysmë. Gjthësesi, po t'i referohemi eksperiencës së vendeve perëndimore, vëmë re se kur u vendos akordi i Baselit për kriterin e mjaftueshmërisë së kapitalit, në vitin 1988, u caktua një afat kohor për zbatimin dhe përshtatjen e këtij akordi, për rreth 4 vjet, deri në vitin 1992. Ndërkohë që në sistemin tonë bankar sikurse u përmend më sipër, periudha e ndryshimit të shumës së kapitalit ka qenë 2.5 vjet.

Konkluzioni 1: Vetëm nga një vështrim i historikut të ndryshimit të nivelit të kapitalit minimal konkludohet që shpeshtësia e rritjes së kapitalit ka qenë relativisht e lartë. Për këtë arsye, gjykohet që është ende shpejt për të ndryshuar shumën e kapitalit, sepse ndryshimi i shpeshtë i të bankat përballë pasigurisë dhe presionit, si dhe vështirëson zbatimin e planbizneseve të tyre.

IV. SHUMA E KAPITALIT NË SHQIPËRI DHE NË DISA SHTETE TË TJERA

Tabelë 2. Krahasimi i treguesve të kapitalit për vendet e rajonit.

Vendet	Shuma e kapitalit minimal (në milionë usd)	Kapitali minimal/ PBB	Shkalla e levës financiare	Mjaftueshmëria e kapitalit	Madhësia e* sistemit bankar
Shqipëri	5,0	0.05%	6.7	42	50
Maqedoni	2,2- 8,3*	0.22%	23.3	36.7	38
Kroaci	4,7	0.02%	11.2	21.3	71
Bosnie Hercegovina	4,1	0.17%	25.7	32	67
SIloveni	4,0	0.02%	14	12.4	79
Bullgari	5,1	0.04%	11.3	41.3	40
Rumani	4,6	0.01%	8.6	23.8	29
Jugosllavi	5,0	1.87%	-	-	-
Turqi			11	-	70
Mesatare	4,8		13.27	25.84	55.5

*Shënim: Në rastin e Maqedonisë kemi dy nivele të kapitalit të kërkueshëm për bankat. Niveli rreth 2 milionë usd është për bankat që ushtrojnë aktivitetin e tyre brenda kufijve të vendit, ndërsa ato që kryejnë operacione jashtë vendit duhet të përmbushin një kapital minimal në shumën rreth 8 milionë usd.

*Me madhësi e sistemit bankar kuptohet totali i aktiveve të sistemit ndaj PBB-së.

Burimi: Raportet vjetore të vendeve si dhe Raporti Vjetor i IFS.

Niveli aktual minimal i kapitalit në Shqipëri, ndodhet afër nivelit mesatar të vendeve të rajonit që sipas një mesatareje të thjeshtë është në nivelin e 5.5 milionë usd. Ky tregues përkrah mendimin se nuk është momenti për ta ndryshuar këtë shumë. Pjesa që zë kapitali minimal ndaj totalit të PBB-së për Shqipërinë është më e lartë sesa në vende të tjera të ngjashme (si Rumani dhe Bullgari) që do të thotë praktikisht se në këto kushte ndryshimi i shumës së kapitalit minimal nuk është i nevojshëm. Niveli i levës financiare në Shqipëri aktualisht është i ulët. Që do të thotë se përpjesa që zë kapitali i vet ndaj totalit të aktiveve është shumë e vogël, më e vogla në të gjitha vendet e marra për krahasim. Ky tregues sugjeron rritjen e shumës së kapitalit. Treguesi i madhësisë së sistemit bankar për Shqipërinë është diçka më poshtë se mesatarja e vendeve të rajonit (55.5), që do të thotë se sistemi bankar në Shqipëri ka akoma nevojë për t'u zgjeruar. Ky tregues nënvizon idenë se rritja e shumës minimale do të ishte e dëshirueshme me qëllim që bankat të kenë mundësi për zgjerim.

Konkluzioni 2: Nga krahasimi i treguesve të kapitalit nënvizojmë se nga njëra anë shuma minimale e kapitalit si dhe madhësia e sistemit bankar janë afër mesatares së vendeve të rajonit, prandaj nuk është e nevojshme rritja e mëtejshme e shumës së kapitalit. Edhe niveli i mjaftueshmërisë që është 1.6 herë më i lartë se vendet e rajonit nuk e përkrah rritjen e kapitalit minimal. Nga ana tjetër, shkalla e levës financiare është sa gjysma e mesatares së rajonit dhe larg nivelit të vendeve të tilla si Kroaci dhe Slloveni (përkatësisht 11.2 dhe 14), që kanë një sistem bankar më të zhvilluar. Ky fakt përkrah rritjen e shumës së kapitalit fillestar.

V. ANALIZA E FAKTORËVE QË NDIKOJNË NË SHUMËN E KAPITALIT PËR SHQIPËRINË

1. SITUATA MAKROEKONOMIKE

Po të krahasojmë ecurinë në vite të disa treguesve makroekonomikë të Shqipërisë, duket qartë që mjedisi makroekonomik i vendit ka ardhur duke u stabilizuar. Gjatë 4 viteve të fundit të marrë në analizë, Shqipëria shfaq zhvillime pozitive më të mira për treguesit makroekonomikë, ndërmjet vendeve të rajonit të marra për krahasim.

Tabelë 3. Historiku i ecurisë së treguesve makroekonomikë.

Treguesit	Vitet			
	1997	1998	1999	2000
PBB në vlerë nominale (milionë) usd	2,294	3,057	3,676	3,752
PBB për frymë në usd	684	906	1,081	1,094
Rritje e PBB (ndryshimi në %)	-7	8	7.3	7.8
Investimet direkte (milionë $)	47.5	45	41.2	143
Investimet ndaj PBB (në %)	2.1	1.5	1.1	3.8
Inflacioni (në %)	42.1	8.7	-1	4.2
Kursi i këmbimit lekë/ usd (mesatar)	148.9	150.6	137.7	143.7

Nga zhvillimet makroekonomike Shqipëria përafrohet më shumë me vende të tilla si Maqedoni, Rumani dhe Bullgari, ndërkohë që ka një inflacion më të ulët ndërmjet këtyre vendeve,

investimet në përqindje ndaj PBB më të ulta si dhe PBB për frymë më të ulët. Sikurse dihet, aktualisht, Ballkani tërheq një përqindje shumë të vogël të investimeve të investitorëve të huaj dhe kjo në njëfarë mënyre ndikon në zhvillimet e përgjithshme makroekonomike, por dhe në atë të sistemit bankar. Kjo ka ardhur si rezultat i situatës tejet të rënduar me luftra si dhe i një shfaqjeje të mungesës së theksuar të stabilitetit politik, si rajon.

Tabelë 4. Të dhënat makroekonomike për vendet e rajonit, për vitin 2000.

Vendet	Treguesit e PBB			Investimet direkte		Inflacioni (në %)	Kursi mesatar vjetor i këmbimit ndaj usd
	PBB në mil. usd	PBB/ Frymë	Rritja reale e PBB-së	Totali në mil. usd	IHD/ PBB (në %)		
Shqipëri	3,752	1,094	7.8	143	3.8	4.2	143.71
Maqedoni	3,800	1,885	5.1	181.6	4.6	10.6	65.904
Kroaci	18,977	4,227	3.7	827,9	21.9	6.2	8.3
Bosnje Hercegovinë	4,130.4	1,053	5	117	2.8	8	2.1
Slloveni	18,169	9,413	4.6	133.3	1	8.9	222.7
Bullgari	11,950	1,459	5.8	999.6	8.4	10.1	2.1
Rumani	36,691	1,636	1.6	1036	3	45.7	21,708
Jugosllavi	267	940	7	-	-	85.6	37.5
Turqi	77,484	1150	7.6	112	1.3	55	1644.5

Burimi: Raporti Vjetor i IFS 2000.

Duke iu referuar problemit tonë do të thotë që akoma nuk ka ardhur momenti i rritjes së shumës së kapitalit, sepse gjithësesi një veprim i tillë do të kufizonte në njëfarë mase rritjen e mëtejshme të sistemit bankar. Po t'i referohemi zërit investime të huaja direkte për frymë shohim se Shqipëria rradhitet si vendi i fundit ndaj gjithë vendeve të rajonit për tërheqjen e investimeve të huaja. Kjo do të thotë që, në përgjithësi, duhen krijuar kushte sa më të favorshme për tërheqjen sa më të madhe për investitorët e huaj, që do të thotë se rritja e shumës minimale të kapitalit nuk është e përshtatshme. Përsa i përket treguesit të inflacionit ai është në nivelin më të ulët për të gjitha vendet e rajonit. Treguesi i inflacionit së bashku me kursin stabël të këmbimit flasin për një situatë makroekonomike të favorshme dhe më të sigurtë, gjë që nuk kërkon domosdoshmërisht më shumë kapital.

Konluzioni 3: Nga analiza e mësipërme mund të themi se situata makroekonomike e krijuar, nuk dikton patjetër rritjen e shumës së kapitalit minimal. Gjithashtu, dhe niveli i ulët

i investimeve të huaja për frymë, përkrah mosndryshimin e shumës së kapitalit.

2. NEVOJA PËR TË PASUR OSE JO BANKA TË REJA

Nevoja për të pasur ose jo banka të reja përgjithësisht përcaktohet nga:

- madhësia fizike e sistemit bankar. Me madhësi të sistemit i jemi referuar disa treguesve sasiorë si për shembull, numrit të bankave për 1,000 km^2 që paraqet shtrirjen gjeografike të sistemit bankar, numrit të bankave për 100,000 banorë që paraqet shtrirjen e bankave për t'iu ardhur sa më shumë në ndihmë popullsisë;
- struktura e sistemit bankar, në lidhje me shkallën e përqendrimit të tij në bazë të aktiviteteve bankare. Këtë fakt e nënvizojmë duke patur parasysh ekzistencën e një konkurrence sa më efikase të sistemit bankar.[1]

Tabelë 5. Shqipëria dhe vendet e rajonit në madhësinë e sistemit bankar.

Vendet	Numri i bankave	Numri i bankave për 1000 km^2	Numri i bankave për 100,000 banorë
Shqipëri	13	0.45	0.37
Maqedoni	22	0.87	1.08
Kroaci	44	0.78	1.02
Bosnje Hercegovinë	63	1.23	1.61
Slloveni	97	4.79	5.03
Bullgari	35	0.32	0.45
Rumani	40	0.17	0.18
Mesatare	45	1.23	1.39*

* Në këtë mesatare nuk janë përfshirë bankat e Turqisë dhe të Jugosllavisë.

Shqipëria është vendi me më pak banka në vendet e rajonit. Në qoftë se këtë numër do ta vendosim në raport me popullsinë e vendit dhe sipërfaqen e tij, do të merrnim një tregues më real. Por, dhe në këtë rast, vendi ynë rradhitet ndër tre vendet e fundit mbas Rumanisë dhe Bullgarisë për koeficientin e bankave për 1,000 km^2, dhe në përgjithësi është larg mesatares së rajonit.

Konkluzioni 4: Këta tregues dëshmojnë se sistemi bankar nuk është i tejngopur, prandaj mund të themi se është e nevojshme të nxitet më tej hyrja e bankave të reja në sistem. E parë në këtë këndvështrim do të thotë që rritja e nivelit minimal të kapitalit fillestar, nuk do të ndihmonte aspak në tërheqjen e investitorëve.

Po t'i referohemi strukturës së sistemit bankar, Shqipëria, ka një sistem bankar të përqendruar në një bankë të vetme. Gjatë vitit 2000 aktivet e bankës më të madhe në vend zënë rreth 65 për qind të aktiveve të sistemit bankar. Ndërkohë që në vendet e rajonit si për shembull, në Kroaci, aktivet e tre bankave më të mëdha të sistemit bankar zënë 18.8 për qind të aktiveve të sistemit.

Konkluzioni 5: Sa më i përqendruar të jetë sistemi bankar aq më e domosdoshme del në pah rritja e konkurrencës dhe hyrja e bankave të reja në treg. Ky fakt përkrah edhe një herë krijimin i kushteve të favorshme për hyrjen e investitorëve në tregun bankar, pra nuk e përkrah rritjen e shumës së kapitalit minimal.

3. FUQIA E BIZNESIT VENDAS (NË TERMAT E KAPITALIT)

Në vendin tonë, në hapat e parë të caktimit të këtij niveli u mendua të bëhej një diferencim ndërmjet investitorëve vendas dhe atyre të huaj. Duke iu ardhur në ndihmë investitorëve vendas me një shumë sa gjysma e shumës së investitorëve të huaj (100 milionë lekë). Ky diferencim u bë sepse, në atë kohë, nuk ishin krijuar akoma mundësitë reale të bizneseve shqiptare për të investuar në aktivitetin bankar. Ky tregues mendohej të ishte një nxitës drejt këtij aktiviteti. Më pas u gjykua e arsyeshme të hiqej ky kriter, edhe pse ishin arsye të tjera që i mbanin larg investimet e bizneseve shqiptare në aktivitetin bankar[2].

Konluzioni 6: Gjithsesi, në kushtet kur bizneset shqiptare akoma nuk janë plotësisht të konsoliduara dhe nuk ndihen të tërhequra nga veprimtaria bankare, do të ishte e parakohshme rritja e shumës së kapitalit.

4. SHKALLA E INTERESIT TË INVESTITORËVE (TË BRENDSHËM OSE TË HUAJ) PËR TË ÇELUR BANKË

Aktualisht investitorët shqiptarë (sipas disa analizave paraprake) nuk parapëlqejnë aktivitetin bankar për shkak të kthyeshmërisë të ulët dhe jo të menjëhershme që merret nga ky aktivitet. Investimi në një bankë është një investim afatgjatë që vitet e para të aktivitetit i ka me humbje, ndërkohë që investime të tilla si tregtia apo ndërtimi i vjelin fitimet e tyre që në vitet e para. Krahas këtij faktori ka edhe shumë faktorë të tjerë që mbështesin preferencën e investitorëve vendas drejt fushave të tjera të ekonomisë sesa në sistemin bankar. Ndërsa tërheqja e investitorëve të huaj do të kërkonte krijimin e kushteve favorizuese për këta investitorë si për shembull, në drejtim të kthyeshmërisë. Gjithashtu, shuma e kapitalit ka nevojë të jetë e tillë, që të ruajë konkurrencën në rajon. Vendosja e një niveli të lartë të kapitalit minimal do të sillte që investitorët e huaj të tërhiqeshin duke investuar kapitalin e tyre drejt vendeve që ofrojnë më tepër lehtësi.

Konluzioni 7: Shqipëria është ende në pozicion që ka nevojë për banka të reja dhe nuk ka investitorë të interesuar, ndaj duke e parë në këtë këndvështrim ajo duhet të nxisë hyrjen e bankave të reja dhe jo frenimin e tyre. Nga ana tjetër, duke parë dhe ecurinë e procesit të privatizimit të bankave shtetërore vëmë re se investitorët e interesuar janë të paktë. Kjo përforcon dhe një herë idenë se shuma ekzistuese e kapitalit minimal nuk duhet të rritet.

5. SHKALLA E RREZIKUT TË VENDIT DHE NË VEÇANTI E AKTIVITETIT BANKAR

Shuma e kapitalit të kërkuar ka një lidhje të drejtë me shkallën e rrezikut. Aktualisht, Shqipëria sikurse dhe disa vende të tjera të Ballkanit, është vend me një rrezik të lartë. Aktiviteti bankar, për vetë rëndësinë që ka, kërkon masa paraprake shumë të kujdesshme që të mund të evitojnë tronditje të gjithë sistemit

bankar dhe, në përgjithësi, të atij financiar. Po t'iu referohemi ecurisë së treguesve të performancës së sistemit bankar (cilësisë së kredisë meqenëse kredia është aktiviteti kryesor dhe me rrezik më të lartë) shohim se ka përmirësime të ndjeshme nga viti në vit.

Konluzioni 8: Në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit treguesit e aktivietit kreditues tregojnë një pozicion me rrezik të konsiderueshëm (të lartë). Ky fakt vepron në favor të rritjes së shumës së kapitalit fillestar, për të krijuar baza për një sistem bankar më të shëndetshëm.

V. SITUATA NË SISTEMIN BANKAR

Gjithsesi, ajo që duhet patur në qendër të vëmendjes është ecuria e sistemit bankar. Rentabiliteti i sistemit bankar të Shqipërisë ndodhet në nivele relativisht të kënaqshme, diçka më lart se mesatarja e vendeve të rajonit (e përcaktuar si mesatare e thjeshtë ndërmjet vendeve të marra në analizë). Treguesi i kthyeshmërisë nga kapitali i vet është në nivelin më të lartë për të gjithë rajonin (të paktën në krahasim me vendet nga të cilat janë siguruar të dhëna). Gjë që tregon se fitimi neto i bankave i vënë ndaj kapitalit të aksionerëve është i lartë. Ndërsa për dy treguesit e tjerë: kthyeshmëria ndaj totalit të aktivit dhe fitimi neto ndaj PBB, treguesit e Shqipërisë rradhiten në vendin e dytë. Përsëri në një pozicion të kënaqshëm.

Tabelë 6. Tregues të rentabilitetit të sistemit bankar për vendet e rajonit.

Vendet	ROE	ROA	Fitim neto/PBB
Shqipëri	21.06	2.1	1
Maqedoni	3.8	0.8	0.3
Kroaci	15.6	1.3	0.8
Bosnje Hercegovinë			
Sllloveni		0.8	1.3*
Bullgari	18	2.4	0.9*
Rumani	12.5	1.5	0.4
Mesatare	14.2	1.5	0.8

* Në mungesë të të dhënave për vitin 2000 janë marrë të dhënat e vitit 1999.

Po të shohim ecurinë historike të treguesve të rentabilitetit, vëmë re një përmirësim të dukshëm nga viti në vit të tyre.

Tabelë 7. Historiku i treguesve të rentabilitetit të sistemit bankar në Shqipëri.

Treguesit	Vitet			
	1998	1999	2000	2001
ROA	-1.8	-0.56	2.1	1.46
ROE	-82.3	16.4	21.06	21.6
Fitim/PBB në %	-0.7	0.3	1.0	0.7

Nga ana tjetër, treguesit e cilësisë së aktivitetit bankar krahasuar me vendet e tjera të rajonit qëndrojnë larg mesatares. Shqipëria është vendi që ka më pak të zhvilluar kreditimin e ekonomisë (sektorit privat) se të gjitha vendet e tjera të rajonit. Aktiviteti kreditues është një aktivitet akoma jo shumë i preferuar nga bankat ekzistuese, ndërkohë që siç dihet aktiviteti kreditues është aktiviteti kryesor i një banke. Cilësia e portofolit të kredive për momentin vazhdon të qëndrojë në nivele të këqija, dhe shumë larg mesatares së rajonit. Nga kjo nxjerrim konkluzionin se duhet stimuluar rritja e mëtejshme e veprimtarisë kredidhënëse të bankave. Në kushtet kur kredidhënia është një proces me rrezik të lartë, themi se mund të shoqërohet me rritjen e shumës së kapitalit.

Tabelë 8. Treguesit e cilësisë së kredisë të krahasueshme me vendet e rajonit.

Vendet	Niveli i huave me probleme ndaj totalit të kredive	Kreditimi i ekonomisë ndaj PBB-së	Kreditimi i ekonomisë ndaj totalit të aktivit
Shqipëri	42.8	5.2	10.4
Maqedoni	34.8	19.5	33.8
Kroaci	9.2	37.5	45.8
Bosnje Hercegovinë		49	73
Slloveni	5	39	53
Bullgari	8.2	18.3	36.8
Rumani	38.3	9.4	32.2
Turqi		22	32.1
Mesatare	23	25	40

Tabelë 9. Historiku i ecurisë së treguesve të performancës së sistemit bankar.

Treguesit (në %)	Vitet			
	1997	1998	1999	2000
Niveli i huave me probleme ndaj totalit të kredive	45.0	41.0	32.7	42.8
Kreditimi i ekonomisë ndaj PBB-së	4.5	7.9	8.1	5.2
Kreditimi i ekonomisë ndaj totalit të aktivit	9.2	18	16	10.4
Madhësia e sistemit bankar (aktiv/PBB)	49.0	44.7	49.3	50.2
Përdorimi i levës financiare (kap. I vet/tot.aktiv)	6.7	2.8	3.6	6.7
Norma e mjaftueshmërisë	-	-1.3	8.2	42

Nëse do t'i referoheshim ecurisë në vite të treguesit për mjaftueshmërinë e kapitalit apo të levës financiare, vëmë re se këta

tregues në vitet e mëparshme kanë qenë në nivele shumë të ulta. Kjo ka ardhur si rezultat i provigjoneve të larta për huatë e këqija të sistemit. Mbas vitit 1999 kemi kalimin e huave të këqija pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive dhe përmirësimin e ndjeshëm të llogarisë kapitale. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit shfaqet në nivelin me të lartë të vendeve të marra në analizë. Ky fakt dëshmon ose që aktiviteti bankar është shumë mirë i kapitalizuar në krahasim me rrezikshmërinë që marrin përsipër bankat (ka më shumë kapital se sa duhet), ose që bankat investojnë shumë pak në aktivitete me rrezik). Ndërsa, përsa i përket peshës që zënë aktivet e sistemit bankar ndaj totalit të PBB-së është shumë afër mesatares së vendeve të marra në analizë, por shumë larg standardeve të vendeve të zhvilluara (në vendet perëndimore ky raport është në nivelet e 250 për qind).

Konkluzioni 9: Duke iu referuar treguesve të rentabilitetit themi se ata janë në nivele favorizuese, më të lartë ndër vendet e rajonit. Ndërsa treguesit e performancës së sistemit bankar janë në nivele të ulta. Ekzistenca e një rreziku të lartë kërkon një shumë kapitali më të lartë.

Duhet patur kujdes se vendosja e një niveli të kapitalit më të lartë, përveç se do të largonte investitorët e huaj, sikurse u përmend më sipër, mund të çojë në rritjen e kërkesës për krijimin e shoqërive të tjera financiare jobanka.

VI. SHQIPËRIA DHE VENDET FQINJE ANËTARE NË BE

Në kuadrin e asocimit të Shqipërisë në Evropë, i jemi referuar treguesve të sistemit bankar të vendeve anëtare në BE. Kemi zgjedhur Italinë dhe Greqinë, jo vetëm për faktin se ato janë anëtare të BE-së, por edhe sepse ato janë partneret tona kryesore.

Shuma e kapitalit minimal të këtyre dy vendeve është përcaktuar nga direktivat e BE-së në nivelin 16.5 milionë usd. Përdorimi i levës financiare në Itali është shumë më i lartë se në Greqi, për vet faktin se zhvillimi ekonomik i Italisë dhe

struktura e sistemit bankar ndodhen në një nivel më të zhvilluar sesa i Greqisë. Madhësia e sistemit, e shprehur në raportin e aktivit të sistemit bankar ndaj PBB-së, është disa herë më e lartë se niveli i këtij raporti për mesataren e rajonit të Ballkanit, dhe se madhësia e sistemit bankar shqiptar. Madhësia fizike e sistemit bankar të këtyre vendeve është shumë e madhe, gjë që dëshmon për një sistem bankar të konsoliduar dhe të zhvilluar. Treguesi i kredive të këqija mbi totalin e kredive tregon qartë për një nivel të ulët të tyre dhe një performancë të mirë të aktivitetit kreditues.

Tabelë 10. Treguesit e sistemit bankar për vendet e BE-së për vitin 2000.

Treguesit	Itali	Greqi
Kapitali minimal i kërkuar në usd	16,500,000	16,500,000
Leva financiare (në %)	6.7	12.3
Madhësia e sistemit bankar (në %)	153	128
Numri i bankave	846	
Mjaftueshmëria e kapitalit	10.3	14.7*
Niv. i kredive të këqija ndaj tot. të kredive	8	
Niv. i tot. të kredive ndaj tot. të aktiveve	51.3	45%
Niv. i totalit të kredisë ndaj PBB-së	78	53%
ROA	0.79	
ROE	11.6	

* E dhëna e marrë për vitin 1999.

Treguesit e mësipërm dëshmojnë se sistemi bankar në këto vende është shumë i zhvilluar dhe i konsoliduar, por gjithësesi ato kanë një nivel minimal të kapitalit shumë herë më të lartë sesa vendet e rajonit. Arsyeja që po japim një tablo tashmë të njohur të vendeve fqinje është për të treguar se vërtet ne duam të rrisim shumën minimale të kapitalit fillestar, por a janë pjekur kushtet për të kryer këtë ndryshim? A është vërtet sistemi ynë bankar në gjendje që të mbështesë dhe përballojë këtë ndryshim? Sistemi ynë bankar është akoma në gjendjen e tij fillestare (infantile), ndaj ai ka shumë rrugë për të bërë derisa të arrijë afër niveleve të sistemit bankar të vendeve të zhvilluara dhe derisa të piqen kushtet, paralelisht me ndryshimin e tyre, duhet të bëhet dhe ndryshimi i shumës së kapitalit.

VII. KONKLUZIONE

Arsyet pro rritjes së kapitalit	Arsyet kundër rritjes së kapitalit
Niveli i ulët i levës financiare	Shpeshtësia e ndryshimit të shumës së kapitalit
Rreziku i sistemit bankar, cilësia e keqe e portofolit të bankave	Shuma e kapitalit dhe madhësia e sistemit bankar janë afër mesatares së rajonit
Rreziku i vendit	Mjaftueshmëria e kapitalit është e lartë
Përafrimi me kriteret e BE-së.	Shuma e kapitalit është sa kriteri i BE-së për vendet që duan të aderojnë në BE.
	Situata makroekonomike e përmirësuar
	Nevoja për banka të reja
	Nevoja për rritjen e konkurrencës në një sistem bankar të përqendruar
	Fuqia e biznesit vendas në termat e kapitalit
	Nevoja për tërheqjen e investitorëve të huaj

Si përfundim, do të theksonim se faktorët, mbi bazën e të cilëve gjykohet për të përcaktuar shumën e kapitalit, veprojnë në të dy krahët. Megjithatë, janë më të shumtë faktorët që nuk e përkrahin rritjen e shumës së kapitalit fillestar.

VIII. REKOMANDIMET

1. Nga analizat e mësipërme gjykojmë se, për momentin, shuma e kapitalit fillestar të mbetet e pandryshueshme.
2. Mendojmë se duhet të vlerësohet me kujdes rreziku i veprimtarisë së sistemit bankar dhe në rast se shkalla e rrezikut rritet, mund të veprohet nëpërmjet kategorive të tjera të kapitalit. Për shembull, duke patur parasysh se rentabiliteti i sistemit tonë bankar është më i lartë se vendet e tjera të rajonit, Banka e Shqipërisë mund të kërkojë politika më konservatore nga ana e bankave në drejtim të shpërndarjes së dividentëve, duke lënë të paprekur shumën fillestare të kapitalit.

SHËNIME

* Erjona Suljoti, specialiste, Departamenti i Politikës Monetare.

[1] Në mungesë të të dhënave për koeficientët e përqendrimit të vendeve të rajonit po e përmendim vetëm si një faktorë teorik, që realisht duhet të merret në konsideratë kur vendoset për nivelin e kapitalit minimal.

[2] Shih vrojtimin "Sistemi bankar shqiptar, probleme të zhvillimit të tij" të përgatitur nga Sh. Cani, M. Muço, T. Baleta.

2003

Reagimi i tregjeve ndaj vendimeve të politikës monetare

Suzana Sheqeri
Arta Pisha
Mars 2003

REAGIMI I TREGJEVE NDAJ VENDIMEVE TË POLITIKËS MONETARE

*Suzana Sheqeri**
Arta Pisha

Fjalë kyçe
- Politikë monetare - Interesi bazë - Reagimi i tregjeve - Depozita - Bono thesari - Kredi -

Vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për ndryshimin e interesit bazë të tregut, janë përcaktuese në sjelljen e interesave në tregje. Bazuar në njoftimin e bërë nga Banka e Shqipërisë për ndryshimin e qëndrimit të politikës monetare, tregjet sigurojnë informacionin e nevojshëm, i cili shërben si sinjal për ndryshimet e interesave.

Niveli i zhvillimit të tregut financiar në Shqipëri, struktura më e zhvilluar e të cilit konsiderohet sektori bankar, bën që vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë të ndikojnë kryesisht në tregun e parasë, duke mbetur kështu të kufizuara në një afat kohor jo më të gjatë sesa një vit. Kjo pasi nuk mund të flasim për ndikim të vendimeve të politikës monetare në çmimet e aseteve, në kushtet kur nuk ekziston tregu i këtyre aseteve dhe në periudha kohore më të gjata sesa një vit.

Transmetimi i vendimeve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në vite të ndryshme ka specifikat e veta, të cilat janë kushtëzuar nga instrumentet e përdorura nga Banka e Shqipërisë për të transmetuar vendimet në tregje, nga zhvillimet që ka njohur vetë tregu i parasë, nga ndryshimet strukturore që ka njohur sektori bankar si shtimi i numrit të bankave, rritja e peshës së bankave me kapital joshtetëror kundrejt bankave me

kapital shtetëror, rritja e numrit të bankave aktive në tregje, rritja graduale e konkurrencës në tregje të ndryshme etj..

Në vazhdim, do të përpiqemi të analizojmë se si janë transmetuar vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudha të ndryshme kohore, për të evidentuar zhvillimet që janë shënuar në procesin e transmetimit si nga pikëpamja e progresit të bërë, ashtu edhe nga pikëpamja e pengesave që kanë frenuar rritjen e efikasitetit të këtij transmetimi.

Tabelë 1. Qëndrimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë për periudhën 1997-2002.

Sinjali i politikës monetare	Data e ndryshimit të interesit bazë	Instrumenti kryesor i përdorur nga Banka e Shqipërisë	Ndryshimi i interesit bazë në pikë përqindjeje	Interesi bazë i Bankës së Shqipërisë
Viti 1997, ndryshuar 8 herë		Interesi i depozitave me afat për bankat me kapital tërësisht shtetëror		
Politikë shtrënguese	30 janar	12-mujore 6-mujore 3-mujore	+3.0 +2.5 +2.0	22.0 21.0 20.0
Politikë shtrënguese	5 mars	12-mujore 6-mujore 3-mujore	+6.5 +7.0 +6.5	28.5 28.0 27.0
Politikë shtrënguese	22 maj	3-mujore	+7.0	34.0
Politikë shtrënguese	27 qershor	3-mujore	+3.0	37.0
Politikë e lehtësuar	18 shtator	3-mujore	-2.0	35.0
Politikë e lehtësuar	10 nëntor	3-mujore	-3.0	32.0
Politikë e lehtësuar	24 nëntor	3-mujore	-2.0	30.0
Politikë e lehtësuar	3 dhjetor	12-mujore 6-mujore 3-mujore	-1.5 -2.0 -4.0	27.0 26.0 26.0
Viti 1998, ndryshuar 5 herë		Interesi i depozitave me afat për bankat me kapital tërësisht shtetëror		
Politikë e lehtësuar	19 maj	12-mujore 6-mujore 3-mujore	-3.0 -2.0 -2.0	24.0 24.0 24.0
Politikë e lehtësuar	18 qershor	12-mujore 6-mujore 3-mujore	-3.0 -2.0 -2.0	21.0 22.0 22.0
Politikë e lehtësuar	24 gusht	12-mujore 6-mujore 3-mujore	-2.0 -2.0 -1.0	20.0 20.0 20.0
Politikë e lehtësuar	22 tetor	12-mujore 6-mujore 3-mujore	-2.0 -2.0 -2.0	18.0 18.0 18.0
Politikë e lehtësuar	12 nëntor	12-mujore 6-mujore 3-mujore	-1.5 -1.5 -1.5	16.5 16.5 16.5

Viti 1999, ndryshuar 6 herë		Interesi i depozitave me afat për bankat me kapital tërësisht shtetëror		
Politikë e lehtësuar	17 shkurt	12-mujore 6-mujore 3-mujore	-1.5 -1.0 -1.0	15.0 15.5 15.5
Politikë e lehtësuar	27 maj	12-mujore 6-mujore 3-mujore	-1.0 -1.0 -1.0	14.0 14.5 14.5
Politikë e lehtësuar	2 qershor	12-mujore 6-mujore 3-mujore	-1.0 -1.0 -1.0	13.0 13.5 13.5
Politikë e lehtësuar	7 korrik	12-mujore 6-mujore 3 mujore	-2.0 -2.0 -2.0	11.0 11.5 11.5
Politikë e lehtësuar	14 shtator	12-mujore 6-mujore 3-mujore	-1.0 -1.0 -1.0	10.0 10.5 10.5
Politikë e lehtësuar	3 nëntor	12-mujore 6-mujore 3-mujore	-1.00 -1.25 -1.25	9.00 9.25 9.25
Viti 2000, ndryshuar 3 herë	Liberalizimi i interesit të depozitave me afat për bankat me kapital tërësisht shtetëror dhe kalimi në përdorimin e ankandeve të repove			
Politikë e lehtësuar	19 janar	12-mujore 6-mujore 3-mujore	-0.50 -1.00 -1.25	8.50 8.25 8.00
Politikë e lehtësuar	29 mars	12-mujore 6-mujore 3-mujore	-0.50 -0.75 -1.00	8.0 7.5 7.0
Liberalizimi i interesave 6-mujor	17 maj			
Politikë e lehtësuar	7 qershor	12-mujore 3-mujore	-0.25 -0.50	7.75 6.50
Liberalizimi i interesave 12-mujor	19 korrik			
Politikë e lehtësuar	27korrik	Repo me shumë çmime & shumë të përcaktuar		9.00
Politikë e lehtësuar	3 gusht	Repo me shumë çmime & shumë të përcaktuar	-1.50	7.50
Politikë e lehtësuar	10 gusht	Repo me shumë çmime & shumë të përcaktuar	-0.50	7.45
Politikë e lehtësuar	17 gusht	Repo me shumë çmime & shumë të përcaktuar	-0.15	7.30
Politikë e lehtësuar	31 gusht	Repo me shumë çmime & shumë të përcaktuar	-0.30	7.00
Politikë e lehtësuar	7 shtator	Repo me shumë çmime & shumë të përcaktuar	-0.10	6.90

Politikë e lehtësuar	5 tetor	Repo me shumë çmime & shumë të përcaktuar	-0.40	6.50
Liberalizimi i interesave 3-mujore	6 tetor			
Viti 2001, ndryshuar 1 herë		Ankandet javore të repove/anasjelltë të repove		
Politikë e lehtësuar	1 mars	Repo me shumë çmime & shumë të përcaktuar		6.5
Politikë neutrale	2 maj	Repo me çmim fiks		6.5
Politikë shtrënguese	22 gusht	Repo me çmim fiks	+0.5	7.0
Viti 2002, ndryshuar 3 herë		Ankandet javore të repove/anasjelltë të repove		
Politikë shtrënguese	21 mars	Repo me çmim fiks	+0.5	7.5
Politikë shtrënguese	10 prill	Anasjelltë repo me shumë çmime	+1.0	8.5
Politikë neutrale	10 dhjetor	Anasjelltë repo me çmim fiks		8.5

Sipas të dhënave të tabelës 1, për periudhën 1997 –2002, Banka e Shqipërisë ka sinjalizuar tregun duke ndryshuar interesin bazë 26 herë ose mesatarisht 4.3 herë në një vit. Nga këto, 22 herë ose mesatarisht 5.5 herë në një vit, i përkasin periudhës 1997 –2000, periudhë në të cilën sinjalizimin e qëndrimit të politikës së saj monetare në treg, e realizonte përmes instrumentit direkt të interesit të depozitave me afat për bankat me kapital tërësisht shtetëror dhe vetëm 4 herë ose mesatarisht 2 herë në një vit, përmes ndryshimit të interesit të instrumentit indirekt të marrëveshjeve të riblerjes njëjavore.

Sinjalet që ka transmetuar Banka e Shqipërisë në treg kanë qenë lehtësuese për pjesën më të madhe të kohës së marrë në shqyrtim. Përjashtim bëjnë viti 1997 dhe viti 2002, ku sinjalet e politikës monetare, në pjesën më të madhe të vitit, kanë qenë shtrënguese. Gjatë vitit 1997, tregu u sinjalizua katër herë për shtrëngime të politikës monetare, ndërsa gjatë vitit 2002 tregu u sinjalizua 2 herë. Edhe pse qëndrimi i politikës monetare është i njëjtë për të dyja periudhat, ndryshimet midis tyre qëndrojnë në mënyrën e transmetimit, në instrumentin e përdorur, në frekuencën e sinjaleve të transmetuara në treg, në masën e ndryshimit të interesit bazë, e cila në vitit 1997 ka qenë konsiderueshëm më e lartë krahasuar me vitin 2002 etj..

Këto qëndrime të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, në të dyja periudhat janë diktuar nga tronditjet që ka pësuar sektori bankar. Konkretisht, nga kriza e sistemit financiar e vitit 1997 pas falimentimit të firmave piramidale, e ndihmuar edhe nga dobësitë e sektorit bankar dhe paniku i depozitave në pranverën e vitit 2002, e cila ishte një ngjarje e pastër e sektorit bankar. Banka e Shqipërisë u pozicionua në rolin e siguruesit të qëndrueshmërisë së sistemit financiar, duke synuar kthimin e besimit të publikut në sistemin bankar.

Rritja agresive e interesit bazë, gjatë periudhës janar - qershor të vitit 1997, tregoi se ishte efektive në kthimin e likuiditetit në sistem. Pas falimentimit të skemave piramidale, të cilat kishin thithur një pjesë të madhe të depozitave, bankat u treguan të shpejta në rritjen e normave të interesit. Shpejtësia e reagimit në drejtim të rritjes së interesave për depozitat me afat ishte e kushtëzuar edhe nga instrumenti i përdorur në atë periudhë, i cili kishte karakter administrativ dhe ishte i detyrueshëm për t'u zbatuar nga bankat me kapital tërësisht shtetëror. Ndërsa bankat e tjera të sistemit ishin të detyruara që të ndiqnin ndryshimet e interesave të bankave me kapital shtetëror për të mos humbur pjesë në tregun e depozitave në lekë, duke mbetur tërheqëse për publikun.

Tabelë 2. Reagimi në tregun e depozitave me afat në lekë, në pikë përqindjeje.

	Interesi depozitave 12 mujore	Interesi depozitave 3 mujore
Periudha janar – mars 1997		
Ndryshimi i interesit bazë	+9.5	+8.5
Masa e reagimit të tregut		
Janar - mars	+6.86	+5.58
Janar - prill	+9.59	+8.51
Periudha maj -qershor 1997		
Ndryshimi i interesit bazë		+10.0
Masa e reagimit të tregut		
Maj - korrik		+9.84
Periudha shtator - dhjetor 1997		
Ndryshimi i interesit bazë	-1.5	-11.0
Masa e reagimit të tregut		
Shtator - dhjetor	-1.17	-7.99

Të dhënat e tabelës 2, tregojnë se në tregun e depozitave shtrëngimi i politikës monetare me 9.5 pikë përqindjeje për

depozitat dymbëdhjetëmujore dhe 8.5 pikë përqindjeje për depozitat tremujore, gjatë periudhës janar- mars, u transmetua rreth 72.2 për qind për depozitat vjetore dhe rreth 65.4 për qind për depozitat tremujore brenda periudhës janar – mars. Ndërsa transmetimi i plotë, në masën 100.0 për qind, u arrit në muajin prill.

Vlen të përmendim se për periudhën në fjalë tregu i depozitave sundohej në masën 93.9 për qind nga bankat me kapital tërësisht shtetëror.

Grafik 1. Sjellja e tregut të depozitave ndaj vendimeve të politikës monetare për vitin 1997 (në përqindje).



Por, kjo rritje administrative e interesave në tregun e depozitave në lekë diktonte rritje të kostos së pranimeve të reja të depozitave për bankat. Mbulimin e kostos së krijuar, bankat e sistemit e transmetuan në tregun primar të bonove të thesarit, duke çuar në një rritje të shpejtë dhe paralele të *yield*-it të bonove të thesarit. Rritja e *yield*-it sipas maturiteteve përputhej me rritjen e interesit të depozitave në lekë për të njëjtat maturitete. Konkretisht, ajo qe më e lartë për bonot e thesarit tremujore, nga 20.4 për qind në muajin janar '97, në 38.22 për qind në gusht[1] (ose 17.82 pikë përqindjeje) dhe më e ulët për bonot dymbëdhjetëmujore, nga 22.5 për qind në janar '97 në 35.5 në muajin gusht '97 (ose 13 pikë përqindjeje).

Tabelë 3. Reagimi në tregun e bonove, në pikë përqindjeje.

	Yield-i i bonove 12-mujore	*Yield*-i i bonove 3-mujore
Periudha janar – mars 1997		
Ndryshimi i interesit bazë	+9.5	+8.5
Masa e reagimit të tregut		
Janar - mars	+9.49	+7.80
Janar - prill	+9.49	+8.92
Periudha maj -qershor 1997		
Ndryshimi i interesit bazë		+10.0
Masa e reagimit të tregut		
Maj - korrik		+8.19
Periudha shtator - dhjetor 1997		
Ndryshimi i interesit bazë	-1.5	-11.0
Masa e reagimit të tregut		
Shtator - dhjetor	-0.50	-2.92

Në dallim nga tregu i depozitave, në tregun e bonove masa e reagimit të tregut është më e lartë brenda periudhës së ndryshimit të interesit bazë, duke treguar për një transmetim më të shpejtë në këtë treg në kahun shtrëngues të politikës monetare. Ndërsa vërehet e kundërta në kahun lehtësues të politikës monetare. Shpejtësia e reagimit në tregun e depozitave është ndjeshëm më e lartë krahasuar me tregun e bonove.

Grafik 2. Sjellja e *yield*-it të bonove të thesarit pas ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë (në përqindje).



Ndërthurja e këtyre tendencave, në kushtet lehtësuese, ka ndikuar në rritjen e diferencave midis interesave respektivë të këtyre tregjeve. Konkretisht, ndërsa diferenca midis interesave të depozitave dhe *yield*-it të bonove tremujore zgjerohet në 4.77 pikë përqindjeje, në fillim të periudhës së shtrëngimit të politikës

monetare, ajo manifeston të njëjtën sjellje edhe gjatë periudhës së lehtësimit të politikës monetare, duke arritur në 6.4 pikë përqindjeje. Luhatshmëria ndaj nivelit mesatar mujor të këtij viti është shumë e lartë. Ndërsa për maturitetin dymbëdhjetëmujor kjo diferencë erdhi duke u zgjeruar nga 3.4 pikë përqindjeje në muajin janar, në 7.2 pikë përqindjeje në muajin dhjetor '97, duke shënuar një nivel mesatar mujor 5.2 pikë përqindjeje. Marzhi i fitimit për këtë maturitet është dukshëm shumë i lartë.

Si periudha e shtrëngimit të politikës monetare ashtu edhe periudha e lehtësimit të politikës monetare janë shoqëruar me zgjerime të diferencës së interesave, duke nxjerrë në pah një treg me nivel të ulët konkurrence dhe ndikimin administrativ mbi nivelin e interesave në tregun e depozitave në lekë.

Grafik 3. Diferenca midis interesave të depozitave dhe bonove të thesarit sipas maturiteteve 3 dhe 12-mujore dhe niveli mesatar, në pikë përqindjeje.



Gjithashtu, krahas luhatshmërisë së diferencës midis interesave për maturitete të njëjta në tregje të ndryshme, evidentohet se marzhi i fitimit ka rezultuar më i lartë për maturitetet afatgjata, kundrejt një marzhi më të ulët për maturitetet afatshkurtra. Ruajtja e këtyre diferencave në marzhet e fitimit për maturitete të ndryshme përbënte një fitim të pameritueshëm për bankat, duke rritur në mënyrë jo të drejtë deficitin buxhetor dhe borxhin e brendshëm.

E njëjta situatë paraqitet edhe në tregun e kredive në lekë. Edhe pse diferenca midis interesave për depozitat dhe interesave për kreditë, pas rritjes së interesave të depozitave mbetej e lartë, bankat i rritën interesat e zbatuar për kredinë në lekë, duke e kaluar një pjesë të kostos së tyre në kreditimin e ekonomisë. Interesi për kredinë nga 6 muaj deri në një vit u rrit nga 24 për qind në janar në 43 për qind në dhjetor (ose 19 pikë përqindjeje), ndërsa interesi për kreditë mbi tre vjet u rrit nga 15.7 për qind në 21.02 për qind (ose 5.32 pikë përqindjeje).

Grafik 4. Sjellja e interesave në tregun e kredive në lekë, në përqindje.



Rritja më e lartë e interesave për depozitat me afat tremujor, krahasuar me dy maturitetet e tjera, u shoqërua me rritjen më të lartë të interesave për maturitetet me afat më të shkurtër, si në tregun e bonove, ashtu edhe në tregun e kredive, duke diktuar rritje të shpejtë të deficitit buxhetor dhe ulje të normës së fitimit të bizneseve të krediduara për periudha afatshkurtra.

Në përgjithësi, transmetimi i vendimeve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 1997, në tregje konsiderohet i shpejtë dhe i plotë me një muaj vonesë në të gjitha tregjet dhe për të gjitha maturitetet. Diferencat e interesave për të njëjtat maturitete në tregje, manifestojnë luhatshmëri të lartë gjatë vitit dhe për maturitetin njëvjeçar një nivel të lartë. Kjo sjellje reflekton prirjen e bankave për të siguruar fitime të larta. Ndërsa luhatshmëria e lartë diktohet nga forma administrative

e sinjalizimit të qëndrimit të politikës monetare në tregun e depozitave. Nga ana tjetër, pozicioni dominues i Bankës së Kursimeve në tregun e depozitave, e bënte edhe më të vështirë konkurrencën e bankave të tjera të sistemit në lojën e interesave në tregun primar të bonove dhe në tregun e kredive në lekë.

Tronditja për të dytën herë e sektorit bankar, nga krijimi i papritur i panikut të depozitave, kushtëzoi vendimet e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë gjatë viti 2002. Kjo situatë u shoqërua me rritjen e parasë jashtë bankave[2], rritjen e presioneve inflacioniste[3], luhatjen e kursit të këmbimit etj.. Paniku i krijuar në rradhët e depozituesve krijoi mungesë të menjëhershme të likuiditetit në sistem, e cila u transmetua në tregun e depozitave, pasi bankat e prekura nga paniku nuk dispononinin likuiditetin e nevojshëm për të mbuluar kërkesat e depozituesve dhe në tregun primar të bonove të thesarit, pasi sistemi bankar nuk plotësonte shumat e ofruara nga qeveria në treg primar[4].

Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë qe e shpejtë dhe e përcaktuar sipas një plani veprimesh. Në treg u ndërhy tërësisht me instrumente indirekte për t'i krijuar tregut të gjithë likuiditetin e nevojshëm. Kështu, u ndryshua pozicioni i Bankës së Shqipërisë nga tërheqëse e likuiditetit në injektuese të likuiditetit, duke mundësuar injektimin me frekuencë të rregullt javore të likuiditetit në treg. Paralelisht u përdorën edhe instrumente të tjera si blerjet dhe shitjet me të drejta të plota, lehtësia e kredisë njëditore, kredia lombard, marrëveshjet e riblerjes njëmujore. Ndërkohë, për të rritur bashkëveprimin midis bankave, u ndërpre gjatë dhjetëditëshit të parë të muajit prill, përdorimi i lehtësisë së depozitës njëditore. Tkurrja e shpejtë dhe e paparashikuar e gjendjes së depozitave në Bankën e Kursimeve dhe në Bankën Kombëtare Tregtare u transmetua dukshëm dhe menjëherë në tregun primar të bonove të thesarit. Nevojat e qeverisë për financim nuk arrinin të plotësoheshin nga tregu. Për pjesën e pambuluar të financimit të brendshëm Banka e Shqipërisë akordoi kredi direkte, duke respektuar kufijtë e lejuar për vitin 2002.

Kjo ndërhyrje në treg, duke plotësuar mungesat e likuiditetit ishte e nevojshme për të garantuar qëndrueshmërinë e sistemit.

Në perspektivë prioritet merrte kthimi i besimit të humbur të publikut në bankat e sistemit. Nisur edhe nga eksperienca e vitit 1997, Banka e Shqipërisë rriti normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes. Deri në mesin e muajit prill, Banka e Shqipërisë sinjalizoi dy herë tregun për shtrëngim të politikës së saj monetare.

Edhe pse sinjalet e politikës monetare ishin shtrënguese, ashtu si dhe gjatë vitit 1997, krahasueshmëria e reagimit të tregjeve paraqet vështirësi në disa drejtime. Konkretisht, rritja e normave të interesit gjatë vitit 2002 nuk ishte në të njëjtat përmasa me atë të vitit 1997, dhe për më tepër, transmetimi i vendimeve në tregun e depozitave ishte indirekt dhe jo administrativisht i detyrueshëm. Mbi nivelin e interesave ndikohej edhe me instrumentet e tjera, gjithashtu, edhe numri i lojtarëve në treg kishte ndryshuar. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë, gjatë vitit 2002, zbatohej vetëm me instrumente indirekte. Tashmë në treg ekzistonte një korridor orientues interesash të tregut dhe tregu ndërbankar, ndonëse jo i formuar plotësisht, kishte një eksperiencë.

Grafik 5. Niveli i interesave të zbatuar nga Banka e Shqipërisë përmes instrumenteve indirekte, në përqindje.



Format krejt të ndryshme të transmetimit të qëndrimit të politikës monetare dhe fleksibilitetit që ofronin instrumentet indirekte të përdorura, krahasuar me ato direkte, diktuan edhe një formë tjetër të sjelljes së tregjeve nga ajo e vitit 1997.



Çdo vendim i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë u shoqërua me rritje të menjëhershme dhe të plotë të interesit të transaksioneve në treg ndërbankar, të diktuara këto nga ndryshimi i korridorit të lehtësive të ofruara. Ndërkohë, në këtë treg kërkesa për likuiditet ishte më e lartë sesa oferta.

Sinjalizimi i tregut për shtrëngim të politikës monetare, i ndërthurur me kërkesën më të lartë për fonde të buxhetit të shtetit krahasuar me vlerën nominale të maturimeve në çdo ankand të vitit të kaluar, kryesisht si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave nga privatizimi, ndikuan në përshpejtimin e rritjes së *yield*-it të bonove të thesarit për të gjitha maturitetet. Rritja e *yield*-eve ishte e menjëhershme, por jo e plotë. Vetëm brenda muajit prill, sinjalet e politikës monetare u transmetuan në masën 81.3 për qind për bonot njëvjeçare dhe 96.0 për qind për bonot tremujore. Në muajin maj, rritja në maturitetin tremujor e kalon rritjen e interesit bazë të Bankës së Shqipërisë. Sjellja e interesave të bonove të thesarit paraqet rritjen më të shpejtë të tyre në afatin e shkurtër të maturimit, duke sjellë një sheshim të kurbës kohore të normave të interesit, e cila zgjati deri muajin gusht. Në përgjithësi, brenda një periudhe dymujore për maturitetet afatshkurtra dhe gjashtëmujore për bonot njëvjeçare u arrit të transmetohej plotësisht sinjali i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në tregun e bonove.

Tabelë 4. Reagimi në tregun e bonove, në pikë përqindjeje.

	Interesi i repove	*Yield*-i i bonove 12 mujore	*Yield*-i i bonove 3 mujore
Periudha mars - prill 2002			
Ndryshimi i interesit bazë	+1.5		
Masa e reagimit të tregut			
Mars - prill		+1.22	+1.45
Mars - maj		+1.31	+1.81
Mars - shtator		+1.78	+2.31
Mars - dhjetor		+3.21	+2.13

Yield-et e bonove të thesarit manifestuan tendenca rritëse në shtator dhe tetor, duke u shoqëruar me rritje më të forta në muajin nëntor[5]. Deri në fund të vitit, llogaritet që *yield*-i i bonove njëvjeçare u rrit sa dyfishi i rritjes së interesit bazë, ndërsa *yield*-i i bonove tremujore llogaritej 1.42 herë më i lartë sesa rritja e interesit bazë.

Grafik 7. *Yield*-i mesatar i ponderuar në treg primar (në përqindje).



Veprimi qe më i ngadalësuar dhe i distancuar në kohë në tregun e depozitave në lekë. Bankat e prekura nga fenomeni i tërheqjes së depozitave reaguan për herë të parë, në muajin maj dhe në përqindje të vogla. Rritja në këto nivele e interesit të depozitave në lekë nga Banka e Kursimeve nuk dha efektet e pritura në reagimin e publikut. Kjo diktoi një rritje të dytë të këtyre interesave gjatë muajit qershor.

Tabelë 5. Reagimi në tregun e depozitave me afat në lekë, në pikë përqindjeje.

	Interesi i repove	Interesi depozitave 12-mujore	Interesi depozitave 3-mujore
Periudha mars - prill 2002			
Ndryshimi i interesit bazë	+1.5		
Masa e reagimit të tregut			
Prill		+0.01	+0.06
Prill - qershor		+0.88	+0.78
Prill - korrik		+0.99	+1.05
Prill - dhjetor		+1.50	+1.07

Deri në fund të muajit korrik ose katër muaj që nga dhënia e sinjaleve në treg, tregu i depozitave i pasqyroi në nivel të kënaqshëm sinjalet e Bankës së Shqipërisë. Sipas maturiteteve, vërehet se sinjalet e politikës monetare në tregun e depozitave u transmetuan në masën 66.0 për qind për depozitat njëvjeçare dhe 70 për qind për depozitat tremujore. Transmetimi i plotë i vendimeve të Bankës së Shqipërisë në tregun e depozitave u shënua në fund të vitit për depozitat njëvjeçare ose vetëm pas 8 muajsh, ndërkohë që u arrit të transmetohej vetëm 71 për qind për depozitat tremujore.

Por, në ndryshim nga viti 1997, diferenca midis interesave të depozitave në lekë dhe *yield*-it të bonove sipas maturiteteve përkatëse, rezulton të jetë dukshëm më e ulët dhe manifeston një luhatshmëri më të vogël. Kjo diferencë paraqitet e qëndrueshme për maturitetin njëvjeçar. Luhatjet e kësaj diference, brenda vitit, kanë qenë në përgjithësi në nivele të ulta dhe janë zgjeruar

Grafik 8. Diferenca midis interesave të depozitave dhe bonove të thesarit sipas maturiteteve 3 dhe 12-mujore dhe niveli mesatar, në pikë përqindjeje.



kryesisht gjatë periudhës së shtrëngimit të politikës monetare. Megjithë tendencën në rritje përgjatë vitit, përsëri ajo është luhatur në kufij të ngushtë, 2.7 –3.3 pikë përqindjeje.

Ndërsa diferenca për maturitetin tremujor është zgjeruar më shumë krahasuar me maturitetin njëvjeçar, duke u rritur nga 1.06 pikë përqindjeje në muajin janar, në 3.23 pikë përqindjeje në muajin dhjetor. Luhatjet e saj kanë qenë më të larta ndaj nivelit mesatar mujor për vitin 2002, duke treguar se bankat janë prirur drejt sigurimit të një fitimi sa më të shpejtë në afat kohor.

Reagimi i tregut të kredive vazhdoi të mbetet i dobët në raport me sinjalet e politikës monetare. Mungesa e likuiditetit në sistem u transmetua dukshëm në tregun primar të bonove të thesarit, por nuk pati efekt në tregun e kreditimit të ekonomisë. Krahas faktorëve të tjerë si, ndryshimi i strukturës së kredive të reja, konkurrenca jo shumë e lartë, përqendrimi i kreditimit kryesisht në valutë, kjo u kushtëzua dhe nga fakti që bankat e prekura nga tronditja kishin një shkallë të ulët ose pothuajse zero të kreditit në lekë. Transmetimi në nivele krejt të ndryshme i mungesës së likuiditetit në tregje, u kushtëzua nga shkalla e ulët ose pothuajse zero e kreditit në lekë nga ana e bankave të prekura nga tronditja dhe nga fakti që 75 për qind e kredisë për ekonominë është kredi në valutë.

Vlerësimet empirike të arritura në këtë material tregojnë se gjatë periudhës së shtrëngimit të politikës monetare, tregjet kanë prirje për të reaguar më shpejt dhe në përqindje më të larta në instrumentet që krijojnë fitime, kundrejt një reagimi më të vonuar dhe gradual në instrumentet që krijojnë kosto, duke konfiguruar në përfundim reagime jo të plota dhe jouniforme me "sferim kohor" të ndryshëm.

Transmetimi i vendimeve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, përgjatë vitit 2002, nga pikëpamja e përqindjeve të reagimit të tregjeve rezulton më e vonuar në kohë sesa ajo e realizuar përgjatë vitit 1997. Megjithatë, siç e theksuam edhe gjatë materialit, periudhat nuk janë të krahasueshme.

Instrumenti bazë i përdorur gjatë vitit 2002, nuk kishte karakter administrativ të detyrueshëm për bankat, por sinjalizonte tregun për qëndrimin e politikës monetare dhe secili treg vepron sipas parimeve të lojës së tregut të lirë.

Sjellja e interesave në tregje të ndryshme reflektoi kushtet e secilit treg, nivelin e kërkesës dhe të ofertës për likuiditet. Ndoshta, transmetimi i vendimeve në tregje mund të ishte më i shpejtë dhe më i plotë, në rast se nuk do të ekzistonte pozicioni dominues i Bankës së Kursimeve në treg, i cili edhe i reduktuar përgjatë vitit 2002, përsëri përbën një pengesë për vendosjen e të gjithë pjesëmarrësve të tregut në të njëjtat pozita.

Më konkretisht, gjatë vitit 2002, u vu re se kjo bankë nuk ishte shumë e interesuar për rritje të larta të interesave të depozitave në lekë. Kjo vonesë në reagim nga ana e kësaj banke, si kryesorja në tregun e depozitave, ndikonte në zgjatjen e afatit kohor të transmetimit të vendimeve të politikës monetare në tregun e depozitave në tërësi. Pra, edhe gjatë vitit 2002, konkurrenca në treg nuk qe aq e fortë për t'i bërë më aktive bankat në drejtim të shpejtësisë dhe të masës së rritjes së normave të interesit. Ky evidentohet si një faktor që ka përkeqësuar transmetimin e sinjaleve të politikës monetare.

Transmetimi indirekt i vendimeve të politikës monetare për ndryshimin e interesit bazë, i ndërthurur edhe me përdorimin e instrumenteve të tjera që ndikonin mbi likuiditetin e sistemit, ka sjellë një reagim natyral të interesave në tregje, duke treguar për rritje të efektivitetit, pavarësisht nga pengesat. Kjo reflektohet në ngushtimin e diferencave midis interesave në tregun e depozitave dhe *yield*-it të bonove të thesarit për maturitetet afatgjata nga 5.2 pikë përqindjeje në vitin 1997, në 3.1 pikë përqindjeje në vitin 2002, ndërkohë që për maturitetin tremujor kjo diferencë është ruajtur në po ato nivele. Gjithashtu edhe luhatshmëria e këtyre diferencave paraqitet më e zbutur gjatë vitit 2002, krahasuar me vitin 1997. Krahas përmirësimeve në kuadrin operacional të Bankës së Shqipërisë, efekt në ngushtimin e diferencave dhe zbutjen e luhatjeve ka dhënë edhe rritja e konkurrencës së bankave në tregun e bonove të thesarit njëvjeçare.

Nga ana tjetër, evidentohet se ndërsa gjatë periudhave të shtrëngimit të politikës monetare ka tendenca për reagime më të shpejta dhe në masa më të mëdha për interesat që sjellin të ardhura kundrejt atyre që krijojnë kosto, në periudhat e lehtësimit të politikës monetare vërehet reagimi i kundërt. Kjo është evidente gjatë vitit 1997. Ndërsa në fund të vitit 2002, edhe pse sinjalet e politikës monetare ishin neutrale, interesat në tregun e bonove vazhduan të rriten, kundrejt një niveli të stabilizuar të interesave të depozitave në lekë. Në të dyja rastet marzhi i fitimit të bankave zgjerohet. Këto momente, megjithë përmirësimet e shfaqura në vitin 2002, mbeten ende pika të dobëta të cilat kërkojnë studime të veçanta.

Faktori që duket se ka peshën kryesore të ndikimit në reagimet e tregjeve ka qenë situata e likuiditetit në sektorin bankar, e cila ka krijuar terren për spekulime me interesat në kushtet kur edhe tregu i kredive në lekë ka qenë pothuajse joaktiv dhe Banka e Kursimeve ruan pozicionin dominues në tregun e depozitave dhe të bonove.

Gjithsesi, evidentohet përmirësimi i efektivitetit të transmetimit të politikës monetare, në faktin që deri në fund të vitit 2002, situata e krijuar nga paniku i depozitave u rikuperua plotësisht dhe besimi i humbur në bankat më të mëdha të sistemit bankar u rikthye, si dhe u përmbushën me sukses objektivat sasiorë dhe objektivi i ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Tregjet arritën të përçonin sinjalet e vendimeve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

SHËNIME

* Suzana Sheqeri, Arta Pisha, specialiste, Departamenti i Kërkimeve dhe Politikës Monetare.

[1] Në muajin gusht, *yield*-et shënuan nivelin më të lartë.

[2] Muajt mars dhe prill u shoqëruan me rritje të shpejtë, prej 16.4 miliardë lekësh.

[3] Rritja e çmimeve u manifestua kryesisht në nivelin e çmimeve të prodhimeve bujqësore, sidomos në rrethet e Vlorës dhe të Fierit, ku edhe fenomeni i tërheqjes së depozitave qe më i theksuar.

[4] Kjo ishte e pritshme, pasi pesha e dy bankave të përfshira në fenomenin e tërheqjes së depozitave në portofolin e bonove të thesarit që zotëronin bankat e nivelit të dytë, llogaritej rreth 89.9 për qind.

[5] Jo vetëm si rezultat i rritjes së kërkesës së qeverisë më shumë se oferta në treg, por edhe i gjenerimit të ngadaltë të likuiditetit pas tërheqjeve masive dhe kostos së krijuar nga pagimi i primit të sigurimit Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Ristrukturimi i sistemit të pagave në Bankën e Shqipërisë
Roland Kajca
Qershor 2004

Godina e Selisë së Bankës së Shqipërisë, Tiranë
Niko Shtrepi
Qershor 2004

2004

Transparenca e Bankës së Shqipërisë
Sofika Note
Shtator 2004

Roli i marrëdhënieve me publikun në audiencat e Bankës së Shqipërisë
Esmeralda Uruçi
Bledar Striniqi
Shtator 2004

RISTRUKTURIMI I SISTEMIT TË PAGAVE NË BANKËN E SHQIPËRISË

*Roland Kajca**

Fjalë kyçe
- Struktura e pagave - Eksperiencë pune - Karrierë - Motivim - Vlerësim -

1. HYRJE

Artikulli studimor që paraqitet në vijim trajton rikonceptimin e sistemit të pagave në Bankën e Shqipërisë. Ky rikonceptim përfshin në mënyrë të detajuar pjesën dërrmuese të strukturës së vjetër të pagave.

Gjatë trajtimit të sistemit të ri janë patur parasysh dhe janë materializuar qëllimi, parimet dhe synimet e përcaktuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë lidhur me politikën e pagave në Bankën e Shqipërisë. Krijimi i strukturës që paraqitet, bazohet konceptualisht në teorinë "pagesë për rezultate" (*pay for performance*).

Në ndërtimin e kësaj strukture të re është realizuar:

1. eliminimi në maksimum i dhënies së të ardhurave pa punë të bërë, të treguar e të pranuar;
2. ruajtja dhe forcimi në maksimum i të drejtave të fituara të çdo anëtari të personelit të Bankës së Shqipërisë, por duke i disiplinuar ato në drejtim të interesit të ndërsjelltë të palëve: individit dhe institucionit.

Arsyeja kryesore e ndryshimit të strukturës së vjetër të pagave është orientimi i vazhdueshëm i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë lidhur me hartimin e një politike të re pagash, e cila të merrte parasysh nivelin aktual të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë dhe realitetet e reja të krijuara në tregun e punës. Por, nxitje për zëvendësimin e saj kanë qenë edhe mangësitë apo problemet e ndryshme që janë vënë re gjatë aplikimit.

Mjaft prej tyre janë konstatuar edhe nga këshilltarët e huaj që kanë këshilluar për një kohë të caktuar Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Juridik pikërisht për këto çështje. Ata kanë lënë edhe rekomandime të ndryshme, që janë reflektuar në të gjitha rastet kur kjo ka qenë e mundur.

Struktura e re e pagave në Bankën e Shqipërisë ka si qëllim kryesor arritjen e objektivave të mëposhtëm.

1. Të vlerësojë sa më drejt arritjet dhe kontributin individual të anëtarëve të personelit dhe ta lidhë këtë vlerësim me pagën e marrë nga secili prej tyre. Si pasojë, konkurrenca ndërmjet anëtarëve të personelit dhe motivimi i tyre për punë më cilësore e rritje profesionale do të ishte më e lartë.[1]
2. Motivimi të jetë i vazhdueshëm, të shtrihet tek të gjithë anëtarët e personelit dhe të japë mundësi për një karrierë të drejtë, jo vetëm vertikale, por edhe horizontale. Në këtë mënyrë së pari, gjithkush do të gjejë veten aty ku ndjehet më i aftë dhe së dyti, do të kemi një element më shumë që do ta bëjë gjithsecilin që të mbetet i interesuar të qëndrojë e të punojë në Bankën e Shqipërisë.
3. Të mbajë në punë anëtarë personeli sa më të kualifikuar dhe sa më të aftë profesionalisht nëpërmjet një sistemi konkurrues pagese dhe të krahasueshëm me vende të njëjta apo të ngjashme pune të tregut aktual të punës.[2]
4. Të tërheqë specialistët më të aftë profesionalisht që gjenden në tregun e punës, duke i motivuar ata për marrëdhënie afatgjata me Bankën e Shqipërisë duke iu ofruar atyre siguri punësimi, shpërblim të drejtë dhe mundësi për rritje profesionale.[3]

2. TË METAT, MANGËSITË DHE PROBLEMET E STRUKTURËS SË VJETËR TË PAGAVE

Paga e përgjithshme bazë në Bankën e Shqipërisë, sipas strukturës së vjetër përbëhej nga paga bazë dhe shtesat mbi të, të strukturuara si në tabelën e mëposhtme (tabela 1):

Tabelë 1. Tabelë përmbledhëse e pagës (paga bazë plus shtesat mbi të) në Bankën e Shqipërisë sipas strukturës së vjetër.

Paga totale bruto →	Paga bruto = Paga bazë + Shtesat mbi pagë							
Elementet e pagës →	Paga bazë	Shtesat mbi pagë						
Elementet e pagës →	Paga bazë	1. Shtesë për vjetërsi pune	2. Shtesë për vjetërsi pune në Bankën e Shqipërisë	3. Shtesë për rëndësi departamenti	4. Shtesë për rezultate në punë (shtesë për performancë)	5. Shtesë për kualifikim shkencor	6. Shtesë për vështirësi të vendit të punës	7. Shtesë për pjesëmarrje në projekt
Masa e secilit element →	Në varësi të vendit të punës	0.4% për çdo vit vjetërsi pune por jo më shumë se 10% gjithsej	1% për çdo vit pune në bankë por jo më shumë se 20% gjithsej	20% për departamentet parësore, 10% për departamentet dytësore	Deri në 20% për rezultatet vjetore në punë	1000 lekë për DSTP 3300 lekë për Doktor 3850 lekë për Profesor i asocijuar 4400 lekë për Profesor	10% dhe 5% për vende të ndryshme pune	Deri 10% për pjesëmarrje në projekte

Sipas kësaj strukture page të gjitha shtesat së bashku, edhe në rastin më të mirë, janë në vlera më të vogla ose të barabarta me pagën bazë. Por, praktikisht ato me vështirësi arrijnë, maksimumi, deri në masën 50-70 për qind të saj. Shtesa e katërt, shtesa e pestë dhe shtesa e shtatë janë shtesa të pasigurta e të lidhura me rezultatet në punë ndërkohë që shtesa e parë, e dytë, e tretë dhe e gjashtë janë shtesa të sigurta, të cilat merren automatikisht. Theksojmë se shtesat e pasigurta përfitohen vetëm nga një pjesë (e vogël) e personelit.

Kjo strukturë pagash është në fuqi prej një kohe relativisht të gjatë dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në arritjen e objektivave të Bankës por ajo, gjithsesi, nuk ka mundësuar një trajtim të përshtatshëm dhe të diferencuar të anëtarëve të saj të personelit.[4]

Si pasojë, me gjithë ndërhyrjet apo rregullimet e herëpashershme në të vihen re të meta, disa prej të cilave (që konsiderohen si më thelbësore) paraqiten në vazhdim së bashku me argumentimin përkatës.

E meta e parë, qartësisht e dukshme e strukturës së vjetër të pagave, është shtesa mbi pagë për vjetërsi të përgjithshme pune (shtesa 1 në tabelën 1)[5].

Së pari shtesa mbi pagë e dhënë për vjetërsi të përgjithshme pune në një profesion të ndryshëm nga ai që anëtari i personelit ushtron në Bankën e Shqipërisë, përbën një kosto joefektive pune. Ajo nuk përfaqëson një vlerësim dhe shpërblim të drejtë të bazuar në aftësi apo kualifikim profesional, elemente këto që janë thelbësore në arritjen e objektivave të Bankës së Shqipërisë. Po japim një shembull, i cili shpjegon më tej arsyetimin e mësipërm:

"Anëtari x i personelit është punësuar në Bankën e Shqipërisë si Përgjegjës Zyre në Departamentin e Burimeve Njerëzore. Më parë se të punësohej në Bankën e Shqipërisë ai ka punuar si administrator në Departamentin e Burimeve Njerëzore të një banke tregtare, si administrator financiar në një kompani private biznesi, si llogaritar në një institucion mjekësor dhe si arkëtar në departamentin e pagesave në një bankë tjetër tregtare."

Ndërsa përvoja e anëtarit në fjalë të personelit si administrator në Departamentin e Burimeve Njerëzore do t'i shërbejë atij pas punësimit në Bankën e Shqipërisë, nuk mund të thuhet e njëjta gjë lidhur me eksperiencën e fituar si llogaritar ose si arkëtar. Prandaj, eksperienca si administrator i burimeve njerëzore duhet të konsiderohet si një element i lidhur me pozicionin e tij të punës në Bankën e Shqipërisë dhe duhet të merret parasysh

gjatë analizës lidhur me punën në këtë pozicion. Ndërkohë që pjesa tjetër e eksperiencës nuk mund të konsiderohet si me vlerë e, si e tillë, nuk duhet të merret në konsideratë

Së dyti, në strukturën e vjetër të pagave eksperienca në punë, trajtohet si një motivues i jashtëm dhe jo si një motivues i brendshëm. Ndërkohë që, motivues të vërtetë janë vetëm motivuesit e brendshëm. Si pasojë, për këtë arsye, duhet të synohet që, aty ku ka mundësi, motivuesit e jashtëm të kthehen në të brendshëm.

Konkretisht, shtesa mbi pagë që përfitohet për efekt të kësaj eksperience jepet "gratis" dhe pa patur nevojë që të tregohet ndonjë vlerë apo punë e çfarëdolloji. Duke iu referuar Teorisë së Herzbergut "Higjena dhe Motivimi", nëse një pjesë e pagës do të jepet falas (sikurse përfitohet sipas strukturës së vjetër të pagave shtesa mbi pagë për vjetërsi të përgjithshme në punë apo për vjetërsi pune në bankë), atëherë ajo vetëm mund të ulë moskënaqësinë në punë (motivim i jashtëm) por nuk mund të rrisë kënaqësinë në të (motivim i brendshëm).

Ndërkohë që do të verifikohej një tjetër pamje nëse eksperienca në punë rikonsiderohet e trajtohet si pjesë e përmbajtjes së punës; për shembull si një element që merret parasysh gjatë analizës për zënien e një vendi pune apo si kriter për promovim (karrierë) (sikurse është në strukturën e re). Në rastin e dytë ajo do të konvertohet e do të klasifikohej në një faktor të vërtetë motivues.

Një e metë e dytë e strukturës në fjalë të pagave identifikohet në shtesën mbi pagë, të bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë.

Kjo shtesë, sipas strukturës së vjetër të pagave, jepet nga Guvernatori bazuar në propozimet e bëra nga eprorët e drejtpërdrejtë dhe nga drejtuesit e tjerë të lartë të bankës. Duke patur parasysh numrin e madh të anëtarëve të personelit të Bankës së Shqipërisë dhe faktin se kjo shtesë jepet për punën e përditshme, një metodë e tillë përfitimi e saj mund të mos rezultojë shumë efektive.

Kjo, sepse titullarët e Bankës së Shqipërisë, para së gjithash, janë përgjegjës për arritjen e objektivave institucionalë (dhe jo departamentalë) si dhe për udhëheqjen e të gjitha veprimeve të Bankës në një mjedis jo të qëndrueshëm (sikurse është ai shqiptar). Si pasojë, atyre u duhet që të fokusohen në shpërndarjen dhe administrimin e të gjitha burimeve të bankës dhe të delegojnë më shumë autoritet në nivelet e ulëta të administrimit.

Delegimi tek drejtuesit e departamenteve i të drejtës për dhënien e shtesës mbi pagë që lidhet me rezultatet në punë, do të ishte një zgjedhje e cila, përveç të tjerave, do t'i jepte më shumë autoritet niveleve përkatëse të drejtimit. Në këtë mënyrë, ata do të bëhen më të motivuar lidhur me përcaktimin e objektivave të departamenteve që ata drejtojnë (të dala nga objektivat e institucionit) dhe me ndarjen, me përmbushjen e me vlerësimin e drejtë të detyrave të personelit që kanë nën mbikëqyrje.

E meta e tretë është se struktura e vjetër e pagave nuk krijon mundësi për karrierë të drejtë horizontale duke mos lejuar (apo edhe penalizuar) kështu, mbi të gjitha, motivimin e mjaftueshëm të atyre burimeve njerëzore që janë të aftë e që, për shkak të mundësive të kufizuara reale për karrierë, nuk kanë mundësi të bëjnë karrierë vertikale.

Më konkretisht, anëtarë të caktuar të personelit gëzonin nëpërmjet strukturës së vjetër të pagave, dhënie automatike shtese mbi pagë bazuar në vjetërsi pune të përgjithshme dhe në vjetërsi pune në bankë. Kjo e drejtë gëzohej pa treguar asgjë dhe pavarësisht nga rezultatet në punë që arrinte gjithsecili prej tyre.

Një analizë sipërfaqësore e kësaj situate do të nxirrte në pah se kemi të bëjmë me një lloj karriere horizontale që i mundësohet kujtdo, por që nuk vë asnjë kusht për ta përfituar. Thjesht mjafton të kesh marrë pagën për një periudhë të caktuar diku ose në bankë.

Një analizë më e kujdesshme do të tregonte se karriera në fjalë është jo e bazuar apo e argumentuar qartë në ndonjë

mënyrë. Gjithkush e ka të lehtë ta kuptojë se të kesh marrë pagën diku nuk përbën ndonjë lloj të veçantë merite, që të mund të shërbejë si kriter për rritje automatike të përvitshme page. Ajo nuk gjeneron ndonjë lloj të ardhure apo nuk ndikon në ndonjë mënyrë në ndonjë burim tjetër të ardhurash, prej të cilave të mund të merret pjesa që i jepet pagëmarrësit. Po ashtu, formalisht, ajo nuk ndikon që të sigurohet qoftë edhe një e ardhur minimale për vetë institucionin.

Praktikisht kemi të bëjmë me një të ardhur, përfitimi i së cilës, në një këndvështrim të caktuar, mund të konsiderohet deri si parazite; si e tillë efekti që ka është demotivues apo edhe dëmtues. Pasi verifikohet që këtë shtesë page e përfitojnë automatikisht njëlloj, si ai që ka patur rezultate të larta në punë edhe ai që është më pak rezultativ apo që nuk impenjohet njësoj me të parin.

Dhe pa dyshim që, në të gjitha këndvështrimet, një sistem i tillë shpërblimi, vetëm punën apo njerëzit që punojnë nuk i nxit, duke krijuar kështu një barazitizëm jo të këndshëm.

E ardhura në fjalë do të kishte kuptim vetëm nëse klasifikohet si element social i pagesës. E shprehur ndryshe, kur pagat janë shumë të ulëta krijohen elemente të tilla shtese në pagë, që të justifikohet rritje e tyre në një nivel të mëtejshëm më të pranueshëm. Në një rast të tillë ajo ka kuptim të ekzistojë. Por, pagat në Bankën e Shqipërisë janë larg të qenit me natyrë sociale apo të ulëta. E si të tilla nuk ka arsye që kjo e ardhur të ekzistojë.

Si përfundim, mund të themi se vitet në punë, në vetvete, nuk kanë asnjë vlerë në drejtimin për të cilin po diskutojmë. Vetëm nëse shoqërohen me elemente të tjera të punës (që sjellin vlerë të re të shtuar) atëherë ato mund të merren në konsideratë, por thjesht për të dhënë mundësi për përfitim, duke krahasuar punën e gjithkujt me atë të të tjerëve.

E meta e katërt që vihet re në strukturën aktuale të pagave është konceptimi dhe vlerësimi që i bëhet shtesës mbi pagë të atyre anëtarëve të personelit që kanë kualifikim shkencor.

Në strukturën e vjetër të pagave vlerësimi material që përfitohej për efekt të kualifikimit shkencor shprehet nëpërmjet një shtese mbi pagë, që vihet re se ka natyrë simbolike. Shumat e përfituara nuk arrijnë të përbëjnë element motivues e, për më tepër, vihet re edhe se konceptimi i tyre nuk i shërben punës në një bankë qendrore.

Nevojitet që kjo shtesë të rikonceptohet rrënjësisht e të shërbejë si një levë e fuqishme në interes të institucionit dhe të individëve të interesuar. Ky rikonceptim, së pari, duhet të synojë të rrisë cilësinë e punës kërkimore në bankë (e cila rezulton përherë e më dominuese në punën e një banke qendrore) dhe së dyti, të krijojë mundësi dhe shtytje reale për kualifikim të vazhdueshëm e prodhimtar të atyre specialistëve, që janë të prirur të zhvillohen në këtë drejtim. Dhe së treti, të mundësojë edhe rritjen e thithjes së këtij segmenti të kualifikuar burimesh njerëzore nga tregu përkatës i punës.

Një problem i pestë (i trashëguar dhe i verifikuar sërish edhe pas disa vrojtimeve të fundit) i strukturës së vjetër të pagave është mungesa e një vertikalizimi të plotë normal të sistemit të pagave dhe pagat relativisht të ulëta, veçanërisht në nivelet e sipërme, krahasuar me pagat për pozicione të njëjta ose të ngjashme të tregut aktual të punës.

Nëse do të bënim një krahasim të pagave të përfituara në nivele të ndryshme drejtuese të Bankës së Shqipërisë me ato në pozicione të njëjta apo të ngjashme me to në mjedise të tjera pune, të krahasueshme me atë të Bankës së Shqipërisë, do të vinim re dallime, të cilat penalizojnë drejtuesit e Bankës së Shqipërisë. Kur, në fakt, duhet të jetë e kundërta. Pasi Banka e Shqipërisë, përveçse është institucion unik dhe kushtetues, rezulton edhe shumë i rëndësishëm për nga profili i punës që kryen apo objektivat që merr përsipër të realizojë.

Për të ilustruar këtë fakt, mjafton të kujtojmë se Banka e Shqipërisë është institucioni që licencon, mbikëqyr dhe kontrollon të gjitha bankat e nivelit të dytë. Ndërkohë që të ardhurat e niveleve drejtuese në këto të fundit janë, nga më

të larta, shumë më të larta, se korrespondueset e tyre (nëse mund të bëhej një paralelizëm i tillë) në Bankën e Shqipërisë. Ndërkohë që normalisht duhej të ishte e kundërta.

E meta e gjashtë është mungesa e një klasifikimi të saktë e të plotë e të gjitha vendeve të punës në Bankën e Shqipërisë, klasifikim i cili do të lejonte një shpërndarje më të drejtë edhe të të ardhurave përkatëse në formën e një shtese mbi pagë.

Në strukturën e vjetër të pagave verifikohet një paradoks i çuditshëm dhe i pajustifikueshëm në lidhje me klasifikimin dhe me trajtimin përkatës material të secilit vend pune. Nga një anë ka një unifikim të atyre të vendeve të punës që mbajnë të gjithë peshën e punës të një banke qendrore (rrjedhimisht verifikohet edhe një unifikim i pagave përkatëse). Nga ana tjetër, ka një "pafundësi" vendesh pune që janë të njëjta apo gati të njëjta për nga rëndësia që paraqesin në arritjen e objektivave të një banke qendrore - e që për më tepër as që mund të krahasohen me të parat - që trajtohen në mënyrë të diferencuar në pagë. E shprehur ndryshe, të gjithë specialistët e bankës (pjesa që mundëson edhe kryerjen reale të punës që lejon ekzistencën e bankës) trajtohen njëlloj me pagë bazë pavarësisht llojit të punës që ata bëjnë (që rezulton e ndryshme në varësi të profilit të departamentit ku ata janë të punësuar). Ndërkohë që trajtohen me pagë të ndryshme bazë deri edhe mirëmbajtësit (në varësi të profilit që ata kanë), shoferët apo edhe pastrueset në varësi të të qenurit në organikën e administratës qendrore apo në degët e saj.

Për të qenë të saktë duhet thënë se ekziston në strukturën e vjetër të pagave një diferencim për të parët (ai që lidhet me shtesën për klasifikim departamenti), por ky diferencim pa dyshim që nuk është i mjaftueshëm në nivelin aktual të zhvillimit të mjedisit të Bankës së Shqipërisë e nuk do të jetë i tillë akoma më shumë në të ardhmen e afërt të saj (kemi parasysh këtu impenjimet afatmesme të marra prej Bankës së Shqipërisë). Dhe për me tepër nuk lidhet me llojin e punës së individit, por me llojin e strukturës ku ai bën pjesë. Nuk duhet harruar këtu të kujtohet se kriteret e përdorura për të realizuar klasifikimin

ekzistues ose mungojnë tërësisht ose janë të pamjaftueshme për të nxjerrë përfundime të sakta.

Niveli i zhvillimit të punës në Bankën e Shqipërisë kërkon një klasifikim të rikonceptuar, i cili duhet të ndryshojë situatën e sipërcituar. Një klasifikim i tillë i plotë, i cili merr parasysh disa kritere vlerësimi (janë tetë të tilla nga maksimumi dy që janë përdorur në klasifikimin e vjetër) është në përpunim e do të paraqitet së afërmi për t'u implementuar.

3. SI DO TË NDRYSHOJË SKEMA E PAGËS ME RISTRUKTURIMIN E SAJ?

Ristrukturimi i sistemit të pagave në Bankën e Shqipërisë u konceptua të realizohej të paktën në dy faza. Kjo, në varësi të zgjidhjes së problemeve të sipërpërmendura dhe të krijimit të një sistemi që të ishte shumë më fleksibël se sa i mëparshmi.

Modeli final synon të ketë pagë bazë sa më të ulët e sistem shtesash të lidhura ngushtësisht me elemente të caktuara të punës, të pranuara këto të fundit si të rëndësishme për të lejuar marrjen e shtesave përkatëse. Sipas këtij modeli, në pagën e përgjithshme bruto, ulet pesha e pjesës së sigurtë të pagës dhe rritet pesha e pjesës së pasigurtë të saj (përfitimi i së cilës lidhet me rezultatet në punë). Konkretisht, do të ulet sa më shumë pesha e pagës bazë dhe e shtesave të sigurta mbi të, ndërkohë që do të rritet pesha e shtesave të pasigurta. Le ta shikojmë më në detaje këtë transformim.

Sipas strukturës së vjetër të pagës kemi këtë ndërtim të saj:

Paga bruto = Pagë bazë + shtesa mbi pagë

Ku:

Paga bazë – është një madhësi e përcaktuar (fikse) në vlerë.

Shtesat mbi pagë – në pjesën dërrmuese janë madhësi të

përcaktuara (fikse) në vlerë dhe jo të lidhura me rezultatet në punë.

Edhe në strukturën e re ruhet po e njëjta skemë e përgjithshme e saj; pra paga e përgjithshme përsëri do të rezultojë si shumë e pagës bazë me shtesat mbi të.

Në mënyrë skematike paga sipas strukturës së vjetër jepet në skemën 1[6]:

Skemë 1. Struktura e vjetër e pagës në Bankën e Shqipërisë.

Paga bruto	=	Pagë bazë	+	Shtesa mbi pagë

Vihet re pesha e madhe e pagës bazë në pagën bruto (krahasuar me pjesën tjetër të saj) dhe pesha e ulët e shtesave në të. Kujtojmë se shtesat janë të gjitha të sigurta, me përjashtim të njërës (asaj për rezultate në punë), e cila përfitohet vetëm nga një pjesë e caktuar (e kufizuar) e personelit. Sipas të dhënave statistikore të viteve të fundit që ne disponojmë, rezulton se kjo shtesë ka një peshë fare të parëndësishme në pagën e përgjithshme.

Sipas modelit të propozuar struktura përmbyset (bëhet fjalë për peshën e elementeve përbërëse të saj) duke marrë formën e paraqitur në skemën e mëposhtme (skema 2):

Skemë 2. Struktura e re e pagës e propozuar në Bankën e Shqipërisë.

Paga bruto	=	Pagë bazë	+	Shtesat mbi pagë

Ku:

Paga bazë – është një madhësi e përcaktuar (fikse) në vlerë, por sa më e ulët.

Shtesat mbi pagë – madhësi sa më pak fikse në vlerë, të

lidhura sa më shumë me rezultate në punë dhe me peshë të përgjithshme sa më të madhe në pagën bruto.

Ndryshon edhe strukturimi i vetë shtesave. Në modelin e vjetër shtesat ishin të strukturuara sipas skemës së mëposhtme (skema 3):

Skemë 3. Struktura e shtesave mbi pagë dhe e peshës përkatëse sipas llojit të tyre në modelin e vjetër

Shtesat mbi pagë	=	Shtesa të sigurta	+	Shtesa jo të sigurta

Vihet re pesha e madhe e shtesave të sigurta dhe pesha e vogël (në praktikë gati e papërfillshme) e shtesave të pasigurta e të lidhura me punën.

Ndërkohë që sipas skemës së re, struktura e shtesave do të ndryshojë si më poshtë (skema 4):

Skemë 4. Struktura e shtesave mbi pagë dhe e peshës përkatëse sipas llojit të tyre në modelin e ri.

Shtesat mbi pagë	=	Shtesë e sigurtë	+	Shtesë pjesërisht e sigurtë	+	Shtesë jo e sigurtë (e varur nga rezultatet në punë)

Edhe këtu vihet re përmbysje e skemës së vjetër. Ulet pesha e shtesave të sigurta dhe rritet pesha e atyre që janë të pasigurta e të lidhura me punën.

Si përfundim, mund të themi se në skemën e re vihen re përmbysje të raporteve të pagës bazë krahasuar me shtesat mbi të dhe mbi të gjitha realizohet ajo që kërkuam më lart: ndryshimi i strukturimit të të gjithë pagës; ulja e peshës së sigurtë të saj dhe rritja e peshës së pasigurtë e të lidhur me punën. Një paraqitje e mundshme skematike e modelit përfundimtar do të ishte ajo në vijim (tabela 2)[7]:

Tabelë 2. Tabela përmbledhëse e pagës (paga bazë plus shtesat mbi të) në Bankën e Shqipërisë sipas strukturës së re.

Paga totale bruto →	Paga bruto = Paga bazë + Shtesat mbi pagë							
Elementet e pagës →	Paga bazë	Shtesat mbi pagë						
Elementet e pagës →	Paga Bazë	1. Shtesë për klasifikim të vendit të punës	2. Shtesë për kategori pune	3. Shtesë për rezultate në punë (i gjithë stafi me përjashtim të drejtuesve)	4. Shtesë për funksione drejtuese (bazuar në rezultate në punë dhe vetëm për drejtuesit)	5. Shtesë për rezultate në punë (lloj tjetër dhe e përfitueshme nga i gjithë stafi me arsim të lartë)	6. Shtesë për kualifikim shkencor	7. Shtesë për pjesëmarrje në projekte, studime e aktivitete
Masa e secilit element →	Në varësi të vendit të punës	Në përpunim (nuk është ende në fazën e implementimit)	Në varësi të kategorisë dhe të pagës bazë	Aktualisht deri në 20%	Aktualisht (me përjashtim të administratorëve (është 0-20%)	Në përpunim (nuk është ende në fazën e implementimit)	Aktualisht sa në strukturën e vjetër (do të synohet të ndryshojnë)	Deri 10% për pjesëmarrje në projekte

Bazuar në skemën e sipërtreguar, përveçse do të ulet masa dhe pesha e pagës bazë në vlerë absolute, do të rritet pesha e shtesave (synimi përfundimtar është që të shkojë në rreth 150 për qind e më tepër në raport me pagën bazë) dhe do të kemi vetëm një shtesë të sigurtë (shtesa për klasifikim të vendit të punës), një shtesë pjesërisht të sigurtë dhe që duhet fituar njësoj si shtesat e pasigurta (shtesa për kategori) dhe pesë shtesa të tjera të pasigurta. Theksojmë se gjashtë shtesat e fundit do të varen nga rezultatet në punë.

Duhet thënë se një pjesë e konsiderueshme e modelit të ri, tashmë është e implementuar. Ndërkohë që është në përpunim faza e dytë e tij, e cila, të paktën në këndvështrimin strukturor, synohet që ta përmbyllë plotësisht atë.

4. TË REJAT KRYESORE TË MODELIT TË RI TË PAGAVE DHE NJË SHPJEGIM I SHKURTËR I TYRE

Të rejat e modelit të ri të pagave lidhen me *rikonfigurimin e klasifikimit* që lejon strukturimin e pagës si dhe me vetë *strukturën* e saj. Trajtohen në vazhdim të rejat kryesore të të dyja drejtimeve të sipërpërmendura.

Ristrukturimi i sistemit të pagave u parapri fillimisht nga një klasifikim dhe rigrupim i vendeve të punës dhe i pagave bazë përkatëse. Risistemim i cili u krye dhe i shërbente vetëm këtij ristrukturimi. Në këtë kontekst, të gjitha vendet e punës u klasifikuan në klasa, grupe dhe nivele. Ky risistemim përbën *të renë e parë* të modelit të ri të pagave.

Futja e konceptit të klasës, të grupit dhe të nivelit ka qëllim identifikues e klasifikues të vendeve të punës. Në strukturën e vjetër të pagave kishte ndarje vertikale të vendeve të punës, por pa i dhënë një emër të vetëm një numri të caktuar syresh kur ata trajtoheshin njëlloj me pagë bazë apo me elementet e tjera të saj.

Për të lehtësuar identifikimin e secilit grup vendesh të njëjta pune (për nga rëndësia) u fut koncepti i "klasës", koncept ky i përdorur gjerësisht për këtë qëllim edhe në struktura të tjera të organizuara (mund të sjellim këtu si shembull klasifikimin aktual në administratën publike shqiptare). Në strukturën e re, me konceptin klasë do të kuptohet një ose më shumë vende pune, të cilat klasifikohen si të njëjta për nga rëndësia që kanë në Bankën e Shqipërisë. Klasa është një klasifikim vertikal i vendeve të punës dhe lidhet me vlerësimin bazë material (pagën bazë) apo me vlerësime të tjera që i bëhen vendit apo grupit përkatës të vendeve të punës.

Në strukturën e re ka dhjetë klasa, tetë prej të cilave janë ekzistuese pavarësisht se nuk identifikohen nëpërmjet këtij koncepti (janë lehtësisht të identifikueshme nëse vihen re pagat e përfituara sipas strukturës së vjetër), ndërsa dy të fundit janë rigrupime të të gjitha vendeve të tjera të punës të të njëjtit lloj

(gjithsej 20 nivele page bazë) e që lidhen me veprimtaritë ndihmëse të punës në Bankën e Shqipërisë.

Nisur nga llojshmëria dhe sasia e madhe e punëve ndihmëse (apo të atyre që sidoqoftë nuk mund të konsiderohen si kryesore në lidhje me punën apo me detyrat kryesore të një banke qendrore), si edhe nga klasifikimi përkatës i tyre (i identifikueshëm vetëm nëpërmjet pagës bazë) këto dy klasa u ndanë në pesë grupe (nënndarje vertikale). Ky rigrupim lejoi kalimin nga 20 nivele pagash bazë të këtyre lloj punëve në vetëm 5 të tilla. Sasi që justifikon edhe rëndësinë e pakët të tyre në llojin e punëve që kryhen në një bankë qendrore. Nuk përjashtohet mundësia që këto grupe të reduktohen akoma më tej.

Duhet thënë se futja e konceptit të klasës lehtëson edhe futjen e konceptit të kategorisë[8]. Koncepti i kategorisë konfiguron një lloj të ri karriere (karrierë horizontale) në Bankën e Shqipërisë. Kjo karrierë nuk ekzistonte sipas strukturës së vjetër të pagave.

Secila klasë e merr emrin nisur nga vendi më i rëndësishëm i punës që bën pjesë në të apo nga karakteristikat më të përgjithshme të punës që lejojnë klasifikimin në të.

Me konceptin e klasës dhe të grupit lidhet edhe paga bazë e të gjithë punonjësve të bankës. Pra, çdo klase (kur nuk ka grupe) dhe çdo grupi (kur ka të tillë), i përket një pagë bazë e caktuar, e ndryshme nga gjithë të tjerat.

Ndërsa me konceptin nivel, në strukturën e re identifikohet një (makro) ndarje vertikale. Klasifikohen brenda një niveli punë të ndryshme që, megjithëse janë aq të ndryshme sa që nuk mund të klasifikohen dot brenda një klase apo grupi, kanë mjaft elemente apo karakteristika të tjera të përbashkëta cilësore, që i dallojnë në grup nga ndarjet e tjera. Për shembull, vendi i punës "Guvernator" dhe vendi i punës "Zëvendësguvernator" dallohen midis tyre për nga shumë elemente. Por, krahasuar me të gjitha vendet e tjera të punës në Bankën e Shqipërisë, ajo që i bashkon është më e fortë se sa ajo që i ndan. Prandaj, në shumë raste, vendet e punës në fjalë identifikohen me një emër të vetëm

dhe pa i ndarë nga njëri-tjetri (termi administratorë). Po kështu, mund të vazhdohet analiza edhe me grupime të tjera. "Drejtorët e departamenteve" dhe "Zëvendësdrejtorët e departamenteve" kanë gati të njëjtën peshë në drejtimin e departamenteve dhe elementet që i bashkojnë janë më të fortë se sa ato që i ndajnë, krahasuar me grupimet e tjera poshtë dhe sipër tyre. Kjo i bën të dallohen qartë si nivel krahasuar me të gjitha vendet e tjera të punës poshtë tyre. Por, ata nuk kanë as karakteristikat cilësore të administratorëve e si rrjedhim, nuk mund të klasifikohen në të njëjtin nivel me ta.

Në strukturën e re të propozuar të vendeve të punës dallohen pesë nivele (vertikale) punësimi. Secili nivel përbëhet nga dy klasa. Qëllimi kryesor i futjes së konceptit nivel, ashtu sikurse edhe në rastin e klasës apo të grupit, është mundësia e trajtimit të klasave përbërëse të ndonjërit apo secilit prej tyre në grup, për efekt të arritjes së qëllimeve të ndryshme të strukturës së re të pagave.

Treguam se tre konceptet e sapotrajtuara janë ndarje vertikale të vendeve të punës. Ato mundësojnë karrierën vertikale të punës në Bankën e Shqipërisë. Por, jo të gjithë e kanë këtë mundësi. Sa më lart të kërkosh të ngjitesh në hierarki aq më e vështirë bëhet ngritja në të. Arsyet janë lehtësisht të kuptueshme për të gjithë, pasi në një departament nuk mund të ketë tre drejtorë dhe tetë zëvendësdrejtorë; vetë natyra e punës nuk e lejon këtë.

Për këtë arsye, në strukturën e re të pagave është futur koncepti i kategorisë, i cili është tërësisht i ri. Kategoria është *e reja e dytë* e modelit të ri të pagave. Në fakt kemi të bëjmë më shumë me përshtatjen e këtij koncepti në kuadrin e ristrukturimit të organigramës së vendeve të punës në Bankën e Shqipërisë dhe jo në futjen e ndonjë koncepti të papërdorur. Pasi edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një nocion gjerësisht të njohur në shumë lloje organizatash.

Kategoria është një ndarje apo një klasifikim që i bëhet secilit vend pune dhe që lejon rritjen e pagës pas periudhave të caktuara kohore e duke u bazuar në vitet në punë dhe, ajo që është më e rëndësishme, në rezultatet në punë. Me marrjen e

kategorisë përfitohet rritja përkatëse e pagës nëpërmjet shtesës me të njëjtin emër. Ndërkohë që mungesa e rezultateve mund të sjellë uljen në kategori apo edhe mosklasifikimin në ndonjërën prej tyre.

Kjo lloj ndarjeje lejon eliminimin e dy shtesave më të përfolura mbi pagë (sipas strukturës së vjetër të pagave); *për vjetërsi të përgjithshme në punë* dhe *për vjetërsi pune në bankë*. Kategoria është një ndarje horizontale e secilës klasë (ose grup). Kjo ndarje nuk do të thotë përparim kryesisht në përgjegjësi (sikurse ndodh në rastin e karrierës vertikale) por përparim kryesisht në profesion (rritje profesionale).

Qëllimi i futjes së konceptit të kategorisë është i shumëfishtë:

- Nëpërmjet kategorisë mënjanohet dhënia falas e dy shtesave të sipërpërmendura. Strukturimi i secilit vend pune në kategori dhe shtesa përkatëse e secilës prej tyre, lejojnë klasifikimin e kësaj të fundit, si faktor real motivues në punë. Theksojmë se është tentuar që sasia e shpërblimit material të përfituar nga klasifikimi në një kategori të caktuar të jetë e njëjtë ose e përafërt me atë të përfituar nga dy shtesat e eliminuara. Vihet re pra që sasi e njëjtë shpërblimi material nuk jepet falas por kundrejt pune të bërë. Kjo sjellje lejon largimin nga konceptimi i strukturës së vjetër ku kjo sasi parash trajtohej si kosto joefektive apo vetëm si zvogëluese pakënaqësie.
- Nëpërmjet futjes së kategorive mundësohet një lloj tjetër karriere përveç asaj vertikale - e quajtur horizontale - e cila mund të përbëjë një motivim më shumë për të qëndruar (apo për të ardhur) në Bankën e Shqipërisë, për të gjithë ata individë që janë apo që ndjehen rezultativë në punën e tyre.
- Kushtëzimi i kalimit në një kategori më të lartë me rezultatet në punë do të nxisë punën në të gjitha nivelet e punësimit, pasi nëse nuk ka rezultate në punë nuk ka ngritje në kategori.
- Nëpërmjet futjes së kategorive realizohet një e drejtë më tepër, jo vetëm për një segment të caktuar individësh, por

për të gjithë anëtarët e personelit të Bankës së Shqipërisë. Bëhet fjalë për të drejtën për karrierë. Për përfitimin e së cilës ka vetëm një kriter të vetëm cilësor matës: rezultatet në punë. Një e drejtë e tillë tregon edhe një impenjim të Bankës së Shqipërisë në drejtim të shtimit dhe të konsolidimit të mundësive për zhvillim të potencialeve të anëtarëve të saj të personelit.

- Rritet fleksibiliteti i sistemit të pagave duke "e copëtuar" atë në funksion të rezultateve në punë; rrjedhimisht, kemi strukturimin e saj sipas kërkesave të *"pay for performance"*.

Paraqitja e marrëdhënieve të krijuara ndërmjet niveleve, klasave, grupeve dhe kategorive jepet në mënyrë skematike në skemën e mëposhtme (tabela 3)[9].

Tabelë 3. Lidhja ndërmjet niveleve, klasave dhe grupeve në strukturën e re të pagave në Bankën e Shqipërisë.

Niveli	Klasa	Grupi	Kategoritë							
Niveli i lartë i drejtimit	Klasa I	Nuk ka							1	2
	Klasa II	Nuk ka							1	2
Niveli i ulët i drejtimit	Klasa III	Nuk ka					1	2	3	4
	Klasa IV	Nuk ka					1	2	3	4
Niveli i shërbimit profesional	Klasa V	Nuk ka			1	2	3	4	5	6
	Klasa VI	Nuk ka	1	2	3	4	5	6	7	8
Niveli i shërbimit të përgjithshëm	Klasa VII	Grupi A	1	2	3	4	5	6	7	
		Grupi B	1	2	3	4	5	6	7	
	Klasa VIII	Grupi A	1	2	3	4	5	6	7	
		Grupi B	1	2	3	4	5	6	7	
		Grupi C	1	2	3	4	5	6	7	

E reja e tretë e modelit të ri të pagave nuk është gjë tjetër veçse "kthim në origjinë". Bëhet fjalë për rifutjen në strukturë të vendit të punës "kryespecialist". Arsyeja kryesore e futjes së këtij vendi pune lidhet me shtimin e mundësive për karrierë vertikale (krahas asaj horizontale) të atyre anëtarëve të personelit, që nuk kanë mundësi për t'u zgjedhur në nivele drejtuese dhe/ose që kanë aftësi të mëdha profesionale. Por, futja e këtij vendi pune lidhet edhe me faktin se në rastin e departamenteve me numër të lartë të punësuarish, mund të lindë nevoja e një klasifikimi më të detajuar të këtyre të fundit në funksion të detyrave që ata kryejnë.

Tre të rejat e mësipërme kishin të bënin me *rikonfigurimin e klasifikimit* që lejon strukturimin e pagës, ndërkohë që të tjerat në vazhdim lidhen me vetë *strukturën e saj*.

Treguam më sipër se skema e pagës mbetet po ajo e strukturës së vjetër; pagë bazë plus shtesa mbi pagën bazë. Ndërkohë që struktura e re, bazuar sidomos në zhvillimin e mjedisit në Bankën e Shqipërisë apo në detyrimin për të realizuar përherë e më mirë detyrat dhe punën në të, (a) redukton nivelet e pagës bazë; dhe (b) eliminon, rikoncepton ose ndryshon shtesat mbi to.

Në strukturën e vjetër verifikoheshin gjithsej 28 nivele page bazë dhe mbi to shtoheshin shtesat e mëposhtme:

- (1) për vjetërsi të përgjithshme pune;
- (2) për vjetërsi pune në bankë;
- (3) për klasifikim departamenti (ose njësie organizative);
- (4) për vlerësimin e rezultateve në punë;
- (5) për kualifikim shkencor;
- (6) për vështirësi të vendit të punës;
- (7) për pjesëmarrje në projekt.

Treguam gjithashtu, se paga bruto sipas strukturës së re përbëhet nga paga bazë plus shtesat e mëposhtme (tabela 2):

- (1) për klasifikim të vendit të punës;
- (2) për kategori pune;
- (3) për vlerësimin e rezultateve në punë;
- (4) për funksione drejtuese;
- (5) për rezultate në punë (e ndryshme nga e mësipërmja);
- (6) për kualifikim shkencor;
- (7) për pjesëmarrje në projekte, studime e aktivitete.

Nga të gjitha shtesat e mësipërme të strukturës së re vetëm shtesa e parë nuk varet nga rezultatet në punë. Ndërkohë që të tjerat, në një mënyrë apo tjetër, kushtëzohen prej tyre në mënyrë vendimtare. Duke bërë të mundur kështu modelimin e plotë të strukturës së re të pagave në Bankën e Shqipërisë sipas konceptit *"pay for performance"*.

Do të shtjellojmë në vazhdim shkurtimisht secilën prej tyre.

(1) Shtesa për klasifikim të vendit të punës është një shtesë ende jo e implementuar dhe në përpunim. Me pak fjalë kjo shtesë bazohet në klasifikimin e të gjitha vendeve të punës në Bankën e Shqipërisë, bazuar në pikët që merr secili prej tyre në tetë kritere që konsiderohen si të mjaftueshme për të mundësuar këtë klasifikim. Ky klasifikim përfshin dhe zëvendëson (duke përmirësuar rrënjësisht dhe konceptualisht) dy nga shtesat e strukturës së vjetër; *shtesën për klasifikim departamenti* dhe *shtesën për vështirësi të vendit të punës*. Kjo shtesë është fikse si madhësi dhe llogaritet mbi pikët që përfiton secili vend pune. Ekziston mundësia që kjo shtesë të suprimojë tërësisht pagën bazë dhe të shërbejë ajo vetë, si kriter kryesor në përcaktimin e pagës bazë.

(2) Shtesa për kategori pune është shtesa e dytë tërësisht e re, e cila tashmë është e implementuar. Kjo shtesë zëvendëson dy shtesa të strukturës së vjetër të pagave, të cilat përfitoheshin automatikisht dhe falas. Zëvendësimi i shtesave në fjalë përbënte një ndër problemet më kryesore që duhej përballuar në konceptimin e strukturës së re të pagave, pasi pesha e tyre në strukturën e vjetër ishte e konsiderueshme. Shtesa për kategori është fikse për secilën kategori dhe e ndryshme për kategori të ndryshme. Ajo përfitohet nëse plotësohen disa kushte, më kryesorja e të cilave, sikurse është thënë edhe më sipër, janë rezultatet në punë.

(3) Shtesa për vlerësimin e rezultateve në punë dhe shtesat e tjera të kësaj natyre që do të tregohen në vijim, pësojnë dhe përbëjnë ndryshime të rëndësishme, shpjegimet e zgjeruara të të cilave meritojnë një material më vete. Madhësia e saj është e ndryshueshme dhe masa e përfituar për një periudhë të caktuar varet vetëm nga rezultatet në punë. Në vijim do të mjaftohemi vetëm me një përshkrim të shkurtër të saj. Ndërkohë që do të trajtohet gjerësisht në një material më vete.

Së pari, kjo shtesë ndryshon "përbërjen" e saj. Përmbajtja e saj është thjeshtuar duke u bërë më e drejtpërdrejtë e duke synuar dhënien në mënyrë më të qartë e më të saktë të asaj që

kërkohet të arrihet. Në këtë kuadër, janë ndarë në dy grupe kriteret dhe kërkesat që mundësojnë vlerësimin dhe marrjen e saj duke dhënë kështu dy formularë tip; një për specialistët me arsim të lartë dhe një tjetër për personelin ndihmës.

Së dyti, kjo shtesë ndryshon "pronarin" që e administron. Sipas strukturës së vjetër të pagave ajo jepej nga Guvernatori, pas propozimit të bërë nga drejtuesit e departamenteve. Ndërkohë që sipas strukturës së re, e drejta e dhënies së saj delegohet tek vetë drejtuesit e departamenteve (apo njësive të cilat janë të barazuara me to). Këta të fundit kanë fuqi të plotë për të përcaktuar masën e kësaj shtese, bazuar kryesisht në realizimin e planit të punës për periudhën që kryhet matja formale e rezultateve në punë por edhe në elemente të tjera të saj, të treguara në formularin që mat këto rezultate.

Së treti, kjo shtesë ndryshon "objektin e saj të interesit". Sipas strukturës së vjetër, kjo shtesë aplikohej vetëm në segmentin e specialistëve me arsim të lartë. Ndërkohë që sipas strukturës së re, ajo aplikohet edhe tek i gjithë personeli ndihmës.

Dhe *së katërti,* kjo shtesë ndryshon "kohën e saj të fuqisë". Sipas strukturës së vjetër ajo përsëritej formalisht një herë në dymbëdhjetë muaj. Ndërkohë që, sipas strukturës së re kjo përsëritje bëhet çdo gjashtë muaj (tendenca është që të kryhet çdo muaj). Qëllimi është i thjeshtë: të përshpejtohet koha e reflektimit në rastin e verifikimit të mungesës së rezultateve.

(4) Shtesa për funksione drejtuese është një shtesë e re që aplikohet për herë të parë në strukturën e re të pagave dhe i adresohet të gjitha niveleve drejtuese të Bankës së Shqipërisë. Kjo shtesë jepet nga Guvernatori në bashkëpunim me administratorët dhe bazohet në cilësinë e kryerjes së punës nga ana e drejtuesve. Edhe masa e përfitueshme e kësaj shtese është e ndryshueshme dhe varet vetëm nga rezultatet në punë.

Aplikimi i saj ka patur dy qëllime kryesore.

I pari është zgjerimi i spektrit të anëtarëve të personelit që përfitojnë të drejtën e shpërblimit për rezultate në punë nga e cila ata janë përjashtuar. Fakt ky që duket i diskutueshëm, pasi argumentet që kanë vendosur lidhur me këtë privim nuk duken përjashtuese (argumente përjashtuese janë ato argumente të cilave nuk mund t'iu përgjigjesh me kundërargumente të të njëjtit nivel cilësor).

I dyti është ai i baraspeshimit të domosdoshëm të decentralizmit të propozuar, në lidhje me dhënien e shpërblimit për rezultatet e arritura në punë. Bëhet fjalë për delegimin e së drejtës për dhënien e tij tek drejtuesit e departamenteve. Ky konfigurim bëhet i domosdoshëm, sidomos për të parandaluar sjelljen e një drejtuesi që mund të bëhet "i mirë" në kurriz të punës. Në verifikimin e një rasti të tillë, Guvernatori mund të penalizojë drejtuesin në fjalë në po atë masë që drejtuesi mund të ketë abuzuar.

(5) Shtesa për rezultate në punë (e ndryshme nga të mësipërmet) është një shtesë e re, e cila është në përpunim. Kjo shtesë do të synojë të masë dhe të vlerësojë rezultate të nivelit makro (në këndvështrimin e objektivave dhe të detyrave që ka Banka e Shqipërisë si institucion) dhe të jetë e ndryshme nga dy të mësipërmet e të njëjtit lloj, vetëm përsa i përket objektit të punës që do të mundësojë përfitimin e saj. Ndërkohë që njëlloj si ato nuk do të jetë fikse dhe e lidhur vetëm me rezultatet në punë.

(6) Shtesa për kualifikim shkencor. Lidhur me këtë shtesë dhe konceptimin e saj ka mendime të ndryshme. Për momentin mbeten në fuqi madhësitë e përcaktuara sipas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 03, datë 19.01.2000. Madhësi që janë fikse e që për t'i përfituar duhen plotësuar kushte që lidhen me rezultate në punë.

(7) Shtesë për pjesëmarrje në projekte, studime e aktivitete. Kjo shtesë është ajo ekzistuese, por e rikonceptuar në funksion të saktësimit më të mirë të qëllimit të saj të përfitimit. Kështu, konceptimi i ri i saj kërkon moskufizimin e spektrit të aktiviteteve

që lejojnë përfitimin e saj dhe që, për arsye të ndryshme nuk mund të marrin emrin "projekt" (emërtimi i vetëm që lejonte përfitimin e saj). Si rrjedhojë, sipas konceptimit të ri kjo shtesë mund të përfitohet nga cilido anëtar i personelit që punon për një studim, për një konferencë apo aktivitet (me çfarëdolloj emri) që kërkon kohë pune shtesë (përtej tetorëshit), më tepër se një muaj dhe paraqet interes për institucionin. Kjo mënyrë rikonceptimi e saj ruan dhe plotëson qëllimin për të cilin është krijuar, duke mos krijuar kufizime të ardhura nga interpretime të mundshme të saj. Dhe njëkohësisht shton spektrin e individëve që mund ta përfitojnë duke mos vënë kufizime që lidhen me formën, me paraqitjen apo me emrin formal të punës që lejon këtë përfitim. Edhe kjo shtesë është fikse; dhe vihet re që është e përfitueshme vetëm kundrejt një pune të bërë e të paraqitur.

Në fazën aktuale të implementuar të strukturës së re të pagave vihet re edhe një shtesë e tetë, e quajtur shtesë për ruajtje të pagës aktuale. Kjo shtesë ka karakter të pastër teknik dhe shpresohet që të eliminohet me miratimin e modelit përfundimtar të strukturës së re të pagave. Qëllimi i futjes së saj ka qenë ekuilibrues i disa aspekteve të fazës aktuale të implementuar, të strukturës së re të pagave.

5. PËRFUNDIME DHE OBJEKTIVA

Si përfundim mund të themi se modeli përfundimtar i strukturës së re të pagave mundëson në praktikë qëllimin e marrë përsipër. Ai konfiguron dhe fragmentizon pagën në funksion të rezultateve në punë dhe të vlerës që ka çdo punë apo vend pune, në hierarkinë e punëve të një banke qendrore.

Në të ardhmen mbetet të rregullohen më tej raportet ndërmjet pagës bazë dhe shtesave mbi të, duke ulur sa më shumë pjesën sociale të saj në "kurriz" të pjesës që lidhet me rezultatet në punë. Ky fakt lejon një lidhje më të mirë e më të saktë të punës së kryer me pagesën. Duke ulur shumën e pagës së sigurtë e duke ngritur shumën e përfitueshme nëpërmjet shtesave mbi pagën bazë (që duhet të synohet të lidhen sa më shumë me objektiva të

matshëm pune) do të mundësohet një rritje e mëtejshme cilësore e impenjimit për të kryer punë rezultative. Duke rritur kështu edhe vlerën psikologjike të parave të përfitueshme nëpërmjet punës.

Një tjetër detyrë mbetet vertikalizimi i mëtejshëm i sistemit të pagave në funksion të rëndësisë që ka secili vend pune, në hierarkinë e vendeve të punës në Bankën e Shqipërisë dhe të pagesës që i bëhet secilit prej tyre në tregun aktual të punës. Ende vihet re një vertikalizim jo i plotë i pagave në Bankën e Shqipërisë, krahasuar me tregun përkatës të pagave. Konkretisht, për vende të njëjta apo të ngjashme pune vihet re ende një pagesë më e ulët në Bankën e Shqipërisë në raport me struktura të tjera të organizuara, që në ndonjë mënyrë mund të quhen si të krahasueshme me të. Dhe kjo mospërputhje rritet sa më shumë ngjitemi në hierarki.

Ky vertikalizim është përmirësuar me strukturën e re por nisur nga dinamizmi i mjedisit, që shërben si model krahasues, do të vazhdojë të jetë në vëmendjen tonë edhe në vitet e ardhshme.

Ndërkohë që modeli i ri i pagave në bankë do të mbështetet nga një sistem shpërblimesh, të cilat do të synohet të afrohen përherë e më tepër me konceptin e pagesës bazuar në rezultate në punë.

SHËNIME

* Roland Kajca, Përgjegjës Sektori, Departamenti Juridik dhe i Burimeve Njerëzore.
Në përgatitjen e këtij materiali kanë ndihmuar edhe z. Artur Lama e zj. Eralda Dume.
[1] Marrë nga rekomandimet e bëra nga z. David L. Schannon dhe z. Iain Thomson, ish-këshilltarë për burimet njerëzore në Bankën e Shqipërisë. Specialistët e mësipërm kanë qenë të dërguar nga FSVC në Bankën e Shqipërisë për ndihmë lidhur me zhvillimin e strategjisë së burimeve njerëzore në Bankë.
[2] Marrë nga rekomandimet e këshilltarëve të huaj.
[3] Marrë nga rekomandimet e këshilltarëve të huaj.
[4] Rekomandimet e këshilltarëve të huaj.
[5] E meta e parë dhe ajo e dytë janë marrë nga rekomandimet e bëra nga z. David L. Schannon dhe z. Iain Thomson.
[6] Në të gjitha skemat madhësia e kuadrateve përkon afërsisht me peshën e secilit përbërës.
[7] Në vijim do të flitet më hollësisht për secilin element të kësaj strukture të re, e cila aktualisht është vetëm pjesërisht e implementuar.
[8] Për këtë koncept do të flitet më hollësisht në vijim.
[9] Paraqitja e kategorive tregon në mënyrë të përafërt edhe periudhën kohore që kushtëzon marrjen e kategorive apo kalimin nga një kategori në tjetrën. Vihet re se sa më lart të ngjitesh vertikalisht (sa më shumë karrierë vertikale që të jetë bërë) aq më të pakta janë mundësitë për të bërë karrierë horizontale. Gjatë diskutimit të aplikimit të kategorive u vendos që të zbatohej ky model krahasuar me një tjetër që lejonte karrierë të barabartë si vertikale ashtu edhe horizontale për të gjitha vendet e punës. Arsyeja kryesore ishte se karriera horizontale, si koncept, u fut edhe si një mundësi apo e drejtë për karrierë për ata punonjës që nuk kishin mundësi të bënin karrierë vertikale. Ndërkohë që adoptimi i modelit tjetër e eliminonte këtë arsye.

GODINA E SELISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË, TIRANË

*Niko Shtrepi**

Fjalë kyçe
- Godina - Morpurgo - Arkitekturë - Racionalizëm - Bankës e Shqipërisë -

TË PËRGJITHSHME

Me konsolidimin e Shtetit të ri Shqiptar në vitet 20-30, krahas rikonceptimit urban të qyteteve dhe në mënyrë të veçantë, të Tiranës, filloi edhe organizimi dhe zhvillimi i administratës shtetërore, sipas modeleve më të zhvilluara të Evropës Perëndimore.

Në këtë këndvështrim, edhe sistemi bankar shqiptar filloi të konceptohej e të konturohej sipas modelit financiar të shteteve perëndimore, për të qenë i gatshëm e t'u paraprinte marrëdhënieve financiare që kishin lindur dhe po ndryshonin me shpejtësi në shtetin, që pak vite më parë kishte fituar pavarësinë.

Në këtë periudhë u ndërtuan në qytetet kryesore të vendit si: Durrës, Vlorë, Korçë, Elbasan etj. godinat e para të personalizuara për bankë. Këto godina, me arkitekturën e tyre të spikatur dhe me pozicionin e saktë urban në qendrat e qyteteve edhe sot mbeten nga veprat më të arrira në fushën e arkitekturës e të ndërtimit administrativ.

Në këtë këndvështrim edhe godina e selisë së Bankës së Shqipërisë, për nga rëndësia e saj në sistemin financiar e bankar,

si banka e bankave, u gjykua të vendosej në godinat që do të formatonin sheshin qendror të kryeqytetit tonë, Tiranës.

Godina e Bankës së Shqipërisë ka një mision të studiuar urban në vendin ku është ndërtuar. Ndryshimi i karakterit të fasadës së bankës nga ndërtesat e tjera të rrugës së Kavajës lajmëron ndryshimin e ambientit urban në hyrje të sheshit qendror të kryeqytetit, duke prezantuar ndërtimin administrativ, tepër të rëndësishëm.

Godina e Bankës së Shqipërisë ka përfunduar së ndërtuari në vitin 1938. Projekti i godinës është realizuar nga arkitekti i njohur i asaj periudhe, italiani Vittorio Ballio Morpurgo. Stili arkitektonik i saj i përket rrymës së "Racionalizmit", rrymë e cila lulëzoi në gjysmën e parë të shekullit tonë në Evropë. Ky stil shquhet për vëllimet e mëdha dhe për linjat e forta në fasada. Kryesisht ai është aplikuar në ndërtimet shtetërore me funksion administrativ zyrtar dhe synonte të shprehte forcën e qeverive perëndimore të asaj kohe. Në këtë këndvështrim edhe godina e Bankës së Shqipërisë bën pjesë në ndërtimet më të spikatura të asaj kohe në llojin e vet, rrymës Racionaliste.

PAK MBI RRYMËN RACIONALISTE NË ARKITEKTURË

Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, Evropa duhet të përballonte probleme të mëdha në fushën e rikonstruktimit, të cilat shoqëroheshin me një *boom* demografik dhe si rrjedhim, me kërkesë të madhe për banim. Për këtë arsye, lindi "Protorazionalizmi" i cili deri në atë periudhë i ishte dedikuar zgjidhjes së problemeve abstrakte të karakterit estetik. Përfaqësuesit e kësaj rryme, në këtë periudhë, filluan të merren me zgjidhjen e problemeve praktike të prodhimit në seri, të përdorimit të materialeve të reja të ndërtimit, përdorimit të parafabrikateve në mënyrë që të ofronin produkte konkurruese dhe ekonomikisht të pranueshme. Ky ishte edhe fillimi i "Racionalizmit" të vërtetë që përkufizohet si shfrytëzim razional i ambientit me burimet e disponueshme.

Eksperimentimi i parë me këto forma të reja arkitektonike, që futi panelet modulare të xhamit dhe skelete prej çeliku dhe betoni filloi në ndërtimet industriale dhe pati si protagonist të parë Walter Gropius, i cili ishte instruktuar në shkollën Protorazionaliste të arkitektit P. Behrens. Gropius krijoi mbi bazën e eksperiencave racionaliste, në vitin 1919, në Waimar "BAUHAUS" , një shkollë arkitekture dhe të arteve të aplikuara, e cila jo vetëm që mblodhi intelektualë dhe artistë të famshëm të kësaj epoke si Kandinsky dhe Klee, por vuri dhe bazat e dizenjos moderne dhe të një qendre të debatit mbi arkitekturën.

Utopistët dhe arkitektët e arkitekturës abstrakte si për shembull, Tatlin dhe ato, neoplasticiste si për shembull, Rietveld si dhe piktorët e përfaqësuar nga Malevic dhe Mondrian ishin të ndikuar nga studimi i perfeksionit formal, bilancimit kromatik dhe kompozimit abstrakt.

Bauhaus mori pjesë me sukses të madh në ekspozitat prestigjioze të kohës, ndër të cilat "Werkbund" në vitin 1927 në Stuttgart ku të gjithë racionalistët projektuan një lagje prototip të mënyrës së ardhshme të banimit. Për herë të parë u ekzekutuan projekte të futuristit Sant Èlia, nga të cilat lindën ambiente komplete të një komforti modern.

Idetë e racionalistëve nëpërmjet avanguardistëve gjermanë e influencuan edhe arkitekturën ruse të atyre viteve (pas revolucionit të Tetorit). Idetë e racionalistëve vazhduan të jetojnë dhe arritën me sukses të ekzekutohen edhe nga përfaqësuesi i famshëm i kësaj periudhe arkitektonike Le Corbusier, i cili ishte formuar në Bauhaus dhe në fillim ishte krejt utopist, pastaj u dallua si një zhvillues konseguent i programeve metodologjike të projektimit.

Nëse Adolf Hitleri i konsideronte eksperimentet brilante të racionalistëve si degjenerim i artit, në Itali ndodh e kundërta, me marrjen e fuqisë nga Mussolini vihet nën kontroll të fashizmit edhe arkitektura dhe zhvillimi i saj. Mussolini hedh tezën se fashizmi është një shtëpi qelqi, ku gjithçka është transparente dhe, mbi bazën e këtij parimi, vë në konkurrencë pothuajse të

gjitha rrymat ekzistuese arkitektonike për të zgjedhur dhe për t'i dhënë mundësi zhvillimi asaj rryme që përfaqëson më së miri idetë i tij. Për Mussolinin kishte rëndësi zgjimi i koshiencës mbi Romën e viteve të arta të saj dhe mbi bazën e kësaj periudhe të ndritshme, ndërtimi i një shoqërie të re glorioze.

Nën këtë përkrahje apo frymë, në këtë periudhë në Itali vlen të përmendet krijimi i Gruppo 7, i cili u krijua si reaksion kundër "Akademizmit". Ky grup duke u orientuar në dy epoka të rëndësishme të artit, në antikën dhe në rilindjen (rinashimento), realizoi aktualizimin me arkitekturën moderne botërore.

Kjo filozofi etike dhe estetike është pothuajse e njëjtë me filozofinë ideologjike të Mussolinit, prandaj lind lëvizja moderne fashiste në Itali, e cila duke thithur nevojën e një diçkaje të re, mbyll marrëdhëniet me lëvizjet e mëparshme artistike të konsideruara si kaotike, orientohet në periudhat e arta të historisë së Italisë dhe kërkon të drejtën e absolutizmit të bazuar në totalitarizmin dhe universalizmin, pranohet menjëherë nga fashizmi.

Në Casa del Fascio materializohet komplet i gjithë programi i lëvizjes dhe konsiderohet si etapa më e lartë e procesit të civilizimit. Giuseppe Terragni përfaqëson dhe drejton modernen italiane të bazuar në arkitekturën racionale. Ato inkorporojnë materializimin e një individi (Mussolinit) me ideologjinë e ngurtësuar nga materia. Gjithçka nënvizohet nga monumentaliteti dhe nga injorimi, pakuptimshmëria personale si individë njerëzorë të lidhur me sistemin ideologjik.

SELIA E BANKËS SË SHQIPËRISË

Prezenca e kësaj godine racionaliste në sheshin qendror të Tiranës, që mban emrin e luftëtarit të famshëm të mesjetës "Skënderbej" e ka justifikuar plotësisht respektin e qytetarëve të Tiranës dhe të të gjithë shqiptarëve.

Në projektidenë e saj, godina ishte e konceptuar me planimetri shumëkëndëshe dhe e ndarë nga ana funksionale në dy pjesë, në korpusin kryesor të harkuar, që do të kryente funksionin prezantues të bankës dhe në pjesën operative të saj. Kjo e fundit do të ndërtohej në të dy krahët anësorë të prapëm të korpusit kryesor, por nuk arriti për shkak të problemeve e ndryshimeve që shkaktoi Lufta e Dytë Botërore.

Korpusi kryesor i saj është i ndërtuar në formën e një harku, i detyruar nga pozicioni në hyrje të sheshit kryesor të qytetit. Hyrja e saj kryesore është realizuar me një portal madhështor i mbështetur në kolona të forta, që përfshin të gjithë lartësinë e fasadës dhe të zbukuruar me relieve murale në argjilë të pjekur në ngjyrën karakteristike të saj, që në kompleks i jep një paraqitje shumë dinjitoze godinës.

Në organizimin dhe funksionimin e aktivitetit të bankës, krahas godinës komplekse me të dyja pjesët e saj, parashikohej edhe ndërtimi i një pallati rezidencial për banimin e punonjësve të bankës, i vendosur sa më pranë saj.

Sipas studimit urban të atyre viteve, kjo godinë me projekt të realizuar po nga arkitekti Morpurgo ishte gjykuar të ndërtohej përbri godinës së Parlamentit Shqiptar (sot Teatri i Kukullave).

GJENDJA AKTUALE

Aktualisht, selia e Bankës së Shqipërisë përbëhet nga korpusi i saj qendror në formë harku dhe nga dy shtesa të vogla (do të prishen pas rikonstruksionit) që janë ndërtuar në periudha të ndryshme të mëvonshme, për të përballuar rritjen e numrit të personelit operativ të saj.

Ndryshimet e mëdha që shoqëruan fillimin e viteve 90-të, impononinkrijimin e institucioneve prestigjioze demokratike, njëri prej të cilëve do të ishte banka qendrore e vendit. Për rrjedhim, në prill të vitit 1992, krijohet Banka e Shqipërisë, të cilës, ashtu si simotrave të saj kudo në botë, iu besuan

funksione jetike për zhvillimin ekonomik dhe financiar të vendit.

Krahas emetimit të monedhës kombëtare, Banka e Shqipërisë gëzon dhe privilegje të tjera, ku më të spikaturat janë konceptimi dhe zbatimi i politikës monetare si dhe mbikëqyrja e sistemit bankar. Pavarësisht sa më sipër, ajo që bie në sy ka të bëjë me faktin se në rrjedhën e viteve, Banka e Shqipërisë ka ardhur duke u rritur profesionalisht dhe nuk përbën ndonjë ekzagjerim fakti, që sot ky institucion është një nga qendrat pararojë të mendimit ekonomik dhe të punës kërkimore.

Në kushtet e kufizimeve të mëdha hapësinore me të cilat përballemi aktualisht, konstatojmë se aktiviteti i përditshëm i Bankës, po has pengesa artificiale, të cilat në një mënyrë ose në një tjetër po ndikojnë në performancën e Bankës së Shqipërisë. Në qoftë se do të bënim një përgjithësim të pasojave do të listonim:

1. Godina me sipërfaqen ndërtimore totale ekzistuese të saj nuk përballon aktivitetet që kryen si bankë qendrore.
2. Godina ekzistuese është e amortizuar fizikisht pothuaj në të gjitha elementet e saj arkitektonike (kryesisht në rifiniturat e ambienteve të brendshme) dhe moralisht e fizikisht në ato instalative (kondicionim-ventilim, teknologji-informacioni, sistemi funksional i furnizimit me energji elektrike etj.).
3. Nuk përballon rritjen e numrit të punonjësve si dhe krijimin e kushteve të nevojshme në realizimin e aktivitetit sipas një tipologjie e infrastrukture të brendshme bashkëkohore.
4. Nuk realizon një nivel sigurie sipas kërkesave të kohës, për pjesë të veçanta të saj dhe të godinës në tërësi.

Për zgjidhjen e problemeve të mësipërme, Banka e Shqipërisë ka vendosur që krahas rikonstruksionit të godinës ekzistuese (65-vjeçare) të ndërtojë një godinë të re, sa më pranë saj.

---

* Niko Shtrepi, specialist, Departamenti i Administrimit.

TRANSPARENCA E BANKËS SË SHQIPËRISË

*Sofika Note**

Fjalë kyçe
- Transparencë - Indeksi i transparencës - Informacion - Të kuptuarit e publikut -

1. HYRJE

Dekadën e fundit është vënë re një prirje e bankave qendrore për të qenë gjithnjë e më shumë të hapura ndaj publikut, përsa i përket punës dhe procesit të vendimmarrjes. Transparenca është bërë një çështje e rëndësishme e bankingut qendror dhe rëndësia e saj për politikën monetare është një temë e trajtuar gjerësisht në literaturën akademike të bankave qendrore. Ajo merr më shumë rëndësi sidomos në implementimin e regjimit të inflacionit të shënjestruar. Gjerësisht pranohet se transparenca është e rëndësishme për politikën monetare në dy drejtime kryesore: rritjen e përgjegjshmërisë dhe rritjen e efektivitetit të politikës monetare. Por, duhet patur gjithmonë kujdes që transparenca të mos kthehet në qëllim në vetvete. Ajo është dhe duhet të mbetet një mjet për të përmbushur objektivin final të politikës monetare.

Banka e Shqipërisë e ka vlerësuar rëndësinë e transparencës për politikën monetare dhe i ka kushtuar rëndësi punës për rritjen e nivelit të saj, sidomos vitet e fundit. Në këtë material është bërë një përpjekje për të dhënë një vlerësim për nivelin e transparencës së Bankës së Shqipërisë sot, duke e krahasuar atë me bankat e tjera qendrore dhe me nivelin e transparencës

së vetë Bankës së Shqipërisë përpara vitit 1997. Kjo bëhet e mundur me anë të një indeksi transparence, të ngjashëm nga natyra me indekset e pavarësisë. Vlerat e tij për Bankën e Shqipërisë tregojnë një rritje të konsiderueshme të transparencës së saj, krahasuar me periudhën përpara vitit 1997 dhe një nivel relativisht të mirë, 8.5 nga 15 gjithsej, krahasuar me bankat e tjera qendrore, duke konsideruar edhe nivelin e zhvillimit ekonomik dhe atë të sistemit financiar në Shqipëri.

Materiali është organizuar në mënyrë të tillë: Në seksionin e dytë trajtohet rëndësia e transparencës për bankën qendrore. Në seksionin e tretë jepet përkufizimi i transparencës. Në seksionin e katërt paraqitet llogaritja e indeksit të transparencës për Bankën e Shqipërisë. Seksioni i pestë trajton të kuptuarit e publikut në Shqipëri, si përmasë e rëndësishme e transparencës, si dhe rolin e ndërmjetësve në tejçimin e informacionit. Së fundi, seksioni i gjashtë konkludon.

2. RËNDËSIA E TRANSPARENCËS

Ekonomistët mbështesin gjerësisht mendimin se transparenca është e rëndësishme për një bankë qendrore për dy arsye: rritjen e përgjegjshmërisë së saj lidhur me pavarësinë dhe rritjen e efektivitetit të politikës monetare.

2.1 TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJSHMËRIA

Transparenca është një element që ndihmon rritjen e përgjegjshmërisë në kushtet kur niveli i pavarësisë në hartimin e politikës monetare është i lartë. Duke pasur parasysh prirjen e politikanëve për të përdorur politikën monetare për interesat e tyre afatshkurtër, dekadat e fundit po bëhet gjithmonë e më qartë që bankat qendrore kanë nevojë për një shkallë të konsiderueshme pavarësie për të kryer detyrën e tyre në mënyrë sa më efektive. Nga ana tjetër, kjo pavarësi duhet të shoqërohet me përgjegjshmëri kundrejt shoqërisë ose të paktën kundrejt përfaqësuesve të zgjedhur të saj. Për të siguruar

përgjegjshmërinë e një banke qendrore të pavarur krijohen marrëveshje të veçanta. Megjithatë, cilatdo qofshin marrëveshjet për një përgjegjshmëri demokratike të bankës qendrore, efekti i tyre është i kufizuar pa transparencën, sepse informacioni që lidhet me sjelljen e bankës qendrore është i rëndësishëm për të gjykuar mbi punën e saj (Eijffinger, Hoeberichts, 2000). Transparenca ndihmon që publiku të kuptojë se çfarë bën banka qendrore dhe pse, duke i dhënë kështu mundësinë atij të vlerësojë performancën e saj. Kështu, një bankë qendrore duhet të raportojë në intervale periodike për performancën e kaluar dhe për planet e politikës monetare në të ardhmen. Për vetë rolin e saj në rritjen e përgjegjshmërisë, transparenca nuk duhet lënë në zgjedhjen e bankës qendrore. Është e nevojshme që ligji të përcaktojë procedura për shpjegimin e veprimeve të politikës monetare nga ana e bankës qendrore.

2.2 TRANSPARENCA, BESUESHMËRIA DHE EFEKTIVITETI I POLITIKËS MONETARE

Nevoja për transparencë nuk lind vetëm nga kërkesa për përgjegjshmëri ndaj një banke të pavarur. Ajo, nëpërmjet përmirësimit të besueshmërisë, rrit efektivitetin e politikës monetare (Issing, 2001).

Transparenca siguron mbështetjen e gjerë të publikut për arritjen e objektivit kryesor, duke e shndërruar atë në një aleat të bankës qendrore. Në këtë mënyrë, ajo ndikon në sjelljen e publikut lidhur me pagat dhe me çmimet, duke lehtësuar arritjen e objektivit final të politikës monetare.

Rëndësia e transparencës dhe e besueshmërisë justifikohet edhe nga teoria e pritjeve racionale. Duke marrë parasysh pritjet racionale, një bankë plotësisht e besueshme mund të ndjekë një politikë disinflacioniste, pa patur kosto të padëshirueshme në papunësi (Taylor, 1983; Ball, 1991). Transparenca redukton asimetritë e informacionit mbi gjendjen e ekonomisë dhe perspektivën e vendimeve të politikës monetare mes bankës qendrore dhe sektorit privat, duke ndihmuar kështu në rritjen e parashikueshmërisë. Shumica e bankave qendrore kontrollojnë

normat afatshkurtra të interesit, por, ashtu siç tregojnë faktet teorike dhe empirike, janë normat afatgjata të interesit ato që kanë më shumë rëndësi në ekonomi. Normat afatgjata, ndër të tjera, reflektojnë edhe pritjet për interesin afatshkurtër në të ardhmen, si dhe primin e pasigurisë. Nëse autoriteti monetar është më i qartë lidhur me faktorët dhe kushtet që mund të ndikojnë politikën monetare, atëherë pjesëmarrësit e tregut mund të përmirësojnë pritjet e tyre për interesat në të ardhmen. Gjithashtu, mirinformimi për politikën monetare mund të ulë edhe primin e pasigurisë në normat e interesit. Si rrjedhojë, pas publikimit të informacionit, lëvizjet e tregut i paraprijnë dhe janë konsistente me veprimet që do të ndërmarrë banka qendrore në vijim (Freedman, 2002). Në këtë mënyrë, transparenca ndihmon në afrimin e normave afatgjata të interesit drejt normës së synuar nga hartuesit e politikës monetare.

3. PËRKUFIZIMI I TRANSPARENCËS

Transparenca është një koncept i gjerë dhe jo i lehtë për t'u përkufizuar. Shumë autorë japin përcaktime të ndryshme të transparencës, megjithatë në literaturën mbi politikën e bankave qendrore mund të dallohen dy të tillë. Geraats (2000) e përkufizon transparencën e bankës qendrore si shkallën e dhënies së informacionit mbi procesin e politikës monetare. Publiku duhet të zotërojë të njëjtin informacion që përdor edhe banka qendrore për realizimin e politikës monetare. Sipas këtij përcaktimi, sa më shumë informacion të japë një bankë qendrore, aq më shumë transparente është ajo. Ky përkufizim i transparencës mund të konsiderohet si shumë i gjerë dhe çdokush që i futet më thellë çështjes së transparencës mund të kuptojë se vetëm të japësh informacion dhe të jesh i hapur me publikun nuk sjell efektet e dëshiruara për bankën.

Winkler (2000), shkon më tej në përcaktimin e transparencës. Ai e përkufizon atë si "*shkalla e të kuptuarit të procesit të politikës monetare dhe vendimeve të saj nga publiku*". Sipas Winkler, vetëm dhënia e informacionit nuk është transparencë. Ajo arrihet atëherë kur publiku e kupton informacionin e dhënë nga banka

qendrore. Winkler dallon 3 aspekte të transparencës, *vërtetësinë* e informacionit të dhënë, *qartësinë* e tij dhe *të kuptuarit e njëjtë të informacionit* nga publiku dhe nga banka qendrore.

Vërtetësia e informacionit nënkupton që informacioni i dhënë nga banka qendrore për publikun duhet të jetë i njëjtë me informacionin që qarkullon brenda vetë bankës qendrore, pa ndryshime apo cungime të qëllimshme të tij. Ky aspekt i transparencës sipas Winkler është deri-diku i njëjtë me përkufizimin e transparencës nga Geraats.

Që informacioni të jetë *i qartë* do të thotë që ai të thjeshtohet, të strukturohet dhe t'i komunikohet publikut në mënyrë të tillë që të mos lihet vend për keqinterpretime. Qartësia e informacionit bëhet sidomos e rëndësishme kur ai iu paraqitet auditoreve të ndryshme.

Të kuptuarit e njëjtë të informacionit nënkupton që informacioni i dhënë nga banka qendrore, në mënyrë që të jetë efektiv, duhet të kuptohet dhe interpretohet nga publiku ashtu siç kuptohet dhe interpretohet nga vetë banka qendrore. Kjo kërkon një shkallë të caktuar të formimit të publikut, e cila mund të vijë si rrjedhojë e vetë interesimit të tij ose si rezultat i veprimtarisë së vetë bankës për të nxitur këtë edukim.

Skema e paraqitur në f*igurën 1*, tregon rrugën e informacionit që del nga banka qendrore për tek publiku në çdo hap të procesit të hartimit dhe të zbatimit të politikës monetare, si dhe efektet e tij në krijimin e pritjeve të publikut dhe për rrjedhojë, në rezultatin final të politikës monetare.

Shigjetat me vija të ndërprera përfaqësojnë informacionin që merr publiku nga banka qendrore, i cili, në mënyrë që të kemi të bëjmë me transparencë, duhet t'i ketë të tre aspektet: vërtetësi, qartësi dhe të kuptuarit e njëjtë. Shigjetat me pika tregojnë krijimin e pritjeve të publikut dhe ndikimin e tyre në arritjen e rezultatit të politikës monetare. Në mënyrë që pritjet e publikut të jenë sa më racionale, ai duhet të marrë informacion nga të gjitha hallkat e procesit të politikës monetare. Kështu, publiku

duhet të dijë se cilët janë objektivat e bankës qendrore, cila është strategjia e politikës monetare për të arritur këta objektiva, si dhe si e pse merren vendimet mbi veprimet e bankës. Publiku duhet të ketë mundësi për të zotëruar edhe informacionin bazë mbi të cilin banka qendrore mbështet vendimin e saj. Kalimi i një pjese të konsiderueshme të të gjithë informacionit nga banka qendrore tek publiku, realizohet nga ndërmjetësit, kryesisht media. Si rrjedhojë, edhe ata kanë ndikimin e tyre, ndonjëherë edhe të madh, në formimin e pritjeve të publikut. Rezultati përfundimtar është rezultant i veprimeve të bankës qendrore dhe i pritjeve të publikut.



4. LLOGARITJA E INDEKSIT TË TRANSPARENCËS

Transparenca e bankës qendrore është një koncept cilësor. Ta matësh atë nga ana sasiore nuk është e lehtë. Ekonomistë të ndryshëm janë përpjekur ta masin transparencën nëpërmjet indekseve, llogaritja e të cilëve bazohet në ngritjen e disa pyetjeve dhe vlerësimin e përgjigjeve përkatëse me pikë. Ndër autorët e këtyre indekseve mund të përmendim: Eijffinger, De

Haan, Amtenbrink (1999), Gros & Bini-Smaghi (2001), Eijffinger & Geraats (2003), De Haan & Amtenbrink (2003). Për të matur transparencën e Bankës së Shqipërisë është zgjedhur indeksi i krijuar nga Eijffinger dhe Geraats (2003), pasi është më i plotë dhe më gjithëpërfshirës, duke e trajtuar transparencën në më shumë aspekte, ndërkohë që autorët e tjerë përqendrohen në aspekte apo grupaspekte të veçanta.

4.1 METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË INDEKSIT

Në llogaritjen e indeksit të transparencës, Eijffinger dhe Geraats (2003) e konsiderojnë transparencën si "*shtrirja e dhënies së informacionit nga banka qendrore, i cili ka të bëjë me procesin e hartimit dhe të zbatimit të politikës monetare*". Autorët identifikojnë disa lloje të transparencës, ku secili i përket një hallke të caktuar të procesit të realizimit të politikës monetare. Si rrjedhojë, ata përcaktojnë më parë fazat e ndryshme të procesit të marrjes së vendimit në politikën monetare dhe më pas, llojin e transparencës që i përket secilës prej tyre. Nga ky këndvështrim, autorët identifikojnë 5 lloje të transparencës: transparencën politike (të objektivit), transparencën e të dhënave dhe modeleve, transparencën procedurale (të marrjes së vendimeve), transparencën e veprimeve dhe transparencën operacionale. Një përparësi e rëndësishme e indeksit mund të konsiderohet pikërisht dallimi që ai bën mes llojeve të ndryshme të transparencës, duke mundësuar analiza të mëtejshme mbi rolin që luan ajo në procesin e marrjes së vendimeve të politikës monetare.

1. Transparenca politike (e objektivit) ka të bëjë me qartësinë e objektivave të politikës monetare. Ajo përfshin përkufizimin e qartë të *objektivit formal* të politikës monetare, përcaktimin e prioritetit në rast se ka disa objektiva që krijojnë konflikt me njëri-tjetrin, si dhe *përcaktimin sasior* të objektivit përfundimtar. Transparenca politike nxitet nga *marrëveshjet institucionale*, si pavarësia e bankës qendrore, marrëveshjet (kontratat) e bankës qendrore dhe mekanizmi i anashkalimit të veprimeve të bankës qendrore, sepse ato

minimizojnë influencën apo presionet politike të tepruara në arritjen e objektivit/objektivave të politikës monetare.

2. Transparenca e të dhënave ekonomike dhe modeleve lidhet me dhënien e informacionit ekonomik që përdoret në hartimin dhe në zbatimin e politikës monetare. Ajo përfshin transparencë në lidhje me të dhënat ekonomike që shfrytëzon banka qendrore, modelet që ajo përdor për të ndërtuar parashikimet ekonomike apo për të vlerësuar ndikimin e vendimeve të saj, dhe parashikimet e brendshme në të cilat ajo mbështetet.
3. Transparenca proceduriale (e vendimmarrjes) ka të bëjë me mënyrën se si merren vendimet e politikës monetare. Kjo transparencë arrihet nëpërmjet publikimeve të strategjisë së politikës monetare[1], të protokollit dhe të votave emërore të mbledhjeve të organit vendimmarrës.
4. Transparenca e veprimeve nënkupton shpejtësinë e shpalljes së vendimeve të politikës monetare. Përveç kësaj, ajo përfshin edhe shpjegimin e vendimit dhe prirjen e politikës monetare apo veprimet e mundshme që mund të ndërmerren në të ardhmen.
5. Transparenca operacionale lidhet me implementimin e politikave të veprimeve të bankës qendrore. Ajo përfshin vlerësimin e arritjes së objektivave operacionalë të politikës monetare, dhënien e informacionit mbi çrregullimet makroekonomike (të papritura) që ndikojnë në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, si dhe vlerësimin e rezultateve të politikës monetare në këndvështrimin e objektivave të saj makroekonomikë.

Pesë llojet e mësipërme të transparencës mund të evidentohen edhe në skemën e paraqitur në *figurën 1*, në seksionin e dytë. Secilës shigjetë me vija të ndërprera që përfaqëson kalim informacioni nga banka qendrore te publiku, në çdo hallkë të procesit të politikës monetare, i është vendosur një numër që përkon me një nga llojet e transparencës, të përshkruara më lart.

Për secilin nga pesë aspektet e transparencës të shtjelluara më sipër, ngrihen nga tre pyetje mbi llojin, sasinë dhe cilësinë e

informacionit që publikohet. Në varësi të përgjigjeve, vendosen 0 ose 1 pikë. Në disa raste ka edhe vlerësim të ndërmjetëm, prej 0.5 pikësh. Për ndërtimin e këtij indeksi në rastin e bankës tonë qendrore, u mor edhe mendimi i disa specialistëve të Bankës së Shqipërisë. Indeksi është llogaritur për vitin 2004 dhe për periudhën përpara vitit 1997.[2] Në *tabelën 1,* paraqitet përmbledhja e indekseve të transparencës për Bankën e Shqipërisë, së bashku me indekset e transparencës për bankat të tjera qendrore, të llogaritur nga Eijffinger dhe Geraats.

Siç shihet edhe nga tabela, vlera e indeksit të transparencës së Bankës së Shqipërisë është e krahasueshme me indeksin e bankave të tjera qendrore. Nëse e analizojmë transparencën sipas nënndarjeve të bëra nga vetë autorët e indeksit, vëmë re se Banka e Shqipërisë vlerësohet mirë përsa i përket nivelit të informacionit të dhënë mbi objektivat e politikës monetare (transparenca politike), vendimet e marra dhe veprimet e mundshme në të ardhmen (transparenca e veprimeve) dhe vlerësimin e objektivave finalë dhe operacionalë (transparenca operacionale). Ndërkohë sasia e informacionit lidhur me të dhënat, modelet dhe parashikimet (transparenca e të dhënave) dhe me mënyrën e marrjes së vendimeve të politikës monetare (transparenca e vendimmarrjes) është në nivele më të ulëta krahasuar me banka të tjera qendrore.

Përcaktimi nga ana sasiore i transparencës mundëson krahasimin mes bankave të ndryshme qendrore. Do të ishte me interes të krahasohej transparenca e Bankës së Shqipërisë me banka qendrore të vendeve që janë më afër nivelit të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, por aktualisht nuk disponohen indekse të transparencës së këtyre bankave. Megjithatë, duke patur parasysh synimin e Bankës së Shqipërisë për t'iu përafruar modelit të bankave qendrore të vendeve të zhvilluara, sidomos Bankës Qendrore Evropiane, krahasimi në vazhdimësi i transparencës me këto banka është më i rëndësishëm.

Tabelë 1

Transparenca e Bankës Qendrore[3]	BSH 1996	BSH 2004	BQE	Kanada	Australi	Japoni	Zelandë e Re	Suedi	Zvicër	Britani e Madhe	SHBA
Transparenca politike	1	3	3	3	3	1.5	3	3	2.5	3	1
Objektivi formal	0.5	1	1	1	1	0.5	1	1	0.5	1	0.5
Objektivi sasior	0	1	1	1	1	0	1	1	1	1	0
Marrëveshje institucionale	0.5	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0.5
Transparenca e të dhënave	0	0.5	2.5	2.5	2	1.5	3	2	1.5	3	2.5
Të dhënat ekonomike	0	0.5	1	1	0.5	1	1	1	1	1	1
Modelet	0	0	1	1	1	0	1	0	0	1	1
Parashikimet e Bankës Qendrore	0	0	0.5	0.5	0.5	0.5	1	1	0.5	1	0.5
Transparenca proceduriale (e vendimmarrjes)	0	1	1	1	1	2	3	3	1	3	2
Strategjia e politikës monetare	0	1	1	1	1	0	1	1	1	1	0
Publikimi i protokollit	0	0	0	0	0	1	1	1	0	1	1
Publikimi i votave	0	0	0	0	0	1	1	1	0	1	1
Transparenca e veprimeve	0	2	2	2	1.5	1.5	3	3	2	1.5	3
Shpallja e menjëhershme e vendimeve	0	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
Shpjegim i politikës së ndjekur	0	0.5	1	1	0.5	0.5	1	1	1	0.5	1
Prirjet e politikës	0	0.5	0	0	0	0	1	1	0	0	1
Transparenca operacionale	1	2	2	2	1.5	1.5	2	3	0.5	2.5	1.5
Objektiva operacionalë	0.5	1	1	1	1	0.5	1	1	0.5	1	1
Turbullirat e transmetimit	0	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5	1	0	1	0
Vlerësimi i rezultatit final	0.5	0.5	0.5	0.5	0	0.5	0.5	1	0	0.5	0.5
Totali	2	8.5	10.5	10.5	9	8	14	14	7.5	13	10

4.2 PROBLEMET E INDEKSIT (KUFIZIMET NË METODOLOGJI)

Gjatë llogaritjes së indeksit të transparencës për Bankën e Shqipërisë dalin në pah jo vetëm kufizime metodologjike të përgjithshme (që vlejnë për të gjitha bankat qendrore), por edhe probleme specifike për rastin e Shqipërisë. Kështu, indeksi i Eijffinger dhe Geraats, ashtu si edhe indekse të tjera të ngjashme, vlerëson transparencën vetëm në drejtim të sasisë së informacionit të dhënë dhe shumë pak në drejtim të cilësisë/qartësisë së tij. Ai nuk merr parasysh të kuptuarit e këtij informacioni nga publiku apo agjentët, që është një aspekt i rëndësishëm i transparencës (Winkler, 2000). Kështu, një vlerë e lartë e këtij indeksi nënkupton një dhënie të madhe informacioni, por kjo nuk do të thotë se transparenca ka ndihmuar maksimalisht në rritjen e efektivitetit të politikës monetare apo në rritjen e përgjegjshmërisë së bankës qendrore.

Një mangësi tjetër e këtij indeksi është edhe përfshirja e aspekteve të transparencës, që aktualisht janë të debatueshme në rrethin e ekonomistëve dhe të bankierëve qendrorë dhe që kanë të bëjnë me publikimin e votave emërore apo të protokollit të mbledhjeve të njësisë që merr vendimet e politikës monetare.[4]

Në vlerësimin e transparencës së Bankës së Shqipërisë, një nga arsyet e vlerës së ulët të indeksit, në krahasim me disa banka të tjera qendrore, është edhe mungesa e informacionit që sipas kritereve të indeksit duhet të publikohet. Këtu mund të sjellim si shembull disa seri kohore të cilat nuk publikohen sepse nuk ekzistojnë. Gjithashtu, që banka qendrore të publikojë një informacion të caktuar, ajo duhet të ketë një nivel të konsiderueshëm konfidence në vërtetësinë apo në saktësinë e tij. Kështu për shembull, banka qendrore duhet të arrijë një saktësi të mirë të parashikimeve të saj përpara se të fillojë publikimin e tyre, në të kundërt mund të rrezikohej besueshmëria e saj.

Një problem tjetër në matjen e transparencës me anë të këtij indeksi lind pasi ai merr parasysh edhe publikimin e informacioneve që aktualisht mund të mos jenë të nevojshme

për publikun shqiptar. Jo të gjitha informacionet që mund të japë një bankë qendrore kanë po të njëjtën rëndësi për publikun shqiptar si për publikun në vendet e tjera, kjo për vetë nivelin e zhvillimit të sistemit financiar në Shqipëri dhe të përfshirjes së publikut në të. Vlerësimi i transparencës bazuar vetëm në sasinë e informacionit të dhënë nga Banka Qendrore, do të ishte i paplotë. Për rrjedhojë, lind e nevojshme që ky vlerësim të plotësohet edhe me vlerësimin mbi të kuptuarit e publikut.

5. TË KUPTUARIT E PUBLIKUT DHE ROLI I NDËRMJETËSVE NË DHËNIEN E INFORMACIONIT

Shkalla e të kuptuarit të publikut lidhur me politikën monetare dhe rolin e bankës qendrore në ekonominë e vendit është një çështje të cilës i është kushtuar vëmendje, për vetë rëndësinë që paraqet për politikën monetare në arritjen e objektivit kryesor, atë të stabilitetit të çmimeve. Për të analizuar shkallën e të kuptuarit të publikut, ky i fundit mund të grupohet në dy kategori bazë: biznesi dhe konsumatori. Është e kuptueshme që këto dy grupe kanë nivele të ndryshme interesi mbi atë se çka ndodh me inflacionin, me kursin e këmbimit dhe me normat e interesit. Biznesi, si prodhues/tregtues, importues, si huamarrës dhe investues është i interesuar për të tre treguesit, duke përbërë kështu grupin më të interesuar mbi ekonominë e vendit në përgjithësi, dhe mbi veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë në veçanti. Nga ana tjetër, konsumatori mund të jetë i interesuar kryesisht për inflacionin, i cili mat fuqinë e tyre blerëse. Çeliku dhe Nasto (2004), duke analizuar një anketim të ndërtuar për këtë qëllim, arrijnë në konkluzionin se është rritur njohja e publikut me treguesin e inflacionit, i cili renditet informacioni më me interes për konsumatorët shqiptarë. Megjithatë, nuk mund të themi se publiku shqiptar është i mirinformuar mbi Bankën e Shqipërisë dhe punën e saj. Këtë e tregojnë edhe rezultatet e një vrojtimi të bërë në tetor 2003, ku afërsisht gjysma e të anketuarve nuk bënin mirë dallimin e përgjegjësive të Bankës së Shqipërisë, të INSTAT-it dhe të Ministrisë së Financave lidhur me inflacionin. Këto rezultate nuk vijnë si rrjedhojë e mungesës së informacionit, por e mungesës së interesit nga ana e publikut

për të thithur këtë informacion. Mungesa e interesit të publikut vjen si pasojë e mospërfshirjes në çështje që kanë të bëjnë me kursin e këmbimit, me normat e interesit. Konsumatori shqiptar nuk është shumë i lidhur me sistemin bankar. Depozitat në bankat e nivelit të dytë janë më shumë një mënyrë kursimi se sa fitimi, kështu që norma e interesit nuk është faktori kryesor. Kreditë konsumatore janë akoma në fillimet e tyre, ndërkohë që kreditë hipotekare, megjithëse në rritje, mbeten akoma zgjedhje e një pjese të vogël të popullsisë, si rrjedhojë e të ardhurave të pamjaftueshme. Nga ana tjetër, efekti i të kuptuarit nga ana e publikut në politikën monetare transmetohet nëpërmjet pritjeve, të cilat aktualisht nuk mund të thuhet se reflektohen sa duhet. Ndoshta për momentin ato nuk janë aq të rëndësishme për mekanizmin e transmetimit më shumë se sa për rritjen e besueshmërisë së Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë ka organizuar leksione dhe fushata sensibilizuese me qëllim rritjen e njohurive të publikut mbi detyrat e rolin e saj në ekonomi. Kjo është një gjë e mirë për sa kohë që nuk kthehet qëllim ne vetvete. Përveç kësaj, këto nisma janë produktive nëse zgjidhet një grup i publikut të cilit ky informacion mund t'i vlejë në një të ardhme të afërt, përndryshe efekti i informacionit humbet.

Një faktor tjetër i rëndësishëm që ndikon në të kuptuarit e publikut është edhe mënyra e tejçimit të informacionit të dhënë nga banka qendrore. Edhe nëse banka qendrore jep informacion të vërtetë dhe të shprehur qartë, ky informacion tek publiku mund të mos transmetohet saktë. Kjo ndodh për faktin se jo gjithmonë komunikimi i bankës qendrore me publikun është i drejtpërdrejtë, por realizohet nëpërmjet ndërmjetësve, kryesisht medias, që ndër të tjera është edhe udhëheqëse opinioni për publikun. Kjo shton rreziqet e shtrembërimit të informacionit, duke dobësuar kështu efektet pozitive të transparencës. Si rrjedhojë është e rëndësishme të vlerësohet se si ndërmjetësit raportojnë për vendimet e bankës qendrore, sepse ata mund të mos reflektojnë saktë vendimet e marra nga banka qendrore dhe arsyetimin që qëndron pas tyre.

Në shumicën e rasteve, reagimi i medias lidhur me Bankën e Shqipërisë është nxitur nga kjo e fundit. Artikujt ekonomikë lidhur me bankën qendrore vërehen kryesisht kur nga Banka e Shqipërisë jepen deklarata ose konferenca për shtyp. Në të tilla raste, gazetat publikojnë informacionin e dhënë nga banka duke iu përmbajtur me besnikëri materialit të shpërndarë nga zëdhënësi apo fjalimit të përfaqësuesit të bankës. Nga ana tjetër, në këta artikuj nuk mungojnë gabimet logjike në shpjegimin e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës, madje mund të hasen edhe gabime të rëndomta shtypi, por që sjellin keqinformim të publikut. Kjo është dhe një nga arsyet që Banka e Shqipërisë është angazhuar në organizimin e trajnimeve për gazetarët ekonomikë. Gjithashtu, analizat dhe komentet profesionale në fushën e bankingut qendror, megjithëse të shtuara kohët e fundit, mbeten ende të rralla.

Ndoshta për nivelin aktual të interesit të publikut, cilësia e ndërmjetësimit nga media në komunikimin e bankës qendrore me publikun mund të mos jetë problem shumë i madh. Por, me rritjen e nxitjes së publikut për të kuptuar rolin dhe punën e Bankës së Shqipërisë, si dhe me zhvillimin e tregut financiar dhe rritjes së rëndësisë së pritjeve të publikut në mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, roli i medias kthehet në një çështje shumë delikate.

6. KONKLUZIONE

Transparenca e bankës qendrore është një temë shumë e trajtuar dekadat e fundit. E konsideruar si element që ndikon veçanërisht në rritjen e përgjegjshmërisë dhe me rritjen e efektivitetit të politikës monetare, transparencës i kushtohet shumë rëndësi, sidomos në kuadër të regjimit të shënjestrimit të inflacionit. Në këtë material u bë një përpjekje për të vlerësuar transparencën e Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë në konceptin e saj jo thjesht dhënien e informacionit por edhe të kuptuarit nga publikut të këtij informacioni.

Aspekti i parë i transparencës, sasia e informacionit të dhënë nga Banka e Shqipërisë, u mat me anë të indeksit të transparencës

Eijffinger dhe Geraats (2003). Vlerat e indeksit për Bankën e Shqipërisë të llogaritura për dy periudha të ndryshme, para vitit 1997, rreth 2 pikë, dhe aktualisht, 8.5 pikë, tregojnë dukshëm rritjen e nivelit të saj vitet e fundit. Indeksi i transparencës prej 8.5 pikësh nga 15, nuk është shumë i ulët në krahasim me banka të tjera qendrore, duke qenë se vlera mesatare e indeksit për bankat e tjera është 10.7 pikë. Ky indeks mund të ishte edhe më i lartë nëse një pjesë e informacionit, që sipas kritereve të indeksit duhet të publikohej, nuk do të mungonte ose nuk do të cilësohej si konfidencial për Bankën e Shqipërisë. Për të patur një nivel indeksi më të lartë, përveç të tjerash, duhet një punë më e madhe në drejtim të sigurimit të një informacioni më të saktë, publikimi i të cilit do të kishte vërtet efekte pozitive.

Të kuptuarit e publikut është një vlerësim, jo i lehtë, cilësor i transparencës. Pavarësisht nivelit aktual të të kuptuarit të publikut shqiptar, ai mbetet i ulët, për vetë shkallën e zhvillimit të vendit tonë, sidomos të sistemit financiar. Interesimi i publikut për bankën qendrore dhe rolin e saj ka ardhur në rritje, kryesisht nga përfshirja e tij në këtë sistem. Nga ana tjetër, ajo për të cilën të kuptuarit e publikut ka rëndësi janë pritjet, të cilat pa patur se ku të reflektohen nuk e japin ende efektin e tyre në politikën monetare.

ANEKS: LLOGARITJA E INDEKSIT TË TRANSPARENCËS PËR BANKËN E SHQIPËRISË PËR PERIUDHËN PËRPARA VITIT 1997 DHE PËR VITIN 2004.

1.a A ka formulim formal të objektivit (objektivave) të politikës monetare, me një përcaktim të qartë prioriteti në rast se ka shumë objektiva?

Lidhur me këtë kriter Banka e Shqipërisë është vlerësuar me 1 pikë, pasi si objektivi formal, ashtu edhe prioriteti i objektivave janë të parashikuar qartë në ligjin nr. 8269, neni 3, pika 1.[5]

Përpara vitit 1997 vlerësimi është 0.5 pikë, pasi në atë periudhë, megjithëse kishte përcaktim formal të objektivave të politikës monetare, nuk përcaktohej qartë prioriteti i tyre.

1.b A shprehet objektivi kryesor nga ana sasiore?

Banka e Shqipërisë që nga viti 1999 ka shprehur kufijtë sasiorë të objektivit final të politikës monetare dhe e ka publikuar atë, fillimisht në raportet vjetore. Kohët e fundit shprehja e objektivit të stabilitetit të çmimeve në terma sasiorë është promovuar gjithnjë e më shumë. Objektivi final është përcaktuar nga ana sasiore në "Planin e zhvillimit afatmesëm të Bankës së Shqipërisë", si dhe në dokumentin e politikës monetare që përpilohet në fillim të çdo viti dhe që jep kuadrin e përgjithshëm të politikës monetare për vitin në vazhdim. Duke menduar se efekti i publikimit të objektivit final në terma sasiorë është i njëjtë, pavarësisht se nuk ka përgjegjësi ligjore për arritjen sasiore të tij, mendojmë që për këtë kriter të jepet vlerësimi 1 pikë.

Për periudhën përpara vitit 1997 vlerësimi është 0 pikë, pasi objektivi kryesor nuk publikohej i shprehur nga ana sasiore.

1.c A ka marrëveshje institucionale të qarta ose kontrata mes autoritetit monetar dhe qeverisë lidhur me pavarësinë e bankës qendrore?

Banka e Shqipërisë gëzon pavarësi ligjore të lartë (Cani, Baleta, 2002). Gjithashtu, megjithëse mendohet që pavarësia reale mund të jetë më e ulët se ajo ligjore, nuk ka patur raste të kompromettimit të saj nga politika fiskale. Si rrjedhojë, mendohet që vlerësimi i Bankës së Shqipërisë në lidhje me këtë kriter të jetë i plotë, pra 1 pikë.[6]

Në periudhën përpara vitit 1997, ligji për Bankën e Shqipërisë nuk i atribuonte asaj nivel të lartë pavarësie. Si rrjedhojë, për këtë kriter është menduar të vendosen 0.5 pikë.

2.a A publikohen të dhënat ekonomike të rëndësishme për politikën monetare? Merren në konsideratë 5 variabla: oferta monetare, inflacioni, PBB, norma e papunësisë dhe përdorimi i kapaciteteve, për të cilat seria kohore duhet të jetë me një frekuencë jo më të madhe se 3 muaj.

Përsa i përket këtij kriteri, Banka e Shqipërisë mund të vlerësohet me vetëm 0.5 pikë. Kjo pasi vetëm për tre nga pesë treguesit e mësipërm mund të gjenden të dhëna me frekuencë të paktën tremujore. Kështu, për ofertën monetare jepen të dhëna mujore, të publikuara në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu, të dhënat mujore për inflacionin dhe ato tremujore të papunësisë gjenden të publikuara si në faqen e internetit të Bankës ashtu edhe në atë të INSTAT-it. Duhet theksuar gjithashtu se arsyeja e mospublikimit të të dhënave të tjera, ka të bëjë me faktin që këto të dhëna nuk disponohen.

Përpara vitit 1997, vlerësimi për këtë kriter është 0 pikë, pasi vetëm dy prej pesë variablave të mësipërm, inflacioni dhe oferta monetare, publikoheshin me frekuencë jo më të madhe se 3 muaj.

2.b A e raporton Banka e Shqipërisë modelin (modelet) formal makroekonomik që përdor për analizat për politikën e saj?

Banka e Shqipërisë vlerësohet me 0 pikë për këtë kriter, pasi nuk publikohet asnjë model makroekonomik.

Gjithashtu, vlerësimi përpara vitit 1997 është 0 pikë , pasi edhe në atë periudhë nuk publikohej asnjë model makroekonomik, madje një model i tillë mund edhe të mos ekzistonte.

2.c A e publikon rregullisht parashikimin e saj?

Parashikimi i inflacionit konsiderohet si informacion konfidencial dhe si të tillë, Banka e Shqipërisë nuk e publikon. Si rrjedhojë, vlerësimi lidhur me këtë kriter është 0 pikë.

As në periudhën përpara vitit 1997 nuk publikohej një informacion i tillë, si rrjedhojë vlerësimi lidhur me këtë kriter është 0 pikë.

3.a A publikon Banka e Shqipërisë një rregull të qartë apo një strategji që përshkruan strukturën (kuadrin) e politikës monetare?

Vlerësimi i Bankës së Shqipërisë lidhur me këtë kriter është i plotë, 1 pikë, pasi strategjia e politikës monetare bëhet publike, duke filluar nga objektivat finalë, të ndërmjetëm dhe operacionalë dhe si mund të arrihen ata, e deri tek instrumentet e politikës monetare.

Përpara vitit 1997, nuk publikohej strategjia e qartë dhe e plotë e politikës monetare. Si rrjedhojë, vlerësimi për atë periudhë është 0 pikë.

3.b A publikon Banka e Shqipërisë një raport të hollësishëm të diskutimeve të organit vendimmarrës (apo të shpjegimeve, në rast të vendimmarrjes nga një person), brenda një periudhe kohe të arsyeshme?

Lidhur me këtë kriter Banka e Shqipërisë vlerësohet me 0 pikë, pasi protokolli i diskutimeve lidhur me marrjen e vendimeve të politikës monetare aktualisht nuk publikohet.

Vlerësimi për periudhën përpara vitit 1997 është gjithashtu 0 pikë, pasi edhe në atë kohë protokolli i diskutimeve lidhur me marrjen e vendimeve të politikës monetare nuk publikohej.

3.c A publikon Banka e Shqipërisë se si është arritur çdo vendim i organit vendimmarrës mbi nivelin e instrumentit apo objektivit kryesor operacional? (pyetja lidhet me publikimin ose jo të votave dhe nëse po, a janë ato emërore.)

Edhe për këtë kriter vlerësimi i Bankës së Shqipërisë është 0 pikë, pasi votat në procesin e marrjes së një vendimi mbi nivelin e instrumentit apo të objektivit kryesor operacional nuk publikohen.

As në periudhën përpara vitit 1997 nuk publikoheshin votat në procesin e marrjes së një vendimi mbi nivelin e instrumentit apo të objektivit kryesor operacional, si rrjedhojë vlerësimi është 0 pikë.

4.a A publikohen menjëherë vendimet mbi rregullimet në instrumentet apo në objektivat kryesorë operacionalë?

Vlerësimi për këtë kriter është i plotë, pra 1 pikë, sepse vendimet mbi ndryshimet e instrumentit të politikës monetare publikohen ditën e marrjes së vendimit.

Ndryshe nga sot, vendimet mbi ndryshimet e instrumentit të politikës monetare nuk publikoheshin ditën e marrjes së vendimit. Si rrjedhojë, vlerësimi për këtë kriter për periudhën përpara vitit 1997 është 0 pikë.

4.b A ofron Banka e Shqipërisë shpjegim kur shpall vendimet e politikës monetare?

Lidhur me këtë kriter është menduar që Banka e Shqipërisë të vlerësohet me 0.5 pikë. Shpallja e vendimeve të politikës monetare bëhet pothuajse gjithmonë me shpjegime apo vlerësime, por nuk mund të thuhet se shpjegimi është gjithmonë i plotë dhe i detajuar dhe nuk shoqërohet përherë nga vlerësimi për të ardhmen.

Banka e Shqipërisë përpara vitit 1997 nuk e shoqëronte marrjen e vendimit (në rast se e shpallte atë në publik) me

shpjegime të arsyeve që çonin në marrjen e këtij vendimi. Për këtë arsye, vlerësimi për këtë periudhë është 0 pikë.

4.c A publikon Banka e Shqipërisë një prirje/tendencë të qartë të politikës monetare pas çdo mbledhjeje apo një tendencë të qartë të mundshme të veprimeve të mëvonshme (të paktën çdo tre muaj)?

Përsa i përket këtij kriteri, Banka e Shqipërisë mund të vlerësohet me 0.5 pikë. Kjo pasi, pavarësisht përmirësimeve të dukshme në këtë drejtim, dhënia e tendencës së politikës monetare nuk është e detyrueshme të bëhet në mënyrë periodike.

Vlerësimi për këtë kriter për periudhën përpara vitit 1997 është 0 pikë, pasi nuk bëhej publike asnjë tendencë apo prirje e qartë e politikës monetare.

5.a A vlerëson Banka e Shqipërisë rregullisht se deri në çfarë mase objektivat e saj operacionalë janë arritur?

Objektivat operacionalë të politikës monetare aktualisht janë mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë dhe rezervat ndërkombëtare neto të saj. Për këta objektiva vendosen kufij sasiorë dhe përmbushja e tyre vlerësohet në çdo dokument periodik të politikës monetare, duke filluar nga ai mujor, deklarata gjashtëmujore, e deri tek raporti vjetor. Si rrjedhojë, për këtë kriter Banka e Shqipërisë vlerësohet me 1 pikë.

Edhe pse mund të jepeshin shifra lidhur me arritjen e objektivave operacionalë të politikës monetare, mungonte shpjegimi i detajuar lidhur me këtë çështje. Si rrjedhojë, për këtë kriter Banka e Shqipërisë për periudhën përpara vitit 1997 vlerësohet me 0.5 pikë.

5.b A jep Banka e Shqipërisë rregullisht informacion mbi çrregullimet (e papritura) makroekonomike që ndikojnë procesin e transmetimit të politikës monetare?

Informacioni mbi çrregullimet makroekonomike, të papritura

apo jo, jepet të paktën një herë në tre muaj në raportet e politikës monetare. Por, duke qenë se jo gjithmonë vlerësohet ndikimi i tyre në mekanizmin e transmetimit dhe mungojnë diskutimet mbi gabimet në parashikimin e këtyre çrregullimeve, Banka e Shqipërisë vlerësohet me 0.5 pikë për këtë kriter.

Përpara vitit 1997, lloji i mësipërm i informacionit ose ka munguar, ose nuk ka qenë i shpeshtë. Për këtë arsye vlerësimi për këtë kriter është 0 pikë.

5.c A jep rregullisht Banka e Shqipërisë vlerësim të rezultateve të politikës nga këndvështrimi i objektivave makroekonomikë?

Vlerësimet e rezultateve të politikës monetare nga këndvështrimi i objektivave makroekonomikë të Bankës së Shqipërisë publikohen rregullisht, por nuk shpjegohet në mënyrë të matshme nga ana sasiore kontributi i politikës monetare në arritjen e tyre. Si rrjedhojë, vlerësimi për këtë kriter është 0.5 pikë.

Edhe për periudhën përpara vitit 1997, Banka e Shqipërisë vlerësohet me 0.5 pikë, pasi shpjegimet nuk kanë qenë të qarta sa duhet, dhe përveç kësaj, mungonte edhe vlerësimi sasior i kontributit të politikës monetare në arritjen e objektivave makroekonomikë.

SHËNIME

* Sofika Note, specialiste, Departamenti i Kërkimeve.

[1] Me strategji të politikës monetare do të kuptohet kuadri i përgjithshëm i saj: objektivat finalë, të ndërmjetëm dhe operacionalë të politikës monetare dhe mënyra e arritjes së tyre, si dhe instrumentet e politikës monetare.

[2] Llogaritja e indeksit për Bankën e Shqipërisë jepet në aneksin e këtij artikulli (faqe 416).

[3] Për bankat e tjera qendrore përveç Bankës së Shqipërisë, indeksi është llogaritur nga Eijffinger dhe Geraats në vitin 2002.

[4] Blinder etj. (2001) paraqet një diskutim më të hollësishëm lidhur me këtë çështje.

[5] Sipas ligjit nr. 8269, neni 3, pika 1, objektivi i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Objektivat e tjerë të saj kushtëzohen nga objektivi kryesor.

[6] Ligji për Bankën e Shqipërisë, neni, 1 pika 3.

BIBLIOGRAFIA

Ball, Laurence, "The Genesis of Inflation and the Costs of Disinflation", Journal of Money, Credit and Banking, August 1991.

Blinder, Alan, "*Central Bank Credibility: Why Do We Care? How Do We Build It*", NBER, wp 7161, June 1999.

Blinder, Alan; Goodhart, Charles; Hildebrand Philipp; Lipton, David; Wyplosz, Charles, "*How do Central Banks Talk*", Geneva Report on the World Economy, No. 3. London: Centre for Economic Policy Research, October 2001.

Cani, Shkëlqim; Baleta, Teuta, "B*anka e Shqipërisë: Sa e pavarur është ajo?*", Banka e Shqipërisë, 2002.

Issing, Otmar, "*The Euro Area and the Single Monetary Policy*", Österreichische Nationalbank, wp 44, 2001

Çeliku, Evelina; Nasto, Rezarta, "*Sinjalet e Bankës së Shqipërisë përballë biznesit dhe publikut*", Banka e Shqipërisë, 2004.

Eijffinger, Sylvester C.W., Geraats, Petra M., "*How Transparent are Central Banks* ", July 2003.

Eijffinger, Sylvester C.W., Hoeberichts, Marco M., "*Central Bank Accountability and Transparency: Theory and Some Evidence*", Economic Research Center of Deutsche Bank, Discussion Paper 6/00, November 2000.

Freedman, Charles, "*The Value of Transparency in Conducting Monetary Policy*", Federal Reserve Bank of St. Louis, Panel Discussion: Transparency in the Practice of Monetary Policy, July/August 2002.

Geraats, Petra M., "*Central Bank Transparency*", University of Cambridge, March 2000.

Taylor, John B., "*Union Wage Settlements During a Disinflation*", American Economic Review, 73, December 1983.

Winkler, Bernhard, "*Which Kind of Transparency? On the need for clarity in monetary policy-making*", ECB wp26, August 2000.

Vrojtim për tërheqjen e opinionit mbi arsyet e rritjes së çmimeve në pragfesta nga bizneset dhe të "pranimit" nga konsumatori të kësaj rritjeje, Banka e Shqipërisë, 2003.

ROLI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN NË AUDIENCAT E BANKËS SË SHQIPËRISË

*Esmeralda Uruçi**
Bledar Striniqi

Fjalë kyçe
- Marrëdhënie me publikun - Komunikim - Media - Faqja e internetit -

HYRJE

Termin "marrëdhënie me publikun" e kemi hasur për herë të parë në fjalimin e Thomas Jefferson-it me 1807 në Kongresin Amerikan.

Në fakt, aty nuk flitet prerazi për marrëdhënie publike, por për marrëdhënie ndërkombëtare. Sidoqoftë, konceptet për marrëdhëniet me publikun që atëherë kanë evoluar, duke zënë një vend të rëndësishëm në veprimtarinë e përditshme të individit e të shoqërisë. Leksioni i parë mbi marrëdhëniet me publikun është mbajtur nga Edward Bernays në Universitetin e New Yorkut në vitin 1923.

Me marrëdhënie me publikun ne duhet të kuptojmë përpjekjet e planifikuara e të mbështetura mirë, për të ndërtuar e mbajtur në nivel sa më të lartë raportin në mes të publikut dhe institucionit, në këtë rast Bankës së Shqipërisë. Si një nga funksionet kryesore të administrimit, marrëdhëniet publike merren me rritjen e mëtejshme të reputacionit të Bankës së Shqipërisë në publikun e gjerë. Në këtë proces ato përcaktojnë se çfarë i duhet thënë publikut si dhe çfarë mendon e thotë publiku për institucionin në fjalë. Pra, ideja është që të harmonizohen sa më mirë interesat

e palëve. Një pozicion delikat marrin marrëdhëniet me publikun në rastet kur institucioni goditet në momente krizash, siç ishte rasti i Bankës së Kursimeve, ku klientët tërhoqën në një kohë të shkurtër 17 miliardë lekë. E thënë me pak fjalë, marrëdhëniet me publikun duhen kuptuar si "shkenca" që kujdeset për reputacionin e Bankës së Shqipërisë, me synimin që ajo të fitojë sjelljen, mirëkuptimin dhe mbështetjen e publikut të gjerë. Një konceptim i tillë i marrëdhënieve me publikun ka ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e besueshmërinë tek Banka e Shqipërisë.

Duhet thënë se matja e performancës së marrëdhënieve me publikun nuk është e lehtë. Njerëz të thjeshtë, por edhe specialistë të fushës pyesin: Sa i matshëm është rezultati në këtë aspekt? Matja e efektivitetit të marrëdhënieve me publikun është e lidhur me suksesin e programeve, të strategjive, të aktiviteteve dhe të taktikave të përdorura, duke analizuar "produktet" apo "rezultatet" e dala.

Duke u ndalur pikërisht në matjen e efektivitetit, studiuesi i njohur David W. Davenport, shkruan: *"Problemi më i madh në komunikim është iluzioni se komunikimi është realizuar". Komunikimi është sa i rëndësishëm aq edhe i vështirë, për më tepër kur synojmë që ai të jetë efektiv.*

Për të realizuar këtë mision, Banka e Shqipërisë është përpjekur dhe mund të thuhet se ka patur rezultate në këtë drejtim. Fakti që materiale të ndryshme të Bankës së Shqipërisë prezantohen në faqen e internetit dhe shkrime të ndryshme publikohen në gazeta, na shtyn ne të nxjerrim konkluzionin se produkti ynë kuptohet nga shumë njerëz, bëhet objekt debati për shumë të tjerë dhe relativisht shuan keqinterpretimet mbi zhvillimet në ekonomi.

Për të matur nivelin e komunikimit me mjedisin dhe komunitetin si dhe për të marrë vlerësimin e klasifikimin prej tyre, ne duhet të kemi parasysh:

- çfarë bëjmë,
- si dukemi,

- çfarë themi,
- si i shprehim ato që themi (Dale Carnegie, 1982).

Nga shkalla e realizimit të këtyre problemeve të shtruara për zgjidhje, varet komunikimi efikas me individët dhe me institucionet e interesuara. Në fakt, duket si e çuditshme që të flasin për komunikimin bankierët, që vazhdimisht sekretin e kanë patur armën e tyre kryesore. Në realizimin e kësaj detyre, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun ka përcjellë tek publiku i gjerë edhe rolin e bankave në administrimin e ekonomisë kombëtare si dhe promovimin e besimit tek investitorët dhe konsumatorët. Por, pse konsiderohet kaq me rëndësi ky rol? Dihet roli i bankës qendrore (Bankës së Shqipërisë) në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe në përpjekjet për rritje të qëndrueshme ekonomike. Problemi është që të rritet besimi i publikut në veprimet dhe në vendimet e saj. Për realizimin e këtij objektivi duhet rritur vazhdimisht niveli i komunikimit apo aftësia komunikuese me audiencën.

Për të përmirësuar punën e për të rritur cilësinë, disa vende kanë ngritur IRO (Zyra për Marrëdhëniet me Investitorët), qëllimi i të cilave është të inkurajojnë komunikimin me publikun. Por, nuk mjafton vetëm kaq, sepse komunikimi me komunitetin e investitorëve (vendas dhe të huaj), duhet të jetë një komunikim i vazhdueshëm dhe konsistent. Ata duhen bindur për qëndrueshmërinë disavjeçare makroekonomike, pasi ambienti makroekonomik është një parakusht i rëndësishëm për investimet e tyre të mundshme.

Gjithashtu, në marrëdhëniet me publikun duhen vlerësuar e përmirësuar më tej instrumentet e komunikimit. Është provuar tashmë se publikimet e ndryshme apo mesazhet elektronike të dërguara, pranohen dhe pëlqehen nga komuniteti i biznesit dhe përbëjnë një element të rëndësishëm të komunikimit. Publiku duhet të bindet se Shqipëria ka një vizion, një plan për ta realizuar këtë vizion dhe një ekip (grup njerëzish) të aftë për të ndjekur zbatimin e këtij plani. Banka qendrore duhet të jetë e aftë për t'iu përgjigjur në kohë edhe mjaft pyetjeve të audiencës mbi performancën ekonomike të Shqipërisë dhe ambientin e krijuar, i cili favorizon biznesin dhe rritjen ekonomike të vendit.

ÇFARË KA PARASYSH BANKA E SHQIPËRISË NË KOMUNIKIMIN E SAJ ME PUBLIKUN?

Banka e Shqipërisë vazhdimisht synon të komunikojë në mënyrë të besueshme mbi realitetin ekonomik të vendit dhe pa slogane të mërzitshme. Pakkush është i interesuar të dëgjojë shpjegimet me terma akademikë për fenomenet e ndryshme ekonomike por dihet se të gjithë interesohen për parashikimet mbi ekonominë kombëtare dhe atë botërore. Suksesi në komunikimin me publikun i dedikohet pikësëpari gjuhës së thjeshtë dhe së dyti, besueshmërisë që gëzon institucioni në publik.

Banka e Shqipërisë, ka objektiva të qartë komunikimi, të cilët synojnë t'i shpjegojnë publikut (në varësi të interesave të grupeve të ndryshme) efektet e vendimeve të Bankës së Shqipërisë për të ardhmen e ekonomisë. Veçanërisht bizneset, pronarët dhe administratorët e tyre, duke njohur efektet afatshkurtra dhe afatmesme të vendimeve të ndryshme, kanë mundësi të reagojnë në kohë me qëllim shmangien e pasojave negative të tyre, por sidomos me qëllim rritjen e fitimit të planifikuar.

Por, sa efikase ka qenë Banka e Shqipërisë në zgjedhjen e instrumenteve të komunikimit? A kanë mjaftuar njoftimet për shtyp apo publikimet njohëse-edukative për ta njohur publikun me rolin dhe me funksionet e Bankës së Shqipërisë, dhe për të përcjellë mesazhet e vendimeve të saj në publik?

Parimet mbi të cilat është ndërtuar puna në këtë institucion, na shtyjnë të njohim më thellë partnerët, bashkëpunëtorët e përgjithësisht grupet e njerëzve apo komunitetet me të cilat na lidhin interesa të punës imediate e në perspektivë. Për këtë ne duhet të njohim origjinën e çdo komuniteti të dhënë, përbërjen dhe interesat e tij. Qëllimi është të rrisim gjithnjë e më shumë vlerat e lidhjeve e të bashkëpunimit për të dyja palët.

Në shërbim të këtyre politikave është edhe puna e diferencuar që është bërë në fushën e marrëdhënieve publike. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë ka zbatuar mënyra të ndryshme komunikimi me audiencën. Ajo ka bërë punë të diferencuar

përkundrejt elitës së biznesit, bankierëve apo studiuesve të ekonomisë, politikanëve, studentëve të ekonomisë dhe publikut të gjerë.

Në këtë veprimtari të rëndësishme, detyra të veçanta e specifike ka Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, i cili në problemet e komunikimit është përqendruar në audiencat tek të cilat duam të hyjmë; tek përcaktimi i intervaleve kohore në të cilat duhet të komunikojmë, në zgjedhjen e argumenteve që paraqesin interes për auditorin si dhe në përzgjedhjen e gjuhës e të stilit me të cilin duhet komunikuar.

ÇFARË SYNOHET DHE ÇFARË DUHET TË BËJMË?

Së pari, duhet të njohim në thellësi çfarë janë marrëdhëniet publike dhe komunikimi, çfarë detyrash duhet të kryejnë specialistët apo departamentet që punojnë në këtë fushë. Dhe më së fundi, cili është ndikimi i tyre në rezultatet e Bankës së Shqipërisë.

Për të sqaruar këtë, ne duhet të bëhemi të ndërgjegjshëm se në realizimin e objektivave do të kemi suksese, nëse arrijmë që së bashku me ne të jetë edhe opinioni publik.

Marrëdhëniet me publikun ne duhet t'i kuptojmë si përpjekje të qëndrueshme e të planifikuara për të vendosur dhe për të ruajtur vullnetin e mirë dhe mirëkuptimin reciprok ndërmjet institucionit dhe publikut të tij. Ideja është që nëpërmjet punës të fitohet mirëkuptimi, mbështetja dhe veçanërisht influenca mbi opinionin dhe sjelljen e publikut të gjerë. Vënia në jetë e marrëdhënieve me publikun është e gjerë dhe shumëplanëshe. Ajo arrihet në rradhë të parë duke publikuar të rejat dhe arritjet pozitive, nëpërmjet të cilave rritet kredibiliteti i institucionit dhe kufizohen dëmet që mund t'i shkaktohen reputacionit të tij në rastin e shpërthimit të një krize.

Në marrëdhëniet publike dhe komunikimin, të rëndësishme janë fazat e planifikimit të punës. Më së pari, ne duhet të bëjmë analizën e situatës, me qëllim identifikimin e problemeve. Më

pas, ne duhet të përcaktojmë objektivat, konsumatorin e synuar, mesazhet, strategjinë, metodat dhe buxhetin.

Në fund, ne duhet të bëjmë me kujdes vlerësimin e punës, të përcaktojmë drejt rezultatet e arritura dhe të nxjerrim mësime për të ardhmen. Në arritjen e rezultateve në fushën e marrëdhënieve publike, parësor është administrimi i punëve. Është thënë dhe provuar tashmë, se sekreti i një programi të suksesshëm të marrëdhënieve me publikun është planifikimi i kujdesshëm i punës në zbatim të një strategjie të përcaktuar e të zgjedhur në përputhje me interesat e institucionit.

Marrëdhëniet publike, në çdo rast, duhet të jenë në korent të të gjitha problemeve duke bërë kërkime në fushat më me interes.

Edhe përcaktimi i objektivave që vendosen në programin e institucionit është shumë i rëndësishëm. Më së pari, duhet klasifikuar e përcaktuar qartë se kush është publiku i organizatës, firmës apo institucionit. Ose më thjesht, kush janë ata që do të blejnë produktet, do të përfitojnë shërbimet apo që luajnë një rol të caktuar në aktivitetin e institucionit. Me një fjalë, është e nevojshme të përcaktohet dëgjuesi ose auditori, të cilit duhet t'i drejtohet programi i marrëdhënieve publike. Të rëndësishme në programin e hartuar janë edhe mesazhet që jep institucioni për publikun e gjerë. Nëpërmjet tyre, ai arrin të komunikojë me publikun apo me komunitetet e interesuara me një mënyrë të qartë, të shkurtër dhe të thjeshtë. Mesazhet duhet të jenë të tilla që të mbahen mend me lehtësi nga audienca.

Që të kemi sukses për realizimin e objektivave duhet patjetër të përfundohet një plan i përgjithshëm ku duhen pasqyruar prioritetet e institucionit, të cilat duhen realizuar doemos.

MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIA

Nuk mund të ketë rezultate në fushën e marrëdhënieve publike, nëse në mes tyre dhe audiencës nuk funksionon një

hallkë ndërmjetëse shumë e rëndësishme e funksionale siç është media. Në programin e marrëdhënieve me publikun janë të përfshira edhe lidhjet e bashkëpunimi i gjerë me median e shkruar dhe me atë elektronike. Duke i ndërtuar drejt këto marrëdhënie, institucioni, në këtë rast Banka e Shqipërisë, arrin të tregojë se cili është, çfarë mund të bëjë, çfarë shërbimesh i ofron publikut të gjerë dhe më në fund, cila është përfitueshmëria e këtij bashkëpunimi.

Bashkëpunimi me median realizon në një kohë shumë të shpejtë dhe efektive përcjelljen e mesazheve të institucionit drejt një numri shumë të madh njerëzish, të cilët në mënyrë të përditshme i marrin këto mesazhe apo informacione me anë të shtypit, radios apo televizionit. Këto mesazhe janë produkt i bashkëpunimit të gazetarëve me specialistët e këtyre fushave. Ruajtja e raporteve të mira me gazetarët dhe me median në përgjithësi, do t'i nxitë ata për të rritur bashkëpunimin, e për rrjedhojë për të pasqyruar punën e institucionit.

Banka e Shqipërisë i kushton shumë rëndësi edhe mjeteve të komunikimit me audiencën si dhe komunikimit brenda rradhëve të saj. Mjetet më të përshtatshme për komunikimin janë buletinet, njoftimet për shtyp, shkrimet në gazeta dhe revista etj.. Megjithëkëtë, ato nuk duhen mbivlerësuar dhe gjithmonë duhet të jemi në kërkim të formave të reja të komunikimit. Gjithashtu, në këtë fushë përfshihen edhe materialet e shtypit, opinionet e specialistëve apo të drejtuesve, të cilat flasin dhe komentojnë punën, të metat dhe rezultatet e institucionit.

Në raportet e marrëdhënieve publike me median janë të rëndësishme të përcaktohen metodat më efektive me të cilat do të punohet për realizimin e programit të hartuar. Që në fazën e planifikimit, ne duhet të marrim në konsideratë jo më pak se tre metoda apo variante, për të cilat duhet të llogarisim edhe kostot përkatëse. Këtu duhet të kemi parasysh të mos kërkojmë gjithnjë koston më të ulët. E rëndësishme është se ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet për të arritur objektivat e përcaktuar dhe jo për të kursyer paratë. Paratë që kursehen atje ku nuk duhen kursyer, janë para që shpenzohen kot.

Duam të theksojmë se marrëdhëniet publike janë një nga aspektet më të rëndësishëm të administrimit të punës. Ato janë një lloj shërbimi pa një produkt në fund, por janë të tilla që mbështesin të gjitha aktivitetet operative të një biznesi, të një firme apo të një institucioni. Marrëdhëniet publike duhet të menaxhohen nga njerëz me nivel të lartë profesional. Ato zakonisht janë përgjegjësi e personave me një pozitë të caktuar në organizatën ku ata punojnë. Është interesant fakti se nga një vëzhgim i bërë nga Shkolla e Biznesit në Universitetin e Harwardit është vërtetuar se krerët e çdo firme, organizate apo institucioni shpenzojnë rreth 60 për qind të kohës së tyre të punës në marrëdhëniet me publikun. Gjatë këtij intervali kohor, ata realizojnë veprimtari të tilla, të cilat përfshijnë komunikimin e mesazhit të firmës, nëpërmjet shtypit, radios ose televizionit, angazhimin në të folurin direkt me publikun, ku ata prezantojnë veprimtarinë e vetë institucionit.

NJOFTIMET PËR SHTYP, SHKRIMET DHE KOMENTET NË GAZETA

Njihet tashmë efekti i njoftimit për shtyp, dalja e tij dhe reagimi i mediave. Nëse kemi nxjerrë një njoftim të ri, atëherë duhet të jemi gati për t'iu përgjigjur qindra telefonatave dhe mesazheve e-mail nga publiku. Njoftimet për shtyp mbeten edhe sot mënyra më e thjeshtë dhe më e lirë për komunikimin me publikun.

Një njoftim i tillë përbëhet nga një deri në dy faqe dhe përdoret për të tërhequr vëmendjen e publikut. Ai u dërgohet mediave, duke u kërkuar botimin në një kohë sa më të shpejtë, sepse përndryshe informacioni e humbet freskinë dhe vlerën.

Për periudhën 2002-2004, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun ka rritur ndjeshëm njoftimet për shtypin. Duke ndjekur e pasqyruar me korrektësi problemet në Bankën e Shqipërisë, njoftimet kanë qenë të shpejta dhe janë lexuar e mirëpritur nga të interesuarit.

	2004	2003	2002
Njoftime për shtyp	105*	99	50

105*)Parashikuar, mbi bazën e ecurisë 7- mujore janar-shtator 2004, ndërkohë janë realizuar 75 njoftime për shtyp deri në fund të periudhës.

Mediat kanë rëndësi strategjike për çdo organizatë dhe institucion, pasi me ndihmën e tyre përcillet informacioni tek publiku i gjerë. Ato kanë një ndikim të veçantë në opinion shoqëror. Megjithëse hapësira kohore që mediat mund t'i kushtojnë një problemi është e kufizuar, përsëri ajo arrin të përcjellë mesazhe me shumë vlerë, si për institucionin ashtu dhe për audiencat e interesuara.

Nuk duhet të harrojmë se mediat veprojnë në një mjedis të ashpër konkurrencial. Duke patur në konsideratë këtë të dhënë, Banka e Shqipërisë nëpërmjet specialistëve të saj si dhe Departamentit të Marrëdhënieve me Publikun është përpjekur të krijojë raporte korrekte e të ngrohta me gazetarët dhe me median në tërësi, duke u krijuar kushte të përshtatshme pune si dhe duke u vënë në dispozicion materiale, për të cilat ato janë të interesuara.

Në këtë drejtim, me vlerë janë edhe seminaret e trajnimit që ka organizuar Banka e Shqipërisë për gazetarët.

FAQJA E INTERNETIT SI INSTRUMENT EFIKAS KOMUNIKIMI

Sot gjithnjë e më shumë po merr peshë debati lidhur me vlerat që ka interneti dhe informacioni që përhapet nëpërmjet tij, përkundrejt mediave të shkruara dhe atyre vizive.

Holanda bashkë me Japoninë, Britaninë e Indinë kanë lexueshmërinë më të lartë të gazetave në botë, ku 75% e familjeve abonohen në një të përditshme. Ndërkohë, gazetat renditen në vendin e katërt si mjet i shpërndarjes së lajmeve pas televizionit, radios dhe internetit. Në këto vende 9% preferojnë gazetat, 17% preferojnë internetin, 35% radiot, ndërsa 39% televizionet. Sipas një studimi të Project for Excellence in Journalism dhe Columbia School of Journalism, televizionet janë në rënie të theksuar krahasuar me format e tjera të shpërndarjes së lajmeve. (Faqja e internetit e Missouri Department of Higher Education, http://www.dhe.mo.gov).

Shpejtësia e përhapjes së lajmeve nga interneti, kostoja e ulët e tij dhe shumëllojshmëria e informacionit të përfshirë aty, kanë rritur interesin e njerëzve.

Në një botë ku gjithnjë e më tepër mediat po përqendrohen në një numër të kufizuar duarsh, informacioni nëpërmjet internetit paraqet shumë interes.

Për të ruajtur kredibilitetin si institucion, si dhe besueshmërinë e informacionit dhe të aktivitetit të saj, Banka e Shqipërisë ka bërë e vazhdon të bëjë përpjekje në drejtim të rritjes së shkallës së informimit tek ambienti i jashtëm (institucione apo individë). Ajo është e orientuar drejt kërkimit, grumbullimit, analizës dhe shpërndarjes të këtij informacioni, në mënyrë që çdokush i interesuar të ketë mundësi për t'u njohur me vendimet dhe me veprimtarinë e saj.

Nëpërmjet faqes së internetit www.bankofalbania.org e cila është lançuar fillimisht në fundin e vitit 1999 dhe është ndryshuar këtë vit, Banka e Shqipërisë komunikon suksesshëm me publikun e interesuar dhe secili prej grupeve të targetuara gjen informacionin për të cilin interesohet. Në fund të muajit shkurt 2004, Banka e Shqipërisë ka lançuar faqen e re të internetit *www.bankofalbania.org*, e cila mendohet se do të kontribuojë më tepër në drejtim të komunikimit me publikun.

Megjithatë, ne duhet të përpiqemi që ta bëjmë atë gjithnjë e më atraktive.

Analiza për këtë problem duhet të nisë me përgjigjen ndaj pyetjes: A është faqja e internetit një zgjidhje e mirë për institucionin si dhe çfarë duhet të bëjmë për ta patur atë sa më të pasur dhe sa më interesante.

Një analizë e tillë si dhe konkluzionet që dalin prej saj, do të na ndihmojnë për të përcaktuar objektiva të qartë lidhur me faqen e internetit dhe me atë se çfarë kërkon vizitori i saj.

Muajt	Numri i vizitorëve
Janar-04	0
Shkurt-04	4
Mars-04	2095
Prill-04	2653
Maj-04	3060
Qershor-04	2667
Korrik-04	2691
Gusht-04	2672
Shtator-04	2579

Nga statistikat mbi vizitat në faqen e internetit www. bankofalbania.org (Faqja e re e internetit u lançua në fund të muajit shkurt 2004).



Për këto arsye, Banka monitoron në mënyrë të vazhdueshme përdorimin dhe vizitorët e faqes së saj të internetit. Ajo kujdeset për të bërë identifikimin e vizitorëve, si dhe të interesave që ata kanë për informacione të ndryshme.

Në faqen tonë të internetit, numri mesatar ditor i vizitorëve (pa fundjavat) ka qenë 258. Tendenca është drejt një rritjeje të qëndrueshme, mesatarisht më shumë se 20 në muaj, ku 70 për qind i përkasin vizitorëve jashtë Shqipërisë dhe kërkuesve të informacionit në gjuhën angleze. *Në muajin maj, numri i vizitave në faqen e Bankës së Shqipërisë është rritur në 3060 në krahasim me muajin mars që ishte 2095,* duke na dhënë një

fakt lidhur me rritjen e interesimit ndaj informacioneve që Banka e Shqipërisë jep në faqen e saj të internetit. Fluksi më i madh është në mesjavë, gjë që lidhet me natyrën e informacionit që përmban faqja jonë.

Kohët e fundit është rritur vëmendja për pjesën në gjuhën angleze, sidomos për pjesën informative dhe atë të statistikave.

Nisur nga interesi për publikimet, Banka e Shqipërisë planifikon që në një të ardhme të afërt të nxjerrë edhe një "CD-offline" me publikimet e saj dhe me pjesë të tjera të rëndësishme nga faqja e internetit.

Analiza e kohëzgjatjes së vizitave në këtë faqe tregon se pjesa më e madhe e vizitorëve qëndrojnë pak (deri në 5 minuta 67.90% e vizitorëve) ndërkohë dy tregues domethënës janë vizitat 30-60 minuta (7.7%) dhe vizitat mbi 1 orë (5.7%).

Faqja e internetit www.bankofalbania.org përditësohet në mënyrë të planifikuar. Ajo është e organizuar në pjesën më të madhe në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, me përjashtim të rasteve kur për shpejtësi informimi, ai publikohet fillimisht vetëm në gjuhën shqipe. Veç kësaj ekziston edhe një kontroll i vazhdueshëm i materialeve që publikohen lidhur me saktësinë si dhe përditësimin.

Informacioni që përmban faqja e internetit është i llojeve dhe fushave të ndryshme. Ai përfshin informacion me shkallë të gjerë përdorimi siç është kursi i këmbimit, interesat e tregut të bonove apo kalendari i bonove, si dhe informacion të përgjithshëm mbi organizimin dhe strukturën e Bankës, zhvillimet në politikën monetare, aktivitete dhe vendime kryesore të Bankës së Shqipërisë, statistika mujore e vjetore të sektorit monetar e real, një numër publikimesh të raporteve vjetore, të deklaratave të Bankës së Shqipërisë, artikuj, materiale diskutimi, analiza dhe vrojtime, konferenca shtypi të Guvernatorit, njoftime të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës etj..

MARRËDHËNIET PUBLIKE *ONLINE*

Banka e Shqipërisë i kushton rëndësi të veçantë komunikimit *online* me publikun ose siç njihen ndryshe, marrëdhëniet *online* me publikun.

Në rubrikën "Përshtypje" të faqes së internetit të Bankës së Shqipërisë, u jepet mundësia vizitorëve që të japin opinione lidhur me përmbajtjen e faqes, si dhe me nevojat e ndryshme për informacion të mëtejshëm. Të interesuarit, opinionet e tyre mund t'i shprehin edhe me anë të regjistrimit *online* apo me e-mail tek adresa public@bankofalbania.org. (20-30 kërkesa vijnë çdo ditë dhe sistematikisht ato marrin përgjigje.) Kjo mënyrë komunikimi rrit mundësitë për dialogim midis Bankës dhe publikut, duke ndihmuar në përmirësimin e kësaj faqeje dhe në përafrimin e vazhdueshëm me kërkesat dhe me nevojat e publikut.

MIRATIMI I PUBLIKUT

Studiuesi Arthur W.Page shkruan: "…jetoni me miratimin e publikut…sa më shumë aprovim të keni, aq më mirë do të jetoni." (Arthur W.Page, 2002.)

Në shërbim të këtyre lidhjeve, Banka e Shqipërisë ka organizuar shpërndarjen e pyetësorit "Banka e Shqipërisë, sa e njeh publiku atë"., me të cilin ka synuar të mësojë sa e njeh publiku i gjerë këtë institucion dhe sa i kupton ai funksionet dhe aktivitetin e tij. Ky pyetësor u shpërnda për plotësim në disa grupe të popullatës, si në biznese të vogla dhe të mesme, biznese të mëdha, shkollat e mesme, shkollat e larta (fakultete ekonomike),shkollat e larta (fakultete joekonomike), pensionistë dhe kalimtarë të rastit.

Rreth 1000 pyetësorë u shpërndanë në Tiranë dhe në rrethet Lushnjë, Gjirokastër, Korçë, Elbasan dhe Shkodër në përpjesëtim me peshën e tyre në popullsinë e Shqipërisë.

Pyetësori përmbante 16 pyetje, me qëllim identifikimin e nivelit të njohjes së institucionit të Bankës së Shqipërisë nga publiku,

funksioneve të saj, si dhe nevojën e publikut për informacion shtesë mbi sistemin bankar dhe funksionimin e tij.

Analiza e rezultateve të pyetësorit tregoi se:

- 93.04% kanë dëgjuar të flitet për Bankën e Shqipërisë;
- pjesa më e madhe, 77.03% e të anketuarve kanë dëgjuar për Bankën e Shqipërisë nga mediat e shkruara ose ato vizive;
- një pjesë e mirë e të anketuarve (63.72%) e njohin konceptin e inflacionit, pasi e interpretojnë drejt atë. Gjithashtu, pjesa më e madhe (52.4%) e dinë që autoriteti përgjegjës për kontrollin e inflacionit është Banka e Shqipërisë;
- një pjesë e konsiderueshme; 41.70% e të anketuarve mendojnë se Banka e Shqipërisë jep kredi (nuk njihet mirë roli dhe funksionet) dhe po ashtu, pjesa më e madhe nuk njeh mirë organizimin e sistemit bankar shqiptar (51.71%).

Nga analiza që i është bërë rezultateve të pyetësorëve kuptohet qartë se Banka e Shqipërisë është një institucion me njohje të gjerë në publikun shqiptar.

Në këto rezultate kanë ndikuar edhe shkrimet mbi çështjet që mbulon banka qendrore (në rastin tonë Banka e Shqipërisë), qoftë të specialistëve të Bankës së Shqipërisë apo të analistëve jashtë saj, të cilat janë të pranishme thuajse çdo ditë në gazetat dhe në revistat shqiptare.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2004 në mediat e shkruara janë publikuar 108 shkrime të Guvernatorit, të drejtuesve dhe specialistëve të Bankës së Shqipërisë për probleme të ndryshme të ekonomisë shqiptare dhe për shpjegimin e vendimeve të marra nga institucioni i bankës qendrore në Shqipëri.

Po gjatë kësaj periudhe, në mediat e shkruara janë publikuar 168 shkrime të lidhura ngushtë me problematikat që mbulon Banka e Shqipërisë, nga studiues të ekonomisë, pedagogë të universiteteve apo punonjës shkencorë pranë institucioneve vendase apo ndërkombëtare.

MARKETINGU I FJALËS SË GOJËS DHE RËNDËSIA E TIJ

"Është thjesht një iluzion se elementet e marketingut po shesin produktet tuaja" - thotë Xhorxh Silverman, presidenti i firmës së "Konsulencës marketing" dhe autori i botimit "Sekretet e Marketingut –me fjalën e gojës".

"Realiteti është se njerëzit po vijnë tek ju, jo si rrjedhojë e aktivitetit tuaj marketing, por sepse ata kanë dëgjuar për ju nga burime të tjera…"

Gjithnjë e më tepër po fiton terren arsyetimi se "*fjala e gojës*" është shumë më efektive se mjetet konvencionale të marketingut të paguar. Ajo mbetet rezultative edhe në këtë nivel të zhvillimit të mjeteve të komunikimit dhe të fushatave promocionale.

Fjala e gojës, sipas Silverman, është komunikimi mes njerëzve mbi produktet dhe shërbimet, të perceptuara në mënyrë të pavarur nga vetë kompania.

Çfarëdo terminologjie të përdorësh,"fjala e gojës" ka rëndësi të veçantë. Në fakt, të gjesh njerëz për t'u folur shpesh dhe në mënyrë të favorshme njerëzve të duhur dhe në mënyrën e duhur, është më e mira që mund të bëjë një specialist marketingu.

Në teori, ky proces mbështetet në aftësitë dhe në cilësitë e personelit të marrëdhënieve me publikun. Marrëdhëniet me publikun kanë të bëjnë më tepër me dialog, me edukim dhe me besueshmëri.

Historikisht, tendenca e marketingut ka qenë "referimi tek ekspertët", por publiku po bëhet gjithnjë e më dyshues për institucionet tradicionale. Mjaft nga opinionistët dhe analistët të supozuar "të pavarur", rezultojnë të paguar nga vetë bizneset apo institucionet.

Duhet të dimë se çdo vit në SHBA, çdo individ shpenzon mesatarisht 800 usd për të mbuluar shpenzimet e reklamave që kryejnë bizneset, do apo s'do ai. 200 miliardë dollarë shpenzojnë

bizneset në SHBA çdo vit për reklamat në media. (http://www.aktuelno.com/MarketingPR). Mjaft nga këto do të kishin më tepër efektivitet nëse do të shpenzoheshin për marketingun e fjalës së gojës.

Shumë menaxherë kompanish dhe administratorë institucionesh e mendojnë sot se për emrin e firmës/organizatës, nuk kanë shumë rëndësi vëzhgimet dhe analizat e studiuesve. Fjala e gojës është ndoshta forma më e mirë e komunikimit. Njerëzit kanë tendencë të besojnë më tepër fjalët dhe pëshpëritjet sesa reklamat shumëmilionëshe dhe komentet e medias.

Marketingu i fjalës së gojës ka kosto të ulët dhe është mënyra më e natyrshme e komunikimit me publikun.

Në këto kohë të "bombardimit mediatik" një person merr mesatarisht rreth 1000 mesazhe në ditë. Në këtë mori informacionesh njerëzit janë të prirur t'i besojnë fjalëve të atyre njerëzve tek të cilët kanë krijuar besim.

Ata janë të lodhur nga sloganet publicitare dhe nga fushatat promocionale dhe kanë nevojë për informacion "pa ambalazh".

---

* Esmeralda Uruçi, Drejtore, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun. Bledar Striniqi, Përgjegjës i Sektorit të Publikimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun.

BIBLIOGRAFIA

Dale Carnegie; *How to Win Friends and Influence People*, ISBN: 0671723650; Publisher: Simon & Schuster Adult Publishing Group, June 1982.

Bates, D. *To inform and persuade*: *Public Relations from the Dawn of Civilization*, APR, Fellow PRSA, 2002

Robert W. Buchanan.Jr, Charles Lukaszewski; *Measuring the Impact of Your Web Site*; Publisher: John Wiley and Sons, January 1997.

Cutlip, S., Center, A. Effective Public Relations (Prentice Hall), Cutlip, S. (1994). *The unseen power: Public relations. A history.* Hillsdale, NJ: Erlbaum.

Dogjani, L. *Analiza e pyetësorit "Banka e Shqipërisë, sa e njeh publiku atë",* Banka e Shqipërisë, 2004.

Faqja e internetit e Missouri Department of Higher Education, (http://www.dhe.mo.gov)

Newsom,D., Van Slyke Turk, D., Krukeberg, D. This is PR: *The Realities of Public Relations* (Wadsworth). The Realities of Public Relations by Doug Newsom, Judy Van Slyke Turk and Dean Krukeberg. Publisher Wadsworth; July 2003. ISBN: 0534562639.

The rise of word of mouth marketing, 17 May 2004, Source: The Holmes Report (http://www.aktuelno.com/MarketingPR/details.asp)

Uruçi, E. *Marrëdhëniet publike dhe komunikimi*, leksion në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, 2004.

Botuar nga Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: 355-4-222230; 235568; 235569
Faks: 355-4-223558
public@bankofalbania.org

Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi: 800 kopje